**Reshat Sahitaj**

# *MUSA (Daut) HOTI*

***- Shënime, kujtime, përjetime, dokumente -***

**Prishtinë, 2011**

Recensentë

**Hamit Boriçi**

**Ali Podrimja**

**Behare Rexhepi - Sahitaj**

Redaktor

**Begzat Baliu**

**Faqosja**

**Berat Batiu**

**Ballina:**

**Autori**

**Prishtinë, 2011**

**Reshat Sahitaj**

# *MUSA (Daut) HOTI*

***- Shënime, kujtime, përjetime, dokumente -***

**UNIONI I SHKRIMTARËVE
DHE KRITIKËVE SHQIPTARË**

**PRISHTINË, 2011**

*Ky libër i dedikohet familjës së Musa Hotit: Mevlydës, Mimozës, Manushaqës, Martirit, Melisës dhe kujtimit të prindërve që nuk kursyen as jetën për lirinë e Kosovës dhe çeshtjës kombëtare, si dhe vëllezërve dhe motërave të tij. Mihrije Hoti, Abdullah Hoti, Isa Hoti, Melihate Hoti, Isuf Hoti, Idriz Hoti, Halil Hoti, Enver Hoti dhe Myrvete Hoti.*

*Autori*

***FAMILJA NË SHENJË KUJTIMI …***

***Babai na i la trashëgim vlerat më të shenjta që ekzistojnë: patriotizmin dhe dashurinë e Shqipërisë Natyrale.***

***(Manushaqe Hoti)***

Me krenari dhe dashuri të veçantë për bashkëshortin, babain, gjyshin dhe vëllaun, me mall të pa përshkrushëm, si dhe me dinjitet ju prezantojmë librin mbi veprimtarinë atdhetare të Musa Hotit.

Kujtimet e tij fisnike dhe bujare na mbajnë sot dhe për gjithmonë.

Ai për atdhe burrërojë dhe për atdhe flijoi.

Nëpërmes këtij libri, ju mundësojmë ta ndani odisejaden e disa momenteve të jetës së tij.

Të shkruhët per Musa Hotin, është një përgjegjësi e madhe që ia dhamë, dhe që e pranojë me shumë kurajë, shoku i tij Reshat Sahitaj.

Njëra prej arsyeve që na inicoi për hartimin e këtij libri është dëshira që te sistemohet veprimtaria e Musa Hotit për brezat e ardhshëm që të dinë veprimtarinë kombëtare të një njeriut i cili kontribuojë në momentet më vendimtare, më delikate dhe historike si dhe gjithmonë dinte t'i jepte popullit të tij, shpresën e Lirisë .

Për admiruesit e tij, Musa Hoti ishte një mbrojtës guximtar i të drejtave të shqiptarëve si dhe nji personazh i pa nënshtrushëm që punoi në mënyrë sistematike deri në vdekje për bashkimin e trojeve shqiptare.

Ai e kishte një ëndërr- Lirinë. Ai mbylli sytë duke e pare të realizuar vetëm pjesërisht ëndrrën e tij. Realizimi komplet i kësaj ëndrre u mbetët amanet brezave të ardhshëm që ta realizojnë.

Bashkëshorti im më dhurojë një thesar: një Yll dhe tri Lule të bukura, që janë më të shtrenjtë se çdo gjë. Nëpërmes tyre, Musa është i gjallë.

(Mevlyde Hoti)



**Musa Hoti në zyrën e tij në Mitrovicë 1977**

**Në vend të parathënies**

# KOSOVA ËSHTË GJAKU IM
# QË NUK FALET

***Një ndër kushtet qenësore të kosovarëve është e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje, duke i përfshirë edhe viset tjera shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi***

***Musa Hoti***

Të shkruash për veprimtaritë dhe veprimtarët e dalluar, të cilët me punën e tyre shumëvjeçare, lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë kombëtare, është një përgjegjësi e madhe sa morale, aq edhe kombëtare. Kështu arsyetoj, kur kujtoj e mendoj për diasporën dhe veprimtarët e shquar të kombit tonë: Vehbi Ibrahimi, Rasim Zenelaj, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, Enver Hadri, Musa Hoti e shumë të tjerë.

I ndërgjegjshëm se do të ketë ndonjë lexues që nuk do të jetë në një mendje me mua për radhën e emrave, duke thënë se pse unë e nisa me Vehbi Ibrahimin e jo me Jusuf Gërvallën; ndonjë tjetër do të shtojë pse e nisa radhën me Vehbi Ibrahimin e jo me Rasim Zenelajn. Fillimisht e përmenda Vehbi Ibrahimin, pasi Vehbiu ishte viktima e parë, vrarë nga Serbia në Bruksel. Përpara Vehbiut UDB-ja kishte tentuar ta vriste Rasim Zenelajn, por fati apo mosfati deshti që Rasimi të mbetet gjallë, invalid i përjetshëm.

Jo rrallë ndodh që dëshmorët i klasifikojnë apo kualifikojnë sipas grupimeve apo rretheve ideologjike. Kështu ndodh që lënë në harresë ose injoruar ata dëshmorë të kombit që, sipas tyre, nuk paskan qenë të organizuar në grupimet e tyre politiko-ideologjike; po ashtu edhe ata që ishin të një tjetër platforme ideologjike. Një pjesë e madhe e shqiptarëve klasifikimin e dëshmorëve e bëjnë nisur

nga informacionet e mjeteve të propagandës, të organeve të ndryshme të shtypit apo të radiotelevizive.
Më ka rastisë të dëgjoj për debate apo të jem i pranishëm në diskutime emocionale grindje mes shqiptarëve për të vlerësuar se cili dëshmor (hero) duhet përmendur e shënuar i pari, cili i dyti dhe kështu me radhë.
Unë personalisht kam ndjekur sistemin renditës sipas kronologjisë së ngjarjeve. Bazuar në ngjarje dihet botërisht se Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla u vranë me 17 janar 1982, ndërsa Vehbi Ibrahimi u vra 11 tetor 1981.
Armiku asnjëherë nuk e ka bërë seleksionimin e shqiptarëve në bazë të ngjyrimeve politike apo ideologjike. Ai ka vrarë djemtë më të mirë të kombit tonë, pavarësisht se cilës parti apo organizatë i përkisnin. Edhe një gjë dihet se armiqtë kurrë nuk kanë falur dhe nuk kanë harruar individët dhe familjet e atyre që historikisht kanë qenë kundër tyre. Ata kanë mbajtur shënime dhe në momentin, kur u është dhënë rasti, ata na kanë vrarë, duke u përpjekur që vrasjet t'i propagandonin si "qërim hesapesh mes shqiptarëve". Ata nuk e kanë harruar se babai i Enver Hadrit ishte kundër okupimit të Kosovës nga Serbia dhe e vranë në vitin 1941; nuk e harruan se babai i Musa Hotit ishte i NDSH-së dhe ish i burgosur politik dhe e vranë Musën në kohën kur askush nuk do ta besonte se Serbia do hakmerrej për aktin e Musa Hotit që kishte bërë në Bruksel me 1981. UDB-ja, policia sekrete dhe strukturat kriminale të Serbisë kanë punuar (dhe punojnë) me projekte sekrete inteligjente, duke parapërgatitur alternativa diversioniste për të krijuar opinione çoroditëse. Ata, përgjithësisht, vrasjeve të veprimtarëve shqiptarë u paraprinin me dezinformime për ngjarjen e pritme. Kjo bëhej në mënyrë profesionale nga psikologë e sociologë kriminalistë, duke shfrytëzuar për këtë qellim hafijet shqiptare.
Mirë e dimë të gjithë se çdo vrasje, që ata kanë bërë, menjëherë është përfolur e hedhur ideja dyshuese se ndoshta e ka bërë shoku më i ngushtë i viktimës. Ka qarkulluar pikëpyetja, bie fjala, si ndodhi që Jusufin e vranë, por nuk e vranë filan fistekun, kur ata gjithnjë ishin bashkë? Pse e vranë Enver Hadrin e nuk e vranë

filanin që tash na shet mend se ishte shok më të?! Pas çdo vrasjeje Shërbimi Sekret i Serbisë ka shkuar aq larg, saqë, përmes hafijeve të veta tepër të sofistikuar, ka ndikuar në familjet e të vrarëve, duke krijuar dyshime për shokët dhe bashkëveprimtarët të kauzës kombëtare; dyshime që shkonin deri në akuza të familjarëve ndaj bashkëluftëtarëve. Trillimet që bëheshin nga “shokët” xhelozë nuk mund të jenë aq kredibile, por kur akuzat vinin nga familjarët e dëshmorëve ato ishin të rënda dhe në vend që të ndikonin në rritjen e figurës së dëshmorit, përkundrazi cenonin statusin e tij. Akuzat e familjarëve ndaj shokut të të birit, të prindit, të vëllait të tyre dëshmor kanë ndikuar që mërgata shqiptare të përçahet si dhe shokët bashkëluftëtarë të zhgënjehen me qëndrimin e trashëgimtarëve të shokut të tyre të idealit kombëtar, të vrarë nga dora e udbashëve. Kështu ka ndodhur pas vrasjes së Jusufit, Kadriut e Bardhoshit; kështu pas vrasjes së Vehbiut; kështu pas vrasjes së Enver Hadrit, dhe, tani në fund, edhe pas vrasjes se Musa Hotit.
Pse ndodh kështu? Pse mbillet tërë ky konfuzion? Unë mendoj se Shërbimi Sekret i Serbisë ka pasur dhe ka plane për të përçarë shqiptarët kudo që ata janë. Mirëpo këtij plani diabolik të Serbisë i kontribuojnë dy faktorë: a) familjarët naivë 2) familjarët në bashkëpunim me hafijet.
E para ndodh që familjarët, të pikëlluar për vrasjen e djalit, të babait etj, sapo dëgjojnë thashethemet e rrugëve dhe të ndonjë të dërguarit special të shërbimeve sekrete, brehen nga dyshimi që ua turbullon mendjet, ua çorodit arsyetimet duke krijuar bindje të rreme. Hafijet dinake të mirinstruktuara nga specialistët e UDB-së ua përforcojnë idenë e tyre diabolike duke ua kujtuar a stisur ndonjë problem, që ata kanë pasur mes shokësh gjatë veprimtarive atdhetare. Ka raste, kur familjarët e dëshmorit, që ka dhënë jetën për lirinë e Kosovës, kanë vënë në dyshim veprën e rolin e birit të tyre për çështjen kombëtare. Në ndonjë rast të kësaj natyre familjarët kanë qëndruar indiferentë ndaj veprimtarisë që djali, burri, babai, vëllai i tyre ka bërë për çështjen kombëtare. Në momentin kur ai është vra dhe populli e ka vlerësuar veprimtarinë e tij, vetëm atëherë familjarët e shohin se sa i madh paska qenë njeriu i tyre; vetëm atëherë ata do ta

çmojnë veprën e familjarit te tyre dhe do të gëzojnë respektin nga populli dhe do të habiten se si tërë populli po i respektuaka.
Këto, që po shkruaj janë fakte të përjetuara nga unë, pasi i njoh të gjithë familjarët e dëshmorëve me të cilët kishim kontakte të përhershme.
Dihet se në të shumtën e herës gruaja, djali, vëllai apo ndonjë familjar ishte krahpërkrah me familjarin e vet në veprimtaritë kombëtare. Nisur nga ky arsyetim, ky tip i familjari dëshiron që historinë ta shkruajë ashtu siç dëshiron ai, duke e shfrytëzuar kredibilitetin e familjarit të tij dëshmor, duke injoruar faktet e pakontestueshme historike të kohës, kur kishte ndodhur ngjarja dhe ishte zhvilluar veprimtaria. Të tillët do të mbesin mjeranë përjetësisht. Historia nuk shkruhet sipas dëshirave e trilleve të kujtdoqoftë, por vetëm mbi bazën e fakteve e dokumenteve.
Kategorinë e dytë e përbëjnë familjarët, të cilët e pengonin njeriun e tyre tani dëshmor të merrte pjesë në veprimtari kombëtare, çka le të dyshohet se ata janë pjesë e sistemit të shërbimit sekret ose kanë qenë nën ndikimin e tyre. Shërbimet sekrete e detyrojnë të deklarohen ashtu siç u përshtatet armikut. Dihet se armiku historikisht ka investuar, duke synuar, dhe në raste të caktuara, arritur të përfshijë në shërbimet sekrete edhe pjesëtarë nga familjet e veprimtarëve të dalluar kombëtar përmes të cilëve informohej për zhvillimet e veprimtarive ilegale kombëtare. Dhe dihet se më vonë populli ynë u ka besuar atyre që dhanë dëshmorë. Ne edhe sot jemi të prirur t’u besojmë familjarëve që anëtari i tyre ka dhënë kontributin për atdhe. Bota e civilizuar i respekton familjet e dëshmorëve dhe ua jep të gjitha privilegjet, por nuk *ua jep edhe pushtetin*, se, po të ndodhte kështu, askush nuk do bëhej kryetar i Amerikës apo Francës. Secili duhet të njohë vetveten, nivelin e diturive, aftësitë, profesionalizmin, respektin që i bëhet dhe të kontribuojë me aq njohuri e dituri sa ka për realitet e veprimtarive kombëtare. Por është e palejueshme që familjarë të tillë të japin urdhra se si shkruhet historia e si duhet vepruar kombëtarisht, kur ata nuk kanë vepruar kur ishte koha.

## *Kush ishte Musa Hoti?*

I lindur ne familje zejtare ne Mitrovicë, i rritur ne skamje si shumica e familjeve të varfra kosovare. Qe në fëmijëri i edukuar me frymën kombëtare nga rrethi i ngushtë familjar e sidomos nga gjysha Nurie që ishte mbesa e Shaban Polluzhës, nga babai, Dauti, ish luftëtar i brigadës së Shaban Polluzhës dhe pastaj i burgosur politik.

Musa qysh në fëmijëri ishte edukuar nga i ati me ndjenjën e atdhedashurisë edhe duke e dëgjuar babain të fliste për trimëritë dhe luftën e bashkëluftëtarit Shaban Polluzha. Babai u fliste për metodat, mynxyrat dhe torturat që politika shoveniste rankoviçiane ua kishte bërë jo vetëm bashkëluftëtarëve të Shaban Polluzhës, ku kishte bërë pjesë edhe ai, Dauti, por mbarë popullit shqiptar. Edhe pse asokohe Musa ishte ende i mitur, fjalët e babait do të linin gjurmë të thella në mendjen e tij dhe do ta çelikosnin me idenë se, pa iu përgjigjur pushkës me pushkë, atdheu nuk çlirohej.

I edukuar në frymë dhe ndërgjegje te lartë atdhetare, djaloshi Musa Hoti rritej së bashku me ëndrrat e tij, në pabarazimet me të tjerët dhe në ambientet tona fshataro-qytetare të qytetit te minatorëve, i cili po ashtu rritej se bashku me rininë kosovare që një ditë për këto ëndrra larg Kosovës do të jehonte krisma e pushkës së Musas Hotit për çlirimin e këtyre trojeve.

Musa Hoti qysh në vegjëli u rrethua dhe ushqye me rrëfime të trimërive të ndryshme që burrat në zë të Kosovës si daja Demir Strovci i tregonin netëve të ftohta dimërore. Thellë në shpirt e kishte prekur rrëfimi i dy vëllezërve të gjyshe Nurijes Rexhep dhe Ramadan Kastrati, të cilët kishin rënë dëshmorë në luftën e Kolashinit të Ibrit. I ati, Dauti, i rrëfente vuajtjet e tij burgjeve sllave duke ia përsëritur refrenin: “Shkaut besë nuk i zihet”, që Musës iu kishte ngulitur në kokë dhe, sa herë që babai e fillonte fjalën e parë, Musa e vazhdonte: “ ... besë nuk i zihet”.

## Gjyshja Nurije – mbesë e Shaban Polluzhës



Në shkollën fillore, Musa dallohej si nxënës i shkëlqyer dhe në shpirt kishte poezinë, artin andaj me andje dhe emocione i recitonte poezitë “O moj Shqipëri! ” dhe “Vajtimet e atdheut”, që ia kishte mësuar gjyshja Nurije dhe babai. Kujdestari i klasës, Sami Raça kishte një kujdes dhe simpati të veçantë për vogëlushin. Samiu, i ardhur nga Malësia e Gjakovës, kishte dashuri për nxënësit e tij që mësonin se në ta shihte perspektiven kombëtare.

Ende pa e përfunduar shkollën fillore ia burgosin babain Dautin, që ishte anëtar i NDSH-së, nën akuzën e famshme të asaj kohe “Për veprimtari armiqësore kundër popullit dhe shtetit”. Në mëshirë të kohës dhe përkujdesjes së fqinjëve Dauti i la 7 djem e 3 vajza.



**Nëna Naile dhe babai Dauti në vitin 1976.**



**Në foto: Musa Hoti me babain  Dautin**

Burgosja e babait, bastisjet brutale të xhandarmërisë rankoviçiane, Musa Hotit do t'i lënë gjurmë të thella shpirtërore që tërë jetën do ta përcjellin dhe do t'i ushqenin urrejtje ndaj pushtuesit.
Brumin kombëtar e mori nga bisedat familjare, gjatë shkollimit të tij të mesëm e të lartë. Por vetëdija kombëtare iu rrënjos edhe përmes kontakteve me shokët e idealit si dhe leximit e studimit të literaturës së ndaluar të asaj kohe.
Si nxënës i shkollës se mesme në Mitrovicë, Musa i përjetoi përndjekjet politike që i bëheshin babait të tij, si dhe të disa profesorëve te shkollës, si Veton Gjika , Mustafa Muni dhe Mustafa Venhari, te cilët UDB-ja i likuidoi me mënyra perfide dhe makiaveliste; kurse disa te tjerë, si Murat Bejten, Latif Berishen, Ahmet Malokun e Muhamet Kerveshin i torturonte natën dhe i lironte gjatë ditës. Këto raste nxënësve ua rrisnin pakënaqësinë dhe urrejtjen ndaj udbashëve, por, në të njëjtën kohë, ndikonin tek ata që të ruanin konspiracionin, sidomos lidhur me vepra të ndaluara që lexoheshin fshehtas e prej të cilave ngrihej vetëdija kombëtare. Çelikosej patriotizmi i moshave rinore sipas mësimeve të simbolit tonë të rezistencës Adem Demaçit, po ashtu të shumë bashkëveprimtarëve, si Hilmi Rakovica, Ismail Dumoshi, vëllezërit Bedri e Selatin Novosella, Shefqet Jashari e shumë të tjerë, veprimtarë të devotshëm e të gatshëm për sakrifica dhe akte më sublime. Por fatkeqësisht, veprimtarë të tillë ndodh që lihen në harresë de përçmohen nga "parija" e "baballarët" e kombit. Por sidoqoftë, ata ishin pishtarët e lirisë dhe mbeten te tillë në historinë e pashkruar te kombit tonë të etshëm për liri dhe unitet kombëtar.
Musa kujton: *në vitin shkollor 1966/67 u pranova si mësues ne shkollën tetëvjeçare "Rilindja " në Dritan (Dobroshevc) te Drenasit, duke iu falënderuar drejtorit te guximshëm te atëhershëm Ymer Dubovcit, ngase në Mitrovicë dhe rrethinë nuk vija në shprehje për një punësim adekuat nga biografitë familjare.*

"Më 27 nëntor 1968 me trenin e pasdites u kthyem në Fushë Kosovë e vazhduam për në Prishtinë me Haxhi Gashin, Enver e Haki Berishen, Musli Elshanin, Emine Rakovicen, mësuese në Bardhin e

madh (Bellaqevcin e dikurshëm) me vëllaun e së cilës, me Hilmi Rakovicën ( dëshmor i kombit) isha ne lidhje organizative. Kur turma e pafund zbriti nga Fakulteti Filozofik, iu bashkëngjitëm demonstruesve në mënyrë spontane.

Pas vrasjes së Murat Mehmetit (tani dëshmor), demonstruesit që i prinin manifestimit madhor, fillimisht të studentëve, iu bashkëngjitën turma nxënësish të shkollave të mesme, punëtorët dhe qytetarët e Prishtinës. Ky manifestim mori përmasa gjithëpopullore. Demonstruesit, që i prinin manifestimit të dalë nga kontrolli, thyen të gjitha vitrinat e dyqaneve në të dy anët e rrugës (tani "Nëna Terezë"), rrotulluan makina zyrtare e ndonjëra edhe u dogj.

Ne tri javët e ardhëshme, me propozimin e Hilmi Rakovicës, u mora me organizimin e demonstratave që nga Tetova deri ne Monastir. Duke punuar me klasat e larta të tetëvjeçares "Rilindja", kisha mundësi të punoj për ngritjen e vetëdijes kombëtare tek nxënësit që për ta ishte një ABC edukativo-patriotike e një niveli shumë të lartë. Puna ime la mbresa si tek nxënësit, ashtu edhe tek prindit e tyre, të cilët më përkrahnin.

Kur partiakët e Drenasit ia mësyn shkollës sonë për t'i gjykuar demonstratat e 68-ës, u kthyen me bisht ndër shalë. Nga diskutimet e arsimtarëve dhe kryetarit të Pleqësisë, partiakët komunistë m'i lëshuan qentë e tyre besnik të pushtetit. Përparësia ime qëndronte në atë se unë punoja në Drenas, por isha banor i Mitrovicës dhe banoja në Prishtinë.

Në Drenas qeveria e asaj kohe më shpalli person te papërshtatshëm politikisht. Në Obiliq, pas një viti pune, hafijet e UDB-ës raportuan te shefat e tyre dhe, me urdhër të **Komitetit**, më larguan nga shkolla "Migjeni". Pasi arrita te punësohem në Mitrovicë në Qendrën Teknike "Boris Kidriç", punëtorët e Sigurimit Shtetëror si shqipfolësit me merrnin në pyetje dhe më torturonin. Pas shumë torturave, që më bënin shqipfolësit e tipit të Faruk Mehmetit dhe gjakpirësit Zejnullah Shalës, u detyrova të largohem përkohësisht duke patur përvojën që babai im kishte përjetuar tërë ato tortura barbare të UDB-ës, më këshilluan të marr rrugën e mërgimit me

ç’rast iu bashkëngjita vëllait tim ne Bruksel” (Fejtoni për aktivitetin kombëtar të Musa Hotit u botua në **“Epoka e Re” 27 janar -2 shkurt 2003, autor R.S.**



**Musa me nxënësit e shkollës fillore “Rilindja” në Duboshevc.**

Pas punësimit të Musës në Duboshevc do të shtohen kontaktet me patriotët më të spikatur të çështjes sonë kombëtare. Pa asnjë fije dyshimi, shkolla fillore “Rilindja” në Duboshevc, mund të quhet çerdhe e patriotizmit. Drejtori i kësaj shkolle, Ymer Duboci, kishte pasur guxim ta merrte mbi vete barrën më të rëndë të asaj kohe, duke i punësuar arsimtarët që ishin aktivistë të çështjes kombëtare, por të larguar nga shkollat tjera pikërisht për veprimtari kombëtare. Ymer Duboci, ky intelektual i kohës dhe atdhetar i përjetshëm, u ofronte punësim bijve më të shquar të Kosovës si Rrustem Morina, Fazli Graqevci, Avdyl Lahu, Zeqir Gërvalla, Rakip Veseli, Sokol Meha, Emine Rakovica dhe Musa Hoti. Disa prej këtyre arsimtarëve, një ditë do të bien në altarin e lirisë për të mos vdekur kurrë.
Asgjë nuk është e rastësishme, as vrasja e ambasadorit jugosllav në qendër të Brukselit që Musa Hoti e bëri me 4 gusht 1981.

## Musa Hoti largohet nga Kosova

Pasi e kam marr përgjegjësinë për të shkruar për veprimtarinë e Musa Hotit, dëshiroj që lexuesit të kanë sa më shumë informacione rreth jetës dhe veprimtarisë së tij atdhetare.
Më së pari është e domosdoshme të sqarohen rrethanat që e detyruan Musa Hotin të largohet nga Kosova.
Në shënimet e Musa Hotit, lënë në dorëshkrim, del se Musai ishte i vënë në shënjestër dhe ndiqej nga organet e sistemit të sigurimit jugosllav. Atij i mbeteshin dy rrugë: 15 vjet burg ose arratisja nga Kosova.?!
Hoti e përshkruan ikjen e tij dhe atmosferën e krijuar në familje një natë para largimit të tij nga Kosova në fletët e ditarit të tij:
*“I detyruar, vendosa të marr rrugët e mërgimit. Me ngut, shpejt, brenda disa orësh bëra përgatitjet dhe, pasi u përshëndeta më të gjithë anëtarët e familjes, hyra në taksi. U nisa drejt Prishtinës. Ndalova pranë shtëpisë së vjehrrit. Pasi e bëra pagesën, iu afrova hyrjes, shtypa butonin e ziles, kunati e hapi derën dhe u përqafuam. Në sallon atmosfera ishte e vranët, e acaruar,emocionale. Ata ishin njoftuar për “udhëtimin “ tim të padëshiruar. Si dhëndër që më kishin , ishin të shqetësuar për fatin e bijës së tyre. Mundohesha të mbaj qëndrim të qetë, por çdo tentim ishte artificial dhe i kotë. Shumë shpejt biseda rrodhi te gjendja e krijuar, çka na mundonte të gjithëve, por veçmas mua. Për një kohë kërkuam ndonjë rrugëzgjidhje, por mbeteshin dy rrugë: të hyja në burg për 12-15 vjet dhe njëherit t’iu nënshtrohesha të gjitha llojeve të torturave, që vetëm sllavët dinë t’i përdorin ndaj nesh; ose të merrja botën në sy pa asnjë cak, por, nga sytë këmbët. Pasi u binda se biseda sa vinte bëhej më e rëndë, më e paduruar, atëherë ua shfaqa mendimin me zgjidhjet e mundshme. Pranë nënës sime kishte zënë vend Mimoza e vogël, dyvjeçare e gjysëm, që asgjë nuk kuptonte, por edhe fytyra e saj e kishte marrë një pamje të papërmbajtshme që ia impononte situata e krijuar e ambientit të vrazhdë. Nëna mundohej të*

*përmbahej, merrej me mbesën e pritur më se 7 vjet, por mendimet e saj bridhnin krejtësisht të shfrenuara dhe nga mosbesimi në qëndrueshmërinë e vet\ shikimin e mbante të humbur. Edhe shoqja ime mundohej të përmbahej. Ndoshta përpiqej të përfytyronte të ardhmen tonë! I ati filloi të fliste për kohën e qëndrimit në Gjermani ( i burgosur nga gjermanët – shënimi im) , për vuajtjet në llogoret e ndryshme të luftës dhe dëshironte të bënte krahasime me të kaluarën e tij të largët dhe më të ardhmen time të afërt, që për mua ishin dy pole të kundërt. Rrallë herë përqendrohesha në bisedë, pasi mendoja se po të bija në dorë të UDB-së, edhe po të më lironin pas një muaji, do të më lironin me shëndet të krisur njëherë e përgjithmonë...!*

*Kunati i madh, që rrinte afër meje e theu heshtjen me fjalë inkurajuese, se nuk jam as i pari as i fundit në mërgatë, se për fillim do të instalohesha të vllau në Belgjikë dhe më vonë do të gjendem si të gjithë kosovarët tjerë, ndoshta edhe më mirë, falë aftësive të mia mendore dhe fizike.*

*Ndërkohë erdhi edhe motra ime e martuar që m'i solli të hollat e udhëtimit dhe orientimet e fundit të babait plak, si të kaloja kufinin e Bullgarisë. Kurse vjehrra, që më respektonte si djalë të saj, interesohej për adresën ku do të vendosesha, se pastaj do të niste për rrugë të bijën me Mimozën ( e cila flinte në prehrin e nënës sime). Vjehrra tregonte storje nga jeta e saj gjatë e kohës së luftës, kur kishte mbetur e vetmuar, si dhe për kohën e pasluftës, kur burri saj ishte dënuar me 8 vjet burgim të rëndë, në lidhje me kërkesën për flamurin kombëtar. I njëjti fat po e ndiqte edhe të bijën.*

*Natën vonë u shpërndamë në disa dhoma për të fjetur, por ajo natë ishte pa gjumë për atë shtëpi në Kodrën e Diellit.*

*Të nesërmen u përshëndeta, së pari, më nënën, pastaj me të gjithë të tjerët, me një gjakftohtësi të imponuar për t'iu dhënë kurajo që dilte më vështirësi nga gjoksi im. Mimoza ishte ulur në shkallët e hyrjes më kokën mes duarve dhe qëndronte pa zë. E përqafova dhe i premtova se unë do të kthehesha shpejt, posa të marr Benzinë, por ajo tha: ti nuk do të kthehesh shpejt se po shkon shumë larg.*

*Shikimet e ne të mdhejve u kryqëzuan nga habia e përgjigjes së saj të prekshme e therëse.*
*Hyra në makinë dhe vazhdova rrugën, këtë rrugë që jam duke e vazhduar akoma për më se tri vjet dhe gjithëherë më duket se ngado të shkoj më përcjellin shikimet e dy familjeve, sikur ditën e parë të rrugës së mërgimit, që tani më duket shumë e largët, por e paharruar. Ajo ditë ka lënë mbresa të mëdha në kujtesën time dhe sa herë e sjell ndërmend më kaplon një mall i papërshkruar, që e përjeton vetëm mërgimtar...”.*

## *Në Bruksel, por me mendje e zemër në Kosovë (monolog)*

*“Më mundonte fakti që në moshën time të detyrohem ti lë lalamtumirën familjeës dhe të katandisëm në mërgatë si shqiptarët e Stambollit, të detyrohem të mohoj vendin tim aq të dashur për të shpëtuar një jetë. E çfarë ishte jeta ime para gjithë atyre peripetive që më prisnin , tani që u bëra i huaj?! Vendlindja ime nuk më dha atë që kërkoja, e çfarë do të pres nga vendi i huaj?!*
*Me pyetje të tilla më rëndohej koka, kurse përgjigjet do t’ i përjetoj! Cili është fati im dhe fati i shqiptarve që veprojnë për liri?! Nuk kam përgjigje,sepse më është rënduar koka nga barra e mërgimit, nga torturat psiqike që më bënin sahanlëpirësit në Mitrovicë. Nuk më hiqen nga mendja kërcnimet e tyre. Kërcnimet e Faruk Mehmetit nuk më rëndonin sa sharjet e e ndyta të Zenë Shalës që për një ditë përseritehin më se 200 herë dhe kend shante se? Nënën e tij! Më sillej zyra e hetuesisë dhe sytë nuk më bënin dritë. Edhe truri i lodhur më errësohej nga çasti në çast. Tentoja të ruaja gjakftohtësinë me një qetësi të shtirur, gjë që atyre nuk u konvenonte. Me temperaturë të ngritur, kur buzët më kishin zënë ndryshk, e përmbaja vetën me forcat e fundit. Pyetjeve të tyre, shpeshherë u përgjigjesha me kundërpyetje. Ata zemroheshin, thua pëlcitnin nga inati. Dhe unë e ndjeja veten triumfues dhe krenar, me*

*forca të reja dhe të pamposhtura nga renegatët dhe sahanlepërsit e armikut. Ata luftonin kundër idealeve të larta të një populli trim dhe lirdashës, që hasnin në qëndresë të pakompromis , ku shihnin dekadencën e politikës së çoroditur të padronëve të tyre të Beogradit.*
*Në ato momente të vështira më kujtoheshin përjetimet e rënda të babait tim, që ca vjet më parë ishte torturuar nga UDB-ja rankoviçjane për kërkesë të Flamurit, simbolit të shenjtë kombëtar, dhe asnjëherë nuk ishte thyer, andaj edhe mua më duhej të qëndroja i pamposhtur para bishave të tërbuara që ushqeheshin me gjak shqiptari. Isha krenar me fatin tim që i ngjante aq shumë atij të babait të shumëvuajtur.*
*Tani që kam kohë t'i mendoj ato të shkuara të hidhura, më bren ndërgjegja që nuk qëndrova gjer në fund i patundur dhe tash u katandisa në radhët e "mërgatës së qyqeve". Kërkova shpëtim nga armiqtë dhe u gjeta në një rreth armiqësh tjerë më të rafinuar.*
*Para çdo përsoni të mërgatës mbaja qëndrimin tim të denjë dhe solidarizohesha me rininë kosovare dhe mburresha kudo me të arriturat e Nënës Shqipëri".*

Ma merr mendja se kur autori bën përpjekje për ta plotësuar jetëshkrimin e personazhit për të cilin bënë fjalë me dëshmi të tjerëve nuk e ka të lehtë, pasi nuk mund të pasqyrohet e plotë, me imtësi e detaje, me emocione, ashtu si do të mund ta paraqiste vetë personazhi. Raste të tilla mund të bëhen kur personazhi nuk na ka lënë asgjë të shkruar dhe ne përpiqemi t'i ndërtojmë e plotësojmë, duke u mbështetur në dëshmi të bashkëveprimtarëve. Por askush nuk do kishte patur mundësi të na paraqiste një tabllo reale dhe emocionale të ndarjes së prindit nga fëmija dhe pjestarët e tjerë të familjes, kur nisej në një rrugë të panjohura.


farkt, që atyre nuk iu konvenonte. Me temperaturë të ngritur, ku kurrë më kishin zën ndryshk dy gisht trashësi, e përmbaja vetën me forcat e fundit. Pyetjeve të tyre shpeshë herë iu përgjigjesha me pyetje, që ata përcitunin të dëshpruar, me ç'rast e ndija vetën të triumfuar dhe krenar, me forca të reja dhe të pamposhtura nga renegatët dhe sahanlpirsit e armikut të gjinjëzuar. Ata luftonin kundër idealeve të larta të një populli trim dhe liridashës, që kasnin në rezistencë të pakompromis, ku e shifnin dekadencën e politikës së a çorodituri të padronave të tyre të Beogradit.

Në ato momente të vështira, më kujtoheshin përjetime të vështira të babit tim, që ca vjet më parë ishte torturuar nga UDB-a rankoviçare për kërkesë të Flamurit - simbolit të shenjtë kombëtar dhe asnjëherë nuk ishte thyer, andaj edhe mua më duhej të qëndroja i pamposhtur para bishave të tërbuara që ~~kërkonin~~ ndyshkoshin me gjak njerin. Isha krenar me fatin ~~të~~ tim që i ngjante ap shumë atij të babait të shumvuajtur.

***Pjesë nga ditari i Musa Hotit***

Musa Hoti na paraqet një atmosferë reale pa smadhime e stërgjatje monotone. Ai me pak fjalë përshkruan gjendjen psikologjike të familjës dhe të tij në ato çaste vendimtare të ndarjes. Pra, mua më është dukur më mirë të shkëpusja copëza nga ditari, shkruar nga vetë dora e Musa Hotit, që asgjë të mos humbasë nga situata reale e krijuar në ato çaste emocionale

Pjesën e veprimtarisë së tij në Belgjikë e kam të njohur,sepse gjatë tërë atyre viteve ishim bashkë në rrjedhën e ngjarjeve. Por kjo nuk do të thotë se vepronim bashkarisht për çdo gjë. Ai vepronte në mënyrën e tij e unë në të timen. Që në shumtën e herës e

bashkëkoordinonim.Gjatë hulumtimeve për të gjetur fakte të shkruara, sepse vetëm ato janë pjesë e pakontestueshme, kam lexuar shumë letra, artikuj e shkrime të ndryshme të tij. Veprimtaria e tij do të shkruhet në disa vëllime duke i ndarë: Jeta dhe veprimtaria e Musa Hotit, Shtypi i huaj dhe vendor për Musa Hotin, Letërkëmbimet e Musa Hotit, Dëshmi për Musa Hotin etj.
Ky vëllim,që është i pari,do t'u vijë në ndihmë studiuesve. Ata do të merren me plotësime e zgjerime për të nxjerrë në pah shumëçka nga jeta e heroit tonë. Prandaj po shkëpusim vetëm disa pjesë nga shënimet e tij, pa synuar botimin e një vepre voluminoze ku do përfshihet tërë veprimtaria e tij.

## Një pasqyrë e mërgatës...

Të jesh objektiv e të shkruash për veprimtaritë e mërgatës sonë është vështirë, sepse askush (si brenda dhe jashtë) nuk e ka imagjinuar se Jugosllavia do të shpartallohej. Mirëpo në mesin tonë ka pas një grumbull idealistësh,të cilët kanë ëndërruar se Kosova një ditë do të çlirohej. Më këto ëndrra idealistët kanë vepruar dhe janë armatosur shpirtërisht që luftën e tyre ta vazhdonin deri në fitoren përfundimtare ose deri në vdekje. Idealistët ishin pjesa më e vogël e popullsisë në emigracion. Ata, jo rrallë injoroheshin, sabotoheshin, shantazhoheshin edhe nga disa bashkëkombës, por edhe lëçiteshin nga familje e kolektiva të tëra. Idealistët luftën e tyre e vazhdonin duke shpresuar se ëndrrat e tyre do bëheshin realitet. Me këto ideale vazhduan veprimtaritë kombëtare, luftën për kauzën e madhe të çlirimit të Kosovës; me këto ideale disa dhanë jetën, disa mbetën invalidë të përjetshëm, disa u plagosën e disa ende jetojnë duke ëndërruar se ka ende të punohet për çështjen kombëtare. Pra, të japësh një pasqyrë objektive të veprimtarive dhe të veprimtarëve kombëtarë, ashtu siç e fillova, kam bindjen se ka edhe do të ketë familjarë që nuk do t'u pëlqejë. Armiku nuk mundi t'i vriste të gjithë, dikush shpëtoi pa rënë nga plumbat e armikut...!

Por, ju lutem të keni mirësinë, bisedoni me cilindo bashkëveprimtar të ndonjë heroi për të cilin ju keni dëgjuar dhe shtrojani pyetjen: A e ndjeni vetën të lumtur që nuk jeni vra siç u vra bashkëluftëtari i juaj?!

Secili do të përgjigjet duke ju rrëfyer problemet, që kishte pasur pas vrasjes se shokut, përjetimet e tij të hidhura në Kosovën e çliruar dhe shumë peripeti të tjera. Kështu ju përgjigjën ata të cilët nuk janë të kyçur në parti politike dhe në pushtet. Ndërsa ata që janë përfshirë në struktura pushtetarë kanë tjetër përgjigje. Pas tërë kësaj teze hipotetike, mund të shtrohet edhe pyetja tjetër; a ishin të gjithë shokët e dëshmorëve vërtetë bashkëluftëtarë të sinqertë? Tani jemi tek një përgjigje më komplekse dhe tepër të rëndë për ta verifikuar se vërtetë tërë shokët ishin pa hile. Kjo mund të vërtetohet me kohën dhe me veprimtaritë që ata kanë zhvilluar pas vdekjes së shokut të tyre.

Për atë që u shkrua më lart, ne të gjithë jemi dëshmitarë se shumica prej fakteve të thëna më lart janë të qëndrueshëm që dukën nga lartësitë e qiellit si, p. sh., ndarja e varrezave të vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës porsa i sollën në Kosovë.

Pasi u fol për familjarët dhe bashkëveprimtarët dua të nënvizoj se Shërbimi Sekret Serb duke u shërbyer me hafijet e veta ka ndikuar që shumica e bijve tanë që u vranë nga plumbat e armikut t'i etiketonte se, gjoja, ata kishin punuar për Serbinë. Historikisht kjo dukuri ka qenë prezent tek ne shqiptarët. Ka shembuj të shumtë, duke filluar nga Skënderbeu për të cilin edhe sot shkruajnë se ai nuk kishte punuar për çështjen kombëtare, por për Vatikanin; flitet për dëshmorët, që u vranë në afërsi të Shtugardit me 17 janar 1982; flitej për Vehbi Ibrahimin se kishte punuar për Serbinë; thuhej për Enver Hadrin, për Musa Hotin e bile, për këta tre të fundit, në librin "Atentatët" autori nuk është anonim. Pra, sipas thashethemeve dhe letërnxirësve të ndryshëm, që nga koha e Skënderbeut e këtej, asnjë hero, dëshmor e patriot nuk e meriton emrin, ashtu siç ne e kemi mësuar në histori apo lexuar në shtyp. Kush mbeti pa u njollosur dhe kush do të mbetet hero?! Lidhur më këtë do kisha shtuar se vetëm pasi të bëhet hapja e dosjeve sekrete do të zbardhet e vërteta dhe

biografia e secilit, e atyre që shpifin, e atyre që nuk shpifin dhe e vetë heronjve.

U zgjata për të dhënë një pasqyrë sa më objektive, sepse Musa Hoti është një figurë që ka pasur të bëjë me të gjitha ato figura të cekura dhe është përballur me thashethemet e njerëzve hafije ose injorantë, apo të painformuar mirë për veprimtarinë e tij kombëtare.

Kjo është arsyeja që u tha edhe më lart se të jesh objektiv është vështirë, pasi kemi të bëjë me një varg problemesh komplekse, që do t'i shtjelloj më poshtë lidhur me gjendjen e përgjithshme të mërgatës shqiptare në Belgjikë e gjetiu. Është vështirë, sepse në një anë është shumica që dikur ishte kundër proceseve kombëtare dhe, në anën tjetër, ajo shumicë kurrë nuk dëshiron të pranojë dështimin apo gabimet e saj, çka do të ishte normale. Por, jo ajo gjithmonë ushqehet nga hafijet dhe dëshiron të përfitojë nga konfuzioni derisa, një ditë të krijohet Ministria e Brendshme e shtetit tonë që medoemos duhet të merret me analizën e veprimeve dhe veprave të qytetarëve tanë.

Vitet '70 konsiderohen si vite kur populli shqiptar mund të frymonte më lirshëm. Sikur të bëhet një krahasim me vitet 1945-1956, kur nga Kosova u shpërngulën me qindra e mijëra shqiptarë, kur u vranë me dhjetëra mijëra shqiptarë të cilët nuk u pajtuan me sistemin e ri okupues të instaluar nga Titoja, kur burgjet jugosllave ishin të stërmbushur me shqiptarë të cilët refuzonin të nënshtroheshin, vitet '70 mund të merren si vite të ngritjes në masë të vetëdijes kombëtare. Kjo nuk erdhi rastësisht, as se sistemi i asaj kohe e kishte parë gabimin që kishte bërë mbi shqiptarët, por ishte rezultat i rezistencës së grupeve dhe individëve gjatë tërë kohës së okupimit që kulmoi me demonstratat masive të 1968-tës.

Disa historianë dhe analistë tentojnë që kontributin e liberalizimit të Kosovës së atyre viteve t'ia japin meritat Titos dhe udhëheqësve shqiptarë të asaj kohe. Një pjesë e këtyre historianëve dëshirojnë ta arsyetojnë Titon se ishte proshqiptar, por ai ishte zënë ngushtë nga strukturat fashiste të Rankoviçit dhe vetëm pasi e largoi atë pati mundësi t'i përmirësonte kushtet politike dhe ekonomike për shqiptarët që jetonin në Kosovë. Të njëjtit historianë japin teza se

gjatë viteve të liberalizimit të Kosovës dukshëm ndihmuan politikanët shqiptarë të asaj kohe, të cilët nuk penguan hapjen e Universitetit, bashkëpunimet kulturore me Shqipërinë dhe valëvitjen e flamurit kombëtar në Kosovë. Ata historianë ose nuk duan, ose nuk dinë se në ato vite shumë popuj afrikanë e fituan pavarësinë nga fuqitë më të mëdha botërore, ndërsa populli shqiptar ende rënkonte i robëruar. Një popull që vendosmërisht dhe masovikisht reziston kundër okupuesit është i destinuar të fitojë pavarësinë. Populli shqiptar i tregoi sistemit të Titos se Kosova nuk nënshtrohet, pavarësisht vrasjeve, burgosjeve dhe shpërnguljeve masive që na bënte i njëjti Tito, i njëjti sistem. Në të njëjtën kohë sistemi jugosllav kërkonte ndihma të shumta financiare nga ShBA dhe vendet europiane, të cilat, shpesh si kusht i dhënieve të atyre ndihmave kërkonin respektimin e të drejtave të njeriut në Jugosllavi. Respektimi i të drejtave të njeriut nënkuptonte lirinë e shprehjes, lirinë e fjalës, të drejtat e individit etj. Dhe në këtë kuadër Tito ishte i detyruar të bënte ndonjë lëshim të sipërfaqshëm, por gjithmonë të kontrolluar, të survejuar e të përndjekur nga qarqet e strukturat politike dhe policore. Kështuqë "liritë" e premtuara e të propaganduara ishin të kufizuara dhe të kontrolluara rreptësisht edhe nga shqiptarët, të cilët sistemi i kishte privilegjuar. Flamuri kombëtar mund të valonte në tërë Kosovën, por pasuria nëntokësore shfrytëzohej nga Beogradi. Flamuri valonte, por shqiptarët ende burgoseshin për idetë dhe organizimet kombëtare. Në këto vite riburgoset Adem Demaçi me grupin e tij. Pikërisht në këto vite ilegalisht organizoheshin grupe shqiptare për çlirimin kombëtar; ku disa burgoseshin e disa vepronin deri sa të hetoheshin; pikërisht në këto vite Shërbimi Sekret Jugosllav kontrollonte çdo pjesë të Kosovës me njerëzit e tyre të rinj që OZNA ishte zëvendësuar me UDB-n. Këto dy institucione jugosllave nuk kishin asnjë ndryshim prej njëri- tjetri, sikurse nuk kishin ndryshim shqiptarët që punonin për këto institucione por me emër tjetër. Në këto kohë të lehta për shqiptarët e sistemit siç ata i quajnë ato kohë, por të vështira për njerëzit e organizuar për çlirimin e Kosovës, Musa Hoti detyrohet të largohet nga Kosova për në Bruksel.

## *Situata e shqiptarëve në Bruksel*

Situata politike e shqiptareve në Bruksel nuk ishte aspak më e mirë se në Kosovë. Ndërsa në Kosovë mund të gjeje shokë të idealit e të veproje në ilegalitet; në Bruksel mund të tentoje të veproje, por shpejt puna organizative kundër interesave të Jugosllavisë shpërfillej nga vetë shqiptarët. Ndërsa në Kosovë ishte krenari kombëtare kur dikush vepronte apo burgosej; në Bruksel shumica të shikonin me nënçmim dhe përbuzje. Në Bruksel ishin krijuar parti politike, grupe e organizata politike më shumë se në çdo vend tjetër. Secila parti a secili grup ishte kundër partisë apo grupit tjetër. Brukseli i asaj kohe i përngjante Kosovës së sotme shumëpartiake. Dallimi në mes situatës së shqiptareve të asaj kohe në Bruksel dhe shqiptarëve të Kosovës së sotme ishte se këtu deri diku funksionojnë ligjet, kurse atje veprohej sipas vullnetit dhe dëshirës.

Gjatë viteve ‘70 shqiptaret që jetonin në Belgjikë ishin në dy shtresime: emigracioni nga Shqipëria dhe ai nga trojet shqiptare të okupuara nën ish-Jugosllavinë. Diaspora kosovare gjer në vitin 1981 shumë pak interesohej të inkuadrohej në ndonjërën nga partitë e emigracionit që kryesisht ishin parti të pasluftës së Dytë si:  Lidhja e parë e Prizrenit,që drejtohej nga  Rifat Kolgjini; Lidhja e dyte e Prizrenit e Xhafer Devës, por që ne Bruksel e kryesonte Hamzë Devetaku; Partia Agrare me në krye Enver Durakun; Partia pa Parti, pjesë e Legalitetit, më e konsoliduar dhe në një formë mbikqyrse e të gjitha partive tjera, e drejtuar nga Muharrem Bajraktari, kolonel i mbretit Zog ; Balli Kombëtar, kryetar i se cilës në Belgjikë ishte Jusuf Selenica; Rezistenca Kombëtare me në krye Enver Hadrin; Besëlidhja Demokratike Shqiptare që në Bruksel e drejtonte Vehbi Ibrahimi etj.

Urëlidhëse mes kosovareve dhe emigracionit politik nga Shqipëria ishte intelektuali Nazmi Muhadri.Nazmiu ishte një zbutës i marrëdhënieve shqiptaro- shqiptare te diasporës se Belgjikës.

Në afrimin e këtyre marrëdhënieve dukshëm ndikoi edhe Faik Kosova, ish-pilot në ushtrinë turke.  Faiku për zot Kosovës rrëmbeu

aeroplanin ushtarak turk për një sulm eventual kundër ushtrisë robëruese, por një veprim i tillë ishte i pamotivuar, prandaj kërkoi strehim politik në Bruksel  ku deri ne vdekje veproi për Kosovën martire. Në këto marrëdhënie rol të rëndësishëm luajtën edhe bijtë e emigracionit të vjetër,  siç ishte Idriz Basha, i cili në kohën e Sali Berishës  u emërua ambasador i Shqipërisë në Belgjike, si Sakip Skepi, Durak Duraku, Fatmir Tahiri dhe shumë të ri të tjerë.

Martin Camaj me librat e tij të sjellë në Bruksel u jepte shpirt këtyre marrëdhënieve përmes kontakteve te tij. Martini ishte i respektuar nga të dy palët. Gjenerator kryesor i veprimtarive të mërgimtarëve kosovarë ishin Enver Hadri dhe Vehbi Ibrahimi, të cilët, me largpamësi u vunë në shërbim të atdheut, merituan vlerësime dhe simpati të pandërprerë në radhët e mërgimtarëve të të gjitha trojeve etnike,  duke mos kursyer as jetën, aktin më sublim, flijimin në altarin e lirisë.

Aktiviteti i partive dhe i organizatave politike shqiptare kufizohej vetëm me mbledhje e takime në kafene, me botime të revistave e gazetave të herëpashershme, por edhe me grindje dhe rrahje ndërshqiptare, individuale dhe masive. Rrahja masive u shkaktua me rastin e një ndeshjeje futbolli të skuadrës përfaqësuese të Shqipërisë me një ekip të Belgjikës. Shqiptarët nga Kosova shkuan të bënin tifozëri për ekipin nga Shqipëria me flamurin kombëtar me yll; ndërsa shqiptarët nga emigracioni i vjetër i Shqipërisë shkuan me flamurin pa yll. Dhe ndërsa zhvillohej ndeshja, në stadium u ndez përleshja fizike ndërshqiptare.

Ata me flamurin me yll i quanin kriminelë dhe me duar të lyera me gjak të shqiptarit të gjithë ata që valëvitnin flamurin kombëtar pa yll. Krahu i shqiptareve të flamurit pa yll i quanin shqiptarët e flamurit me yll, agjentë të Moskës dhe të Beogradit. Në fakt asnjëra palë nuk kishte arsye ta akuzonte palën tjetër as kriminelë dhe as agjentë të Beogradit, por shikuar nga një tjetër këndvështrim, të dy palët kishin të drejt në opinionet e tyre. Nuk do mend se pala e flamurit me yll kombëtar kishte marrë orientime nga Ambasada Shqiptare e Parisit që të dilnin me flamuri me yll dhe e kishte indoktrinuar këtë pjesë të mërgatës së emigracionit të vjetër nga

Shqipëria me idenë se ai krah i kishte duart e përgjakura deri në bërryla me gjak të vëllezërve të tyre shqiptarë. Shqiptarët me pikëpamje të majta ishin dëshmitarë se disa emigrantë nga Shqipëria të vendosur në Kosovë shëtisnin me revole në brez dhe bënin çka të donin pa u ndjekur nga policia serbe. Kuptohet se nuk ishin të tillë të gjithë emigrantët. Mirëpo në Bruksel kishte disa emigrantë që kishin bërë gjëra të këqija ndaj shqiptarëve, ndonëse ata e kishin ndarë kafshatën e bukës së bashku. Në Bruksel kishte edhe emigrantë që ende nuk i kishin shkëputur lidhjet me ambasadën e Beogradit në Bruksel dhe fëmijët e tyre i dërgonin ta bënin shërbimin ushtarak në Beograd dhe të studionin në Kosovë.

Në anën tjetër, emigracioni i vjetër, po ashtu kishte arsye ta akuzonte palën që e valëvitëte flamurin kombëtar me yll, ngase në mesin e tyre kishte shqiptarë, që mbanin lidhje haptas me ambasadën e Beogradit në Bruksel dhe i kalonin pushimet në Kosovë pa asnjë pengesë, pasi kishin kaluar pushimet grupore në Shqipëri. Ishte absurde dhe e pakuptueshme të shkoje në Tiranë e pastaj të vizitoje Kosovën pa asnjë ditë në biseda informative apo në burg.

Nisiatorët e përleshjes masive ndërshqiptare, pa dyshim, duhet të kenë qenë bashkëpunëtorë të shërbimeve sekrete shqiptaro-jugosllave. Kjo përleshje shënon edhe shkatërrimin e relacioneve ndërshqiptare, që deri me atë kohë ishin shumë të mira. Pas kësaj ngjarjeje, çdokush që vepronte dhe angazhohej për çështjen kombëtare shikohej me dyshim. Pikërisht në ato kohë të vështira u vendos Musa Hoti në Bruksel. Në këto kushte vepronte Enver Hadri që e kishte krijuar "Rrezistencën Kombëtare", që rreth tij kishte mbledhur tre katër individë të pashkolluar dhe gjysëm të shkolluar. Enver Hadri, kohë pas kohe, publikonte revistën "Zëri i Kosovës", që kryesisht përbëhej me artikuj nga shtypi i Tiranës, ndërsa editorialin e shkruante vetë Enver Hadri.

Në anën tjetër, Vehbi Ibrahimi organizatën e tij e kishte shkrirë në "Besëlidhjen Kombëtare Shqiptare", që po ashtu e botonte revistën e tyre me të njëjtin titull.

Shumica e shqiptareve nga Kosova ishte e detyruar të organizohej në klubet jugosllave dhe shkollat shqipe që aso kohe ishin hapur në shumë vende europiane. Mosdërgimi i fëmijëve në shkollën shqipe sanksionohej me marrjen e pasaportave të prindërve. Bashkëpunimi me grupin e Enver Hadrit apo të Vehbi Ibrahimit, po ashtu, sanksionohej me marrje të pasaportave dhe me ndëshkime të tjera, aktualisht për ne ende të panjohura. Shtresa e shqiptareve, që vinin nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia kishte hapur restauronte me mbishkrime jugosllave në tërë territorin e Belgjikës që rregullisht frekuentoheshin nga diplomatët e ambasadës jugosllave.

Kjo ishte gjendja reale e mërgatës shqiptare në Belgjikë, ku Musa Hoti ikur nga Jugosllavia, shpresonte të merrej me veprimtari kombëtare antijugosllave.

Para se të zbulojmë përpjekjet e Musa Hotit në angazhime për aktivitet kombëtar në Bruksel do t’i kthehemi për një çast veprimtarisë së tij kombëtare në Kosovë. Pasi të krijojmë një përfytyrim për veprimtarinë e tij antijugosllave në Kosovë, do ta kemi më lehtë ta kuptojmë se në çfarë gjendje emotive do të gjendej Musa Hoti në mesin e shqiptareve në Belgjikë.

Për angazhimet e tij kombëtare do të lexoni ato që Musa Hoti m’i thoshte kur unë doja të shkruaja një artikull për jetën e tij, sa ishte ende gjallë. Fejtoni im për Musa Hotin, që u botua për së gjalli të Musës, u inçizua dhe po e japim ashtu siç ai më kishte rrëfyer.

## *Kronikë*
## *Bruksel, 9 nëntor 1978*

Shtetet e Europës nuk u bënin ndonjë trajtim të veçantë azilkërkuesve shqiptarë, siç u bënin disidentëve nga Rusia dhe shtetet tjera të bllokut komunist. Jugosllavia e asaj kohe gëzonte privilegje të mëdha dhe simpatinë e tërë vendeve Perëndimore. Azilkërkuesit shqiptarë intelektualë nuk trajtoheshin si ata të shteteve të tjera, por secili duhej të gjendej sipas mundësisë personale. Mundësitë ishin se kishe të drejt të punoje çdo lloj pune fizike që aso kohe kishte nevojë për fuqi punëtore. Diploma e Universitetit të Kosovës nuk bëhej ekuivalente dhe as që diskutohej për këtë gjë. Refugjatëve të shteteve sllave u pranohej diploma dhe ata mund të punonin në fushën e tyre për çka kishin mbaruar studimet. Shqiptarët kishin dy zgjidhje: të punonin punë fizike dhe përkthyes në policinë belge. Disa prej nesh, që jetonim në Belgjikë, si Enver Hadri, Behare Rexhepi, Gani Azemi, Qamil Zekolli, Vehbi Ibrahimi dhe unë, me të cilët Musa Hoti kishte kontakte, e nënçmonim punën si përkthyes i policisë, ndaj zgjodhëm rrugën tjetër që ne mendonim se ishte më e ndershme.

Musa Hoti duke e parë se nuk kishte tjetër zgjidhje u punësua në një autolarje që ishte në qendër të Brukselit. Enver Hadri, pasi kishte punuar si ndihmës i një arkitekti, largohet nga puna; Gani Azemi punësohet mirëmbajtës i një ndërtese; Beharja po ashtu në mirëmbajtje të një shtëpie; unë isha punësuar në një fabrikë të vajit, por pas pak muajve më larguan; Qamili ishte punësuar në një restorant, por shpejt mbeti pa punë. Gjatë kohëve kur kishim takime të rëndësishme Enver Hadri më thirrte të shkoja t’i ndihmoja Ajshes (gruas se tij) në një restorant në qendër të Brukselit, dhe, në raste të tjera, bashkë me Enverin shkonim i ndihmonim Behares ose edhe Ganiut për t’i kryer më shpejt punët e pastrimit. Tani në Kosovën e pasluftës disa mburren se nuk kanë punuar në firma të pastrimit, por kanë bërë punë intelektuale si përkthyes të policisë. Më këtë rast nuk dua të nënçmoj e as t’i etiketoj ata që punuan si përkthyes të

policisë dhe të gjyqeve ku jetonim ne, por jam plotësisht i bindur se puna e jonë fizike që bënim ishte së paku e ndershme. Nga kjo nuk duhet të nënkuptojnë ata se u lodhën me punë të pandershme, sepse ata vetë janë të vetëdijshëm: punuan ndershmërisht apo punë të pista. Vetëm ata e dinë sa kanë qenë të sinqertë e të ndershëm.
Musa Hoti edhe pse punonte tërë ditën, gjatë kohës së lirë bënte përpjekje për të vazhduar aktivitetin kombëtar. Mundohej të gjente shokë të idealit me të cilët bashkarisht mund të jepte kontributin personal për çështjen kombëtare. Por cili ishte aktiviteti që mund t’i kontribuoje çështjes kombëtare në Bruksel?! Në Kosovë ishte çështje tjetër. Mund të gjeje dy vetë me të cilët kishe mundësi të organizoje diçka që i shkonte në favor të Kosovës. Në Bruksel të gjeje dy vetë dhe lirisht të veproje kundër politikës shoveniste të Serbisë ishte gjëja më e vështirë. Shtresa e shqiptarëve të ardhur nga Turqia, që ishin vendosur në Belgjikë, e quanin vetën shqiptar, por ishte numër i vogël i tyre që nuk e simpatizonin politiken jugosllave të asaj kohe. Pjesa më e madhe e tyre të shpërngulur me dhunë gjatë viteve të torturave të Rankoviçit, nuk kishin asnjë anëtar të afërt të familjes në Kosovë, përveç pasurisë së patundshme që u kishte mbetur djerrinë. Kjo shtresë e frekuentonte ambasadën jugosllave në Bruksel, përfitonte nënshtetësinë jugosllave dhe pajisej me pasaporta jugosllave. Kjo ishte shtresa ku edhe Ambasada Jugosllave dhe delegacionet zyrtare nga Kosova e Beogradi gjenin pritje e përcjellje të ngrohta. Ne mesin e kësaj shtrese kishte edhe prej atyre që nuk pajtoheshin me kushrijt e vet, por ishin të paktë.
Shtresa e shqiptarëve nga Kosova, që ishte instaluar në Belgjikë, përbëhej prej individëve që Kosovën e kishin lëshuar për të gjetur punë krahu. Të paktë ishin prej tyre që nuk e vizitonin ambasadën jugosllave që mos t’i prishnin punët e tyre për të kaluar pushimet vjetore në gjiun familjar në Kosovë.
Nga emigracioni i vjetër shqiptar po ashtu shumica nuk i prishnin punët me Jugosllavinë për të pasur mundësi të kalonin pushimet në Kosovë që, së paku, nga afër t’i afroheshin Shqipërisë. Më në fund kjo shtresë e këtij emigracioni kishte nostalgji për kohën që e kishin kaluar në Kosovë, pasi kishin ikur nga Shqipëria. Madje vite të tëra

kishin jetuar në Kosovë ku pjesës më të madhe u kishin lindur edhe fëmijët.
Vetëm një grup i vogël shqiptarësh që jetonin në Belgjikë ishte i vendosur që kurrë këmba e tyre të mos shkelë në ambasadën jugosllave për të marrë pasaportën e tyre. Ishte ai një grup aq i vogël, saqë nuk e kalonte numrin dhjetë, maksimumi pesëmbëdhjetë. Nga ky grup kaq i vogël, po që se mbahet parasysh fakti se as bashkëshortet e tyre nuk shkuan në ambasadë për të kërkuar pasaportë, reduktohej në katër individë. Vetëm katër vetë deri në përfundim të luftës në vitin 1999 nuk i kaluam pushimet në Kosovë. Vetëm katër prej nesh jetonim me nostalgjinë për vendlindjen, për dasmat dhe vdekjet e prindërve tanë të cilët nuk patëm mundësi që, në çastin e fundit të jetës së tyre të gjendeshin pranë tyre. Vetëm katër! Bashkarisht, me bashkëshortet, vetëm tetë prej nesh kurrë nuk e shtrimë dorën për pasaportën jugosllave. Në fakt pasaporta jepej vetëm me një kusht, të mos ishe kundër sistemit jugosllav; të denoncosh çdo të afërt, që ishte anëtar i ndonjë organizate politike shqiptare.
Mund të merrni me mend se ishte lehtë, apo vështirë të punoje e veproje për çështjen tonë kombëtare në kryeqytetin e Europës, në Bruksel. Me dashje apo pa të duhej të flisje shqip me dikë e të gjithë nuk ishin projugosllavë. Ata shkonin në ambasadë por të gjithë nuk spiunonin, por që e kishin të vështirë të takoheshin me ne dhe aq më tepër të bashkëvepronin.
Kujt t'i bashkangjitej Musa Hoti e të vepronte pa frikë për interesa të çështjes kombëtare?! Të vetmit që haptas kishin krijuar organizatën legale ishte Enver Hadri dhe në anën tjetër Vehbi Ibrahimi. Si Enveri, ashtu edhe Vehbiu, rreth tyre kishin individë që ditën rrinin me ta dhe natën me ambasadën jugosllave. Për këtë problem pak vite më vonë Enver Hadri do të shkruajë dhe do t'i denoncojë anëtarët me të cilët kishte punuar në "Rezistencën Kombëtare" Pak vite më vonë (1981) Vehbi Ibrahimi do të vritej pikërisht nga kurthe që përgatitën vetë anëtarët më të afërt të tij. Shumë vite më vonë (1990) Enveri Hadri supozohet po ashtu se është vënë në kurth nga ndonjë anëtar i afërt më të. Kujt mund t'i

besonte Musa Hoti, i cili, po ashtu, shumë vite më vonë enigmatisht do të vritet në qendër të Brukselit?! Kujt t'i besonte e t'i bashkangjitej në bashkëveprim për çështjen kombëtare Musa Hoti?!
Kur Musa Hoti në vitin 1979 kërkonte t'i bashkangjitej ndonjë strukture kombëtare të organizuar ishte kohë e një pasiviteti total të mërgatës shqiptare në Belgjikë. Unë asokohe isha duke i vazhduar mësimet e frëngjishtes, Gani Azemi pasi u punësua i ndërpreu mësimet, Sefo Bejta Krasniqi, bashkë me ne, përgatitej për pritjen e grupit më të njohur të intelektualëve nga Kosova, Jusuf Gërvallës, Teki Dervishit, etj.
Grupi ynë, Sefa, unë dhe Ganiu kontaktonim me Enver Hadrin dhe bisedonim për mundësin e vazhdimit të botimit të "Albania"-s. Enveri na sqaroi se mërgata e Belgjikës është tërësisht e ndikuar nga dy shërbimet sekrete, të Beogradit dhe të Tiranës. Sipas tij dhe konstatimit tonë ishte e pamundur që grupi intelektual që prisnim të na bashkangjitej shumë shpejt në Bruksel. Gjatë një takimi tonë Enver Hadri erdhi i shoqëruar me një anëtar të tij të vjetër në moshë. Ai nuk ishte i vjetër, por ne ishim të rinj dhe ai na dukej i moshuar. Posa i moshuari u prezantua, kush ishte, pse kishte ikur nga Kosova dhe me kë kishte vepruar në Kosovë, Sefo Bejta Krasniqi u zbeh. Biseda e asaj dite nuk zgjati shumë, sepse Sefa dëshironte të largoheshim sa më parë. Më pas Sefa na tha se shoku me të cilin i moshuari thoshte se kishte vepruar kundër interesave jugosllave në Ferizaj, e kishte kidnapuar Sefën. Unë e njihja njeriun nga Ferizaj që Sefën e kishte futur në grackë. Më vonë shumë dekada më vonë vetëm në vitin 2004 i moshuari do të deklarojë vetë në një libër se UDB-a jugosllave i kishte dhënë pasaportën dhe miliona dinarë të asaj kohe për të ikur në Belgjikë. Në Kosovën e pasluftës është bërë një shprehi dhe, ndoshta edhe e kanë për krenari, të deklarojnë në gazeta dhe libra se dikur paskan punuar për UDB-në! Madje njerëz të tillë po gëzojnë respekt edhe nga personalitete të ndryshme politike dhe intelektuale në Kosovë.
Ashtu siç ishin lënë fjalët me ta sa ishim në Kosovë, para se të vinte në Bruksel Jusuf Gërvalla me të cilin Sefa komunikonte rregullisht, në banesën time në Bruksel vijnë Teki Dervishi, Resul Shabani dhe

Xhabir Ahmeti. Pasi u studiuan të gjitha mundësitë se si mund të organizohej mërgata e Brukselit dhe të nisej puna për vazhdimin e "Albania-s" të Faik Konicës, Tekiu dhe dy të tjerët e shfaqen zhgënjimin e tyre për situatën e keqe e shqiptarëve në Belgjikë. Një javë më vonë ata u kthyen në Kosovë. Dy vite më vonë, edhe Sefa i zhgënjyer, nga Brukseli shkoi për të jetuar në Francë. Lexuesit, që për herë të parë dëgjojnë për Sefo Bejta Krasniqin, duhët të dinë se ai ishte regjisor i filmit, teatrit dhe radios më i miri i të gjitha kohrave që kishte Kosova.

***Orientimi ideologjik i Musa Hotit***

Kujt t'i bashkangjitej Musa Hoti? Enver Hadri kishte nevojë për shoqëri, por jo të krijonte ndonjë rreth të zgjeruar, pasi nuk kishte fushëveprimi. Botimi i "Zërit të Kosovës" herëpashere ishte aktivitet i mjaftueshëm për të. Të zgjeronte rrethin duhej veprime konkrete, por veprime konkrete nuk mund të ndërmerrte, sepse nuk kishte kushte. Për secilin kosovar e vetmja zgjidhje ishte takimi me Enver Hadrin. E vetmja gjë që mund të bëhej ishte shkrimi i ndonjë artikulli për revistën dhe kalimi i kohës në kafenetë ku rrinin shqiptarët. Të takoje Rifat Kolgjinin të quanin reaksionar. Të takoje Jusuf Selenicën të quanin ballist që ia ke kthyer shpinën Kosovës. Të takoje Idriz Bashën të quanin zogist dhe bashkëpunëtor i UDB-ës. Të takoje Enver Hadrin ose Vehbi Ibrahimin të quanin spiun të Rusisë. Grupi ynë i takonte dhe zhvillonte biseda të ngjeshura më të gjithë këta duke mos e veçuar as Muharrem Bajraktarin.
Shumica e të ardhurve nga Kosova kishte ideologji majtiste. Në mesin e tyre me ideologji majtiste ishte edhe Musa Hoti, por jo marksiste-leniniste. Musa Hoti e preferonte flamurin me yll, e simpatizonte shtetin shqiptar dhe politiken e Tiranës, siç e donin edhe miliona të tjerë në Kosovë dhe jashtë saj. Për të gjithë shqiptarët asokohe ishin vetëm dy rrugë: me Enver Hoxhën ose me Titon. Rruga e tretë nuk ekzistonte. Ata që donin Enver Hoxhën e donin Shqipërinë dhe bashkimin kombëtar. Ata që donin Titon ishin

pro sistemit jugosllav dhe pajtoheshin që Kosova të mbetej nën pushtimin serb.
Më kot sot mund të dëgjojmë zëra që arsyetojnë se duke e dashur Titon kanë punuar kundër sistemit jugosllav. Ata që dikur e donin Titon, më vonë dashurinë e tyre e kthyen për Milloshevìçin, por kur ky nuk i përfillte më dhe kur forcat e NATO-s u futën në luftë, këto tipa mund të mburren sa të kenë dëshirë. Realiteti është realitet dhe nuk ndryshohet sipas dëshirës se disave.
Në Gjermani, në Zvicër dhe kudo në diasporë pjesa më e madhe e mërgatës sonë përbëhej prej punëtorëve me punë të përkohshme përveç mërgatës në Belgjikë ku nuk pranoheshin punëtorë, por vetëm refugjatë politikë. Shumica nga tanët kishin kërkuar strehim politik, por në fakt mbanin pasaporta të Jugosllavisë dhe të refugjatëve politikë. Në mesin e të ardhurve të ri nga Kosova ishte edhe Musa Hoti,që arriti në Bruksel me 9 nëntor të vitit 1978. Komisariati për Refugjatë Politikë lëshonte vetëm një letër të thjeshtë më të cilën mund të shëtisje kudo në territorin e Belgjikës, por më atë dokument të thjeshtë nuk kishe të drejtë për të dalur jashtë Belgjikës. Ishte një dokument zyrtar, me të cilin mund të bëje asgjë, vetëm të sorollateshe rrugëve dhe kafeneve. Shumëkush që vinte nga Kosova për një kohë të shkurtër, pranohej si refugjat politik, mirëpo Musa Hoti nuk pranohej edhe pse i plotësonte të gjitha kushtet. Në Belgjikë pranimi i statusit të refugjatit ishte një proces tepër i çuditshëm; pranoheshin ata që nuk e kishin bërë asnjë problem në Kosovë e, madje, ata që shkonin e vinin në Kosovë; kurse Musa Hotit, mua e ndonjë tjetri na refuzohej qëndrimi në Belgjikë si pretekst se Musa Hoti nuk posedonte elemente të mjaftueshme që i rrezikohej jeta në Kosovë.
Të vetmit që, sipas Komisariatit për Refugjatë Politikë, që nuk i plotësonim kushtet ishim Musa dhe unë. Kjo odesiadë zgjati deri në vitin 1985. Të tjerët pranoheshin brenda shtatë muajve, ndërsa ne dy u detyruam të prisnim plot shtatë vjet. Shumë vite më vonë në shtypin dhe mediat belge njoftohej se Ministri i Punëve të Brendshme i Belgjikës kishte qenë spiun i Shërbimit Sekret Jugosllav me ç’rast organet belge e burgosën.


NV

UNITED NATIONS
HIGH COMMISSIONER FOR REFUGEES
Branch Office for Belgium and Luxembourg

NATIONS UNIES
HAUT COMMISSARIAT POUR LES RÉFUGIÉS
Délégation pour la Belgique et le Luxembourg

Télégrammes : HICOMREF
Téléphone XXXXXXXXXXXXX

RÉFÉRENCES À RAPPELER
C/83139

BRUXELLES 4, le 27 novembre 1978
43, rue de Trèves
rue Van Eyck, 11A
1050 BRUXELLES
Tél. : 649.01.51

V.V.G. C/A

Monsieur l'Administrateur,

J'ai l'honnur de vous informer que M. HOTI Musa de nationalité yougoslave né à Mitrovice le 11 juillet 1946 s'est présenté ce jour à nos bureaux pour demander que je lui reconnaisse la qualité d réfugié.

L'intéressé déclare être arrivé en Belgique le 9 novembre 1978 et résider actuellement à rue Jourdan 137 1060 Bruxelles

L'intéressé se présentera dans les plus brefs délais à l'Administration de la Police des étrangers, XXXXXXXXXXXXXXXXXX à Bruxelles 1, le mardi ou le vendredi entre 9 h. et 11 h. ou entre 14 h. et 17 h. en vue de la régularisation de son séjour dans le Royaume.

Une copie de la présente lettre a été remise à l'intéressé.

Veuillez agréer, Monsieur l'Administrateur, l'assurance de ma considération la plus distinguée.

Pour le Délégué en Belgique,

COPIE

L'intéressé s'est déjà présenté à la Délégation le 15 novembre 1978

MINISTÈRE DE LA JUSTICE — OFFICE DES ÉTRANGERS

Monsieur l'Administrateur
de la Police des étrangers,
Administration de la Sûreté publique
Ministère de la Justice
XXXXXXXXXXXXXX square de Meeûs 8
Bruxelles 1040

Mo

**Faksimile e dokumentit të Musa Hotit,**
**që asokohe lëshonte zyra e refugjatëve politikë**

Vitet 1970-1980, në mërgatën shqiptare të Belgjikës nuk kishte ndonjë aktivitet që e meriton të veçohet, sepse rrethanat ishin të tilla ku nuk ndodhte asgjë me rëndësi. Asgjë përveç takimet në kafene dhe revista e Enver Hadrit që kishte dalë vetëm tre numra. Pavarësisht situatës së qetë ardhja e kosovarëve të ri ngadalë po i krijonte kushtet për veprim më të ngjeshur.

## *Shpërbërja e klubi famëkeq "Jugosllavia"*

Komuniteti slloven dhe kroat ishin ndarë nga klubi famëkeq "Jugosllavia". Ndarja e sllovenëve dhe e kroatëve ndikoi që edhe shqiptarët të kërkonin krijimin e klubit të tyre. Klubi i posaformuar, "Përparimi", rreth vetës tubonte shqiptarët, që e kalonin kohën në këtë lokal ku mund të lexonin literaturë nga Kosova dhe të organizonin udhëtime të fëmijëve për ta vizituar Kosovën. Edhe pas formimit të klubit "Përparimi" kishte shqiptarë që ishin anëtarë të devotshëm të klubit "Jugosllavia", klub që dalëngadalë po zbrazej, sepse shqiptarët ishin ata që i mbushnin lokalet e tij. Që të dy klubet i vizitonte herë pas here ambasadori jugosllav. Ndarja e klubeve, shqiptarët veç dhe serbet veç, nuk i shkonte për hosh Beogradit. por nuk mund të ndodhte ndryshe. Shqiptarët kishin filluar të vetëdijesoheshin se hyrja në klubin "Jugosllavia" do të thoshte të ishe me ata; ndërsa hyrja në klubin "Përparimi" nënkuptonte se je me Kosovën, por jo me Shqipërinë dhe me emigracionin që ishte kundër Jugosllavisë.

Klubet ekzistuese ishin plotësisht të varura nga ambasada e Jugosllavisë. Në ato klube nuk zhvillohej ndonjë aktivitet, por ishin vendtakime të punëtorëve të ish-jugosllavisë nga të gjitha republikat dhe krahinat autonome të asaj kohe. Në fakt në këto klube më shumë kishte shqiptarë dhe serbë, sesa nga kombësitë tjera të Jugosllavisë. Komunitetet sllovene dhe kroate, që jetonin në Belgjikë, kishin krijuar klubet e tyre qysh më herët. Ata nuk shkonin në klubin "Jugosllavia" që gjendej në qendër të Brukselit. Ky klub

vizitohej rregullisht nga ambasadori serb dhe zyrtarët tjerë të ambasadës jugosllave. Në këtë klub nuk bëhej hapur politikë e posaçme antishqiptare, por shteti jugosllav, respektivisht i serbëve, synonte t'i tregonte opinionit të huaj se shqiptarët dhe serbët janë të barabartë. Me ndarjen e sllovenëve edhe shqiptarët bënë përpjekje për t'u shkëputur nga klubi jugosllav. Kështu u themelua dhe u organizua klubi "Përparimi". Ndarja e shqiptareve nga klubi serb ishte hapi i parë i mirëfilltë, që bëri mërgata e ardhur nga Kosova. Në këtë klub ishte biblioteka, salla për organizime të ndryshme si dhe bari ku mërgimtarët tanë mund të pinin kafe e tjerë ose ushqeheshin me çmime të pranueshme. Klubin "Përparimi" e vizitonte edhe ambasadori jugosllav. Natyrisht që ai dhe "diplomatët" serbë disi e shtrinin kontrollin e tyre ndaj këtij klubi. Pavarësisht që klubi kontrollohej prej ambasadës, për një grup ishte më e pëlqyeshme të shkoje në klubin "Përparimi", sesa në atë "Jugosllavia", që kishte mbetur vetëm me serbë. Shqiptari nga Kosova nuk kishte asnjë arsye a motiv të shkonte në klubin serb, pasi edhe klubi shqiptar ishte miratuar nga vetë ambasadori i Jugosllavisë në Bruksel. Shqiptarët ia lehtësuan vetes barrën dhe nuk kishin asnjë kushtëzim si më parë, se, nëse nuk e viziton klubin serb, do t'ua merrnin pasaportat jugosllave. Kryetar i klubit shqiptar "Përparimi" për një kohë të gjatë ishte Myfail Hajdini, kurse si koordinator Vaid Reka. Këta organizonin vizita me grupe të fëmijëve shqiptarë në Kosovë, po ashtu koncerte me këngëtarë të njohur të Kosovës, turnire të ndryshme të futbollit dhe, para së gjithash, ndjekjen e mësimeve në shkollën plotësuese shqipe. Shkollën plotësuese shqipe e ndiqnin më shumë se 400 fëmijë shqiptarë.

Sikur të bëhej një vlerësim objektiv mes klubit "Përparimi" dhe klubeve tona të mëvonshëm shqiptarë, do të vinim në përfundim se "Përparimi" kishte një strukturë dhe organizim të mirëfilltë; kurse klubet tona, që ne i hapëm më shumicë, kishin më shumë përplasje mes anëtarëve, sesa punë efektive. Ne kurrë nuk arritëm të organizonim një grup nxënësish tanë që të vizitonin Shqipërinë. Numri i nxënësve tanë kurrë nuk arriti më shumë se 150 nxënës.

Klubi “Përparimi “, nga ana jonë, trajtohej si klubi i UDB-së; kurse ana e tyre klubet tona i trajtonte si klube të Enver Hoxhës. Asnjëra dhe as tjetra palë nuk kishte të drejtë edhe pse mund të ketë pasur spiunë të UDB-së në “Përparim”, ashtu sikurse mund të ketë pasur në klubet tona spiunë të Shqipërisë. Të vlerësosh aktivitetet e klubit “Përparimi”, si atëherë edhe sot, ka zëra që thonë se unë po e mbroj politikën e atëhershme jugosllave. Unë po tregoj një realitet me shifra dhe fakte. Nuk po shkruaj për politikën e brendshme të klubit dhe për edukatën e fëmijëve tanë, të cilët e merrnin në atë shkollë. Lidhur më ketë duhet lexuar libri “Idealistët 1” ku gjerësisht përshkruhet hapja e shkollës shqipe “Bajram Curri” me iniciativën time dhe të Musa Hotit, Hazir Hazirit, Qamil Zekollit etj. Asnjëherë nuk isha kundër shqiptareve që shkonin në atë klub, përkundrazi unë, herë pas here, shoqërohesha me ndonjërin prej tyre.
U detyrova të shkruaj për këtë klub, sepse pikërisht në lokalet e tij zënë fill shumë ngjarje të mëvonshme, sidomos ato të Musa Hotit. Ky përshkrim i gjendjes dhe organizimeve të mërgatës do t’u shërbejë lexuesve dhe protagonistëve, që ende jetojnë në mesin tonë, pasi disa prej tyre u vranë nga shërbimi sekret jugosllav. Ky përshkrim do t’u shërbejë gjeneratave të mëvonshme me shpresë se ata dhe vetëm atëherë do të vlerësohen gjërat me objektivizëm dhe pa xhelozi. Të gjitha klubet shqiptare luajtën rolin e tyre në historinë e diasporës sonë.
Asnjëherë deri më sot nuk është bërë një vlerësim objektiv i veprimtarive që janë zhvilluar në klubet shqiptare. Lexuesit e gjeneratave të sotme dhe ato të ardhshme, sidomos studiuesit dhe ekspertët e ardhshëm do të jenë të interesuar për specifikat dhe të përbashkëtat e këtyre klubeve.
Të fillojmë me klubin e parë të formuar në Belgjikë dhe të frekuentuar nga shqiptarët. Ky ishte klubi “Jugosllavia”. Pas disa vitesh u themelua klubi “Përparimi” e pastaj në rend e në kohë vijnë klubet “Idriz Seferi”, “Anton Çeta” etj. Kurse shumë vonë u krijuan kafene shqiptare për t’iu shmangur tatimeve të shtetit belg. Por ata nuk ishin klube të ngritur me qëllime të caktuara për aktivitete kulturore. Specifika e të gjitha klubeve të përmendura është se në

asnjërin prej tyre nuk mund të anëtarësoheshim në të që ishim refugjatë politikë. Ne mund të hynim, të pinim kafe, por assesi të zhvillonim aktivitete kombëtare. Të gjithë ne, që vepronim në favor të çështjes kombëtare, ishim të padëshirueshëm për këto klube. Ne nuk habiteshim për klubin “Përparimi”, sepse ishte gjë normale që ne nuk mund të zhvillonim aktivitete kombëtare në një vend ku kontrollohej nga ambasada jugosllave. Habiteshim pse klubi “Idriz Seferi” na quante reaksionarë, të padëshirueshëm dhe të rrezikshëm, si mua,ashtu Enver Hadrin, Musa Hotin, Gani Azemin, Ramiz Zekollin e të tjerë

Gjatë një aktiviteti kulturor që e kisha organizuar, unë ftova Enverin, Ganiun dhe Beharen, natyrisht në pajtim me Sadik Tolajn, Zeqir Krasniqin, por kryesia e klubit “Idriz Seferi” na ndaloi të lexonim poezitë tona. Kështuqë ora letrare nuk u mbajt me pretekstin se anëtarësinë e atij klubi po e infektonim me irredentizëm. Në kohën kur zhvilloja këto aktivitete kulturore isha në lidhje me Sabri Novosellen dhe Xhafer Shatrin. Ata më shkruanin që t’i bashkangjitemi Lëvizjes, sepse me aktivitetet tona ata do forcoheshin. Më shkruanin ta merrja Enverin dhe Ganiun. Organizimi i kësaj ore letrare do ta shqetësonte kryesinë dhe na e ndaluan, por nuk do të hezitonin t’i shkruanin Lëvizjes për ndërhyrjen tonë. Ja se si shprehet Xhafer Shatri në një letër që i shkruante Musa Hotit.

***“ Për E. H. (Enver Hadrin - shënimi im) e di se ka aftësi të madhe, aty s’ka dilemë, bile më njoftuan se në Bruksel qenka paraqitur në klub, por frikohem mos ajo injoranca e tyre po e keqpërdor qëllimin e tij të mirë, sepse edhe ai ka fëmijë dhe sigurisht dëshiron t’i dërgojë në shkollë. Prandaj bisedo me ata njerëz që t’ia mundësojnë, se fundi njerëzit kanë të drejtë të frekuentojnë çdo klub, pasi si i tillë ai është hapur për të gjithë.***

***Sa i përket lejes për dasmë, nëse vjen puna për aty, kuptohet ne do t’i drejtohemi Enverit, sepse pothuajse aty është i vetmi që ka aftësi të rregullojë çështje të tilla. Ajo mërgata tjetër, disa kanë rënë kllukë, dhe e vetmja punë e mirëfilltë që bëhet aty është çështja e klubit, më fal, desha të them e shkollës”.***

I dashur shok,

kam qenë shumë i zënë kështu që sot po të përgjigjem edhe në letrën tënde të 10 shtatorit.Besomë kam qenë tejet i zënë me përgatitjen e ZK nr.6 i cili do të dalë në fund të kësaj jave.

Fillimisht po të njohtoj se jam takuar me Qamilin.Ai është shumë burrë i mirë,unë mund të them ndoshta edhe ndër të rrallët aty.Biseduam për shumëçka.Ishte edhe Sabiti,edhe ai ishte entuziast,por mjerisht njerëzve tanë po u mungon përvoja,dhe kjo po na dëmton shumë.Për dasmë është e nevojshme të bëjmë diçka së shpejti,por më mirë është në Fr. dha tsh për tash nuk mund të të them asgjë.Do të shohim më vonë,janë marrë disa hapa por për suksesin e tyre nuk di akoma asgjë.Sa për ambasadën e Shqipërisë në Br. me sa di unë atë regjion e ka ajo e Parisit,prandaj në atë drejtim ne nuk do të humbim asgjë.Br. është vend i përshtatshëm,aq më tepër kur prej aty mund të dalin shumë njerëz,mund të dalin rreth 500 vetëm prej aty, po si do që të jetë ne do të këqyrim.

Për bashkëvendasin tënd ne nuk do t`i lajmërohemi,të shohim se a po lajmërohet ai natyrisht nëse na dërgon kërkesën për abonim se ne do t`ia dërgojmë ZK.

Po si do që të jetë kij kujdes me të,dhe jo vetëm me të por edhe me tjerë se mos po ta bëjnë aty farë sherri.Këtë gjithmonë kije parasysh,sepse është fat që po rri në asi burgu.

Për E.H. e di se ka aftësi të madhe aty s`ka asnjë dilemë,bile më njohtuan se në Bruksel qenka paraqitur në klub,por frikohem se mos ajo injoranca e atyshme po e keqpërdor qëllimin e tij të mirë,sepse edhe ai ka fëmijë dhe sigurisht deshiron t`i dërgojë në shkollë.Prandaj bisedo me ata njerëz që t`ia mundësojnë,fundja njerëzit kanë të drejtë në frkuentim të çdo klubi sepse si i tillë ai është i hapur për të gjithë.

Sa i përket lejës për dasmë nëse vie puna për aty,kuptohet ne do t`i drejtohemi Enverit,sepse pothuaj i vetmi është që ka aftësi të rregullojë çështje të tilla.

Ajo mërgata tjetër disi ka rënë kliuk dhe e vetmja punë e mirëfilltë që bëhet aty është çështja e klubit.më fal desha të them çështja e shkollës.

Shkolla ka rëndësinë e vet ta themi haptas historike,dhe ajo ka mundësi të zgjërohet edhe më shumë,ka mundësi të hapet edhe shkollimi i mesëm,sepse aty ka kuadro,bile shumë kuadro.Por ja që nuk ka unitet.Në këtë drejtim po të porosis që të kesh kujdes me ata njerëz,dhe i vetmi prej tyre është dh. në të cilin ti mund të bazohesh në`çdo gjë.

Për ankesat ke bërë shumë mirë që i ke shkruar dhe lidhur me to konsultohu ashtu shkarazi me E.H. pade çka pothotë se ndoshta është në dijeni me çështjën e tyre.

Tash për tash e kemi një problem,kemi nevojë në përkthimin e materialit të ZK për të burgosurit,pra ky numri që del tash.Kishte me qenë me shumë rëndësi që të përkthehet sa më parë.A di ndonjë njeri atje që mund ta bëjë këtë?

Nëse i rregulloj dokumentet,do të dal andej gjithsesi pastaj shihemi e bisedojmë gjerësisht për të gjitha.Përshëndetje vëllazërore.Z

3 tetor 1983

***Letra e Xhafer Shatrit dërguar Musa Hotit ku shprehet për klubin dhe E.H.***

Në kohën kur klubet jugosllave filluan të ndahen në klube shqiptare, Qamil Zekolli ishte i ftuar si delegat i Lëvizjes nga Belgjika në një mbledhje të klubeve të Lëvizjes, por nuk u lejua pasi nuk kishte pasaportë jugosllave. Në ato mbledhje të Lëvizjes zgjidheshin vetëm delegatë me pasaporta jugosllave, refugjatët politikë mund të kontribuonin vetëm anonimisht. Lidhur më këtë, Qamil Zekolli do t'i shkruante një letër Musa Hotit (asokohe Musa ishte në burg) ku i shprehte habinë dhe mllefin ndaj një vendimi të tillë. Pjesën e kësaj letre do ta lexojmë në faqet në vijim.
Më herët Lëvizja kishte motivuar vendimet e kësaj natyre me pretekstin se takimet në klube përcilleshin nga Shërbimi Sekret Jugosllav dhe refugjatët politikë, që ishin aktivistë të dalluar të çështjes kombëtare, rrezikoheshin edhe me jetë. Sipas shefave të Lëvizjes, armikun po e luftonin me të njëjtat armë, prandaj, kur tjerët hynin në mesin e aktivistëve, Jugosllavia i identifikonte dhe në udhëtimet që bënin punëtorët për pushime në Kosovë, i arrestonte. Asnjëherë nuk më ka shkuar ndërmend që ta pyesja ndonjërin prej shefave të Lëvizjes pse punëtorët tuaj Jugosllavia po i burgos edhe pa qenë ne anëtar të klubeve tuaja?!
Në vijim do të shohim se si aktivistët e Lëvizjes u burgosën dhe u vranë pa qenë asnjëri prej tyre në kontakt me refugjatët politikë të rrezikshëm, siç na quanin ata. Pse u vra Zija Shemsiu, e... ?! Sipas letërkëmbimeve të krerëve të Lëvizjes, me Musa Hotin do ta gjejmë një përgjigje që ka shumë gjasa të jenë ashtu siç shkruhet në ato letra që do t'i lexojmë në vijim të këtij libri.
Më daljen e LDK-së u hap edhe një klub tjetër me emrin "Anton Çeta". Fillimisht kryetar u zgjodh Ramiz Zekolli. Çudia më e madhe ishte se kryetari, nën presionin e kryesisë, doli me një komunikatë që u shpall në portën dhe lokalet e këtij klubi, ku shkruante: "U ndalohet hyrja në lokalët e klubit "Anton Çeta": Reshat Sahitajt, Qamil Zekollit, Musa Hotit...". Ne, nuk ishim në gjendje të kuptonim, pse na ndalohej hyrja. Ky vendim ishte absurd. Pak kohë më vonë edhe vetë Ramiz Zekollit, që dikur ishte kryetar, iu ndalua hyrja në të njëjtin klub nga anëtarët të cilët vetë i kishte sjellë. Pra, specifika e përbashkët është se kryesia e klubit "Jugosllavia" e

themeloi klubin “Përparimi”; anëtarët aktivë të “Përparimit” u futën në kryesi të “Idriz Seferit”, dhe më vonë, disa prej kryesive të klubeve “Jugosllavia” e “Përparimi” u përfshinë në kryesi të klubit “Anton Çeta”. Mrekulli! Asgjë nuk kishte ndryshuar, përveç emërtimeve të mbishkrimeve dhe aty këtu anëtarësisë. Pas dekadave të ardhshme studiuesit tanë, patjetër do të interesohen dhe do t’i gjejnë regjistrat e anëtarëve dhe të kryesive të klubeve të përmendura. Historia nuk shkruhet nga thashethemet dhe familjarët, por nga faktet, dokumentet, dëshmitë e përcjellura me letra të kohës.
U zgjerova enkas në përshkrimin e klubeve që kanë ekzistuar në Belgjikë, ngase shumë ngjarje tragjike të mëvonshme do të lidheshin me “klubet”, përfshirë edhe Musa Hotin, viktimë e thashethemeve.
Sa herë që shkruaj për Vehbi Ibrahimin ( dëshmori i parë që UDB-ja e vrau në diasporë), për Enver Hadrin (dëshmor i katërt që UDB-ja e vrau në diasporë), për Musa Hotin (dëshmor i pestë që enigmatisht u vra në qendër të Brukselit), për Rasim Zenelin ( i harruar nga shteti ynë) , për Hysen Karaliun (i harruar nga shteti ynë), gjithnjë mendoj se këta i kam pranë tavolinës sime dhe bisedoj me ta. Ata, që nuk besojnë se ekziston Zoti, jam i bindur se më marrin për të çmendur; por ata që i besojnë Zotit, më kuptojnë. Pranë meje në dhomën time i kam të gjithë këta personalitete, edhe kur shkruaj, edhe kur nuk shkruaj. Jam i bindur se të gjithë këta do të krenohen me atë që unë jam duke bërë për aktivitetet e tyre.
Më kujtohet kur unë, Musa, Beharja, Enveri dhe Gani Azemi bisedonim rreth zhvillimeve të veprimtarive tona kombëtare. Vite të tëra ne kemi qenë të vetëdijshëm se me punën tonë po e pengonim aq shumë Jugosllavinë, respektivisht Serbinë.

Pasi Musa Hoti i kishte shpëtuar një atentati në Bruksel, përgatitur nga UDB-ja, jo rastësisht u takuam në një kafene të Brukselit, Musa, Enveri, Ganiu dhe unë. Ne asnjëherë nuk kemi shkuar në kafene ku pihej alkool, por në lokale të mira luksoze. Kafenetë ku luheshin letra, shah dhe ku bëhej zhurmë e tollovi nuk i frekuentonim kurrë. Ishin vetëm raste specifike kur shkonim ne lokale të tilla. Për ne,

raste specifike ishin kur duhej të shpërndanim ndonjë komunikatë për të thirr masën në demonstratë që do e organizonim. Vetëm në raste të tilla ishim të detyruar të shkonim ne kafene të tilla për t'i takuar bashkatdhetarët tanë që t'i njoftonim për ndonjë organizim masiv.
Ja se si u zhvillua njëra prej bisedave në "Danish Taverne", që ishte dhe është në qendër të Brukselit.Pas bisedës për organizim të një manifestimi, Musa Hoti iu drejtua Enverit: Enver si shumë je kundër Serbisë, më duket se ma ke marrë radhën! – tha kështu dhe nënqeshi duke vënë dorën të buzët. Kështu bënte Musa, sa herë qeshte njërën dorë e vinte te goja. Çuditërisht Musa Hotin kurrë nuk e kam parë të nervozuar. Kurrë në jetën time Musa Hotin nuk e kam dëgjuar të flasë më zë të lartë. Musa Hoti gjithnjë ka qenë i kujdesshëm të mos pinte asgjë nga askush pa e parë mirë se çka po i shërbehej. Më thoshte se frikësohej se mos UDB-ja po i vente helm në pije. Deri në vitin 1988, Musa Hoti nuk ka pirë alkool. Më pas filloi të pinte , por pas çlirimit të Kosovës ai pinte shumë.

Në Kosovën e çliruar Musa Hoti nuk gjeti asnjë vend pune. Refuzimi i vendit të punës, Musa Hotit ia ka thye të gjitha shpresat dhe moralin për të jetuar. Musa Hotit, që nga tërë populli shqiptar konsiderohej si Avni Rrustemi, në Kosovën e çliruar iu ndalua të punonte njëlloj si të ishte sistemi i Milloshevicit. I zhgënjyer me shtresën politike të Kosovës, Musa kishte filluar të pinte.
Ishte i rregullt në veshje dhe në paraqitje. Vishej me kostum dhe kravatë. Asnjëherë Musa Hoti nuk ka dalë në qytet i parruar, i papastër, pa kravatë. Gjatë bisedave mbante qëndrim dinjitoz. Nuk fliste shumë. Fliste më zë të qetë. Kishte një shkrim tepër të bukur, saqë më mirë më dukej t'ia lexoja letrat në dorëshkrim, sesa kur shkruante me makinë shkrimi apo më vonë me kompjuter. Zakonisht Musa ulej me shpinë prej murit, kur kishte mundësi të zgjidhte vendin, por kur vendet ishin të zëna, ulej ne vendin e lirë. Ndezte cigare pas cigareje. Ganiu nuk pinte duhan. Enveri, për shkak të një operacioni, e kishte rralluar , por më vonë e ndërpreu krejtësisht. Unë ende vazhdoj të ndez cigare pas cigareje.

## Biseda vazhdoi:

**Enveri**: Jo Musë, mos u shliro kaq shpejt se unë nuk jam aq budallë sa mendon ti që veten ta qes para teje!
**Ganiu:** Na i kemi peshue punët më herët dhe kemi gjet formën më të butë: ti me punue kundër Jugosllavisë. Punojmë si Komitet për Mbrojtje të Drejtave të Njeriut.
**Reshati:** Të kishte qenë Enveri kokëfortë si ti, Musë, Enveri kishte vazhduar me Rezistencën Kombëtare, por cili shtet i vret ata që merren me të drejtat e insanit?!
**Musa:** Unë nuk di shumë, por e di që kur të shkruajnë gazetat më prestigjioze për konferencat që po i organizoni ju, Jugosllavia nuk ua falë kurrë.
**Enveri**: Jo Musë, jo! Mos flejë rehat se ti e ke radhën me u vra para meje, tha Enveri dhe qeshi dhe pas teje edhe ne tjerët. Ne, shqiptarët i harrojmë shpejt masakrat dhe vrasjet që ata na kanë bërë; kurse serbët i shkruajnë, nuk i harrojnë , nuk ngutën por pa u hakmarrë kurrë nuk e lënë. Pra ruaju ti, se ti i ke vra ata. Kur të vrasin ty, pastaj ruhemi ne tjerët.
**Musa:** Unë thash vetëm mos po ke qejf me ma marrë rendin, se unë ka shumë vite që po i pres, por si duket, atyre nuk po ua mban të dalin përpara.
**Reshati:** Vetëm kur e mendojnë ata se ti me një plumb një e ke lënë të vdekur dhe dy i ke plagosur, ata shpirti i lëshon ende pa u nisur për Bruksel.
Të gjithë qeshnim se si Musa me një plumb tre diplomatë të Jugosllavisë i kishte paluar për tokë. Lidhur më këtë bisedë Musa Hoti shpesh do të fliste me shokët e tij. Kjo bisedë u bë e njohur për të gjithë shqiptarët, që jetonin në Belgjikë dhe, më vonë, në vitet e pasluftës, Musa e rrëfente edhe me shokët e tij në Kosovë, se si Enver Hadrit i kishte thënë se ia kishte lëshuar radhën e vrasjes.
Pas përfundimit të luftës dhe çlirimit të Kosovës, më ka ra shpesh të rrija me Musën në Bruksel, sidomos në Kosovë ku ai kalonte net të

tëra në banesën time. Beharja shkonte të prindërit në Prizren e Musa përtonte të shkonte në Mitrovicë, andaj e kalonte kohën me mua në Prishtinë ku takoheshim me shokë. Gjatë bisedave që zhvilloja me të në Prishtinë me ka ra të ia rikujtoj bisedën tonë të dikurshme me Enverin. Po tash? - e pyeta Musën.
Tash Serbia ka aq shumë luftëtarë të lirisë, që kanë vrarë serbë më shumë se unë. Unë jam i harruar për Serbinë. Nëse dikush e ka radhën, e kanë Ramush Haradinaj ose Hashim Thaçi. Këta kanë vepruar me shumë se unë.
Kjo ishte biseda ime e fundit që e pyeta Musën. Dhe ai, si zakonisht, radhën ia “lëshonte” tjetrit, jo se frikësohej nga vdekja. Jo, Musa nuk ia kishte frikën vdekjes edhe pse ishte më se i bindur se një ditë Serbia do ta vriste. Musa nuk dëshironte që veprën e tij ta glorifikonte. Musa Hoti ishte tepër modest për veprën që kishte kryer me 4 gusht 1981 në qendër të Brukselit. Ishte aq modest saqë secilin luftëtar të lirisë e quante më të guximshëm se veten e tij.

## *Pas vdekjes i çmojmë heronjtë*

Është për t’u habitur me ne shqiptarët se si e çmojmë njeriun kur nuk e njohim hiç, por vetëm se kemi dëgjuar për aktivitetin e tij. Është një rast që dëshiroj t’ua bëj të njohur se si i ka ndodhur një shokut tim, Rexhë Karalisë, pikërisht për Musa Hotin. Rexhë Karalia ka qenë i dënuar politik në burgun e Idrizovës ku ka vuajtur disa vjet. Pasi doli nga burgu, në pamundësi për të punuar në Kosovë, u arratis në Belgjikë.
Në kohën kur Musa Hoti kishte vrarë diplomatët e ambasadës Jugosllave me 4 gusht 1981. Për këtë ngjarje, përveç shtypit botëror, shkruan edhe gazetat e Beogradit dhe të Kosovës. Kudo në Kosovë dhe në hapësirat shqiptare nën okupimin jugosllav, atë që e përmendte emrin e Musa Hotit, policia e merrte në pyetje dhe e të torturonin, duke e pyetur se ku e njeh, si i njeh etj. Rexhë Karaliu asokohe jetonte në Kosovë. Gjatë një udhëtimi në tren sheh njërin duke e lexuar gazetën ku dukej fotografia e Musa Hotit. Rexha ia

kërkon të panjohurit gazetën dhe në lexim e sipër fillon të qeshë. Bashkëbiseduesi i rastësishëm e pyet Rexhën se pse qeshte. Rexha i tregon se Musa Hotin e ka shok dhe se me të ka pirë kafe e ka biseduar,siç po bisedonte edhe më të. Bashkëbiseduesi ngrihet në këmbë dhe i thotë Rexhës se si nuk të vjen turp të gënjesh ashtu, po ku rrinë Musa Hoti me ty. Bashkëbiseduesi fillon ta përshkruaj Musa Hotin si një njeri fizikisht të zhvilluar dhe se si ai është i paprekshëm. Rexha i betohet se e ka shok Musën dhe vëllaun e tij, Isën. Bashkëbiseduesi largohet nga Rexhë Karaliu duke e trajtuar si gënjeshtar. Ja se si i panjohuri ynë e çmon veprën patriotike të tjetrit, që nuk e njeh aspak por vetëm ka lexuar për të. Rexhë Karaliun e merr si gënjeshtar që krekosej se, gjoja, e njihte Musa Hotin. Po sikur ky bashkëbisedues ta kishte njohur mirë Rexhë Karaliun, që pas një viti të kësaj bisede me të panjohurin, vëllau i Rexhës, Hysen Karaliu do të bëjë një akt patriotik, po aq sa Musa Hoti, si do ta kishte trajtuar Rexhën?! Po sikur i njëjti bashkëbisedues të dinte se Rexha, një pjesë të madhe të jetës e kishte kaluar në burgje të ndryshme të Belgjikës dhe të Amerikës për çështje kombëtare me kriminelet amerikanë më të njohur të kohës moderne? Si do ta kishte trajtuar Rexhën, i cili nuk e zë në gojë veprën e vllaut të vet.

Sa herë të takohem me Rexhë Karaliun gjithnjë më rrëfen ngjarjen që i ka ndodhur me bashkëbiseduesin e rastësishëm. Rexha dhe unë natyrisht habitemi pse ne nuk i çmojmë njerëzit tanë të mençur e trima sa janë gjallë, por vetëm pas vdekjes. E keqja më e madhe është se pas vdekjes të gjithë bëhen shokë me të vdekurin që shpallet hero ose dëshmor i kombit.

Gjatë një takimi që kisha para pak kohësh me Gani Azemin, Mejremen (gruan e tij) dhe Beharen në restorantin “Rroni”, ra fjala për Musa Hotin, Enverin dhe tjerët. Kah fundi i bisedës gruaja e Ganiut që është gazetare në Agjencinë Shtetërore “Belgapress” tha: Ju e keni bërë një pjesë të historisë; ju e keni shkruar pjesën tuaj të historisë; ju jeni pjesë e pakontestueshme e historisë.

Ne iu përgjigjem gati bashkarisht se e dinim se jemi një pjesë e historisë, sepse ajo që është bërë në Belgjikë nuk mund të përsëritet,

të bëhet edhe njëherë. Ne jemi të vetëdijshëm se kemi dhënë kontributin tonë që pas shumë vitesh do të vlerësohet, por vetëm pasi ne të vdesim, sepse shumëkush tani i frikësohet punës së hijes sonë...Ndoshta edhe kurrë nuk do vlerësohet!

Kah mesi i vitit 1989, kur për aktivitetin tonë shkruanin të gjitha gazetat botërore, u zhvillua kjo bisedë në mes Enverit, Ganiut, Behares dhe meje:

**Enver Hadri**: Po me na vra Jugosllavia, çka ndodhë?!

**Beharja:** Nuk mund të na vrasë të gjithëve përnjëherë!

**Ganiu:** Enver, nëse të vrasin ty, unë kam me ta shkrue një poezi!

Të gjithë filluam të qeshnim e të qeshurën më të gjatë e kishte Ganiu.

**Reshati:** Nëse të vrasin ty të parin, e nëse Ganiu e shkruan një poezi, unë do ta recitoj atë poezi që do bëhet hit në tërë diasporën.

**Ganiu**: Vallahi, ti me recitue po se po, por edhe film ke me i kushtue. A e din se çfarë filmi interesant do të bëhej? Unë, ja se si e kisha shkrue skenarin- vazhdoi Ganiu-. Enveri e ka pamjen si të Skënderbeut. Një burrë i veshur me kostum, kravatë dhe duke ecur korridorit në Parlamentin Europian. Një eurodeputete ndalet duke e shikuar dhe dashurohet në shikim të parë. Enveri vazhdon të eci pa e hetuar se femra ia ka ngulur syrin...

Ganiu vazhdonte të rrëfente për skenarin, Enveri, Beharja dhe unë qeshnim. Ganiu u ngrit në këmbë dhe skenat që do i shkruante na i rrëfente me gjestet e tërë trupit.

**Beharja**: E mue si do të më përshkruash, Gani?!

**Ganiu:** A me ty e kam pak më vështirë.

U mendue pak dhe vazhdoi- imagjinoni sallën e madhe në IPC (International Press Centre). Enveri ka zë vend në të majtë, unë në të djathtë e ti, si zakonisht, ulesh ne mes. Salla përplot gazetarë të mediave ndërkombëtare. Ndërsa ti je duke folur, një gazetar me fytyrë të përzhitur, sikur të atyre që u bie lija e ujit, ngrihet në këmbë dhe të kundërshton. Imagjinojeni këtë skenë se si do të dalë në film: salla plot, gazetari me fytyrë të përzhitur në mes të sallës në këmbë, Reshati pas shpinës së të gjithë gazetarëve në këmbë, ti, Behare, çohesh e thua: Populli shqiptar ka qenë mbrojtës i Europës

prej pushtimit të Perandorisë Turke, sepse ishte Skënderbeu ai që i bëri ballë plot 25vjet. Papa i Vatikanit e quajti Skënderbeun Engjëlli i Krishtit. Ne jemi bijtë e Nënë Terezës. Gjithë shqiptarët janë Micë Sokola!

Ne dhe Ganiu bashkë me ne ia filluam të qeshnim, aqsa lotët na shkonin për faqe. Episode të tilla të jetës, që kaluam bashkë, me kujtohen edhe kur jam vetëm, herë qeshi e herë qaj.

Pas vrasjes së Enver Hadrit, Ganiu vërtetë i ka kushtuar poezi. Unë në Akademinë  përkujtimore, që e organizuam me rastin e varrimit të Enverit, recitova një poezi në sallën e Hotel “Sheratonit”. Më pas bëra filmin dokumentar për vrasjen dhe jetën e Enver Hadrit. Para pak kohe botuam edhe librin “Idealistët 1”, shkruar nga Beharja dhe unë.

Kur më kujtohen sekuenca të jetës, që kemi përjetuar bashkarisht, besoni që ato i përjetoj duke e imagjinuar se bashkë me mua qeshin Vehbiu,Enveri, Musa, Hyseni si dhe Ganiu që ndodhet në Bruksel. Gjatë mendimeve të mia ata janë pranë meje dhe flasin me mua.

Pasi përfundoj së kujtuari përjetimet e asaj kohe, ndalem dhe e “pyes” Enver Hadrin: Enver, këta që po të sjellin lule te varri, kur i paske pasur shokë?! Pse, bre Enver, nuk më ke tregue se edhe me këta paske zhvilluar aktivitete?!

E më duket se ndjej zërin e Enverit tek më përgjigjët: “ Jo, bre Reshat, a e din se çfarë probleme kisha unë prej atij që pikërisht tash po mburret se ishte bashkëveprimtar i im?! Ti, bre Reshat, e din ma mirë se askush tjetër se kur ky filani  e bëri një takim në BRT e të kishte thënë ty që unë të shkoja më të në radio. A të kujtohet, bre Reshat, se të thashë: me të kurrë nuk shkoj. Ti je gjallë, Ganiu është gjallë, Beharja gjallë, pse nuk flisni?  Pse nuk shkruani?! Pse nuk i kundërshtoni? !

Dialogët, që unë zhvilloj me Enver Hadrin dhe Musa Hotin e ndonjë tjetër, nuk janë të imagjinuar, por vërtetë unë monologoj, “bisedoj” e, natyrisht, përgjigje nuk marr prej tyre. Përgjigjem vetë, sepse kam bindje se ata janë krenarë për punën që e kemi vazhduar ne tjerët. Ata, që dikur e urrenin Enverin, Musën, Vehbiun e ndonjërin prej nesh, tash pasi ata u vranë dhe u shpallën dëshmorë, vrapojnë të

thyejnë dyert e historisë që të nënshkruhen si bashkëveprimtarë. Zoti na ruajt prej të tillëve!
Presidenti i Kosovës zyrtarisht e shpalli Enver Hadrin dëshmor të kombit, ne nuk na thirri të asistonim në ceremoni. Shkojnë të varri për t'i freskuar lulet ata që, për së gjalli, e urrenin. Priren nga trillimi se Enver Hadri ka qenë i izoluar dhe vetë i paska bërë të gjitha aktivitetet! Prirja është që të quhen bashkëluftëtarë të të ndjerit ata që nuk bënë asgjë për çështjen kombëtare. Dhe kësisoj të nënvlerësohet vepra e Enver Hadrit. Pas shumë vitesh, kur gjeneratat e ardhëshme do të lexojnë biografitë e atyre që tani në Kosovën e pasluftës na u vetëdeklaruan bashkëveprimtarë të Enverit apo të Musës, do të habiten. Si mundet dhe si ka fuqi morale dikush të mashtrojë ditën për diell se ishte shok me Enverin, kur po vetë deklaron në shtypin tonë se UDB-ja i kishte dhënë pasaportë dhe para të shkonte të spiunonte në Bruksel?! Si mundet dhe si ka fytyrë e moral të deklarojë kështu ai dikushi, që prej rinisë e deri sot në pleqëri tërë kohën ishte dhe është i dehur?!
Deri këtu shumica e lexuesve gjatë kësaj paraqitjeje, do të mendojnë se ne paskemi kaluar shumë mirë mes nesh, bile më mirë se vëllezërit e një shtëpie që kanë harmoni. A ishte vërtetë që mes nesh kurrë nuk pat opinione të ndryshme? Jo, nuk duhet menduar se ne nuk jemi fjalosur mes veti kurrë. Ne jemi fjalosur, jemi grindur, aqsa me javë të tëra, e me ndonjërin, me muaj të tërë nuk kemi folur njëri me tjetrin. Lexuesit duhet të dinë se ne jemi "grindur" vetëm për opinionet tona rreth një strategjie për ta luftuar armikun sa më mirë. Ndoshta ndonjërit i është dukur gabim propozimi im apo mua më është dukur gabim mendimi i tij për një punë kombëtare, Ja për çka ne jemi fjalosur. Asnjëherë, kurrë ne nuk jemi grindur për çështje morali; për çështje hajnie; për çështje intrigash dhe ndërskamsash; për çështje të interesave personale. Jo. Kurrë! Ne jemi fjalosur, për shembull, pse demonstrata të organizohet të dielën, kur nuk kishte asnjë eurodeputet në Parlamentin Europian. Po të analizohet kjo, do të shohim se organizimi i një manifestimi të dielën do ishte më masiv, sepse të dielën nuk punojnë shqiptarët. Të organizohej një ditë pune ishte vështirë që demonstrata të kishte

pjesëmarrje masive. Kjo do dobësonte imazhin e diasporës sonë. Mirëpo asokohe ne ishim të rij dhe nuk i merrnin punët shtruar, nuk i arsyetonim propozimet me gjakftohtësi. Secili prej emrave të përmendur më lart jemi fjalosur mes nesh, së paku një herë gjatë tërë bashkëveprimit. Ka ndodhur që tjerët e kanë shfrytëzuar "grindjen" tonë dhe pastaj kanë shtuar gjëra, të pa bëra e të pathëna. Gjatë një diskutimi në një mbledhje që kishim në Hotel "Metropole", unë , Ganiu dhe Beharja e kundërshtuam Enver Hadrin pse kishte ardhur në mbledhje me komunikatën e shkruar pa u konsultuar me ne. Kur Enver Hadri me një letër i drejtohet Gorbaçevit që ta ndihmonte Kosovën. Unë e kam kundërshtuar. Unë isha i bindur se Rusia nuk e ndihmonte Kosovën shqiptare edhe sikur Serbia ta digjte të tërën flakë. Kjo nuk do të thotë se Enver Hadri ka besuar në Gorbaçevin. Ai kishte menduar të bëjë diplomaci me Rusinë. Tash mendoj se Enveri, ndoshta ka pasur të drejtë. Musa Hoti, po ashtu, është fjalosur me Enver Hadrin, kur Enveri sulmonte përmes shtypit njërin prej shefave të Lëvizjes. Musa Hoti është fjalosur me mua, duke menduar se unë kam ndikuar që mos të përkrahet Radiostacioni i tij, që e kishte hapur në Bruksel. Më vonë, kur unë shkoja dhe lexoja lajmet dhe ndonjë analizë politike, Musa e ka kuptuar se mua nuk më ka penguar ajo radio. Musën e kam këshilluar që ta ndryshonte politikën redaktuese në Radio, pasi ai lexonte fjalimet e Komitetit Qendror të Shqipërisë.

Musa jepte lajmet për ngjarjet në Kosovë, por nuk hezitonte aspak të fliste dhe të lexonte për të arriturat në Shqipëri. Pra, ne jemi grindur, por jo edhe të hidhërohemi mes nesh për jetë e mot. Për këto fjalosje tona, tani ata që nuk kanë qenë në rrjedhën e ngjarjeve, i s'madhojnë e, madje, ndonjëri, i shtyrë nga dreqi dhe i biri, shkojnë në ekstremitete, në akuza e trillime, duke thënë se unë apo filan fisteku ka dorë në vrasjen e Enver Hadrit. Vrasësit e Enver Hadrit botërisht dihen se janë tre serbë, dy prej të cilëve janë vrarë dhe njëri në burg. Të tillët që kanë misione të caktuara nga dreqi, përpiqen të gjejnë metoda, u afrohen familjarëve dhe e përvetësojnë (lexo: mashtrojnë) ndonjërin prej tyre, duke e bërë krah të tyre. Trashëgimtarët familjarë të personaliteteve tona të njohur, tani disa

prej tyre dëshirojnë të bëhen pjesë e trashëgimisë patriotike të vëllaut, babait, burrit, dashnorit, kushëririt etj. etj dhe tani, në Kosovën e pasluftës, krekosën se e kanë tapi patriotizmin. Unë pajtohem se familjarët e tyre duhen respektuar deri në maksimum. Unë pajtohem se ata kanë plotësisht të drejtë të mburren e të krenohen për burrin, vëllaun, babain, kushëririn etj, i cili e dha jetën për çlirimin e Kosovës. Pajtohem që ndonjëri prej familjarëve të marrë flamurin dhe të na udhëheqë  në rrugën kombëtare, nëse ka vlera dhe kapacitete. Mirëpo nuk pajtohem kur ndonjëri që, kurrë nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet kombëtar, tani krekoset për patriotizëm, duke i nënçmuar bashkëveprimtarët e familjarit të tyre. Tash në Kosovën e lirë edhe babai im i vdekur,  e ka lehtë të deklarojë se ka luftuar bashkë me Adem Jasharin. Po, po, në Kosovën e çliruar edhe të vdekurit "votuan"! Të vdekur janë ata që krekosen sot, kur dje nuk bënë asgjë.

Lidhur me situatën e shqiptareve në Belgjikë në vitin 1984, Enver Hadri do të shkruante një editorial të gazetës së tij, ku jep një pasqyrë reale të shqiptareve që me vetëdije ose pa vetëdije ishin në shërbim të armikut. Në atë editorial Enver Hadri përqendrohet në ndeshjen e futbollit të 17 tetorit 1984 që u zhvillua në stadiumin "Heysel" në Bruksel mes të ekipit të RPS të Shqipërisë dhe ekipit të Belgjikës, me ç'rast, për herën e dytë, shqiptarët u rrahën mes tyre. Hera e parë ndodhi në qytetin Liege për të njëjtin ekip të futbollit, ndërsa hera e dytë me 1984 në Bruksel.

Sport

# kuptimi i dilemës dhe i alternativës

Nji ngjarje tjetër na ka befasuar po ashty sikundër dhe ajo e para, mirpo mbresa është më e madhe dhe normalisht protogonistët duhet ta mbajn përgjegjësin më të madhe. Ku qendron puna: më 17 tetor 1984 në Bruksell të Belgjikës(për lexuesit tanë në Amerikë) kishte me u zhvilluar ndeshja futbollistike për kampionatin botror në mes ekipit të RPS të Shqipërisë dhe atij të Belgjikës. Kjo ngjarje sportive bëri nji buj të madhe shum ditë para se të zhvillohet loja. Së pari emigracioni reaksionar duke u friguar se shtypi i prendimit nuk do të thot mjaft të zeza për RPS të Shqipërisë qiti në shesh paljaqon e tyre "intelektual" e ku ta dijm ne se dhe çka në nji gazet belgje dha nji deklerat duke ia numruar e trilluar shum ma tepër të "këqijat" e RPS të Shqipërisë, i njajti tip mur demarshe dhe si flitet shkoj te mbreti i Belgjikës për ta ndaluar lojën- sa demarsh i turpshem me lidhur sportin me politikën vehtëjake të nji emigracioni që 40 vjet ka humbur lojën në nji fush shum më të gjanë te publiku i vet.
Natën kur po zhvillohej loja nji grup shqiptarësh (pjesa më e madhe nga Kosova) shkuan me par lojën dhe me entuziazmuar lojtarët shqiptarë me brohoritje dhe flamur... Ja këtu lind problemi. Kur grupi admirues nxori flamurin e shtetit shqiptar - emigracioni reaksionar- pjesa më e madhe e partisë mbretrore - Legalitetit- shkyan flamurin dhe u ba aty nji rafje mes shqiptarëve. Disa dhe nga belgjit duke mos dijtur u futën në atë tollovi por me të kuptuar se ku qendron problemi u larguan. Rasti ndodhi se ata që duelen me flamur të RPS të Shqipërisë i takojshin LRSSHJ grupi i Zvicrës dhe se kishin kaluar pushimet në RPS të Shqipërisë. Duke qen koshient se çka ndodhi më 1968 në Liezhë - Belgjikë me rastin e të njajtës ndeshje dhe duke ditur se si u sabotua "bashkimi" i asaj kohe në stadion e aq më tepër kur të njajtit njerëz mueren pjesë me flamurin e 6 miljon shqiptarëve sot në stadionin e Heysel-it në Bruksell më 17 tetor të këtij viti, ne pytemi: A mos janë këto sabotime me paramendim. Me e mbajt flamurin Shqiptarë lartë në lojë apo kudo tjetër nuk është lehtë dhe duhet me pasë nji përgjegjësi të madhe. Flamuri nuk është shtaga e govedarit e atëherë kur të vendosët me u ngritë nuk duhet me u lejuar që qfardo rrugaqash me e kall apo shkye.
Është shum lehtë me shpërndar gazeta nepër kafehane apo me ngran silla me sekretarët e ambasadave shqiptare ose me shkuar në Shqipëri e me shitë patriotizëm - por disa gojë të këqija thojn se turqëve nuk iu kushtun gja flamuri Shqiptarë. Ne mendojm se kjo u ba me paramendim pasi aty pati dhe njerëz të menqur e jo vetëm të pa shkoll e qoban por pati dhe profesor e gjind të kalemit pra nuk mundemi me kuptue se si këta njerëz do të shkojn përseri në Shqipëri pos nese me ta kundër Shqipërisë dhe flamurit nuk është dhe sekretari i ambasadës shqiptare. Këto gjëra nuk mund të arsyetohen, por mund të klasifikohen vetëm në trathti të vendit- pasi flamuri i Shqipëris" është flamuri i ne gjithë shqiptarëve andej dhe këndej kufirit, pra i ne 6 miljon shqiptarësh. Për kundër skuadri shqiptarë bëni nji lojë shum të bukur, megjithëse humbi 3:1 shtypi Belgj të nesërmen më shum lavderoj ekipin dhe trenerin shqiptarë se sa ekipin e vet. Kur më 1968 patë ngja i njajti rast stypi belgj pat shkruar se u rrafen kumunistët mes vedi, kësaj rradhe nuk ceku asgja, nji gazetar vetëm përfundoj kur e takuam,u rrafen vagabondët mes vedi! Cila është e verteta?- E mbramja me hajr thot nji fjalë.

Nji numër i "Spektrit" është në përgaditje e sipër dhe do të shtjellon tër problematikën tonë. - TETOR- 1984 - New York

*Faksimile e editorialit, shkruar nga Enver Hadri, tetor 1984*

Enver Hadri i kritikon anëtarët e Lëvizjes (LRSSHJ) që shkuan me flamuj dhe, në rrahje e sipër me anëtarët e organizatës së Legalitetit (zogistët), ikën duke i lëshuar flamujt për tokë. Enveri i kritikon këta se shumica prej tyre kanë nënshtetësinë turke dhe flamuri shqiptar për ta nuk sinjifikon asgjë, por të ishte lëshuar nga dora flamuri turk, këta nuk do guxonin ta linin. Në anën tjetër e kritikon shefin e Legalitetit (që asokohe ishte Idriz Basha) që kishte ndërhyrë në shtetin belg që ndeshja të mos zhvillohej. Enveri e quan akt të turpshëm përpjekjen që kjo ndeshje futbolli të mos zhvillohej, siç kishte bërë Idriz Basha.
Deri tani u dha një pasqyrë e shkurtër e situatës dhe e relacioneve ndër shqiptare të diasporës sonë në Belgjikë. Mirëpo situata dhe relacionet ndër shqiptare të kësaj natyre ishin identike kudo në Europë dhe në ShBA; identike, por me personazhe tjerë.
Shtrohej pyetja si në fillim: kujt duhej t'i bashakngjitej Musa Hoti? Kujt t'i bashkangjitej për bashkëveprim kombëtar në vitin 1979? Grupet e organizuara në parti dhe organizata politike ishin ato që ishin. Në vitin 1973, Ibrahim Kelmendi në Gjermani kishte themeluar organizatën "Fronti i Kuq" , që në Bruksel thuhej se kishte disa individë që aderonin. Ndoshta viti nuk është i saktë. Ne, të porsaardhurit nga Kosova, nuk e dinim as kush aderonte në "Frontin e Kuq" dhe as kur ishte themeluar. Unë një gjë e dija se diku në vitin 1978, në Itali organizata "Brigada e Kuqe" kishte vrarë Aldo Moron, një personalitet të lartë italian. Kjo organizatë thuhej se ishte krijuar nga Rusia komuniste e atyre viteve. Musa Hoti, po ashtu, nuk kishte simpati për "Frontin e Kuq" të Ibrahim Kelmendit, sepse për ne çdo gjë, që lidhej me Rusinë, ishte e dëmshme për Kosovën. Ndoshta Ibrahimi nuk ka pasur asnjë lidhje me Rusinë, por ne ishim të bindur se organizata, që ai e drejtonte , kishte reputacion të keq, nëse mendonim të kontribuonim për Kosovën.
Pra, Musa Hoti nuk dinte kujt t'i bashkangjitej. Andaj kishte krijuar një rreth shokësh të ardhur nga Kosova me të cilët ndante mendime të njëjta. Mendimet e tyre nuk ishin kundër organizatave të tjera ekzistuese, por nuk kishin parametra të njëjtë. Grupi i shokëve të Musës shkonte në klubin "Përparimi", por kishte kontakte të

vazhdueshme edhe me ne tjerët. Ne nuk e kritikonim Musën pse shkonte, por edhe ai nuk na kritikonte ne që nuk shkonim. Me kalimin e kohës dhe me tendosjen e situatës në Kosovë, Musa Hoti dhe shokët e tij do të ishin pengesa numër një e realizimit të projekteve antishqiptare që ambasada e Jugosllavisë dëshironte t'i arrinte përmes anëtarësisë së klubit.

## Demonstratat e 1981-ës aktivizuan diasporën

Shpërthimi i demonstratave studentore të vitit 1981 e gjet mërgatën tonë krejtësisht të shpërndarë në grupe dhe grupacione të të gjitha ngjyrave politike. Edhe pse demonstrata e 11 marsit kishte ndodhur në Bruksel, askush nuk bisedonte për këtë ngjarje që do të shënonte kthesën e madhe historike të mbarë shqiptarëve. Asokohe komunikimin e parë për shpërthimin e demonstratave të 11 marsit ma përcolli aktori ynë Samedin Latifi me të cilin nuk i kisha shkëputur lidhjet asnjëherë deri në vdekjen e tij. Para arratisjes sime në Bruksel, me Samedinin, Bislim Muçajn e të tjerë kisha luajtur në teatër dhe filma. Samedini punonte në RTP dhe pas ngjarjeve të 11 marsit më thirri në telefon. Unë menjëherë thirra Ganiun e bashkë me të shkuam të Isuf Selenica, që ishte Kryetar i "Ballit Kombëtar". Më vonë takuam Enver Hadrin, Vehbi Ibrahimin, Qamil dhe Ramiz Zekollin, Musa Hotin dhe tjerët veprimtarë kombëtarë që mund të kontribuonin për organizimin e një manifestimi në përkrahje të studentëve. Kështu, më 12 prill 1981, ne organizuam demonstratën e parë në diasporë. Rëndësi kishte që organizata të vogla e të mëdha vendosën të manifestojnë bashkarisht me flamurin pa yll. Kjo demonstratë u organizua kryesisht nga ne kosovarët, por që më dëshirë iu bashakngjitën ballistat, zogistat, bllokistët me përjashtim të grupit të shqiptarëve që vetën e quanin komunistë. Këta ishin ata që u përleshën në stadiumun e Liége me 1968 kundër atyre që shqiptarëve që bënin tifozëri me flamur pa yll. Në demonstratë morën pjesë rreth njëmijë vetë. Ishte e para herë që në Bruksel dilte numër kaq i madh shqiptarësh të manifestonin në përkrahje të rinisë

studentore në Prishtinë e qytete të tjera të Kosovës. Manifestimin tonë e përcollën mediet më prestigjioze të Belgjikës, mirëpo jo shtypi i Tiranës zyrtare. Pavarësisht se shtypi belg shkruante pozitivisht për qëllimet e demonstratës sonë, krahu i majtistëve na quante bashkëpunëtorë të UDB-së, reaksionarë, Na kritikonin se ne ishim bërë bashkë me emigracionin e vjetër të Shqipërisë që, sipas tyre, i paskan duart e përlyera me gjak shqiptari.
Menjëherë pas demonstratës u formua "Komiteti Kombëtar për Europën". Kryetar u zgjodh Gani Azemi, sekretar Ramiz Zekolli. Komiteti Kombëtar u formua nga organizatat ekzistuese si ajo e Enver Hadrit, e Vehbi Ibrahimit me Emil Fazliun etj. Ky Komitet shumë shpejt u shpërbë. Enver Hadri nuk dëshironte që Komiteti të ekzistonte, sepse ishte vështirë të koordinoje aktivitetet me organizata që nuk vepronin në Bruksel. Pastaj edhe ato, që ishin në Bruksel, nuk dëshironin t'i nënshtroheshin urdhrave të komitetit të posaformuar. Asnjëri nuk dëshironte të binte nën hije të Komitetit edhe pse secili grup a parti kishte përfaqësuesit e vet në atë komitet.

**"Shqiptarë kundër shqiptarëve"!**

## Individë të Klubit "Përparimi" dënojnë demonstratat e pranverës 1981!

Ambasada e Jugosllavisë kishte shpeshtuar ardhjen e delegacioneve nëpër klubet dhe shkollat shqiptare të Belgjikës. Qëllimi i tyre ishte t'i minimizonin demonstratat e Kosovës dhe të diasporës, duke këshilluar vigjilencë ndaj dukurive te tilla. Ata e përdornin çdo shqiptar tek i cili kishin ndikim, për interesa të shtetit. Klubi "Përparimi, që shpallej si i pavarur nga Ambasada e Beogradit, mbajti një mbledhje urgjente dhe tërë kryesia e klubit miratoi një deklaratë të përbashkët me nënshkrimet e tyre, ku ndër të tjera thuhej:
*Ne, komuniteti shqiptar i Belgjikës, konsiderojmë se demonstratat e marsit dhe të prillit 1981 janë pjellë armiqësore. Të gjithë ata që i*

*përkrahin demonstratat janë armiq të popullit dhe të fryteve të Luftës Nacional-çlirimtare të Jugosllavisë . Ne, komuniteti shqiptar i Belgjikës, i dënojmë ashpër studentët dhe të gjithë ata që i përkrahën ato demonstrata...*

Kjo deklaratë u botua në "Rilindja" dhe zuri vend të konsiderueshëm. Për dënimin që "komuniteti" shqiptar po i bënte demonstratave, ambasadori jugosllav në Bruksel kishte shtruar një darkë si shpërblim për anëtarët e kryesisë, për punën e tyre besnike karshi shtetit dhe popullit.

Komunikata e lëshuar për media nuk ishte futur në rendin e ditës që të diskutohej me anëtarët e klubit, por u nënshkrua nga disa individë besnikë të sistemit jugosllav të asaj kohe. Kundër kësaj komunikate ishin pjesa dërmuese e anëtarëve të klubit, të cilët as që ishin pyetur, në duhej aprovuar teksti që do botohej në gazetat e përditshme jugosllave të asaj kohe. Jugosllavia, sidomos Serbia, bënte çmos që demonstratat e 1981-së t'i demaskonte dhe t'i klasifikonte si reaksionare, staliniste, religjioze, si dhe të minimizonte numrin e pjesëmarrësve. Si në çdo metropol europian, ashtu edhe në Bruksel, ambasada e tyre afronte rreth vetes intelektualët tanë, të cilët i dënonin demonstratat dhe propagandonin se në Kosovë është ngritur vetëm një grup i vogël studentësh të dështuar. Jugosllavisë, gjegjësisht Serbisë, i interesonte të përfitonte opinionin shqiptar e, më së shumti, opinionin botëror, duke i përdorur si argumente deklaratat e intelektualëve tanë, që kolektivat e shumë organizatave u bënin manifestimeve të studentëve, duke propaganduar në mediet se, gjoja, në Kosovë çdo gjë ishte në rregull. Armiku gjithnjë e përdorte armën më të fuqishme të tij: shqiptari kundër shqiptarit!

Që edhe më shumë të minimizoheshin demonstratat dhe të njolloseshin demonstruesit, Ambasada e Jugosllavisë organizoi në klubin "Përparimi" edhe një ekspozitë me piktorë të Kosovës që jetonin në Belgjikë.



DJE, NE BRUKSEL TË BELGJIKËS

**NË KLUBIN »PËRPARIMI« U HAP »GALERIA E VOGËL«**

Bruksel, 29 maj

Në kuadrin e festës së 25 Majit – ditës së rinisë, në një atmosferë vërtet festive, në klubin e punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia »Përparimi« në Bruksel, u hap ekspozita e punimeve të krijuesve figurative dhe e studentëve të viteve të fundit të Akademisë Mbretërore të Arteve të Bukura të kryeqytetit të Belgjikës: Kader Pagarushës, Valdet Hamitit, Jusuf Qorraj, Ahmet Podrimçakut, Zija Radoniqit dhe Dako Uashingtonit. Që të gjashtë autorët, të cilët në këtë ekspozitë që e pagëzuan »Galeria e vogël«, e ku ekspozuan 35 punime me motive të ndryshme, janë qytetarë shqiptarë nga Jugosllavia, që përkohësisht jetojnë e punojnë në Bruksel. Këtë ekspozitë, të parë kësodore në këtë qytet, në prezencën e shumë punëtorëve kulturorë e publikë nga kryeqyteti dhe disa vende fqinje të Belgjikës, e hapi ambasadori i RSFJ-së në Bruksel, Esad Ceriq.

Y.BAJRA

E shtunë, 30.V.1981 RILINDJA

***Gazeta "Rilindja", 30.V.1981, mbi ekspozitën e piktorëve shqiptarë në Belgjikë, që u mbajt në lokalet e Klubit "Përparimi"***

Në këtë ekspozitë morën pjesë Abdyl Kadër Pagarusha, Valdet Hamidi, Jusuf Qorraj e shumë të tjerë. Ekspozita u përcoll nga gazetarët që kishin ardhur nga Beogradi dhe Prishtina dhe po ashtu kësaj ekspozite i dhanë hapësirë në faqet e të së përditshmes së Prishtinës"Rilindja". Që ekspozita të kishte edhe më shumë jehonë dhe t'i tregohej botës Perëndimore se në Kosovë nuk janë shumica e shqiptarëve përkrahës të demonstratave ishin ftuar edhe gazetarë belgë, të cilët do të shkruanin në faqet e gazetës kryesore "Le soir" lidhur me këtë ekspozitë. Natyrisht, sa herë që kjo ambasadë organizonte gjëra të tilla ftonte gazetarë të huaj me qëllim që t'u

tregonte se shtresa intelektuale e Kosovës është projugosllave dhe të gjithë ata që organizojnë demonstrata në Bruksel janë rrugaçë, janë njerëz që shesin drogë etj. Në saje të ambasadës dhe devotshmërisë se tyre një numër i mirë piktorësh nga Kosova bënin emër dhe famë në Kosovë. Sikur këta piktorë të ishin, ashtu siç shkruante “Novosti” dhe “Rilindja”, jam i bindur se do të kishin jetuar shumë mirë duke ua shitur pikturat e tyre francezëve apo gjermanëve!
Pavarësisht nga kjo, qëllimi nuk është të vlerësojmë punën artistike të piktorëve tanë, por të nxjerrim në pah se ata u vunë në shërbim të propagandës së armikut, ndoshta pa qenë të vetëdijshëm se ekspozita e tyre ishte në dëm të Kosovës.
Duke mbledhur njerëzit e artit, Serbia e asaj kohe kishte vepruar saktësisht, siç kishte vepruar Hitleri në vitet 1941-1945, kur kishte ftuar piktorët francezë, shkrimtarët dhe aktorët e Francës që të zhvillonin aktivitete kulturore pa pasur nevojë të hidhnin parulla fashiste, sepse vetë ekspozita dhe puna e tyre i kontribuonte fashizmit gjerman. Pas disa dekadave artistët francezë, të cilët nuk kishin marrë pjesë në aktivitetet kulturore, që kishte organizuar propaganda naziste, u revoltuan dhe i kërkonin që të shpërblehej puna e atyre, ndërsa të dënohej puna e atyre që morën pjesë në ekspozita në shërbim të Hitlerit. Artistët francezë nuk ishin bashkëpunëtorë të gjermanëve dhe as që spiunuan, por intelektualët e sotëm kërkojnë dënimin e tyre edhe pse një numër i madh i tyre tanimë janë  ndarë nga jeta.

## *Pranvera e kuqe e Kosovës*

Pranvera e vitit 1981 po lulëzonte me gjakun më të pastër të bijve të Kosovës. E para ishte diaspora e Belgjikës, që iu bashkangjit me vetëdijesim në përkrahjen pa rezerva me manifestimin e parë në diasporë që u mbajt me 12 prill 1981, ne shenjë solidarizimi me Kosovën. Në këtë manifestim, që organizohej nga Enver Hadri dhe Vehbi Ibrahimi, Reshat Sahitaj, Gani Azemi, Qamil Zekolli etj,  u

përfshi edhe emigracioni nga Shqipëria. Që manifestimi të kishte efekt sa më të madh, pala kosovare dhe ajo e emigracionit të vjetër për disa ditë rresht zhvilloi diskutime të ashpra derisa, më në fund, u pajtuan që demonstrata të mbahej për Kosovën me kusht atë të mos e shfrytëzonte askush për interesa partiake. Ndihmesë të veçantë këtyre bisedimeve i dha Jusuf Selenica, i cili bindi mërgimtarët e vjetër të lëshonin pe dhe të dilnin të gjithë se bashku kundër okupatorit të përbashkët.

Pranvera e vitit 1981 dukshëm pati ndikim në diasporën shqiptare, veçanërisht në atë të Belgjikës ku UDB-ja kishte përqendruar pjesën më të fortë të efektivit të saj që, në momente të caktuara, të asgjësonte këtë pjesë të diasporës.

Numerikisht shqiptarët, që kishin ikë nga regjimi komunist i Enver Hoxhës, përbënin pjesën më të madhe të diasporës në Bruksel. Ata në çdo moment prisnin shembjen e diktaturës komuniste. Prandaj ngjarjet e Kosovës në pranverën e vitit ’81 sikur ua zgjuan edhe shpresat diasporës së vjetër për një kthim më të shpejtë në vendlindjen e tyre. Pavarësisht nga preokupimet e tyre, ata përsëri e ulën zërin dhe iu përshtaten revendikimeve të kosovarëve, që numerikisht ishim më të dobët. Përkrahja e tyre ishte një ndihmë e çmueshme për luftën që bënte populli ynë në Kosovë.

Në ditët e para të demonstratave të Prishtinës, Ferizajt,Vushtrrisë e… qeveria e Beogradit përmes zërit të Stane Dollancit me 6 prill akuzoi diasporën shqiptare duke e potencuar Brukselin dhe Shtutgardin si çerdhe ekstremiste reaksionare që kërkonin shkatërrimin e Jugosllavisë.

Me 8 prill 1981 gazeta “Zëri i popullit” e Tiranës shkruante se demonstratat e studentëve në Prishtinë u konfrontuan me forcat policore serbe vetëm pse kërkojnë të drejtat legjitime që Kosova të mos jetë nën tutelën jugosllave. Pas këtij artikulli, Beogradi tani akuzat ia drejtoi Tiranës. Gazetës së përditshme tiranase i përgjigjët e përditshmja e Prishtinë “Rilindja”, por të njëjtin artikull e botonte edhe “Politika” e Beogradit ku shkruanin se Tirana nuk ka nevojë të përzihet në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe nuk duhet të jetë avokat i elementit shkatërrues dhe reaksionar shqiptar. Këtu nis

filli i prishjeve diplomatike mes Tiranës dhe Beogradit, së paku sipas medieve të kohës.
Shtypi i Europës Perëndimore, duke u bazuar në burimet e “Tanjugut”, shkruante se në Kosovë kishte 11 të vrarë, mirëpo në analizat e tyre nuk e injoronin Bashkimin Sovjetik të asaj kohe që mund ta përkrahte Jugosllavinë, por ajo ishte e zënë me luftën në Afganistan. Gazetat e Perëndimit nuk ngurronin të shkruanin se Kosova ishte një fuçi baroti dhe se kjo ishte kriza më serioze qysh pas luftës së Dytë Botërore; se vetëm 11muaj pas vdekjes së Titos, kosovarët ishin të parët që po ia lëkundnin themelet e Jugosllavisë.
Diaspora shqiptare e Belgjikës, që përcillte me vëmendje situatën në Kosovë, e pa më se të nevojshme që të mblidhte të gjitha forcat politike dhe kulturore ekzistuese në këtë territor në mënyrë që ndihma dhe solidariteti me vëllezërit dhe motrat në Kosovë të jetë më i frytshëm. Shqiptarët, që jetonin në Bruksel, e ndjenin vetën më të fortë se kurrë. Duke parë se jetonin në qendrën ekonomike dhe politike të Europës, përveç demonstratave në Bruksel u organizuan edhe një seri atentatesh kundër interesave të Serbisë ,që përfaqësoheshin në Bruksel. Gazeta zyrtare belge “Le soir “ e datës 01.04.1981 shkruante për atentatin e parë me bombë, që kishte ndodhur të dielën e fundit të marsit, kundër përfaqësisë së JAT-it. Këtë atentat e kishte marrë përsipër Vehbi Ibrahimi.
Atentate të tilla kundër përfaqësive serbe në Belgjikë e posaçërisht në Bruksel, shtoheshin gjithnjë e më shumë. Këto, në një farë mënyre ishte një vërejtje e paralajmërim që u bëhej autoriteteve serbe që të ndalonin torturat dhe vrasjet në Kosovë. Dihej shumë mirë se një atentat në Bruksel, qoftë ai i natyrës së djegieve të përfaqësive zyrtare të Jugosllavisë apo i likuidimit të trupit diplomatik, kishte peshë më të madhe se sa e njëjta ngjarje të ndodhte në Prishtinë. Po ashtu diheshin kushtet e vështira të organizimit të një atentati në Kosovë ku shërbimi sekret kishte venë në dispozicion tërë arsenalin e vet.



Série noire pour les Yougoslaves à Bruxelles

Mardi matin, deux membres de l'ambassade de Yougoslavie à Bruxelles étaient victimes (un mort, un blessé) d'une agression. Mardi soir, un nouvel attentat a été commis contre un établissement yougoslave, un magasin du boulevard Lemonnier. Ici, trois cocktails Molotov ont été lancés, dont l'un a brisé la vitrine du magasin. C'est le dernier incident d'une longue série dont ont été victimes, chez nous, des ressortissants de ce pays ou des bâtiments leur appartenant. (Lire nos informations en sixième page.)

***Seri e zezë për jugosllavët në Bruksel, "Le soir"***
***qershor 1981***

Andaj, në Bruksel merret një vendim sekret i drejtuar nga Vehbi Ibrahimi që, pas atentateve të shumta (mbi 20) në objekte të përfaqësive serbe, të fillohet një seri tjetër që do e prekte mu në zemër Serbinë.

Më 15 korrik 1981 gazetat e përditshme belge do të shkruanin për atentatin e parë politik me ç'rast dy persona në orën dhjetë e tridhjetë minuta hyjnë në ambasadën jugosllave dhe me rafale automatikësh plagosin Blagoje Anakioskin dhe Franc Sindelerin, që të dy nëpunës të ambasadës si dhe vranë një nëpunës tjetër, emri i të cilit nuk u mësue kurrë ngase autoritet e Beogradit e mbajtën të fshehur për arsye që vetëm ata i dinë.

Me këtë rast nënshkruhet atentati i parë politik kundër trupit diplomatik jugosllav, të cilin po ashtu Vehbi Ibrahimi në deklaratën e tij për shtyp do ta marrë si organizim të tij. Forma e zgjedhur nga Vehbi Ibrahimi që atentatet t'i merrte përsipër, natyrisht, ia rrezikonte jetën. Ai ishte i vetëdijshëm për këtë rrezik dhe çdo ditë që kalonte e dinte se ishte një ditë më tepër në jetën e tij. Vehbiu dëshironte që qeverisë së Beogradit t'ia dërgonte mesazhin se për çdo vrasje në Kosovë një vrasje e priste në diasporë.
Në Bruksel vrasje të serbëve kishte patur edhe më herët, por ato ishin qërim hesapesh mes grupeve dhe grupacioneve serbe. Më herët një serb i quajtur Pierre Valiç ishte gjetur i vrarë në dhomën e tij. Më vonë po ashtu në Bruksel u vra Miodrag Boshkoviçi në apartamentin e tij si dhe Urosh Miliçeviqi që ishte dëshmitari numër një për vrasjen e Stefan Markoviçit. Ky i fundit truproja e Alen Delonit. Me të drejtë një gazetar serb, vetëm disa muaj pas disa vrasjeve tjera kundër serbëve dhe personelit të ambasadës ne Belgjikë do ta përshkruante Brukselin si qytet i tmerrit dhe i ferrit për serbët.
Një muaj pas demonstratës se 12 prillit, në Belgjikë Jusuf Gërvalla dërgoi vëllaun, Bardhoshin dhe Kadri Zekën për të përgatitur demonstratën e dytë që do mbahej në Bruksel më 13 qershor 1981. Lejen për këtë manifestim e nxori Enver Hadri.
Pakkush ishte në dijeni se Enveri Hadri po ua mundësonte majtistëve të demonstronin në Bruksel, ashtu si pakkush e dinte se ato ditë Musa Hoti kishte bërë një njoftim publik në emër të klubit “Përparimi” që edhe anëtarët e atij klubi të solidarizoheshin me vëllezërit e motrat tona në Kosovë. Kjo komunikatë që dukej zyrtare shkaktoi konfuzitet në anëtarët e klubit. Shumica e dinin se një komunikatë e tillë ishte e pamundur të publikohej, sepse aty haptas thuhej se policia serbe kishte vrarë qindra shqiptarë, kishte okupuar Kosovën. Komunikata ndikoi në prishjen e relacioneve te anëtarëve të klubit.

BASHKËSIA E SHOQËRIVE
DHE KLUBEVE TË PUNËTORVE
R.S.F.J.
NË BELGJIKË DHE LUXEMBURG
SHOQËRIA KULTURO-ARSIMORE E SPORTIVE
PËRPARIMI
E PUNËTORVE SHQIPËTAR TË R.S.F.J.
NË BRUXELLES

ZAJEDNICA DRUŠTAVA
I KLUBOVA RADNIKA
S.F.R.J.
U BELGIJI I LUXEMBURGU

ASSOCIATION
CULTURO-SPORTIVE
« PERPARIMI »
DES TRAVAILLEURS
ALBANAIS DE R.S.F.J.
A BRUXELLES

-Bashkëatëdhetar të nderuar siq e dini edhe ju se KOSOVA jonë e dashurë
përjetuar muejve të fundit një valë trazirash të cilat edhe sotë e kësaj dite vazhdo
Demostratat e 11-26 marsit,të 1-2-3 prillit kanë pasë si revandikim të vetëm që K
statusin e REPUBLIKES SOCIALISTE mbrenda R.S.F.Jes.
Por siq e dini edhe ju se demostratat hasën në përghithësi në një rezistencë të ma
policore te bashkuara në Kosovë nga tërë viset e Jugosllavis, njëherit në ndihmëu
Armata Jugosllave.Si rezultat i kësaj shtypje të eger nga forcat policore ,jan
dhe motra Kosovare te¨ mbytur mizorisht nga plumbat dhe nga tururat mizore,qindr
që edhe kësaj ditee ndoshta për ghithmonë janë në ghendje kritike,njëherit sotë
dhe të tërë Jugosllavisë janë përplot të mbushura me vllëzërit e motrat tona..
- Pra sotë ka ardhur koha qëedhe Ne shqipëtaret që ghindem përkohësisht
e veqanarisht Ne antarët e klubit „PERPARIMI" të japim kontributin tonë ndaj atëdh
Gherë sotë qeverija Jugosllave ka arritë të na mashtron duke naj paraqitur demost
Nacionaliste Iredentiste,anti Jugosllave bile edhe dukena shtyar që edhe ti denojm p
vllëzërit tonë. Porë syqeltësija e jonë na bëri të kuptojm të verteten, do të t
se vllëzërit edhe motrat tona nuk kishinë asnjë nga teparët e akuzave të bëra
E verteta ishte se kërkesa e vetëm që bënë Kosovaret me parullatë „KOSOVA REPUBL
asnjë formë Nacionaliste ,Iredentiste,anti Jugosllave apo për shkatërrimin e R. S.
Kjo kërkes e tyre ishte tërsisht e bazuar në kushtetuten e R.S.F.J.es.
Pra vllëzër e motra Ju ftojmë që të merrni pjesë masivisht në demostratat e 13.
Qëdo të zhvillohen në BRUXEL Plac Flager, në ora 10.h.
Kështu që edhe Ne ti shprehim solidaritetin me vllëzër e motra tpna KOSOVARE.
Kërkesa e ynë e vetem do të jetë „KOSOVA RREPUBLIKË"që është deshira e ghith bashkëa
tonë në KOSOVË..
Ftohen të ghith ata shqipëtar që e ndinë veten si të tillë.
Kurse ata që nuk marrin pjesë do ta tregojn veten metëvertet tradhëtar të Atëdheu

RRNOFTË KOSOVA RREPUBLIKË.

RROFSHIN SHQIPETARET E NDERSHËM .

Ua dergon nderimet KSHILL
KULTURO ARSIMORE eSPORTIVE
P E R P A R I M I
Bruxell.....

***Kopje e komunikatës së klubit "Përparimi" , qershor 1981***

Në kohën kur po kryhej manifestimi në Keln që kishte organizuar Vehbi Ibrahimi ku edhe foli, duke hedhur poshtë politikën

hegjemoniste kolonializuese serbe në Kosovë, oratorit i arriti lajmi se në një restorant shqiptar në qytetin Namur, pronari kishte ftuar për darkë personelin e ambasadës jugosllave.
Vehbi Ibrahimin e shqetësoi kjo mirëpritje që i bëhej diplomacisë jugosllave. Ashtu, i nervozuar Vehbiu shkoi ne banesën e Musa Hotit dhe kërkoi nga ai që të merrte armen dhe t'i bashkangjitej në aksion kundër "bashkim vëllazërimit" në qendër të Europës. Vehbiu kishte dëgjuar se mikpritësi shqiptar për t'i hyrë ne qejf trupit diplomatik serb ishte veshur me kostum kombëtar malazez dhe këndonte kengën " Oj serbi kush thotë se je e vogël kur ti shtrihesh prej Mariborit deri ne Gjevgjeli". "Mikpritësit" këndonin këngë për mirëqenien e Jugosllavisë. Kur arritëm në vendin e ngjarjes, pronari i restorantit që kishte hetuar se po përgatitej një akcion i armatosur kundra tyre, i fshehu diplomatët e ambasadës jugosllave në dhomat e tyre.




*MUSA HOTI ME SHOKË*

Në po atë kohë në klubin shqiptaro-jugosllav "Perparimi", me udhëzimet e Vehbi Ibrahimit mori pjesë Musa Hoti në tubimin e anëtarësisë së klubit ku ishin mbledhur rreth treqind shqiptarë. Do të gjykohej pranvera e kuqe e Kosovës. Ambasada e Jugosllavisë

kishte ftuar si mysafir special një delegacion nga Kosova, që kryesohej nga Rabit Rexhepi, nga Sindikatat e Kosovës, shkrimtari Rifat Kukaj, djali i Gjuro Pucarit, Fehmi Hoti, dhëndër i Mahmut Bakallit, mësues i shkollës shqipe, që kishte hapur ambasada, dhe Behxhet Shabani, sekretar i ambasadës. Delegacioni kishte për obligim të propagandonte se në Kosovë nuk kishte demonstrata anti-jugosllave, por ishte një grusht i vogël studentësh që kërkonte vetëm përmirësimin e kushteve ushqimore dhe se nuk kishte të vrarë, ashtu siç flitej.
Fill pas diskutantëve jugosllavë fjalën e mori Musa Hoti që denoncoi dhunën dhe terrorin e ushtruar nga forcat policore mbi shqiptarët e pafajshëm. Fjala e tij u prit me duartrokitje nga të gjithë pjesëmarrësit. Për këtë rast "Rilindja" e ditës së nesërme shkroi për dështimin e diplomacisë jugosllave, duke fajësuar, gjoja, një fashist që e kishte prishur rendin dhe qetësinë. Në këtë tubim foli Xherë Hasanxhekaj, një mësues që me vetiniciativën e tij kishte ndihmuar në hapjen e shkollës, i cili tha hapur se pas plasjes së demonstratave, ai nuk dëshironte të jetë i manipuluar nga propaganda jugosllave. Po ashtu Milazim Çerolli, një mërgimtar i vjetër, u ngrit dhe kërkoi që delegacioni të tregonte të vërtetën mbi ngjarjet në Kosovë e të mos i hidhte pluhur syve diasporës, duke gënjyer se në Kosovë nuk po ndodh asgjë.
Në këtë tubim disa pjesëmarrës të organizuar nga Vehbiu ndikuan që diplomacia dhe organizatorët e klubit të kërkonin "birën e miut" nga se situata dhe shqiptarët e Belgjikës nuk po manipuloheshin ashtu siç e kishte planifikuar shërbimi sekret jugosllav i atëhershëm. Që një tubim i tillë të mos përsëritej kurrë ndikoi ndërhyrja e Jakup Sylës nga Gjilani dhe e Bardhosh Mavrajt, të cilët bashkëvepronin me Musa Hotin. Këta nxorën revolet përpara tërë pjesëmarrëseve dhe iu kërcënuan organizatorëve se në Belgjikë nuk pinin ujë gënjeshtrat e tyre dhe se shqiptaret e Belgjikës nuk lejonin të gjykohej lëvizja studentore e Kosovës. Pas këtij akti Musa Hotit dhe Jakup Sylës iu ndalua hyrja në lokalet e klubit "Përparimi". Kësisoj dështoi plani "diplomatik" i koordinuar me shërbimet

sekrete të Beogradit; dështoi propaganda antishqiptare; dështoi delegacioni i intelektualëve të sjellur nga Kosova.
Por ekspertët e shërbimeve sekrete ndërruan taktikë. Hodhën kartën e kulturës shqiptare, duke organizuar koncerte me këngë popullore. Shpejt ata organizuan një turne ShKA "Kastriotët" nga Ferizaj me mysafire Shkurte Fejzën, Shyhrete Behlulin, Shpresa Gashin etj. Me mbajtjen e një koncerti te tillë Jugosllavia dëshironte të dëshmonte para diasporës shqiptare dhe diplomacisë ndërkombëtare se në Kosovë nuk ndodhte asgjë, se Kosova ishte e barabartë me Republikat tjera-gjegjësisht element konstituiv i Federatës.
Po a ishte gjendja normale ne Kosovë pikërisht në kohën kur në Prekaz luftonte si luan Tahir Meha, kur ai dhe i ati, Vehbiu qëndronin për jetë a vdekje përpara breshërisë se plumbave të gjakpirësve, kriminelëve serbë? A mund të mbahej një koncert i tillë në Bruksel? Kështu mendonin Vehbi Ibrahimi dhe Enver Hadri me shokë. Andaj Enver Hadri bëri një telefonatë anonime se në sallë do eksplodonte një bombë. Koncerti u anulua dhe këngëtaret u kthyen te zhgënjyer apo ndoshta te gëzuar!

## NGJARJA E TAHIR MEHËS

Jehona e luftës së Vehbi dhe Tahir Mehës mori dhenë. Vehbi Ibrahimi ishte njeriu, i cili në Bruksel kudo që shkonte me vete kishte kullën e Tahir Mehës të shkatërruar nga forcat serbe. Ai mbante foton e kullës dhe të Tahir Mehës. Vahbiu e admironte aktin e Prekazit dhe në çdo bisedë fliste me admirim për Tahir Mehën. Nga ana e jonë Vehbiu ishte më i informuari rreth ngjarjes së Prekazit. Bisedat e Vehbi Ibrahimit i galdonin zemrat e të rijve, i frymëzonin ata me ide përparimtare, duke krijuar vetëdijen se pa luftë Kosova nuk çlirohej; se pa akte heroike, siç ishte rasti i Tahir Mehes, Serbia nuk do lëshonte Kosovën kurrë. Vehbi Ibrahimi shoqërohej me Musa Hotin si dhe Jakup Sylën, Shaban Shkupin e shumë të tjerë. Vehbiu është dëshmori i parë që Shërbimi Sekret Jugosllav do ta vriste në korridorin e shtëpisë se tij në qendër të

Brukselit. Vehbiu ishte gjenerator i akteve të shumta që ndodhën kundër përfaqësive të Jugosllavisë së asaj kohe. Por sot vepra e tij nga disa konsiderohet terroriste; prej të tjerëve, jo intelektuale; prej kundërshtarëve politikë, tepër i moderuar; dhe nga qeveria e Kosovës as që përmendet. Aktet, që janë kryer në Bruksel, pavarësisht se sot dikush dëshiron t'i injorojë; ndonjë t'i përvetësojë; dhe ndonjë t'i shlyej nga historia si aktet, po ashtu edhe aktorët, por nuk do t'ia arrijë, sepse për ato vepra dëshmojnë gazetat ditore të Europës, pa i llogaritur ato që botoheshin në Jugosllavi.

Të rinjtë e mërgatës së Belgjikës, të nxitur nga vrasjet që Serbia bënte në Kosovë, inkurajuar nga bisedat me Vehbiun dhe me ndonjë tjetër, vepruan ose të organizuar ose të pa organizuar kundër përfaqësive jugosllave.

Prej marsit e deri ne fillim te gushtit '81, pra, gjatë pesë muajve në Bruksel u bënë një varg sulmesh kundër përfaqësive të Jugosllavisë. Ata vepronin aty ku mendonin se zhvillohej propagandë antishqiptare. Kështu që edhe klubit "Përparimi" iu dha flaka; klubit "Abdullah Grashtica" në Namyr po ashtu; u dogjën tërësisht zyrat e kompanisë së aviacionit JAT; kompania e turizmit bregdetar u hodh ne ajër; depot e furnizimeve nga po ai shtet digjeshin; kah mesi i korrikut disa karikatorë u zbrazen në lokalin e Ambasadës jugosllave ku u vra 1 dheu plagosën 2 të tjerë.

Përfaqësitë dhe përfaqësuesit jugosllavë ndjenin pasigurinë e objekteve dhe personale. Ne mesin e këtyre atentateve nuk dihej pse pikërisht digjeshin klubet e shqiptarëve si "Përparimi" apo të tjerët kur dihej se aty kishte shumicë shqiptare. Ekzistojnë mendime se disa prej tyre i bëri edhe vetë Shërbimi Sekret jugosllav për t'i akuzuar shqiptarët. Më vonë do të ndodhte edhe një rast tragjik, një atentat i sofistikuar për kohen që ndodhi ku u vra një shqiptar. Këtë vrasje e kishte organizuar Serbia që të fuste familjet shqiptare në hasmëri. Për këtë u akuzua Isa Hoti, vëllai i Musës, që ndodhej në burg për vrasjen e trupit diplomatik të ambasadës jugosllave në Bruksel. Isa Hoti ishte krejtësisht i pafajshëm.

Ngjarjet e pranverës 1981 ishin ato që e aktivizuan mërgatën shqiptare si në aspektin pozitiv, por edhe në atë negativ. Në të parën

iu bashkangjitën të gjithë ata që dëshironin lirinë; në të dytën ata që ende besonin së ka serbë të mirë, por ekstremistët nuk po i lejojnë progresistët t'i ndihmojnë Kosovës.
Lidhur me 11 marsin 1981, shtypi ndërkombëtar përcillte opinion se bilanci i manifestimeve të 11 marsit në Kosovë ishte tragjik. Gazeta prestigjioze belge "Le soir", bazuar në deklaratën e anëtarit të kryesisë së LKJ, Stane Dollanc, nën titullin "Manifestimet në Kosovë: bilanc i rëndë, 11 të vdekur" njoftonte lexuesit për dyndjet e rinisë shqiptare në demonstrata masive. Stane Dollanci në takimin me gazetarët në Beograd u përpoq të shtrembëronte faktet, duke reduktuar numrin e të plagosurve në "mbi pesëdhjetë" dhe të të arrestuarve në 22 ! Ndërsa për pjesëmarrjen në demonstratat shqiptare politikani i lartë jugosllav tha se nuk e ka kaluar dymijshin. Manifestimet politike i quajti turbullime. Ai akuzoi "organziatorët kanë lidhje " me emigracionin nga jashtë në vendet europiane e veçmas më atë të Shtutgardit, të Brukselit dhe të ShBA., duke shtuar se "Ky emigracion profashist ka një platformë të përbashkët me elementë konformistë prosovjetikë, që tentojnë ta destabilizojnë Jugosllavinë". Por bota kishte sy e veshë. Korrespondentët e saj nga Beogradi dhe Kosova raportonin çdo ditë për kryengritjen e madhe politike dhe përgjakjen e rinisë nga dyndjet e policisë kriminale të armatosur gjer në dhëmbë.



# Les émeutes du Kossovo : le bilan est lourd : 11 morts

**Belgrade, 6 avril (A.F.P.).**

**M. Stane Dolanc, membre de la présidence de la ligue des communistes de Yougoslavie (L.C.Y.), a indiqué lundi au cours d'une conférence de presse que le bilan officiel des victimes des émeutes du Kossovo s'établit actuellement à onze morts, dont deux parmi les forces de l'ordre, et cinquante-sept blessés.**

Il a précisé par ailleurs que vingt-deux personnes étaient maintenues en état d'arrestation. Tout en soulignant que le nombre des manifestants actifs n'avait pas dépassé deux mille personnes, il a déclaré que les troubles s'étaient étendus à six districts voisins de Pristina, capitale de la région.

Il a estimé que la situation au Kossovo serait normalisée d'ici à la fin de la semaine et que les journalistes seraient autorisés à s'y rendre.

M. Dolanc, dont la conférence de presse était la première organisée à Belgrade depuis le début [d]es événements du Kossovo, région autonome peuplée en majorité d'Albanais, a dénoncé les « liens des organisateurs » des émeutes avec des groupes de l'étranger, et notamment l'émigration albanaise.

Ces groupes, a dit M. Dolanc, sont basés « dans plusieurs villes européennes, dont Stuttgart et Bruxelles, ainsi qu'aux Etats-Unis ». « Cette émigration pro-fasciste a trouvé une plate-forme commune avec « les éléments kominformistes ». (pro-soviétiques) pour tenter de provoquer « une déstabilisation de la Yougoslavie », a-t-il ajouté.

Il a en revanche formellement mis hors de cause le gouvernement albanais de M. Enver Hodza et s'est félicité du développement des liens culturels du Kossovo avec l'Albanie.

Par contre, M. Dolanc a dénoncé à plusieurs reprises la principale revendication politique des manifestants, qui porte sur la transformation de la région autonome du Kossovo, partie intégrante de la République de Serbie, en une république jouissant du même statut que la Serbie et les cinq autres républiques. Cette modification du statut du Kossovo, a-t-il affirmé, « porterait atteinte à l'intégrité de la Yougoslavie, conduirait à sa déintégration ». « Il s'agit d'un mot d'ordre nationaliste, irrédentiste et contre-révolutionnaire » a-t-il ajouté.

M. Dolanc a réaffirmé la détermination de la direction yougoslave de prendre des mesures vigoureuses contre les « adversaires du système socialiste yougoslave ». « Cette ligne, a-t-il conclu, s'appliquera à tous ceux qui tenteront de porter atteinte aux acquis de la révolution. »

***Kopje e artikullit "Le soir".***

Çdo gjë që deklaronte asaj kohe Jugosllavia ishte që të fitonte simpatinë e opinionit botëror dhe ata kishin mekanizma që të bënin

propagandën sipas dëshirës që tjerët donin ta dëgjonin. Ishte krejt normale që kur perëndimorët,sipas makinerisë propagandistike të Beogradit, të mësonin se Bashkimi Sovjetik i asokohshëm donte të shtrinte influencën në Jugosllavi përmes shqiptarëve, nuk do interesoheshin më për Kosovën. Kështuqë deklaratat e jugosllavëve do të bëheshin më bindëse kur ne protestonim në metropolet europiane e amerikane me parulla staliniste. Parullat tona në këto shtete perëndimore ishin të papranueshme për qytetarët e huaj, sidomos kur bërtisnim me megafon: “Marksizëm-Leninizëm !” ose “Haj Fyr proletar ... “ etj.etj të këtij lloj. Ndokush nga organizatorët e asaj kohe që ende është gjallë mund të deklarojë se nuk janë të vërteta, por faktet janë kokëfortë. Ekzistojnë fotografitë dhe dokumentet e ndryshme që e dëshmojnë..

Pas këtij artikulli të dëmshëm për imazhin e manifestimeve të pranverës 1981, me iniciativën e Idriz Bashës dhe Enver Hadrit u organizua një konferencë për shtyp në IPC (Qendra Nderkombëtare e Shtypit), ku morëm pjesë edhe në që ishim më të ri. Në këtë konferencë u demaskuan deklarata e Stane Dollancit. Gazeta “Le soir” mbante titullin : Kosovë, nga represionet mbi 800 të vrarë”

Unioni i emigracionit shqiptar, organizatë që përmblidhte jo vetëm shqiptarët nga Shqipëria, por edhe nga Kosova, mbajtën në Bruksel një konferencë për shtyp, për të denoncuar “represionet e forcave jugosllave gjatë ndërhyrjeve kundër manifestuesve të marsit dhe prillit të këtij viti”. Fillimisht oratorët kanë nënvizuar se nuk bëhet fjalë për një manifestim të thjeshtë, por për një revoltë gjithëpopullore, për shkak të zhvillimit ekonomik të dobët të Kosovës, papunësisë dhe kundër tutelës se Beogradit. Shqiptarët asgjë nuk i lidh me serbët, ky vend është i yni, ne kemi qenë para tyre në territorin e sotëm të Kosovës”. Sipas tyre nuk kishte vetëm 11 të vrarë (versioni zyrtar) ose 70 ( gjysmëzyrtar), por kishte 847 të vrarë, prej tyre femra e fëmijë dhe mbi 1200 të zhdukur.



**Kossovo : la répression aurait fait plus de 800 morts**

L'Union des nationalistes albanais, organisation qui regroupe des émigrés venant non seulement d'Albanie mais aussi du Kossovo, a donné une conférence de presse à Bruxelles pour dénoncer « la répression à laquelle ont procédé les forces yougoslaves contre ceux qui s'étaient soulevés en mars et avril de cette année ». Tout d'abord, ont souligné les orateurs, il est faux de parler d'une simple manifestation d'étudiants. Il s'est agi d'une révolte justifiée à la fois par le faible développement de la région et le chômage très élevé, ainsi que par la mise en tutelle de la population par les Serbes. Or « les Albanais ne sont en rien liés aux Serbes, ce pays est le nôtre, nous étions là avant eux ».

Ensuite, les orateurs ont évoqué la brutalité avec laquelle l'armée yougoslave a réagi. Il n'y a pas eu selon eux, onze morts (version officielle) ou septante (version officieuse), mais huit cent quarante-sept, dont des femmes et des enfants, ainsi que mille deux cents disparus. Et le refus de reconnaitre au Kossovo le statut de république a été catégoriquement réaffirmé par M. Stane Dolanc, un des successeurs de Tito, ce qui est considéré par les orateurs comme logique, car la première étape du droit pour les Albanais du Kossovo de disposer d'eux-mêmes serait suivie de la volonté d'être réunies aux Albanais d'Albanie.

Un discours, donc, basé sur la revendication d'un peuple qui a incontestablement des particularités culturelles, ethniques, historiques expliquant qu'il tienne à rester ce qu'il est. Mais qui va lui donner raison ? L'Occident déploie d'intenses efforts, précisément, pour que la Yougoslavie n'éclate pas. Tirana ne bouge pas. L'U.R.S.S. a autre chose à faire, et d'ailleurs les membres de l'Union des nationalistes albanais est contre le communisme, qu'il soit yougoslave, albanais ou soviétique...

A. Bd.

***Kopje e artikullit "Le soir", ku Idriz Basha dhe Enver Hadri demaskuan propagandën e diplomacisë jugosllave***

Ishte konferenca e parë për shtyp që Enver Hadri e bëri në konsultim me mua, Ganiun, Musën dhe Agim Radoniqin, por në panelin e takimit ishte Idriz Basha. Në fakt konferencën e kishte organizuar tërësisht Idrizi. Enverin e kishte ftuar sepse ai vinte nga emigracioni i Shqipërisë e bota kërkonte të deklaroheshin kosovarët. Lidhur me numrin e viktimave, sa duhej të deklarohej para gazetarëve të huaj, e kishim dhënë unë dhe Ganiu. Kur i thamë Enverit të jepte shifrën 847 e jo 850 ose 800 sepse ne dalim më të informuar dhe deklarata do të ketë impakt tek gazetarët. Një gjë të tillë kundër nesh e kishte bërë Jugosllavia duke deklaruar vetëm 11 të vrarë. Ata kanë pasur mundësi të thonin 10 ose 20, por jo, deklaruan 11 që numri i të vrarëve të jetë më i besueshëm tek perëndimorët. Gjatë marsit dhe prillit 1981 kishte më shumë të vrarë, por ata e minimizuan numrin e viktimave tona. Zmadhimi i numrit të të vrarëve ishte në dobi të Kosovës dhe demaskonte politikën jugosllave. Nëse perëndimorët nuk do të besonin që kishte aq të vrarë sa ne deklaruam, ata nuk do t'i besonin as Jugosllavisë se kishte aq pak. Perëndimi do ta merrte numrin e të vrarëve diku nga mesi. Kjo ishte në favorin tonë.

Pasi në gazetat belge u shkrua numri saktësisht, u takuam me Enverin dhe si gjithmonë pas një pune të suksesshme, komentonim dhe qeshnim që sa mirë ia bëmë Serbisë. Për ne ishte gëzim i madh kur aktivitetet tona kishin sukses dhe përcilleshin nga mediet ndërkombëtare. Kur them për ne, nuk duhet nënkuptuar vetëm tre-katër veta, por për shumicën e atyre që ishin në rrjedhën e ngjarjeve.

Secili prej nesh përpiqej të jepte maksimumin për çështjen kombëtare. Çdo aktivitet zhvillohej asokohe kishte rëndësi të veçantë. Thjeshtë të veproje në atë kohë (në Kosovë ose mërgim) ishte guxim dhe vetëflijim. Jam i bindur se të gjithë ata të gjeneratës sonë, kur ndalën dhe i kujtojnë aktivitetet e tyre, u rrëqethet trupi. Po të pyesje, secili veç e veç, do të thotë se po ta kisha ditur se pas çlirimit të Kosovës do të shoh invalidë pa punë dhe pa respekt, familje të dëshmorëve pa strehë mbi kokë edhe pas 11 vjetëve çlirim, pa respekt për ata që luftuan tërë jetën për çështjen kombëtare, nuk do u kisha hyrë atyre punëve. Tani po e them një realitet që askush publikisht nuk e thotë. Para pak ditësh takova Demaçin. Në bisedë e sipër e pyeta: "Çka po thuash Bacë, kështu nuk e kemi menduar Kosovën e lirë?!" Baca qeshi pak dhe tha: " A po e sheh që po mund të folim, pimë kafe e çaj lirisht në qendër të Prishtinës, pa u frikësua nga polici i Serbisë! A ta ka marrë mendja najherë qe ti dhe unë kemi me pi kafe në qendër të Prishtinës?"
Fjalët e simbolit të rezistencës janë ngushëllua për secilin veprimtar kombëtar. Është e vërtetë se ëndrra e secilit prej nesh ka qenë çlirimi i Kosovës nga Serbia. Sikur çdo gjë të shkonte mirë, asnjëri prej luftëtarëve të lirisë nuk do të zhgënjehej, por kur sheh se të gjithë vrapojnë pas pasurisë dhe askush nuk mendon për popull, përsëri tek këta individë zgjohet delli kombëtar dhe gjumin nuk e bëjnë të qetë. Ka shumë gjëra që na bëjnë të zhgënjehemi si psh. ngritja e busteve në baza familjare, financime të librave në baza familjare dhe interesa të ndryshme klanore, ndarjet e medaljeve për punë patriotike atyre që nuk e kanë merituar....
Ngjarje e pranverës 1981 do t'i aktivizojnë të gjitha organizatat dhe partitë politike si dhe individët e pa politizuar. Secili individ u angazhua për të dhënë kontributin e vet në fushën që mendonte se kishte mundësi t'i ndihmonte sadopak çështjes kombëtare. Para se të shkojmë te akti patriotik që Musa Hoti kreu në Bruksel, do të ishte mirë të lexohet një artikull i tij, botuar në "Zëri i Kosovës", organ i Lëvizjes. Siç kemi parë deri tani në diasporë botohej "Zëri i Kosovës" nga Lëvizja dhe ai i Enver Hadrit në Bruksel. Në atë të

Lëvizjes kishte artikuj profesionalë dhe informata më të thukta, por dihej se autorët ishin anonimë.
Ja se ç'shkruante Musa Hoti në "Zëri i Kosovës" Nr 4.

***Manipulimi dhe sabotimi i aktiviteteve kombëtare nga armiqtë***

## Musa Hoti, Bruksel

"...Pas përfundimit të luftës së Dytë Botërore, popullit shqiptar nën Jugosllavi iu mohua liria dhe e drejta për vetëvendosje për fatin e tyre, kur armata e mbante situatën politike me presione të njëpasnjëshme, që shqiptari të mendonte vetëm për ekzistencë e assesi për ta njohur veten e tij. Aq më tragjik është fakti se ky popull liridashës mbeti i copëtuar në tri republika të federalizmit jugosllav, njësoj si në kohën e kralëve të ish-Jugosllavisë. Në këto treva ushtrohej një politikë shoveniste e programuar dhe e analizuar nga njerëzit më "eminentë" të udhëheqësisë me qëllim të detyrimit që shqiptarët të shpërngulën nga trojet e veta.
Nga UDB-ja u organizua Kongresi i Lipovicës, ku morën pjesë më së 6000 intelektualë dhe patriotë shqiptarë, të cilët u arrestuan dhe shumë sish u persekutuan në vitin 1946.
Dhjetë vjet më vonë, pasoi aksioni i grumbullimit të armëve, ku një pushkë shitej e stërshitej më se 100 herë, me ç'rast prap zhduket gjenerata patriotike shqiptare në Kosovë.
Më 27 nëntor 1968, rinia progresive organizoi në Prishtinë një demonstratë antijugosllave. Dhe si efekt rezulton: e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe; e drejta e flamurit kombëtar; njohja e statusit të Krahinës së Kosovës dhe hapja e Universitetit të Prishtinës. Ata që u arrestuan në këto demonstratë, pas vuajtjes së dënimit kanë vdekur një nga një në shtëpitë e tyre.

## Më 11 mars 1981 vazhdoi vallja e filluar

Premtimet e rrejshme të demagogëve jugosllavë për zhvillimin e shpejtuar të Kosovës vazhdojnë tani e 36 vjet. Ato premtime nuk u realizuan asnjëherë, mbeten të shkruara në letër e të mbuluara nga pluhuri i pasluftës.
Të gjitha pasuritë natyrore shfrytëzohen pa mëshirë, kurse standardi i njerëzve zbret nga viti në vit. Nga pasuritë nëntokësore kosovare është ngritur Beogradi i sotshëm, janë ngritur qytete të tëra dhe fabrika me investime kolosale sidomos në S.S. Serbisë. Ata në shenjë mirënjohjeje na gjuajnë me plumb të Trepçës nga tyta të armëve të kalibrave të ndryshëm.
Mënyra e eksploatimit të pasurive nëntokësore kosovare bëhet me metoda të kolonializmit të përmbysur në botë. Stagnimi i ekonomisë kosovare arrihet edhe në mënyra të sabotimit në punë nga ekspertët dhe « udhëheqësit » e kombit serb në Kosovë, ku prodhimi i përgjithshëm i ekonomisë është 40% nën plan në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Deficitet jugosllave i tejkalojnë dy herë ato polake dhe arrijnë në 26miliardë dollarë.
Ja ku e çoi ekonominë politika jugosllave e «vetëqeverisjes», teori kjo e klikës Tito-Kardel! Edhe « socializmi » specifik në botë, vertetë e ka mahnitur botën !Sikur të mos ishin qesharakë këto dy variante, sigurisht edhe bota do t’i përvetësonte si të tilla.
Dihet mirëfilli se shkeljet më të rënda të ligjit në ekonomi ndodhin mu në specifikat e «vetëqeverisjes» dhe « socializmit » të Beogradit. Ndarja e të ardhurave personale sipas njerëzve ndodh vetëm në këtë trevë shumëkombëshe, për çka duhet të mburret i gjithë kombi.
Mos të shkruajmë për keqpërdorimet në nivel të Federatës, republikave dhe krahinave autonome, e vetëm nga serbët e privilegjuar. Në Kosovë, psh, keqpërdorën miliarda dollarë nga kombinatet e mëdha vite me radhë dhe askush nuk merret kurrë në përgjegjësi.
Familjarizimi, neglizhenca, ngritja e çmimeve etj. janë specifika të llojit të Beogradit, të një rruge drejt e në humnerën e pafund.

Ngjashmëri më këto kanë edhe puna e bashkuar si sistemi i delegimit, ku gjithmonë është prezent mospërgjegjësia e mosfunksionimi i organeve partiake e shtetërore në nivelet më të larta të Federatës së qelbur nga egoizmi djallëzor serbomadh dhe nga sëmundjet e tyre kronike, fizike e shpirtërore.
Udhëheqësia jugosllave gjendet në një barkë të përmbysur në ujëra të turbullta dhe akoma nuk i sheh rreziqet e fundosjes së plotë. Ata nuk e përfillin fjalën vetëkritikë dhe ndërgjegjia e tyre është e avulluar me kohë, kurse etikën njerëzore duhet pastruar nga erozioni i moteve. Si është e mundur të arrihet një korrektësi aq e lartë në « udhëheqësinë » e tipit jugosllav, ku për dëshirat e serbomdhejve në piedestal, përgjegjësinë e merr e tërë « kryesia » ?. A s'është kjo anomali ?

## MUSA HOTI:

### Manipulimi dhe sabotimi i aktivitetëve kombëtare nga armiqët

Pas përfundimit të luftës së dytë botërore,popullit shqiptar në Jugosllavi iu mohua liria dhe e drejta për vetëvendosje për fatin e tyre,ku armata e mbante situatën politike me presione të një-pasnjëshme,që shqiptari të mendoi për ekzistencë e asesi për ta njohur vetën e tij.Aq më tragjik është fakti,se ky popull liridashës mbeti i coptuar në në tri republika të federalizmit jugosllav,njësoi si në kohën e kralve të ish Jugosllavisë.Në këto treva ushtrohej një politik shoveniste e programuar dhe e analizuar nga njerzit më"eminent" të udhëheqësisë me qëllim të detyrimit të shqiptarve të shpërngulen nga trojët e veta të shtrenjëta.

Nga UDB-a u organizua Kongresi i Lipovicës,ku morën pjesë më se 6000 intelektual dhe patriot shqiptar,të cilët u arrestuan dhe shum sish u persekutuan në vitin 1946.

Dhjetë vjet më pas pasoi akcioni i grumbullimit të armve,ku një pushkë shitej e stërshitej më se 100 herë,me ç rast prap zhduket gjenerata patriotike shaiptare në Kosovë.

Më 27 Nëntor 1968,rinia progresive organizon demonstrata anti jugosllave në Prishtinë dhe si efekt rezulton; e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe,e drejta e flamurit kombtar,njohja e statusit të krahinës së Kosovës dhe hapja e Univerzitetit të Prishtinës.Ata që u arrestuan në këto demonstrata,pas mbajtjes së denimit kanë vdekur një nga një në shtëpit e tyre.

ë 11 Mars 1981 vazhdoi vallja e filluar.

Premtimet e rrejshme të demagogve jugosllav për zhvillim të shpejtuar të Kosovës vazhdon tani 36 vjet.Ato premtime nuk u realizuan asnjëherë,ato mbetën të shkruara në letër e të mbuluara nga pluhuni i pasluftës.

Të gjitha pasurit naryrore shfrytëzohen pa mëshirë kurse standardi i njerzve zbret nga viti në vit.Nga pasurit nëntoksore kosovare është ngritur Beogradi i sotshëm,janë ngritur qytete të tëra dhe fabrika me investime kolosale sidomos në RS të Sërbisë.Ata në shenjë mirënjohjeje na gjuajnë me plumb të Trepçës nga tytat e armve të kalibrave të ndryshëm.

5

***Faksimile nga dorëshkrimi i artikullit, shkruar nga Musa Hoti***

## Bashkëjetesa dhe « vëllazërim-bashkimi »

Nacionalizmi serbomadh është ushqyer me gjakun e bijve më të mirë e më të denjë shqiptarë, tash e më shumë se 100 vjet të kaluara, dhe nuk është mësuar të na shikojë me sy të konkurrentit në të gjitha fushat dhe lëmit e jetës, por është mësuar të na shohë si sharrëxhinj, pastrues të rrugëve të Beogradit e hamej të përulur, andaj kurrë nuk jemi konsideruar si vëllezër të tyre, gjithmonë kemi pasur tretman si izraelitet ndaj popullit heroik palestinez. Marrëdhëniet ndërnacionale kurrë nuk kanë qenë në baza të respektimit reciprok.
Standardi i serbëve gjithmonë dominon, kuptohet në dëm e në kurrizin e shqiptarëve hallemëdhenj, nga se ata i kanë të drejtat politike nga Serbia. Kjo u pa e qartë edhe në kohën e demonstratave të fundit në Kosovë, ku serbët civilë, të mobilizuar nga shteti policor, shtinë me armë të ndryshme kudo në masë dhe asnjërin prej tyre nuk e morën në përgjegjësi.
Ishin tragjike përjashtimet e demonstruesve në të gjitha qytetet, ngase sulmoheshin me mijëra e mijëra milicë të « huazuar » nga të gjitha republikat e Jugosllavisë. Në momente të tilla nuk mungoi as armata me mjete të blinduara kundër demonstruesve duarthatë, ku numri i të vrarëve dhe të plagosurve është fatal. « Bashkim-vëllazërimi « i imagjinuar është tretur një herë e përgjithmonë.

## Universiteti i Prishtinës

Viti i kaluar shkollor në Universitetet dhe shkollat të larta të krahinës përfundoi para afatit të rregullt; kurse viti i ardhshëm shkollor nuk do të fillojë “sanimit” të gjendjes së krijuar, e cila sigurisht s’do të arrihet pa plotësimin e kërkesave të kosovarëve. Mosvijimi i studentëve në fakultete, i nxënësve në shkolla dhe i punëtorëve në vende të ndryshme të punës, do t’i sjellë kokëçarje të reja qeverisë së Beogradit si dhe kukullave të tyre në Kosovë. Rinia dhe klasa punëtore do t’i kërkojnë shokët e vrarë dhe të plagosurit radhas me kërkesat e mirënjohura për vetëvendosje.

Masat preventive të qeverisë dihen mirëfilli. Ajo do të dërgojë masovikisht rininë kosovare në shërbimin ushtarak , për çka është aprovuar edhe ligji në nivel të Federatës.
Numri i studentëve për regjistrim në vit të parë është i zvogëluar me 10% në këtë vit shkollor; kurse Shkolla e Lartë Komerciale në Pejë dhe Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë nuk do të pranojnë më studentë të ri. Kriteret për regjistrim i ka caktuar Beogradi, kurse i kanë aprovuar "kompetentët" kokëkrisur kosovarë. Çdo kërkesë për regjistrim do të shqyrtohet në Sekretariatin për Punë të Brendshme të Krahinës .
Studentët shqiptarë nuk i aprovojnë ndërrimet e planprogramëve mësimore, ku faktikisht do të zhduket mësimi i historisë kombëtare, mësimi i shkrimtarëve rilindas dhe veprat e tyre si dhe do të ndërpritet bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës.

## Intensifikimi i diferencimit ideopolitik

Për t'iu kundërvu forcave kosovare qeveria e Serbisë propozoi një program "aksional", që u miratua nga "udhëheqësit" kosovar. Por që në fillim hasi në vështirësi të pakaluara nga e gjithë rinia dhe punonjësit shqiptarë në Kosovë. Organizohen mbledhje dhe tubime të niveleve të ndryshme, por asnjë pjesëmarrës nuk e akuzon tjetrin, përkundrazi e mbrojnë njëri-tjetrin. Diferencimi ideopolitik është bërë i pamundur, i pa prekshëm dhe plotësisht i dështuar.
Tubimet e niveleve të ndryshme përfundojnë pa diskutantë, përveç lakenjve, miopëve dhe këlyshëve tradhtarë, që popullin e përdorin si shkallë për t'u ngritur sa më lart në jetën e karrierizmit, që kur të bien poshtë, t'i japin fund jetës si tradhtarë. Ndërpriten bursat e kreditë edhe ashtu të pakta, përjashtohen nga bankat shkollore, suspendohen nga puna pa të drejtë kompensimi të të ardhurave personale. Ata nuk do të pushojnë kurrë nga kërkesat e tyre!
Shqiptarët nën Jugosllavi i janë adaptuar jetës së të burgosurit politik. Ata dënohen me nga 13 vjet burg të rëndë, akuzuar si armiq të popullit, meqë i kërkojnë të drejtat e tyre legjitime. Për vepra të

njëjta dënohen kroatët me nga 2-3 vjet burg, kurse serbët nuk dënohen fare. Një dukuri e tillë është e natyrshme, pasi dihet mirëfilli se Jugosllavia dirigjohet nga serbët e vetëpushtetshëm dhe gëzojnë shumicën e votave si në Kryesi, ashtu edhe në të gjitha organet tjera të pushtetit.

## Informimi

Shkrimet tendencioze, sensacionale dhe armiqësore të Beogradit ndaj të gjithë shqiptarëve në rruzullin tokësor po ushqehen dhe ndërsehen nga vetë timonierët e barkës së përmbysur, timonierë të demoduar dhe të zhveshur nga petku internacionalizmit proletar dhe i maskës së xhelatit. Ata nuk shohin ekzistencë as perspektivë pa u ushqyer me gjakun e shqiptarit të pafajshëm për çka përdorin të gjitha horrllëqet, duke filluar që nga vënia në rolin e organit hetues, në rolin e gjykatës deri edhe në rolin e kirurgut pa diagnozë, risi dhe sensacion në stilin e vet specifik plotësisht "vetëqeverisës"! Por këto metoda bastardhësh kriminelë nuk po gjejnë treg në trevat kreshnike shqiptare. Besa as gazetat kosovare, që rregullisht, e paraqesin situatën me gënjeshtra që nuk i ha as gomari më hudhër.

## Lotët e Shimpanzesë

Më "dhimbsen " me shpirt udhëheqësit e Kosovës, të Serbisë dhe të Jugosllavisë që derdhin lot për shpërnguljen e serbëve dhe malazezëve nga tokat shqiptare. Të gjithë serbët dhe malazezët ardhacakë në Kosovë e dinë se në cilin vit kanë ardhur në Kosovë të shtyrë nga kralët dhe tellallët e tyre; njëherë i dinë qëllimet dhe synimet e programuara, por ata kanë pak logjikë: shpërngulën sa nuk kanë rënë në gropat që i kanë hapur për ne. Si nuk duel një njeri me e cekë shpërnguljen e dhunshme të 350 mijë shqiptarëve në Turqi, para dhe gjatë vitit 1956, si dhe emigracionin "ekonomik " në Perëndim?!

Pse nuk flitet për realitetet e udhëheqësve jugosllavë, që janë vu në rolin e kurtizaneve?

## Manifestimet e jashtme

Në shenjë solidariteti me rininë kosovare në të gjitha shtetet e Europës Perëndimore, në ShBA dhe Australi, mërgata shqiptare organizoi manifestime masive deri më nga 8000 pjesëmarrës. Ata kishin për qëllim me njoftue opinion botëror mbi ushtrimin e gjenocidit, shtypjes dhe presionit të Jugosllavisë ndaj popullatës shqiptare.
Elementi armiqësor serbomadh po përdor edhe dhunën e forcën në aksione të armatosura kundër klubeve dhe legatave jugosllave, në bashkëpunim me vetë policinë sekrete të tyre, për t'i akuzuar shqiptarët, por edhe bota i njeh veprat e tyre të ndyta që nuk zgjedhin metoda nga etja e dominimit.

## Kushtet për stabilizim

Një ndër kushtet elementare të kosovarëve është e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje, duke i përfshirë edhe viset tjera shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi...".

***"Margaritarë historike"***

## Komentimi i artikullit

Qëllimisht lexuesit ia solla artikullin në tërësi, që secili që e lexon këtë libër të ketë njohuri pak më të zgjëruara mbi personalitet që dikur vepruan në shërbim të çështjes kombëtare. Në bazë të shkrimeve të tyre, botuar asokohe në shtypin e mërgatës. Këto shkrime janë margaritarë historikë dhe na shërbejnë për të vlerësuar aktivitetin e një periudhe të caktuar si dhe vizionin e tyre për

ardhmërinë e fatit të popullit shqiptar. Përveç vlerës historike, që përmbajnë artikujt e asja kohe, arsyeja tjetër, që më shtyen të mbledh materiale të kohës së shkuar e sidomos të atyre me të cilët kam bashkëvepruar me dekada të tëra, është se veprimtarët tanë ishin intelektualë e jo siç propagandonte Jugosllavia. Propaganda e armikut, si atëherë edhe tash, përmes shërbëtorëve të tyre bën të gjitha përpjekjet që të ulë vlerën e rëndësinë e çdo aktiviteti dhe prestigjin e personalitetin e çdo aktivisti të çështjes kombëtare, duke i etiketuar këta si njerëz që janë marrë me prostitucion e drogë dhe aspak më problemin kombëtar. Gjatë përvojës sime në mërgim (mbi 25vjet) e di se asnjë veprimtar i çështjes kombëtare nuk është marrë me gjëra për të cilat na akuzonte dikur Jugosllavia e tani ndonjë i pa informuar apo shërbëtor i tyre. Çuditërisht edhe në një nga gazetat tona të përditshme me vazhdime u shkrua se si Enver Hadri, Vehbi Ibrahimi, Musa Hoti, unë e ndonjë tjetër nuk paskemi bërë asgjë për çështjen kombëtare, veçse jemi marrë me shitjen e drogës dhe me prostitucion. Po i citoj fjalët e vajzës sime, Leonorës dhe Manushaqes, vajzës së Musa Hotit. Kur lexuan ato “shkresurina” më thanë: “ Të ishit marrë me shitje të drogës, bile ne fëmijët sot do t’i kishim punët më mirë. Sot ne do të shëtisnim me xhipa dhe do kishim vila luksoze”. U turpërova nga fjalët e dy vajzave tona, që tani ato janë gra dhe më fëmijë. U turpërova se më binte ndërmend kur ne shkonim në manifestime të ndryshme me qindra kilometra duke i shpenzuar edhe parat e fundit që kishim e duke i marrë të gjithë fëmijët tanë në demonstrata thua se Kosova kishte mbetur vetëm në disa prej nesh! Në fakt ishte një lloj turpi që ne asokohe nuk e mendonim se kishim fëmijë, sepse prioritet kishim çlirimin e Kosovës. Mirëpo në të njëjtën kohë ndjehesha krenar për punën që kemi bërë, së paku krenari kisha para fëmijëve, sepse të tjerët, po t’u thuash se ke vepruar pa fituar asgjë, të quajnë naiv, të quajnë të marrë.

Përmes këtij artikulli do ta vlerësoni edhe ju se asokohe Musa Hoti kishte një vizion tepër largpamës për ardhmërinë e Kosovës. Ky vizion shihet në fjalinë që Musa e përfundon artikullin e tij.

Musa kishte ide të majta, por koha ishte e tillë, sepse pjesa më e madhe e intelektualëve në Kosovë kishte po të njëjtat ide. Mirëpo majtistët nga Kosova nuk ishin si çdo majtist i shteteve tjera. Majtistët tanë kishin menduar se, së pari, duhej që Kosova të bëhej Republikë në kuadër të Federatës së asaj kohe, pastaj me kalimin e kohës të vetëvendoste nëse duhej shkëputur nga Federata e t'i bashkangjitej shtetit amë. Kështu ka menduar Jusuf Gërvalla; kështu ka menduar Musa Hoti e shumë e shumë majtistë të tjerë, që duke iu falënderuar punës se tyre ne sot e gëzojmë lirinë në Kosovën e pavarur e, ndoshta, me kalimin e kohës edhe bashkimin natyral të vendit tonë.

Asokohe ekzistonte mendimi se, pasiqë Jugosllavia është komuniste, ne shqiptarët duhet të kërkojmë të drejtat tona vetëm në kuadër të sistemit komunist. Kjo ishte arma më e mirë e asaj kohe mendonin intelektualët e asaj kohe, sepse ne do ta luftonim komunizmin pikërisht me armën e tyre. Ata quheshin komunista, edhe ne mund të quheshim komunista, por në bazë të teorisë komuniste, secili popull duhej te gëzonte të drejtat e barabarta. E të drejta të barabarta ne shqiptarët nuk kishim, pasi, siç shkruan Musa Hoti, Trepça po shfrytëzohet nga Beogradi, pasuritë nëntokësore po shkojnë në Beograd, ndërsa jeta e shqiptarëve gjithnjë e varfër. Në sistemin komunist nuk duhej që një regjion të ishte më i varfër. Sllovenia, Maqedonia e Mali i Zi ishin republika, teksa Kosova jo, nuk i jepej, ndonëse ishte disa herë më e madhe se ato dy republika Kjo ishte arma që majtistët mendonin se duhej realizuar duke përdorur mjetet dhe metodat e njëjta të sistemit. Secili majtist ëndërr e ka pasur realizimin e bashkimit natyral të Shqipërisë, por deri atje duhej shkuar shkallë-shkallë.

Në anën tjetër, djathtistët poashtu kërkonin bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet të vetëm. Asgjë të keqe dhe antikombëtare nuk kishte asnjëra palë. Problemi qëndronte në atë se shërbimet sekrete të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë ndikuan dukshëm në prishjen e relacioneve ndërshqiptare, duke infiltruar spiunë të tyre në dy palët. Gjatë një bisede, që kemi zhvilluar me Musën dhe Enverin, më kujtohet kur Enver Hadri foli me një mosbesim në politikën e RS

Shqipërisë. Enveri na tregoi se kishte qenë në ambasadën e Shqipërisë në Paris i shoqëruar me Avni Xharrajn. Disa muaj më vonë, pas bisedës që këta kishin zhvilluar me ambasadorin dhe zyrtarët tjerë në ambasadën e Shqipërisë, kishte shkuar policia e Serbisë dhe kishte marrë në pyetje njerëzit emrat e të cilëve Enveri dhe Avniu kishin përmendur. Çdo shqiptar në mërgim që ka qenë veprimtar, qoftë majtist ose djathtistë është takuar me zyrtarët e ambasadës shqiptare. Secili shqiptar është rrëfyer tek zyrtarët e lartë të Shqipërisë dhe atë e ka bërë me krenari. Ka qenë krenari t'u huash atyre se në Kosovë ka djem e vajza që janë kundër sistemit jugosllav. Ishte krenari t'u thuaje atyre se Kosovën nuk ka fuqi që mund ta mposhtë. Kur me mburrje është folur në mënyrë të përgjithësuar, zyrtarëve u kanë interesuar emrat me të cilët ti i njeh si patriotë. Asnjërit nuk i ka shkuar ndërmend se emrat që ti do t'i përmendësh, do të keqpërdoroheshin. Në ç'mënyrë janë keqpërdorur askush ende nuk e di. Si ka shkuar e tërë biseda, që u zhvillua në ambasadën shqiptare në Paris tek veshët e UDB-së, Enveri nuk e dinte. Enveri ishte i bindur se Avniu nuk i ka treguar askujt dhe vetë Enveri e dinte se nuk folur me askë. Është logjike sqarimi i Enverit, sepse sikur mërgata djathtiste të dinte se Enver Hadri takohej më zyrtarë të Shqipërisë, nuk do bashkëpunonte më me te. Asokohe ne kemi ra në përfundim se Tirana bashkëpunonte me Beogradin. Supozimi ynë, Musa Hotit nuk i pëlqente e madje nuk mund të besonte. Pavarësisht në mosbesimin që kishte Enver Hadri, përsëri vazhdonte kontaktet me zyrtarët e Shqipërisë. Pavarësisht besimeve ose mosbesimeve ne vazhdonim të jepnim kontributin tonë në favor të Kosovës, dhe nuk i prishnim relacionet tona për shkak të bindjeve politike.

Duke parë se jetonin në qendrën ekonomike dhe politike të Europës, përveç demonstratave në Bruksel u organizuan edhe një seri atentatesh kundër interesave të Serbisë që përfaqësoheshin në Bruksel. Gazeta zyrtare belge “Le soir “ e datës 01.04.1981 shkruante për atentatin e parë me bombë që kishte ndodhë të dielën e fundit të marsit, kundër përfaqësisë së JAT-it, që përsipër e kishte marrë Vehbi Ibrahimi.

Atentate të tilla kundër përfaqësive serbe në Belgjikë e posaçërisht në Bruksel shtoheshin gjithnjë e më shumë që në një farë mënyre ishte një vërejtje autoriteteve serbe që të ndalej tortura dhe vrasjet në Kosovë.
Kështu me 15 korrik 1981 gazetat e përditshme belge do të shkruanin për atentatin e parë politik me ç'rast dy persona në orën dhjetë e tridhjetë minuta hynë në ambasaden jugosllave dhe me rafale automatikësh plagosin Blagoje Anakioskin dhe Franc Sindelerin, që të  dy nëpunës të ambasades dhe vranë një nëpunës tjetër emri i të cilit nuk u mësue kurrë nga se autoritet e Beogradit  e mbajtën të fshehur për arësye që vetëm ata i dinë.




***Blagoje Anakioski dhe Franc Shpindleri të plagosurit me 14 korrik 1981***

Me këtë rast nënshkruhet atentati i parë politik kundër trupit diplomatik jugosllav të cilën poashtu Vehbi Ibrahimi në deklaratën e tij për shtyp do ta marrë si organizim të tij. Forma që kishte zgjedhur Vehbi Ibrahimi që atentatet t'i merrte përsipër, natyrisht që ia rrezikonte jetën, por ai ishte i vetëdijshëm për këtë rrezik dhe çdo ditë që e kalonte e dinte se ishte një ditë më tepër që i zgjatej jeta. Vehbiu dëshironte që qeverisë së Beogradit t'ia dërgonte mesazhin se për çdo vrasje në Kosovë një vrasje pritet ne diasporë.
Në Bruksel vrasje të serbëve kishte patur edhe më herët por ato ishin qërim hesapesh mes grupeve dhe grupacioneve serbe. Më herët një serb i quajtur Pierre Valiç ishte gjetur i vrarë në dhomën e tij. Më vonë poashtu në Bruksel u vra Miodrag Boshkoviçi në apartamentin

e tij si dhe Urosh Miliçeviqi që ishte dëshmitari numër një për vrasjen e Stefan Markoviçit ky i fundit truproja e Alen Delonit.
Beogradi nuk kishte llogaritur se kosovarët e posardhur dhe ata të viteve ‘70 u vetorganizuan duke krijuar strukturat e tyre për të vepruar kurdo që paraqitej nevoja. Të rinjtë kosovarë të diasporës së Belgjikës ishin krejtësisht të padjallëzuar politikisht dhe kështu qëndruan deri në vitet 1984. Pas këtij viti çdo gjë në Bruksel ndryshoi gati rrënjësisht sepse shërbimi sekret serb kishte arritur të depërtonte edhe të disa të rij të cilët në fillim nuk i kishte llogaritur fare. Që Beogradi nuk ia kishte frikën diasporës organizoi një ndeshje futbolli mes ekipit te Splitit dhe skuadrës së Anderlehtit te Brukselit. A ishte e sigurt Serbia se ndeshja do të zhvillohej pa një incident që shqiptaret e Belgjikës mund ta provokonin? E Jugosllavia që përfaqësohej përmes zërit të Stane Dollancit kishte shpërndarë hafijet e veta shqiptare që të merrte masa sigurie qe kjo ndeshje te zhvillohej normalisht. Por sa u besonte Serbia hafijeve te veta shihet qartë se ata kishin organizuar shërbimin sekret special që, së paku, kjo ndeshje te shkonte siç e dëshironin dhe e kishin parashikuar.
Loja do të zhvillohej me 5 gusht. Në mbrëmjen e katër gushtit çdo gjë dukej se do të shkonte në rregull. Ambasada Jugosllave po bindej se shqiptarët i kishte zënë gjumi...Zhvillimi i një ndeshjeje futbolli pa asnjë incident ishte shenjë poshtërimi për diasporën shqiptare të Belgjikës. Së paku kështu pëshpëritej në rrethe të ngushta patriotike.
Zhvillimi i ndeshjes ishte nënçmim që i bëhej diasporës. Luhej me gjakun e bijve të vrarë në Kosovë. Mbajtja e ndeshjes njëherit ishte sinjal që i përcillej tërë diasporës dhe popullit në Kosovë se shqiptarët ishin të nënshtruar dhe Serbia i mbante tërësisht nën kontroll. Mbajtja apo mos mbajtja e kësaj ndeshje ishte një luftë sekrete që zhvillohej në heshtje mes diasporës dhe hafijeve të Beogradit. Muajt e fundit diaspora e Brukselit pas një seri atentatësh të rangut të mesëm kishte fituar reputacionin se trualli belg ishte i tepërt për serbët që jetonin në këtë vend. Zhvillimi i ndeshjes mes Splitit dhe Anderlehtit do ta zhdukte këtë kredibilitet që kishin fituar

shqiptarët që jetonin në këtë shtet. Humbja eventuale e renomesë që kishte fituar diaspora e Belgjikës ishte  një humbje që nuk do ta pranonte askush, sepse më këtë rast do binte edhe morali ndër të rinjtë.
Trupi diplomatik i ambasadës,pasi ishin informuar nga informatorët se ata nuk kishin hetuar asnjë shenjë nga pala shqiptare se do te ndodhte diçka në disfavor, vendosen ta festonin këtë lajm te mirë në një restorant në qendër të Brukselit. Kjo iniciativë për të festuar para kohe fitoren mbi diasporën shqiptare, jo vetëm ishte e hershme, por edhe e tepërt. Kjo iniciativë nuk i ngjante aspak festës por më shumë dukej si një nuhatje për të kuptuar sa ishin të qetësuar shqiptarët nga se në ketë tubim të ftuar kishte edhe shqiptar që përcillnin trupin diplomatik dhe të shërbimit sekret nga Beogradi. Në këtë ekspeditë ishin shtatë vetë të armatosur pa lejen e jurisprudencës belge, që ilegalisht kishin hyrë të armatosur, fakte që bien ndesh me ligjet dhe normat e policisë belge per të huaj, qofshin ata diplomatë apo vrasës të shkolluar pjesëmarrës të shërbimit sekret jugosllav nën udhëheqjen e diplomatit që njëheri nxiste urrejtjen dhe provokonte shqiptarët.

## Krismat dhe jehona e pushkës<br>së  Musa Hotit në “Wite Horse”!

“Derisa  po shëtisja në qendrën e Brukseli - tregon me emocione Musa Hoti, në një kënd me ndriçim te zbehtë rastësisht po dëgjoja sharje dhe kërcënime ne gjuhen serbe. Spontanisht ktheva kokën. Pashë se ishin shtatë veta. Te gjithë shtatlartë qe ecnin sikur pa frikë dhe me një guxim arrogant. Për të evituar një konflikt eventual kalova ne anën tjetër te rrugës dhe hyra ne lokalin “Wite Horse” ku i njihja  të pesë bashkatdhetarët me te cilët pasi u përshëndeta. U ula në tavolinën e tyre. Vetëm disa minuta me vonë shtatë serbët hapen deren e lokalit ku isha unë. Kuptova se ata ishin duke më përcjell. Pasi ma hodhën një shikim urrejtës, u ulen në një tavolinë përballë meje dhe vazhduan me kërcënime dhe sharje ne baza nacionale si:

"Do t'i vrasim të gjithë terroristët ne Bruksel", "Ne jemi sundimtarë e ju skllevërit tanë!" etj.  Ofendimet e tyre më rëndonin, por mundohesha të kontrolloja vetën deri në momentin kur njëri prej tyre u ngrit dhe, pasi ë shau nënën shqiptare, nxori revolen në drejtim timin. Çdo gjë ndodhi me një shpejtësi të rrufeshme. Unë bëra vetëmbrojtjen legjitime me ç'rast u vra kryeserbi i ambasadës dhe u plagosen tre tjerë, - rikujton Musa Hoti ngjarjen  e para njëzët viteve".

*("Epoka e Re", 23 janar 2003, autor R.S)*

## Të panumërt ishin artikujt e shtypit të botës për aktin e Musa Hotit



**Judiciaires**

LA LIBRE BELGIQUE
6-8-1981

**Le meurtre d'un membre de l'ambassade yougoslave : un réfugié politique du Kosovo recherché**

Dès mardi soir, le juge d'instruction Ost de Bruxelles a fait diffuser sur les antennes de la R.T.B.F. et de la B.R.T., mais non dans la presse écrite, la photo de l'homme suspecté d'avoir abattu mardi à l'aube dans un café du centre de la capitale M. Djeric, comptable à l'ambassade de Yougoslavie, et blessé un collègue de ce dernier, M. Zuko. Il s'agit du portrait d'un Yougoslave originaire de la région du Kosovo où des troubles sérieux se sont produits récemment qui ont débouché sur de nombreuses condamnations. Par ailleurs, trois cocktails Molotov ont été lancés dans la nuit de mardi à mercredi contre un magasin yougoslave du centre de Bruxelles, tandis qu'un témoin du drame du «White Horse», M. Mohamet Roma, attablé avec les victimes était interrogé mercredi.

Hoti Musa, le suspect, est né le 11 juillet 1946 à Mitrovica, une ville du territoire autonome du Kosovo faisant partie de la République de Servie et peuplé en majorité d'Albanais. Réfugié politique en Belgique depuis de nombreuses années, M. Hoti Musa avait une photo anthropométrique à l'identité judiciaire, sans pour cela être connu comme délinquant.

Mercredi matin, le parquet de Bruxelles a maintenu sa version d'un crime non politique. Il semblerait, y disait-on, que les deux employés de l'ambassade attablés au «White Horse» se soient moqués de leur futur agresseur. Toutefois, sachant qu'il est d'origine albanaise et connaissant les protestations qu'ont entraîné dans la communauté yougoslave originaire du Kosovo et parmi les Albanais de Belgique, les condamnations consécutives à l'agitation «autonomiste» ou «nationaliste» survenue dans le territoire du Kosovo il y a quelques semaines, on peut se demander si la brève discussion entre Hoti Musa — à condition qu'il se vérifie qu'il est bien le suspect recherché par la police — et les deux autres Yougoslaves, ne tournait pas autour d'un différend politique.

Le suspect recherché, Hoti Musa.

Quoi qu'il en soit, ce enième incident a provoqué un froid dans les relations entre la Belgique et la Yougoslavie qui reproche à notre pays de ne pas prendre toutes les mesures nécessaires pour protéger ses intérêts ici. A Belgrade, mardi soir, l'ambassadeur de Belgique, M. Joseph Trouveroy, a été convoqué au secrétariat fédéral des Affaires étrangères où on lui a fait part de «l'indignation de l'opinion publique et du gouvernement devant la poursuite non troublée des activités antiyougoslaves en Belgique».

M. Trouveroy a assuré M. Pekic, adjoint au secrétaire aux Affaires étrangères, «que des mesures énergiques seraient prises afin de prévenir ce genre d'activités».

Le nouvel attentat commis mercredi vers 0 h 25 contre le magasin «Cinex Inac Belgique», 85 boulevard Lemonnier, à Bruxelles, où l'on vend des spécialités yougoslaves, n'arrangera certainement pas les choses. D'autant qu'il a été revendiqué par un coup de téléphone anonyme à l'agence Belga, au nom d'un «Mouvement indépendantiste albanais». L'interlocuteur de Belga a déclaré que les trois cocktails Molotov lancés contre la vitrine du magasin exploité par Radivoj Bebic et qui ont occasionné un début d'incendie, l'ont été par les mêmes personnes qui avaient commis un attentat contre les bureaux de la compagnie aérienne yougoslave «J.A.T.» au printemps dernier.

«Nous n'en resterons pas là, a ajouté l'inconnu, qui a exprimé l'intention de venger les milliers de frères albanais poursuivis dans le Kosovo».

***"La libere Belgique", 06.08.1981***

HET VOLK 6-8-1981



*Musa Hoti: de verdachte die zijn naam achterliet.*

# Joegoslavisch moordenaar vergat zijn identiteitskaart

**BRUSSEL. — Stojan Djeric, bediende van de Joegoslavische ambassade, is neergeschoten door een man die, met de steun van die ambassade, in Schaarbeek een vereniging had opgericht die regeringsgezinde Joegoslavische emigranten van Albanese afkomst groepeert. Een politieke medestander bijgevolg; althans op het eerste gezicht, want in de verbeten strijd tussen een hele reeks Joegoslavische bewegingen blijken de verhoudingen steevast ingewikkelder te liggen dan het de schijn heeft. Een van tevoren beraamde aanslag lijkt de moord niet te zijn geweest. De dader, wiens motief nog niet gekend is en die voortvluchtig is, heeft in zijn haast om weg te komen zijn identiteitspapieren achtergelaten in de herberg waar de feiten plaatsgrepen.**

De man heet Musa Hoti. Hij werd op 11 juli 1946 geboren in Mitrovic, een stad in Kosovo. In het autonome gebied Kosovo wonen twee miljoen Albanezen; er is een autonomistische beweging actief, die het gebied wil losmaken van de Joegoslavische staat. Hoti behoort tot de andere strekking.

## BOMAANSLAG

Binnen het etmaal na de moord op het Joegoslavisch ambassadelid is dinsdagnacht enkele honderden meter verder, een bomaanslag gepleegd op een winkel van Joegoslavische specialiteiten. Onbekenden verbrijzelden de vitrine met een riooldeksel en wierpen daarna drie brandbommen, waarvan er één ontplofte. De schade zou zowat 150.000 fr. bedragen.

ZIE BLZ. 3

**“Het volk”, 6. 8. 1981**



TELEPHONE 02/218.30.28
ANNONCES 02/219.31.20 (CCP 000-0065444-68)
ABONNEMENTS 02/218.75.30 (CCP 000-0550410-32)
SERV. VENTES 217.56.32

# La Dernière Heure

LE PLUS GRAND JOURNAL BELGE, LE MIEUX RENSEIGNE - 127, BOULEVARD EMILE JACQMAIN

## La fusillade du White Horse

## C'est un «barbouze» yougosl qui aurait été abattu

### Du terrorisme et de ses victimes

● Toutes les polices chent activement l'a Musa Hoti, né, à Mit Avant d'abattre le Yo sade, l'exilé, qui conv moment, avec le «dipl criant : «Vous me pren

***La Derniere Heure" 6 gusht 1981***

Pas vrasjes së diplomatit jugosllav, në adresë të shtetit belg menjëherë qeveria e Beogradit dërgon një notë protestuese, duke kritikuar autoritet belge se trupi diplomatik i ambasadës jugosllave nuk mbrohet nga ekstremistët shqiptarë dhe se ata ndihen tejet të indinjuar që policia Belge njoftoi ambasadorin me tri orë vonesë për vrasjen që ishte kryer.

Ndërsa Musa Hoti fshihej për të mos i rënë në dorë policisë belge, u bë një atentat kundër përfaqësisë jugosllave " Cinex Inac", që gjendej në bulevardin Lemonier nr.85, pronar i së cilës ishte Radivoje Bebiç.

Musa Hotin fillimisht e strehoi Agron Palloshka. Pastaj ai shkoi në disa vende tjera për të mos u arrestuar. Kishte dëshirë të arratisej në Shqipëri, ku mendonte se jetën do ta kishte më të sigurt. Pavarësisht se e strehonin shqiptarët, policia belge kishte marrë masa që Musa të

mos e kalonte kufirin e Belgjikës. Pas disa ditësh Musa ishte në dilemë: të dorëzohej apo të vazhdonte arratinë.
Në ndërkohë, gazetat e Beogradit nuk pushonin së shkruari për arratisjen dhe ngjarjen që kishte kryer Musa Hoti duke e vrarë Stojan Qeriqin.




*Pamje nga ceremoniali i varrimit të Stojan Gjeriqit,*
*që Musa Hoti e vrau me 4 gusht 1981*

Ja, një ndër artikujt e gazetës beogradase “NIN”

## Armiku i armikut....

***Përshkrimi i parë i vrasjes së zyrtarit të ambasadës jugosllave Stojan Çeriqit. I plagosuri Rexho Zuko , dëshmitar i vrasjes flet për sulmin terrorist në restorantin e Brukselit…***

Ministri i Drejtësisë i shtetit belg, Filip Muro, i intervistuar të shtunën e kaluar në televizion, tha se disa të huaj po e shfrytëzojnë sistemin liberal të Belgjikës për qëllime terroriste dhe se këtyre duhet t'u ndërpritet rruga.

Kur ? Si?

Në pesëmuajshin e fundit qytetarët jugosllavë dhe institucionet në Belgjikë kanë përjetuar serinë e sulmeve terroriste (pesëmbëdhjetë), aq sa vështirë të ketë ndodhur diku në këto kohë moderne. Nga zjarri deri tek plumbat e revolverëve! I nderuari ynë në zyrën e Ambasadës Jugosllave barbarisht është vrarë. Tre shokët e tij zyrtarë u plagosën rëndë me armë zjarri. Kanë djegur në flakë institucione jugosllave, pasuri të patundshme të qytetarëve tanë, besnikë të Jugosllavisë dhe të Belgjikës. Është djegur një autobus turistik.....

.... Asnjëri, kryes i këtyre veprave, nuk është arrestuar dhe askush nuk u zbulua deri në çastin kur këtë të mërkure jam duke e dërguar këtë lajm nga Brukseli.

NIN-it (gazetë serbe) nuk i ka shkuar për dore që këtë situatë t'ia sqarojë ndonjërit prej zyrtarëve të lartë të Belgjikës. Ministri i drejtësisë nuk ka pasur kohë të pranonte gazetarin tonë dhe shefi i zyrës së informimit të ministrit ka deklaruar se ministri mund të bisedojë, por nuk mund të ju thotë asgjë më shumë se sa është thënë. Ministri i Punëve të Jashtme po bëhet gati të udhëtojë për pushimet verore dhe nuk ka kohë të bisedojë . Asnjë tjetër zyrtar kompetent nuk është në disponim për intervistë. Na është dhënë mundësia e vetme që pyetjet tona t'ua dërgojmë me shkrim dhe me shkrim do t'i marrim përgjigjet e tyre pas njëzetë ditëve.

## Dëshmitari i vrasjes

Franc Shpindler, i cili në atentatin e 14 korrikut 1981 ishte plagosur në gjoks është arsyetuar aq mirë sa duke na thënë se po udhëton për Jugosllavi. Rexho Zuka dhe Bllagoja Anakiosko janë në spital nën kujdesin e policisë belge. Gazetarit i është thënë se për shkak të gjendjes së të plagosurve nuk është mirë të japin deklarata. Nuk janë të paraqitur as në shtypin belg.

Rexho i ka 25 vjet. Djalosh. I zhdërvjelltë, i shoqërueshëm. Sykaltër e flokëbiond që i ngjan aktorit holivudian Pol Njumeni. Motrat medicinale po kujdesen shumë mirë. Ka filluar të shoqërohet edhe më rojet e policisë belge, edhe pse vetëm tani ka filluar të nxjerrë fjalët e para në gjuhen frënge.

Më 4 gusht 1981 te “Kali i bardhë” plumbi e kapi në asht afër palcës nga ana e jashtme, i është thyer ashti. Ka ardhur të punojë në ambasadë për ta zëvendësuar Shpindlerin e plagosur me 14 korrik, e jo të plagoset edhe vetë. Atë mbrëmje, rrëfen Gjeriqi, e kam ftuar t’i tregoj Brukselin në drita të natës. Shumë mirë kanë drekuar në një restorant jugosllav dhe pastaj e kanë ndërruar lokalin.

-Te “Kali i bardhë” – ndërhyn Rexho Zuko- na shoqëronin dy shokët e Gjeriqit. Një i yni me mustakë, shqiptar nga Kosova, dhe një i huaj, më duket ishte belg. Nuk më kujtohet emri tij. Ne të dy kemi pirë birra. Kam zënë vend pas Gjeriqit. Menjëherë pas shpinës ishin disa në një shoqëri të madhe. Gjeriqi më tha ngadalë të mos e kthej kokën. Në të njëjtën kohë kam dëgjuar fjalinë: “ Dikë sonte do ta vras”. Tavolina jonë ishte afër shankut. Nga ajo shoqëri erdhi një burrë më gungë dhe i shkurtër, pështillej afër nesh, që nuk e besoj se ishte më shumë se një metër. Gjeriqi i ofroi një kafe. Nuk kemi biseduar më zë. Kur papritmas nga tavolina tjetër erdhi atentatori te tavolina jonë. Ishte në anën e djathtë time. Ndërsa Gjeriqi në të majtën. Më është drejtuar vetëm më këto fjalë: “ Çka keni ju dy që po qeshni?” Pas shpinës nën xhemper apo maicë, nuk më kujtohet, nxori revolen dhe e qëlloi në kokë Gjeriqin nga

largësia 30 ose 50 cm. Jam hedhur përpara drejt revolverit, por në këtë kohë plumbi më kishte kapur edhe mua. Gjeriqi ra i vdekur përtokë. Edhe unë u rrëzova. Nga dhimbjet e plumbit jam rrokullisur deri te shkallët që të iki.
Më duket se pas tre katër minutash ka ardhur policia. Dola nga vendi ku isha fshehur (Isha fshehur në WC – shënimi im ). E shikoja Gjeriqin të paluar për tokë, gjakun e tij në kokë dhe tavolinën e rrotulluar mbrapsht. Më dërguan në spital ku më bënin pyetje për një kohë të gjatë. Përveç pyetjeve të tjera më thanë: “Pse kanë gjuajtur në ju?”. Jam përgjigjur: “ sepse jemi Jugosllavë”.
Më vonë e kuptuan se, përveç meje, ishte edhe një tjetër i plagosur. Policia ka shkuar pas gjurmëve të gjakut. E kanë gjetur në gjumë të fshehur diku në rrugë të plagosurin tjetër. Nuk e kishin hetuar që ishte plagosur. Në momentin e krismave ishte brenda në lokal.
Në lokal, atentatorit i kishte mbetur setra me dokumente. Kështu, emri i Musa Hotit notoi mbi sipërfaqe.
Rexho Zuko, policia i tregon fotografinë e patentës së shoferit që Musa e kishte harruar: “A është ky që ju ka plagosur? , “Po”. “ Ku e moret këtë? “ . Nuk është më rëndësi”.

## *E papërgatitur qeveria belge*

Vetëm pas dhjetë orëve të vrasjes dhe plagosjes sonë erdhi ambasada jonë të na vizitonte. Gazeta belge “Le soir” më 6 gusht shkruante se policia belge nuk mundi ta kontaktojë direkt ambasadën jugosllave, sepse fillimisht ajo kujdesej për t’ua shpëtuar jetën të plagosurve. Pastaj policia përcaktoi identitetin e të plagosurve dhe të të vrarit...
Gjykuar sipas shtypit të Belgjikës, këto nuk kanë bërë hetime të zgjeruara për këtë rast, por janë shërbyer nga informatat e policisë. Madje edhe emrat ua shkruan me gabime. Kurse gazeta “La dernére heures” Gjeriqin e quan agjent jugosllav që ka ardhur në Belgjikë për të hetuar lidhur me atentatin e 14 korrikut, ndërsa Rexho Zukon truproje të tij. Kjo na bën të mendojmë se përse këto gënjeshtra.

Sipas versionit të kësaj gazete, Musa Hoti paska vrarë “rojtarët engjuj”. Ata e dinë shumë mirë se, kur kanë shkuar në vendin e ngjarjes, në trupin e vrarë të Gjeriqit dhe as në dy të plagosurit nuk kanë gjetur armë.
Për këso dezinformatash të çuditshme ky sistem edhe më lart?! Del edhe plani i parë, vendi dhe koha, që të ketë mundësi edhe plani i dytë të rrjedhë me vrasjen barbare të viktimave. Çdo gjë shkon ashtu, madje edhe gjygji i hetuesisë deklaron se kjo nuk ishte vrasje me motive politike. Çfarëdo tjetër – por jo vrasje politike.

## *Atentati në ambasadë*

Sipas natyrës atentati në ambasadë ishte edhe më i rëndë sesa i vrasjen së Gjeriqit, por askush nuk kishte vdekur. Me 14 korrik, rreth orës dhjetë paradite, dy femra kanë shtypur butonin e ziles së ambasadës. Rojtari nga largësi, në formë elektronike e hap derën. Me dy femrat ka hyrë edhe një i tretë. Në hollin e ambasadës Franc Shindleri ka qenë duke folur me telefon. Njeriu i tretë i është drejtuar atij dhe pa e folur asnjë fjalë ka filluar të zbrazë armën. Plumbi ia ka thyer pjesën e poshtme të kufjes së telefonit që Shindleri e mbante mbështetur për gjoks afër mushkërive. Ndoshta kufja ia ka shpëtuar jetën. Bllagoje Anakiovski (40 vjeçar), këshilltar ekonomik i ambasadës, rastësisht është ndodhur aty, për të kërkuar një numër të telefonit.

### *Ka dëshmua për NIN-in*

Menjëherë ai njeriu e ka zgjatur dorën për të qëlluar Franc Shindlerin. Më kujtohet vetëm pak. As fytyrën nuk kam mundur t’ia shoh. Mua dhe Shindlerin na ndante zjarri që s’kishte të ndalur. Atentatori, në tërheqje e sipër armën drejt meje. Më shumë, më tej, asgjë nuk më kujtohet. Pak minuta më vonë kam ndier se trupi filloi të më ligështohej dhe rash për tokë.

I plagosuri rëndë dy shuplakat e duarve i ka të djegura. Kjo, ndoshta ka ngjarë, kur ai ka zgjatur duart për të marrë librin e telefonit, për çka edhe kishte shkuar. Në supin e majtë duket një shenjë si kryq, ndoshta nga dalja e plumbit prej mishit. Dy plumba i ka afër mushkërive. Këmbët nuk i ndjen. Është duke luftuar me temperaturë të lartë që po i përsëritët. Plumbi prej eshtrave të gjoksit ka kaluar nëpër mushkri deri në kurriz . I është dëmtuar unaza e shtatë. Vetëm pasi t'ia shpëtojnë mushkrit, mjekët mund të merren me kurrizin dhe me mjetet moderne të mjekësisë mund t'ia kthejnë edhe këmbët që të ecë. Vështirë beson gruaja e tij, Mira 35 vjeçare, që burri saj mund të ecë një ditë. Fëmijët Stefani (5) dhe Marta (2.5), mendojnë ende se babi i tyre është në një udhëtim të gjatë.

## *Trimëria e Franc Shpinderit*

"Vrasësi ka ikur drejt portës që vetë e ka hapur. Shpindleri ka vrapuar pas tij gati 150 metra, deri në këndin e shtëpive. Para një kamioni të kompanisë amerikane ka rënë, shtrirë për tokë. Policia në atë vend ka bërë dy shenja me shkumës: një rreth në vendin e kokës dhe vijën tjetër të trupit.
Kishte kaluar gati një muaj. Ndonëse kishin rënë edhe shira, shenjat e shkumësit ende nuk ishin shlyer.
Në tërë botën e civilizuar rritet ndërgjegjja për humbjen nga terrorizmi. Kushdo që e arsyeton rastin nga rasti , **terrorizmi mbetet akt që, herët ose vonë, do të goditet edhe pse dikush mendon se tash nuk është koha.**
**Duket se në Gjermaninë Perëndimore ekstremistët shqiptarë e kanë përjetuar dorën e fortë të shtetit tonë, por edhe në Francë, në Suedi...** Në ShBA u gjykuan ekstremistët kroatë, të cilët kishin pasur ndërmend të bënin akte terroriste. Kështu ka ndodhur edhe në Australi.
Ndoshta në shtetin belg mendojnë se ekziston toleranca për politikë ekstremiste, në mënyrë që t'i vrasin ekstremistët e grupeve tjera,

duke e hequr të keqen nga shtëpia e tyre. Këtë gabim vendet tjera tanimë e kanë paguar.
Më në fund pyesim, a thua do të ketë hetime të ashpra. Kjo duhet të lërë gjurmë në relacionet e dy shteteve që dikur ishin të mira. Një fjalë e vjetër e popullit thotë: armiku i armikut tim nuk është miku im. Kush është miku i Belgjikës: Jugosllavia apo ekstremistët shqiptarë që janë të gatshëm të bëjnë çdo gjë? “.

***Përkthimi i artikullit të gazetës beogradase “NIN” 16 gusht 1981***

**нин на лицу места: брисел**



САХРАНА СТОЈАНА ЂЕРИЋА: ЈОШ ЈЕДНА ЖРТВА АНТИЈУГОСЛОВЕНСКОГ ТЕРОРИЗМА

# непријатељ мог пријатеља...

**Први детаљан опис убиства југословенског службеника Стојана Ђерића. Рањени Реџо Зуко, сведок убиства, говори о терористичном нападу у бриселском ресторану . . .**

Белгијски министар правде Филип Муро, интервјуисан прошле суботе на телевизији, рекао је да се неки странци користе либералним режимом ове земље за своје терористичке циљеве и да се томе мора стати на пут.

Када? Како?

У последњих пет месеци југословенски грађани и институције доживели су у Белгији серију терористичких напада (петнаестак) какви тешко да су игде забележени у новије време. Од паљевина, до револверских метака! Угледни службеник југословенске амбасаде мучки је убијен. Три друга службеника рањена су ватреним оружјем. Гореле су просторије југословенских институција, имовина југословенских грађана, лојалних и према Југославији и према Белгији, паљена је. Запаљен је један туристички аутобус . . .

. . . И ниједан починилац није ухапшен и нико није директно окривљен до тренутка када се у среду пре подне овај извештај шаље из Брисела.

НИН-у није пошло за руком да са неком високом белгијском личношћу разјасни ову ситуацију, коју би наш читалац, служећи се домаћим политичким речником, вероватно означио као „раскорак између речи и дела". Министар правде није могао да прими овога новинара, а шеф за штампу Министарства рекао је да може разговарати, али да не може рећи ништа што већ није речено.

Министар иностраних послова се управо спрема на пут, а због сезоне годишњих одмора ниједна друга компетентна личност у Министарству није била на располагању. Остављена нам је могућност да питања поставимо у писменој форми и да писмене одговоре добијемо за двадесетак дана.

Тако је овај новинар од белгијских извора могао да користи само белгијску штампу, а од југословенских — да разговара са преживелим жртвама два атентата.

## СВЕДОК УБИСТВА

Франц Шпиндлер, који је приликом атентата у амбасади 14. јула рањен у груди, толико се опоравио да је могао да путује у Југославију. Реџу Зуку и Благоја Анакиоског чувају у болници белгијски полицајци. Овај новинар је замољен да због безбедности рањеника не објављује називе болница. Нису објављени ни у белгијској штампи.

Реџо има 25 година. Момчина. Ведар, друштвен. Плавоок и светле косе, помало личи на Пола Њумена. Медицинске сестре га мило гледају. Спријатељио се и са „својим" стражарима, мада учи тек прве француске речи. Одиграју понекад партију шаха.

Четвртог августа „Код белог коња" метак га је погодио у корен палца са спољне стране шаке, смрскао кост и избио на длан. Дошао је у амбасаду као чувар на место рањеног Шпиндлера. Те вечери га је, каже, Ђерић позвао да изађе да му покаже ноћни Брисел. Добро су вечерали у неком југословенском ресторану, па су променили локал.

„Код белог коња" — каже Зуко — „придружила су нам се двојица Ђерићевих познаника. Један брка, наш Албанац са Косова и један странац, мислим Белгијанац. Не знам имена. Нас двојица смо пили пиво. Седео сам насупрот Ђерића. Одмах иза леђа у углу седело је повеће друштво. Ђерић ме је упозорио да се не окренем. У један мах чуо сам са те стране реченицу: 'Неког ћу ноћас да убијем'.

Наш сто је био близу шанка. Из оног друштва дошао је до шанка и ту се мувао један мали, грбави, не верујем да је за оштрицу жилета виши од метра. Ђерић му је понудио пиће.




РАЗБОЈНИЧКИ НАПАД: Хотел „Бели коњ“ у Бриселу у чијем ресторану је убијен Стојан Ђерић

***Hoteli “Kali i bardhë” në Bruksel, ku Musa Hoti Bëri aktin heroik***

*Shteti terrorist serb kërcënon...*

## Interpretim

Artikulli “Armiku i armikut... “ , në përkthimin integral më është dukur se ka një rëndësi të veçantë, jo se përshkruhen vrasjet dhe djegiet brenda atyre pesë muajve kundër përfaqësive dhe qytetarëve serbë, që sot shumëkujt do t’i duket absurde. Kështu ka ndodhur edhe në biseda. Të gjithë e merrnin me skepticizëm.
Këtë që shkruaj e tregoj nuk lidhen me mua. Jo. Unë, Qamil Zekolli e grupi im dramatik kemi organizuar vetëm manifestime kulturore dhe nuk kemi marrë pjesë në asnjë nga këto raste. Ne ishim kundër çdo veprimtarie që kishte apo merrte ngjyrimet e terrorizmi. Natyrisht, që disa prej tyre përfshirë në veprime të kësaj natyre për çka edhe janë dënuar, i kam njohur dhe kemi qenë shokë. Por këtu kemi të bëjë me mënyra të menduari dhe të vlerësimit të formave të qëndresës, kundërshtisë dhe reagimit ndaj terrorizmit serb në Kosovë, por edhe në diasporë nga UDB-ja jugosllave kundër shqiptarëve.
Pra, unë i hedh këto shënime, duke u bazuar edhe në kujtesën e largët, por sidomos në shtypin e kohës belg, por edhe jugosllav. Pasi edhe ata veprimtarë, që aktet e tyre “terroriste” i kanë kryer përgjithësisht në rrethana vetëmbrojtjeje apo si hakmarrje nga vrasjet klandestine të organizuara nga rrëgjimi i egër jugosllav kundër shqiptarëve në Kosovë dhe në diasporë! Lexuesi i këtij libri, duke u kthyer në kohë, në gjendjet e shqiptarëve, sidomos prej para tridhjetë vjetëve derisa Kosova u çlirua. As unë që po i shkruaj nuk kam ditur dhe nuk di shumëçka nga shkaqet e shtysat aktive të atyre bijve të Kosovës e të kombit shqiptar që u detyruan të marrin në sy vdekjen dhe të luftojnë dhëmb për dhëmb me UDB-në dhe udbashët jugosllavë dhe duart e shtrira të tyre në grupet e spiunëve dhe shërbëtorëve, tradhtarë të kombit shqiptarë! Dhe ironia është se ata që u detyruan të mbrohen duke sulmuar e vrarë udbashët, po njollosen me epitetin “terrorist”; ndërsa, jo pak prej atyre që i

shërbyen UDB-së, duke zhytur duart edhe në gjak të shqiptarit, po na nderohen si “atdhetarë”, politikanë apo zyrtarë të Prishtinës!
Sidoqoftë, unë po shkruaj, aq sa di nga mediat dhe ashtu si mendoj.
Është interesant rasti i përshkrimit të të plagosurit nga ana e gazetarit serb. Vëreni me kujdes se si atë e bëjnë hero edhe pse dihet se ai nga frika është stepur. Po të kishte ndodhur i njëjti rast të shqiptarët të gjitha gazetat do ta quanin frikacak. Serbët e quajnë trim ikjen e tij.
Artikullin që e përktheva (nga serbishtja) ka një rëndësi tjetër. Në këtë artikull është zëri i qeverisë gjegjësisht i Serbisë e që ne shqiptarët asnjëherë nuk e kemi lexuar me vëmendje, por vetëm na interesonin fotografitë e të vrarëve dhe të plagosurve. Në fakt, pasi ta lexojmë me kujdes vërehet se përmes këtij artikulli, Serbia një ditë do të hakmerret për vrasjet në Bruksel.
Ata hapur deklarojnë se  Musa Hoti, heret a vonë, një ditë do të vritet nga dora e fortë e tyre. Ja si thuhet në këtë artikull: “*terrorizmi mbetet akt që herët ose vonë do të goditet edhe pse dikush mendon se tash nuk është koha”*. Ky ishte një mesazh paralajmërues e provokues që i përcillej Musa Hotit. Ndërkohë zëra kritikë dhe ankues i shkonin Musës nga ndonjë bashkëkombas kosovar  të dërguar të UDB-së apo naiv se po e prishka “bashkim vëllazërimin” ”shqiptaro-jugosllav”. Prandaj nuk e pranonin në partitë politike të organizuara në Bruksel  nga shqiptarët.

Serbia shkon edhe më larg, madje edhe më zë kërcënues kur shkruan: *Duket se në Gjermaninë Perëndimore ekstremistët shqiptarë e kanë përjetuar dorën e fortë të shtetit tonë, por edhe në Francë, Suedi, ShBA...”*. Kështu kërcënohen të gjithë ata që janë kundër Jugosllavisë, respektivisht kundër Serbisë.
Serbia e pranon krimin që ka bërë në Gjermani, duke e plagosur rëndë Rasim Zenelin. Sa çudi! Ata kanë të drejtë të mburren për vrasjet e tyre dhe nuk i quajnë terrorizëm vrasjet që bëjnë mbi shqiptarët e pafajshëm; ndërsa ne nuk guxojmë të shkruajmë, bije fjala, për vrasjen që bëri  Musa në rrethanat e vetëmbrojtjes, se të quajnë përkrahës të terrorizmit. Bile ka të tillë që shkojnë  edhe në

## Përsëri dikush “pas perdeve”
## Shkruan Dragan Ganoviq

Ngjarja e pakëndshme me diplomatët jugosllavë në Bruksel ka qenë si një bombë e papranueshme nga UDB-ja dhe qarqet serbomëdha. Prandaj ata menjëherë filluan të
përcjellin kërcënime ndaj qytetarëve shqiptarë, anëtar të klubit në Bruksel dhe në qytete tjera të Belgjikës. Posaçërisht ata janë agresivë ndaj komunitetit shqiptar, veçanërisht ndaj anëtarëve të klubit “Përparimi”. Fatkeqësisht politika dhe manovrat, duke trembur apo aktivizuar nëndheshëm kontingjentet e e shërbëtorëve, të blerë e të nënshtruar, përhapnin frikë e panik. Në raste të tilla vihen në lëvizje ata që me dinakëri a naivitet janë strukur në qoshe të organizatave balliste e irredentiste.
Por vërehet edhe kundërveprimi nga bashkëkombësit. Vihen në lëvizje disa nga “ekstremi i djathtë” (pasardhësit e ballistëve dhe fashistëve), disa nga “ekstremistët e majtë” siç është i ashtuquajturi “Fronti i kuq”, etj.
Prej këtyre krijohet njëfarë “demokracie e përzierë”, nga të vjetrit dhe anëtarësohen gjithfarësh anëtarë të të gjitha rrymave. Fillojnë të punojnë me emër të firmës së re dhe kjo firmë e re në Belgjikë ua mundëson të shprehin mllefin kundër Jugosllavisë, pra, veprojnë nën maskën e “demokracisë”!

### *Thirrje e vjetër*

Megjithatë, terreni i ri për terroristët”,nuk po tregon diçka të re. Çdo gjë që terroristët janë duke bërë atje – është bërë edhe më herët. Edhe më herët janë kërcënuar, kanë kallur, dhe kanë gjuajtur mbi diplomatët tanë. Në fakt, ekstremistët dhe nacionalistët po krijojnë një njësi terroriste në disa qytete të Europës po sulmojnë çdo gjë jugosllave. Lidhjet me ambasadat e Shqipërisë, këtyre po u japin

vulën e veçantë dhe natyrisht duke i futur në këto ujëra mërgatën në ngjarje kundërrevolucionare.

## *“Marksistët “ dhe “djathtistët”*

Për këta nuk është edhe aq më rëndësi. Edhe pse secila prej këtyre grupimeve të vogla e propagandojnë njëfarë klase të tyre me motive politike apo ideologjike, të gjithë e kanë të njëjtin qëllim krijimin e një “Shqipërie të madhe”.

Qendra e këtyre organizatave është në Europën Perëndimore në Shtutgard, ndërsa degët në Belgjikë, Zvicër, Austri dhe Francë. Në shumë vende, mbi 30 të tilla, ku aktivistët bashkëpunojnë edhe me shërbimin sekret të Shqipërisë. Vendtakimet janë në qendrat e ambasadave të Shqipërisë.

Këto grupe kanë edhe përkrahjen e fraksioneve të partive marksiste–leniniste të ndonjë shteti të Europës. (Këtyre u lejohet në shtypshkronjat e partive të tyre të botojnë pamflete dhe materiale që haptas e ftojnë popullin në kundërrevolucion ndaj shtetit tonë). RS e Shqipërisë u jep këshilla, para dhe ekspertë për akte subversive, ndërsa krahut të djathtë u jep vetëm para.

Pastaj këta ecin lirshëm në tërë Europën me para të fituara pa lodhje. Flasin, kërcënohen dhe veprojnë, edhe me synimin që shefat e tyre i shohin se punojnë për çështjen kombëtare. Vrasja e Stojan Gjeriqit me 4 gusht 1981 vlerësohej si vetëmbrojtje, por edhe si shpagim për vrasjet dhe intrigat e udbashëve të Beogradit e të Prishtinës.

E çka mund të bëjnë këta, u pa. Stojan Gjeriq 43 vjeçar, diplomat i ambasadës jugosllave ne Bruksel, u vra në atentatin më të ri nga grupet e egra antijugosllave në Belgjikë.

Stojani dhe Rexho Zuko janë sulmuar rreth orës tre në një lokal të Brukselit, në mënyrë më të poshtër. Vrasësi iu është afruar dhe ka zbrazur shumë plumba nga revolveri i tij, ku plumbi i parë e ka kap në kokë dhe vdekur e ka lënë Stojan Gjeriqin. Kur Rexho Zuko është hedhur drejt vrasësit që ta ndalojë plumbi e ka kapë në dorë.

........................ ...............

Vrasësi ka ikur nga lokali me tërë shoqërinë e tij. Policia belge e ka njoftuar zyrtarët e ambasadës tepër vonë vetëm të nesërmen në mëngjes. Një sjellje e tillë është e pazakontë, që mos të thuhet e paparë dhe e padëgjueshme, në praktikën ndërkombëtare. Sepse pas aq shumë kohësh zyrtarët e ambasadës sonë do të dilnin në vendin e krimit për të parë se çka ka ndodhur.
..................................................

Në dallim prej sulmit të para pakditëve brenda në lokalet e ambasadës jugosllave, kësaj here, së pak, dihet kush ishte vrasësi. Autori që, në rrethana vetëmbrojtëse, këtë akt e kreu Musa Hoti, i lindur në Mitrovicë, i cili përkohësisht jeton në Belgjikë. Është anëtar i klubit "Kosova" që vepron për " pavarësinë dhe lirinë e partisë së kuqe".
Musa Hoti ishte anëtar i grupit në përbërjen e të cilit bënin pjesë edhe Jusuf Gërvalla e Ibrahim Kelmendi , organizatorë të një vargu mitingjesh, demonstratash, manifestimesh e veprimtarish të tjera që paraqisnin rrezikshmëri për institucionet e shtetit jugosllav. Studenti i përhershëm Ibrahim Kelmendi që vetën e quan shef i "Frontit të Kuq" bashkë me Jusuf Gërvallën Gjermaninë e kanë shtet të dytë. Ai udhëton shumë dhe shpesh është mysafir në Bruksel! Por saherë që del nga Belgjika për në shtet tjetër, aq herë diçka ndodh atje. Ose bëhen demonstrata ose dhunë. Kështu ka ngjarë edhe gjatë udhëtimeve të tij në Zvicër e në shtete tjerë të Europës. I shkathtë, nisiator, aktiv dhe me reputacion në emigracionin shqiptar, Ibrahim mbledh rreth vetes me turlifarë metodash bashkëkombësit në veprimtaritë e përbashkëta antijugosllave. Ishte partizan i veprimeve edhe me dhunë!

***Paralajmëruesit e dhunës***

Kelmendi dhe Gërvalla janë njohur dhe afirmuar si përfaqësues të nacionalizmit shqiptar në Europën Perëndimore. Në grupin e veprimtarëve të prirë për aksione edhe me dhunë janë: Muharrem Berisha, Menan Imetovski, Muhamet Rama, dhe në njëfarë mënyre

edhe Drita Fishti. Kjo haptas fton veprimtarët e aksioneve të guximshme antijugosllave.
Në fushatën antijugosllave ndahen si ultramajtistë, por edhe si bashkëpunëtorë të afërt me zyrtarët e ambasadës së Shqipërisë. Qytetarëve tanë kosovarë rreziku po u vjen –siç thonë ata- nga urdhëratë e ambasadës së Shqipërisë. Nuk po u duket mjaft që janë anëtarësuar në "organizatën" e tyre, por i përgatisin që kur të jetë nevoja t'i fusin në Jugosllavi. **(*"Novosti", 14 gusht 1981*)**

R E Q U I S I T O I R E

Le Procureur Général près la Cour d'appel de Bruxelles;

Vu les pièces de la procédure à charge de :

HOTI Musa, manoeuvre, né à Mitrovica (Yougoslavie) le 11 juillet 1946, résidant à Koekelberg, 5, rue Jean Jacquet, actuellement détenu sous les liens du mandat d'arrêt à la prison de Forest,

inculpé d'avoir à Bruxelles, au cours de la nuit du 3 au 4 août 1981,

A. volontairement, avec intention de donner la mort et avec préméditation, commis un homicide sur la personne de Djeric Stojan;

B. tenté de, volontairement, avec intention de donner la mort et avec préméditation, commettre un homicide sur les personnes de Zuko Redzo et Midi Achille, la résolution de commettre le crime ayant été manifestée par des actes extérieurs qui forment un commencement d'exécution de ce crime et qui n'ont été suspendus ou n'ont manqué leur effet que par des circonstances indépendantes de la volonté de l'auteur;

Vu l'ordonnance de la chambre du conseil du tribunal de première instance de Bruxelles du 7 juillet 1982 qui ordonne l'internement de l'inculpé prénommé du chef des préventions reprises ci-dessus;

Vu les deux appels interjetés le 8 juillet 1982 contre cette ordonnance, l'un par l'inculpé et l'autre par son conseil Me Guy Delfosse;

Attendu que, s'il n'est pas possible de déterminer l'antériorité de l'un des appels par rapport à l'autre, tous deux ayant été interjetés le même jour, sans que les actes d'appel fassent mention de l'heure à laquelle les dits appels ont été actés, la chambre des mises en accusation est cependant valablement saisie des recours;

Attendu que les faits qui constituent les préventions sont qualifiés crime par les articles 51, 52, 80, 392, 393 et 394 du Code pénal;

Attendu qu'il est constant que l'inculpé a commis ces faits;

Attendu qu'il est également constant que l'inculpé était au moment des faits et est actuellement encore dans un état grave de déséquilibre mental le rendant incapable du contrôle de ses actions et que la défense sociale exige qu'il soit interné dans un établissement à désigner par la commission de défense sociale;

Vu les articles 1, 7, 8, 9, 11, 12, 14, 28 et 31 de la loi du Ier juillet 1964 et les articles 11, 12, 13, 16, 31 à 37 de la loi du 15 juin 1935

**Aktakuza në gjuhën frënge nga prokurori belg**

***Strukturat e shërbimeve sekrete synojnë përçarje e konfuziont në gjirin e shqiptarëve***

## - Duke komentuar shënimin e "Novostit"

Duke e përkthyer këtë artikull, më kujtohen shumë skena e situata të asaj kohe që përshkruhen e stisen nga autori-gazetar, por që nuk ka asgjë të vërtetë.
Pak më parë e kemi lexuar letrën e Musa Hotit që i drejtohet Ibrahim Kelmendit, në të cilën, pasi i kujton se Beogradi i quan të një organizate majtiste duke akuzuar se Ibrahimi po e ndez situatën; pse ti ngrihesh kundër meje. Musa është i hutuar dhe dezorientuar nga veprimet e Ibrahimit dhe e pyet: si është e mundur që ai të jetë kundër nesh në Bruksel, kur Serbia e trajton si shefin e të gjitha ngjarjeve? Por a ishte vërtetë ajo që propagandonte Serbia? Jo. Së pari, Ibrahimi nuk e ka simpatizuar Musën, as më herët dhe as më vonë e as tani në Kosovën e çliruar. Së dyti, Ibrahimi nuk ka komunikuar kurrë me Musën apo me ndonjë ndonjë shok të tij. Së treti, ata me të cilët shoqërohej Ibrahimi në Bruksel, as që janë marrë me aksione, kohën e kalonin duke luajtur me letra dhe shah, Po nganjëherë merrnin pjesë në demonstrata. Dalja në manifestime dhe pritja e përcjellja e mysafirëve veprimtarë të çështjes së Kosovës ishte akt patriotik që nuk ia mohojmë askujt.
Unë nuk po e mohoj aktivitetin patriotik të Ibrahim Kelmendit, por vetëm dëshmoj se nuk ka pasur lidhje me grupin tonë në Bruksel dhe gjithnjë i ka përdorur besnikët e tij kundër nesh.
Dallimi i shkrimeve të mia nga shkrimet e autorëve tjerë është se unë nuk e akuzoj askënd si bashkëpunëtor i UDB-së apo i Tiranës. Është qëndrim korrekt ky. Po ashtu, jam i vetëdijshëm se është e vështirë, për të mos thënë, e pamundur të tregohet e vërteta , ashtu siç ka qenë.
Qëllimi i artikullit beogradas është të bëjë një lëmsh,duke i përzier të gjithë shqiptarët, që askush të mos dijë të orientohet. Disa emra të cituar në këtë, ashtu si në disa artikuj tjerë të tyre,janë emra që nata

e dita nuk i ka ndarë nga ambasada jugosllave. Ndonjëri prej këtyre emrave a qëlluar aty dhe Musa Hotit i kanë dalur kundër, dëshmitarë për vrasjen e diplomatit. Disa prej tyre kanë shkuar në Jugosllavi kur kanë dëshirue duke u dërguar dhurata të shtrenjta
Duke filluar me doganierët deri të shefi i SUP-it të qytetit te tyre.
Kur shkruan se Musa pas vrasjes ka dalur i shoqëruar me tërë shoqërinë, nuk është e vërtetë, sepse ata kur e kanë dëgjuar krismën kanë ikur drejt nevojtoreve bashkë me Rexho Zukon, i cili ka qenë truproje e ambasadorit. Ky jo vetëm që nuk është hedhur mbi Musën, por plumbi që ka dalur nga koka e të vrarit e ka plagosur këtë që ishte pas shpinës se tij dhe tjetrin që shkruan se e kanë gjetur 150 larg lokalit. Në fakt edhe ky është futur ne WC bashkë Rexho Zuko.
Sulmet kundër përfaqësive jugosllave që janë kryer në Belgjikë nuk janë bërë nga të vjetrit, as nga Kosova e as nga Shqipëria. Nuk janë bërë as pse ishin majtistë e as djathtistë. Fati i tyre ka qenë se nuk kanë qenë anëtarë të asnjë partie e as organizate, sepse ose do të ishin spiunuar nga shokët e partisë e të organizatës ose nuk do t'i pengonin të tilla veprime, sepse këto ishin nën kontrollin e Beogradit, të Tiranës dhe natyrisht të Belgjikës. Këta kanë qenë kosovarë të mllefosur të paangazhuar politikisht dhe ne momentin kur janë bërë anëtarë të partive janë tërhequr nga veprimtaritë.

***Atentatët vazhdonin...***

Një atentat tjetër vetëm pas 24 orëve pas aktit të Musës shpërtheu në rrugën Royale nr.103 kunder përfaqësisë turistike jugosllave, e cila ende nuk ishte riparuar pas atentatit të muajit maj. Pas kësaj serie të atentatesh, Jugosllavia tërheq ambasadorin Esad Ceriç duke i dërguar edhe një notë protestuese Belgjikës, ku e akuzonte se autoritet belge nuk mbrojnë interesat jugosllave, sepse ata ende nuk po arrestonin asnjë shqiptar.
Personeli diplomatik dhe përfaqësitë tjera jugosllave në Belgjikë kërkonin që autoritetet belge të kujdeseshin për ruajtjen e tyre. Mirëpo Belgjika nuk kishte mundësi që pas secilit diplomat të

dërgonte nga një ekip truprojesh. Për të qetësuar qeverinë e Beogradit, Belgjika lëshoi leje për armë mbajtje për të gjithë jugosllavët, që të frikësoheshin se mund të ishin të rrezikuar nga shqiptarët. Më këtë rast ata duhet të siguronin veten me revolet që i morën me leje. Pikërisht gjersa një nëpunës i misionit ekonomik jugosllav në zyrën e tij në katin e gjashtë po e shikonte revolen e posablerë, padashje plagos shokun e vet.
Musa Hoti ende gjendej në arrati. Misioni Ekonomik Jugosllav në fillim akuzon Musa Hotin se, gjoja, kishte hyrë në një nga zyrat e tyre dhe kishte plagosur një serb. Pasi ndërhyrjes së policisë belge dhe ekspertizës, autoritet belge njoftojnë se ngjarja në Avenu Louise nr. 250 ishte një incident i vetë trupit diplomatik nga pakujdesia në manipulimin e armëve që kishin në përdorim.
Kryetari klubit të futbollit të Hajdukut, zoti Santiç, me Galetoviçin, anëtar i komitetit dhe Mlladiniçin trajner, deklaroi para gazetarëve belgë se ndeshja miqësore mes ekipit të Belgjikës dhe të Jugosllavisë se ekipi nga Jugosllavia do të kthehej përsëri në Bruksel për të zhvilluar këtë ndeshje. Sipas drejtuesve të klubit “Hajduk” ndeshja do të zhvillohej pasi të krijohen kushtet e sigurisë së lojtarëve dhe të trupit diplomatik. Këtë premtim të kryetarit të klubit belgët do ta mbajnë mend por edhe diaspora shqiptare nuk do ta largonte nga vëmendja ndeshjen e ardhshme të këtyre dy ekipeve. Jugosllavia do të bënte presion në shtetin belg që ndeshja e ardhshme të zhvillohej pa asnjë incident. Mirëpo mërgata shqiptare e Brukselit do të organizohej në atë mënyrë që kjo ndeshje të mos zhvillohej, ashtu siç ishte paraparë nga dy shtetet.
“Pas aktit që kreva, rrëfen Musa Hoti, gjatë tetë ditëve më strehuan disa bashkatdhetarë, pasiqë unë dëshiroja të mos u dorëzohem organeve belge. Në ndërkohë disa shokë interesoheshin që ilegalisht të me dërgonin ne ShBA. Unë këmbëngulja të vendosesha në Shqipëri. Për këtë u vunë në lëvizje Enver Hadri,Vehbi Ibrahimi dhe Hysen Xhelili. Policia belge kishte bërë publikimin e fotografisë sime në të gjitha mediat e shkruara dhe televizive dhe kërkonte nga qytetarët informata për kapjen time. Grupi që merrej për vendosjen time jashtë Belgjikes po zhvillonte biseda me palën e shtetit

shqiptar. Por nga që puna po zgjatej, unë nga padurimi, u dorëzova në organet belge. Letra e nënshkruar nga Mehmet Shehu veç sa kishte rënë ne duar te Vehbi Ibrahimit, unë ne mungese te informatave dhe kufizimit te qarkullimit nuk kisha durim te prisja më. Dokument i cili pas vrasjes se Vehbiut e konfiskoi policia belge, por ende ruhet ne arkivat shtetërore belge.
Jugosllavia e atyre viteve gëzonte kredibilitet dhe prestigj te pakontestueshëm kështu që drejtësia Belge më dënoi me burg te përjetshëm. Gjykata belge asnjëherë nuk e muar aktin tim si mbrojtje legjitime dhe vetëm kur Amnestia Internacionale me qendër në Londër më mori në mbrojtje, gjërat ndryshuan. Si i vetmi i burgosur politik "për shkaqe të shtetit" iu drejtova Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Komisioni i Helsinkit në Strasburg dënoi Belgjikën dhe jo mua. Kjo ndodhi pas peticionit të përgatitur nga bashkatdhetarët me mbi 7000 nënshkrime dhe 2800 telegrame në javën kur me bëhej gjykimi. Ky veprim ishte një përkrahje morale për mua, por ishte një presion direkt kundër drejtësisë belge. Prokuroria belge me liroi si të pafajshëm, duke pranuar realitetin se me ka gjykuar për shkaqe te shtetit belg ngase Belgjikës i nevojitej një "fajtor" për të qetësuar Beogradin. Ajo tentoi të më sakrifikojë si i vetmi shqiptar i arrestuar, duke më akuzuar pa asnjë bazë, për 28 akte tjera që ndodhen ne territorin belg ku u vranë 14 serbë dhe u plagosen 12 tjerë.""

(" ***Epoka e Re " 27janar -01 shkurt 2003, autor R.S.***)

Pas atentatit për vetëmbrojtje që kreu Musa Hoti dhe aksioneve tjera që zhvilloheshin në Bruksel e qytete tjera të Belgjikës ku kishte përfaqësi dhe përfaqësues serbo-jugosllavë , situata mes shqiptarëve dhe serbëve, që jetonin dhe vepronin në Belgjikë, ndryshoi rrënjësisht. Brenda pesë muajve u bë një kthesë radikale në mentalitetin e shqiptarëve. U shkatërruan marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve.

Gjerë në ato kohë Jugosllavia kishte punuar me diasporën shqiptare aq shumë, saqë shpeshherë në festa të ndryshme familjare shqiptare, ftoheshin me një respekt te veçantë nëpunësit e ambasadës serbe. Klubet shqiptaro-serbe, që Jugosllavia i kishte hapur vetëm për të përçarë shqiptarët, frekuentoheshin shumë, pa e ditur pjesa më e madhe e shqiptarëve se aty zhvillohej një propagandë antishqiptare. Nga këto klube, që dikur Serbisë i shërbenin për t'i grumbulluar shqiptaret rreth veti, pas demonstratave te '81, pjesëmarrja nisi të rrallohej.
Edhe pse Musa Hoti për disa ditë nuk iu dorëzua policisë belge,shtypi botëror i dha jehonë kësaj ngjarjeje ngase për ta nuk ishte me rëndësi emri i veprimtarit, rëndësi të veçantë kishte vetë akti kundër diplomacisë së Beogradit. Disa ditë më vonë Musa Hoti shkon në policinë belge i përcjellur me një bashkatdhetar dhe u dorëzohet autoriteteve belge. Po të qëndronte Musa Hoti ilegal edhe për një kohë të gjatë dhe të mos dihej kurrë e vërteta, ndoshta jehona e vrasjes së diplomatit jugosllav nuk do të kishte shkaktuar aq shumë jehonë, siç nuk shkaktuan edhe shumë vrasje tjera, para dhe pas aktit të Musa Hotit.
Akti i Musa Hotit ishte një akt që u krye në një moment të caktuar dhe të duhur. Akti që kreu Musa dhe vendimi i tij për dorëzim ishte akt heroik dhe unikal, sepse u bë në kohën kur rinia kosovare, e përkrahur nga populli, doli haptas që ta kundërshtonte politikën hegjemoniste sërbosllave. Kjo ngjarje u kujtoj autoriteteve serbe se edhe ata mund të vriteshin, se as jeta e tyre nuk ishte e sigurt përderisa në Kosovë të ushtrohej dhunë kundër popullsisë së pafajshme.
Dorëzimi i tij organeve kompetente belge ishte edhe një sakrificë që Musa me vetëdije po ia bënte jetës së tij dhe familjes në përgjithësi. Musa kishte mundësi reale që ilegalisht të shpërngulej në një shtet të një kontinenti tjetër, siç shkuan disa tjerë, dhe të jetonte në anonimitet, por ai zgjodhi rrugën e një sfide të re tejet të rrezikshme.
Zbulimi i emrit të Musa Hotit, shërbimit sekrete jugosllav, ia lehtësoi punën që atentatin ta zhvlerësonte dhe Musën ta diskreditonte në sy të shqiptarëve. Në fillim UDB-ja do të merrte

masa dhe të zbulonte të gjithë shokët që Musa dikur i kishte frekuentuar në Kosovë. UDB-ja do të kërkonte nga shokët e Musës dhe, natyrisht, do të bënte presion mbi disa që ata të jepnin deklarata qyqare për “Rilindjen” duke deklaruar se Musa Hoti ishte një trupshkurtër dhe se gjithnjë kishte qenë frikacak.Nga disa tjerë do kërkonin të dinin se kush e kishte organizuar Musën dhe mos vallë në Kosovë kishte një organizatë ilegale që e dirigjonte Musën apo Musa i dirigjonte ata.

***Represion në Kosovë***

Një valë e re represionesh kundër shqiptarëve do të fillonte menjëherë pas vrasjes që Musa Hoti kishte bërë në Belgjikë. Fillimisht represionet serbe do të orientoheshin në familje të Musa Hotit. Pasi përjetojnë tortura psikike dhe fizike vëllezërit e tij në Mitrovicë, shërbimi sekret i sistemit të atëhershëm do të detyrojnë organizata punuese dhe lagje të tëra që familja e Musës të diferencohej. Diferencimi ishte metoda më e sofistikuar e Serbisë. Kur diferencohej një familje askush nuk kishte të drejtë të bisedonte me atë familje. Në fakt mund të bisedohej, por UDB-ja e merrte si pretekst dhe, madje, e shkak për të dënuar njerëzit. Asnjëri nuk kishte të drejtë të punësohej. Mirëpo këtij lloj diferencimi shqiptarët i bënin ballë duke i ndihmuar familjet e diferencuara mbrëmjeve apo edhe në baza miqësore. UDB-ja nuk mund t’i ndalte këto lidhje.
Në këto rrethana, anëtarët e familjes së Musa Hotit, që ishin në punë u përjashtuan, ndërsa ata që nuk ishin nuk u punësonin. Madje i largonin nga puna edhe femrat e martuara të familjes së Musës, si Melihaten, e cila punonte në qendrën e studentëve në Prishtinë. Ate e larguan pa asnjë sqarim.
Shërbimi Sekret nuk ndalej me masa përgjimi e shantazhesh të formave të ndryshme siç është rasti i Bejto Jusufit. Kur ai, më 1984, do të shkonte nga televizioni i Prishtinës për transmetimin e Lojërave Olimpike të Sarajevës, do përcillej kudo që ai vente këmbën. Madje ishte përhapur lajmi që Musa Hoti kishte dërguar telegram në Jugosllavi se do të bënte një atentat në Sarajevë për t’i

treguar botës se gjendja e shqiptarëve në Kosovë nuk ishte ashtu siç propagandonte qeveria e asaj kohe. Tërë olimpiada e lojërave dimërore është zhvilluar me roje ushtarake, madje edhe staza e pistës.
Unë jam i bindur se Musa nuk ka dërguar ndonjë telegram të tillë, sepse do të kishte folur me mua, siç flisnim për telefonatat që tjerët i bënin për të sabotuar koncertin e "Kastriotëve" që Jugosllavia i kishte sjellur në Bruksel. Mendoj se sistemi i asaj kohe është frikësuar edhe nga komunitetet tjerë si kroatët, boshnjakët etj, dhe nëse ndodhte diçka ata "fajtorin" e kishin të gatshëm. Ndoshta serbët e kanë përhapur këtë lajm në institucione ndërkombëtare dhe, ndodhi apo nuk ndodhi atentati, këtë rast do ta shfrytëzonin për të vrarë Musa Hotin. Dhe botës perëndimore do t'i arsyetoheshin se e vranë një terrorist ndërkombëtar. Për terroristë të atij rangu perëndimi i mbyllte sytë dhe veshët.

Hetimet kundër Musa Hotit do të orientoheshin edhe në mesin e Armatës Jugosllave të asaj kohe ku do merreshin ne pyetje ushtarë dhe oficerë të shumtë, që shërbenin në atë kohë, siç dëshmon Naim Maloku. Në kohën kur Naim Maloku ishte kadet i vitit të pestë në Akademinë Ushtarake, Musa Hoti kishte qëlluar mbi trupën diplomatike në Bruksel. Atentati në qendër të Europës bëri bujë në opinion botëror. Në shtypin botëror shkruhej për vrasjen kundër diplomacisë jugosllave. Ishte hera e parë në tërë historinë tonë që një shqiptar të vriste trupën diplomatike të shtetit jugosllav. Një vrasje e tillë kishte ndodhur në Paris kur Avni Rrustemi shtiu mbi Esad Pashë Toptanin. Pas shumë dekadash Musa Hoti e përseriti këtë akt, jo duke vrarë ndonjë shqiptar, por armikun shekullor të shqiptarëve. Vrasja që Musa Hoti e bëri në Bruksel me 4 gusht 1981 i dha zemër rinisë shqiptare kudo që jetote. Këngëtarët e folklorit popullor i këndonin këngë Musa Hotit për guximin dhe aktin patriotik të tij. Për rininë tonë Musa Hoti ishte model i guximit dhe i trimërisë. Madje trimëria e tij bëri jehonë edhe më të madhe, sepse ishte i vetëm dhe me një plumb vrau një dhe plagosi dy të tjerë. Çuditërisht, të vrarët ishin një serb, një boshnjak dhe një kroat.

Shërbimi Sekret Shtetëror i Jugosllavisë dhe Shërbim i Armatës Jugosllave KOS morën të gjitha masat e duhura që të hetonin të gjithë ata që flisnin me simpati për aktin e Musa Hotit. Ata frikësoheshin që akti i Musës mos po shërbente si nxitje që edhe të tjerë të vepronin në të njejtën mënyrë. Andaj masa të tilla kishin marrë edhe në tërë shqiptarët që asokohe shërbenin në armatën jugosllave siç shkruan Naim Maloku: "... Pra filloi loja e survijimit të përgjigjeve të mia deri në një moment kur u rrezikova shumë, ngase punët filluan të lidhën edhe me atentatin që bëri Musa Hoti në Belgjikë. Kur Musa Hoti e bëri këtë atentat në Belgjikë, ata filluan të interesohen përmes asaj shoqes sime se a bart unë armë dhe a mos po përgatis ndonjë atentat." (*"Dëshmi për rrugën e lirisë" botues "Zëri" 2000 , faqe 28,* 29).
Në vitet e çlirimit të Kosovës, Musa Hoti dhe akti i tij në Bruskel, përveç Naim Malokut do citohet edhe nga shumë autorë të tjerë. Vlen të citohet shkrimi i Ramadan Hazirit, i cili veç tjerash shkruan: " Hilmi Rakovica porositi atdhetarë, më vonë, siç ishte Musa Hoti, një bashkëpunëtor i Hilmiut me ca të tjerë, që të organizonin demonstrata në Tetovë e Gostivar. Dhe ato vërtetë u organizuan. Musa Hoti e ka dëshmuar sa herë këtë porosi të Hilmiut, po as këtë radhë nuk u denoncua. Vallë, mos serbët rastësisht e vranë , dhe kështu u hakmorën para një viti atdhetarin dhe idealistin Musa Hoti! ( *"Imazhi i vëllait në sy të motrës" , 2005, f. 73, autor Ramadan Haziri*).
Po të filloj t'i rendis të gjitha represionet që shërbimet sekrete serbe kanë bërë mbi popullsinë tonë vetëm me rastin e Musa Hotit. Libri do ta humbë rëndësinë e figurës së Musës, vëmendja e lexuesit do të lundrojë herë të Musa e herë të presekutuesit e të tjerëve. Mirëpo është e patejkalueshme të shkruhet një vëllim i tërë e të mos citohen disa raste të tilla kalimthi; raste që ilustrojnë veprimet e UDB-së kundër shqiptarëve dhe plotësojnë imazhin e Musa Hotit.
Vrasja që bëri Musa Hoti nuk ishte e rëndomtë, por, për kohën, momentin ndikoi fuqishëm në çdo shtresë të popullit shqiptar kudo që ata jetonin. Musa nuk ishte njeri i pashkolluar, por kishte kryer

Pedagogjinë në Universitetin e Prishtinës. Ishte intelektual, jo njeri i rrugëve siç thoshte propaganda serbe.

***Musa Hoti dhe prishja***
***e marrëdhënieve diplomatike jugosllavo-belge***

Pas vrasjes së diplomatit jugosllav, në adresë të shtetit belg menjëherë qeveria e Beogradit dërgon një notë proteste duke kritikuar autoritet belge se trupi diplomatik i ambasadës jugosllave nuk po mbrohet nga ekstremistët shqiptarë dhe se ata ndihen tejet të indinjuar që policia belge e njoftoi ambasadorin pas tri orësh vonesë për vrasjen që ishte kryer.
Jugosllavia tërheq ambasadorin Esad Ceriç, duke i dërguar edhe një notë proteste Belgjikës, ku e akuzonte se autoritet belge nuk mbrojnë interesat jugosllave ngase ato ende nuk po e arrestojnë asnjë shqiptar.


4 · LE SOIR 15/7/1981 INFORMATIONS GÉNÉRALES

Après l'attentat de mardi matin, propos amers et critiques à l'ambassade de Yougoslavie

Sans un mot

Amertume à l'ambassade

L'état des victimes

***"Le soir" 15.07.1981 faqe 4***

**Ja një paragraf i nxjerrë nga artikulli i gazetës “Le soir” 15 gusht 1981**

*“Pas atentatit të mëngjesit të së martës*
*deklarata të hidhura dhe kritika nga ambasada jugosllave*

*“... Pyetjes sonë se kush mendoni se e ka bërë atentatin e së martës, në zyrat e ambasadës së Jugosllavisë, nuk japin asnjë përgjigje, sepse “aktit terrorist i takon seksionit të autoriteteve belge të ju përgjigjet e jo ne”. Tregohen tepër të hidhëruar në këtë ambasadë pas këtij atentati, i cili vjen pas gjashtë atentateve të tjera të mëparshme, që u kryen në hapësirën kohore brenda tre muajve të kaluar....*
*Ambasada gjithashtu mendon se shtypi belg u ka bërë jehonë manifestimeve anti-jugosllave, duke iu dhënë kurajo shqiptarëve për akte terroriste”.*

Shërbimi sekret kishte mobilizuar hafijet, jo vetëm në Kosovë, por edhe në diasporë e posaçërisht në Bruksel që të përhapnin dezinformata lidhur me vrasjen që kishte kryer Musa. Për çdo vrasje që kryhej kundër interesave jugosllave ata nuk hezitonin të shkruanin se ishin vrasje për qërim hesapesh mes grupeve dhe grupacioneve shqiptare. Në Belgjikë asnjëherë nuk ka ndodhur vrasje ndërshqiptare deri pas krijimit të LDK-së. Deri pas viteve ‘90 asnjë shqiptar nuk është vrarë mes veti për asnjë lloj grindjeje. Kurrë nuk kanë ekzistuar vrasje për bindje politike deri më formimin e LDK-së, kur në lokalet e klubit “Anton Çeta” plagoset një shqiptar për bindje e grindje politike majtiste e djathtiste.



БЕЛГИЈСКА ШТАМПА НАСТАВЉА СА СВОЈИМ ВЕРЗИЈАМА О УБИСТВУ СТОЈАНА ЂЕРИЋА

# Тероризам - »приватна свађа«!

● И даље се пише да је убиство члана наше амбасаде у Бриселу резултат приватне свађе ● Лист „Ле Соар" наговештава да ће тужилац подићи оптужницу против Хотија „за намерно убиство без предумишљаја"

ВЕЋ више месеци евидентну чињеницу да ескалација антијугословенских активности организованих емигрантских група и групица на територији Белгије представља антијугословенски тероризам, прихватила је, барем терминолошки, коначно и већина белгијских листова. Они су раније бежали и од саме употребе речи „антијугословенски тероризам" и уместо тога белгијски читалац је могао да чита у новинама да је реч о „југословенском тероризму" и „међусобним обрачунима", а било је чак таквих чланака да на крају читалац просто није могао да разазна ко су терористи и убице а ко њихове жртве.

Последњи догађај, пожар у представништву Туристичког савеза, назива се, међутим, у садашњој штампи, антијугословенским непријатељским актом и узима као знак да „тероризам постоји", али како његови починиоци нису откривени, испада да постоји само „начелно"! И за већину озбиљних белгијских листова све остаје у магли.

Јуче је, у првом саслушању пред белгијским истражним органима, Муса Хоти отворено признао да је убио службеника амбасаде СФРЈ, Стојана Ђерића и ранио другог њеног члана Реџу Зуку, који је још на лечењу у бриселској болници. Но читалац у јутрошњој штампи, уместо стварне позадине антијугословенског терористичког акта, може само да нађе тврдњу да ово саслушање „потврђује мишљење истраге „да је реч о „приватној свађи" и убиству у наступу беса, и „без политичке позадине"!

Све се заснива на саслушању Мусе Хотија, док се изјаве других сведока не наводе. За њих је јуче штампа само написала да истрага запажа како „ни једна не садржи егзактну истину". Новине су, уз такво „мишљење истраге" пренеле још и неке детаље из саслушања Мусе Хотија, у правом романсираном стилу. Према тој „верзији" Муса Хоти је пуцао у Ђерића пошто је овај најпре одбио да с њим попије једно понуђено пиће. А потом, пошто је Ђерић понудио пиће, „сви за столом Мусе Хотија су прихватили". „Муса Хоти је остао сам за столом"... „шта га је, onaко већ под гасом разбеснело, напунио је револвер, пришао столу за којим се чуо гласни смех и... у бесу пуцао". Томе се још додаје да је Муса Хоти „патио од нервне депресије", или „био недавно на психијатријском двомесечном лечењу". Као „круна" свега, за антијугословенско терористичко убиство тужилац ће — према писању јутрошњег „Ле Соара", вероватно, подићи оптужницу за „намерно убиство без предумишљаја.

НОВОСТИ ☆ субота, 15. август 1981.

Attentat à la mitraillette à « Yugoslavia » à Bruxelles deux tués, trois blessés

**Artikulli me titull: Terrorizmi- "grindje private"**
**("Novosti" , 15 gusht 1981 )**

## Gazetat serbe vrasjet në Bruksel kundër interesave jugosllave i quanin qërim hesapesh.

Kështu, vetëm disa muaj më vonë, në Bruksel qarkullonin thashetheme se Musa kishte vrarë diplomatin që e kishte patur shok; tjerët thonin se Musa e kishte kryer aktin pasi ishte dehur; disa tjerë nuk ngurruan të flisnin se Beogradi e kishte urdhëruar Musën ta vriste diplomatin në mënyrë që shqiptarët t’i besonin Musës sekrete që UDB-ja të shërbehej me to. Shumë fjalë qarkulluan vetëm e vetëm për ta nënçmuar aktin e guximshëm dhe për ta zhvlerësuar realitetin. Nga këto thashetheme, që përcilleshin shqipfolësit, por që ishin përgatitur nga ekipi special i Beogradit të luftës psikologjike, ata bënin efektin në shumë drejtime. Kështu do ta demoralizonin dhe shkatërronin moralisht Musën dhe familjen e tij. Në anën tjetër do të krijonin konfuzion brenda në popull, duke dyshuar se Musa, jo vetëm ishte frikacak, por edhe njeri që Beogradi e kishte përgatitur, siç do të ndodhte pesëmbëdhjetë më vonë kur flitej se UÇK-ja ishte dorë e zgjatur e Serbisë.
Serbia dëshironte të minimizonte këtë vrasje duke shkruar se Musa ishte njeriu që merrej me prostitucion, drogë etj. Këto gjepura të Serbisë, disa javë më vonë, filluan t’i flisnin edhe disa shqiptarë. Nga një fjalë bëhej e dy e kështu thashethemet filluan të shtoheshin, aqsa thuhej se fëmijët e Musa Hotit ishin rritur në prehër të ambasadorit, që Musa e kishte vra. Flisnin se Musa e kishte vrarë shokun e tij që dita e nata nuk i ndante.
Pse përhapeshin thashethemet? Kush i përhapte këto dezinformata? Pse shpërndaheshin këto dezinformata? Jam përpjekur të gjej një përgjigje logjike e të bindshme, jo për lexuesit, por për vetën time dhe nuk e kam gjetur. Përgjigjet që ia jepja vetvetes më dukeshin të bindshme,por kur flisja më të tjerët, ma shtonin dyshimin në veten time. Asokohe, si edhe tani, mendoj se thashethemet kundër Musës përgatiteshin në Beograd dhe thuheshin përmes shërbëtoreve të tyre. Ata që thonin se Musa e ka pasur shok ambasadorin e Jugosllavisë, pikërisht ata ishin që tërë kohën, para dhe pas vrasjes që e bëri

Musa, ende vazhdonin të rrinin në kontakt me zyrtarët e ambasadës Jugosllvae në Bruksel. Njëri prej tyre që vazhdimisht rrinte në klubin "Përparimi" që ambasada Jugosllve e vizitonte rregullisht, më ndali në rrugë duke më kërkuar të pija një kafe më të. Më të tillët nuk kam biseduar gjatë, por kur njeriu takohet me një shqiptar nuk mund të kaloj pranë tij pa biseduar dy fjalë. Në bisedë e sipër ai filloi të fliste:

**AI**: Reshat, shumë e keni ngritur Musa Hotin.

**UNË**: Vepra e ka ngritur, jo unë dhe askush tjetër!

**AI**: Me e pas njoftë ju Musën qysh e kam njoftë unë, ha,ha,ha, ...

**UNË**: Pse qysh e ke njoftë ti?!

**AI**: Musa Hoti është një pëllëmbë njeri.

**UNË**: Një pëllëmbë njeri e tri pëllëmbë seri, thotë një fjalë e urtë. Edhe Azem Galica thonë se ishte i shkurtë me shtat.

**AI**: Ha, ha,ha. Ti je dreq, nuk të lenë as me fol. Po a e din ti bre se unë vetë e kam pa duke pirë raki në klubin "Përparimi" bash më atë ambasadorin.

**UNË**: E ti çka bëje?

**AI**: Edhe unë pija me ta, bile unë paguejsha!

**UNË**: Ai shok e ti shok, a po?

**AI**: Po!

**UNË**: Ai e vrau shokun e ti ende rrinë me shokët e shokut, a po?

**AI**: Unë s'kam çare, se kam fëmijë!

**UNE**: E Musa dy fëmijët e tij i ka gjet në rrugë? !

**AI**: Jo nuk thash ashtu, por...

Nuk e vazhdova më gjatë bisedën sepse ai e kuptoi se unë nuk imponohesha nga mendimet e tij. Kurrë më ky njeri nuk më ka thirr me pi kafe. Kurrë më unë nuk kisha nevojë ta shtrembëroja rrugën kur e takoja, sepse ai vetë e lakonte rrugën, për t'u mos u takuar me mua. Madje edhe tani kur ai vjen në Kosovë, më qëllon ta shoh në rrugë rastësisht, ai largohet. I njëjti tani u rrëfen të tjerëve se dikur ishte shoku më i ngushtë i Musa Hotit.

Kur Musa iu dorëzua policisë belge kishte vetëm dy vajza, Mimozen dhe Manushaqen. Si çdo shqiptar edhe Musa kishte dëshirë të kishte një pasardhës djalë. Kështu, pas lirimit nga burgu Musa u bë me një

djalë. E pagëzoi me emër Martir. Pas djalit u shtua edhe me një vajzë, që e thërrasin Melisa.



***Musa Hoti dhe bashkëshortja e tij Mevlyde Hoti***

Unë me Enverin bënim shaka me Musën, që djalin e pagëzoi Martir, duke i thënë se pak të duket ty që je martirizuar e po i len telashe edhe djalit me testament që të martirizohet për Kosovën. Musa qeshte dhe shtonte se nëse djali do ta ketë vetëm një dell timin do të martirizohet për Kosovën, po të paraqitet nevoja.

Qëllimi i UDB-së ishte që  Musa nuk duhej të bëhej idol i të rijve kosovarë dhe, për aktin e tij të mos krijohet mit, sepse rrezikohej që rinia të inspirohet nga akte të tilla dhe këto aksione do të përhapeshin në tërë metropolet europiane e sidomos brenda në

Kosovë. Kjo do të ishte katastrofike për Jugosllavinë, e cila nuk do të kishte mundësi t'i kontrollonte dhe t'i kufizonte.
Jeta ka treguar se, kur një popull ndodhet i sunduar dhe i shtohet dhuna sistematike, ai do të kërkojë një rrugëzgjidhje për të ushtruar ndikim te sunduesit për të hequr dorë nga veprimet arbitrare dhe nënshtruese. Prandaj kanë lindur iniciativa nga individë, që për ideale shoqërore a kombëtare kanë vepruar deri në vetësakrifikim. Ata me veprimtari dhe aksione konkrete i janë kundërvënë terrorizmit masiv që autoritetet shtetërore ushtronin mbi një popullsi të tërë. Në këtë vështrim janë motivuar edhe vrasjet e personaliteteve nga sistemi shtypës dhe i dhunës masive. Kjo formulë është e njëjtë për çdo popull, i cili lufton për pavarësinë e tij. Nga iniciatorët e parë të këtyre vrasjeve shpesh ka ndodhë në historinë e njerëzimit që të mobilizohet i tërë populli dhe të vije deri të një luftë e armatosur mes popullit të shtypur dhe sunduesit. Ka raste në histori kur nga atentatet e tilla është marrë edhe preteksti për fillim të luftës Botërore siç është rasti i Sarajevës.

## *Si do të lirohej Musa nga Burgu?*

Pas tri vjetësh Musa Hoti lirohet nga burgu, i pafajshëm, sepse vrasjen e kishte kryer në rrethana vetëmbrojtjeje. Pas daljes nga burgu, Musa do të konfrontohej me fenomenin më të ri që nuk e kishte pritur – diferencimin. Diferencimi ishte një metodë perfide, që kishte përhapur shërbimi sekret i Jugosllavisë dhe me të cilën diaspora e Brukselit për herë të parë po përballej. Diferencimi në diasporë kishte filluar të ngulte rrënjët në heshtje dhe nga thashethemet por jepte rezultate për shtetin jugosllav. Me daljen nga burgu, Musa nuk e gëzonte përkrahjen e të gjithë liderëve të Levizjes edhe pse ai kishte qenë një ndër krerët e Kryesisë së Levizjes. Ndër kontaktet më të mira dhe më të ngushta i kishte mbetur vetëm Sabri Novosella, i cili vazhdonte ta përkrahte Musa Hotin. Liderët tjerë, që mbanin kontakte me disa bashkatdhetarë pasivë të Belgjikës, kundërshtonin që Musa të vazhdonte për të

dhënë kontributin dhe të riaktivizohej në Lëvizje duke nxjerrë si pretekst se Musa ishte i klasifikuar si atentator dhe në Lëvizje nuk duhet të ketë njerëz të tillë, ngase Jugosllavia do akuzonte Lëvizjen si terroriste.
Në kohën e daljes nga burgu, kah fundi i vitit 1983, Lëvizja veç kishte filluar të përçahej. Ndoshta kjo ishte edhe arsyeja që Musa nuk mund të gjente përkrahjen e duhur. Asokohe ishin krijuar dy krahë të Lëvizjes, por lufta mes tyre zhvillohej në heshtje. Më vonë Lëvizja u nda në dysh: në krahun e Sabri Novosellës bënin pjesë Skender Durmishi, Milaim Zeka dhe Musa Hoti; kurse në krahun tjetër: Xhafer Shatri, Ibrahim Kelmendi, Faredin Tafallari etj.
Jashtë këtyre ndarjeve të aktivizuar ishin Enver Hadri, Reshat Sahitaj dhe Gani Azemi, të cilët vendosën që aktivitetin e tyre ta vazhdonin përmes "Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut". Kështu do t'u vinin në ndihmë të dy krahëve të Lëvizjes, kur ata kërkonin ndihmën e komitetit siç edhe ndodhi më vonë.
Komiteti i Enver Hadrit përkrahte iniciativat e Ibrahim Kelmendit për aktivitetin e Lëvizjes se tij në Bruksel, poashtu përkrahte edhe iniciativën e Sabri Novosellës, kur paraqitej nevoja për aktivitetin e tyre në Belgjikë. Komiteti nuk do të refuzonte të ndihmonte as Xhafer Shatrin me Komitetin e tij "SOS Kosova", i cili kishte dalë nga Levizja e krahut të Ibrahim Kelmendit.
Kush i përçau shqiptarët? Sipas të gjitha gjasave këtë e bënë dy shërbimet sekrete, të Serbisë dhe Tiranës. Kjo është vetëm një hipotezë që ndoshta kurrë nuk do vërtetohet apo ndoshta do gjenden fakte e prova se një hipotezë e tillë ishte e mundur. Pas shumë letërkëmbimeve, që unë kisha personalisht me disa nga liderët e asaj kohe në tërë Europën, dhe pas leximit të shumë letrave të Musa Hotit që tani i kam në dispozicion (por që i kam lexuar edhe gjatë kohës sa Musa ishte në burg), kam vërejtur se Tirana ka ndikuar n djeshëm në përçarjen e mërgatës. Harrova të përmend se kur Musa ishte në burg, komunikonim rregullisht përmes letrave që bashkëshortja e tij, m'i sillte kur kthehej nga vizita. Musa kishte një shprehi që përgjigjet e shokëve më të cilët komunikonte të m'i dërgonte mua. Herë më dërgonte një letër që ia kishte dërguar

ndonjërit e herë përgjigjet e tij m'i dërgonte përmes Mevlydës, gruas se tij. Duhet kuptuar se ai m'i dërgonte vetëm ato letra që kishin të bënin me mua apo me çështjen kombëtare. Musa Hoti ishte anëtar i KQ të Lëvizjes dhe kishte autorizim të krijonte celulat e treshit në Bruksel dhe gjetiu. Pra, gjatë letërkëmbimeve mes nesh shtronim problemet me të cilat ballafaqoheshim. Bazuar në ato letra, duket haptas se krerët e Lëvizjes, që asokohe ishin Sabri Novosella, Xhafer Shatri, Ibrahim Kelmendi, Musa Hoti e të tjerë, i tregonin njëri tjetrit se çka ishte biseduar me ambasadorin e Shqipërisë në Paris, në Vjenë apo në Stamboll. Zyrtarët e RS të Shqipërisë i quanin me nofkën "Daja". Sabriu kishte nofkën "Omeri", Musa "Valoni", Xhafer Shatri "Ujkani" e kështu me radhë. Ibrahim Kelmendi nuk di se çfarë nofke kishte, sepse ai asnjëherë nuk më ka shkruar edhe pse unë i kam shkruar për t'i treguar se simpatizantët e tij, që i kishte në Bruksel, më sabotonin aktivitetet e ndryshme që ndërmerrja unë, siç e ceka më heret, orën letrare me Enver Hadrin, Beharen, Ganiun, Muharrem Hajdinin, Ahmet Beken , Zeqir Krasniqin... Unë merresha vetëm më të rijt që vinin nga Kosova. Me ta zhvilloja aktivitete kulturore, që na i sabotonte emigracioni i shqiptarëve të shpërngulur në Turqi e të rishpërngulur në Belgjikë. Pra, në bazë të letrave të Musa Hotit, tani dhe atëherë, konstatoja se shteti amë nuk ishte për bashkimin e shqiptarëve. Qe Serbia pengonte çdo aktivitet tona e dinim të gjithë. Nuk duhej të gjenim fakte se ato ishin kudo. Mirëpo nga Serbia as që pritej që ata të përkrahnin aktivitetet tona.
Unifikimi, që ishte krijuar në mesin e shqiptarëve të diasporës, pa asnjë dyshim e pengonte Jugosllavinë e asaj kohe. Demonstratat që bëheshin në kryeqytetet europiane zbehnin imazhin e Jugosllavisë së Titos, siç shkruante shtypi i huaj. Numri i manifestuesve shkonte duke u rritur, saqë kishte raste kur sheshet e kryeqyteteve skuqeshin nga flamujt kombëtar që valonin ndër duar të shqiptarëve. Aksionet që zhvilloheshin në Bruksel e që jehonë i dha akti i Musa Hotit, poashtu ndikonin në ngritjen dhe forcimin e moralit për qëndresë.
Jugosllavia nuk ishte në gjendje të kontrollonte tërë këtë makineri shqiptare të diasporës që ishte vu në lëvizje. Shërbimi sekret

jugosllav nuk kishte mundësi praktike të afrohej e të zhvillonte bisedime me krerët politikë shqiptarë.
Në këtë kohë, shumica e liderëve politikë të diasporës mbante kontakte të rregullta me personelin e ambasadës shqiptare. Çuditërisht këta nëpunës të ambasadës shqiptare shumicën e takimeve i zhvillonin në katër sy dhe në kafene të kategorisë së fundit ku pas çdo takimi me ta, kosovari dilte i armatosur me një urrejtje të re ndaj shokut me të cilin bashkëpunonte.
Ishin të çuditshme imponimet e tyre për të krijuar bindje tek individët se shoku me të cilin zhvillonin aktivitetin, sipas informatave që kishin këta nëpunës të ambasadës, dilnin njerëz të dyshimtë. E si mund të kundërshtohej diplomati të cilin shteti e kishte ngarkuar që të kontaktonte kosovarët? Si mund të vihej dyshimi se diplomati shqiptar nuk ka të drejtë? Shteti në të cilin kishim mbështetur të gjitha shpresat dhe që përfaqësonte shërbimin sekret nuk mund të imagjinohej nga asnjë kosovar se ata punonin kundër interesave kombëtare. Mjaftonte vetëm një fjalë e tyre dhe njeriu të krijonte bindje për shokun me të cilin kishte vepruar vite të tëra të dyshonte se ai ishte i dërguari i UDB-së.
Nxitjen e dyshimeve mes shokëve e kishte praktikuar edhe vetë shërbimi sekret i Jugosllavisë duke dërguar tek veprimtarët prindërit e tyre. Raste kur prindërve, Sekretariati i Punëve të Brendshme, ua kishte rregullue pasaportat dhe i kishte porositur të flisnin me fëmijët e tyre, janë të shumta. Kjo ishte metoda më efektive e UDB-së për të dërguar porosinë e tyre direkt tek veprimtarët e pathyeshëm.

## *Hapja e radios së parë në gjuhën shqipe “Passe murailles”*

Celulat e para kishin filluar të krijoheshin në Bruksel, por unë nuk doja të krijoja celulën time, sepse asokohe posa e kisha hapur një radio lokale në Bruksel ku jepnim lajme për situatën në Kosovë, lexonim shtypin që na vinte nga Tirana, recitonim poezi dhe muzikë.

Ishte hera e parë në Bruksel që shqiptarët dëgjonin në një lokal një radio në gjuhën shqipe dhe e cila mbeti e hapur deri ne fund të vitit 1982.

Ishte koha, kur Musa Hoti gjendej në burg dhe shkëmbeheshim me letra. Musa më shkruante së në pjesën e Brukselit që quhet XL në rrugën “Chaussée de XL” ishte hapur një radio lokale, e cila dëgjohej edhe nga të burgosurit që vuanin dënimin në burgun e Brukselit. Unë  bëra një takim me themeluesit e radios që quhej “Passe murailles” që në shqip “Kalim matanë mureve”. Në fakt radion e kishte hapur një gazetar i njohur për respektimin e të drejtave të njeriut dhe më qëllim të vetëm që emisionet i dedikoheshin të burgosurve. Gjatë transmetimeve të emisioneve vinin shumë gra, burra e fëmijë, të cilët përshëndesnin të afërmit e tyre në burg dhe ua dedikonin nga një këngë. Ndonjëri i drejtohej të afërmit e tyre në burg për gjendjen familjare e sidomos për fëmijët se ishin rritur, se si fëmija nuk bënte gjumë pa i treguar ndonjë rrëfim për babain që ishte në burg. Me një fjalë ishte radio për të komunikuar me të burgosurit dhe me opinionin e gjerë.

Gjatë bisedës me drejtorin e radios i tregova se në burgun e Brukselit kishte një numër të konsiderueshëm shqiptarësh, të cilët dëshironin të njoftohen lidhur me lajme nga vendi dhe të dëgjojnë muzikë shqip. I thashë se një pjesë e madhe e të burgosurve nuk dinë gjuhen frëngjishte, andaj, po t’u flitej në gjuhen e tyre, ata do t’i kalojnë më lehtë  ditët në burg. Drejtori u pajtua , por më tha të mos bënim politikë. I premtova se nuk do bënim politikë, por do të

jepnim nga pak lajme për situatën në Kosovë. Drejtori dhe stafi drejtues u pajtuan që ne të fillonim emisionin tonë në gjuhen shqipe.
Emisionet tona zgjasnin 25 -30 minuta, dhe emetoheshin në direkt çdo të premte prej orës 16h30. Në radio, përveç meje, lexonte Behare Rexhepi, Qamil Zekolli dhe Ismet Bicaj (tani dëshmor). Kur nga familja e Musës vinte dikush nga Kosova për ta vizituar Musën si, psh, motra e tij Myrvete Hoti, ne e ftonim në emision. Ajo përshëndeste Musën dhe e recitonte një poezi.
Në fakt ky emision, përveç që kishte rëndësi për të burgosurit, poashtu ishte një freski edhe për komunitetin shqiptar që jetonte në Belgjikë, sepse deri atëherë nuk kishte pasur emision në gjuhen shqipe.
Shtypin e Tiranës na e sillte Ismet Bicaj, i cili vazhdimisht insistonte që të lexonim sa më gjatë fjalimet e Enver Hoxhës, apo të ndonjë personaliteti tjetër të rëndësishëm të shtetit shqiptar. Leximet e shpeshta e të gjata të fjalimeve të Komitetit Qendror të Tiranës e pengonin drejtorin e Radios që ishte vendor dhe ai nuk lejonte që të vazhdonim në atë mënyrë. Ismet Bicajn e këshillova se një gjë e tillë tani e tutje nuk është e lejueshme dhe ka gjasa që mundën të na e mbyllin tërësisht emisionin. Ismeti i nervozuar i tha drejtorit të Radios se ishte fashist dhe shumë fjalë të tjera duke e quajtur armik të shqiptarëve. Iu kërcënua se marksizmi i shtetit shqiptar se shpejti do të vërshonte në tërë rruzullin tokësor dhe me kot kapitalizmi dhe borgjezia mundohej ta pengonin. Ismet Bicaj i nervozuar doli nga zyra e tij pa më pritur mua. Pasi mbeta vetë iu luta drejtorit që të mos ia zinte për të madhe, sepse ne shqiptarët jemi të traumatizuar nga torturat dhe vrasjet që po ndodhin në Kosovë, andaj të merrte parasysh se nga vinim dhe çka kishim përjetuar.

## *Rasim Zeneli – gjahu i parë i shërbimit sekret serb në Europë*

Shërbimi Sekret Serb kishte përgatitur kurthe si për palën e djathtë, po ashtu edhe për atë të majtën. I pari që do e përjetonte plumbin e këtij Shërbimit ishte Rasim Zeneli, i cili nga një atentat plagoset rendë (ende sot e kësaj dite ka mbetur invalid i përjetshëm).



Die mörderische Zärtlichkeit der dunkelhaarigen Zorica

***Në foto lart vrasësit e Rasim Zenelit, ndërsa ulur në karrige të invalidëve Rasim Zeneli***

## Kush ishte Rasim Zeneli?

Rasim Zeneli ishte një aktivist i dalluar dhe anëtar i Besëlidhjes Kombëtare Demokratike Shqiptare. Më Rasimin jam takuar vetëm dy herë: herën e parë në një demonstratë në Frankfurt dhe shumë vjet më vonë, pas plagosjes se tij, herën e dytë.
Rasim Zeneli ka lindur më 18 prill 1948 në Sllatinë - komuna e Besianës.
Shaban Zenelaj, babai i tij, Rasimin e dallonte nga gjashtë djemtë, sepse ishte më i vogli prej të tjerëve. Më 1972, Rasimi niset në rrugët e mërgimit ngase asokohe ai kishte probleme me njerëzit e pushtetit. Pas punësimit dhe përmirësimit të kushteve ekonomike,
Rasim Zeneli do t'u ndihmonte edhe bashkatdhetarëve të porsaardhur. Rasimi një shumë të konsiderueshme të mjeteve materiale ia dedikonte organizatës së tij.
Për ta privuar nga jeta Rasim Zenelajn ishte angazhuar një femër serbe që quhej Zorica Aleksiq, e cila ishte punëtore e shërbimit sekret në ambasadën jugosllave në Gjermani. Nuk kam asnjë informatë se si Rasimi kishte hyrë në kontakt me këtë biondinë serbe, që sipas dëshmitarëve më të cilët kam biseduar, thuhej se ishte e bukur dhe ndoshta femër e lehtë për ta shtirë në dorë. Çuditërisht, shumica e shqiptarëve që bashkëpunonin me kroatët, gratë e tyre i kishin serbe. Në biseda me ne, thonin se janë kroate, kurrë nuk më ka interesuar se a ishin kroate apo serbe, por e di se asokohe edhe femrat kroate, që martoheshin me shqiptarë punëtorë, ishin po aq të rrezikshme sa serbet. Kam menduar atëherë dhe tash se Rasimi kishte bërë gabim që kishte krijuar relacione me Zoricën, gjë që jam i bindur se edhe ai e kuptuar.
Mirëpo Rasimi, - thoshte Vehbi Ibrahimi - nuk ka shkuar me ketë femër. Sido që të jetë, Zorica e ka luajtur rolin e saj në mënyrë të përkryer dhe më datën 14 maj 1981, me tetë plumba gjuan në drejtim të Rasim Zenelit, ku katër prej të cilëve ia shkatërrojnë krahun e majtë, ndërsa katër të tjerë ende i ka afër boshtit kurrizor.

Thuhej se Zorica ishte ushtruar në podrumet e ambasadës jugosllave se si të gjuante shënjestrën e saj. Posa e kryen atentatin, Zorica niset në drejtim të aeroportit ku policia gjermane e arreston ende pa e vu këmbën në aeroplanin “Jat”. Po qe se Zorica do arrinte të futej në aeroplanin e kompanisë jugosllave, policia vështirë që do të kishte mundur për ta arrestuar.
Në “Ilustrovana politika” të datës 26 maj 1981 botohen dy faqe me titullin “Kush janë terroristët shqiptarë” dhe se vrasja e Rasim Zenelit ishte një qërim hesapesh në mes partive dhe grupeve politike shqiptare.
Çuditërisht kurrë, asnjëherë as në Kosovën e pavarur nuk u shkrua e nuk u fol për pikën e parë të gjakut të derdhur për Kosovën!!! Çfarëdo që do të shkruante Beogradi kundër Rasim Zenelit është plotësisht e sigurt se ata shpifnin vetëm e vetëm që shqiptarët të mos bashkoheshin dhe përpiqeshin t’i njollosnin të gjithë ata që sinqerisht luftonin sistemin jugosllav. Pjesa tjetër po aq habitëse është se edhe në revistën partiake, së cilës i takonte Rasimi dhe e financonte, shkruan aq pak për të, sikur ngjarja të kishte ndodhur në Tibet. Në atë revistë shkruhej dhe lavdërohej partia dhe se si UDB-ja e ka “halë në sy partinë” e jo Rasimin që po e derdhte gjakun për Kosovën. Plagosja e Rasimit përdorej për t’u ngritur kulti i individit, në këtë rast i shefit të partisë, ndërsa Rasimi trajtohej si një viktimë besnike e tij dhe e partisë. Absurditet!

***Kush ishte Hysen Karalia ?***



Hysen Karalia ishte një djalë biond i bukur dhe i hajthëm. Në qendër të Brukselit në *Rue Progres* kishte hapur një lokal ku shërbente ushqime të shpejta. Kur nuk kishte klientë, ne: Qamil Zekolli, unë dhe vëllai i tij, Rexhë Karalia e kalonim kohën duke biseduar rreth çështjes kombëtare. Bisedonim dhe shpesh zhgënjeheshim pse ne shqiptarët nuk po hakmerreshim ndaj serbëve, kur ata po vrisnin djalërinë kosovare.

- Nëse e vras një serb, a do më këndoni në këngë?! – më pyeti një ditë Hysen Karaliu.
- Unë nuk di me shkrua tekst për këngë e as poezi, por nëse dikush i shkruan unë di të recitoj e publikun e bëj të derdhë lot për ty.
- Qysh jo more, Fadil Hoxhës po i këndojnë këngë hiç pa e vra asnjë shka! – ndërhyni Qamil Zekolli dhe ia filloi disa vargje të këngës për Fadilin në kal t'bardhë.

- Jo bre Hysen, me një shaka nuk hyn në këngë! A e ke pa sa shkije i ka vra Miftar Hasani deri sa ka hy në këngë! – i tha Rexha, vëllai i tij.
- Aiii po larg e çove, po ku me i gjet unë aq shkije në Bruksel. Veç naj luftë nëse bahet e me shkue në Kosovë, se këtu kurrë nuk mundem t’i vras aq! – u përgjigj Hyseni.
- Hajt bre vëllau jem, vraje nja se të del sa të duash. Një serb në Bruksel është sa me i vra dhjetë në Kosovë! – tha Rexha.
- A qesim short, e cilit t’i bie shorti,ai i pari ka me e vra një shka?! – tha Qamili.
- Qesim! – njëzëri thamë të gjithë, madje edhe Aliu, i cili nuk e kishte një dorë.

Ndoshta kjo bisedë as që është bërë ndonjëherë, sepse tash pas plot dyzet vjetëve nuk më kujtohet asgjë. Dyzet vjet më vonë gjërat mjegullohen dhe tretën për dike, por për ndonjë tjetër duken se kanë ngjarë dje.

Sido që të jetë pas serisë së atentateve që bëheshin në Bruksel, ne herë pas here takoheshim në lokalin e Hysenit, dhe një ditë, derisa po bisedonim, shihej se Hyseni dukej i nervozuar dhe nuk po e zinte vendi vend.

Krejt shqiptarët e vrajtën nga një shka, e na po flasim e tjerët po punojnë. Unë, jam burgosë në shitoren time.

- Ti edhe pare edhe patriot, të dyjat nuk shkojnë!- i tha Qamili.
- A po mendon se ata vijnë te ti, si në gojë të hutit, a?! – i thash unë.
- Aty e kisha fjalën, këtu si në burg! – u përgjigj Hyseni.

## *Hakmarrja për babain dhe për të gjithë shqiptarët*

Vetëm pak muaj më vonë gjatë një mbrëmjeje, ndërsa Hyseni po u shërbente disa klientëve vendor, në lokalin e tij hyjnë dy serbë. Hyseni i pyet në gjuhën frënge se çka dëshirojnë, ata i përgjigjën në gjuhën serbe se po kërkonin të hanin kokë shqiptari. Hyseni me

gjakftohtësi e nxjerr revolen që gjithnjë e mbante në tavolinë ku i kishte paratë dhe e shikon Aliun që ishte afër, por që serbët nuk e dinin se Aliu ishte shqiptar. Aliu e kupton se ç'kishte ndërmend të bënte Hyseni, andaj largohet pak mbrapa për t'ia liruar vendin Hysenit, i cili del nga vendi prej nga shërbente dhe me revole i vret të dy serbët. Aliu që ishte në vendin e ngjarjes na rrëfente se si dy serbët bërtisnin dhe gjëmonin duke dhënë frymën e fundit dhe se si Hyseni ua kishte shkelur gjakun e tyre duke i mallkuar ata dhe në fund u kishte thënë se po ua shkelte gjakun, sepse babanë e tij serbët e kishin torturuar dhe kështu kishin vepruar. Hyseni ndjente një lehtësim që më në fund ishte hakmarrë për gjakun e babait dhe për gjakun e tërë shqiptarëve, që serbët po vrisnin në Kosovë.

Për këtë Hyseni do të arrestohet, por nuk do të dënohet pasi aktin e kishte kryer në lokalin e tij dhe se ai e kishte bërë në vetëmbrojtje. Lokali përsëri do të hapej dhe përsëri serbët do të tentonin të kërkonin kokë shqiptari për të ngrënë në të njëjtin vend. Është absurde të imagjinohet se si ishte e mundur që serbët të ktheheshin për t'u hakmarrë për serbët e tjerë të vrarë.

Historia do të përsëritet disa muaj më vonë në rrethana të njëjta, por me personazhe të tjerë. Ndërkohë që Hyseni gjendej në burg, lokalin ia kishte lëshuar me qira një shqiptari, i cili posa kishte ardhur ne Belgjikë. Ky djalosh ishte ende pa u paraqitur në Komisariatin për refugjatë politikë. Serbët do të vriteshin njëlloj sikur shokët e tyre para disa muajve, mirëpo kësaj radhe në lokal thuhej se nuk kishte asnjë dëshmitar vendor, siç kishte në rastin e Hysenit. Vrasësi kishte lënë viktimën në dysheme dhe menjëherë erdhi në banesën time.

- Ku e ke revolen, - e pyeti Beharja?!
- Nuk e di, e kam gjuajtur?! – u përgjigj i mbushur frymë.
- Afër vendit të ngjarjes?! – e pyeti Beharja.
- Jo e kam gjuajtur diku, jo larg vendit të ngjarjes, në bar.

Ai tregoi përafërsisht vendin ku e kishte gjuajtur revolen. Po që se revolja gjendej nga policia miku që e kreu atentatin do të dënohej në bazë të shenjave të gishtave.

Banesa ishte një kilometër larg lokalit, ndërsa vendi ku ishte gjuajtur revolja ishte në mes banesës dhe lokalit. Njeriu i cili e kishte kryer

vrasjen u kthye në Kosovë, u angazhua në radhët e UÇK-së dhe pas plagosjes së rëndë, në konfrontim mes forcave serbe, një javë më vonë, në fund të marsit 1999 vdes.
Në vend të vrasësit tani policia e kërkonte Rexhën, vëllain e Hysenit. Ambasada e Jugosllavisë kishte bërë presion që të burgosej Rexha, i cili ishte në Nju Jork.
Rexha kishte shkuar në Amerikë dy-tre muaj para se të ndodhte ngjarja dhe asgjë nuk kishte të bënte me vrasjen. Shteti belg e solli Rexhën në Bruksel ku gjyqi e liroi si të pafajshëm. Hyseni dhe Rexha janë histori në vete dhe duhet të shkruhet një libër e tërë. Në këtë rast i përmenda vetëm përciptazi për ta treguar vendosmërinë e shqiptarëve që jetonin në Belgjikë, e sidomos të këtyre dy vëllezërve të pathyeshëm.

## *Vrasja e Jusufit dhe e Vehbiut...*

Koordinimi i aktiviteteve shqiptare, edhe pse jo publik, do ta shqetësonte Serbinë, sepse në mes grupimeve ekstreme e jo ekstreme u instalua një qetësi, saqë aktivistët e dalluar merrnin pjesë në demonstrata të njërës palë. Një shembull. Kur Vehbi Ibrahimi do të shkonte në Gjenevë në një demonstratë që e organizonte Jusuf Gërvalla, me ç’rast Vehbi Ibrahimi bashkë me demonstruesit “marksistë” do t’ia thyente aparatin një gazetari apo spiuni serb që i fotografonte.
Madje, më 18 shtator të vitit 1981, në orën 22 e 30 minuta Vehbi Ibrahimi kishte arritur në fshatin Undergrubenbache të Gjermanisë te banesa e Jusuf Gërvallës, për të biseduar për çështjen kombëtare. Asnjërit nga të dy dëshmorët e ardhshëm nuk i shkonte ndërmend se i pari do të binte në fushën e nderit vetëm 22 ditë pas këtij takimi, kurse i dyti tre muaj më vonë. Asnjëri nga dy martirët e ardhshëm, që jetën ia kishin falur vetëm çështjes së shenjtë kombëtare, nuk po e dinte se Beogradi kishte përgatitur atentatin kundër tyre.

## *Rënia e ndikimit të së djathtës në Europë*

Demonstratat e organizuara nga djathtistët e diasporës dalëngadalë po pakësoheshin si pjesëmarrje. Kjo, për shumë faktorë, por më e rëndësishme ishte se për këto demonstrata shtypi i Tiranës po heshtte sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Zyrtarët e ambasadës Shqiptare nga Parisi e Vjena po i kontaktonin besnikët e tyre dhe po u thoshin se demonstratat tona ishin armiqësore ndaj nuk duhej të merrnin pjesë në to. Këta zyrtarë na kontaktonin edhe ne të tjerëve, dhe në biseda të tyre fillonin të na flisnin kundër organizimeve majtiste.

Në anën tjetër, organizimet e demonstratave që i bënte Jusuf Gërvalla ishin masive dhe mediat e Tiranës, sidomos Radio-Tirana gjerësisht raportonte për to. Faktori tjetër që i ndihmonte dobësimit të organizimeve tona ishte se shtypi i Beogradit që këto i cilësonte nacionaliste, zogiste, reaksionare dhe organizatorët shpesh i ngatërronte qëllimisht me njerëz hajna e të droguar. Kjo propagandë mediale e dyanshme, por shumë e përafërt mes vete, ndikuan që masa e jonë të dobësohej, por jo aq sa të mos organizonim asgjë.

Pa dallim se si shkonin zhvillimet e propagandave tona e të huaja ne vazhdonim të shkonim në demonstrata të majtistëve, sepse ne mendonim se kudo që merrnim pjesë e shtonim një numër më shumë.

Lëvizja gjithnjë e më shumë shkonte duke i zgjeruar degët e saj në tërë diasporën shqiptare e po ashtu edhe në Belgjikë.

Vehbi Ibrahimi ishte ndër njerëzit më besnikë të Hysen Terpezës dhe, sa herë që Hysen Terpeza i vizitonte shqiptarët e Belgjikës, shoqërohej dhe qëndronte në shtëpinë e Vehbiut në *Rue Floriste* nr. 21. Vehbiu kishte dëshirë që Hysen Terpezën ta njoftonte jo vetëm me aktivistët e moshuar, por edhe me të ardhurit e ri. Një ditë më tha të përgatisja një darkë se Hysen Terpeza do të vinte atë natë të unë. Në atë darkë ishte Gani Azemi, Sokol Terlaku dhe Vehbi Ibrahimi. Deri në orët e hershme të mëngjesit qëndruam duke biseduar për situatën në Kosovë.

Vehbi Ibrahimi shpesh kishte marrë kërcënime për vrasjen e tij dhe atë natë tregonte se si i vinin letra anonime dhe se si telefoni i cingëronte në orën një pas mesnate. Kur lajmërohesha, thoshte, dëgjoja vetëm një lloj gërrhame që mund ta dëgjojmë kur njeriu është duke dhënë frymën e fundit e pastaj lëshonin këngë serbisht. Pasi rrëfente i shante ata qe e kishin shqetësuar dhe tërë Serbinë.
Vehbiu e dinte se pa viktima Kosova nuk mund të çlirohej. E dinte Vehbiu se UDB-ja nuk kërcënonte kot dhe se një ditë do të vritej prej tyre. Vehbiu njëherë ishte betuar se jetën ia kishte falë Kosovës; njëherë kishte dhënë betimin dhe më nuk kishte forcë ta kthente prapa. Kërcënimet anonime dhe direkt të Selim Broshës, jo vetëm që nuk e frikësonin, por e forconin edhe më shumë në luftën e tij të drejtë për çlirimin e tokave shqiptare.
Vrasjet e përfaqësuesve serbë për Vehbiun tanimë qenë bërë një rutinë. Ai kishte plane të tjera. Që ta gjunjëzonte politikën hegjemoniste serbojugosllave, Vehbiu kishte paguar ekspertët më të njohur belgë të armëve bakteriologjike. Vehbiu dërgoi në Beograd dhe Kralevë ekspertët për të siguruar planin e ujësjellësit të këtyre dy qyteteve. Pasi bënë të gjitha analizat e planit, studiuan mundësinë dhe formën që një sasi e kësaj arme të lëshohej në fillim në shpërndarjen e ujësjellësit te Kralevës dhe tjetra të vihej në atë të Beogradit. Pasi që arma bakteriologjike të kryente efektin e vet, Vehbiu dëshironte që ta urdhëronte Beogradin për tërheqjen e forcave të armatosura nga Kosova.
Këto që po i shpalosi, dikush nga Gjermania që hiqej se bashkëpunonte me Vehbiun, por në fakt shumë gjëra për veprimtarinë e Vehbiut nuk i ka pasur të njohura, për shkak të largësisë gjeografike, ndoshta, dhe ky individ edhe sot mund të ketë mendim se unë po bëjë gabim që shkruaj për këto të vërteta, sepse sipas tij Vehbiu po paraqitet si terrorist. Ky plan, Vehbi Ibrahimit i është konfiskuar nga policia belge e antiterrorizmit dhe gjendet në dosje të tij. Për këtë Vehbi Ibrahimi edhe ishte arrestuar në Bruksel. Unë nuk po shtoj asgjë më shumë se sa vetë Vehbiu ka deklaruar në shtypin kryesor belg. Pas çdo atentati që kryhej në Bruksel, policia e merrte në biseda informative Vehbiun, e jo ata që tani krekosen se

ishin shokë e larg tij. Vehbiu deklaronte se pasi që ne nuk kemi forcë e armatim ushtarak për një luftë ballë për ballë, mënyra e armës bakteriologjike do ta shtrinte për tokë Serbinë. Por a ishte vetëm Vehbi Ibrahimi që kishte plane të tilla?! Jo! Luftëtari i lirisë kur e sheh se po i digjet populli, po i vriten foshnjat, e nuk po ka mundësi t'i mbrojë, ai nuk do t'i zgjedh mjetet e as metodat për ta larguar armikun. Jemi dëshmitarë të masakrave të fundit që forcat serbe bënë mbi popullsinë tonë. Secili prej jush ka dëgjuar rastin kur policia e detyron nënën që beben e saj ta fusë në ujë të përvëluar. Nëse ju nuk keni dëgjuar, kjo nënë ende është gjallë dhe jeton në Kosovë. Kjo nënë, ujin e fëmijës të saj të përvëluar ua hedh syve policisë dhe shpëton. Të tillët që thonë se nuk duhet të shkruhet për planin e Vehbiut, mendoj se luftën e tyre e kanë pasur me hile, dhe tani mund të flasin. Mirëpo plane të ngjashme kanë imagjinuar dhe janë përpjekur t'i bëjnë edhe disa të tjerë. Njeri prej tyre tani është personalitet politik ndër shtatë më të njohurit në qeverinë tonë. Ai kishte planifikuar që në stadiumin e Beogradit të hidhej një armë tjetër biologjike. Ata që kanë dëshiruar ta çlirojnë Kosovën kanë menduar kështu e ata që kanë menduar të hyjnë në luftë për t'i spiunuar apo për të përfituar nga lufta kanë menduar ndryshe.

## *Vrasja e Vehbi Ibrahimit, 10 tetor 1981*

E shtunë, 10 tetor 1981. Vehbiu atë ditë, - siç rrëfen gruaja e tij, - ishte zgjuar më herët se ditëve të tjera. E kishte futur revolen në brez dhe po përgatitej ta përfundonte një punë të vogël të derës kryesore të shtëpisë së tij, e cila nuk po u mbyllej lehtë. Për ta mbyllur duhej shtyrë shumë. Nga kati i sipërm zbret miku i tij, që banonte te Vehbiu troket në derën e sallonit, kur Vehbiu bëhej gati të punonte. Ai e pyet Vehbiun, nëse mund t'ia huazonte revolen se sot ai e kishte një punë që pa revole nuk mund të shkonte. Vehbiu e kishte pyetur nëse ka nevojë do shkonte me të për t'i ndihmuar, por ai ishte

përgjigjur se vetë do e kryente. Vehbiu i jep revolen dhe zbret në katin përdhesë për ta rregulluar derën.
Ndërsa po rregullonte derën e hyrjes kryesore të shtëpisë, gruaja e tij po pastronte tepihun në korridor krejt afër burrit, një i panjohur kërkon nga Vehbiu që të shkonte në katin e tretë se e kishte një shok që banonte në shtëpi të Vehbiut. Pasi Vehbiu e pyet si quhet, sepse të gjithë banorët ishin të njohur për të, i huaji ia thotë një emër, por Vehbiu edhe pse i tregon se një emër si ai nuk banonte, ia hap derën dhe ai ngjitet lart. Pas pak sekondash Vehbiu e vëren se i huaji u kthye dhe e pyet:

- A e gjete atë shokun tënd?!
- Po, ty të kërkova e ty të gjeta! – i përgjigjet prej mesit te shkallëve të katit të parë.

I huaji në katin e parë e kishte rregulluar revolen duke ia futur plumbin në grykë dhe tani pasi gjendej përballë Vehbiut, tre-katër metra më lart se Vehbiu, ia drejton revolen në ballë dhe e qëllon me dy plumba. Në ndërkohë Vehbiu i pa armatosur në ato sekonda e sheh para tij një karrige, e merr dhe e vë para kokës se tij por çdo gjë ishte vonë.
Gruaja e Vehbiut, që ishte pak metra më larg,bërtiste dhe kërkonte ndihmë për burrin. Atentatori shtinë mbi gruan dhe e plagos rëndë dhe kthehet edhe një herë që dy plumbat e fundit t'i zbrazë mbi trupin e Vehbiut tanimë të pajetë.
Gjaku i Vehbi Ibrahimit në qendër të metropolit politik të Europës ishte gjaku i parë që po derdhej për lirinë e Kosovës. Vrasja e Vehbi Ibrahimit në qendër të Brukselit ishte viktima e parë dhe atentati i parë politik për diasporën shqiptare. Vehbi Ibrahimi nuk kishte çka t'i dhuronte më shumë Atdheut veç se edhe pikën e fundit të gjakut, pikërisht ashtu siç ishte betuar me Metush Krasniqin.
Vehbi Ibrahimi u dha shembull se si duhet të vdiset për Kosovë edhe ushtarëve të tij që i kishte përgatitur gjatë jetës në mërgim.

Shtypi belg do t’i kushtonte rëndësi vrasjes së Vehbiut. Në faqet e shtypit të botimit të së hënës, 12 tetor, do të hasim në tituj të ndryshëm. Po veçojmë njërin prej tyre me këtë titull:

## Kush është në radhë ?



LE CHABANAIS ALBANAIS

**A qui le tour ?**

**• Six coups de feu dans une cage d'escalier, l'autre samedi à Bruxelles. Un meurtre froidement exécuté : celui de Vehbi Ibrahimi, 43 ans, numéro deux de la Ligue Démocratique Albanaise, une organisation de nationalistes albanais originaires de la région du Kosovo (Yougoslavie). Sa liquidation n'est certainement pas la dernière mort de la série noire qui a déjà fait trois victimes en cinq mois, rien qu'à Bruxelles. C'est en effet surtout chez nous que se règlent actuellement, de manière violente, les séquelles des troubles sanglants qui ont agité le Kosovo au printemps dernier.**

DEPUIS ces événements, et la répression féroce qui a suivi (des centaines d'années de prison ont été infligées), Bruxelles et surtout Schaerbeek voient arriver chaque semaine des autocars entiers en provenance de cette région de Yougoslavie, dont les trois quarts des habitants sont d'origine albanaise. Ils sont déjà ici une dizaine de milliers, dont près de la moitié Albanais de Yougoslavie. Autant dire que s'amasse peu à peu à Bruxelles un énorme potentiel de haine vis-à-vis de l'« oppresseur » yougoslave et que, la tradition de la vengeance aidant, il n'y a pas de raison que ça cesse. La balle, si on ose dire, est à présent dans le camp des Albanais anti-yougoslaves...

**Le pourrissement du régime est inéluctable**

Car pour ceux-ci, sans aucun doute, ce sont les « barbouzes » des services secrets de Belgrade qui ont liquidé Ibrahimi.

Une seule « preuve » leur suffit : son nom était régulièrement cité par Politika Express, un journal yougoslave, qui voyait en lui un des « terroristes fascistes » ayant commis les attentats de l'été dernier contre les locaux des organisations culturelles yougoslaves en Belgique. Et selon certaines informations, c'est en Allemagne que pourraient être portés les prochains coups contre certains opposants à Belgrade d'origine albanaise. Comme d'habitude en pareil cas, les rumeurs les plus folles circulent...



**Vehbi Ibrahimi, comme tous les exilés, gardait religieusement intactes les traditions de la terre natale.**

32

Ja përkthimi integral i këtij artikulli:

## *Kush është në radhë?*

*"Gjashtë plumba nga shkallët e korridorit të shtëpisë, të shtunën në Bruksel. Një vrasje e kryer me gjakftohtësi; gjashtë plumba mbi trupin e Vehbi Ibrahimit, 43 vjeçar, numri dy i Lidhjes Demokratike Shqiptare, një organizatë e nacionalistëve shqiptarë, me origjinë nga regjioni i Kosovës (Jugosllavia). Likuidimi i tij, sigurisht që nuk do të vdekja e fundit nga seria e zezë ku brenda këtyre pesë muajve pati tre të vdekur vetëm në Bruksel. Në fakt këtu tek ne po i rregullojnë hesapet në mënyrën të dhunshme, për shkak të turbullirave që kanë ndodhë në pranverën e fundit.*
*Qe një prej këtyre ngjarjeve,represion i të egër (të burgosur që dënimet e tyre të mbledhura bashkë shkojnë në disa qindra vjet)! Brukseli, e kryesisht Skarbegu sheh çdo javë autobusë që vijnë nga Kosova e që sjellin shqiptarë. Tani në këtë lagje janë ¾ banorë shqiptarë, disa dhjetëra e mijëra, të cilët gjysma e tyre janë nga Kosova. Duhet theksuar se pak nga pak po mblidhet një urrejtje potenciale e shqiptarëve ndaj okupuesit jugosllav dhe se traditat e hakmarrjes u ndihmojnë dhe nuk ka asnjë arsyeje që kjo të ndalët. Tani topi është në fushën e shqiptarëve- nëse guxoj të them kështu.*
*Prishja e sistemit e paevitueshme, sepse e dinë shqiptarët që Vehbi Ibrahimin e ka vrarë shërbimi sekret i Beogradit. Vetëm një provë e vogël është e mjaftueshme: emri i Vehbi Ibrahimit është cituar rregullisht në "Expres Politika", një gazetë jugosllave, që në Vehbiun e merrte si "terrorist fashist", i cili kishte kryer disa atentate kundër shoqatave kulturore jugosllave në Belgjikë, e sipas disa informatave atentati i ardhshëm pritet të ndodh në Gjermani, për t'i dhënë një grusht të rëndë opozitës shqiptare. Si zakonisht në situata të tilla thashethemet qarkullojnë... "*



LE SOIR

LUNDI 12 OCTOBRE 1981

*Représailles de l'U.D.B.A. yougoslave ?*

**Un nationaliste albanais, originaire du Kosovo, et son épouse abattus en rentrant chez eux à Bruxelles**

Abattus à bout portant

Vice-président du groupement de « ceux qui sont restés fidèles »

Les similitudes entre les diverses liquidations

FRANKFURTER STADT-RUNDSCHAU

**Bereits fünf Verdächtige**

Im Mordfall Zeneli

Jugoslawien verfolgt einen Exil-Albaner

**„Auf der Mordliste des Geheimdienstes"**

Unter falschem Namen im Kreisgebiet / Kontakt zu den Unruhen um Kosovo / Starb Tito früher?

NWZ GÖPPINGER KREISNACHRICHTEN

***Gazeta "Le soir" mbi vrasjen e Vehbi Ibrahimit***

Po që se i bëhet një analizë sipërfaqësore këtij artikulli do të vëreni se ai ka një përmbajtje shumë më të gjerë se ç'është shkruar nëse lexohen nënrreshtat. Përmes këtij artikulli do të vëreni se Belgjika i ka përkrahur shqiptarët dhe e ka dënuar represionin serb që ushtronte kundër popullsisë shqiptare. Ne, që kemi jetuar atje dhe

kemi qenë të kyçur në aktivitete e dimë përkrahjen që na bëhej, por edhe ata që nuk kanë qenë mund ta vërejnë se si Musa Hotin e liruan të pafajshëm vetëm për tri vjet, Hysen Karaliun as që e kanë dënuar, për disa atentate të tjera as që janë kapur akterët. Në artikull shkruhet për shpërnguljet e shqiptarëve të shtyrë nga represioni i forcave serbe. Para se të vritej Vehbiu kishte disa serbë që shkuan në arkivole nga Brukseli në Beograd, dhe tash në artikull thuhet se rendin e kanë shqiptarët të vrasin, sepse e kanë grumbulluar urrejtjen ndaj sistemit të kalbur të okupuesit serb. Në fund të artikullit gazetari u jep një porosi shqiptarëve, që askush kurrë nuk e ka marrë seriozisht. Porosia e tij në fjalinë e fundit ishte se Serbia shumë shpejt shqiptarëve do t'u jepte një grusht të rendë, me një vrasje që do të bëhet në Gjermani. Dhe, pikërisht, më 17 janar 1982 vriten Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi. **(Kopja e gaz. doc/0032/8209/ark.B.I.K.)**

## *Varrimi i Vehbiut me 17 tetor 1981*

Atë ditë mbajti kohë me shi. Kortezhi u ndal para dyerve të ambasadës jugosllave dhe në lëshonim parulla kundër ambasadës dhe Serbisë, duke i akuzuar se po na vrisnin në Kosovë e tash edhe në Bruksel. I quanim vrasës. Ne, disa më të rinj që kishim kaluar shumë kohë me Vehbiun, qanim dhe hidhnim parullën "Jugosllavia vrasëse!". Vdekja e Vehbi Ibrahimit me preku thellë në shpirt dhe nuk e ndalja dot lotin.
Pasi policia belge nuk na lejonte të qëndronim më gjatë para ambasadës jugosllave, kortezhi vazhdojë drejt varrezave.



***Pamje nga varrimi i Vehbi Ibrahimit, 17 tetor 1981. Ahmet Bajraktari me flamur, (në mes babai i Vehbiut ), Reshat Sahitaj dhe Gani Azemi...***

## *Betimi*

Varrimi i Vehbiut u bë në varrezat e Skarbegut në Bruksel, ku morën pjesë mijëra bashkatdhetarë edhe nga Gjermania, edhe vendet e tjera. Shiu nuk kishte të ndalur. U vendos që asnjëri prej nesh të mos mbante fjalime sepse të pranishmit që ishin me qindra, ishin të lodhur e të lagur gjer në palcë. Disa prej nesh me sy të përlotur u betuam para kufomës së Vehbiut se do të hakmerremi. U vendos që fjalimet mund të mbaheshin në lokalet e xhamisë, dhe një pjesë e madhe u tubuan në xhami, ku përveç Emil Kastriotit foli Idriz Basha, Rifat Kolgjini, Gani Azemi dhe unë shkurtimisht.

Vetëm pak minuta pasi po shpërndaheshim disa filluan të na akuzonin, mua dhe Ganiun, se betimi ynë ishte i pavend dhe destruktiv.

Kishte të atillë që nuk morën pjesë në varrim dhe me dukej se kishin ndjenjën se ishin çliruar nga një barrë, sikur mendonin se e vranë një

kundërshtar të tyre e jo kundërshtarin e armikut. Vehbiu nuk ishte kundërshtar i askujt, madje kurrë nuk kërkonte të dilte në skenë për fjalime që të dukej para popullit. Aty ku të tjerët guxonin të dilnin, si në fjalime e mbledhje të ndryshme, Vehbiu nuk fliste shumë, po aty ku pakkush guxonte ai nuk frikësohej. Ai nuk frikësohej prej gazetarëve belgë kur e pyesnin se kush e kishte kryer atentatin kundër ambasadës jugosllave. Jo. Çdo atentat e merrte përsipër me plot vetëdije se një ditë mund të vritej.
Lidhur me vrasjen e Vehbi Ibrahimit unë pretendoja të bëja një film dokumentar për jetën ,veprën dhe vrasjen e tij, por aso kohe nuk më lejonin kushtet ekonomike. Më vonë me përkrahjen materiale të Emil Kastriotit e realizova filmin dokumentar 30mn të titulluar "ATDHEU MBI TË GJITHA"; kurse në vitin 2004 në bashkëpunim me Mon Beqirin u realizua një film dokumentar mbi jetën dhe veprën e Vehbiut për televizion RTK, duke u shërbyer nga sekuenca të ndryshme të filmit tim të realizuar shumë vite më parë.

## *Vranë Jusuf Gërvallën!*

Me 18 janar, kah mbrëmja, në banesën ku banoja ilegalisht, hyni Enver Hadri. Nga pamja e tij e kuptova se diçka nuk ishte në rregull. Menjëherë më shkoj mendja se mos kishte informata nga polica se ata e kishin hetuar banesën time ilegale.

- Mos ke marrë vesh se do të më dërgojnë në Kosovë?! – e pyeta i shqetësuar.
- Jo për atë mos ke frikë. Thanë se mbrëmë e kanë vra Jusuf Gërvallën, - foli ngadalë dhe ra në heshtje.

Për një çast mu errësuan sytë dhe u mbështeta për muri. Nuk e nxora asnjë fjalë. Nuk kisha çka të flisja, sepse çdo fjalë më ishte tretur e mendimet me fluturuan larg në Kosovë duke i sjellë ndërmend bisedat në Prishtinë dhe takimin e fundit në Gjermani ku ai pas recitimit tim ia mori këngës. Nuk dija se më rridhnin lotët në prani të Enverit, nuk shihja asgjë e askënd. Në imagjinatën time parakalonte fytyra e buzëqeshur e Jusufit dhe asgjë tjetër. Nuk mund

ta imagjinoja se ai ishte vra. Me dukej absurde. Nuk më kujtohet sa minuta apo sa orë kishte qëndruar Enveri të unë. Nuk di as nëse kisha biseduar diçka më të, por e di se atë natë nuk bëra gjumë.
Ditën kur bashkatdhetarët tanë nga Brukseli po shkonin të organizuar në varrimin e Jusufit, erdh Sokol Terlaku të më merrte për të shkuar ne Gjermani. Isha ilegal pa asnjë dokument. Kishte rrezik të më kapnin dhe të më dërgonin në Kosovë. Që në fillim sqarova se unë dhe Musa Hoti ishim pa dokumente deri më 1985.
Njeri i tretë me radhë po shkonte për të mos u takuar kurrë më as në ëndrra. Çuditërisht as prindërit që më vdiqën, as vëllai, as shokët deri në këto çaste nuk i kam ëndërruar kurrë. Pse?! Nuk e di! Ndoshta nga se flas e shkruaj për veprimtarinë e tyre, jetoj duke biseduar me ta dhe për ta. Më ndodh që në ëndrra të më paraqitën disa që kurrë nuk i kam dashur e jo ata që i dua dhe i kam dashur. Tërë kohën, sa kam jetuar në Bruksel, ëndrrat e mia ishin gati të njëjta. Kurrë nuk kam ëndërruar se jam në Bruksel. E pa besueshme për ju, por e përjetuar realisht nga unë. Se ne nuk e ëndërronim kurrë Belgjikën - më kishte treguar edhe Musa Hoti pas shumë vitesh në Kosovën e çliruar, kur banoi për disa ditë në banesën time në Taslixhe.
Ëndrrat e mia më dërgonin në Kosovë dhe atje zhvillohej rrëfimi i tyre. Ëndërroja lagje të panjohura të Prishtinës, të fshatit tim të.... Gjithnjë ëndërroja se policia serbe e kishin rrethuar lagjen dhe me kërkonin të më kapnin të gjallë. Unë vrapoja, ikja dhe u shpëtoja. Edhe sot pas dyzet vjetësh përsëri ëndërroj se si policia serbe me ndjek. Në fakt kurrë nuk jam frikësuar se policia serbe mund të më kap të gjallë. Kurrë! Gjithnjë kam menduar se plumbi nuk me merr. Dhe nuk do vdes pa e plagosur ose vrarë edhe unë atë që tenton të më vrasë. Ashtu mendoja kur isha i ri, tani pak më ndryshe.

## *Musa Hoti  anëtar i KQ të Lëvizjes*

Musa Hoti, pas atentatit që kishte bërë në trupin diplomatik të ambasadës jugosllave, nga burgu (apo siç na shkruante ai “nga

kulla”), mbante lidhje me Sabri Novosellën dhe anëtarët e Kryesisë së Lëvizjes. Si u kyç Musa në Lëvizje dhe kur, për mua është e panjohur. Ndoshta ishte ende paraaterntatit apo ndoshta më pas. Ekzsiton mundësia të ishte më herët, por duke e njohur mentalitetin tonë ma merr mendja se Musa është kyçur pas veprës së tij të guximshme..

-2-

me Organ qëndror "Zëri i Kosovës" numri i parë ka dalë. Së shpejti do të i shkoj Ilinojës e Ajo beroj se ta bjen tye.

Në qoftë se e shef të arsyeshme dhe e aprovon Komunikatën që është botuar në këtë numër. Betohu para ndërgjegjjes tënde e para mureve të qelisë së burgut, (gjë që nuk është rast i rrallë të bëhen betime para mureve të tilla, që djalërit me të mirë të popullit tonë i bajn shoqëri e në to, me gjakun e tyre të pastër shënohen fjalët që do të ia shtojnë faqet Historis të Kombit tonë të vuajtur, por gjithmon krenarë)

Ne kemi ardhë në përfundim që ti plotsisht e meriton emnin <u>Antar</u> i LRSH-J. pasi është argumentuar se, vepra e jote e fundin nuk është atentat i ndonji terroristi, por është vetëmbrojtje e domosdoshme, që është i detyruar gdo kush të e bajë, kur është i atakuar nga agjentët e qeveris terroriste jugosllave.

J. i ka Degët në shum vende të Botës. Është duke punuar, që të e formoj D. edhe te ju në Bel.

3 26-6-82

Nukë i di aftësit e Tresë edhe gadishmërin e ti. Unë jam i mendimit, që ai apo ndokush tjetër që e njef ti shum mirë në çdo pikpamje, ose të vijë këtu ose caktohet nji shok e vjen atje edhe na sjell udhëzimet e duhura për formimin e D. së I. gjë që është dashur qysh me kohë të formohet. Shokët të cilet janë duke punuar në atë drejtim, do të mundohem të e ngadalsoj punën e tyre, pasi që po më duket se, te ju egzziston nji bazë shum e mirë për nji punë të tillë. Unë nuk kam mundsi të shkoj askund, pasi që nuk kam pasaportë, por kam ku me i pranuar çdo kush që të vjen.

Analizoj këto propozime e vepro si të e shifësh të arsyeshme.

Disi jam mërzitur me shkrimin tend të deri tanishem, për ndryshe edhe këtë letër e lexova shum lehtë.

Të fala vëllazërore, Q.

P.S. Shokët që paskan filluar të e nxjerrin „Ilirin" kishte me qenë mirë edhe Ata të e shkrijn aktivitetin e vetë në Organin Qendror të I.


4

Është interesan, shokët tanë që veprojn në shtetin e J. bajn propozim që të dali edhe një Revistë për çështje letrare me emnin "Iliria". Jam i mendimit që, tani këta shokë të e derdhin aktivitetin e vetë në "J.e.K." e kur të piqen kushtet të ndihmuar nga e tërë J. të e nxjerin Revisten Letrare "Iliria" në kuadrin e J.

***Letra e Sabri Novosellës drejtuar Musa Hotit faqe 2,3 dhe 4***

*Në këtë letër Sabri Novosella, që ishte anëtar i KQ të Lëvizjes, i shkruan Musa Hotit, përveç tjerash edhe për pranim e Musës në Lëvizje:*

*"Ne kemi ardhë në përfundim që ti plotësisht e meriton emrin Anëtar i LRSSJ , pasi është argumentuar se vepra e jote e fundit nuk është atentat i ndonjë terroristi, por është vetëmbrojtje e domosdoshme, që është i detyruar çdo kush të bëjë, kur është i atakuar nga agjentët e qeverisë terroriste jugosllave. L. I ka degët në shumë vende të botës. Është duke u punuar që të formojmë degën edhe te ju në Belgjikë. Nuk i di aftësitë e Isës dhe gatishmërinë e tij. Unë jam i mendimit: ai ose dikush tjetër që e njef ti shumë mirë në çdo pikëpamje; ose të vijë këtu të unë, ose caktohet një shok vjen atje dhe ua sjellë udhëzimet e duhura për formimin e degës së Lëvizjes, gjë që është dashur qysh moti të formohej. Shokëve që janë duke punuar në këtë drejtim, do të mundohem tua ngadalësoj punën , pasi atje te ju është një bazë shumë e mirë për një punë të tillë. Unë nuk kam mundësi të shkoj askund, pasiqë nuk kam pasaportë, por kam vend për t'i pranuar kushdo që vjen. Analizoji këto propozime dhe vepro siç të duket më e arsyeshme. Jam mësuar me*

*shkrimin tënd të deritashëm, për ndryshe edhe këtë letër e lexova lehtë.*
*Të fala O.*




***Ballina e revistës "Ilria", Nr 2 gusht 1982***

***P.S***. *Shokët të cilët paskan filluar ta nxjerrin “Ilirinë”, kishte me qenë mirë edhe ata të shkrijnë aktivitetin e tyre në organin Qendror të Lëvizjes.*
*Është interesant, shokët tanë që jetojnë në Z., bëjnë propozim që të dali edhe një revistë për çështje letrare me emrin “Iliria”.*
*Jam i mendimit që tani këta shokë të derdhin aktivitetin e vë në “ZK” e kur të piqen kushtet, të ndihmuar nga e tërë Lëvizja, ta nxjerrim revistën letrare “ILRIRIA”, në kuadër të Lëvizjes.“*
Kjo ishte përmbajtja e letrës ku Musën e autorizonin të krijonte degën e Lëvizjes në Belgjikë dhe interesimin e tyre që revista letrare “Ilrira “, që e nxirrja unë e që shkruante Musa Hoti e të tjerë , ta shkrinim në Lëvizje.

**Ja një shkrim nga Musa Hoti, botuar në “Iliria”**

## NJË PASQYRË MBI RININË HEROIKE KOSOVARE

**Musa Hoti, 23/06/1982**

Roli i rinisë sonë kosovare në historinë e pasur të popullit tonë, është një mekanizëm i fortë dhe i ndërlikuar, që e vë në lëvizje motorin e madh të revolucionit dhe të ardhmes së sigurt të popullit tonë të shtypur nga barbarizmi shekullor sllav.
Patriotizmi i flakët i rinisë sonë kosovare, aplikohet me aksione revolucionare me dinamizëm dhe shpirtin e lartë të sakrificës , që me gjakun e zemrës dhe djersën e ballit do ta ndërtojnë lumturinë e tyre, do të zgjidhin problemet e rënda e të ndërlikuara të Atdheut tonë; të imponuara nga armiku sllav e që përkrahët nga aleatët e tyre rusë.
Rinia si bijtë e bija besnike të denjë të popullit , e frymëzuara nga e kaluara heroike e gjyshërve dhe stërgjyshërve tanë, me vigjilencë e

zgjuarsi po e përdor rrugën e aksioneve më se 16 muaj. Me fjalën aksion nënkuptojmë veprim, shtytje, ecje përpara duke e shkallmuar okupatorin sllav nga rrënjët, duke e përmbysur të vjetrën e reaksionaren si dhe çdo gjë të huaj për rininë e Kosovës - kudo.
Kontributi i dhënë në këtë aspekt, do të shkruhet vetëm me shkronja të arta në faqet e historisë sonë të lavdishme. Vullneti, atdhedashuria, heroizmi dhe sakrifica janë faktorë që e favorizojnë luftën tonë të drejt për çlirim nga shtypja e shfrytëzimi nga okupatorët e huaj.
Të rinjtë kudo veprojnë e vigjilojnë bandat kriminale të policisë sekrete jugosllave, nga tradhtarët e vendit që lëvizin në çdo anë duke e vajtuar fatin e tyre të mjeruar, andaj tentojnë t'i asgjësojnë aksionet, ta kthejnë rininë nga rruga e drejtë revolucionare , nga rruga e denjë e çlirimit nacional që udhëhiqet nga komunistët kosovarë. Tradhtarët të bërë një me armikun nuk kursejnë sharje e ofendime, lot e gënjeshtra , vrasje e arrestime, tortura e dënime të rënda shqiptarëve të pafajshëm, largime nga puna, shkolla e fakultete që sipas mendimeve të tyre të varfra, duan ta dobësojnë qëndrueshmërinë e revolucionarëve, duan të mbjellin pasiguri , frikë, tmerr e llahtari.
Okupatori reaksionar bënë presion. Ndiqet kushdo që posedon prirje kombëtare e demokratike, që kërkon një rreze drite e lirie. Mendojnë se e shtypën kryengritjen me gjak dhe me gjyqet që dënojnë qindra e mijëra atdhedashës e liridashës të pafajshëm, por ato ndjenja të pastra e të lavdëruara nuk zhdukën kurrë.
Absurdja u mpleks me tragjiken. Shpirti i iniciativës, i protestës së hapur, i aksioneve të organizuara nuk i lë vend armikut e as tradhtarëve shqiptarë të cilët do të "dekorohen" nga vetë populli! Për këto u bind opinioni dekadent jugosllav si dhe opinioni përparimtar botëror.
Aktet patriotike si jetë e dytë e rinisë, manifestohen në çdo pore të jetës në masa të gjëra popullore në vend , dhe në çdo mes të mërgimit ku jetojnë patriotët e vërtet që ngrohin zemrat e popullit tonë të shumëvuajtur, që i udhëheqin aksionet me dinjitet e krenari kombëtare, që i frymëzojnë të gjithë patriotët në Europë, Amerikë,

Australi dhe vetëm me shembuj konkret të shpirtit të lartë të sakrificës. Ja se më çfarë fjalësh e përcjellë birin e vetëm një burrë kosovar në rrugën e mbarë kombëtare: “ Shko, shko biri im! Shko atje ku të thërrasin shokët; Atje është vendi yt i zbrazët dhe ndjehet mungesa jote. Shko, dhe bëja me dije të gjithë armiqve dhe tradhtarëve të çfarëdo ngjyre qofshin se kjo tokë është me zot, se populli ynë nuk farohet kurrë! Shko e ju priftë e mbara!”.
Një nënë e përcjell të birin në demonstratë duke i thënë: “ Biri im, biri i nënës besoj se nuk do më turpërosh! Babai yt – ndjesë pastë-luftoi dhe u vra për lirinë e Kosovës, por ai lum gjaku nuk na e solli lirinë , nuk dha asnjë fryt. Kosova gjithmonë mbet e robëruar , por gjaku i derdhur i vëllezërve dhe motrave para tankeve e automatikëve sllav , nuk do i humb gjurmët e veta kurrë! Shko biri i nënës e kthefshi me flamurin fitimtar! “
Kështu i përcillnin djemtë dhe vajzat , kështu do t’i përcjellim vazhdimisht deri në formimin e Republikës së Kosovës me të gjitha viset shqiptare në Jugosllavinë e degjeneruar, deri në fitoren përfundimtare.
Kryengritja dhe manifestimet e ndryshme të popullit janë bërë një shkollë e madhe e edukimit revolucionar , e kalitjes së fuqishme politike, fizike dhe ideologjike.
Optimizmi revolucionar dhe perspektiva e qartë e së ardhmes, janë faktorë që ngritin guximin e sakrificës, përballojnë me sukses të gjitha vështirësitë e pengesat objektive dhe subjektive. Nuk ka aksion në Kosovë e jashtë saj, që të mos e ketë vulën e rinisë, vulën e entuziazmit të saj, të hovit revolucionar dhe të patriotizmit të lartë.
Rina ka ndjekur dhe po e ndjek si metodë rrugën e aksioneve në kërkesën e Republikës së Kosovës si dhe në eliminimin e tradhtarëve që kurrë nuk e përqafojnë popullin.
Rinia është e ndërgjegjshëm për objektivin që e cakton , ngase e dinë se këto aksione janë për një të arritur të madhe politike e ekonomike , një kurdhër e farkëtimit revolucionar , që do luajë një rol të rëndësishëm për përparimin e afirmimit të gjithanshëm të trevave shqiptare. Do të favorizojë zhvillimin e industrisë , bujqësisë, arsimit e kulturës ideoartistike në tërësi.

Vetë në luftë të tillë me vështirësi e pengesat e njohura, kalitën më tej virtytet dhe idealet e larta të moralit kombëtar. Këngët popullore patriotike , janë pjesë e pandarë e rinisë sonë në luftën e përgjakshme për liri:

O trima luftëtarë, o bijtë e Skënderbeut,
Kërkoni ju shqiptarë, Lirinë e mëmëdheut
.........;

Plagët e rinisë sonë heroike janë barrikadë e pakapërcyeshme e ndikimeve të armikut dhe sahanlëpirësve të tyre të mjeruar, e ndikimeve të huaja të jetës së shthurur e të zbrazët, e dembelizmit dhe të çdo lloj uzurpimi të lirisë që predikohet nën tutelën armike.

“... ngrihuni dhe bjeruni ,
Korrni dhe shtyp’ni
Katundarë dhe pun’torë
Nga Tivari gjer në Ohër... “

Jemi krenar në rininë tonë të ndërgjegjshëm në luftën për lulëzimin e atdheut tonë, me rininë që po kalitët në fushat a e betejave me pushtuesit e huaj sllav, dhe që e ndjek me besnikëri traditën e luftës nëpër aksione, që i vënë kazmën armikut tonë shekullor; fakte që rininë tonë e madhërojnë, fitojnë pjekuri politike, qëndrojnë syshqiponjë më kërkesat e drejta kategorike e pakompromis, e gatshme në çdo çast të vërsulet mbi hordhitë e okupatorit fashist jugosllav.

Zjarri i aksioneve të rinisë kosovare është ndezur për të mos u shuar kurrë, gjersa të realizohet liria e plot e viseve shqiptare në jugosllavi, që do të përfshihen në Republikën e madhërishme të Kosovës.

“ ... se mjaft më në robëri, e mjera Shqipëri,
O djem rrëmbeni pushkët
Ja vdekje , ja liri... “




Ky artikull u botua si shtojcë speciale e revistës “Iliria”, me 23.VI.1982 , në Bruksel. Kjo shtojcë ka 30 faqe dhe u titullua sipas kryeartikullit që posa e lexuat. Analizat tjera të botuar në po të njëjtën shtojcë mbajnë titujt: “Socializmi e lufton politikën kolonialiste” (f8-14), “Ç’kërkon populli shqiptar në Jugosllavi ? “ ( faqe- 15- 17), “ Uniteti i shqiptarëve armë e sigurt e fitores

pakusht" ( faqe 17-  30), ku kjo analizë dhe tjerat kanë edhe nëntitujt e tyre.

***Komentim***

Se Lëvizja interesohej për revistën time, nuk dija asgjë. Nga burgu, Musa shkruante në revistë duke i dërguar artikujt përmes bashkëshortes se tij. Në revistë shkruanin kryesisht të rinjtë e porsaardhur nga Kosova si dhe nga Turqia Nijazi Sylçoglu që ishte i dënuar në ish Jugosllavi për veprimtarinë e tij kombëtare.
Me ndërmjetësimin e Musa Hotit, unë isha në kontakt me Sabri Novosellën përmes letërkëmbimeve. Sabriut nuk i interesonte isha apo nuk isha anëtar i Lëvizjes, por thjesht dëshironte të komunikonte më të gjithë veprimtarët në mërgim pa marrë parasysh bindjet e tyre ideologjike. Interesohej për veprimtarin time, por kur merrte letra prej aktivistëve që ishin të organizuar në celulat e treshit në Belgjikë, Sabriu mbetej konfuz: aktiviteti im kombëtar i dukej i mrekullueshëm për atë që bëja, por letrat që merrte prej aktivistëve e zhgënjenin, sepse ata do ta kenë shkruar kundër meje duke më etiketuar ideologjikisht të papërshtatshëm, karrierist që artikujt e mi i botoja më emër dhe mbiemër e jo me pseudonim. Aktivistët në Bruksel të organizuar në Lëvizje, kërkonin të mos vihej emri e mbiemri, por çdo gjë të bëhej anonim. Në fakt shumica prej tyre nuk kishin ku ta venin emrin sepse as nuk dinin të shkruanin e as të organizonin ndonjë ngjarje kulturore. Ku ta venin emrin e tyre? Në thashetheme e në vrapime të ndryshme kafeneve duke shpërndarë "Zërin e Kosovës". Aso kohe të shpërndaje "Zërin e Kosovës" bashkatdhetarëve tanë, ishte një krenari, sepse kur ua jepnin shtypin ishte shenjë se është njeri i madh i Lëvizjes. Në fakt "Zëri" zbarkohej fillimisht të unë përmes Fahredin Tafallarit. Fahredini transportonte mallra të ndryshme me një kamion dhe kur i rastiste të vinte në Belgjikë, më thirrte në telefon. Unë e thirrja Hazir Dërallën dhe shkonim bashkë më të, i merrnim gazetat dhe pastaj Haziri ua jete grumbuj-grumbuj shokëve që ai e dinte se cilët ishin të

organizuar. Kështu "Zëri" shpërndahej pa e kuptuar se unë kisha lidhje me Musën, Sabriun dhe Xhafer Durmishin.

Sabri Novosella e udhëzonte Musën që unë duhet të shkruaja me pseudonim.

Sabri Novosella kishte parime dhe zbatonte përpikëshmërisht programin e Lëvizjes. Shkrimet e mia dhe poezitë që i recitoja në manifestime të ndryshme kulturore, do të kenë ndikuar që Sabriu të ishte shqetësuar nga letrat që i merrte prej aktivistëve të Lëvizjes. Në Lëvizje askush nuk punonte më emër. Unë pasi që nuk isha anëtar i tyre asgjë nuk mund të më ndalonte të mos e veja emrin tim dhe të shokëve që zhvillonim aktivitete kulturore. Madje ishte absurde ta përgatisje një shfaqje e të mos kishe emrat e atyre që interpretonin. Unë e kisha botuar librin tim me tregime "Rojtari i Shqipërisë së harruar" me emër e mbiemër timin. Në anën tjetër e kisha përgatitur pjesën teatrale "Kosovë shqiponjë e robëruar" me emra e mbiemrat të anëtarëve. Gani Azemi kishte botuar librin e tij me poezi poashtu më emër e mbiemër. Ata që ishin të organizuar në degën e Lëvizjes në Bruksel me siguri që i kanë penguar emrat tanë. Unë asokohe as që e kam ditur se ç'po ndodhte në prapavijë kundër meje dhe tjerëve që punonim. Vetëm tani duke i lexuar letërkëmbimet e Musës dhe Sabriut e të tjerëve po e zbuloj se çfarë intrigash paskan bërë inferiorët. Në letrat që Sabriu ia dërgon Musës, unë e kam pseudonim Ragip. Ja se çfarë i shkruan Sabriu Musës në këtë letër:

*"Anëtarët e Lëvizjes duhet të jenë heronj të heshtur. Ne nuk guxojmë t'i zbulojmë çerdhet tona. Nëqoftëse duken kjo i përngjan fjalës popullore: " Një krua që e din çdokush, një herë shkojnë e pinë ujë në të e pastaj shkojnë pshurrin në të". Ne nuk guxojmë të bëhemi si ekipet e vjetra. Të bëhemi maskarej të botës e të qeshë bota me ne si me ata. Ne duhet të jemi ata që si përsona të mos na njohë asksush. Puna jonë krejtësisht e padukshme, por vetëm rezultatet e punës të duken. Në këtë drejtim disa baza në Europë po na çalojnë. Për këtë qysh në fillim duhet të kenë kujdes shokët e Ragipit (Reshatit- shënimi im). Duhet të krijohet bindja se nuk është duke u punuar për emër, por për çështje. Për çështje punojnë vetëm*

*ata që s'duan që emri i tyre të dihet askund. Kuptohet këta emra të dalin në shesh kur të vijë koha.*
*Të fala vëllazërore! Omeri! - Sabri Novosella (Shënim i autorit) .*


të zakonshme. Ndoshta po gabohem, por në qoftë se bëh-
et ashtu si e propozoni ju, frigohem se do ti zbuli-
n ato vende shumë lehtë ata që janë të interesuar
për zbulimin e tyre.
Autorët e L. duhen të jenë heroj të heshtur.
Puna e tyre duhet të jetë krejtësisht e pa dukshme.
Ne nuk guxojm ti zbulojmë gerdhat tona. Në qoftë
se dikush, kjo i përngjanë fjalës popullore, me ndërë
me thanë: „Një krua që e dinë çdo kush, një herë
shkojn e pinë ujë në te e pastaj kthehen dhe e
pshurrin" Ne nuk guxojmë të bëhemi si skipet e
tjetra. Të bëhemi maskarenj të botes e të gjithë bota
me ne si me ata. Ne duhet të jemi ata që si perso-
ona mos të na njef askush. Puna e jonë krejtësisht e
padukshme, por vetem [illegible] resultatet e punës të
duken. Në këtë drejtim dira kosa në Evropë po na gdhij-
në. Për këte gjithë në fillim duhet të kenë kujdes
shokët e Pogijit. Për këte pak i shkrova por vazhdimisht
do të japim udhëzime. Duhet të krijohet bindja se nuk ësh-
të duke u punuar për emër, por për qështje. Për qështje punoj-
në vetëm ata që s'duan emri i tyre të ndihet askundë.
Kuptohet; këta emra do të dalinë në shesh kur të vij koha.
Të fala vëllazerore

**Letra ku Sabri Novosella e udhëzon Musën të punohet me pseudonime**

Musa kishte informata se unë shoqërohesha me Gani Azemin dhe Enver Hadrin, andaj qëllimi i tij ishte që ne të tre të formonim celulën tonë.

Që Musa ta merrte këtë iniciativë kokë më vete ishte problem, sepse ne njiheshim si grup me ide djathtiste dhe nga majtistët merrnim gjithfarë epitetesh. Vetëm ngase e kundërshtova Ismet Bicajn t'i lexonim fjalimet e Enver Hoxhës dhe propagandën e Tiranës u përhap lajmi se unë isha ballist. Fakti që shoqërohesha me Jusuf Selenicën, Ganiun dhe Enverin, për majtistët ishte dokument dhe provë se unë nuk jam i denjë për marksizëm.

Duke propozuar emrat tanë, Musa mori barrën më të madhe, sepse, nëse ne do të devijonim rrugën marksiste, Musa do të kritikohej, madje, përjashtohej nga Lëvizja. Lëvizja e dënonte, jo atë që e devijonte rrugën, por atë që e kishte lidhur dhe futur në organizim të treshit, prandaj, në rastin tonë, Musa do pësonte. Pas këmbënguljeve nga Musa, Sabriu në këshillim me anëtarët tjerë vendosi që unë të anëtarësohem. Prej meje të anëtarësoheshin Gani Azemi e Enver Hadri. Lidhur me krijimin e celulës në Bruksel, Sabri Novosella i shkruan Musës kështu:

" *Të kam udhëzuar që ta udhëzosh Ragipin (Reshatin – shënimi im) të formojë celulën e vet; kurse dhëndri (Qamil Zekolli ishte dhëndëri i Musës - shënimi im-), të formojë celulën e vet dhe të veprojnë veç e veç. Ti të angazhohesh më tepër rreth dhëndrit, pasi e ke dhëndër se unë nuk kam kontakt më të, kurse me Ragipin (Reshatin) kam unë kontakte. Ragipin do të mundohem ta angazhoj sa të mundëm. .. Pasi i lexova disa herë poezitë e Gani Azemit, i dërgova një letër përmes Ragipit (Reshatit – shënimi im-), më të cilën e urova veprën dhe i bëra disa propozime. Përgjigje ende nuk kam marrë. Letrat vonohen. Nuk ka mundësi me mbrri letra brenda këtyre ditëve. Do të ju njoftoj për përgjigjen e tij.*

*Të fala vëllazërore, Omeri.* "

Omeri ishte pseudonimi i Sabri Novoselles.

Pas shumë insistimeve dhe letërkëmbimeve me Sabriun dhe me të tjerët, unë zyrtarisht u bëra anëtar i Lëvizjes. Pas një kohe të gjatë e shumë konsultimeve me Sabriun e Xhafer Shatrin rreth anëtarësimit

të Enver Hadrit dhe Gani Azemit, Sabriu e Xhaferi u pajtuan që Enveri dhe Ganiu të jenë pjesë e Lëvizjes. Enver Hadri dhe Gani Azemi u betuan konform rregullave të Lëvizjes në praninë time. Unë isha udhëheqësi i treshes, celulës sonë. Enveri dhe Ganiu, pas betimit zyrtar që u bë në banesën e Gani Azemit në Ucle, kanë pasur të drejtë të themelojnë celulat e tyre, unë nuk duhej të kisha njohuri me kë dhe kur. Duhet theksuar se unë dhe Enveri me Ganiun nuk jemi anëtarësuar kur është bërë ndarja e Lëvizjes në dy krahë, por kur ajo ka qenë një dhe unike; as që kemi qenë të interesuar për formime të celulave tjera. Aktiviteti ynë ishte sa qindra anëtarë të tyre krejt bashkë. Ishte qesharake të merreshim me krijime të celulave, kur të gjithë na akuzonin si reaksionarë. Ne u bëmë pjesë e tyre për të dhënë kontributin tonë për çështjen kombëtare pa e shuar aktivitetin tonë.

## *Fama e Musa Hotit tek shqiptarët*

Musa Hoti ishte figurë çelës i formimeve të celulave në Belgjikë, madje ai kishte arritur të krijonte lidhje edhe në vende të tjera të Europës si dhe në ShBA. Pas aktit, që kishte bërë në Bruksel, Musës i vinin letra nga katër anët e botës, duke filluar nga Ankaraja, Malmo, Parisi, Nju Jorku, Çikago, Detroiti si dhe nga Australia. Të gjithë ata, që merreshin me aktivitete kombëtare në tërë diasporën kudo që jetonin shqiptarët, i shkruanin letra Musës. Ishte mburrje të merrje një letër nga Musa Hoti. Kur takoheshim me ndonjë shqiptar, që jetonte në Gjermani apo diku tjetër, menjëherë tregonte se kishte kontakte me Musa Hotin.

Musa Hoti kudo gëzonte tretmanin e një heroi kombëtar; në shumicën e rasteve krahasohej me Oso Kukën, Tahir Mehën e, më së shumti, me Avni Rrustemin.

Musa Hoti gëzonte simpati te zogistat, te ballistat, dhe te çdo organizatë e parti, si djathtiste, poashtu edhe majtiste, pa e përmendur edhe tërë popullin e Kosovës.

Fama e Musa Hotit, që po përhapej në botën shqiptare, do ta shqetësonte Jugosllavinë e asaj kohe si dhe ndonjë lider të Lëvizjes.

Disa muaj pasi Musa gjendej në burg, në qendër të Brukselit do të ndodhte një vrasje tragjike në klubin "Jugosllavia", që do ta destabilizonte familjen e Musa Hotit. Para se të flasim për këtë vrasje, të sqarojmë rrethanat e krijuara gjatë kohës që Musa ishte i burgosur.

Gjer tani u njohëm me situatën e diasporës në Belgjikë para vitit 1981 dhe aktivizimin e shqiptarëve pas atyre ngjarjeve.

Kudo në diasporë, shqiptarët ishin më afër njëri-tjetrit, por, natyrisht, ekzistonte ndarja mes majtistëve dhe djathtistëve. Demonstratat në përkrahje të studentëve nuk kishin të ndalur. Nuk kalonte një e shtune e të mos organizohej një demonstratë në një qytet të Europës. Një grup yni nga Brukseli merrnim pjesë në çdo demonstratë në cilindo qytet që kishte organizime. Pjesëmarrja në këto manifestime kishte edhe koston e saj dhe kishte filluar të ndikonte në ekonominë familjare të atyre që nuk e ndërprisnin aktivitetin. Shtypi serb shkruante se për pjesëmarrje në demonstrata paguheshin autobusët nga shqiptarët e pasur. Kjo ishte një gënjeshtër e kulluar, sepse ne, secili paguante për vete dhe familjen. Të shkosh në një manifestim nga Brukseli në Gjenevë, nuk paguhej vetëm autobusi, por duhej edhe ushqimi ngase vetëm udhëtimi zgjaste 16 orë vajtje dhe ardhje. Përveç kostos ekonomike që sakrifikonin shqiptarët ishte edhe një çmim tjetër që paguhej me jetë dhe për ç'gjë askush sot e kurrë nuk ka qenë objektiv i penave shqiptare. Transporti për pjesëmarrje bëhej në mënyra të ndryshme, shkonim me vetura, me autobusë dhe me tren. Pak janë ato manifestime e të mos kalonin pa viktima që shkaktoheshin nga ndeshjet në komunikacion. Atëherë dhe tani e marr si absurde pasi asnjëherë nuk përmendej dhe nuk respektohej viktima, që kishte humbur jetën, vetëm e vetëm që numrit të manifestuesve t'i shtohej edhe një shqiptar më tepër. Ishte një kënaqësi kur udhëtonim me veturë, sepse gjatë kalimit në autostrada të ndryshme të Europës shihje veturën tjetër duke i valuar flamuri kombëtar. Pikërisht në takime të tilla, shoferët nxiteshin kur tjetri me shpejtësi na kalonte

dhe i binte sirenës në shenjë përshëndetjeje. Shoferi tjetër i lënë pas, për t'i treguar tjetrit se edhe ai ishte shqiptar dhe nuk e lejonte ta tejkalonte aq lehtë, rriste shpejtësinë e veturës për ta tejkaluar. Këto ishin raste që të jepnin kënaqësi, por kishte edhe raste pasojash tragjike. Vdekje të tilla kishte në demonstratën e Hagës, të Cyrihut, të Mynhenit, si dhe në Nju Jork. Jam i bindur se këta shqiptarë, vdekur në autostradat e botës e meritojnë titullin e viktimës së luftës. Është e vërtetë se kanë vdekur në ndeshje komunikacioni, por nuk vdiqën duke ikur me dhunë nga policia serbe siç ndodhi në vitin 1999. Këta ishin viktima që u nisën për të shtuar një njeri më shumë kundër reprezaljeve që Serbia bënte mbi vëllezërit tanë në Kosovë.
Grupi ynë në Bruksel, që më shumë merreshim me aktivitete kulturore, ishim prezent në çdo demonstratë të metropoleve europiane.
Pasi kisha përgatitur pjesën teatrale, dëshiroja ta hapja shkollën shqipe, e cila nuk do kishte asgjë të përbashkët me atë të Ambasadës Jugosllave. Për këtë inisiativë kisha biseduar disa herë me Hazir Dërrallën, Hysen Xhelilin dhe Qamil Zekollin.



*Në foto: Hazir Haziri (Dërralla), Shaqiri dhe Musa Hoti*

Pasi ne konsideroheshim ende të ri, të vjetrit nuk dëshironin ta përkrahnin idenë e hapjes së shkollës shqipe. Përveç që nuk donin të

na ndihmonin. Ata edhe na frikësonin me idenë se Jugosllavia do të na vriste. Asnjëri prej nesh nuk frikësohej se mund të vritej, por hallin e kishim të gjenim mjete materiale për të paguar qeranë e një lokali që do të na shërbente si shkollë për fëmijët tanë. Qëllimi i hapjes së shkollës sonë nuk ishte që të mbyllej shkolla ku jepte mësim Feim Hoti, dhëndëri i Mahmut Bakallit, por ne, që nuk i dërgonim fëmijët tanë në atë shkollë, së paku të hapnim shkollën tonë.

Në këto kohë Musa Hotit i kishin ardhur disa ndihma nga shqiptarët e diasporës. Kur unë i tregova iniciativën tonë, nga ai mora një letër ku më thoshte se vëllai i tij, Isa Hoti do të merrte një shtëpi me qira dhe kati i dytë mund të na jepej pa të holla. Kështu,në shtator të vitit 1982,unë bashkë me shokët që i përmenda më lart, e hapëm shkollën shqipe me emrin Bajram Curri. Mësues emëruam Qamil Zekollin, ndërsa klasa e parë në hapje kishte vetëm 17 nxënës.



LAJMRIM



***Kopje nga origjinali i pllakateve që kishim shpërndarë në lagjet ku banonin shqiptarët.***
***Vizatimi është punuar nga Shaban Shkupi.***

Komunikatën për hapje të shkollës e kisha shkruar dhe nënshkruar unë, pasi asnjëri nga piktorët nuk e mori guximin të ilustronte pllakatin, Shaban Shkupi e vizatoi edhe pse nuk ishte profesionist e as ndonjë që i shkonte piktura.
Shkolla shqipe u hap në adresën Chaussée de Mertchem 182, Bruxelles 1080.
Hapja e shkollës shqipe ishte meritë edhe e Musës, që e kishte bindur vëllaun e tij,Isën,që të na lejonte lokalin, katin e dytë të shtëpisë së tij për nxënësit shqiptarë. Madje ende pa u hapur shkolla, një pjesë e mërgatës së lidhur me Lëvizjen e kundërshtonte këtë nismë. Musa Hoti i kishte shkruar letër Xhaferit dhe Sabriut lidhur më hapjen dhe pengesat që na vinin nga anëtarët e organizuar të Lëvizjes. Pra, kontributi i Musës për hapjen e shkollës shqipe, ishte i pakontestueshëm.
Hapja e shkollës në lokalet që na i lëshoi falas Isa Hoti, do ta pengonte dukshëm propagandën jugosllave.
Gjatë asaj kohe unë isha duke përgatitur një shfaqje që do jepej me rastin e njëvjetorit të demonstratave. Në këtë shfaqje merrnin pjesë Qamil Zekolli, Behare Sahitaj, Bedrije Jusufi, Isa Hoti, Hajrush Graica, Durak Duraku, Dilaver Lita, Blerim Ndreu, Flamur Lita dhe Reshat Sahitaj. Hazir Haziri ishte ndër përkrahësit e parë të çdo veprimtarije për interesin kombëtar.
Ekipi i shfaqjes ishte i përbërë nga mërgata e vjetër e Shqipërisë dhe nga Kosova. Edhe sikur asgjë mos të vepronim ishte e mjaftueshme që vetëm struktura dhe përbërja e ekipit të shqetësonte Beogradin dhe Tiranën.
Pasi ne kishim përfunduar provat e dramës, secili u shpërnda në punë të veta. Pak kohë më vonë në klubin "Jugosllavia" kishte ndodhur një atentat kundër anëtarëve të klubit jugosllav. Diku rreth mbrëmjes policia belge e arrestoi Isa Hotin si të dyshuar në këtë vrasje ku viktima ishin një shqiptar dhe disa të plagosur serbë e boshnjakë.
Menjëherë pas atentatit ambasada jugosllave e kishte akuzuar Isa Hotin pa e njohur. Isa në ato momente kishte shumë dëshmitarë që

deklaronin të vërtetën: Isa nuk kishte kryer atë atentat. Isa Hoti pas provave të dramës kishte shkuar në një lokal  ku kishte shumë shqiptarë dhe me ta kishte qenë në lojë e sipër. Të gjithë ata që kishin qenë me Isën në kafene shkuan të dëshmonin se Isa në ato kohë kishte qenë bashkë më ta. Dëshmitareve shqiptarë, policia belge nuk ua merrte për bazë deklarata e tyre.
Në shtypin belg dhe jugosllav shkruhej se atentatori ishte vëllai i Musa Hotit. Më këtë vrasje në klubin e serbëve “Jugosllavia”, Sërbia me siguri kishte planifikuar të fuste në hasmëri shqiptarët, veçanërisht familjen e Musës me familjen e viktimës së klubit.
Shqiptarët,të cilët ende shkonin në atë klub, thonin se klubi ishte i survejuar me kamera dhe dera nuk kishte mundësi të hapej pa e hapur përgjegjësi i klubit. Përgjegjësi i klubit, thonin ata,ishte serb. Ai nuk do t’ia kishte hapur portën ndonjë shqiptari pa qenë anëtar i klubit e aq më pak Isa Hotit. Sipas të gjitha gjasave supozohej se vrasjen e kishte përgatitur Shërbimi Sekret i Jugosllavisë, me njerëz të specializuar për kryerje të atentateve të tilla.
Sipas shtypit belg thuhej se vrasësit ose vrasësi kishin zbrazur rafale të automatikut dhe qëllimisht e kishin vrar shqiptarin, që më vonë këtë vrasje ta përdornin për interesa të tyre.
Siç mbeti vetë atentati enigmatik, poashtu mbetet enigmatike se, pse shqiptari kishte shkuar në atë klub kur qe nga hapja e klubit “Përparimi” shqiptarët nuk e frekuentonin klubin “Jugosllavia”. Në te shkonin vetëm serbë e boshnjakë të përbetuar për Serbinë.
Në fillim,posa dëgjuam se kishte ndodhur një vrasje në atë klub, ne shqiptarët u gëzuam, por kur kuptuam se aty ishte vra një shqiptar u pikëlluam. Kjo që po e them tani është një realitet se vrasja e tij na kishte vënë në dyshim dhe ne ndjenim vetën të pikëlluar.  E dinim, ose mendonim që e dinim,  se atë shqiptar e kishte mashtruar dikush nga ambasada e Jugosllavisë që të gjendet në ato momente aty.
Në anën tjetër, kjo vrasje në tërë Kosovën kishte njëlloj jehone pozitive, pavarësisht se aty ishte vrarë një shqiptar. Shqiptarët të etur për liri  mendonin pak më  ndryshe. Sipas tyre edhe sikur kjo vrasje të jetë përgatitur nga shqiptarët, ata nuk do të dinin se në klub kishte shqiptarë duke pasur parasysh se aty nuk shkonin shqiptarët

por vetëm serbët. Pastaj,nëse atentatori ishte shqiptar, ai/ ata në atë shpejtësi nuk e kanë njohur e dalluar se cili prej tyre do të kishte qenë shqiptar, pasi ai/ ata ishin përgatitur për të vrarë serbë e jo shqiptarë. Bazuar në shtypin belg dhe në ekspertizën e policisë belge që shkruante se atentati ishte kryer nga profesionalistë të stërvitur, automatikisht ne e dinim se vrasës të stërvitur kishte vetëm Serbia.
Isa Hoti mbahej në burg pa nevojë. Në këtë kohë familja e Musa Hotit respektohej nga të gjithë shqiptarët, si në Kosovë, poashtu edhe në diasporë. Dy meshkuj në burg kundër Jugosllavisë ishte rast për t'u respektuar dhe për të ardhur keq, ngase Serbia kishte filluar të bënte represione në tërë familjen e Musës. Në Bruksel bashkëshortja me fëmijët e vegjël kishte mbetur pa të ardhura. Ajo mbahej nga ndihmat sociale dhe ndihmat e shqiptarëve që i vinin aty-këtu.
Në këtë kohë derisa Musa dhe Isa Hoti gjendeshin në burg, grupi ynë vazhdonte provat e dramës edhe pa Isën që kishte një rol episodik.
Një ditë marsi të vitit 1982 unë, Beharja dhe Qamili kur parkuam veturën para banesës së Musa Hotit, ku shkuam për ta marrë Bedrije Jusufin (mbesa e Musa Hotit) për të vazhduar provat, vërejtëm një grup shqiptarësh në kafenenë përballë dritareve të banesës së Musës. Takimin e atyre shqiptarëve në atë kafene belge nuk e morëm si të pazakontë edhe pse ishte i tillë. Në fakt në këtë kafene shqiptarët nuk shkonin, sepse aty klientët ishin vetëm vendas. Pasi Beharja i kishte ra ziles, unë me Qamilin rrinim anash, nga dritarja e katit të dytë, Bedrije Jusufi na foli diçka dhe e hodhi çelësin. Nga lartësia nuk dëgjuam mirë se çka na tha ajo, dhe u ngjitëm shkallëve për në banesë.
Derën e banesës e hapi Bedrije Jusufi dhe na tha me zë të ulët se aty ishte një gazetar nga Beogradi. Ne mbetëm të shokuar. Unë për disa sekonda mendoja me vete, sa të guximshëm janë serbët. Ishte kohë tepër e tendosur për serbët që jetonin në Belgjikë. Qe nga marsi 1981 e deri në shkurtin 1982, nuk mund të dëgjoje serbë që mes tyre e flisnin serbishten, nga frika se mos po i dëgjonte shqiptari dhe do të vritej. Para vitit 1981, në sheshin kryesor të Brukselit dhe vende

tjera dëgjoje gra ose burra që flisnin gjuhen e tyre. Më pas asnjë serb nuk guxonte të fliste më zë të lartë gjuhen e vet. Në komunitetin e tyre kishte hyrë një panik deri në palcë, sepse u vranë mbi dhjetë qytetarë të tyre në qendër të Brukselit. Madje mbishkrimet e restoranteve u ndryshuan dhe nuk quheshin më Restorante "Jugosllavia", por venin mbishkrime belge që mos të identifikoheshin si qytetarë jugosllavë. Kjo atmosferë ishte në ato vite, ndërsa sot gjendja e komunitetit serb është kthyer si në vitet e para 1981-së. Sot po të rastisë të shëtisësh rrugëve të Brukselit është e pamundur të mos i dëgjosh serbët duke folur gjuhen e tyre, bile ndodh të jenë të shoqëruar me shqiptarë.
Pavarësisht situatës dhe atmosferës së sotme që mbretëron në Belgjikë po i kthehem momentit kur ne qëndruam të shokuar në hollin e banesës të Musa Hotit. Hyrjen e gazetarit nga Serbia në banesën e Musa Hotit, unë e merrja si akt patriotik të tij. Qe nga marrja e detyrës në Beograd, për të bërë reportazh për familjen e Musës, gazetari serb ka qenë i vetëdijshëm se po hynte në një avanturë të rrezikshme. Ai ka qenë i vetëdijshëm se në Kosovë do të mund ta bënte artikull të tillë, sepse ka pasur sigurimin e policisë serbe, por në Bruksel, kush do t'ia siguronte jetën e tij?! Natyrisht para se të nisej, policia sekrete serbe i kishte premtuar se shteti belg ka konsideratë për Jugosllavinë dhe se do të jetë i siguruar nga shërbimi sekret i tyre gjatë tërë qëndrimit të tij në Belgjikë. Megjithatë, unë mendoja se ai ishte gazetar i guximshëm. Disa muaj më vonë mësuam se gazetari Rajko Gjurgjeviç i revistës "Duga", në aeroportin e Brukselit ishte pritur nga disa shqiptarë. Disa ditë kishte shëtitur me ata që e pritën në aeroport. Në disa familje shqiptare iu shtruan dreka dhe darka. Gazetari beogradas do të shkruante për ta dhe mikpritjen e atyre shqiptarëve. Rajko Gjurgjeviç shkruante se një grup i vogël irredentistash shqiptarë po e prishnin rendin, qetësinë dhe harmoninë e bashkëjetesës mes shqiptarëve dhe serbëve që jetonin në Belgjikë. Duke ngrënë dhe pirë në familjet shqiptare, gazetari kishte krijuar mendimin se shqiptarët e Belgjikës nuk ishin aq të rrezikshëm, siç kishte dëgjuar dhe siç shkruhej në shtyp.

Ne të katërt, unë, Beharja, Qamili dhe Bedrija qëndronim ende në hollin e banesës. Me gazetarin serb dhe pjesën tjetër të familjes së Musës na ndante vetëm një portë. Në ato momente isha sa i çuditur, aq i inatosur me guximin e gazetarit serb. Si ishte e mundur të vinte në një familje shqiptare ku dy meshkuj ishin të akuzuar për vrasje të serbëve. I thash Qamilit, pasi ta vërtetojmë se është gazetar dhe serb, po e fusim në veturë dhe ... Duhej të tregoheshim të matur që mos ta frikësonim dhe do të reagonte me britma nga frika. Banesa e Musës ishte në qendër dhe në rrugën ku çdo sekondë kishte kalimtarë, madje banorë e kateve të larta e të mëposhtme do të njoftonin policinë. Ne nuk ishim të përgatitur as psiqikisht për vepra kriminale, as që kishim kryer ndonjëherë më parë e as më vonë.
I shënoj këto radhë ngase tani pas luftës po dëgjojmë sajime e trillime "trimërish", gjoja, atdhetare duke u mburrur se gjatë luftës kanë vrarë e kanë bërë shumë akte heroike. Ne, shqiptarët kemi dëshirë të mburremi, edhe për akte që nuk i kemi bërë, se për ato që i kemi bërë nuk dimë të ndalemi, duke folur për burrërinë tonë. E pasi ata vetë po tregojnë, shumë vite më vonë po burgosën, sepse shoku i tyre i bisedës po i tradhton. Sido që të jetë ne nuk bëmë akte kriminale, por vetëm zhvillonim aktivitete kulturore.
Qamilit nuk i durohej të priste për të planifikuar se ç'do bënim me gazetarin nga Beogradi. Shumë shkurt u morëm vesh ta fusnim në veturë...
Nuk u përshëndetëm me askënd e madje as me nënën e Musës, e cila u ngrit për të na zgjatur dorën. Me zë të qetë e pyeta gazetarin se kush ishte dhe pse kishte ardhur në familje të Musës.
Qamili e kapi për fyti gazetarin dhe ia futi disa flakaresha. Unë e ndala që të mos i binte se me flakaresha dhe boksa nuk isha i interesuar të përfundonte vizitën gazetari i Beogradit.
Iu drejtova gazetarit butësisht që të na jepte dokumentet për të verifikuar nëse ishte gazetar i "Duga ", siç pretendonte me lot. Por sa ai deshi ta fuste dorën në xhepin e setrës, Qamili iu afrua dhe e ndaloi të bënte gjeste që do i kushtonin me jetë. Në fakt ne, siç u tha, nuk ishim të përgatitur të vrisnim askënd, por pa revole nuk dilnim nga shtëpia. Shkonim të armatosur kudo, për t'u mbrojtur në

rast nevoje. Qamili ia nxori nga xhepat e tij të brendshëm të gjitha dokumentet dhe e zgjati dorën të më jepte mua.

- Eja me ne! – e urdhërova unë
- Ku ?! – pyeti i habitur gazetari.
- Kemi me sqarua disa gjëra me ty – i foli Qamili.

Gazetari nguli këmbë të mos dilte , por Qamili e shtyu dhe ai, gati sa nuk u rrëzua para meje që e prisja në dalje të derës së sallonit.

- Mos më vrisni, ju lutem! Qante dhe bërtiste gazetari.
- Mos ke frikë, ne nuk jemi vrasës, por kemi punë për të sqaruar- i thash butësisht. Doja ta qetësoja që të dilte pa e shtrënguar me forcë.

Pikërisht në momentin kur me dolëm në hollin e banesës, u dëgjuan të trokitura të rënda në derën e shtëpisë.

- Policia! Hapeni derën! – u dëgjuan zëre të policisë belge me të cilët na ndante vetëm dera kryesore.

Ne mbetëm të shtangur, por jo të frikësuar. Me shikime u morëm vesh që armët t’i lenim në banesë. Kishim disa sekonda kohë për fshehje të revoleve tona. Bedrija i mori dhe shkoi në dhomat tjera pa hetuar gazetari asgjë. Beharja e hapi derën. Katër policë para nesh dhe katër apo më shumë të tjerë qëndronin në trotuar, që kishin ndezur dritat e tyre. Policia e armatosur, dritat, që i jepnin ngjyra blu trotuarit, grumbulli i qytetarëve të lagjes, ishte skenë sikur në filma hollivudian.

Pasi dera u hap, policët nuk dinin se jeta e cilit ishte në rrezik. Ne ishim tre meshkuj dhe dy femra.

- Cili prej jush është Rajko?! Pyeti njëri nga policët që të gjithë rrinin të gatshëm me armë që në rast të rezistencës sonë ata të qëllonin.
- Unë jam! U përgjigj gazetari dhe u nis të ndahej prej nesh që të hidhej në përqafim të policisë. Njëri prej policëve ia drejtoi automatikun dhe i tha të ndalej. Policët nuk e dinin ke ta merrnin në mbrojte. Secili prej nesh mund të përgjigjeshim se ishim Rajko që policia kishte ardhur ta mbronte.

- Ja ky është, dhe ne posa u nisëm që t’ua sillnim në polici, sepse për ne ky është i dyshimtë.

Shefi i njësitit të policisë dha urdhër të na venin prangat të gjithëve, përveç Behares. Gazetari zbriste shkallët para nesh, pas tij unë, Qamili dhe Beharja.

Pasi na dërguan në polici dhe na morën shenjat e gishtërinjve, mua dhe Qamilin na dërguan në një celulë të burgut, ku na mbajtën disa ditë.

Më vonë e kemi kuptuar se grupi i shqiptarëve që rrinte në kafenenë përballë banesës së Musa Hotit ishin përcjellësit e gazetarit serb. Në mesin e tyre kishte pasur edhe të dërguar specialë të shërbimit sekret jugosllav që përkujdeseshin për jetën e gazetarit.

Nga kjo mësuam se Serbia edhe pse e dërgonte njeriun në ndonjë mision krejt të parëndësishëm, atë e shoqëronte për t’ia siguruar jetën. Grupi i shqiptarëve në kafene, posa kishte parë se unë dhe Qamili jemi ngjitur në banesën e Musës, menjëherë kishte telefonuar policisë dhe ambasadës së Jugosllavisë në Bruksel. Sikur ne të kishim pasur njohuri se shqiptarët e përcillnin gazetarin serb, do ta dinim se policia nuk do vononte të vinte.

## Ko to puca u Briselu

# JEDAN DAN U ULICI SMRTI

**• Prestonica Belgije postala je za Jugoslovene pakleni grad, odakle se neki u domovinu vraćaju izrešetani i u mrtvačkim sanducima . . .**



**Sa sedam metaka u telu: Ljubiša Paunović u bolnici San Pjer.**

Dakle, i to je Brisel: požari i „Molotovljevi kokteli" za naša predstavništva! Rafali na „Marše o Gren", na „Žitnoj pijaci", ili još — u „Ulici Smrti", kako je sada zovu naši ljudi.

Prestonica Belgije postala je za Jugoslovene pakleni grad, odakle se neki u domovinu vraćaju izrešetani i u mrtvačkim sanducima.

Užas i nasilje koje izaziva emigracija, ovde su postali redovna pojava. Tobožnji naziv „refižie politik", politička emigracija, kao da je do sada u Briselu davao pravo na sve. Ni diplomatski imunitet, ni status Jugoslovena na privremenom radu, nisu dovoljna zaštita za goli život.

Kada sletite na briselski Zoventem, utisak je drugačiji, „ako ste pobožni, gospodine, izvolite ovuda . . ." U terminalu aerodroma dve prostorije, za protestante i katolike. Pod statuom Hrista slomljenih ruku dogorevaju sveće.

Pomolite se još na aerodromu . . .

Smernost, korektnost i ljubaznost Belgijanaca u prolazu kao da ostaju privilegija za neke druge. Iz perspektive Jugoslovena stvari u glavnom gradu Belgije stoje sasvim drukčije. U njihov svakodnevni život uselio se teror, strepnja i strah.

Ali, bolje krenimo redom.

Taksi me ostavlja u ulici Žan Žak, u briselskoj četvrti Kukelberg, koja nije na najboljem glasu. Danas izgleda mirno . . .

Na ulazu zgrade broj pet, piše: „NOT." — prezime braće koje ne silazi sa stubaca belgijske štampe. Stariji, Musa je početkom avgusta u kafeu „Vajt Hors" ubio računopolagača Stojana Đerića i ranio Ređu Zuku, takođe službenika naše ambasade.

Danas pre podne službeno saopštenje briselskog javnog tužioca i za mlađeg Isu Hotija: „Uhapšen je pod sumnjom da je izvršio masakr u Klubu „Jugoslavija".

Snimam tu zgradu i praznu ulicu popodneva. Na staroj četvorospratnici sve je zatvoreno, sem prozora na trećem spratu. Mlada žena, koja odozgo posmatra šta radim, baca ključeve od ulaznih vrata.

## U osinjem gnezdu

Tako sam se našao u stanu Hotijevih, uveren da me očekuje razgovor sa porodicom. Majka i otac sigurno imaju da kažu nešto o svojim sinovima. Gore, suviše kasno, shvatam da sam ispred ubojica.

Pri ulasku, u stanu je bilo dosta žena i dece. Sa njima samo jedan muškarac.

Ali, ubrzo stižu još dva muškarca i nekoliko žena. Ta dva mladića, ne starija od dve i po decenije, ulaze bučno i nasrću na mene. Prvi, za koga sam kasnije saznao da se zove Rašid Sahidaj, viče na našem jeziku:

— Odavde ćeš da izađeš mrtav. Mi ćemo rasturiti Jugoslaviju. Sve ćemo popaliti i spržiti . . . Sve ćemo pobiti . . . .

U lice mi gura neke belgijske novine koje su, navodno, pisale o njemu. Jugoslaviji obećava bombe, Jugoslovenima ubistva.

Sa neverovatnim besom na mene nasrću i žene, i otvoreno prete.

U opštoj gužvi drugi pridošlica, za koga se kasnije ispostavilo da se zove Ćamil Zekoli, je najsuroviji. Nasrće na mene, vadi mi grubo sve iz džepova, zahteva da se „stvar okonča po kratkom postupku" . . .

Njegov drug Sahidaj, je sistematičniji. U dokumentima proverava moj identitet. Gleda i u „Ilustrovanu politiku" koja leži na stolu. U potpisima tekstova kontroliše imena. Pretura i neke svoje spise.

Okreće se prema meni i prosto besni: „Mi i hoćemo da ubijemo novinare. Ti si mi izgleda prvi."

Gde je izlaz odavde?! Da li je novinarska anatema dovoljna da se uopšte dođe u ovakvo osinje gnezdo. Sledeća prostorija, koja je odeljena samo razmaknutom zavesom, ima prozor koji gleda na ulicu. I skok sa trećeg sprata daje više izgleda da se preživi.

Ipak, treći Albanac, koga sam zatekao još pri ulasku i koji mi sada stoji iza leđa, ne daje ni takvu šansu. Zahteva „da ne mrdam." Njegovo ubeđivanje ima veličinu kalibra devet milimetara. I bez njega, ko bi protrčao iz jedne prostorije u drugu, ko bi uspeo da protrči do prozora, kroz živi špalir prisutnih?

Kako sam se prevario?!

Ostaje iščekivanje kraja njihovog „političkog programa". Jedan deo te „ideologije" krvavo se ispisuje već mesecima, ovde u Briselu.

U noći 29. marta prošle godine eksplozijom bombe uništeno je Predstavništvo JAT-a. Dvadesetog aprila su antijugoslovenske demonstracije . . .

Prostorije jugoslovenskog turističkog predstavništva izgorele su do temelja u podmetnutom požaru, dok je radnička klasa Brisela slavila Praznik rada. Sredinom jula albansko-ustaški teroristi neometanb prave nered ispred jugoslovenske ambasade. U toku juna i jula teroristički napad na dva jugoslovenska kluba.

Na Dan borca, 4. jula, ispred jednog hotela u Briselu, zapaljen je autobus „Jugoekspresa". A već 15. jula zločinci su ranili dvojicu službenika naše ambasade u Briselu, Blagoja Anakioskog i Franca Špindlera.

Tri nedelje kasnije, u centru Brisela, u kafeu „Vajt hors" terorista Musa Hoti ubija Stojana Đerića i ranjava Ređu Zuku.

I, najnovije, u Klubu „Jugoslavija", na Žitnoj pijaci, usred dana, u samom centru Brisela, terorista rafalima mašinke masakrira prisutne Jugoslovene.

Ja një përkthim i pjesrishëm i artikullit :

## Një ditë në rrugën e vdekjes

Po japim vetëm disa fragmente nga ky artikull, që kap tri faqe të revistës së botuar në mars ose prill 1982.
Gazetari Rajko Gjurgjeviq në ketë artikull rrëfen se si në Bruksel ka shqiptarë të ndershëm që e mbrojnë atdheun e tyre –Jugosllavinë, por në mesin e tyre është një pakicë që lufton kundër Serbisë.
Në nëntitulli i këtij shkrimi "U osinjem gnezda", që nuk di si përkthehet, shkruan: "
*... por shumë shpejt vijnë disa meshkuj e disa femra. Këta dy djelmosha, jo më të vjetër se 25-vjeçarë hapen derën me rrëmbim dhe u drejtuan drejt meje. I pari, për të cilin më vonë mësova se quhej Reshat Sahitaj, bërtiste në gjuhën tonë: "- Nga këtu do të dalësh i vdekur. Ne do ta shkatërrojmë Jugosllavinë. Çdo gjë do ta kallim... Të gjithëve do ju vrasim....".*
*Në fytyrë m'i gjuante disa artikuj të gazetave belge, që kishin shkruar dhe për Jugosllavinë, më premtonte bomba dhe jugosllavëve vdekje.*
*Në këtë tollovi, tjetri ndërhyni, për të cilin më vonë mësova se quhej Qamil Zekolli, që ishte shumë më i egër se i pari. Kërceu mbi mua, më nxori çdo gjë që kisha në xhepa dhe dëshironte që puna të përfundonte me procesin e shkurtër... Shoku i tij, Sahitaj, ishte më sistematik, i shikonte dokumentet e mia, ia hidhte një sy "Ilustrovana politikës", që ishte mbi tavolinë. I shikonte artikujt dhe emrin e gazetarëve. Pastaj u kthye nga unë dhe më tha: "Ne do t'i vrasim gazetarët. Më dukesh se ti qenke i pari që e ke këtë fat"... Në sallon Qamil Zekolli bërtet dhe kërkon gjak, kërkon të vrasë. Sikur veç kjo do ta qetësonte. Po aq i rrezikshëm, por shumë i qetë, Reshat Sahitaj sikur po i thotë Qamilit: nëse e vrasim na prishet drama. Sahitaj është aktor. Në Jugosllavi ka fituar edhe disa shpërblime e tash po e luan rolin e jetës së tij..."..*

*(“Duga”, mars/prill 1982)*

## *Meditoja për Musa Hotin*

Gjatë qëndrimit disaditor në burgun e Brukselit kisha kohë të mendoja për shumë gjëra. Dhoma e burgut ishte e vogël, por shumë e lartë. Dritarja ishte në lartësi që nuk arrihej të shikoje asgjë. Nuk kishte as krevat as dyshek. Një beton që kishte formën e dyshekut dhe asgjë. Kjo dhomë nuk ishte burg , por quhej paraburgim.
Pasi nuk kisha çka të bëja, mendja më shkonte fillimisht të gazetari, pastaj mendoja se si Musa qëndron i vetmuar pa pasur mundësi të fliste me askënd. Unë nuk kisha fortë gajle që nuk kisha më kë të bisedoja. Sikur të kisha ndonjë libër për të lexuar! Po të kisha libra, edhe mos të dilja aspak jashtë nuk e çaja kokën. Më ndodh që kur filloj të lexoj nuk dal nga banesa më ditë të tëra.
Po Musa Hoti ç’bën tani në këto çaste? Më shkonte mendja për të. E pyesja vetën nëse policia do të kishte shkuar në dhomën e tij për ta marrë në pyetje për gazetarin, për Qamilin dhe mua. Ai do të habitej se si gazetari kishte hy në banesën e tij. Sikur Isa të mos ishte në burg, së paku, ishte një lehtësi për të, në fund të fundit, ishte një burrë në shtëpi. E mendoja se kur policia do t’i rrëfente ngjarjen dhe do të krenohej me qëndrimin dhe sjelljen tonë.

Kisha mëshirë për nënën e Musa Hotit e cila ishte zënë ngusht. Të na përkrahte ne, kishte frikë se djemtë, që kishte në Kosovë, do të pësonin nga policia serbe në shenjë hakmarrjeje. Të mos nas përkrahte ne, nuk dëshironte, sepse edhe ajo urrente gazetarin serb. Kur e shihja atë, më përfytyrohej nëna ime, të cilën nuk e kisha parë vite të tëra. Nëna e Musës kishte ngjashmëri fizike me nën time. Ne dolëm të prangosur nga banesa e Musës dhe ajo mbeti me lotë në sy, duke na përcjellur. Ajo nuk e dinte se ne do të liroheshim brenda pak ditësh. Ajo kishte përvojë të hidhur me policinë serbe. Burrin ia morën për pak ditë e nuk e pa për shumë vite. Ajo mendonte se edhe ne tani do burgoseshim për vite të tëra. Ne nuk kishin pse të na

dënonin rëndë, kur gazetari nuk kishte asnjë shenjë në trup. Ne u treguam policisë se dyshonim në të dhe veçsa ishim duke dalur për ta sjellë në stacionin policor më të afërm që ata ta identifikonin.
Gazetari serb u lirua të nesërmen, Qamili dhe unë u liruam pas disa ditësh, pasi u vërtetua se ne nuk kishim shkuar me paramendim dhe se gazetari nuk ishte lënduar askund. Pasi policia hetimore belge kishte vërtetuar se Isa Hoti nuk kishte asgjë të bënte me vrasjen në klubin "Jugosllavia", u lirua i pafajshëm. Si të pafajshëm shteti belg Isës i pagoi një shumë të hollash si dëmshpërblim.

## *Kontributi dhe roli i Musa Hotit nga burgu*

Siç u tha më parë, pas aktit që kishte bërë, Musa Hoti fitoi famë mbarëkombëtare. Kjo i jepte mundësi komunikimi me të gjithë liderët dhe patriotët, të organizuar ose të pa organizuar në tërë diasporën shqiptare. Musës i ofroheshin dy mundësi që asokohe nuk i kishte asnjë shqiptar: të ndikonte pozitivisht dhe negativisht.
Që të ndikonte negativisht ajo dihet që nga starti se nuk ishte i asaj rruge destruktive. Akti që kishte kryer nuk ia lejonte një gjë të tillë,edhe sikur Musa Hoti të merrte miliona dollarë. Madje Musa ishte i vetëdijshëm për çka kishte bërë. Musa nuk kishte nnevojë për konsulta e këshilla se cilës rrugë duhej shkuar,kur ai që në fëmijëri ishte brumosur në frymën kombëtare e ishte çelikosur me organizimin dhe pjesëmarrjen në demonstratat e 1968-tës. Në Kosovë kishte bashkëvepruar me figurat më të njohura të çështjes sonë si me Hilmi Rakovicën e shumë të tjerë. Musës i duhej që ta kanalizonte veprimtarinë e tij në një organizim të mirëfilltë kombëtar, në mënyrë që puna e tij të kishte fryte dhe mendimi i tij të ndikonte në masë.
Duke e parë se Lëvizja ishte organizata politike më gjithëpërfshirëse, jo vetëm në diasporë , por edhe në trojet shqiptare nën Jugosllavi; duke parë së në Lëvizje ishin inkuadruar figurat më të shquara të kombit si Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhoshi,

Sabri Novosella etj; duke e parë se organizimet e Lëvizjes po i përqafonte e tërë pasa popullore në diasporë dhe në Kosovë, Musa Hoti pa hezitim do ta pranonte dhe përqafonte programin e Lëvizjes që njëherë përputhej me mendimet e tij.

Qe nga kyçja në Lëvizje shkrimet në gazetat e diasporës, letërkëmbimet me bashkatdhetarë dhe bashkëveprimtarë nuk do të jenë mendime përsonale, por mendime bazuar në platformën e një organizate politike,të një njeriu me kompetenca të dyfishta: hero i gjallë dhe anëtarë i KQ të Lëvizjes. Sadoqë mendimin e tij të shprehur përmes letrave personale, njerëzia do ta merrnin së pari si mendimin e një patrioti që kishte vrarë ambasadorin jugosllav në qendër të Brukselit, pastaj si mendim të Lëvizjes e krejt në fund si mendim personal. Fjala e tij kishte peshë. Mendimi i tij natyrisht respektohej.

Se Musa Hoti bënte pjesë në hierarkinë e Lëvizjes askush nuk duhej ta dinte. Ishte rregull i programuar i Lëvizjes. Në momentin që zbulohej konspiracioni, Musa e madje anëtari i thjeshtë i një celule do largohej nga Lëvizja. Unë gjithnjë kam qenë kundër që ky rregull të zbatohej edhe në diasporë. E kuptoja se në Kosovë duhej të punohej sekret se po të zbulohej anëtari i shkonte koka aty për aty. Në shtetet ku ne vepronim ishte diçka tjetër; nuk mund të shkoje në konferenca për shtyp të denoncohej politika shfarosëse e Serbisë që bënte mbi popullin shqiptar pa emër e mbiemër. Gazetarët perëndimor duhej të flisnin me njeriun që ekzistonte e jo me hije të njerëzve. Kjo është edhe arsyeja që Lëvizja kurrë nuk ka arritur të bënte punë të mëdha në diplomacinë perëndimore, por kishte impakt tek mërgimtarët tanë e sidomos në daljen masovike në demonstrata.

Dobësia tjetër e Lëvizjes ishte se nuk mbahej asnjë evidencë, nuk ruhej dokumentacioni. Për këtë kemi raste të mjaftueshme si psh. gjatë një bisede që kisha me Sabri Novoselën më thotë se nuk ka ruajtur asnjë letër të tij,sepse gjatë shpërnguljeve nga Turqia në Suedi e tani në Kosovë nuk i ka mbetur asgjë. Unë kam më shumë letra të Sabri Novoselës që m’i ka dërgua mua dhe Musës. Një herë tjetër e pyeta Ibrahim Kelmendin nëse kishte dikund arkiv të fotografive që disa aktivistë të autorizuar të Lëvizjes na fotografonin

në demonstrata. Ibrahimi u përgjigj: nuk ka asgjë. I bindur që ata kanë ruajtur fotografitë, e kërkoja një fotografi time që gjatë një manifestimi në Frankfurt me 1981, kur marshonim Jusuf Gërvalla, unë, Ganiu dhe Beharja, pastaj në sallë kur ndiqnim programin kulturor, pranë Jusufit dikush na fotografonte. Unë e kërkoja këtë fotografi. Ibrahimi më tregoi emrin e njeriut që as kohe fotografonte e tash jeton ende në Zvicër, por nuk ia mori mendja se ai kishte ruajtur diçka të tillë. Madje shtoi se ata nuk kishin ruajtur asnjë numër të "Zëri i Kosovës". Për këtë Ibrahimi i është drejtuar Arkivit Shtetëror të Shqipërisë që të siguronte numrat e "Z.K.". Arkivi i është përgjigjur se çdo gjë e Lëvizjes mund të hapet vetëm pas 50 vitesh. Ambasadat e Tiranës dhe të Beogradit i kanë ruajtur të gjitha letrat, fotografitë dhe çdo gjë tjetër që ka dalë publikisht, siguruar fshehtas përmes bashkëpunëtorëve të tyre. Ne, e sidomos Lëvizja,asgjë.

Në këto kushte anonimiteti vepronte edhe Musa Hoti, si çdo anëtar tjetër i Lëvizjes , pa guxuar të zbulonin emrat e tyre. Ky anonimitet në kushte të sotme krijon vështirësi për të deshifruar letrat dhe shkrimet që ata i kanë botuar në gazetën e tyre. Ky anonimitet më shkakton vështirësi që të di se cili shkrim ishte i Musa Hotit dhe cili jo. Tani po mbushën 30 vjet nga koha që ne kemi shkruar letra mes nesh dhe gjatë leximit të letrave të mia po hasi në vështirësi të gjej se çfarë nofke kishte filani e çfarë fisteku. Më duhet një kohë e gjatë që të thellohem në gjetjen e emrave që asokohe ishin vetëm nofka. Jam i bindur se nëse këto letërkëmbime,që janë me qindra vetëm të miat, nëse nuk i botoj pas disa vitesh nuk do të di të gjendëm ne mesin e tërë atyre personazheve enigmatike por me rëndësi kombëtare.

Sa për ilustrim po zbardh një letër që Musa Hoti i shkruan një miku të tij. Duhet sqaruar se asokohe, ne gjithnjë letrën ia adresonim me fjalët e para: "I dashur mik" kur njiheshim vetëm pak, ose "I dashuri vëlla" kur e njihnim mirë, ose " i dashur shok" kur i shkruanim zyrtarëve të Lëvizjes. Sidomos kur i shkruanim Xhafer Shatrit dhe ai kur përgjigjej kurrë nuk na adresohej "I dashur vëlla" por gjithnjë

"I dashur shok" ose "Të dashur shokë". Xhaferi letrën e tij e përfundonte me shkronjën e madhe U, që ishte nofka e tij Ujkani.

*I dashur mik, shok e vëlla*

*Po e shfrytëzoj rastin t'ju shkruaj nga largësia, që sadopak të jeni në dijeni për ekzistencën time fizike e psiqike. Rrethanat e kanë bërë të vetën- që të katandisemi në situata të ndërlikuara, e që nga këto raste të vështira të dalim faqebardhë- ashtu siç pritët më të drejt. Edhe sikur të mos ishim miq e shokë, jemi vëllezër të gjakut e gjuhës më parë, aq më tepër edhe të një ideali të lartë, që na mishëron për jetë; kurse ambientet e ndryshme nuk do e dobësojnë aspak qëndrueshmërinë tonë. Vërtetë situata ime është pak më specifike e që po tejkalohet me sukses, ku po ngadhnjon vetëmohimi, shpirti i sakrificës e gatishmëria e përhershme në dispozicion të solidarizimit të thellë me kërkesat e drejta e legjitime të popullatës së trojeve tona të lashta, fakte që shpirtërisht më ushqejnë dhe jo vetëm mua. Gjithmonë është prezente vigjilenca dhe konspiracioni, ngase na janë të imponuara nga pala kundërshtare e që i respektojmë me mendje të kthjelltë e me syrin shqiponjë, konsekuenca që na bëjnë më të fortë se kurrë më parë! Rruga e revolucionit e shtruar me gjak, në vend të dafinave, po vazhdohet me bindje të plotë e në fitore të sigurt.*
*Këshillat tuaja të qëlluara, që t'i kushtoj kujdes më madh familjes sime, i kam marr me mirëkuptim të merituar, andaj ju jam mirënjohës për kujdesin që tregoni ndaj meje e familjes sime, kujdes që ia kemi borxh njëri-tjetrit në çdo situatë e veçanërisht në ato pak më delikate, por shok i dashur , para se të bëhem burrë apo babë-kam lind shqiptar e dëshiroj edhe të vdes i tillë çfarë edhe jam. Ju e dini se rruga e revolucionit as që parasheh stangim apo kthim prapa. Ato janë dhe mbesin dëshira, se realiteti është tjetër, gjë që është parë në të gjitha revolucionet e popujve të botës.*
*Një rrugë e shtruar me ferra e gjemba nuk posedon shenja të komunikacionit që të kufizohen të drejtat e vozitësit, gjegjësisht të mbetet në gjysmë të rrugës ( se patriot e revolucionar është vetëm*

*ai që qëndron deri në fund të fundit), ku pikënisja dhe caku janë të njohur e që më çdo kusht duhet të tejkalojë të gjitha pengesat e pritura e të papritura, përndryshe sakrificat dhe obligimet tona i pezullojmë në gjeneratat vijuese apo në fëmijët, nipat e mbesat tona, punë që nuk na e lejon ndërgjegjja – nëse kemi sadopak- e që ne duhet t'iu dalim zot njëherë e përgjithmonë!*

*Piketimet e depërtimit në thelbin e çështjes- janë bërë, kurse Lëvizja e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (që i përfshinë të gjitha grupet patriotike e revolucionare në vend dhe jashtë), paraqet limit të kundërthënieve të shkaktuara absurde (shaka që e mohon ekzistencën e një solucioni të dytë drejt zgjidhjes së çështjes), problematikë e shkaktuar dhe e kultivuar gjatë nga doktrina dekadente e palaçove e që më të drejt hasen në ashpërsinë e subjektit të ngritur, çështje që nuk zgjidhen në tavolina të rrumbullakëta nga gënjeshtarët në tribuna antipopullore e antishqiptare, që duan të lundrojnë mbi gjakun e vet për një jetë të premtuar, e që mund të zgjidhen me unitet e me ngjyrën e flamurit. Ata pseudopatriotë ( si tejpamës e gjeni që janë), preferojnë shtrirje të qafës para kasapit, kurse rryma e revolucionit imponon bukë e liri, aksione e progres e që po afirmohet drejt masovitetit të plotë suksesiv. Rrugën e dytë të gjarpërinjve të gjakut, rrugën e turpit e të tradhëtisë, rrugën e zezë e të pakrye mund ta vazhdojnë ata që edhe e filluan, por jo kurrë punonjësit e shkollarët e të vetëditurit.*

*Nuk jemi në gjendje të kënaqemi me rezultatet e arritura, kur tani sa jemi nisur nga starti i vonuar e i përgjumur, por kryesore është gjetur rruga e vetme që do vazhdohet pa asnjë pushim të vogël.*

*Si luftëtar i përjetësimeve të aspiratave të Lëvizjes së LRSSHJ, si revolucionar i vogël e i parëndësi, si biri i trojeve tuaja të martirizuara do i qëndroj besnik i përjetshëm i kushtrimit dhe i Zërit të Kosovës- që është vetë zëri i vullnetit , i nevojës, i kërkesës për një rreze drite, e që në mënyrë paqësore dhe simbolike do e përkrahi rrugën e vetme të nderit- gjer në vdekje.*

*Pak fjalë për LRSSHJ-në. Përveç organeve punëdrejtuese të L. në vend, degëve e celulave në të gjitha viset shqiptare nën Jug, L. disponon edhe shumë degë e celula në mbarë botën e komuniteteve*

*shqiptare në botë, duke i përfshirë në gjirin e saj të gjitha grupet apo shoqëritë e deridjeshme patriotike revolucionare të Kosovës.*
*Me përvojë prej dy dekadash, me kuadro mahnitëse dhe me prezencën e shpirtit të lartë të sakrificës- ajo po e çanë rrugën e vështirë- drejt sigurimit të të drejtave elementare- që garantohen në paçavuren kushtetutë, e tenton të na i mohojë i huaji. Rruga e gjertanishme e L. ka përjetuar rënie e dobësime ( gjer më 1981), po ja që gjeti shprehje thënia: "një bie, njëmijë tjerë ngritën"!.*
*Aktivitetet e Lëvizjes në vend i dëgjoni më mirë se unë, kurse aktivitetet paqësore jashtë atdheut ende janë në përsosje e sipër. Përveç demonstratave madhështore, shfaqjeve të koncerteve, dramave e filmave, klubeve e shkollave etj L. përmban edhe organin e saj- gazetën " Zëri i Kosovës" dhe revistën letrare artistike, shoqërore e politike "Iliria" , që botohet në çdo muaj ( në perspektivë botimet të shpeshtohen duke i përfshirë edhe gjinitë tjera letrare si: drama, romane, përmbledhje vjershash, etj), e që financohet vetëm nga simpatizuesit dhe anëtarët e L. në vend dhe jashtë tij. Shpërndarja kryhet në rrugë delikate në vend, kurse jashtë mes degëve që lindin si këpurdhat pas shiut. Materialet që botohen në to kryesisht 80% janë nga autorët e vendit e përqindjen tjetër e plotësojmë ne kosovaret në mërgim.*
*Prezenca e konspiracionit është e përhershme dhe degët me anëtarë formohen në mënyrë zinxhirore, që pastaj veprojnë me pseudonime. Kështu që edhe në rast së arrin ndonjë parashutë i huaj, ai nuk mund të njohë më shumë se dy vetë- ku qëndrimi i çdonjërit përcillet me vëmendje e maturi. Redaksia me seli në Zvicër, pas materialeve për botim, materiale për Amnesty Internacional etj, pranon edhe ndihma materiale (kryesisht nga kosovarët), për familjet më të goditura të vendit, që pastaj shpërndahen në mënyrë të organizuar. Janë bërë edhe demarshe të vlefshme në të gjitha format ndërkombëtare- deri në OKB, gjëra që vazhdojnë gjithnjë.*
*Në faqet e shtypit botohen dhe do të botohen edhe dorëshkrime të shumta të heronjve e dëshmorëve të kombit siç janë : A.Demaçi, F.Grajqevci, H.Rakovica, J e B. Gërvalla, K Zeka, dhe shumë të tjerë –duke i përfshirë edhe veprat e kolosve të Rilindjes.*

*Bashkëpunimi i vendosur me penat e vendit po lulëzon nga dita më ditë, kur respektohen të gjitha normat e parapara me aktet normative të qendrorit e që punimet i dërgojnë përmes analeve të sigurta- duke mos u rrezikuar. Ato kanë vlera të larta ideo-artistike dhe paraqesin zhvillim të mbarë për letërsinë dhe kulturën tonë në tërësi. Prandaj nuk mungon bashkëpunimi ( me diasporë të caktuara) me albanologë e intelektualë të huaj që janë miq të shqiptarëve. Ata e përkrahin luftën tonë me shkrime të ndryshme në shtypin e tyre zyrtar. E tërë bota e ka kuptuar realitetin e hidhur të shqiptarëve në jugun " e civilizuar " specifik, e me plotë të drejtë e demaskojnë hegjemonizmin e saj- që tentojnë ta gënjejnë botën duke e fshehur realitetin, por opinioni botëror nuk është aq i marrë-si e dëshiron jugu.*



3

vetme, që do vazhdohet pa asnjë pushim sado të vogël.

Si luftëtarë i përjetësimeve të aspiratave të Lëvizjes në RSSH-së, si revolucionarë i vogël e i parëndësi, si i biri i trojeve tuaja të martirizuara do të qëndroi besnik i përjetshëm i kushtrimit dhe i Zërit të Kosovës - që është vet zëri i vullnetit, i nevojës, i kërkesës për një rrezre dritë, e që në mënyrë pagësore dhe simbolike do e përkrahi rrugën e vetme të nderit - gjer në vdekje.

Pak fjalë për LRSSH-së-në: Përveç organeve udhëdrejtuese të L. në vend, degëve e celulave në të gjitha viset shqiptare në jug, L. disponon edhe shumë degë e celula në mbarë botën e komuniteteve shqiptare në botë, duke i përfshirë në gjirin e saj të gjitha grupet apo shoqëritë e deridjeshme pat. rev. të Kosovës. Me përvojë prej dy dekadash, me kuadra mahnitëse dhe me prezencën e shpirtit të lartë të sakrificës, ajo po e çanë rrugën e vështirë - drejtë sigurimit të të drejtave elementare - që garantohen në pagavurën kushtetutë e tentan t'na i mohon i huaji. Rruga e gjertanishme e L. ka përjetuar rënie apo dobësime (gjer në '81), po pa që gjeti shprehje thënja: një bjenë - mijëmijë tjerë ngriten!

Aktivitetet e L. në vend i dëgjoni më mirë se unë, kurse aktivitetet pagësore jashtë atdheut ende janë në përvojë e sipër. Përveç demonstratave madhështore, shfaqjes së koncerteve, dramave, filmave, klubeve, shkollave etj. L. përbanë edhe organin e saj - gazetën „Zëri i Kosovës" dhe revistën letrare, artistike, shoqërore e politike „Ilirja" që botohen në çdo muaj (në perspektivë botimet shpeshtohen - duke përfshirë edhe gjini tjera letrare, si: drama, romane, përmbledhje vjershash etj.), e që financohen vetëm nga simpatizuesit dhe anëtarët e L. në vend e jashtë tij. Shpërndarja kryhet në rrugë delikate në vend, kurse jashtë mes degëve që lindin si këpurdhat pas shiut. Materialet që botohen në to, 80 % janë nga autorët e vendit e përqindjen tjetër e plotësojnë kosovarët në mërgim.

***Letra që Musa ia kishte dërguar një miku të tij***

***Korrektesë, parimësi dhe përgjegjësi shoqërore dhe atdhetare***

## Komentimi i letrës

Ata që këtë letër e lexojnë më vëmendje do të zbulojnë shumë gjëra, por, para së gjithash, korrektësinë dhe respektin ndaj korresponduesit, por edhe përgjegjësinë shoqërore dhe atdhetare për problemet që trajtohen në letër. Përmes kësaj letre dhe letrave të tjera,që meritojnë një botim të veçantë, do të arrihet të kemi një pasqyrë shumë më reale se sa librat të cilët ne i shkruajmë, qoftë si monografi, qoftë si kujtime apo si dokumentet. Letrat dhe artikujt e botuar në atë periudhë do t'i ndihmojnë studiuesit të gjeneratave të ardhshme të ndërtojnë piramidën objektive të luftës sonë dhe të situatës së asaj kohe.
Në këtë letër do të shohim se Musa Hoti e paraqet opinionin e tij lidhur me luftën që duhet bërë deri në vdekje për të arritur te fitorja përfundimtare. E shohim se Musa është i determinuar të punojë për çështjen kombëtare deri në vdekje dhe se sipas tij, hero është vetëm ai që luftës çlirimtare i shkon deri në fund.
Përmes kësaj letre duket se Musa Hoti i është drejtuar ndonjë shoku të tij që ende nuk ka njohuri të mjaftueshme për Lëvizjen. Musa Hoti i jep njohuri të përgjithshme duke mos e zbuluar vetveten së është anëtar i Kryesisë së L, por i shkruan së është një njeri me rëndësi krejt të vogël si çdo anëtar tjetër. Për ta bindur atë më mirë, i shkruan se Lëvizja ka degët kudo në botë, ka celulat e treshit të cilat ia arsyeton pse janë krijuar vetëm me tre individë. I tregon se Lëvizjes iu është imponuar sistemi i treshit, nga se nëse ndonjë spiun përpiqet të futët në organizim si parashutë, ai nuk do ka mundësi të zbulojë më shumë se dy vetë me të cilët bashkëpunon. Musa rrëfen për "Zërin e Kosovës" si dhe nuk harron t'i shkruan se kemi edhe një revistë letrare "Iliria" . Unë nuk isha asnjëherë në dijeni se Musa bënte propagandën pozitive për revistën time. Tani pas shumë dekadave po e zbuloj punën e tij lidhur me nxjerrjen e

revistës letrare. Këtu shihet se Musa Hoti nuk ka xhelozuar në ata që kanë kontribuar për çështjen kombëtare.
Tërë letrën e përshkon fryma e atdhedashurisë që rrëfehet përmes individit, familjes dhe shoqërisë në përgjithësi.
Pas një vizite të Ibrahim Kelmendit në ShBA Musa do shqetësohet lidhur me ato që Ibrahimi kishte biseduar në Nju Jork, Detroit dhe qytete tjera. Bashkatdhetarët me të cilët ka bashkëpunuar dhe ata që nuk ka bashkëpunuar i shkruajnë Musës se çfarë kishte folur Ibrahimi ne biseda me ta. Sipas të gjitha letrave dhe kur pas një viti kur unë isha në SH.B.A. të gjithë më pyesnin nëse ishin të vërteta fjalët që kishin dëgjuar nga Ibrahimi. Ibrahim Kelmendi në librin e tij shkruan se pas vrasjes se trefishtë Jusufit, Kadriut dhe Bardhoshit iu është dashur të shkonte në Amerikë pasi në Europë kishin filluar ta akuzonin padrejtësisht
Dhe se i kishte humbur konaku kudo që shkonte. Më shkuarjen time në Amerikë dhe në të gjitha qytetet ku kishte qenë Ibrahimi dhe me të njëjtit bashkatdhetar e kuptova se Ibrahimi asgjë nuk kishte rregulluar dhe sistemuar në komunitetin tonë të atjeshëm. Me këdo që flisja pyetjet e para ishin: “ A e ka vra Jusuf Gërvallën Ibrahim Kelmendi?” dhe “Musa Hotin a e kanë shti UDB-a me vra ambasadorin? ”. Përgjigjja ime ishte e prerë: Ibrahim Kelmendi nuk e ka vra Jusuf Gërvallën dhe Musa Hotin nuk e ka shti UDB-a me vra diplomatin e vetë”. Përgjigjet e mia ishin të pakuptimta për mërgatën tonë në Amerikë. Sipas tyre nëse unë isha shok me Sabri Novosellën dhe me Musa Hotin, pse nuk thoja se Ibrahimi e ka vra Jusuf Gërvallën dhe pasi përgjigjesha se Ibarahimi nuk e ka vra Jusuf Gërvallën atëherë sipas tyre nuk u thoja se Musa Hoti duhej të ishte spiun i Serbisë. Pas qëndrimit tim disamujorë në Amerikë vërejta se Ibrahim Kelmendi nuk ishte interesuar ta qetësonte mërgatën tonë të atjeshme por kishte bërë ndarje jo vetëm ideologjike, por edhe ndarje brenda Lëvizjes. Grupi i Zef Camajt që e kishte emisionin e tij dhe fliste kundër Enver Hoxhës ishte thelluar në hasmëri me grupin e njëfarë Qazimit i cili poashtu fliste në radio kundër ballistëve e zogistave dhe e lavdëronte në qiell Enver Hoxhën. Me intervenimin tim Zef Camaj dhe grupi tjetër u arrit

njëfarë kompromisi se pakut të mos vinte deri të vëllavrasja. Në anën tjetër Ibrahimi kishte thelluar problemet brenda Lëvizjes duke folur kundër Sabriut dhe Musës dhe shqiptarët ishin ndarë kush është me Sabriun, Xhaferin dhe Musën e kush me Ibrahim Kelmendin. Ata habitëshin se duhej te isha kundër njërit apo tjetrit sepse bashkë nuk ishte e mundur. U tregova se bashkë është e mundur nëse ju koncentroheni ne aktivitet tuaja pa i dëgjua tjerët nga jashtë. Kështu bashkë me Zef Camajn e disa majtistë tjerë arrita të bashkohemi e të bëjmë filmin "Procesi" të Jusuf Gërvallës".

Ibrahimi me sjellje të tij, të disa kishte lënë përshtypje të mira. Më tregonin se si rrinte mbyllur me ditë të tëra në banesën e Ahmet Zherkës vetëm duke shkruar me një makinë shkrimi. Ata habiteshin me mua pse nuk rrija duke shkruar si Ibrahim Kelmendi. U thoja se ai ka detyra të mëdha në Lëvizje dhe se preokupohet me të gjitha ndërsa unë që nuk jam i Lëvizjes jam njeri i veprimeve konkrete.

U thoja se Musa Hoti kishte bërë një akt patriotik dhe se në historinë tonë kombëtare është akti i vetëm që është bërë ndonjëherë që është bërë në kohë dhe moment të duhur.

Musa Hotit nuk i hiqej shqetësimi se pse Ibrahim Kelmendi nuk po i përgjigjej në letrën e tij ku kishte kërkuar sqarime rreth bisedave te tij në Amerikë me Kolë Gojçin në Detroit. Ibrahimi nuk i përgjigjej e Musa i shkruan Sabriut dhe Xhaferit për t'i njoftuar dhe ja si Xhafer Shatri i përgjigjet:

*" I dashur shok,*

*Po të përgjigjëm shkurtimisht në dy letrat tua të fundit dhe po të njoftoj më sa vijon:*

*Letrat e gjata 10 faqëshe i kam marr dhe për ketë të kam njoftuar në një letër të mëparshme.*

*Sa për I.K. mendoj se nuk duhet ta dramatizosh këtë punë, unë kam biseduar më të lidhur për atë çeshite dhe ai më tha se ka biseduar me Isain në Shtutgard dhe i ka thënë atij shkakaun pse ai nuk po shkruan përgjigje në letrat tua.*

*Sidoqoftë unë mendoj se ti po i kushton rëndësi një çështjeje që s'meriton të përmendet, sepse nëse ti dhe IK nuk gjeni gjuhë të*

*përbashkët për një ose më shumë çështje kjo s'është tragjedi kur dihet se jeta është përplot kundërthënie të përditshme edhe në mes njerish edhe shumë më të afërt.*
*Ta kam thënë edhe më parë se i lëshin fjalët nganjëherë pa i matur fare, prandaj mos u shqetëso kurrë për këtë, sepse ka kush të mbrojë ty, nuk ke nevojë ta mbrosh vetën , siç të kam thënë edhe më parë, koncentrohu dhe jep propozime konkrete se si të dalësh jashtë, për ty dhe për ne, kjo është e rëndësishme. Fjalët i merr era. Sa për atë që ti thua se të kanë thënë shokët se IK qenka njeri i madh në Lëvizje, do ishte mirë që të më shkruash për këtë menjëherë dhe sa më gjerësisht. Dhe mundësisht kjo të mbështetët ne fakte. Me Vl dhe Resh. Jam në kontak të përhershme. Shokët e atjeshëm nuk na dërguan një punim se si ka shkuar gjykimi. Unë po habitem me ata njerëz.*

*Të fala vëllazërore*
*ZK*
*Mërgim*

I dashur shok,

po tè pèrgjigjem shkurtimisht nè dy letrat tua tè fundit dhe po tè njohtoj me sa vijon:

Letrat e gjata lo faqshe i kam marrè dhe pèr kètè tè kam njohtuar nè një letèr tè mèparshme.

Sa pèr IK,mendoj se nuk duhet ta dramatizosh kètè punè,unè kam biseduar me tè lidhur me atè çèshtje dhe ai mè tha se ka biseduar me Isain nè Stut. dhe i ka thènè atij pèr shkakun pse nuk po shkruajka pèrgjegje nè letrat tua.

Sidoqoftè,unè menoj se ti po i kushton rèndèsi njè çèshtjeje qè s'meriton as tè pèrmendet,sepse nèse ti dhe IK nuk gjeni gjuhè tè pèrbashkèt pèr njè ose mè shumè çèshtje kjo s'èshtè tragjedi,kur dihet se jeta èshtè pèrplot kundèrthènie tè pèr[illegible]s-me edhe nè mes njerèzish edhe shumè mè tè afèrt.

Ta kam thènè edhe mè parè se I. i lèshon fjalèt nganjèherè pa i matur fare,prandaj mos u shqetèso kurrè pèr kètè,sepse ka kush tè mbron ty,nuk ke nevojè ta mbrojsh vetèn,siç tè kam thènè edhe mè parè,koncentrohu dhe jep propozime konkrete se si tè dalèsh jashtè,pèr ty dhe pèr ne kjo èshtè e rèndèsishme.Fjalèt i merr era.Sa pèr atè qè ti thua se tè kanè thènè shokèt se IK qenka njeri i madh i L. do tè ishte mirè qè tè mè shkruajsh pèr kètè menjèherè dhe sa mè gjèrèsisht.Dhe mundèsisht kjo tè mbèshtetet nè fakte.Me Val. dhe Resh. jam nè kontakt tè pèrher-shèm.Shokèt e atyshèm nuk na dèrguan njè punim se si ka shkuar gjykimi.Unè po habitèm me ata njerèz.

Tè fala vèllazèrore

ZK

Mèrgim,4 mars 1983

***Letra e Xhafer Shatrit dërguar Musa Hotit***

Kjo letër përsëri nuk ia hiqte mërzinë Musës i cili nga burgu nuk kishte se si të lëvizte e kundër tij flitej. Po të ishte në liri mërzia do ishte më e vogël. Madje si të mos mërzitej kur fjalët sa shkonte përhapeshin edhe më. Fjalët e tilla Musën e rëndonin psiqikisht dhe moralisht. Kishte vra diplomatët jugosllav e çka mund të bënte më shumë për të dokumentuar se ishte kundër Jugosllavisë? Të vritej! E pse të vritej, kur kishte pasur mundësi t'i vriste?
Vizita ime në Amerikë dhe zhvillimi i bisedave të mia me Kolën në Detroit dhe me tjerët ne Nju Jork bënë që Musa të ndjehej mirë. Bisedat e mia i raportonin bashkatdhetarët tanë njëlloj siç dikur ato të Ibrahim Kelemndit.

*Letra, dërguar Ibrahim Këlmendit*

IBRAHIM KELMENDIT
**Postfach 250321**
**4630 Bo-Querenburg**
**w.Germany**

**Vetëm ju qenkeni shqiptar, e ne tjerët paskemi zbritur nga Venera?**

## Bashkatdhetar i nderuar, 4 prill 1983

*Cilido shqiptar i mirë që e ka dëgjuar emrin Tuaj, sigurisht ushqen respekt e admirim për virtytet patriotike që i posedoni. Nuk kam patur rast të ju njoh nga afër dhe sidomos pas botimit të "BASHKIMIT", dëshiroja të njihem ,të bisedojmë, t'ia qajmë hallet e njëjta njëri-tjetrit si vëllezër, por si e dini edhe ju, kushtet e atëhershme diktonin që mos t'i i imponohemi njëri -tjetrit dhe secili*

*të ballafaqohet me realitet në mënyrë të tij, kuptohet vetëm në favor të çështjes sonë të madhe.*
*Nuk i kam meritat tuaja, por as nuk qëndroj shumë prapa jush, se edhe mua ne damar më qarkullon gjak i pastër shqiptari. Kam vepruar aq sa kam patur mundësi pa e kursyer vetën asnjëherë, dhe në asnjë mënyrë, për to nuk dëshiroj të flas, ngase flasin të tjerët, e si një njeri, e shqiptar i thjeshtë, i urrej mburravecet që i numërojnë me radhë anët e tyre pozitive ose të bërat e tyre, kurse ka kush i vlerëson, ose nëse janë për t'u denoncuar - prapë ka kush i gjykon për çdo person veçmas.*
*Si e keni dëgjuar edhe ju, më 4 gusht 1981, ndodhi ngjarja e padëshiruar dhe kushdo që kishte më qenë në vendin e situatën time - sigurisht ishte mbrojtur nga "diplomatët" e etshëm për gjak shqiptari, kështu që krejt rastësisht shpëtova nga ai atak i organizuar i UDB-ës dhe shtatë ditë qëndrova në ilegalitet duke pritur një përkrahje të vogël të disa shokëve të caktuar për evakuim. Pas pritjes pa përgjigje - pak edhe më fajin tim, por më shumë me faj të tjetërkujt.*
*ku për aferën time shkruhej edhe emri i juaj -si nxitës! Fakti që ne as që njiheshim më bëri të mendoj për shkaqet e një shkrimi të pa bazë dhe erdha në këtë përfundim: Emri i juaj ishte shkruar edhe më parë si një marksist që i përkrahë te drejtat e popujve-gjegjësisht të Kosovës. Emri im ishte cekur që nga prishja e mbledhjes në klubin shqiptare "PERPARIMI" , ku disa karagjoz donin t'i dënonin demonstratat dhe kryengritjen kosovare dhe me intervenimin apo diskutimin tim të urtë, ato tendenca u shafitën një herë e përgjithmonë, rast kur edhe klubi filloi të shembet si çerdhe e spiunazhit subversiv Jugosllav, pastaj as jugosllavët nuk hanë barë që të më akuzonin si ballist apo zogist, kur me kanë njohur si komunist në Kosovë dhe si njeri korrekt me 12 vjet përvojë pune në arsim. Pra, logjikisht e kane ditur se M. HOTI nuk lejon të përlyhet me organizata reaksionare dhe duhet te jetë aty ku është filani e fisteku që paraqesin grup Marksist-Leninist, për ç'gjë jam marrë ne pyetje sa herë ka dirigjuar qeveria e Beogradit në policinë vendase (belge, shënim im), dhe kurrë nuk ua kam thënë asnjë fjalë që mund*

*ta kompromitoj Hasanin apo Hysenin, Behlulin apo Kajtazin. Gjithmonë kam deklaruar se "diplomatet" me kane atakuar për shkak të shkrimeve gazetareske në revistën "ZERI I KOSOVES " që dikur e botonim me Enver Hadrin -si grup Marksist - Leninist, që u shua pas arrestimit tim- e qe ata numra dhe shumë shkrime tjera i kishin në depozitë. Për raste tjera apo për emra tjerë as që i kam lejuar të më pyesin, se mjaft kanë tentuar të më nxisin të flas për tjerët -duke më premtuar lirim e çdo " te mire", kur edhe u detyrova tua them haptazi e në mënyrë demonstrative: "jeni shume te mjerë nëse mendoni se për shkak të lirisë mund ta ktheni intelektualin shqiptar në vegël tuaj qorre dhe protestoj ashpër kundër çdo bisede të tillë ! Nëse jam i arrestuar,mos mendoni se mund ta përdhosni dinjitetin, karakterin dhe krenarinë time, që për të gjallë as ju e as miqtë tuaj jugosllav nuk do ia arrini qëllimit kurrë !". Zotëri Hoti, mendoni pak më mirë për vetën tuaj e për fëmijët që ju presin, se ne disponojmë metoda shumë të rënda për kundërshtarët tanë komunist, e mos po i'u behët tepër vonë, me tha komiseri kryesore i shërbimit shtetëror -ne praninë e 4 komiserëve të xhandarmerisë dhe 4 tjerëve të policisë juridike, por kurrë nuk i kam konsideruar as për njerëz . Me suallën " deklarata" të shqiptarëve kundër meje (të falsifikuar) , 280 teleksa te Beogradit (UDB-së) , dhe disa qindra fotografi të mia, që as vetë nuk e di se si e ku i kanë marrë (pos disa në manifestime që i bënte Vahid Reka) , dhe më akuzonin për "shef" të mërgatës shqiptare në Europë, profka e shpifje që ua hudhja turinjve me gjakftohtësi të rrallë dhe si rezultat i dorës së tyre të gjatë të fuqishme, u vendos syrgjynosja ime si e keni dëgjuar edhe ju, por shpirti i shqiptarit nuk thyhet as para vdekjes me të tmerrshme se lëre më para torturave të tyre fizike e psiqike!*

*Që nga dita e parë, në "kullë" kam tretman te posaçëm si një kafshë e xhunglës dhe hallet e mia i kam fshehur nga familja e nga shoqëria e shumtë -qe mos t'i demoralizoi dashamiret, e në kushte tejet-tejet të vështira nuk i kam dhënë vetës të drejtë të pasivizohem dhe kam vepruar përtej mundësive të mia në favor te Lëvizjes. Qëndrimi im ka qenë korrekt dhe nuk i kam zhgënjyer s'pari prindërit e mi, familjen e me gjerë. Por, nuk mund të kaloj pa e*

*cekur edhe mirëkuptimin e përkrahjes morale (besa edhe materiale) të bashkatdhetarëve të ndershëm , ku edhe me letra e kemi zgjeruar aktivitetin tonë paqësor, në dobi të çështjes e të Kosovës sonë të dashur. Nga logjika e dini mirë se në raste të tilla, përkrahja morale ka rëndësi të posaçme dhe i jam mirënjohës çdo shqiptari të mirë që në ndonjë mënyrë është solidarizuar me mua, mirëpo ka patur (fatkeqësisht) edhe të tillë që i janë bashkangjitur fushatës se egër armike –që të " komprometojnë" çdo person apo shqiptar të dalluar, metodë kjo e vjetër sa njerëzimi "përçaj e sundo! "*
*Në këtë aspekt -sigurisht pa dashje -jeni zhytur edhe ju rast që ka mbjellur dyshime të disa persona të caktuar e të painformuar (si te Kola p.sh), ,se ato fjalë (Musa është agjent i Beogradit) , nuk i tha një kushdo -po një emër i njohur edhe jashtë Europës! Për këtë nuk keni bërë vetëkritikë ende, e që në masa mund të mbjellë dyshime për personalitetin tuaj, se kur dihet një " bombë" e tillë ose duhet të argumentohet ose mbjellë dyshime se ai që i hedhë gjërat e tilla i bënë shërbim palës së kundërt!? Pra, me dashje apo pa dashje vetën e keni ngarkuar më barrë të huaj dhe me vjen shumë keq, po nëse gabimi i një natyre përafërsisht të njëjtë përsëritet -atëherë edhe nuk tolerohet nga askush. Ne vend që jazi i krijuar të zbutët e të mbyllet, në mënyrë të tillë, jazi po thellohet dhe po e dëmton kauzën tonë e po i bëjmë shërbim të huajt, kurse keni mundur të gjeni gjuhë të përbashkët dhe nëse diçka keni pasur të pakjartë , keni mundur te informoheni nga shokët apo edhe nga unë, pasi që i shërbejmë të njëjtit ideal -kush më pak e kush më shumë- e që edhe nga ky aspekt përgjegjësia mbetet mbi ju, kur dihet se 20 muaj jam i izoluar dhe nuk i kam mundësitë e juaja të komunikimit.*
*Në letrën e para 7-8 muajsh ua kam shkruar disa gjëra globale e ajo letër i'u ka befasuar, por si ajo -si kjo e sotmja, nuk duhet të ju befasojnë e as tronditin, se nëse ka gjëra të vërteta –të vërtetës nuk mund t'i shmangeni as ju e as unë, e ato nuk duhet të ju pengojnë , po nëse janë të pavërteta –atëherë përse të ju shqetësoi e pavërteta ?!*
*Ju jeni bindur në shpifjet e huaja pa i verifikuar dhe i keni shikuar gjërat me dulbi nga një lartësi që nuk ua lejon morali komunist ,*

*kurse keni mundur te zbritni pak më poshtë, te lidheni më afër e më ngushtë me njerëz të mirë e me masën që vetvetiu t'i zbërtheni ekuacionet e panjohura për ju e tek atëherë të vepronі sipas rezultateve të anketës: Nëse anketa ishte treguar e kundërt me shpifjet e huaja , nuk kishit vepruar si keni vepruar, por nëse ajo ishte treguar negative, prapë nuk kishte qenë vonë të thuhet bile botërisht e pa e fshehur emrin. Ndaj tipave të huaj kam qenë dhe jam i ashpër, jam i pamëshirshëm dhe fare nuk pritoj t'i demaskoj me fakte.*

*Mirë, ai gabim rrëshqiti dhe Kolës nuk ia pranuat atë gabim tuajin, po te rasti i Reshatit ç'kemi ?! Qe nga fillimi i hapave te parë të ''ILIRISE'' ne mënyrë direkte ose indirekte keni tentuar ta bojkotoni veprimtarinë e saj paqësore , duke formuar grupacione te thirrura ne emrin tuaj. Nuk e mbroj Reshatin, por punën e tij te mirë patriotike e përkrahi më gjithë shpirt, dhe jo vetëm te tij, por të çdo patrioti e revolucionari të vërtet që e arsyeton vetin me punë paqësore, me sakrifica e me ndjenja të larta atdhedashurie, se sot e as kurrë -pa sakrifica nuk arrihet asgjë. Ai dinte ta ndante kafshatën nga gojët e fëmijëve te tij, dhe të veprojë në dhënien e revistës ''ILIRIA'' në formimin e grupit dramatik -qe mos t'ia numëroj disa gjëra tjera që i kanë arritur me shokët tjerë në BXL, derisa lindën apo u importuan përçarjet aktuale.*

*Reshati, Musa apo Ibrahimi e paskan një dobësi? Po, atëherë të shifet se ajo dobësi a është për t'u rregulluar –përmirësuar apo për t'u gjykuar dhe assesi të izolohet nën akuzën e pavërtetë të bajraktarit ! Apo mos ua ka rrezikuar juve vendin e ''bajraktarit'' ! që ta ''zbritni'' nga platforma nën pretekste qesharake ?*

*Ndoshta po logjikoj me gabim, por sa e di unë, bajraktarët -nëse ashtu mund t'i quajmë – gjenden në vend dhe jashtë veprojnë degët ose celulat e Lëvizjes që formohen nga kuadro të besuara, të njohura e të provuara dhe vetëm si Luftëtar të Lirisë. Po nëse ndonjëri dëshiron ta privatizoi LËVIZJEN, të quhet themelues i saj dhe kumandar, atëherë ku po mbesin meritat e atyre që u përgjakën, që dirgjen nëpër kazamatet Jugo-Fashiste dhe që veprojnë në kushte të njohura delikate?*

*Edhe nëse bash është meritë e juaja personale, ju apo kushdoqoftë tjetër, meritat duhet t'ia hedhë popullit dhe avangardës apo pararojës së saj LRSH-J-së, se vetëm në atë mënyrë e afirmojmë Lëvizjen. Lëvizja nuk është mërgate e qyqeve që të dirigjohet nga një Musë, Reshat apo Ibrahim,kur aty vlon vullneti i një populli të tërë të vuajtur e të shtypur si është më keq nga çetnikët dhe bashkëmendimtarët e tyre. Jam dakord, të gjithë të kemi merita nuk duhet t'ia humbim vetit më fjalë të pamatura e të ulëta, se edhe për to ka kush jap mendime e vlerësime. Sipas praktikës suaj të gjertanishme (kuptohet aq sa di unë, se ndoshta një e di e njëqind nuk i di, por për ato që nuk i di , nuk mund të më fajësoi askush) , Musa na dual "spiun", Reshati u izolua se na qenka marrur me njerëz "te dyshimte", ai i keq , ky i lig, ai tjetri ballist dhe me fjalë tjera, po ua impononi njerëzve që vetëm ju na qenkit i mirë, se ju vendosni për interesat e Lëvizjes, se ju pyetni për formimin e degëve te reja dhe pa "vizën" tuaj nuk bëhet asnjë çap! Po , a mos nuk janë ekzagjerime të tepruara që e kalojnë çdo kufi, se vetëm ju qenkit shqiptar e ne tjerët kemi zbritur nga Venera?*
*Për vizitën tuaj në BXL u njoftova nga gjashtë shokë. Katër prej tyre më këshillojnë të mos i'u shkruaj, se : "Ibrahimi qenka njeri i madh ne Lëvizje dhe mund të ju "izolojë" njëlloj si Reshatin"! Mua me vjen shumë mirë që jeni aq i madh, se si i tillë bile ju nuk guxoni të gaboni. Po nëse vërtetë jeni aq i madh, as nga vërejtjet e mia nuk do hidhëroheni, se i madhi duhet ta tolerojë të voglin. I vogëli edhe nëse e bënë ndonjë gabim të vogël të rastit (si unë më këtë letër të dytë që ua them lirshëm atë që mendoj se duhet t'ua them), atë nuk e njeh askush dhe përgjegjësia është më e vogël, kurse të ju është e kundërta.*
*Si po e shihni, qëllimet e mia janë thjeshtë njerëzore e vëllazërore. Nuk dëshiroj të krijoj keqkuptim mes nesh, jo, e çmoj të kundërtën, se armiqtë tu janë edhe armiqtë e mi, e cili ka më shumë armiq -nuk po hy, se e di fort mirë. Kësaj rruge nuk i kemi hy nga dëshira e aventurave, por nga nevojat për veti e për fëmijët tanë dhe dëshiroj të kemi gjuhë të përbashkët si me luftëtarët tjerë të lirisë. Nëse diçka e keni të pakjartë dhe doni ta dini, lirisht më shkruani dhe ju*

*përgjigjem si vëlla, por jo si kumandar ngase jam alergjik ndaj gjeneralëve të pa fron ! Me thashethëna nuk dëshiroj të mirrem.*
*Të unë flet vetëm gjuha e fakteve, se të e fundit nuk jemi gra të këqija. Kopja e letrës i dërgohet personit të autorizuar të Lëvizjes, që as sot e as nesër të mos mundeni të mi shtoni apo mungoni fjalët e shkruara. Këtë kujdes ma imponon qëndrimi i juaj.*
*Përshëndetje nga bashkatdhetari i juaj i vogël,*

**19,Rue de L'eglise St. Anne**
**1080 Bruxelles Musa Hoti**

## *Relacione konfliktuale në relacionet Ndërshqiptare të diasporës*

Siç kemi parë në faqet e para të librit, relacionet ndërshqiptare në diasporë nuk ishin aq të lakmueshëm. Ky mosbesim në mes aktivistëve krijohej jo vetëm nga dy shërbimet sekrete Tiranë e Beograd. Faktori xhelozi ishte po aq i dëmshëm dhe i rrezikshëm sa dy shërbimet sekrete bashakarisht. Më kot akuzoheshim mes veti pa pasur asnjë fakt e asnjë provë se shoku ynë mund të ishte spiun i UDB-së. Ti mund të sakrifikoje familjen, tjetri të quante spiun dhe gjente pretekste banale se po sakrifikohesh që të fitosh besimin. Ti mund të të vriteshe prej serbëve, tjetri edhe për së vdekuri do të gjente pretekste siç gjetën më vonë për Vehbi Ibrahimin, për Enver Hadrin, për Rasim Zenelin që Serbia i kishte vrarë. Ti mund të shpëtoje gjallë e të mos vritesh , tjetri të quante spiun sepse ti nuk je vrarë, por të ishe i mirë Serbia të kishte vrarë siç i vranë tjerët. Madje keni lexuar në shtypin të pasluftës kur një ministër e ndonjë deputet pa kurrfarë turpi deklaron: “UDB-ja e ka lëshue Adem Demaçin, se po të kishte qenë aq patriot sa na shitët do e kishin vrarë në burg”. Kush deklaronte se ?! Hiç më i vogël se Ministri i dikurshëm i Kulturës së shtetit të Kosovës. Po në kohën kur ne vepronim në diasporë?! Të gjithë mjeranët merreshin duke kurdisur

thashetheme e etiketime ndaj atyre që punonin për çështje kombëtare. Lexojeni me kujdes letrën që Musa ia drejton Ibrahim Kelmendit dhe do e vëreni se në asnjë fjali Musa nuk e vë në dyshim dhe të dyshimtë Ibrahim Kelmendin. Musa në asnjë fjali nuk mburret me aktin që kishte krye dhe po vuante dënimin. Çuditërisht edhe nga qelia e burgut Musa ishte pengesë e ndonjë lideri të Lëvizjes!
Nga qelia e burgut Musa informohej për aktivitetet e shqiptarëve kudo që ishin, ndërsa për aktivitetin tonë në Bruksel as që bëhej fjalë, dinte çdo lëvizje tonë. Jo se ai ishte profet, por ne vazhdimisht komunikonim me të. Musa përkrahte atë që punonte. Në këtë letër Musa e mbron aktivitetin tim kulturor si revistën dhe shfaqjet që përgatisja. Edhe revista edhe shfaqjet e mia për ndonjërin ishin pengesë. Në fakt, sipas mendimit dhe qëllimit tim, aktivitetin e zhvilloja që të demaskoja poetikën sllave, pa e ditur se mund të hasja në pengesë nga shokët më të cilët zhvilloja aktivitete. Për shfaqjet e mia shkruani,n gazetat më prestigjioze si “Le soir”, “La derniere heures” etj. Ishte hera e parë në historinë e diasporës shqiptare që gazetat prestigjioze të shkruanin për një shfaqje. Kjo nuk kishte ndodhë kurrë më parë. Kurrë! Qëllimi i Jugosllavisë ishte që opinioni botëror të na njihte si barbarë që dimë vetëm të vritemi vëlla më vëlla. Shfaqjet e mia jepeshin në të gjitha metropolet europiane dhe njerëzia dilnin duke qarë. Pikërisht këta faktorë do bënin që dikush të bënte përpjekje të më izolonte atëherë dhe tash. Pikërisht kundër këtij izolimi në përkrahje doli Musa Hoti, që dukshëm e ngre zërin në këtë letër.
Asokohe në Bruksel dhe vende tjera, Ibrahim Kelmendi kishte krijuar simpatizuesit e tij që do i rrinë besnikë deri në ditët e sotme. Të gjithë simpatizuesit e tij ishin njerëz të ndershëm (më sa i njoh unë), njerëz që tërë ditën punonin, që jepnin kontributin për çështje kombëtare, por asnjëri prej tyre nuk i kishte të kryer as katër klasë fillore. Këta ishin të gatshëm të kontribuonin për Ibrahimin materialisht e madje edhe tani për librin “Atentatet” kanë kontribuar; ishin të gatshëm të dilnin në demonstrata vetëm kur

lëshonte kushtrimin Ibrahim Kelmendi. Revistat, radio, shfaqjet dhe zhvillimet tjera kulturore thonin se me to nuk çlirohet Kosova.
Ibrahim Kelmendi asnjëherë nuk është kujdesur që të informohet për punën tonë në Bruksel nga ne, por është informuar prej sejmenëve të tij besnikë. Të gjitha ngjarjet që i përshkruan në librin e tij "Atentatet" janë fiktive dhe pjellë e imagjinatës së shokëve të tij në Bruksel. Po e nënvizoj vetëm rastin kur përshkruan se si vjen në banesën time, ku jam unë me Enver Hadrin, e Enveri e fsheh një çantë të vogël me dokumente prej Ibrahimit e ky ia merr me dhunë. Në fakt ajo ngjarje nuk ka ndodhur kurrë as në banesën time e as në ndonjë vend tjetër. Përkundrazi kur jemi takuar ne të tre gjithnjë ka qenë edhe i katërti, Sadik Tolaj dhe kemi biseduar se si Enveri të merr leje për demonstrata të Lëvizjes. Jo që situata kurrë nuk është elektrizuar, por bisedat i kemi bërë duke qeshur sikur të ishim miq të vjetër. Enverin askush nuk ka pasur mundësi ta nervozonte e aq më pak Ibrahim Kelmendi që vinte për të kërkuar ndihmën tonë.
Ende edhe sot, jam i bindur se Ibrahim Kelmendi është manipuluar nga tjerët për të krijuar opinion të keq për Enverin, Musën, Vehbiun, mua dhe ndonjë tjetër. Unë nuk jam kategorik t'i mbroj shokët me të cilët kemi bashkëvepruar, por mundem vetëm të shtoj se puna jonë që bënim publikisht dhe organizimet tona sekrete apo gjysmësekrete ishin në dobi të Kosovës. Jam përgjegjës vetëm për aktivitetet që i kemi bërë bashkë. Unë dhe asnjëri prej nesh nuk kemi qenë profetë të dinim se cili prej shokëve ishte i UDB-së. Nëse ndonjëri ka qenë bashkëpunëtor i UDB-së, kjo do të dalë në shesh vetëm kur të bëhet hapja e dosjeve sekrete. E këto një ditë do të hapen. Xhelozët dhe karrieristët bënin luftë të vrazhdët dhe të pamëshirshme ndaj shokëve të tyre edhe pa qenë në shërbim të armikut. Mund të krenohem se kurrë nuk isha xheloz ndaj shokëve të mi që punonin. Nuk ishin xhelozë as Vehbi Ibrahimi, Enver Hadri, Musa Hoti, Hazir Deralla, Muharrem Hajdini, Zeqir Krasniqi, Sadik Tolaj, Ahmet Beka, dhe Rexhë Karaliu. Ndoshta ne punonim dhe nuk kishim arsyeje të bëhemi xhelozë, sepse inferioriteti është shkak dhe nxitës i xhelozisë. Paaftësia për të kryer një punë, që tjetri e ka arritur, është nxitësi më i madh i xhelozisë. Ne ishim kategorikë që

të mbronim aktivitetin tonë, nuk pajtoheshim e as nuk u nënshtroheshim rregullave të disave që kërkonin vendnumërim. Çuditërisht, secili që shkruan monografi për diasporën apo që do shkruajë në të ardhmen ne jemi emra që na përmendin dikush ne aspektin pozitiv e ndonjë sharlatan në aspektin negativ. Jemi personazhe në libra të Sabri Novosellës, Fahredin Tafallarit, Ibrahim Kelmendit, Mehmet Hazirit, Selajdin Krasniqit e të shumë autorëve të tjerë për kontributin tonë dhënë për çështjen kombëtare. Të jesh personazh në libra të autorëve të njohur e të panjohur është sinjal, se ke punuar diçka. Madje të jesh personazh kryesor edhe i ndonjë librit që kryesisht shkruhet kundër teje, edhe kjo tregon se ti ke qenë gjenerator, ke vu në lëvizje diçka kur tjerët kanë heshtur. Po mos të kishe qenë nuk do përmendej emri. Në anën tjetër, përveç shtypit të asaj kohe serb, janë shkruar edhe libra të posaçëm nga autorë të Serbisë ku grupin tonë të Belgjikës e etiketojnë si terrorist të nëntokës shqiptare duke na quajtur të rrezikshëm. Gazetarët beogradas rrugët e Brukselit i quanin “Ulice smrti” qe ne shqip i bie “Rrugët e vdekjes “. Ne ishim ata që ishim. Më të mirë nuk ka pas! Tash pasluftës dalin “më të mirët”.

## *Musa Hoti dënohet me burgim të përjetshëm*

Qe nga dita e arrestimit Musa Hotit, mënyra e jetës dhe gjendja sociale do t’i ndryshohej rrënjësisht: familja me ndihma sociale, fëmijët pa kushte përkëdheljeje prindërore, aktiviteti kombëtar i kufizuar, lufta kundër thashethemeve. Të gjitha këto bënin strumbullarin që Musën do ta ngarkonin psiqikisht. Musa duhej të përballej me drejtësinë e Belgjikës që pasi e kishte kryer aktin në vetëmbrojtje të mos e mbanin në burg, por anën tjetër Jugosllavia çonte notë protestuese Belgjikës që Musa të dënohej rëndë që të merrej shembull për mërgatën shqiptare, në atë mënyrë që më askush të mos bënte akte të tilla. Mosbajtja e Musës në burg ishte frymëdhënëse dhe kurajo që tjerët të vazhdonin me aksione të tilla.

Dikush prej lexuesve tendencioz do të përgjigjet “ Punë e madhe, vetë e ka lyp!”, tjetri do të shtojë: “ Burgu është për burra dhe këtë e ka”, ndonjë tjetër do të shtojë : “ Çka lypi me u çue kundër Jugosllavisë!”. Ka edhe ndonjë tjetër që thotë: “ Pse a Kosova paska mbetur veç në Musa Hotin”, ndërsa të tjerë: “Çka e ka lyp e ka gjetë”; ekziston edhe ndonjë që thotë: “ Pse a mos e kemi shti na me vra shkije?!” dhe më keq: “ Pse a mos e ka vra për mue, a?! “.
Të gjitha këto që mund t’i thonë tash, i kanë thënë në kohën kur Musa u arrestua. Të gjitha këto fjalë Musa i ka dëgjuar edhe pse ishte i izoluar në burg. Habitej Musa se si njerëzit mund të flisnin ashtu, kur e dinin se çka kishte bërë. Nuk mund ta imagjinonte një urrejtje patologjike të shqiptarëve ndaj tij, që kishte kryer një vepër patriotike e lirisht mund të shtoj vepër heroike. Të kishte lejuar të vritej prej tyre, ne do e kishim shpallë dëshmor, dhe kishim vajtuar duke u ankuar : “ Qe si na vret Jugosllavia në qendër të Brukselit! “, “ Na e vranë njeriun e lapsit, patriotin na e vranë! Jugosllavia vrasëse! Ata janë terrorista! “ dhe do të shkonim nëpër manifestime me fotografinë e Musës duke thënë: “Një na e vranë mijëra u ngritën!”. Vetëm të vdekur ne i duam njerëzit tanë. Duke i dëgjuar fjalët e tjerëve që flisnin për të, Musa ndjente dhembje koke që i shtoheshin dita më ditë. Dhembjet e kokës pas disa muajve iu shtuan aq shumë saqë më vështirësi e kalonte ditën dhe natën. Edhe pas lirimit nga burgu e deri sa ishte gjallë dhembjet e kokës Musës nuk iu larguan.
Sikur vrasjen ta kishte bërë në Kosovë, gjendja do të ishte pak më ndryshe. Në Kosovë kur njeriu burgosej për çështje kombëtare, tërë populli i Kosovës të respektonte. Kudo që shkonin pjesëtarët e familjes gëzonin respekt. Dihet se në Kosovë Serbia bënte përpjekje që familjet e të burgosurve politikë t’i diferenconte, por populli tinëzisht u ndihmonte. Dallimi në mes burgut ku ishte Musa në Bruksel dhe sikur të ishte në burgjet jugosllave ishte se në burgjet e Belgjikës fizikisht nuk të maltretonin, familja merrte ndihma sociale për të jetuar mirë; kurse për burgjet jugosllave nuk kam çka shkruaj se nuk ka familje shqiptare që nuk e ka pasur një anëtar në ato burgje.

Po të kishin qenë vetëm këto fjalë që i kanë shkuar, Musa do të ishte çmendur, por fatmirësisht merrte letra përkrahëse nga të gjitha vendet ku jetonin shqiptarët. Letrat e bashkatdhetarëve ia lehtësonin barrën e shumëfishtë që kishte gjatë qëndrimit në burg. Ia lehtësonin por nuk ia hiqnin krejtësisht. Ja njëra në mesin e qindra letrave që i dërgonin në emër të bashkëshortes Mevlydes ose vajzës Mimozës, pasi Musa nuk dëshironte që letrat t’i adresoheshin në burg.



4/6/82

SH.B.A.

E dashtuna motra Mevlyde Hoti, s' pari jemi te gezuar qe bashkshorti i juaj dhe bashkatdhetari yne Musai doli me sukses ne vepren e kryer ne dobi te atdheut e kombit. Ju urojm suksese te me tejshme ne ceshtjen shqiptare dhe ne vepra te tilla patriotike. Fitorja do te jet me ne se neve jemi ne rrugen e drejt dhe parimore se kerkojm ate qe ka kerkue populli yne ne shekuj me rradhe dhe i asht mohue nga bishat e egra te Serbise e sllavizmi ne pergjithsi.

Sakrifica qe juve do te bani per rritjen e femive dhe per ruajtjen e prestigjit te bashkshortit tuaj Musait do te cmohet shum nga shqiptaret patriot,nga kombi atdheu dhe nga foleja e shqiponjave si c' asht Kosova Martire.

Po u dergojm ket ndim te vogel me nje vler perej $ 560 dollar

Shoqria shqiptare me banim ne Qytetin
e Waterburyt (Waterberit)
ne SH.B.A.

***Letra përkrahëse që merrte Musa Hoti gjatë qëndrimit në burg***

**SH.B.A. 4/6/82**
**E dashura motra  Mevlyde Hoti,**

Së pari jemi të gëzuar që bashkëshorti juaj dhe bashkatdhetari ynë Musa doli me sukses në veprën e kryer në dobi të atdheut dhe kombit. Ju urojmë suksese të mëtejshme në çështjen shqiptare dhe në vepra të tilla patriotike. Fitorja do të jetë me ne, sepse ne jemi në rrugën e drejtë dhe parimore, se kërkojmë atë që ka kërkuar populli ynë shekuj me radhë dhe i është mohuar nga bishat e egra të Serbisë e sllavizmit në përgjithësi.
Sakrifica që ju do të bëni për rritjen e fëmijëve dhe për ruajtjen e prestigjit të bashkëshortit tuaj, Musës, do të çmohet shumë nga shqiptarët patriotë, nga kombi, atdheu dhe nga foleja e shqiponjave siç është Kosova Martire.
Po ua dërgojmë këtë ndihmë të vogël me një vlerë prej 560 dollarësh.

Shoqëria Shqiptare në banim në Waterbury
(Waterberit), ShBA

## *Mëdyshje...*

Kjo letër është dërguar nga Lutfi Dauti, që ishte një bashkatdhetar i lindur në Veleshtë, i burgosur politik. Në Waterber ShBA asokohe jetonin kryesisht shqiptarë nga viset tona në Maqedoni. Në këtë vend jetonin një numër i vogël shqiptarësh që kryesisht merreshin me punë ndërtimore e sidomos dalloheshin si mjeshtër të ndërtimit të oxhaqeve dhe mureve rreth e rreth vilave, pasi në atë regjion jetonin yje të Hollivudit, shkrimtarë dhe të pasuri. Në tërë atë regjion për aktivitete kombëtare dalloheshin Lutfi Dauti dhe Tasim Lena, të cilët për shkak të thashethemeve ishin konfuzë për çështjen e Musës, kurse pas vizitës sime disi u qetësuan se nuk ishte puna ashtu siç kishin dëgjuar. Tasim Lena nuk arriti t’i  përjetonte

bombardimet e NATO-s, kurse Lutfi Dauti vdiq pak kohë pas hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë.

Letrat e tilla e qetësonin Musën përballë luftës që Jugosllavia zhvillonte pas perdeve, që Musa të dënohej maksimalisht.

Musa bënte përpjekje me avokatin e tij të lirohej i pafajshëm. Belgjika e zënë ngusht: nga njëra anë Jugosllavia me një protestë diplomatike kërcënonin se, po të mos dënonin maksimalisht Musa Hotin, do t'i prishnin marrëdhëniet ndërshtetërore; nga ana tjetër Musa ishte i pafajshëm se ata ia kishin sharë nënën shqiptare dhe ishin kërcënuar. Jugosllavia pas pak kohe e kishte bërë hapin e parë duke e tërhequr ambasadorin nga Belgjika. Lirimi i Musës shkatërronte relacionet mes dy shteteve. Autoritetet belge i ofruan Musës një variant që, të mos dënohej dhe shpejt të lirohej, Musa të pranonte se nuk ndjehej mirë psiqikisht. Ky propozim do ta nervozonte Musën edhe më shumë. Musa nuk donte të lirohej si i sëmurë psiqik, por të lirohej pasi aktin e kishte bërë në vetëmbrojte.

Në ditën e gjykimit, në këshillim me Musën tentuam të bënim një manifestim protestues pranë Gjyqit, por avokati e kishte rekomanduar Musën që të mos i provokojmë autoritetet sepse shtetet Perëndimore nuk pranonin shantazhe e kërcënime violente. Në sallën e gjykimit morëm pjesë një numër bashkatdhetarësh, por këshillat ishin që të mos bëjmë asnjë gjest provokativ që do ta dëmtonte procesin gjyqësor. Duhej të tregonim pjekuri dhe maturi e jo gjeste agresive siç pretendo Serbia se jemi ne shqiptarët. Nga frika se komuniteti ynë mund të bënte eksese (ashtu siç i kishte frikësuar Jugosllavia), Pallati i Drejtësisë atë ditë ishte i rrethuar me automjete të blinduara dhe polici të shumtë që rrallë ndodhte për gjykime të tjera.



***Pallati i Drejtësisë ku Musa Hotit iu shqiptua dënim i përjetshëm***

Për ditën e gjykimit, shqiptarët e të gjitha vendeve të botës kishin nënshkruar një peticion që i drejtohej Ministrisë së Drejtësisë së Belgjikës. Mbi 25 mijë letra nga bashkatdhetarët tanë i shkuan Ministrisë së Drejtësisë që Musa të lirohej. Musa u denua me burgim të përjetshëm, por e shpallën si të sëmurë psiqik dhe duhej të internohej në burgje enkas për sëmundje të tilla.

Dënim me burg të përjetshëm ishte dënimi më i rëndë dhe rrallë që po shqiptohej në Belgjikë. Pasi nuk kishte ligj të dënohej me vdekje, dënimi me vdekje ishte zëvendësuar me të burg të përjetshëm.

I indinjuar nga ky dënim, ja se ç'shkruan Musa:

"Nga kontaktimi me avokatin Guy Delfosse, dhe me dokumentacionin e depozituar jeni njohur pjesërisht me situatën time të vështirë e delikate, ngase në to evitohet çdo konfrontim me realitetin e hidhur e të favorshëm për mua.

Argumentet më të forta e elementare, fare nuk përfillën aty. Ato janë absorbuar me rigorozitet absurd e mjaft banal që të afirmohet alternativa e abuzimit tim pa ekzaminime të duhura e më shumë ekzagjerime arbitrare.

Këto divergjenca arrogante, kjo demagogji dekadente, ky kombinim fatal i koncentruar sipas tendencave e rekomandimeve të huaja konfirmojnë sanksion absolut e sensacional.
Internimi i pa bazë, i montuar e i improvizuar nga lart, hasi në indinjatë masive te bashkatdhetarët shqiptar që i njohin kapacitetet dhe afinitetet që i posedoj, si njeri paqedashës, por edhe si njeri i diskriminuar nga policia sekrete jugosllave. Humanizmi dhe solidariteti i tyre ka qenë spontan dhe mjaft specifik, realitet që e tregoi pjekuria e mërgatës pa asnjë konspiracion eventual që të mund të dyshohet në sinqeritetin e tyre të interpretuar në dy peticione të dedikuara për afirmimin ekskluziv të gjendjes së shqiptarëve nga evazioni flagrant i agresivitetit jugosllav në Europë”.



Nga kontaktimi me avokatin Guy Delfosse dhe me dokumentacionin e dërguar jam njohur pjesërisht me situatën time të vështirë e delikate, nga se në to evitohet çdo konfrontim me realitetin e hidhur e të favorshëm për mua. Argumentet më të forta e elementare, fare nuk përfshihen aty. Ato janë absorbuar me rigorozitet absurd e mjaft banal që të afirmohet alternativa e abuzimit tim pa ekzaminime të duhura e me shumë ekzagjerime arbitrare. Këto divergjenca arrogante, kjo demagogji dekadente e hegjemoniste, ky kombinim fatal i konceptuar sipas tendencave e rekomandimeve të huaja konfirmoj sanksion absolut se sensacional.

Internimi i pabazë, i montuar e i improvizuar nga lartë, hasi në indinjatë masive në bashkatdhetarët shqiptar që i njohin kapacitetet dhe afinitetet që i posedoj si njeri paqëdashës por edhe si njeri i diskriminuar nga policija sekrete jugosllave. Humanizmi dhe solidarizimi i tyre ka qenë spontan dhe mjaft specifik, realitet që e tregoi pjekurinë e mërgatës që asnjë konspiracion eventual që të mund të dyshohet në sinqeritetin e tyre të interpretuar në dy peticione të dedikuara për afirmimin ekskluziv të gjendjes së shqiptarëve nga aluzioni flagrant i agresivitetit jugosllav në Evropë.

***Origjinali i letrës ku shpreh indinjatën për vendimin e gjyqit***

### *Bashkatdhetarët reagojnë*

Shqiptarët e të gjitha viseve pa dallim ku jetonin u mobilizuan që t’i dërgonin letra protestuese Ministrisë së drejtësisë në belgjikë të indinjuar me vendimin e gjyqit për ta internuar Musa Hotin në spital psikiatrik. Ja një letër nga Nju Jorku:



This is the copy of the straight telegram sent from Royal Oak, Michigan on 26 April 1983, at approximately 6:00 P.M. (1800 hours):

MONSIEUR LE MINISTRE DE LA JUSTICE
PLACE POELAERT 3
1000 BRUXELLES BELGIUM

WE INSIST YOU REVERSE YOUR DENIGRATION OF MUSA HOTI'S POLITICAL ACT SHOOTING YUGOSLAVIAN EMBASSY SECRETARY TWO YEARS AGO IN PROTEST AGAINST FASCISTIC TREAMENT OF KOSOVA DEMONSTRATORS. MR. HOTI SHOULD BE JUDGED ONLY IN AN OFFICIAL COURT FOR THOROUGHLY NORMAL POLITICAL ACT. HE MUST NOT REPEAT MUST NOT BE COMMITTED TO A MENTAL INSTITUTION NOT FOR ONE MINUTE.

(signed) ALBANIAN AMERICAN CULTURAL PROGRAM GROUP

***Peticioni nga shqiptarët me banim në ShBA, Drejtuar Ministrisë së Drejtësisë***

Moniseur Ministere de la Justice
Place Poelaert 3
1000 Bruxelles

We insist you reverse your denigration of Musa Hoti’s political act shooting yougoslavian embasy secretary two years ago in protest against fascistic treament of Kosova demonstrators.
Mr Hoti should be judget only in an officila court for thoroughly normal political act. He must not be comitted to a mental institution not for one minute.

*Singed Albanian American Cultural Program Group*
**Zoti Ministër,**

Në emër të Komitetit Kombëtar të Kosovës, me seli në Belgjikë, ju lus të merrni në shqyrtim kërkesën tonë më sa vijon:
Sipas informatave tona, kemi kuptuar se Musa Hoti, mbajtur në burg më shumë se dy vjet, dhe së shpejti do lirohet.

Në kërkojmë prej jush që të mos e ekstradoni në Jugosllavi pas lirimit të tij, ku i rrezikohet jeta me ndoshta 10 apo 15 vjet burg.

Duke u bazuar se ju i kushtoni rëndësi problemeve që ka populli shqiptar i okupuar nga Jugosllavia, mendojmë së nuk do të keni vështirë të pranoni kërkesën tonë. Ne shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe në emër të Komitetit Kombëtar të Shqiptarëve të Kosovës, ju falënderojmë.

## Komiteti Kombëtar i Shqiptarëve të Kosovës

### *Letër përkrahëse për Musa Hotin nga Komiteti Kombëtar i Kosovës, Bruksel*

Pas shqiptimit të dënimit Musa Hoti u transferua nga burgu i Brukselit në një qytet tjetër për të vuajtur denimin e përjetshëm, por procedura kundër dënimit të padrejtë që ia kishte bërë Belgjika, Musa Hoti kishte angazhuar avokatin e tij Guy Delfosse që të merrte hapa e të ankohej në Këshillin e Europës në Strasburg.
Për një dënim arbitrar që ia kishte bërë Belgjika intervenuan institucionet e të drejtave të njeriut si Amnesti Internacional etj.



amnesty international

International Secretariat, 10 Southampton Street, London WC2E 7HF, England
Telephone: 01-836 7788 Telegrams: Amnesty London Telex: 28502

r reference: MA/JM/EUR
ease quote in all letters)

12 April 1983

M. Guy Delfosse
Avenue Van Becelaere 24 A
Bt 34
Bruxelles
Belgium

Dear Maître Delfosse

re: Musa Hoti, Yugoslav citizen of Albanian ethnic origin

I am writing in connection with our telephone conversation yesterday about your client Musa Hoti.

Am I right in understanding that you believe that Musa Hoti may well be discharged from mental hospital shortly, without having to face criminal proceedings for murder and attempted murder? I am slightly puzzled by this as it seems to me that if it is recognized that he is sane then it would follow that he would face trial for murder? I would be very grateful if you would clarify this point for us, and also if you would inform us of his eventual discharge/release.

I look forward to hearing from you.

Yours sincerely

Melanie Anderson
Research Department (East Europe)

mnesty International is a worldwide movement which works impartially for the release of prisoners of conscience: men and women detained anywhere or their beliefs, colour, ethnic origin, sex, religion or language, provided they have neither used nor advocated violence. Amnesty International opposes orture and the death penalty in all cases without reservation and advocates fair and prompt trials for all political prisoners. Amnesty International is idependent of any government, political grouping, ideology, economic interest or religious creed. It is financed by its membership and by subscriptions from all parts of the world. Amnesty International has consultative status with the United Nations (ECOSOC), UNESCO and the Council of Europe, has cooperative relations with the Inter-American Commission on Human Rights of the Organization of American States, and is a member of the Coordinating Committee of the Bureau for the Placement and Education of African Refugees of the Organization of African Unity.

**Kopje e letrës nga Amnestia Internacionale 12 prill 1983**

Pas shumë intervenimeve nga Amnestia Internacionale dhe ekspertët juridikë të Këshillit të Europës në Strasburg bëhet rigjykimi i Musa Hotit. Në këtë rigjykim në Strasburg vendoset se Musa Hoti ishte i pafajshëm. Ky gjyq do ta dënonte shtetin e Belgjikës me një gjobë simbolike për padrejtësitë që i kishin bërë Musa Hotit

***Luljeta Kurtesi i vjen në ndihmë Musa Hotit***

**Lule Kurtesi**

**Halmstad , më 5 dhjetor 1982**

I dashur dhe i nderuari vëlla Musa,
Letrën tënde të shkrojtur me 3 nëntor e kam marrë me kohë dhe gëzohem që je shëndosh e mirë. Në një udhëtim që pata këto ditët e fundit të nëntorit, kalova aty për të takuar njerëzit që ishin në mbledhjen e rinisë Kosovare – mjerisht nuk i gjeta siç duhej, por të përçarë, ashtu siç i intereson kryeqytetit të maxhupëve, Beogradit. Ndërsa ata lozin gurin e fundit për të humbur moralin tonë dhe ne rrimë duarkryq duke shikuar dramën e popullit tonë të dashur nga larg…
Reshat Sahitajt i premtova se do të ia dërgoj një kopje të një letre që të shikojë se si UDB-ja organizon agjentët në emigrantët e perëndimit, por thash më mirë po e dërgoj tek ju dhe mbasi ta kesh lexuar, dërgoja Reshatit. Letra është e shkruar prej një zogisti, i cili u përla më shokët e tij për çështje pozitash dhe është në Amerikë.
Revista që do ta botoj si po duket vonohet ( deri nga vera) , mbasi po na mungojnë mjetet dhe shkrimtarë të dorës së parë, të cilët duhet të shkruajnë artikuj në gjuhë të huaja vetëm për kulturën, historinë e shqiptarëve dhe çështje partish. Vetëm çështja kulturore/historike mundet të zgjojë opinionin, që është helmuar dhe qorruar nga gënjeshtrat dhe profkat e sllavizmit. Duhet t'i hedhim poshtë gënjeshtrat që ka përhapur Jugosllavia.
Shpresoj që në mbledhjen e zakonshme të rinisë të më rekomandoni njerëz të ndershëm. Më kaq, të fala nga ne të tre krejt familjes tande.

**Juaja si motër**
**Lulja**

Halmstad, më 5 Dhetor 1982

I dashur dhe i nderuar vlla Musa,

Letrën tënde e shkrojtur më 3 Nëntor e kam marrë me kohë dhe gëzohemi që je shëndosh e mirë.

Në një udhetim që pata këto ditët e fundit të Nëndorit kalova aty për të takuar njerëzit që ishim në mbledhjen e rinis Kosovare - mjerisht nuk i gjeta siq duhej por te përçarë ashtu si u-intereson krueqytetit e maxhupeve Beogradit. Pastaj palaçot e 40 flamureve lozin gurin e fundit për të humbur moralin t'onë dhe të rrimë më duar kryq duke shikuar dramën e popullit t'onë të dashur nga larg...

Reshatit (Sahitaj) i premtova se dotë i çonja një kopje të një letër anonyme që të shikojë sesi UDB:a organizon agjentat në emigrantat e përëndimit, por thashë më mirrë po e çoj tek ju dhe mbasi ta kesh lexuar dërgoja Reshatit. (Letra është shkrojtur prej një zogistit i cili u-përla më shokët e vetë për çeshtje pozitash, dhe është në Amerikë).

Revistën që dua të botoj si po duket vonohet (deri nga vera) mbasi po na mëngojnë mjetet sidomos shkrimtarë të dorës parë, të cilet duhet të shkruajnë artikuj në gjuhë të huaja vetëm për kulturen/historin e Shqipëtareve dhe jo çeshtje partish. Vetëm çeshtja kulturore/historike mundet të zgjojë opinionin botnor, i cili opinion ësht helmuar dhe qërruar nga gënjeshtrat dhe profkat e sllavizmit e tj. Duhet të hedhim posht gënjeshtrat që ka përhapur Jugosllavia!

Shpresoj që në mbledhjen e zakonshëm të rinis të më rekomandoni njerz të ndershëm. Me kaq të fala nga neve të tre ty dhe krejt familjes tënde,

Jueja si motër

*Letra e Luljeta Kurtesi Nr 1*

**Halmstad 1/ 1-83**

**I dashur vëlla Musë,**

Dje mora letrën tënde e cila na gëzoj që je mirë dhe për të cilën ju falënderoj. Po të përgjigjëm menjëherë pasi rezoluta duhet dërguar brenda dy muajve.

Mos harro se qysh 25 vjet më parë, kur Kosova u pranua në atë organizatë, Beligradi nuk ka lënë laro pa paguar që të vijë ta sabotojë favorin e Kosovës. E pasi në Kosovë tani gjendja është më e keqe se kurrë më parë, gjakpirësit e Beligradit për t'i fshehur veprat çnjerëzore i thonë botës se Kosova është zemra e Serbisë dhe se shqiptarët i ka sjellur këtu turku….Kështu pra në këtë mbledhje nuk ka parti e ç'parti, atje do të jepen vetëm fakte që shqiptarët janë të parët e atij vendi, të cilët flasin gjuhën më të vjetër të Europës, e jo siç pretendojnë shërbëtorët e Beligradit se gjuha shqipe përbëhet prej gjuhës turke, greke dhe sllave… Gjithashtu duhet thënë fakte dhe emra e të burgosurve, të torturuarve etj.

Pastaj një nga kryesoret që kjo organizatë interesohet është kultura, dmth, a lejohen fëmijët e Kosovës të mësojnë historinë e vërtetë, gjuha e mëmës, a po mundohet Beligradi ngadalë ta sllavizojë ? E për këto fakte, i dashur vëlla Musë, ne nuk duhet të fshihemi qoftë edhe pse rrezikojmë jetën.

Dhe po ta kishim një grup si atë që e patëm kur ishte mbledhja në Belgjikë ( me Reshatin) do të ishte shumë mirë se janë në propozim se grupet e tilla do të ndihmohen edhe ekonomikisht dhe kështu të shfaqim rregullisht zhvillimin e kulturës. Por, mjerisht Reshati me familjen e tij nuk kanë ende letërnjoftime, sepse duhet që kufini ta kalojnë dy herë…

Në rezolutë do të jenë edhe këto kryesore: Bashkimi i të gjithë shqiptarëve që ndodhen në Jugosllavi me një republikë të vet siç iu është dhënë të tjerëve.

Për rezolutën e vitit të parë duhet t'u drejtohemi Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurimit Europian, dhe një delegacion të shkojë t'i vizitojë të burgosurit se si i ka katandisur Beligradi.

Delegacionet turk, grekë dhe italianë, nuk pranojnë të flasin për Kosovën, por për veten e tyre që të kërkojnë të drejtat e gjuhës mësimore kulturore në atë vend ku ata jetojnë. Një gjë të tillë unë e kam kërkuar që 3-4 vjet më parë, por në Turqi ka vetëm një familje shqiptare - në Izmir- për të tjerët mos pyet….
Nuk është lehtë për ne që t'ia mbushim mendjen botës se çfarë tmerresh po ngjajnë mbi popullin shqiptar të Kosovës dhe kur këto revista gjëja efektive në botën e perëndimit nuk kanë bërë të paktën një film dokumentar ose me emra të humbur fëmijësh, që Amnesty Internacional të vinte t'i kërkonte këta të mjeruar… Pastaj bota e perëndimit është qorruar nga sytë e Beligradit dhe të Moskës.
Këta nuk shohin se qëllimi i Beligradit nuk është vetëm për zhdukjen e shqiptarëve, por dalëngadalë duan që krejt botën ta sllavizojnë.
Lajmet e fundit nga Kosova: të gjithë sllavët që kanë qenë në burg për vjedhje, krime e të çmendur janë liruar dhe dërguar në Kosovë…
Me kaq të fala e  nderime si nga unë dhe nga prindërit e mi. Shumë të fala edhe familjes suaj.

**E juaja si motër**
**Luljeta Kurtesi**

Halmstad 1/1-83

I dashur vlla Musë,

Dije mora letrën tënde e cila na gëzoj që je mirë dhe për të cilen u-falënderoj. Po të përgjigjem me njëherë mbasi rezoluta duhet dërguar brënda dy muajve.

Mos harro se qysh 25 vjet më parë kur Kosova u-pranua në atë organizatë, Beligradi nuk ka lënë laro pa paguar që të vij e të sabotoj favorin e Kosovës. E mbasi në Kosovë tani gjendja është më e keqe se kurdoherë dhe gjakëpirsit e Beligradit për të fshehur veprat çnjerëzore i thonë botës se Kosova ësht "zemra i serbis" dhe Shqipëtarët i ka sjell turku... Që kështu në këtë mbledhje nuk ka partira stërpartira, atje do jepen vetëm fakte që Shqipëtaret janë të parët e atij vëndi të cilët flasin gjuhën më të vjetër të Europës, e jo siç pretendojnë shërbetoret e Beligradit se gjuha Shqipe përbëhet prej gjuhës turke, greke dhe sllave... Gjithëashtu duhet dhënë fakte dhe emra e të burgosurve, të turturuarve e tj.

Pastaj një nga kryesoret që kjo organizat interesohet ësht kultura; d m th a lejohen fëmijët të Kosovës të mësojnë historin e vërtet, gjuhen e mëmës, apo mundohet Beligradi dalë ngadalë ti slavizoj? E për këto fakte, i dashur vlla Musë, neve nuk duhet të fshihemi qoft edhe pse rezikojmë jetën.

Dhe po të kishëm një grupë kulturore si atë që patëm kurë ishte mbledhja në Belgjikë (me Reshatin e tj) do të ishte shumë mire se janë në propozimë që grupet e tila do të ndihmohen edhe ekonomikisht dhe kështu të çfaqin regullishtë zhvillimin e kulturës. Por mjerisht Reshati me familjen skan letër njoftimi, të cilë u duhet mbasi do kalohet kufiri dy herë...

Në rezolutë do të jenë edhe këto kryesoret: Bashkimi i të gjithë shqipëtarëve që ndodhen nën Jugosllavi në republikën e vet siç u ësht dhënë të tjerëve; mbasi nuk e vuri ujët në zjarrë Beligradi

- 3 -

Nuk është e lehtë për neve që t'ja mbushim mëndjen e botës se çfar tmerre po ngjasin mbi popullin Shqipëtar të Kosovës dhe kur këto revista gjoja efektive në botën e perëndimit nuk kanë mujtur të japin të paktën film dokumentar ose emra të humbur fëmijsh që Amnesty të vinte ti kërkonte këta të mjeruar... Pastaj bota e perëndimit është qërruar nga sytë prej Beligratit/Moskës. Këta nuk shofin se qëllimi i Belgradit nuk është vetëm zhdukjen e Shqipëtarëve por dal nga dal duan që krejt botën ta sllavizojnë, dhe një shëmbëll të vogël: raca Austriake ka stagnuar qysh në vitin 1970 dhe kjo shtohet vetëm me jugosllavë, po ashtu Suedija dhe shtete të tjerë të cilët interesohen vetëm për materializëm dhe po rritin gjalpërin që një ditë dotë ja u-hajë kokën edhe këtyreve!

Lajmet e fundit nga Kosova: Të gjithë sllavët që kanë qënë në burkë për vjedhje, krime e të ç'mëndur janë liruar dhe dërguar në Kosovë...

Me kaqë të fala e nderime si nga unë dhe prindërit e mij. Shumë të fala edhe Familjes t'uaj.

Jueja si motër

Luli Kurtesi

*Letra e Luljeta Kurtesi derguar Musës*

## Halmstad, më 29 mars 1983

I dashur vëlla Musë,
Me shpejtësi po ju shkruaj këto rreshta. Vendimi marrë aty na hidhëron, por nuk duhet të na demoralizojë se e dimë se Jugosllavia e ka gënjyer krejt botën e perëndimit dhe jo vetëm ata ty!
Propozimin tonë ia dërguam ekspres avokatit. Ti po të na dëgjosh, shkruaji asaj zonjës në Gjermani, Brigitta Wulf, se unë i kam shkruar.
Gjithashtu t'i thuash avokatit që ai t'i drejtojë një lutje për çështjen tënde në këtë adresë.

Nderime të gjithëve<br>E juaja motër<br>Luljeta Kurtesi



Halmstad, më 29 Mars 1983

I dashur vlla Musë,

Me shpejtsi po ju shkruej këto rreshta. Vendimi marë aty na hidhëron po nuk duhet të na demoralizoj, se e dim se Jugosllavija ka gënjyer krejt botën e përendimit dhe jo vetëm ata aty!

Propozimin tonë ja dërguam "express" avokatit. Ti po të na dëgjosh shkruej asaj zonjës në Gjermani, Birgitta Wulff, se unë i kan shkruar mbi Shqipëtarët të burgosur në Jugosllavi, dhe le të shikoj se edhe në Belgjike i kanë mashat... Gjithë-ashtu ti thuash avokatit që ay ti drejtoj një lutje për çështjen tënde në këtë adres: Haut Commissariat des Nation Unies
pour les Refugies,
Palais des Nations
CH-1211 Geneve 10
Suisse

Nderime nga gjithë neve

Juaja motër Luljeta

***Letra e Luljetës, dërguar Musës***

## *Kushtëzimi i lirisë së Musa Hotit*

Jugosllavia e asaj kohe kishte angazhuar ekspertët e vet të drejtësisë ndërkombëtare dhe tërë potencialin diplomatik që rigjykimi të bëhej në bazë të gjykimit që ishte bërë në Belgjikë. Duke e parë se në Këshillin e Europës nuk mund të ndikonte ashtu siç e kishte planifikuar, diplomacia jugosllave vë kusht që edhe nëse lirohet Musa, nuk duhej të jetonte në Bruksel. Arsyetimi i palës jugosllave ishte se në Bruksel kishin ndodhur dhe po ndodhnin akte terroriste kundër interesave të tyre dhe frikësoheshin se Musa Hoti do të ndikonte në organizimin e akteve të tilla.

Gjyqi i Strasburgut vendosi që Musa të lirohej brenda një afati të shkurtër njëmujor, dhe në ndërkohë të jetonte në Belgjikë për një afat të shkurtër derisa të gjente një shtet,i cili do ta pranonte Musën.

Avokati i Musës do t'i shkruante të gjitha qeverive të Europës që ta strehonin politikisht, por përgjigjet e tyre ishin pa shpresë. Secili shtet nuk dëshironte të kishte barrë një njeri që kishte vrarë diplomatët e Jugosllavisë. Ata kishin frikë nga hakmarrja që më vonë Jugosllavia mund të ndërmerrte kundër Musa Hotit. Asnjë shtet nuk kishte dëshirë që vrasja të ndodhte në territorin e tyre. Gjermania kishte përvojë të hidhur me jugosllavët. Agjentët e sigurimit shtetëror jugosllav kishin vrarë Jusufin, Kadriun dhe Bardhoshin.

Që nga viti 1981, unë dhe Beharja kishim kontakte të mira me një familje shqiptare nga Suedia. Kjo familje kishte vetëm një vajzë që quhej Luljeta Kurtesi. Luljeta ishte anëtare e Ballit Kombëtar dhe kishte kontakte të ngushta me Luan Gashin. Luljeta kishte ide djathtiste.

Ajo e urrente sistemin komunist të Shqipërisë, por jo Shqipërinë. Gjatë takimeve tona me Luljetën në një Kongres të Popujve të Shtypur, Luljeta kishte një admirim për aktin e Musa Hotit. Në përfundim të punëve të këtij kongresi i shkëmbyem adresat dhe telefonat tanë. Me Luljetën mbetëm në kontakte miqësore të përhershme e madje më vonë bashkë me Enver Hadrin donim të

bënim një revistë letrare dhe politike në bashkëpunim me Luljetën. Por kjo nuk u arrit për arsye ideologjike. Pavarësisht kontaktet tona vazhdonin. Në momentin kur Musës i kërkohej të gjente një shtet që ta pranonte, ne biseduam me Luljetën. Ajo propozoi që prindërit e saj pranonin më dëshirë që Musa Hotin ta adaptonin si djalë të tyre, pasi nuk kishin djalë.
Luljeta i dërgon një letër Musës ende në burg duke ia sqaruar dëshirën e saj dhe të prindërve.
Musa i jep adresën avokatit të tij. Tani fillon procedura e Luljetës me avokatin e saj në Suedi që t'i rregullojë të gjitha dokumentet e nevojshëm që Musa ligjërisht të ishte djalë i familjes së tyre. Në anën tjetër Avokati i Musës, poashtu fillon procedurën tek autoritetet belge.
Gjatë këtyre përpjekjeve, Belgjika detyrohet që më 8 nëntor 1984 ta lirojë Musën nga burgu. Lirimi i Musës nga burgu ishte me të njëjtin kusht: gjetje strehimi në një shtet tjetër. Përveç këtij kushti Musa ishte i detyruar që çdo javë të paraqitej në policinë e lagjes dhe të mos e lëshonte pragun e banesës së tij.
Që nga koha kur kishte ndodhur vrasja e diplomatit jugosllav, familja e Musës jetonte në shtëpinë e Sherif Limanit, një burrë mesatar, i ikur nga Shqipëria,  me ide zogiste, por tërë kohën e kalonte vetëm me ne kosovarët e ri. Nuk kishte kosovar që vinte në Belgjikë dhe mos
të vraponte pas Sherif Limanit për t'ia rregulluar dokumentet. Kudo që shkonte Sherifi dhe me këdo që bisedonte fliste për trimërinë dhe guximin e Musa Hotit si dhe për rininë kosovare që po ia dridhte themelet Jugosllavisë së kalbur, thoshte ai. Sherif Limani kishte dëshirë ta shihte Kosovën e bashkuar me Shqipëri, por vdiq para bombardimeve të NATO-s.
Musa Hoti,i izoluar në banesën e tij, priste dhe përcillte mysafirë shqiptarë që vinin për ta parë nga të gjitha shtetet e Europës. Musa ishte shndërruar në legjendë për shumicën e popullit tonë. Vinin shqiptarët vetëm për t'ia dëgjuar zërin, vetëm për t'ia prekur dorën...
Mes vizitorëve nga Amerika ishte edhe Luan Gashi, ardhur personalisht me suitën e tij.

Edhe pse i izoluar, Musa vazhdonte t’u shkruante letra miqve të tij anë e kënd botës.
Procedura vazhdonte me Lulën dhe avokatin e tij.



29 janvier 1985

NS/85/21.444 - 29/1/1985

2.

NS/85/21.444

Je compte demander sa libération définitive à la fin de cette année.

Je vous prie d'agréer, Madame la Déléguée, les assurances de ma haute et respectueuse considération.

Madame BADIANI

Déléguée du Haut Commissariat
des Nations-Unies pour les Réfugiés

11 A rue Van Eyck

1050 - BRUXELLES

Guy DELFOSSE.

Madame la Déléguée,

Concerne : M. Musa HOTI

Je vous remercie de votre très aimable accueil du 23 janvier 1985 et de notre agréable et constructif entretien.

Par même courrier, je signale à Monsieur Musa HOTI qu'il y aurait lieu pour son épouse de reprendre la procédure, visant à l'obtention du statut de réfugiée politique "au bénéfice du doute", procédure qui, si elle aboutit, faciliterait sa propre procédure ultérieure.

De toute manière, je demande à Monsieur HOTI de reprendre contact avec moi et je lui dirai que vous êtes bien consciente de la situation humaine désespérée (refus d'inscription par le Bourgmestre BROUHON, dossier toujours ouvert chez vous, pas d'emploi pour ce double motif, pas de secours du C.P.A.S., etc ...) dans laquelle il se trouve.

De mon côté, je vous confirme qu'après avoir bénéficié d'un congé de près d'un an, dans l'espoir d'une adoption par une famille suédoise, Monsieur HOTI, qui s'était parfaitement conduit durant ce congé, a été libéré à l'essai le 8 novembre 1984 par une décision dont ci-joint copie.

../..

***Letra e avokatit, drejtuar autoriteteve belge me të cilën i vinte në dijeni se Musa kishte gjetur një familje shqiptare në Suedi***

Në këtë letër avokati i drejtohej Zyrës për Refugjatë Politikë, ku përveç tjerash, shkruante:

“Nga ana ime ju konfirmoj që pasi e fitova që Musa Hoti të ketë një pushim prej një viti, në kërkim të strehimit në një shtet tjetër, jemi me shpresë që Musa të adaptohet nga një familje në Suedi. Musa Hoti ka treguar shembull tepër të mirë me sjelljet e tij gjatë kohës që po qëndron në shtëpi”.

***NS/85/21.444-29/1/1985***

***Përpjekjet e Musës për t’u strehuar***

**Ambasadës së RPS të Shqipërisë**
**Paris**
**Rue de la Pompe 131**
**Francê**

## Kërkesë për strehim të përhershëm në RPS të Shqipërisë

Në pritje të një përgjigjeje pozitive nga autoritetet suedeze, Musa Hoti do të merrte një demarsh të tij duke kërkuar nga RS e Shqipërisë që të shkonte për të jetuar përgjithmonë. Ëndërronte të jetonte në Shqipëri pasi në Kosovë ishte e pamundur.
Musa i kishte përgatitur të gjitha të dhënat familjare dhe pasi kishte marrë takim përmes telefonit me një zyrtar të ambasadës shqiptare niset për në Paris i shoqëruar nga Qamil Zekolli, që tanimë ishte bërë dhëndër duke u martuar me mbesën e Musës.

## Ja se ç’shkruante Musa Ambasadës RS Shqipërisë

« I keqtrajtuar nga UDB-j jugosllave, me 4 nëntor të vitit 1978, u detyrova të marr rrugët e botës në sy, e në Bruksel e kisha që më parë vëllain (Isa Hoti), për ku edhe u nisa pa humbur kohë.
Pas bredhjeve dhjetëditëshe  në Bullgari dhe Turqi, më në fund arrita në Belgjikë, ku pas një erdhi edhe shoqja dhe vajza Mimoza.

Në fillim punoja në pastrimin e shitoreve të ndryshme të kryeqytetit të Belgjikës, pastaj në një servis për larjen e makinave.
Në një mbrëmje pasi e mbarova punën dhjetorëshe, duke shkuar në shtëpi ( banesë), hasa në një kosovar, i cili e kërkoi ndihmën time, që t'ia gjej një banesë, meqë gruan e kishte para lindjes. U përpoqa t'i ndihmoj dhe humba mjaft kohë pas tij. Rreth orës 23.00, duke u kthyer nga banesa, dy serbë mu kërcënuan se do të më vrisnin.
Për t'i evituar kalova në anën tjetër të bulevardit dhe pas disa hapash në një kafene i pashë katër bashkatdhetarë kosovarë, ku u instalova me gjithë dëshirë, duke shpresuar se aty nuk do guxojnë të më kërcënohen apo të kryejnë ndonjë punë të ligë kundër meje.
Pas një kohe, ata dy të shoqëruar edhe me pesë të tjerë (në dukje serbë), ia behën në kafene. Këta të fundit dolën, kurse të parët mbeten aty duke sharë e nënçmuar çdo gjë shqiptare, për ç'arsyeje u ngrita nga kërriga dhe iu afrova tavolinës ku qëndronin diplomatët jugosllavë, duke u thënë mos të shajnë e mos të shprehen ashtu. Mirëpo « trimat « e Beogradit i futën duart në xhepa që t'i nxjerrin armët e tyre dhe të shtinë kundër meje (bashkatdhetarët tjerë kishin «humbur», dikush në nevojtore, tjetri ulur me ta, i treti për të blerë cigare etj). Prandaj u detyrova të mbrohem nga sulmi i tyre i papritur dhe i zbraza dy plumba nga revolja. Dola nga kafeneja dhe e prisja shtypin e nesërm që të shoh deri ku kishte shkuar puna. Nga shtypi vendor kuptova se njëri kishte vdekur në vend, kurse dy të tjerët ishin plagosur lehtë. Tetë ditë më vonë ju dorëzova organeve kompetente të ndjekjes, meqë u binda se nuk do të më kthenin në Jugosllavi.
Procedura në burgun hetues zgjati plot 22 muaj, kur u muar vendimi të mos më lejohet e drejta për gjykim të rregullt e me dyer të hapura. Prandaj për shkaqe të shtetit vendosën të më dërgojnë në syrgjynosje të përjetshme si njeri që në momentin e ngjarjes kritike « Nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet e tij ».!!!
Kjo thënie e gjykatës belge nuk kishte kurrfarë baze, por këtë poshtërsi e kanë bërë që t'ia ruajnë fytyrën aleates së tyre të ndytë dhe njëherë t'i ruajnë edhe marrëdhëniet e mira politike , ekonomike, diplomatike me Jugosllavinë.

Vet gjykata më thoshte se : « Një shqiptar duhet sakrifikuar », sidomos pas 26 atentateve që u bënë në Bruksel kundër përfaqësive jugosllave ( edhe i vetmi shqiptar isha unë në burg), kështu që dëshironin të m'i vishnin të gjitha dëmet që ndoshta vetë jugosllavet i kishin shkaktuar vetit, që kinse t'i tregojnë « botës së lirë » se ne shqiptarët jemi agresivë. Se ne duam luftë, duam shkatërrimin e Jugosllavisë etj etj. Të gjitha ato që ia dëshironin vetë Jugosllavisë, tentonin të na i mvishnin ne. Por bota e kuptoi se kush janë ata që e dëshirojnë shkatërrimin e saj edhe sot edhe gjithmonë.
Pas qëndrimit pesëmuajsh në syrgjyn (burg për të sëmurësh mendorë), të bindur me kohë se nuk isha për syrgjynosje, më liruan në pushim prej dy muajsh dhe kurrë më nuk më kthyen ne asnjë burg. Hetimet e shtetit ku jetoj, por edhe të shtetit nga kam ardhur nuk kanë të sosur. Çdo hap im përcillet nga dy palët dhe thënë të vërtetën kurrë nuk jam i qetë. Edhe sa kohë do të mund t'i bëjë ballë një situate të tillë as vetë nuk e di, por po e shoh se çdo ditë e më tepër por rëndojnë në mënyra dhe forma të ndryshme….
Janë një shembull krejtësisht tjetër, që nga shtatori i vitit 1984 nuk m'i kanë paguar shtesat e fëmijëve, të cilat më janë garantuar me ligj.
Pasi e lexova Amnistinë e 13 janarit, vendosa t'ua bëj këtë kërkesë edhe pse jam nënshtetas i huaj, por me zemër e shpirt jam shqiptar si gjithë shqiptarët tjerë në shtetin tonë, në Kosovë apo edhe në mërgim.
Kam bindje të thellë se Shqipëria Socialiste do të tregojë kujdes vëllazëror ndaj meje e sidomos ndaj familjes sime të lodhur në mjerimin e rrugëve të pafund të botës.
Kam bindje se për mua dhe bashkëshorten time do të gjenden një vend pune (aty ku na kishte caktuar Partia), ndonjë banesë e vogël por edhe vend për shkollimin e fëmijëve tanë. Vet jeta na ka mësuar të jemi modest në çdo lëmi të jetës. Por ndoshta vlen për të cekur edhe ketë : unë në Kosovë kam punuar për 12 vjet si punëtor i arsimit, kurse gruaja ime e ka të mbaruar shkollën e tregtisë.
Kërkesës sonë po ia bashkangjesim edhe disa dokumente, në të cilat shifet pafajësia ime në procedurën e arrestimit. Dokumentin

vendimtar për  lirim i PAFAJSHËM nuk po ma japin, nga frika se po u kërkoj dëmshpërblim për kohën e kaluar në burg, por edhe që të mos më armatosin kudër drejtësisë së tyre të mbuluar me turp, shpifje e gënjeshtra.
Në lidhje me ato që m’i bëri e mi bën qeveria vendore nuk dëshiroj të ju shkruaj, ngase pasojat mund të kthehen shumë shpejt, prandaj mund të kuptoni gjendjen time të mjeruar në këtë vend me shumë « liri » e « demokraci », sa që thika në fyt më ka ardhur dhe më nuk kam ku të shkoj apo kujt t’i drejtohem.
Me shpresë se kërkesa ime do të hasë në mirëkuptim të plotë dhe se do të vendoset pozitivisht , ju përshëndes me sinqeritet vëllazëror

Me nderime
Musa Hoti

(arsyetim):

I keqpërdorur nga UDB-ja jugosllave, më 4 nëntor të vitit 1978 u detyrova t'i marrë rrugët e botës në sy, e në Bruksel e kisha që më parë vëllain (Isa Hoti), për ku edhe u nisa pa humbur shumë kohë.

Pas bredhjeve dhjetë ditëshe në Bullgari dhe Turqi, më në fund arrita në Belgjikë, ku kërkova strehim politik. Një muaj më pas më erdhi bashkëshortja dhe vajza (Mimoza).

Në fillim punoja në pastrimin e shitoreve të ndryshme të kryeqytetit të Belgjikës; pastaj laja enë në restaurante që kishin nevojë për krah pune e më vonë punoja në një servis për larjen e makinave (veturave).

Në një mbrëmje, pasi e mbarova punën dhjetëorshe,duke shkuar në shtëpi (banesë) hasa në një kosovarë, i cili e këekoi ndihmën time; që t'ia gjejë një banesë, meq gruan e kishte para lindjës. U përpoça t'i ndihmoi dhe humba mjaft kohë pas tij. Rreth orës 23,oo, duke u kthyer nga banesa, dy serb m'u kërrcnuan,se: do t'më vrasin...

Për t'i evituar, kalova në anën tjetër të bulevardit dhe pas disa hapash në një kafene i pash katër bashkatdhetarë kosovarë, ku u instalova me gjithë dëshirë, duke shpresuar se aty nuk do të guxojnë t'më kërrcnohen apo të kryejnë ndonjë punë të ligë kundër meje.

Pas një kohe, ata dy të shoqëruar edhe me pesë persona tjerë (në dukje serb), ia behën në kafene. Këta të fundit dolën kurse dy të parët mbetën aty duke sharë e nënçmuar çdo gjë shqiptare, për ç'arsye u ngrita nga karrika dhe iu afrova tavolinës ku qëndronin "diplomatët" jugosllav, duke iu thënë mos të shajnë e mos të shprehen ashtu, mirpo në ndërkohë "trimat" e Beogradit i futën duartë në xhepa që t'i nxjerrin armët etyre dhe të shtijnë kundër meje (bashkatdhetarët tjerë kishin "humbur", dikush në nevojtore, tjetri ulur me ta, i treti për të"blerë" cigare etj.), prandaj u detyrova të mbrohem nga sulmi i tyre i papritur dhe i zbraza dy plumba nga revolja. Dola nga kafeneja dhe e pritja shtypin e nesërmë që të shof se deri ku ka shkuar puna. Nga shtypi vendas kuptova se njeni ishte vrarë në vend kurse dy të tjerë ishin plagosur lehtë. Tetë ditë më vonë iu "dorzova" organeve kompetente të ndjekjes, meq u binda se nuk do t'më kthejnë për Jugosllavi.

Procedura në burgun hetues zgjati plot 22 muaj, kur edhe u mor vendimi që mos t'më lejohet e drejta për një gjykim të rregulltë e me dyer të hapura, prandaj për shkaqe të shtetit vendosën t'më dërgojnë në syrgjynosje të përjetëshme si njeri që në momentin kritik të ngjarjes "nuk ka qenë në gjendje t'i kontrolloi veprimet e tij"!!!

Kjo thënje e gjykatës belge nuk kishte kurfar baze, por këtë poshtërsi e kanë bërë që t'ia ruajnë "fytyrën" aleatës së tyre të ndytë e njëherit t'i ruajnë edhe marëdhënjet e mira politike, ekonomike e diplomatike me Jugosllavinë.

Vet gjykata më thoshte,se: një shqiptar duhët sakrifikuar, sidomos pas 26 "atentateve" që u kryen në Bruksel kundër përfaqësive jugosllave (dhe vërtetë i vetmi shqiptar isha unë në burg), kështu që dëshironin t'mi mveshnin të gjitha damet që ndoshta vet jugosllavët ia kishin shkaktuar vedit, që kinse t'i tregojnë "botës së lirë" se ne shqiptarët jemi agresiv; se ne duam luftë; duam shkatrrimin e Jugosllavisë etjerë-etjerë. Të gjitha ato që ia dëshironin vet Jugosllavisë, tentonin t'na i mveshnin neve, por bota e kuptoi se kush janë ata që e dëshirojnë shkatrrimin e saj edhe sot e edhe gjithmon.

Pas qëndrimit pesë muajsh në syrgjyn (në një burg për të sëmuar mental), të bindur me kohë se nuk isha për syrgjynosje, më liruan në pushim prej dy muajsh dhe kurr më nuk më kthyen në asnjë burg.

Hetimet policore të shtetit ku jetoj por edhe ato të shtetit nga kam ardhur nuk kanë të sosur. Çdo hap imi përcillet nga të dy palët dhe thënë të vërtetën kurrë nuk jam i qetë. Edhe sa kohë do t'mund t'i bëjë ballë një situate të tillë as vet nuk e di, por po shof se çdo ditë e më tepër po më rëndojnë në mënyra e forma të ndryshme...

Ja një shembull krejtësisht tjetër: Që nga shtatori i vitit '84 nuk m'i kanë paguar shtesat e fëmijëve, të cilat më janë të garantuara me ligj; që nga 1 shtatori '84 nuk më ka paguar enti apo ministrija e punës si i papunë që jam, e për çdo ditë e shtypi kartonin e papunësisë. As asistenca sociale nuk më ka ndihmuar kurrë, kurse punë për ne nuk ka! Si "shef" i familjës pesë anëtarëshe, nuk jam në gjendje të sjelli një bukë në familje dhe pasi e lexova Amnistin e 13 janarit vendosa t'ua bëjë këtë kërkesë edhe se jam nënshtetas i huaj por me shpirt e zemër shqiptar si gjithë shqiptarët tjerë

./..

4

në shtetin amë, në Kosovë apo edhe në mërgim.

Kam bindje të thellë se Shqipëria e jonë Socialiste do të tregoi kujdes vëllazëror ndaj meje e sidomos ndaj familjës sime të lodhur në mjerimin e rrugëve të pafund të botës. Kam bindje se për mua dhe bashkëshortën time do të gjindet ndonjë vend pune (aty ku na kishte caktuar Partia), ndonjë banesë e vogël por edhe vend për shkollimin e fëmijëve tanë. Vet jeta na ka bërë të jemi modest në çdo lëmi të jetës. Po, ndoshta vlen për të cekur edhe këtë: unë në Kosovë kam punuar 12 vite si punëtor arsimi (mësues), kurse gruaja ime e ka të mbaruar shkollën e tregtisë - dega e tekstilit por asnjëherë nuk ka punuar as në Kosovë e as në Belgjikë.

Kërkesës sonë po ia bashkangjesim edhe disa dokumente, në të cilat shifet kjartë pafajsia ime në procedurën e arrestimit. Dokumentin vendimtar për lirim I PAFAJSHEM nuk po ma japin, nga frika se po ua kërkoi damshpërblimin për kohën e kaluar në burg, por edhe që t'më mos armatosin kundër "drejtësisë" së tyre të mbuluar me turp, çpifje e gënjeshtra. Në lidhje me ato që m'i bëri e m'i bënë qeveria vendase nuk dëshiroi t'Ju shkruaj, nga se pasojat mund t'më kthehen shumë shpejtë, prandaj mund të kuptoni gjendjen time të mjeruar në këtë vend me shumë "liri" e "demokraci", sa që thika në fyt më ka ardhur dhe më nuk kam ku të shkoi apo kujt t'i drejtohem.

Me shpresë se kërkesa ime do të has në mirëkuptim të plotë e se do të vendoset pozitivisht, Ju përshëndes me sinqeritet vëllazëror dhe me dëshirë që t'na rroi Partia e Punës së Shqipërisë.

Në Bruksel, më 19 janar 1986

Me nderime,

Musa Hoti

Rue de Beyseghem, 117 - B.27
1120 Bruxelles (Belgjikë)
Adresa tjetër e fshehtë(ileg.):
B.P. 16
1120 Bruxelles
TEL: 02/268.71.22

***Letra drejtuar RSP Shqipërisë f 2, 3 e 4***

Letra ka katër faqe. Në faqen e parë janë të dhënat e Musës dhe tërë familjes së tij. Në faqe 2,3, dhe 4, Musa shkruan arsyetimin pse po kërkonte të jetonte në Shqipëri.
Askush nuk ia dinte problemet financiare dhe problemet tjera që Shërbimet Sekrete e përcillnin Musën në çdo hap. Përmes kësaj letre Musa ia hap zemrën vëllaut, duke i rrëfyer vuajtjet e tij dhe duke u arsyetuar se Shqipëria do ta pranonte.
Për ta dërguar këtë letër, Musa do të udhëtonte bashkë me Qamilin, pasi takimin e kishte caktuar më herët. Në Paris përpara portës së Ambasadës së Shqipërisë, Musa kishte ndjenjën se po hynte në shtëpinë e tij. E trus butonin e ziles. Pas pak del një zyrtar, të cilit identifikohet Musa i tregon se kishin takim me filan zyrtarin. Musa përpiqet të përqafojë si vëllaun e tij zyrtarin, që përfaqësonte popullin shqiptar, por ai largohet. I prêt me një ftohtësi të akullt. Musa bëhet gati të fusë këmbën për të hyr në ambasadë. Zyrtari nuk e lejon duke i thënë se nuk është askush.
Kthehet Musa i demoralizuar, sepse tani po i mbyllej edhe shpresa e fundit. Shteti amë ia kishte refuzuar edhe hyrjen në lokalet e ambasadës nga frika se mos po acaroheshin relacionet me Jugosllavinë. Pasdreken e asaj dite dhe ditëve të tjera, Musa provon t'i kontaktojë me telefon. Më kot! Asnjë përgjigje!
Ky refuzim do të lerë pasoja të mëvonshme në shpirtin e Musës, sepse pas pak ditësh u përhap lajmi se Musën e kishte refuzuar shteti amë. Lajmin e përhapte vetë Ambasada e Shqipërisë përmes besnikëve të saj që as emrin e tyre nuk dinin ta shkruanin. E përhapen lajmin që ato fjalë të shkonin në veshët e shërbëtorëve dhe të shërbimit sekret jugosllav, që të arsyetoheshin para Jugosllavisë se Shqipëria ia kishte mbyllur dyert Musa Hotit.
Përsëri njerëzit filluan të flasin se, po të ishte Musa aq patriot, Enver Hoxha do ta kishte marrë për të jetuar në Shqipëri. "Shqipëria komuniste me shokun Enver Hoxha në krye e din edhe ku dreqi bënë vezë, e nuk po i ditka se çfarë patrioti është Musa Hoti", thonin rrugëve të Brukselit shqiptarët për ta diskredituar Musën dhe veprën që ai e kishte bërë. Natyrisht këtij kori iu bashkëngjitën edhe

bashkëpunëtorët e ambasadës jugosllave, të cilët thonin pak më ndryshe dhe pak më rreptë: “ Jugosllavia e ka përgatitur Musën qysh në Kosovë, që t’i vrasë ata dhe pastaj të shkojë në Shqipëri për t’i spiunuar”.
E Musa Hoti përjetonte vuajtje të tmerrshme psiqike, duke shpresuar në të vetmen zgjidhje, ideuar nga bashkëkombësja mirëdashëse Luljeta Kurtesi që jetonte në Suedi. Megjithëkëto, Musa Hoti kurrë nuk e ngriti zërin të shante Shqipërinë që nuk e kishte pranuar. Ai e arsyetonte refuzimin, duke thënë se “vërtetë pranimi im në Shqipëri, do t’u jepte mundësi serbëve për të argumentuar se Shqipëria po i organizonte të gjitha vrasjet. Çuditërisht, zyrtarët e Ambasadës së Shqipërisë , Musa Hotin e kontaktonin fshehtas, duke e këshilluar të mos tregonte për takimet me ta.
Musa niset për Suedi me tërë familjen pa i treguar askujt. Herën e parë e ndaluan në kufirin gjerman pa dokumente të udhëtimit. Herën e dytë niset me dokumente të vëllait Isa.
Në Suedi Luljeta kishte dalur me prindërit e saj ta priste. Pas dy ditësh qëndrimi në Suedi, Musën e ndalojnë, e burgosin dhe i deklarojnë se organet kompetente suedeze nuk i jepnin strehim politik nga frika se shërbimi sekret i Jugosllavisë mund të organizonte atentat, vrasjen e tij. Prandaj zyra kompetente të Suedisë nën masa të rrepta mbrojtëse e përcjellin Musën me aeroplan deri në Bruksel.
Në këto rrethana, pas një kohe, Belgjika detyrohet t’ia akordojë Musës dhe familjes së tij statusin e refugjatit politik.

## *Vitet e Musa Hotit në liri*

Më në fund Belgjika detyrohet t’i akordojë Musa Hotit statusin e refugjatit politik. Si çdo i burgosur edhe Musa me entuziazëm të madh e kishte pritur ditën që do të përjetonte lirinë.
Bazuar në vizitat e shumta, në korrespondencën e madhe më bashkatdhetarët, me pjesëmarrjen masive në demonstrata për lirimin

dhe të drejtat e tij, Musa nuk dyshonte në sinqeritetin e askujt. Ai besonte se lirimi nga burgu do t'ia mundësonte të jepte kontributin maksimal për çështjen kombëtare. Sipas tij, gjërat shkonin mirë edhe në kreun e Lëvizjës, pasi në vizitë i kishte ardhur edhe Ibrahim Kelmendi, me të cilin kishte shkëmbyer mendime e polemizuar përmes letrave.

Nga burgu Musa Hoti nuk e dinte se përmes letrave, Sabriu e Xhaferi dhe anëtarët tjerë nuk ia rrëfenin të gjitha problemet e brendshme, pasi kishte filluar plasaritja e relacioneve të tyre. Askush nuk kishte njohuri se brenda kryesisë kishte filluar xhelozia shqiptare t'i brente ngadalë e nën rrënjë relacionet e liderëve. E aty ishin shumë liderë. Mirëpo me që ishte organizim ilegal, asnjë lider nuk ishte i autorizuar që publikisht të deklarohej si i tillë. Ndër liderët kryesor ishin Sabriu, Xhaferi, Ibrahimi. Secili prej tyre mundohej t'ia vente grackën tjetrit nga frika se mos tjetri popullarizohej më shumë.

Në çdo organizim ilegal të partive apo organizatave zhvillohet luftë e tmerrshme interesash, që ishte aq e rrezikshme, saqë është e pamundur të krahasohet me ato që bëhen në legalitet. Në organizma partiake ilegale, sidomos në ato me ideologji majtiste deklarohet se nuk ka njeri të madh dhe se të gjithë janë të barabartë. Në fakt aty askush nuk është i barabartë, por kjo është një ideologji marksiste tepër diabolike. Majtistët krijojnë një çerdhe të tyre hermetike , nga njerëz që kanë probleme psiqike dhe që janë në gjendje ankthi.

Gjendja fizike, po ashtu mund të karakterizohet me agresivitet, fryt i një periudhe të gjatë të hutimeve individuale dhe kolektive. Agresivitetin e shoqërojnë një përzierje të qëndrimeve të luhatshme karshi kundërshtarit për aspirata të reja, ëndrra apo mendime utopike. Po ashtu, gjendja e agresivitetit është e natyrës që prodhon ideologji të tipit reformist apo revolucionar. Ekzistojnë divergjenca mes analizave të ideologjisë marksiste dhe analizës së ideologjisë në sociologjinë bashkëkohore.

Askush nuk e din shumën e saktë të mjeteve materiale që iu është dhënë Sabri Novosellës. Në bazë të informacioneve shoqërore të asaj kohe,thuhej se Sabriu ka marrë 17-20 mijë dollarë. Asokohe me

aq para mund të blihej një shtëpi bashkë me shtypshkronjë në qendër të Brukselit.
Sabriu deklaron se ka marrë gjysmën e asaj shume, ndërsa gjysmën tjetër e kanë marrë njerëzit e sigurimit të Shqipërisë. Ky variant është i besueshëm, sepse pasi paratë, të marrura ilegalisht, agjenti i sigurimit shqiptar mund t'i ketë vënë kushte Sabriut : merr kaq dhe nënshkruaj për kaq. Sabriu, që deri në atë ditë nuk kishte patur në dorë aq para, i dukej se me ta mund të kryente punë, prandaj nënshkroi. Ky është vetëm supozimi im. Sabriu të hollat ia dërgoi Jusuf Gërvallës në Gjermani.
Po të dëgjojmë versionin e Ibrahim Kelmendit lidhur më ndihmën që Shqipëria ia ka dhënë Sabriut, shuma e thënë nga Ibrahim Kelmendi është marramendëse. Në fakt Ibrahimi mund të supozojë, sepse agjentët e sigurimit parat nuk i kanë dhënë haptas dhe me dëshmitarë. Ata e kanë njohur Sabriun, kanë pasur besim të plotë në të dhe nuk kanë ndjerë nevojë t'i arsyetojnë parat e tyre ilegale te njerëzit ilegalë. Madje Ibrahimi nuk ishte në relacione me Sabriun në kohën e ardhjes së Jusufit dhe supozimet e Ibrahimit mund të jenë të pabaza, por… mund të jenë edhe me baza.
Ato kohë Ibrahim Kelmendi kishte krijuar « Frontin e kuq » dhe gazetën e tij « Bashkimi ». Askush nuk din prejardhjen e shpenzimeve financiare, kur dihej se Ibrahimi ishte vetëm student në Bochum të Gjermanisë. Mendoj se edhe Ibrahim Kelmendi është ndihmuar ilegalisht nga Sigurimi i Shqipërisë apo nga ndonjë sigurim tjetër i ndonjë organizate ekstreme majtiste.
Kadri Zeka, poashtu kishte krijuar organizatën e tij majtiste dhe organin e tyre.
Ardhja e Sabri Novosellës dhe e Jusuf Gërvallës do të ndikonte që grupet majtiste të futeshin nën një kulm. Për këtë qëllim do të bëhej një mbledhje në Stamboll me iniciativën e Sabriut dhe Jusufit, nën mbikëqyrjen e Bujar Hoxhës, konsull nga Shqipëria.
Sido që të jetë, asnjë organizatë majtiste apo djathtiste nuk ka pasur mundësi reale të ekzistonte dhe të krijohej për të qëndruar në skenën politike, pa një përkrahje materiale të një shteti. Organizata duhet të ketë njerëz që veprojnë e jo që punojnë aktivisht për të mbajtur

familjen. Organizatës i duheshin mjete financiare për të publikuar organin e saj. Prandaj, pa një përkrahje të një force shtetërore ishte e pamundur ekzistenca e organizatës dhe e organit te tyre.
Me ndihma të mërgatës shqiptare nuk ishte i mundur botimi i një reviste me tirazh të vogël, sepse mërgata në Europë përbëhej kryesisht prej punëtorëve që duhet të ushqenin dhe mbanin familjet e tyre të varfra në Kosovë.
Ne, me Enver Hadrin, kemi provuar të botojmë një revistë të qëndrueshme e të rregullt, por nuk ia kemi arritur. Enver Hadri e botonte revistën kohë pas kohe dhe asnjë numër nuk ishte me rregull. Madje botohej një apo dy numra në vit, vetëm sa për të thënë se ekzistonte një revistë. Unë kisha nxjerrë dy numra të revistës sime letrare « Iliria » me mjetet e mia financiare, por u detyrova ta mbyllja. Si përfundim, kanë mbijetuar dhe ekzistuar vetëm ato organizata që përkrahshin nga Shqipëria ose nga ndonjë shërbim sekret tjetër, që vetëm ata e dinë.
Musa Hoti u gjend para një situate të tendosur të marrëdhënieve të liderëve. Çka nuk e kishte imagjinuar. Në këtë kohë dhe situatë, Sabriu kishte frikë nga Xhafer Shatri të cilit, pas vrasjeve së Jusufit, i kishin dhënë kompetenca të mëdha në Lëvizje. Në fillim Xhaferi kishte respekt për Sabriun dhe Musa Hotin, por pa i prishur relacionet me Ibrahim Kelmendin. Xhaferi e përforconte pozitën e tij edhe si redaktor i « Zëri i Kosovës » edhe si vendimmarrës politik në Lëvizje, duke i forcuar lidhjet e tij me çdo celulë jashtë Zvicrës.
Ibrahim Kelmendi me udhëtimet e tij në Europë kishte krijuar grupet e tij dhe klube. Pas tij kishte një masë të gjerë njerëzish në shumë shtete. Sabri Novosella nuk kishte krijuar simpatizantë të tij personalë, por mbante kontakte vetëm me aktivistë të njohur, të organizuar ose të paorganizuar.
Në këtë organizim ilegal përmes programit të tyre parashihej që të gjithë duhet të jenë të barabartë, e në fakt nuk ishte ashtu. Në manifestime ekspozoheshin përpara popullit me fjalime të tyre të zjarrta, natyrisht pa e treguar emrin. Mirëpo populli e dinte se kush ishte ai që foli. Pra këta liderë, që e ndalonin çdonjërin të ekspozohej me emër, vetë i ekspozoheshin masës. Cila ishte logjika

e tyre kur ndaloheshin tjerët të vepronin me emër, e vetë ekspozoheshin ?! Në ato kohë unë me mjete personale e kisha përgatitur pllakën me poezi në një studio të njohur dhe po bëhesha gati t'i venim etiketat e titullit dhe kush recitonte, kur erdhën dy nga Lëvizja, Hyzri Reka dhë një tjetër më thanë jo me emër.

Ata e ushqenin dhe u kultivonin kultin e individit për veten e tyre, por nuk e lejonin askënd të dilte mbi sipërfaqe. Ata kishin njerëzit e tyre besnikë, të cilët u tregonin anëtarëve tjerë se si Xhafer Shatri kishte vuajtur në burg, si ishte arratisur e shumë rrëfime tjera për ta ngritur dhe çmuar figurën e tij. Të njëjtat gjëra tregoheshin për Ibrahim Kelmendin, si « kurrë nuk bën gjumë rahat nga frika e ndonjë atentati », se ishte betuar « pa u çliruar Kosova, nuk martohej », se nuk kishte para « pasi tërë jetën e kalon rrugëve të botës duke organizuar Lëvizjen » etj. I vetmi ishte Sabri Novosella ai që nuk kishte formuar besnikët që të propagandonin figurën e tij. Ndoshta Sabiru ishte i bindur se të gjithë e njihnin si i burgosur i grupit të Demaçit, si njeri që Jusufi kishte pasur respekt, andaj nuk i kishte kushtuar rëndësi ngritjes se kultit të individit.

Mirëpo edhe Jugosllavia nuk mungonte të ngrinte kulte të individëve shqiptarë përmes shtypit të tyre, për të dy krahët: djathtiste dhe majtiste. Shërbimi sekret jugosllav punonte kur e ngrinte ndonjërin. Specialistët e propagandës së shërbimit sekret me qëllim i ngatërronin, i përzienin emrat e individëve ; ndërsa kur flisnin për një ngjarje konkrete përmendnin emra njerëzish, që kishin dhe nuk kishin lidhje me ngjarjen. Shtypi jugosllav shkruante se si filani apo fisteku ishin tepër të rrezikshëm për integritetin territorial të Jugosllavisë. Përmes shtypit jugosllav disa fitonin besim në masën popullore si në Kosovë, ashtu edhe në diasporë. Si mund ta kritikoje dikë që në shtypin e armikut shkruante se ishte njeri kryesor apo ndër kryesorët e çështjes kombëtare ?!

Çuditërisht shtypi jugosllav kurrë më nuk do shkruante për aktivitetet, që Musa Hotit që zhvillonte në Bruksel pas lirimit nga burgu. Kurrë shtypi jugosllav nuk do të shkruante për aktivitetet që unë zhvilloja, jo vetëm në lëmin e kulturës, ku tri herë u prishën relacionet shtetërore Belgjikë-Jugosllavi, por edhe për aktivitete në

Parlamentin Europian ku me iniciativën time u realizuan dhjetëra rezoluta kundër Jugosllavisë. E ata asnjë fjalë kundër meje, por plot kundër atyre që tërë ditën pinin raki e luanin letra. Vetëm një artikull ishte shkruar kundër meje, që më shumë e ka bërë gazetari i zënë ngushtë mes jetës dhe vdekjes se përndryshe kurrë nuk do të ishte shkruar. Ata nuk shkruanin kundër meje apo Musës e ndonjë tjetri në shtypin e tyre, por shtetit të Belgjikës i shkruanin duke protestuar dhe duke u kërcënuar se prishën relacionet diplomatike, nëse Belgjika nuk do të ndërmerrte hapa konkretë për ndalimin e aktiviteteve tona.
Mendoj se liderët e Lëvizjes nuk kanë dëshiruar që të krijohet imazhi i individit që dallohet me punë, nga frika se popullarizohej dhe bëhej i rrezikshëm për vendin e tyre. Dalja e Musa Hotit nga burgu, që në tërë diasporën e kishte krijuar personalitetin e një heroi kombëtar, po ua rrezikonte postet e tyre. Kurrë ata nuk e lejuan që Musa Hoti të dilte përpara demonstruesve për të mbajtur një fjalë të vetme. Kurrë ! Po t'i lejohej dalja para masës, Musa do të fitonte simpatinë e tërë anëtarëve të Lëvizjes kudo që do të ishin ata. Dalja publike e Musës përpara demonstruesve do të elektrizonte masën dhe do ta forconte më shumë Lëvizjen, por ata nuk donin shumëfishimin e anëtarëve. Ata i ruanin postet e tyre. Musës i thonin « Ti je me ne ! Ti je i yni » Po të dalësh ti , Jugosllavia na akuzon që jemi organizatë terroriste ». Në çdo aktivitet Musës ia kanë mbyllur derën me demagogji të tillë.
Kur Musa gjendej në liri, relacionet në mes tre liderëve ishin të acaruara, por jo të ekspozuara. Musa Hoti vazhdonte të kontribuonte në Lëvizje, njëlloj siç kishte vepruar nga burgu. Pas një kohe relativisht të shkurtër, filluan akuza të ndërsjella mes liderëve, ku përfshihej edhe Milaim Zeka. Asokohe Milaim Zeka kishte nofkën « Ganiu ». Milaimi kishte një oratori të pa parë asnjëherë më parë. Para masës ishte në gjendje të fliste pa asnjë letër më orë të tëra. Fjalimet e tij e elektrizonin masën dhe Lëvizjes i jepte një imazh pozitiv, ku krijohej përshtypja se aty janë më të shkolluarit dhe më patriotët e viseve shqiptare. Fama e tij ngrihej gjithnjë e më shumë në mjediset e punëtorëve. Nuk kaloi shumë dhe nisën të qarkullonin

fjalë se Ganiu, alias Milaim Zeka, ishte përzënë nga Shqipëria si i padëshirueshëm. Unë kurrë më parë nuk e kisha dëgjuar se Milaimi para së të instalohej në Perëndim kishte qenë në Shqipëri. Këto të dhëna i dinin Xhaferi, Ibrahimi, Sabriu e ndonjë tjetër afër tyre. Natyrisht që edhe akuzat kundër tij do të vinin prej tyre, por duke ua thënë vetëm njerëzve të besuar të klanit të ngushtë. Nuk vonoi shumë kohë, filluan edhe akuzat kundër Xhafer Shatrit, duke pëshpëritur se atë Serbia e kishte lëshuar nga burgu, menjëherë pas vrasjes së trefishtë të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit. Këto ishin akuza, që i bënte Sabri Novosella, duke u bazuar dhe duke dokumentuar se kështu ia kishte thënë Daja i Madh, alias Shqipëria. Kësaj akuze iu bashkëngjiten edhe: Musa Hoti, alias Valoni, Milaim Zeka, alias Ganiu, Skendër Durmishi, alias Sahiti, dhe disa të tjerë. Për Skender Durmishin thuhej se e kishte dërguar Serbia që ta vriste Jusuf Gërvallën, por ai porsa kishte arritur ishte paraqitur të Jusufi dhe ia kishte dhënë revolën me të cilën duhej ta vriste. Pas kësaj ngjarjeje, Jusufi e kishte afruar shumë dhe Skenderi kishte post të rëndësishëm.

Ne, në Bruksel, ishim ata që ishim. Unë me Enver Hadrin vazhdonim aktivitetin tonë me Komitetin për Mbrojtjën e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Klubi « Idriz Seferi » filloi të përkrahte krahun e Ibrahim Kelmendit, por një pjesë e anëtarëve të tyre iu bashkuan Musa Hotit, i cili ishte i krahut të Sabriut.

Xhaferi kishte këmbëngulur që grupi ynë ta përkrahte krahun e tij, ku bënte pjesë Ibrahim Kelmendi. Musa Hoti insistonte që grupi ynë ta përkrahte krahun e tij ku ishte Sabriu dhe Milaimi.

Ne vazhduam të mos e përkrahnim asnjërin krah dhe dhamë dorëheqje nga organizimi i celulës sonë ilegale të Lëvizjes. Grupi ynë nuk e ndjente nevojën të anonte në asnjërin krah, sepse aktivitetet tona në Parlamentin Europian ishin sa tërë Lëvizja që kishte dhjetëramijëra anëtarë. Lëvizja përfitonte prej nesh, jo ne prej tyre. Lëvizja ne na përdorte për interesat e tyre. Megjithatë, kur vinte puna, nuk na lejonin as në klubet e tyre e as të flisnim ne manifestime publike të cilat Enveri ua merrte lejet për manifestime.

Ne e dinim që na përdornin si vegël, por për ne më rëndësi kishte që të avanconte çështja kombëtare.
Sabri Novosella, duke e parë se nga Turqia ishte vështirë të ndikonte, detyrohet të instalohet në Europë që të jetë më afër vendit ku zhvillohej ngjarja. Sabriu, Skenderi Milaimi e të tjerë shkuan në Suedi dhe nga aty doli numri i parë i « Zëri i Kosovës », me të njëjtën logo, por me format më të vogël.
Tani botoheshin dy organe të Lëvizjes: njëri me qendër në Suedi, tjetri në Biel ( Zvicer) në adresën që e kishte gjithnjë. Përvjetori i Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës bëhej dy herë në vit. Me 16 janar e bënte njëri krah e me 17 janar tjetri krah i Lëvizjes. Syzana Gërvalla ishte në krahun e Sabriut, aty ku bënte pjesë edhe Musa Hoti, i cili kujdesej për artikujt e « Zërit » organit të tyre.
Musa Hoti ishte aktiv, por gjithnjë nën hije. Në këtë kohë do të dilte edhe grupi i tretë në krye me Avdullah Prapashticën që ishte në aktivitet me grupin e tij qysh nga fillimi. Ky grup nuk kishte jehonë, pavarësisht se Avdullahu nxirrte organin « Punëtorët ». Në anën tjetër kishte filluar të krijohej edhe një opozitë tjetër; ajo e grupit të Hasan Malës.
Lëvizja e Xhaferit dhe Ibrahimit filloi të dobësohej. Lëvizja e Sabriut dhe Musa Hotit filloi jo vetëm të dobësohej, por edhe të shkatërrohej.
Në këto kohë ndarjesh të Lëvizjes, në skenën politike hyn Hysen Gërvalla. Hysen Gërvallës i kishte propozuar grupi i Hasan Malës, grupi i Xhafer Shatrit dhe ai i Sabri Novosellës vend të rëndësishëm në Lëvizjet e tyre, por Hyseni nuk kishte pranuar. Kyçja e Hysen Gërvallës në njëren prej këtyre Lëvizjeve do ndikonte pozitivisht dhe do të ringjallej, ku Hyseni vënte firmën e tij. Mirëpo Hysen Gërvalla donte më shumë. Dëshironte të kishte vendin e të vëllait, Jusufit. Asnjëra palë nuk ia lëshonte këtë vend. Kështu që Hysen Gërvalla nis punën dhe krijon grupin e tij.
Hysen Gërvalla, duke shpresuar se emri i Jusufit do t'i ndihmonte për të bashkuar shqiptarët e ndarë në pesë pjesë, shkruan një letër publike me emër e mbiemër të tij. Në grupet majtiste ilegale ishte

hera e parë që dikush bënte thirrje publike me emër e mbiemër. Kjo nuk ndodhi për qëllime demokratike, por thjeshtë duke shpresuar në luftën e Jusuf Gërvallës, se populli do t'i shkonte pas edhe pasardhësit të tij, Hysen Gërvallës.
Hysen Gërvalla do t'i drejtohet popullit me këtë letër:

***"Letër e hapur,***

## *Tri grupeve, respektivisht organizatave Që luftojnë në emër të LRSSHJ-së*

Qe në fillim e shoh të udhës të theksoj se propozimi i parashtruar më poshtë është mendim i lirë, mbështetur në qëllimet më të sinqerta, të cilat ia ka imponuar koha dhe momenti i çdo njeriut të ndershëm të popullit tone dhe që, jam i bindur se i ka parasysh edhe secili prej jush.

Parasëgjithash, mendoj se të tri grupet duhet ta studiojnë këtë propozim në mënyrë sa më objektive, të paanshme e pa pasoja dhe të marrin një qëndrim, duke patur parasysh gjithnjë interesin e përgjithshëm dhe rrugën, e cila na shpie drejt qëllimit për realizimin e kërkesës së popullit tone- konstituimin e Republikës së Kosovës në kuadrin e Federatës Jugosllave.

Ashtu siç është e ditur, duke filluar nga data 17.02.1982 u bashkuan LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, respektivisht, më 15.05.1982 këtij uniteti iu bashkangjit edhe OMLK-ja. Këto grupe formuan organizatën e vetme, e cila veproi nën emrin LRSSHJ.

Duke u mbështetur në këto fakte krijohet bindja se ky bashkim ishte vetëm formal e jo esencial. Këtë e dëshmojnë edhe ngjarjet që pasuan dhe sollën deri të shpartallimi i Lëvizjes.
Mirëpo, siç thotë Lenini, bëhet një bashkim, i cili dështon për të ardhur deri të një bashkim i fuqishëm ( duhet të ndahemi që të bashkohemi! ). Prandaj është e domosdoshme që të bëhet një bashkim i vërtetë dhe esencial i tri grupeve, respektivisht organizatave të lartpërmendura.

Madje edhe nëse ekziston ndonjë grup apo organizatë tjetër me orientime dhe qëllime të drejta, mendojmë së është e udhës t'i bashkohet Lëvizjes së përgjithshme.

Përvoja historike e popullit tonë dhe lëvizjet e shumta të popujve të tjerë, kanë dëshmuar se bashkimi bën fuqinë, garanton fitoren dhe sjell deri të shpëtimi kombëtar; kurse shkapërderdhja e distribuimi i forcave çon në dështim, në zventim dhe në katandisje të lëvizjes.

Në bazë të të gjitha këtyre dal më ketë propozim:

- që tri grupet t'i autorizojnë përfaqësuesit e tyre, me të gjitha kompetencat e duhura, prej tre deri në pesë veta.
- bashkimi të bëhet pa asnjë kusht nga tri grupet ekzistuese, respektivisht organizatat. (Po deshëm të arrihet mirëkuptimi duhet t'i hedhim poshtë të gjitha pretendimet se njëra është e drejtë, se tjetra është më e fortë apo se akcila është "koka" e kombit shqiptar; pretendime këto megalomane, tendencioze të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejt apo terthorazi, shkojnë në dobi të armikut e që pengojnë bashkimin e lakmueshëm.

Edhe pse nuk mund të mohohen anët pozitive të luftës, që është zhvilluar nga këto tri grupe, lufta e zhvilluar, që nga koha e bashkimit formal, ka qenë më tepër luftë mes grupësh dhe individësh, sesa luftë kundër armikut.

Qe të shkohet përpara dhe të eliminohen të gjitha anët negative të këtyre grupeve, është e domosdoshme të arrihet bashkimi i tyre në një organizatë të vetme dhe të njësuar, në mënyrë që tërë aktivitetin ta drejtojnë kundër armikut- shovinistëve serbomedhenj dhe të tjerëve që na bëjnë pengesa në realizimin e kërkesës së popullit shqiptar për formimin e Republikës Socialiste të Kosovës në kuadrin e Federatës.

Mendoj se kjo duhet të arrihet:

1. – me shkrirjen e tri grupeve në një organizatë, e cila do të emërohet: Lëvizja për Republikën Socialiste tê Kosovës në Jugosllavi

**Arsyetimi:**

Republikat ekzistuese në Jugosllavi, emërohen sipas territorit, psh, RS e Sllovenisë, RS e Kroacisë, etj. Prandaj e shoh të arsyeshme që të merohet kështu edhe RS e Kosovës, në mënyrë që t'i mos mbetet rrugë dhe mundësi e askujt të na sulmojë, gjoja, se kërkojmë Republikë "të pastër etnike".

2. - duke pasur parasysh se "Zëri i Kosovës" është Zëri i tërë popullit shqiptar në Jugosllavi dhe i atyre në mërgim, që thërret për një Republikë në kuadrin e Federatës, e shoh të arsyeshme që të mbetët emri i organit "Zëri i Kosovës".

3. - simbolet e gjertanishme, siç janë stema dhe pushka me flamur, duhet të hiqen, pasi për këto simbole duhet ta japë fjalën vetë populli i Kosovës dhe të përcaktojë vetë stemën dhe Republikën e tij.

**Arsyetimi:**

Pushka me flamur nuk përputhet me platformën e kërkesës së popullit tonë në luftën e tij për Republikë pa përdorim të dhunës.

Do të ishte mirë që simbol i organit të jetë libri dhe pena, të cilat në këtë moment dhe me në këto rrethana specifike, do të simbolizonin luftën tonë me libër e me penë dhe me mjete tjera demokratike pa u përdorur dhuna.

Lëvizja përfundimisht duhet të distancohet nga të gjitha format e luftës që mbajnë erë baroti, njëherë, mendoj se është me vend, mos t'i imponojmë Jugosllavisë asgjë tjetër përveç realizimit të kërkesës për konstituimin e Republikës së Kosovës, respektivisht LRSKJ-në.

Jugosllavia nuk duhet të luftohet as si shtet as në pikëpamje të sistemit shoqëror dhe kam bindje se me konstituimin e kësaj Republike, populli shqiptar në Jugosllavi do të jetë i barabartë me të gjithë popujt tjerë të Federatës dhe të mënjanohet rreziku i ndonjë konflikti më të gjerë në përmasa jugosllave e Ballkanike. Përderisa populli shqiptar është i persekutuar dhe pa të drejta, nuk mund të ketë paqe dhe qetësi as për popujt tjerë që e përbëjnë Federatën.

Këto që u cekën dhe shumë të tjera, që mund të nënkuptohen, na bindin se ndihma jonë, po qe se është e drejtë, do të jetë shumë e madhe; po të mos jetë e drejtë, kontributi ynë do të jetë i vogël,

sepse populli e di mirë rrugën e vet. Pra, bashkimi do të reflektohet si besëlidhje në fitoret tona dhe do të tregojë qartësinë dhe pjekurinë e përgatitjes sonë për luftë. Besëlidhja e fortë ka qenë gjithnjë kushti i parë, i cili na ka shtie në fitore të pareshtura dhe përfundimtare. Na kanë mësuar rrugët e gjata dhe të hidhura se vetëm të bashkuar mund të luftojmë drejt, se gabimet e bëra gjatë luftërave të kaluara duhet të na shërbejnë si mësime të shtrenjta. Nga ana tjetër luftërat mes grupesh gjithnjë janë paraqitur në momente kur na ka humbur qartësia, por atë- qartësinë- e kemi gjetur së shpejti, jemi bashkuar pa pengesa duke i eliminuar gabimet e vogla, kurse të mëdhatë i kemi zvogëluar. Kështu ka ecur shqiptari nëpër rrugën e historisë, i munduar, por kurrë i thyer, kurrë i asgjësuar. Kjo qëndresë u arrit përherë duke u mbajtur për njëri-tjetrin dhe duke i bërë pushkët strumbullarë në duart e bashkuara dhe të fuqishme.

Po qe se ky bashkim nuk arrihet, do të vërtetohet edhe njëherë se në mesin tonë ka njerëz, që punojnë për armikun; do të vërtetohet papjekuria jonë në çështjen e madhe, e cila duhet të qëndrojë mbi çdo interes personal dhe mbi çdo tendencë individuale dhe subjektive. Duhet t'ua theksojmë shokëve të ndershëm që të marrin drejtqëndrimin dhe ta thonë fjalën e vet çdonjëri në emër të kësaj çështje të madhe, të distancohet secili, pa ngurrim, pa humbur kohë dhe pa luhatje, prej grupeve, prej dinastive, familjarizimit, bajraktarizmit, përkatësive primitive fisnore e të hordës dhe, mbi të gjitha prej "Krerëve" që pengojnë bashkimin; ta thotë secili fjalën e vet haptas, mendimin e vet të lirë konstruktiv, sepse, siç ka theksuar Isamil Qemaili, çdo shqiptar i ndershëm ka të drejtë të flasë në emër të kombit dhe atdheut.

Nder i madh është të përcaktohesh në shërbim të atdheut, ndërsa tradhti të vihesh në shërbim të individëve destruktivë, sepse forca qëndron në masë, jo në grupe, as në individë.

**Në Delémont – Zvicër, më 12.07.1985** **Hysen Gërvalla**

leter e hapur:

## TRI GRUPEVE,RESPEKTIVISHT ORGANIZATAVE
## QE LUFTOJNE NEN EMRIN E LRSSHJ-se

Qe në fillim e shof te udhes te theksoj se propozimi i parashtruar me poshte, eshte mendim i lire, mbeshtetur ne qellimet me te sinqerta, te cilat ia ka imponuar koha dhe momenti çdo njeriut te ndershem te popullit tone e qe, jam i bindur se i ka parasyshe edhe seicili prej jush.

Parasegjithash, mendoj se te tri grupet duhet t'a studjojne kete propozim ne menyre sa me objektive, te paanshme e pa pasjone dhe te marrin qendrim, duke patur parasyshe gjithenje interesin e pergjithshem dhe rrugen, e cila na shpie drejte qellimit per realizimin e kerkeses se popullit tone - konstituimin e Republikes se Kosoves ne kuadrin e Federates Jugosllave.

Asgjtu siq eshte e ditur, duke filluar nga data 17.02.1982, u bashkuan LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, respektivisht, me 15.05.1982, ketij uniteti iu bashkangjit edhe OMLK-ja. Keto grupe formuan organizaten e vetme, e cila veproi nen emrin LRSSHJ.

Duke u mbeshtetur ne keto fakte, krijohet bindja se ky bashkim ishte vetem formal e jo esencial. kete e deshmojne edhe ngjarjet te cilat pasuan dhe sollen deri te shpartallimi i Levizjes.

Mirepo, siq thot Lenini, behet nje bashkim i cili deshton per te ardhur deri te nje bashkim i fuqishem (duhet te ndahemi qe te bashkohemi!)

Prandaj eshte e domosdoshme qe te benet nje bashkim i vertete dhe esencial i tri grupeve, respektivisht organizatave te lartepermendura.

Madje, edhe nese egziston ndonje grup apo organizate tjeter me orientime dhe qellime te drejta, mendojme se eshte e udhes t'i bashkohet Levizjes se pergjithshme.

Pervoja historike e popullit tone dhe levizjet e shumta te popujve tjere, kane deshmuar se bashkimi bene fuqine, garanton fitoren dhe sjelle deri te shpetimi kombetare, kurse shkaperderdhja e distribuimi i forcave çon ne deshtim, ne zvetnim dhe ne katandisje te levizjes.

Ne baze te te gjitha ketyre dal me kete propozim:

- qe te tri grupet t'i autorizojne perfaqesuesit e vet me te gjitha kompetencat e duhura, prej tre - pese veta.
- bashkimi te behet pa asnje kusht nga te tri grupet egzistuese, respektivisht organizatat. (Po deshem te arrihet mirekuptimi, duhet t'i hedhim poshte te gjitha pretendimet se njera eshte e drejte, se tjetra eshte me e forte apo se akcila eshte "koka" e kombit shqiptare; pretendime keto megalomane, tendencioze te cilat ne menyre te drejte per drejte apo terthorazi shkojne ne dobi te armikut e qe pengojne bashkimin e lakmueshem.)

3.-

persekutuar dhe pa te drejta, nuk mund te kete paqe dhe qetesi as per popujt tjere qe e perbejne Federaten.

Keto qe u ceken edhe shume tjera qe mund te nenkuptohen, na bindin se ndihma jone po qe se eshte e drejte, do te jete shume e madhe, po te mos jete e drejte - kontributi yne do te jete i vogel sepse populli e di mire rrugen e vet. Pra, bashkimi do te reflektohet si beslidhje ne vazhdimsine e fitoreve tona dhe do te tregoi qartesine e pjekurine e pregaditjes sone per lufte. Beslidhja e forte ka qene gjithenje kushti i pare, i cili na ka shpier ne fitoret e pareshtura dhe perfundimtare. Na kan mesuar rruget e gjata dhe te hidhura se vetem te bashkuar mund te luftojme drejte, se gabimet e bera gjate luftrave te kaluara duhet te na sherbejne si mesime te shtrenjeta. Nga ana tjeter luftrat mes grupesh gjithenje jane paraqitur ne momente kur nà ka humbur qartesia, por ate - qartesine - e kemi gjetur se shpejti, jemi bashkuar pa pengesa duke i eliminuar gabimet e vogla, kurse te mdhate i kemi zvogluar dhe keshtu ka ecur shqiptari neper rrugen e historise, i munduar, por kurre i thyer, kurre i asgjesuar. Kjo qendrese u arrit perhere duke u mbajtur per njeri-tjetrin dhe duke i bere pushket strumbullare ne duart e bashkuara dhe te fuqishme.

Poqese ky bashkim nuk arrihet, do te vertetohet edhe njehere se ne mesin tone ka njerez qe punojne per armikun, do te vertetohet papjekuria jone ne çeshtjen e madhe, e cila duhet te qendroi mbi çdo interes personal dhe mbi çdo tendence individuale dhe subjektive. Duhet t'ua theksojme shokeve te ndershem qe te marrin drejteqendrimin dhe t'a thone fjalen e vet çdonjeri ne emer te kesaj çeshtje te madhe, te distancohet seicili pa ngurim, pa humbur kohe dhe pa luhatje prej grupeve, prej dinastive, familjarizmit, bajraktarizmit, perkatesive primitive fisnore e te hordes dhe, mbi te gjitha prej "Krereve" qe pengojne bashkimin; t'a thot seicili fjalen e vet haptas, mendimin e vet te lire e konstruktiv, sepse siq ka theksuar Ismail Qemaili, çdo shqiptar i ndershem ka te drejte te flas ne emer te kombit dhe atdheut.

Ndere i madh eshte te percaktohesh ne sherbim te atdheut ndersa tradhti te vihesh ne sherbim te individeve destruktiv, sepse forca qendron ne mase e jo ne grupe as ne individ.

ne Delémont - Zvicerr, me 12.07.1985

Hysen Gervalla

*Hysen Gërvalla*

***Letra e parë e Hysen Gërvallës për Bashkim 17.07.1985***

## *Ndikimi i letrës në masë*

Musa Hoti që ishte krahu i Sabriut dhe të gjithë liderët tjerë këtë letër të shkruar në emër të Hysen Gërvallës nuk e kishin marrë parasysh. Letrën e lexonin punëtorët dhe tërë diasapora shqiptare që nga Zvicra e deri Amerikë. Hysen Gërvalla gjente përkrahjen e individëve nga të gjitha grupët e Lëvizjes, por nuk haste në mirëkuptim me shefat e tyre.
Bazuar në përmbajtjen e letrës së tij, shihej se Hysen Gërvalla fliste në emër të një institucioni, por pasur askënd afër tij. Nuk kishte zyrë, nuk kishte adresë, nuk kishte sejmën, nuk kishte organ e as mjete materiale.
Të veproje në emër të një institucioni ishte guxim edhe më guxim të nënshkruaje me emër e mbiemër të plotë. Kjo nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë. Një letër të tillë, të hapur, edhe kur Lëvizja u nda në katër copa, nuk kishte marrë guximin ta bënte Sabri Novosella, Xhafer Shatri dhe as Ibrahim Kelmendi.
Hysen Gërvallës nënshkrimi do t'i kushtonte shumë sepse, aktivistët e ilegalitetit ishin mësuar të hidhnin gurin e të fshinin dorën. Më këtë rast hidhej guri dhe dihej autori. Menjëherë pas kësaj letre do të dalin thashethemet kundër Hysen Gërvallës, pikërisht nga nga ata me të cilët nuk kishte gjetë gjuhë të përbashkët. Flisnin se Hyseni është i dyshimtë dhe Serbia e kishte dërguar të kontrollonte dhe pasivizonte Lëvizjen; thonin se Hyseni po e heq pushkën simbolin e rezistencës dhe kërkon që liria të fitohej në mënyrë paqësore! Në anën tjetër vetë ata ishin kundër aktit që kishte bërë Musa Hoti e tash flisnin kundër Hysenit për këmbënguljen e tij të hiqej stema dhe pushka. Hysen Gërvalla nuk kërkonte asgjë më pak se grupet tjera, vetëm se rrugën simbolet i kishte lënë t'i zgjidhte populli e jo mërgata.
Gjatë publikimit të kësaj letre unë isha në ShBA, ndërsa Musa Hoti në Bruksel i aktivizuar në organin e tyre, "Zëri". Në Nju Jork ishte edhe nipi i Xhafer Shatrit më të cilin në vitin 1984 ishte kudo më mua në aktivitetet e atjeshme që i zhvilloja unë. Në vitin 1986 kur

isha për herën e tretë, Xhaviti nuk vinte në asnjë takim dhe në asnjë aktivitet që e zhvilloja unë me shokët tjerë të Nju Jorkut, sepse asokohe Xhafer Shatri kishte acaruar marrëdhëniet me Musa Hotin dhe ishte bërë krah i Ibrahim Kelmendit, por gjithnjë Xhaferi e mbante kontrollin total të Lëvizjës. Edhe në Nju Jork dhe vende tjera të Amerikës letra e Hysen Gërvallës do bënte jehonë. Në këtë kohë në Nju Jork kishte ardhur prof. dr Sefedin Fetiu me të cilin shoqërohesha unë.

Edhe unë, edhe Sefedini në biseda tona private me bashkatdhetarët e atjeshëm e respektuam mendimin e Hysen Gërvallës. Pas disa muajve, kur unë po kthehesha në Kosovë, bëra që edhe Sefedini të vinte në Bruksel. Sefedini ishte i sëmurë nga veshkat, prandaj preferonte të ishte më afër Kosovës. Çuditërisht Brukseli kishte emër të madh për veprimtari kombëtare, por nuk kishte lider të tij. Nga xhelozia ndërshqiptare komuniteti i Belgjikës i preferonte liderët që vinin nga Gjermania, jo ata që vepronin dhe jetonin me ta. Musa Hoti ishte lider i pakontestueshëm në mbarë diasporën, por jo në Belgjikë.

Po bëhej një vit që letra e Hysen Gërvallës nuk po gjente impakt te shefat, por po ndikonte në masën e gjerë. Këta simpatizantë ishin vetëm fluska të shpërndarë në ajër, sepse u mungonte organi i shtypit dhe zyra ku duhej të takoheshin, ku duhej të informoheshin.

Në gusht të vitit 1987 shkova në Zvicër të Hysen dhe Avdyl Gërvalla, në shoqërimin e Mustafë Istrefit, që ishte kusheri i poetit të njohur Adem Istrefi. Në shtëpinë e Hysen Gërvallës qëndrova një javë e më shumë. Gjatë bisedave të ndryshme u vendos që të shkruhet edhe letra e dytë përmes së cilës Hyseni do t'i drejtohej publikisht popullit shqiptar në diasporë.

Gjatë qëndrimit tim më shumë bisedoja me Avdylin me të cilin flisnim për kohë të shkuara në Kosovë. Avdyli ishte më i ri se unë. Kujtonim kur unë e Sefo Bejta Krasniqi rrinim me Jusufin në kafene të Prishtinës e Avdyli vinte por nuk rrinte shumë. Flisnim për filmin "Procesi", dramë nga Jusuf Gërvalla, që unë e kisha realizuar si film. Më tregonte Avdyli se unë kisha fituar shumë pare nga filmi siç kishte dëgjuar nga disa shqiptarë që jetonin në Belgjikë dhe që

kishin shkuar enkas para meje ta vizitonin këtë familje. I tregoja se nuk kisha fituar asgjë për gjashtë muaj, vetëm se e kisha të paguar ushqimin dhe fjetjen në banesa të dobëta të ndonjë bashkatdhetari.
Gjatë vizitës sime kisha përshtypjen se Hysen Gërvalla fluturonte nga gëzimi. Kjo shihej në biseda që vinin shqiptarët për të vizituar familjet e dy dëshmorëve nga të gjitha anët e Zvicrës. Hyseni vendosi që letrën ta përpilonim unë dhe Avdyli.
Unë kurrë më parë nuk kisha përpiluar tekst për një komunikatë të tillë. Avdyli po ashtu ishte i pa përvojë në këtë drejtim. Më në fund e përpiluam, herë duke kopjuar nga librat politikë e herë duke prodhuar nga imagjinata jonë. Më në fund me qyk të zorit, komunikata doli 6 faqe. E titulluam "Thirrje masave". Në të u referoheshim thënieve të Adem Demaçit, Skenderbeut, Naim Frashërit. Doli një thirrje modeste por kuptimplote.
Ja pjesërisht letra e përpiluar dhe shkruar nga Avdyl Gërvalla dhe unë

***Letra e dytë e Hysen Gërvallës***

## THIRRJE MASAVE

Kur e gjithë Europa dridhej prej fuqisë Otomane, populli shqiptar bëri bashkimin, me në krye Skënderbeun bëri Shqipërinë.
Këtë porosi Skënderbeu e kishte trashëguar me nder nga bashkimi i parë Ilirianë të të dy princërve Batua, të cilët i japin grusht ushtrisë romake, por nuk trashëgoi thyerjen e mëvonshme të tyre, që bënë për interesa të ngushta personale.
Lidhja e Prizrenit, fazë para kurorëzimit të fitores së madhe – Shpalljes së Pavarësisë, mbështetët në porosinë që vetëm të bashkuar arrihet çdo gjë.
Bashkimi është grumbullimi i të gjitha forcave në një vend, i cili vepron me efikasitetin e vet të shumëfishuar; është një goditje e përqendruar kundra armikut; bashkimi na burrëron, kthjellon

mendjen dhe sjell pushim shpirtëror duke hequr lodhjen e fatit tonë rrugëve të mundimshme e të gjata. Thonë se në bashkim forcohet karakteri, kurse në vetmi bjerrjet vullneti. Me bashkim ne do të intensifikojmë kërkesën e drejtë të popullit tonë.
Na fton viti i njëzetetetë i burgjeve të errëta të poetit, shkrimtarit, ideologut dhe mendimtarit të ndritur, i cili më kohë, duke u mbështetur në tabanin e popullit të vet dhe në fjalët e veprat e martirëve të këtij trualli, në momente si këto tona, vazhdimisht u dha të drejtë: Jo atyre që janë trima...

Pra, vëllezër, ta tregojmë pjekurinë tonë politike në çështjen tonë.
Aspiratat dhe kërkesat tona të drejta do të arrihen vetëm nëpërmjet bashkimit, kurrsesi me përçarje, në radhë të parë për shkak kushteve të këqij të jetës, të papunësisë dhe gjendjes së rëndë ekonomike të Kosovës...
..............................................................................

Po të jemi të bashkuar çdo gjë është e mbaruar
(Naim F)

Spastrimi i të gjitha mendimeve të dëmshme, angazhimi i pakursyer drejt qëllimit tonë të lartë, jo lufta kundër njëri-tjetrit, janë kushte dhe faktorë që garantojnë konsolidimin e Lëvizjes sonë.
Nuk duhet të ketë më : “Jo unë nuk mund të rri më atë se e lexon “Zërin” me adresë, “Zërin” pa adresë, “Zërin” e Suedisë, apo gazetën “Punëtorët”.
.................................
Kërkesa e kohës është thjeshtë - Bashkimi!
Bashkimi i forcave të shëndosha në vendlindje dhe në mërgim, i atyre që këtë e kuptojnë thjeshtë, ashtu siç e ka pasur zakon populli ynë gjatë shekujve me radhë, atyre që kanë sy dhe veshë, ndërgjegje të pastër dhe janë përcaktuar me tërë qenien e vet, atyre të cilët kanë interesin e përgjithshëm mbi çdo interes tjetër, luftën, e cila do të na shpie drejt realizimit të të drejtave të popullit

shqiptar, por për barazi më popujt tjerë-drejt idealit tonë , Kosova Republikë!

...................................................................

Shumë herë pyetëm: ku është betimi ‘Jemi më të fortë se kurrë më parë!”. I dhënë pas vrasjes në Gjermani.

A mos u frikësuam?!

?!

Ne, ndoshta nuk ditëm të përpilojmë tekstin e bashkimit: Thirrje masave!” , por ju ftojmë që në emër të Shpatës dhe të Përkrenares në Vjenë, fjalëve të urta të rilandasve tanë, gjakut të derdhur të bijve dhe bijave tona më të mira, qelive të errëta të burgjeve ku dergjen vëllezërit dhe motrat tona, qëndresës heroike të masave të gjëra të popullit tonë, ju ftojmë t’u qëndrojmë çdo herë besnikë dhe t’i kemi ato udhërrëfyese gjatë veprimtarisë tonë të përbashkët, në to do të gjejmë shembullin e ndritur të bashkimit dhe të mobilizimit të forcave të reja në çështjen tonë të madhe që na pret.

Përgjigjet tuaja mund t’i dërgoni në këtë adresë:

**Casse postale 120**
**2764 Courrendlin**
**Jura**
**Suisse**
**Në Zvicër, gusht 1986**

# THIRRJE MASAVE

*"... Të bashkohemi për të mbrojtur truallin e të parëve.*
*Të kryejmë detyrën ndaj atdheut,*
*për të cilin kurrë s'duhët kuptuar*
*se është derdhur tepër gjak.*
*Është luftuar sa duhët.*
*Se dashuria për Të ia kalon çdo dashurie tjetër.*
*Stemat*
*gunat*
*dhe qeleshet i kemi të ndryshme,*
*por kemi të përbashkët gjuhën dhe hallet.*
*Kjo luftë do të jetë lufta e të gjithëve."*

*i Madhi SKENDERBE, në Lezhë, më 2 mars 1444*

Kur e gjithë Evropa dridhej prej fuqisë së Perandorisë Otomane populli shqiptar bëri bashkimin e në krye me Skënderbeun bëri Shqipërinë.

Këtë porosi Skënderbeu e kishte trashëguar me nderë nga bashkimi i parë Ilirian të të dy princërve Batua, të cilët i japin grusht ushtrisë romake, por nuk trashëgoi thyerjen e mëvonshme të tyre që bënë për interesa të ulta personale, tradhëtinë e merr Hamza.

Lidhja e Prizrenit, fazë para kurorëzimit të fitorës së Madhe - Shpalljës së Pavarësisë, mbështetët në porosinë që vetëm të bashkuar arrihët çdo gjë.

Sa herë që u dha kushtrimi për bashkim prej shtatë në shtatëdhjetë luftërat i kurorëzoi me sukses.

Bashkimi është grumbullimi i të gjitha forcave në një vend, i cili vepron me efikasitetin e vet të shumëfishuar, është një goditje e përqendruar kundra armikut; bashkimi na burrëron, kthjellon mendjen dhe sjellë pushim shpirtërorë duke hequr lodhjen e fatit tonë rrugëve të mundimshme e të gjata. Thonë se në bashkim forcohët karakteri, kurse në vetmi bjerrët vullneti. Me bashkim ne do të intensifikojmë kërkesën e drejtë të popullit tonë, do të mishërohemi me të dhe hapat tonë drejt fitorës do të jenë të shpejtë e më të sigurt.

Na fton viti i njëzet e tetë i burgjeve të errta të poetit, shkrimtarit, ideologut dhe mendimtarit të ndritur, i cili më kohë duke u mbështetur në tabanin e popullit të vet dhe në fjalët e veprat e martirëve të këtij trolli, në momente, si këto tonat, vazhdimisht u dha të drejtë:

*Jo atyre që janë trima*
*Me ngrehë gishtin e krimit,*
*Por atyre që janë trima*
*Me shtri dorën e pajtimit!*

*ADEM DEMAÇI*

( dhe një letër e tij e shkruar në Kosovë më 29. 6.1963, e botuar për herë të parë në "Zeri i Kosovës", nr. 2 / 1982) :

*"... - Para nesh qëndrojnë pengesa shumë e shumë të vështira, para nesh qëndron një luftë mjaftë e gjatë dhe jashtëzakonisht e ashpër dhe e pa barabartë, por ne jemi thellësisht të bindur se populli ynë heroik kur të bashkojë të gjitha forcat e veta do të shkëpusi me siguri prangat e robërisë dhe mjerimit.*
*Mos të harrojmë se në qoftëse ne i lëmë me një anë interesat e ngushta personale dhe mospajtimet ciktrimtare nëse ne të gjithë, me mish e me shpirtë përqëndrojmë përpjekjet dhe synimet tona kah qëllimi thelbor i popullit tonë - nuk do të ketë forcë mbi faqën e dheut që do të mundet me ndalue bashkimin tonë!...*

14 - 3

6.-

Kosova tani lëngon prej sëmundjes më të vështirë - ndarjes dhe **kundërshtimit** mes pjelles së vet, si të ishim pjellë e paligjshme e saj, ajo lëngon dhe mallkon fatin e vet për bijtë, prej të cilëve pret që t'a ndihmojnë trupin e saj plotë plagë... e ne, gjersa të jemi të shpërndarë, të degëdisur, ulemi sofrave të huaja dhe gostitemi me mishin e vëllezërve të rënë... për "aperitiv" pijmë gjakun e tyre... salloneve të huaja... duke vallëzuar gjithë ditën me përqarje... ndërsa të burgosurit, ashtu si numra monedhash, i shfrytëzojmë si "zhetona" të ruletit... vetëknaqësitë tona, "që ne jemi më të mençuritë", "fati i Kosovës lidhët për personalitetin tim", "jemi trima mbi trimat"... janë fryte të përqarjës, fryte të injorimit të kërkesës së popullit tonë. *Të gjitha këto, janë ushqim shpirtërorë i kundërshtarëve tanë, të cilët duke shfrytëzuar papjekurinë tonë politike vazhdimisht i cungojnë të drejtat tona...* dhe kështu do të jetë gjithënjë përderisa të jemi të përçarë, në petka të zeza, me kravata të zeza, nëpër sofra të huaja...

Ka njerëz, që në një mënyrë apo tjetër mundohën t'i shtijnë edhe të tjerët në këto valle... rrugë të pakrye... me të vetmin qëllim për t'a nxitur përqarjen në këto momente delikate...

Jo!!!

**Populli shqiptar në Jugosllavi ka forca për t'i realizuar qëllimet e veta të drejta.**

**Kërkesa e kohës është e thjeshtë - BASHKIMI !!!**

Bashkimi i forcave të shëndosha në vendlindje dhe në mërgim, i atyre që këtë e kuptojnë, thjeshtë ashtu siq e ka patur zakon populli ynë gjatë shekujve me rradhë ; atyre që kan sy dhe vesh, ndërgjegje të pastër dhe janë të përcaktuar me tërë qenjen e vet, atyre të cilët e kanë interesin e përgjithëshem mbi çdo interes tjetër, luftën e cila do të n'a shpie drejtë realizimit të të drejtave të popullit shqiptar, për barazi me kombe tjera - drejtë idealit tonë KOSOVA REPUBLIKE !!!

Vet identiteti ynë, është rezultat i luftrave të drejta të cilat populli ynë i bëri pandërprerë gjatë shekujve të robërisë, por të gjitha ato fitore janë rezultat i forcës së përbashkët e cila është sintetizuar gjithënjë gjatë periudhave më të vështira me **bashkim dhe besëlidhje.**

Njeh populli ynë momente vendimtare gjatë shekujve, prej tyre ka nxjerrë figura të ndritura që i kanë shërbyer bashkimit, kurse ata të tjerët që e kanë kundërshtuar bashkimin, i ka hedhur në shportën e mbeturinave, të tillët kanë mbetur tipa destruktiv e lakmitarë, të pa varrë e të pa nishan, pa asnjë fije tradite, të cilët me ose pa vetëdije bëjnë punën e armikut më të rrëzikshëm!

Shumë herë pyetëm : Ku është betimi "Jemi më të fortë!", i dhënë pas vrasjës në Gjermani.

A mos u frikësuam?

?!

Ne, ndoshta nuk dijtëm të përpilojmë tekstin e bashkimit : **THIRRJE MASAVE !** por ju ftojmë që në emër të : Shpatës dhe Përkrenarës në Vjenë, fjalëve të urta të Rilindasve tanë, gjakut të derdhur të bijëve dhe bijave tona më të mira, qelive të errta të burgjeve ku dergjen vëllazërit dhe motrat tona, qëndresës heroike të masave të gjëra të popullit tonë, ju ftojmë t'u qëndrojmë çdoherë besnikë dhe t'i kemi ato udhërrëfyese gjatë veprimtarisë tonë të përbashkët, në to të gjejmë shembullin e ndritur të bashkimit dhe të mobilizimit të forcave të reja në çështjen tonë të madhe që na pret.

Përgjigjet e juaja mund t'i dërgoni në këtë adresë :

në Zvicërr, gusht 1986

Casse postale 120
2764 Courrendlin
JURA
SUISSE

{[illegible]
([illegible] PËR HYSEN G.)

***Letra e dytë e Hysen Gërvallës f. 1 & 6, drejtuar masës me gusht 1986***

## *Komentimi*

Pas publikimi të letrës, unë vendosa të shkoja në Bruksel, sepse kisha më shumë se një javë që qëndroja në Zvicër ku takoja shokë me të cilët njihesha që në Kosovë.
Në Bruksel me ne erdhi Avdyl Gërvalla. Bashkë më të vizita e parë ishte në shtëpi të Musa Hotit. Në Bruksel, Avdyli kishte edhe një mik të tij nga ana e gruas, por ne vazhdonim të kontaktonim shqiptarët më aktivë të Belgjikës e gjithnjë Musa Hoti ishte shoqërues i Avdylit.
Në komunitetin tonë letra e Hysenit po gjente përkrahje, sepse aty, veçse kishin filluar ndarjet në mes grupit të Ibrahimit dhe Sabriut. Një pjesë e konsiderueshme e tyre ishin pranë Musa Hotit si Qamil Zekolli, Muharrem Hajdini, Milaim Blakaj, Shqipe Bujupi e ndonjë tjetër emrat e të cilëve aktualisht nuk më kujtohen.
Pas një kohe të shkurtër në Bruksel te Musa Hoti, erdh Hysen Gërvalla që të formonte grupin zyrtarisht. Hyseni me mua u takua vetëm disa orë, pastaj shkoi për të marrë pjesë në takime grupore që, aktivistët e Brukselit bashkë më Musa Hotin, ia kishin organizuar. Musa ishte simpatizues i Hysen Gërvallës, por nuk e shihte të arsyeshme të shkrinte Lëvizjen e tij tek Hyseni që, përveç emrit të tij dhe ndonjë shoku përkrahës, nuk kishte të tjerë që e pasonin. Më vonë me dobësimin e LRSSHJ- së Musa do t'i bashkohej Hysenit.
Pikërisht në këto kohë Enver Hadri e kishte një orë emision të lirë në një radiostacion në qendër të Brukselit dhe më tha mua që të punoja, por unë i sugjerova Musa Hotin me arsyetimin se kishte kohë dhe aftësi për këtë gjë. Pas bisedës më Musën, pranoi që ta merrte këtë emision. Musa Hoti ishte parimor dhe njeri që nuk i thyente rregullat e grupit. Pasi kishte filluar të ishte pjesë e organizimit me Hysen Gërvallën dhe pasi Hyseni ishte aty, Musa këtë çeshite e futi ne rendin të ditës. Të gjithë të pranishmit dhe vetë Hyseni ishin kundër që Musa e grupi i tyre te merrte një radio aty ku kishte shkelur këmba e Enver Hadrit. Në atë mbledhje ishte vendosur që vetë do ta gjejnë një radio me valë transmetuese edhe

më të forta se ajo e Enver Hadrit. Musa nuk i thente rregullat. Priti prej tyre, por asgjë nuk bënë. Më në fund Musa Hoti vendosi të hapë radiostacionin pa pyetur askënd.
Vendimi i Musës, pa i pyetur shokët, do t'i sillte probleme me Hysen Gërvallën dhe Avdylin. Grupi më të cilët Musa e kishte njohur Avdylin dhe Hysenin, filloi të udhëtojë për  në Zvicër. Sumë prej tyre flisnin kundër Musës, ashtu siç bënin edhe të tjerët më herët.
Musa disaherë do t'u shkruante dy vëllezërve, të cilët i respektonte për gjakun e derdhur të Jusufit dhe Kadriut. Por ata nuk i përgjigjeshin.
Ja pjesërisht një letër nga Musa Hoti, drejtuar Avdyl Gërvallës:

**Bruksel, më 28 qershor 1987**
**I nderuari shok Avdyl,**

Në fillim ju pyes si jeni më shëndet, si e keni familjen, si kaloni atyre rrugëve të mërgimit që na ranë hise dhe a jeni lodhë e mërzitë në përgjithësi?
Që prej sa isha gati para një viti, ju kam shkruar se paku tri herë, mirëpo as prej jush dhe as prej Bacës Hysen kurrë përgjigje nuk mora! Ju ndoshta jeni hidhëruar diçka, mirëpo unë shkaqet nuk i njoh?
Si po e kuptoni nga "Lajmërimi", para një muaj kemi startuar me një radio lokale, e cila nuk dëgjohet përtej Brukselit me rrethinë (mbi 1 milion banorë - shënimi im), mirëpo edhe ashtu të vogël e pranuam që mos të rrimë krejt kot. Shqiptarët me banim në kryeqytet dhe rrethinë e dëgjojnë për bukuri (në rast se dëshirojnë ), kurse në qytete tjera nuk dëgjohet. Kjo është radio e katërt me radhë në Bruksel.
........................................................... ..

Nuk po di ku dhe pse u hidhërua Baca herën e fundit te ju? Apo mos ngase e kaluam natën me Reshatin te Sabri Novosella, apo me fjalë të Sh... ?!  Tek e fundit lë të hidhërohet kush të dojë,  kryesorja është

që unë mos t'i jap shkak e ai prej vetës nëse hidhërohet, unë nuk i kam faj, edhe pse kam respekt të thellë, të sinqertë, vëllazëror për ju si Avdyl, por edhe për Bacën.

Klubi ka mbetur ashtu siç ka qenë. Reshati është në Amerikë dhe gati e ka përfunduar filmin " Kosovë shqiponjë e robëruar".

Në Bruksel; më 28 qershor 1987

I nderuar shok Avdyl,

Në fillim ju pyes si jeni me shëndet, si e keni familjën, si kaloni atyre rrugëve të mërgimit që na ranë hise dhe a jeni lodhë e mërzitë në përgjithësi ?

Që prej se isha gadi para një viti, ju kam shkruar së paku tri herë, mirpo as prej jush e as prej bacës Hysen kurrë përgjigje nuk mora ! Ju ndoshta jeni hidhëruar diçka në ne, mirpo unë shkaqet nuk i njohë ?

Si po e kuptoni nga "Lajmërimi", para një muaji kemi startuar me një radio lokale e cila nuk dëgjohet përtej Brukselit me rrethinë, mirpo edhe ashtu të vogël e pranuam, që mos të rrimë krejt kot. Shqiptarët me banim në kryeqytet dhe rrethinë të afërtë e dëgjojnë për bukuri (në rast se dëshirojnë!),kurse në vende tjera nuk dëgjohet. Kjo është radioja e katërtë me radhë në Bruksel; S'pari me radio në gjuhën shqipe pat filluar Ramadan Gashi (profi i historisë), dhe pas një letre anonime (si thoshte ai),emisionin në gjuhën tonë ua "dorëzoi" njerëzve të amb;jugosllave, të cilët e kanë edhe sot e kësaj dite të dielave nga ora 10 deri në 12.Në te, pos muzikës (që ua lejojnë kushtet e tyre),kanë edhe emision me dëshira të dëgjuesve dhe urime e përshëndetje (pa lajme).Radion e dytë e kanë zogistat me në krye Idriz Bashën e Novosejt, me nga një orë program në javë; të tretën e mban Enver Hadri(Ilirinë),me dy orë program në javë, mirpo pos ndonjë kënge shqipe, ata lexojnë materiale vetëm në gjuhën frenge (për baskët, kurdët, shqiptarët dhe disa pakica tjera),duke u shërbyer në të shumtën e rasteve me botime nga Tirana. Tash pasi startoi radioja e jonë, po dëgjoi se do e ndërprenë emisionin e tij; për shkaqe të shëndetit dhe për shkak se është tejet i zënë me "Import-Eksportin" mes Belgjikës dhe Shqipërisë.

Ne patëm startuar edhe para 7-8 muajsh me një radio të vogël, mirpo pas reagimit të Reshatit dhe Mustafës së Parisit (kryesisht!),me marrëveshje e ndërprem punën në atë radio.

2

Ata,(Reshati,Qamili,Muharremi,Shqipja e sidomos Mustafa), thirreshin,se;"meq në atë radio ka hyrë këmba e Enver Hadrit,ne nuk duhët të hyjmë aty!),por kur Mustafa më tha se"nëse ne e marrim atë radio, e komprimitojmë Bacën Hysen që është shoqëruar me mua", e me këto fjalë "u dorëzova" edhe unë. Ata pastaj për t'më "qetësuar mua", premtuan se së largu 6 muaj, do e merrim një radio më të fortë dhe ajo bisedë ngeli aty tash e më se 7 muaj ! Prita se po bëjnë diçka të tjerët dhe meq ata nuk ndërmuarën asgjë, i hyra kësaj pune duke u mbështetur kryesisht në forcat dhe mundësitë e mia.

Në radio, pos këngëve të mira, po lexojmë edhe materiale nga Zëri i Kosovës së Bielit (të cilëve sot ua shkrova një letër tetë faqesh-kritikë, pas plot 4 vitesh),"VEPRA" përej Kadri Zekës, "Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion", pastaj "7000 prisoniers politique au Kosovë" etj. por të shumtat i pregadisim vet.

Në rast se dëshironi të më ndihmoni me ndonjë material apo gazetë, lirisht mund t'i dërgoni në adresë të radios (shih; "Lajmërimin"), në:B.P. 16 - B-1120 Bruxelles ose në banesë: M.H. Laekebeekllaan, 18 - 1610 Ruisbroek (Belgique), e ato mund t'i lexojmë në radio kohë pas kohe.

Nuk po e di ku dhe përse mu hidhërua Baca; herën e fundit te ju ? apo mos që e kalova një natë (me Reshatin) te S.Novosella; apo me fjalë të Shqipes ?! Tek e fundit, le të hidhërohet kush të doj, kryesisht unë mos t'i jap shkak, e ai prej vetës nëse hidhërohet, unë nuk i kam faj edhepse kam respekt të thellë, të sinqertë, vëllazëror e revolucionar për ju si Avdyl por edhe për Bacën.

Klubi ka mbetur ashtu si ka qenë. Reshati është në Amerikë dhe gadi e ka përfunduar filmin "Kosovë-zog i robëruar". Xh.Shatri bashkpunëtorin më të ngushtë për Belgjikë e ka bërë Enver Hadrin ! Këta që i përmena më lartë, janë tërhjekur nga çdo aktivitet dhe "i ruajnë familjet e tyre në Kosovë" si thonë ata, kurse unë do të punoi në rast nevoje edhe veq vet, e radion nuk e lëshoi !

Në fund, ju përshëndes me parullën:KOSOVA REPUBLIKË !

Me nderime,

*Letra e Musës drejtuar Avdyl gërvallës*

Musa Hoti nuk mund të qëndronte duarkryq e të bënte sehir dhe nga tjerët të priste të ndërmerrnin iniciativa. Jo, ai vetë merrte dhe vetë përgjigjej për punën e tij me vetëdijen se atë që e bënte do i shërbente atdheut.



*Në foto: Musa Hoti (i para nga e majta), Hysen Gërvalla (në mes), Qamil Zekolli dhe Sefedin Fetiu*

***Radio "Zëri i Kosovës" në Bruksel***

Punën në radio për të transmetuar lajme dhe aktivitete tjera kulturore Musa e kishte marrë me një entuziazëm të madh. Me kalimin e kohës, duke parë se askush nga shqiptarët nuk e ndihmonte, jo vetëm financiarisht por as moralisht. Musa filloi të demoralizoje skajshmërisht.
Kishte mbushur një kohë të gjatë që punonte në emisionin e tij, ku përveç lajmeve, jetë dhe muzikë. Musa ftonte edhe mysafirë në studio. Si mysafir në emisionin e tij, më ftoi mua dhe Gani Azemin,

me rastin e botimit të përmbledhjes me poezi të Gani Azemit. Unë kisha përgatitur një recension për librin që e lexova; ndërsa Ganiu fliste për librin e tij. Gjatë emisionit recitova tri poezi nga libri. Njëra prej atyre poezive si motiv kishte Sefë Beta Krasniqin, të cilin UBD-ja e kishte kidnapuar duke ia hedhur thesin në kokë dhe duke iu kërcënuar. Me Sefën isha njohur qysh nga drama “Sfinga e gjallë”, ku unë luaja rolin e dytë, Habilin. Që nga ajo kohë kemi qenë të pandarë, madje, edhe bashkë kemi ikur në Belgjikë. Sefa, gjatë kohës që ishim duke punuar në Kosovë, realizoi një varg dramash dhe një film për televizion.

Në emisionet e Musa Hotit, “Zëri i Kosovës“, kam shkuar vetëm disa herë. Dhe sa herë kam shkuar për t’i ndihmuar, kam lexuar vetëm tekstet që bënin fjalë për situatën e tendosur në Kosovë. Gjatë një emisioni Musa më dha një tekst ku bëhej fjalë për një diskutim të Ramiz Alisë, të cilin pa e ditur përmbajtjen fillova ta lexoja. Mundohesha që gjatë leximit të evitoja fjali që nuk më pëlqenin. Leximi im ishte i dobët, mos të them katastrofik.

Siç u tha edhe më herët, Musa Hoti kishte parimet e veta dhe ideologjinë e tij që nuk i ndryshoi deri në vitet e çlirimit të Kosovës. Ai një herë kishte vendosur dhe më nuk kthehej prapa.

Më kujtohet një bisedë me Musën rreth ideologjisë. Unë i thoja të ndryshonte opinionet e tij. Ai ngulte këmbë dhe nuk i ndryshonte.

**UNË**: Musë, kam takuar njerëz që, pas vizitës në Shqipëri, janë kthyer të zhgënjyer!

**MUSA**: Nuk e besoj!

**UNË**: Sa isha në Amerikë, Zef Camaj thoshte se nuk është kopsht me lule Shqipëria. Në Shqipëri ka varfëri të madhe e shteti nuk kujdeset ashtu siç thonë në gazeta.

**MUSA**: Çka din Zefi, për dhjetë ditë në vizitë grupore nuk je në gjendje ta vlerësosh një shtet.

**UNË**: Nuk është vetëm Zefi, që më ka folur, ka edhe tjerë. Të gjithë flasin keq, kur bisedojmë pa prezencën e tjerëve.

**MUSA**: Flasin keq vetëm ata që i ka dërgue Serbia!

**UNË**: Edhe me Avdyl Gërvallën kam biseduar dhe me ka thënë në besim se atje është keq.

**MUSA**: Ani de, ne kosovarët nuk po dojmë as vetura, as frigo, as shtëpi të mëdha, më mirë varfër por të çliruar nga Serbia. Këmba e shkaut çetnik mos ta shkeli Kosovën.
Edhe pa bukë e pa ujë do rrina veç shkijet mos të na sundojnë! A e kam mirë?
**UNË**: Tash e the mirë dhe pajtohem me ty. Në fakt ti e pranove se në Shqipëri nuk është siç thotë xhaxhi Enver Hoxha.
**MUSA**: E di, por për inati të Serbisë nuk po due më thanë. Pikë!
Kjo bisedë u zhvillua pas emisionit ku unë evitoja ta lexoja fjalën e Ramiz Alisë. Nuk insistoja më që ai të ndërronte përmbajtjen e radios së tij. Mirëpo nuk duhet harruar se në ato kohë të gjitha radiot "Zëri i Kosovës" që ishin në diasporë ( e radio të tilla kishte në shumë vende të botës), secila i transmetonte fjalimet e Enver Hoxhës, të plenumit, të kongreseve etj. Këto radio e kishin publikun e tyre të përbërë kryesisht nga kosovarët e porsaardhur. Gati shumicën e themeluesve të këtyre radiove në diasporë i njoh dhe një pjesë e tyre ende edhe sot kur vinë për vizitë në Kosovë, flasin me nostalgji për kohën e shkuar marksiste.
Këta marksistë, a ishin të UDB-së ? !
Të gjithë marksistët që i njoh, asnjëri prej tyre kurrë nuk më ka lënë përshtypje se është kundër interesave të Kosovës. Secili ishte i bindur se e vetmja rrugë për të fituar të drejtën e Republikës së Kosovës ishte ajo rrugë.
Qe nga 1945-a e këtej, çdo kosovar që e ka simpatizuar Enver Hoxhën, e ka dashur Shqipërinë.
Çdo kosovar që e ka simpatizuar Titon e ka dashur Jugosllavinë. Patriot konsiderohej ai që e kishte fotografinë e Enver Hoxhës; e kundërta, ai që e kishte fotografinë e Titos konsiderohej tradhtar.
Në kohën e gjeneratës sime, në modë ishin disa pasqyra të xhepit. Pas këtyre pasqyrave kishte fotografi të vajzave të bukura. Ata të cilët kishin një traditë familjare kombëtare , pas fotografisë së femrës së bukur e futnin pullën postale ku ishte fotografia e Enver Hoxhës. Për herë të parë, që unë e kisha parë fotografinë e Enver Hoxhës, ishte kur Adem Salihu ( ish zv/ Kryeministër i qeverisë së Kosovë) e nxori nga pasqyra e tij. Asokohe unë nuk kisha më shumë

se 15-16 vjeç. Ademi shoqërohej me kushëririn tim, Alushin, dhe kështu unë rrija me ta rrallëherë.
Një pullë postale të tillë e ka mbajtur edhe Musa Hoti kur ishte i ri. Të gjithë ata që nuk e kanë pranuar sistemin e Jugosllavisë dhe që këtë sistem e kanë quajtur robërues të Kosovës, kanë mbajtur foto të Enver Hoxhës. Përmes këtyre pullave postale ne jemi dalluar kush është me Serbinë e kush me Shqipërinë.
Përveç pullave ishte edhe metoda tjetër që njeriun e dalloje me kë është. Të gjithë ata shqiptarë që simpatizonin klubin futbollistik " Crvena Zvezda" ishin proserbë; të gjithë ata shqiptarë që simpatizonin klubin "Partizani" ishin pro Titos; ndërsa të gjithë ata që simpatizonin "Vëllaznimin" e Gjakovës ishin pro-Shqipërisë.
Kur e përdori fjalën "të gjithë" kam parasysh shumicën, sepse në mesin e tyre të rinjtë simpatizonin ndonjë klub vetëm duke e parë se shumica anojnë andej. Pastaj "Partizanin" e kanë simpatizuar shumë shqiptarë, sepse aty luante Jusufi. Jusufi ishte yll i futbollit në tërë Jugosllavinë. Thuhej se kishte shitur fara kungulli në rrugët e Beogradit dhe prej aty ishte bërë sportist ndër më të mirët e kohës. Thuhej se klubin "Crvena Zvezda" e kishte themeluar Rankoviqi" ndaj shumica e shqiptarëve nuk e simpatizonin.
Midis shembujve që kanë ndikuar në rinin tonë, Musa Hoti sillte atë të shoferëve të kamionëve që sillnin rrush në Kosovë. Shoferët nga Shqipëria, kur e zbraznin rrushin në podrume të Kosovës, nuk e kthenin kamionin pas, por vetëm përpara. Tregonin se si një shofer u kishte thënë punëtorëve tanë se Shqipëria nuk kthehet pas, ne shkojmë vetëm përpara. Kjo thënie e shoferit u përhap në tërë rininë e kohës sonë. Madje këtë ide do ta gjeni edhe në shkrimet publicistike të Musa Hotit.
Kjo ishte koha e ngritjes së vetëdijes sonë kombëtare. Pastaj filloi literatura nga Tirana që edhe më shumë na ngjallte dashurinë për shtetin tonë amë. Kurse me ardhjen grupeve artistike nga Shqipëria për të dhënë shfaqje e koncerte situata u bë eksplozive, aqsa digjeshin këmishët ne sallë; aqsa thyheshin dritaret e sallave në tërë Kosovën vetëm e vetëm të shihnim një shqiptar nga Shqipëria.

Për gjeneratën e sotme kjo do të duket absurde, por ky ishte realiteti. Dhe ky realitet i ka ndihmuar rinisë sonë që të dinë se e kemi një shtet dhe një kryetar shteti tonin. Ai ishte Enver Hoxha. Nuk është puna ime të bëj vlerësime për Enver Hoxhën, sepse nuk e kam atë kompetencë e as aftësi profesionale, por desha të sqaroj se si ne, rina e kohës sonë, kemi vepruar. Po sikur të mos e simpatizonin Enver Hoxhën? Cila rrugë na mbetej? Tito dhe Rankoviqi! E ne, e preferonim Enverin.

Nuk ishin spiunë ata që e donin Enver Hoxhën. Ishte një shok i imi dhe i Musës, që kur i lindi djalë e pagëzoi Enlirat. Unë kurrë nuk kisha dëgjuar një emër të tillë,dhe nuk di ku ai e kishte dëgjuar apo ndoshta vetë e kishte sajuar, duke i bashkuar shkronjat. Emri Enlirat ishte krijuar nga dy shkronja të para të " Enver", dy shkronja të para nga "Liri" dhe dy shkronja të para nga "Atdheu". Ky është një veprimtar, i cili ka dhënë kontribut të madh për çështjen kombëtare, e të tillë kishte dhe ka.

Vlerësimet, se ai që ishte marksist nuk është kombëtar, janë të gabuara. Madje, ai që vlerëson kështu, vetë është në rrugën e gabuar dhe, pa asnjë dyshim, në veprimtarinë e tij do të gjeni se ai kurrë nuk ka qenë kombëtarisht në rregull.

Pse u vranë Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Vehbi Ibrahimi, Rexhepi dhe Nuhiu, Zija Shemsiu, Enver Hadri, Musa Hoti? Në mesin e këtyre të vrarëve nga Shërbimi Sekret i Serbisë kemi edhe majtistë edhe djathtistë. Për të dy palët objektivi ishte çlirimi i Kosovës dhe bashkimi kombëtar. Ata që thonë ndryshe gabojnë, sepse përveç Rexhep Malës dhe Nuhiut, të tjerët i kam njohur personalisht dhe e di se çka kanë bërë për çështjen kombëtare. Serbia i kanë vrarë figurat që kanë pasur ndikim në masë pa marrë parasysh se cilës rrymë i takonin.

Lidhur me emisionin që mbante Musa Hoti, unë disa herë e këshilloja që mos t'i lexonte referatet që i vinin nga ambasada e Shqipërisë së Parisit. Mërgata e Brukselit dallonte dukshëm nga ajo e metropoleve të tjera Europiane, sepse aty ishte përqendruar një numër i madh emigrantësh që pikërisht kishin ikur nga sistemi komunist. Rrëfimet e tyre që kishin përjetuar tortura etj. nga sistemi

në Shqipëri na bënin përshtypje. Madje ata kishin edhe një dhembje tjetër më të rëndë se ne. Të të arratisurve nga Shqipërisë sistemi ua internonte familjet dhe të gjithë i quanin tradhtarë. Në Kosovë, familjet tona përjetonin maltretime, por nuk internoheshin, e, madje, në popull nuk trajtoheshin si tradhtarë.
Kjo qe arsyeja ime që Musa duhej të ndërpriste leximin e referateve nga Tirana. Mendimet e mia e prekën Musën. Ai do t'i shkruante letër shokëve të tij lidhur me emisionet e radios së tij. U thoshte se askush në Bruksel prej shokëve nuk po e përkrah emisionin tij.

Ja komunikata që Musa Hoti e lexoi me rastin e hapjes së emisionit në gjuhën shqipe:

"**Lajmërim**"

Të dashur bashkatdhetarë,
Të dashur vëllezër e motra në Bruksel,
Këto ditë u mbushën plot 6 vjet e 3 muaj nga mbrëmja e 11 marsit 1981, kur në konviktet e studenteve të Universitetit Kosova në mënyrë spontane shpërtheu revolta e përgjithshme e popullit shqiptar në jugosllavi e që u manifestua me dhjetëra demonstrata nëpër të gjitha qytet tona.
Kaluan më se 6 vite të kobshme për ne shqiptarët në Jugosllavi e në mërgim, meqë janë vrarë qindra shqiptarë, duke i përfshirë edhe ato raste kur natën vrasin e ditën vajtojnë, me mijëra të tjerë janë arrestuar dhe po arrestohen vazhdimisht duke u dënuar me dënime që nuk kanë precedencë në shekullin e XX.
Kjo dhunë, kjo mungesë logjike, ky tërbim i shfrenuar i shovinizmit serbomadh bëhej në zbatim të politikës së tyre shfarosëse ndaj shqiptarëve. Kjo politikë ndërgjegjësoi dhe ngriti masat studentore, duke filluar me reagime vetëmbrojtëse dhe kaluar në një urugan masiv kundër shovinizmit serbomadh.
Në kuadrin e kësaj këmbënguljeje në të drejtat tona, me rastin e 6 vjetorit të demonstratave të mëdha të pranverës 1981, redaksia e Radios "Zëri i Kosovës" në Bruksel fillon një program të rregullt, në

fillim vetëm me një orë në javë, kurse qe nga muaji korrik, para dëgjuesve shqiptarë do të dalim me, së paku,t me dy orë program në javë.
Radio “Zëri i Kosovës” ka për qëllim t’i tregojë kryeqendrës së Europës, por edhe më gjërë mes radiove tjera, se dymilion e gjysmë shqiptarë në Jugosllavi meritojnë të quhen komb dhe të kenë elementin e tyre të shtetësisë, që është Republika e Kosovës, element që e kanë popujt tjerë në Jugosllavi e që në numër janë shumë më të paktë se ne.
Etiketimet e ulëta, që shovinizmit serbomadh ia vë luftës sonë, nuk kanë kurrfarë bazash. Ne nuk kërkojmë të izolohemi nga bota; përkundrazi Republika e Kosovës do ta afronte popullin shqiptar me të gjithë popujt e Jugosllavisë e të botës.
Lëvizja jonë nacionale për të drejta demokratike është një lëvizje progresive, ngase ajo i lufton forcat e errësirës që nxisin urrejtjen kombëtare e që shtypin kombe dhe u hap perspektiva forcave përparimtare. Pa zgjidhjen e drejt të çështjes kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi, ashtu siç është zgjidhur për popujt tjerë të Federatës, as që mund të bëhet fjalë për qetësimin e popullit tonë liridashës.
Prandaj, bashkatdhetarë të dashur, sado që të ngrihet zëri ynë, sado që të forcohet radio e juaj “Zëri i Kosovës”, sado që të bëjmë që bota të dëgjojë për ne, kësaj radhe kjo barrë, më së shumti, do të bie mbi supet tuaj. Ne shpresojmë me optimizëm se do ta jepni me sukses këtë provim nderi.
T’i tregojmë Belgjikës demokratike se ne shqiptarët kemi ardhur këtu emigrantë e refugjatë, se nuk kemi ardhur nga dëshira për një klimë më të mirë apo për një copë më të madhe mishi, por nga dhuna e egër serbomadhe e mbështetur nga shovinistët rus, nga ata shovinistë që kanë qëllime të errëta edhe ndaj Belgjikës, na kanë detyruar të largohemi nga tokat e të parëve tanë. Shekulli XX po i mbush vitet. Hapësira e indiferencës po zhduket si asnjëherë më parë. Europa plakë, e ndeshur përsëri më problemin e çështjes shqiptare do të duhej të rrotullojë krahun, por për t’u arritur kjo, nga ne kërkohet të punojmë pa u ndalur, as ditën e as natën.

Bashkatdhetarë të dashur, edhe ne si pjesë përbërëse e popullit tonë, lexojmë, shikojmë, përgjojmë e dëgjojmë çdo gjë që sillet rreth nesh dhe që ka të bëjë me ne, e në fund duke i krahasuar të gjitha, e zgjedhim vetëm atë rrugë, e cila është në interesin tonë e të popullit në përgjithësi.
Radio "Zëri i Kosovës" nuk e ka për qëllim të bëjë politikë, nuk ka as komitete, as udhëheqësi, as nuk do të jetë e moderuar dhe as radikale, por sa më realiste e objektive.
Përpos disave që merren me problemet teknike në radio, çdo gjë tjetër është në duar të bashkëpunëtorëve. E këta janë të gjithë mërgimtarë, që kontribuojnë me ndihma morale e materiale duke e mbajtur në funksionim edhe Radion "Zëri i Kosovës", ashtu si edhe periodikët tjerë në mërgim.
Ky do të jetë zëri i mërgimtarëve, pjesë e zërit të popullit të Kosovës, zërit të çdo humanisti, jo vetëm shqiptar, që, më vetëdije të kristalizuar, din të thërrasë LIRI, DREJTËSI, BARAZI, VËLLAZËRI, HUMANIZËM! Dhe jo në mënyrë deklarative, por më fjalën e shkruar, me art, me kulturë, me shije e vlera artistike.
Bota shpirtërore e mërgimtarit është botë e pasur, e frymëzuar nga vuajtjet, nga peripecitë, nga malli për atdhe. Secili ka çka të thotë e të shprehë në një formë origjinale botën e vet dhe atë që e rrethon. Veçmas të shkolluarit. E të tillë ka shumë.
Më angazhimin modest të mërgatës sonë në Bruksel, nëpërmjet valëve të Radios "Zëri i Kosovës" do të kishim mundësi të përgatisnim orë letrare, recitale, formimin e një shoqërie kulturore-artistike, pjesë dramatike, tribuna për çështje të ndryshme drejt ngritjes së vetëdijes kombëtare, arsimimit, perfeksionimit të shijes artistike etj. Kjo kishte me qenë detyra parësore e Radios "Zëri i Kosovës".
Siç po e shihni dhe e lexoni në shtypin e vendit dhe të huaj nga rrjedhat e ngjarjeve në Kosovë, turri i çubrilloviqëve, qosiqëve, karagjorgjeviçve e zhargojve tjerë të Beogradit nuk ka të ndalur, sepse në vetë LKJ-në janë infiltruar njerëz me pikëpamje e tendenca çetnike. Edhe internacionalistët e vërtetë në Jugosllavi janë në hall prej tyre. Prandaj detyra kryesore e mërgimtarëve tanë është

që, pa ngurrim, të punohet në lëmin e kulturës e të letërsisë, se vetëm në këtë mënyrë mund t'ia çierrim maskën bandës antishqiptare e antihumaniste të Beogradit.
Të gjitha këto ne mund t'i shprehim lirisht në radion tonë "Zëri i Kosovës", përmes fjalës së shkruar, publicistike, letrare, poetike, artistike, kulturore e shoqërore. Jemi të vetëdijshëm se nuk kemi aftësi të mëdha, por kemi një përparësi, lirinë e fjalës, të mendimit, të shprehjes e të shkrimit, çka mungon në Kosovë.
Si pjesë e pandarë e popullit tonë, ne jemi forcat më progresive në Kosovë e Jugosllavi,e kundër çdo nacionalizmi, çdo seperatizmi e çdo irredentizmi. Ne nuk pretendojmë, siç u tha më lart, të bëjmë politikë, sadoqë politika është imanencë e jetës njerëzore, e veprimtarisë kulturore e letrare. Në përputhje më këtë ne përkrahim kërkesën e drejta të popullit për Kosovën Republikë, duke e konsideruar si imperativ të domosdoshëm.
Me shpalljen e Kosovës Republikë, Jugosllavia do të forcohet dhe do të dëshmohet fuqia e saj. Dëshirojmë që radio "Zëri i Kosovës" të jetë lajmëtari i paqes dhe i lirisë, jo lajmëtar i furtunës, e cila hove –hove po përplaset mbi kokën dhe kurrizin e shqiptarëve në Jugosllavi e që mund të përplaset edhe në brigjet e siujdhesës ballkanike.
Tani për tani, Radio "Zëri i Kosovës" emetohet çdo të marte prej orës 16.00 deri në ora 17.00, në valët FM-106,7 Megaherz
Shtypin, punimet materiale të ndryshme mund t'i dërgoni në këtë adresë:

Radio Midi 1/
**Centre International Rogier/**
**13 Place Rogier Et 4. Nte 42**
**1210 Bruxelles**

**Redaksia e Radios "Zëri i Kosovës"**

L A J M Ë R I M

Të dashur bashkatdhetarë,
Të dashur vëllezër e motra në Bruksel,

Këto ditë u mbushën plot 6 vite e 6 muaj nga mbrëmja e 11 Marsit 1981, kur në mensën e Univerzitetit KOSOVA, në mënyrë spontane shpërtheu revolta e përgjithshme e popullit shqiptarë në Jugosllavi e që u manifestua me dhjetra demonstrata nëpër të gjitha qytetet tona.

Kaluan më se 6 vite të kobshme për ne shqiptarët në Jugosllavi e në mërgim, meq janë vrarë qindra shqiptarë, duke i përfshirë edhe ato raste kur natën na vrasin e ditën na qajnë, me mijra tjerë janë arrestuar dhe po arrestohen vazhdimisht duke u dënuar me denime që nuk kanë presedan në shekullin e XX-të. Kjo dhunë, kjo mungesë logjike, ky tërbim i shfrenuar i shovenizmit serbomadh, po bënë që si kundërpërgjigje në këtë tentim shfarosjeje, në reagimin vetëmprojtës të ngrihet i gjithë populli ynë, i cili së shpejti dhe njëherë e përgjithmonë shovenizmit serbomadh do t'i thot STOP!

Në kuadrin e kësaj këmbënguljeje në të drejtat tona, me rastin e gjashtëvjetorit të demonstratave të mëdha të Pranverës '81, Redaksia e Radios ZËRI I KOSOVËS në Bruksel fillon një program të rregulltë, në fillim vetëm me një orë në javë, kurse që nga muaji korrik, para dëgjuesve shqiptarë do të dalim me së pakut dy orë program në javë.

Radioja ZËRI I KOSOVËS ka për qëllim t'i tregoi kryeqendrës së Evropës, por edhe më gjerë mes radiove tjera, se dy milion e gjysëm shqiptarë në Jugosllavi meritojnë të quhen komb dhe të kenë elementin e tyre të shtetësisë, që është Republika e Kosovës, element që e kanë popujt tjerë në Jugosllavi e që në numër janë shumë më të paktë se ne.

61-4

Etiketimet e ulta që shovenizmi serbomadh ia venë luftës sonë nuk kanë kurfar bazash. Ne nuk kërkojmë të izolohemi nga bota, përkundrazi, Republika e Kosovës e afron popullin shqiptarë me të gjithë popujt e Jugosllavisë e të botës.

Lëvizja jonë nacionale për të drejta demokratike është një lëvizje progresive, nga se ajo i lufton forcat e errësirës që nxisin urrejtjen kombëtare e që shtypin kombe dhe u hapë perspektivë forcave përparimtare. Pa zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi, ashtu siç është zgjidhur për popujt tjerë të Federatës, as që mund të bëhet fjalë për qetësimin e popullit tonë liridashës

Prandaj, bashkatdhetarë të dashur, sa do të ngritet zëri ynë, sa do të forcohet radioja e juaj ZËRI I KOSOVËS, sa do të bëjmë që bota do të dëgjojë për ne, kësaj rradhe kjo barrë më së shumti do të bie mbi supet tuaja, dhe ne shpresojmë me optimizëm se ju do ta jepni me sukses këtë provim nderi.

T'i tregojmë Belgjikës demokratike se ne shqiptarët që kemi ardhur këtu emigrant e rrefugjatë, nuk kemi ardhur nga dëshira për një klimë më të mirë apo për një copë më të madhe mishi, por dhuna e egër serbomadhe e mbështetur nga shovenistët rus, nga ata shovenist që kanë qëllime të errëta edhe ndaj Belgjikës, na kanë detyruar të largohemi nga tokat tona e të parëve tanë. Shekulli i XX-të po i mbush vitet. Hapsira e indiferencës po zhduket si asnjëherë më parë. Evropa plakë, e ndeshur përsëri me problemin e çështjes shqiptare do të duhet të rrotulloj krahun, por për t'u arritur kjo, nga ne kërkohet të punojmë pa u ndalur as ditën e as natën.

Bashkatdhetarë të dashur, edhe ne pjesë përbërse e popullit tonë, lexojmë, shikojmë, përgjojmë e dëgjojmë çdo gjë që sillet rreth nesh dhe që ka të bëjë me ne, e në fund, duke i krahasuar të gjitha, e zgjedhim vetëm atë rrugë e cila është në interesin tonë e të popullit në përgjithësi.

Radio ZËRI I KOSOVËS nuk ka për qëllim të bëjë politikë, nuk ka as komitete as udhëheqësi, as nuk do të jetë e moderuar as radikale por sa më realiste e objektive.

2 2

***Kopje nga origjinali i lajmërimit për hapjen e radios “Zëri i Kosovës” nga Musa Hoti f 1,2***

Përpos disa individëve që e kryejnë punën teknike në radio, çdo gjë tjetër është në duartë e bashkëpunëtorëve, në sygjerimet e juaja, e këta janë të gjithë mërgimtarët pa përjashtim, të cilët ftohen që me anë shkrimesh, me dërgim të shtypit të përditshëm e periodik nga Kosova, nga RPS e Shqipërisë dhe nga Jugosllavia, me anë të ndihmave morale e materiale ta ndihmoni mbajtjen e rregulltë të radios ZËRI I KOSOVËS.

Ky do të jetë zëri i mërgimtarëve, pjesë e zërit të popullit të Kosovës, zërit të çdo humanisti - jo vetëm shqiptar!- që me vetëdije të kristalizuar di të thrasë: LIRI, DREJTËSI, BARAZI, VËLLAZËRI, NJERZISHMËRI etj. dhe jo në mënyrë deklarative por me fjalën e shkruar, me art e kulturë, me shije e me vlera artistike.

Bota shpirtërore e mërgimtarit është botë e pasur, e frymëzuar nga vuajtjet, nga peripecitë, nga malli për atdhe. Secili ka çka të thotë e të shprehë në formë origjinale botën e vet dhe atë që e rrethon. Veçmas të shkolluarit, e të tillë ka shumë.

Me angazhimin modest të mërgatës sonë në Bruksel, nëpërmjet të valëve të radio ZËRI I KOSOVËS do të kishim mundësi të pregatisnim orë letrare, recitale, formimin e një shoqërie kulturore-artistike, pjesë dramatike, tribuna për çështje të ndryshme drejtë ngritjes së vetëdijes kombëtare, arsimimit, perfeksionimit të shijes artistike e tjerë. Kjo kishte me qenë detyra primare e radios ZËRI I KOSOVËS.

Siç po i shifni rrjedhat e ngjarjeve në Kosovë, mes shtypit të vendit dhe ati të huaj, turri i Çubrilloviqve, Qosiqve, Karagjorgjeviqve e zhargojve tjerë të Beogradit nuk ka të ndalur, sepse në vet Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë janë infiltruar njerëz me pikëparje e tendenca çetnike. Edhe vet internacionalistët e vërtetë në Jugosllavi janë në hall prej tyre, prandaj detyra kryesore e mërgimtarëve tanë është që pa ngurrim të punohet sa më shumë në laminë e kulturës e të letërsisë, se vetëm në këtë mënyrë mund t'ia çjerrim maskën bandës antishqiptare e antihumaniste të Beogradit.

Të gjitha këto ne mund t'i shprehim lirisht në radion tonë ZËRI I KOSOVËS përmes fjalës së shkruar publicistike,

3

letrare, poetike, artistike, kulturore e shoqërore. Jemi të vetëdijshëm se nuk kemi aftësi të mëdha, por e kemi një përparësi; lirin e fjalës, të mendimit, të shprehjes e të shkrimit, e cila mungon në Kosovë.

Si pjesë e pandarë e popullit tonë, ne jemi me forcat më progresive në Kosovë e Jugosllavi dhe kundër çdo nacionalizmi, çdo shovenizmi, çdo separatizmi e çdo irredentizmi.
Ne nuk pretendojmë, si tham më lartë, të bëjmë politikë,sado politika është imanencë e jetës njerzore, e veprimtarisë kulturore e letrare. Në përputhje me këtë ne përkrahim kërkesën e drejtë të popullit për KOSOVËN REPUBLIKË dhe atë e konsiderojmë si imperativ të domosdoshëm.

Me shpalljen e KOSOVËS REPUBLIKË, Jugosllavia do të forcohet dhe do të dëshmohet fuqia e saj.

Dëshirojmë që radio ZËRI I KOSOVËS të jetë lajmëtari i paqës dhe i lirisë e jo lajmëtar i furtunës, e cila hove-hove po përplaset mbi kokën dhe kurrizin e shqiptarëve në Jugosllavi e që mund të përplaset edhe në brigjet e Siujdhesës Ballkanike.

Tani për tani, radio ZËRI I KOSOVËS emitohet çdo të martë prej orës 16 deri në ora 17 në valët FM - 106,7. MEGARC.

Shtypin, punimet dhe materialet e ndryshme mund t'i dërgoni në këtë adresë:

RADIO ~~ZËRI I KOSOVËS~~ MIDI-1
CENTRE INTERNATIONAL ROGIER
13,Place Rogier - Et.4 Bte.42
1210 Bruxelles - Belgique

Ndihmat materiale mund t'i dërgoni në të njejtën adresë në xhiro-llogarinë rrjedhëse:

310-0701919-16

REDAKSIA E RADIOS "ZËRI I KOSOVËS"

4

***Kopje nga origjinali i lajmërimit për hapjen e radios Zëri i Kosovës nga Musa Hoti f 3,4***

Musa Hoti emisionin e mbante rregullisht dhe e fillonte sipas orarit të caktuar. Gjithnjë ishte i përgatitur, nuk i ndodhte asnjëherë të shkonte vetëm sa për ta kryer obligimin moral që ia kishte dhënë vetës, por për t'i njohur bashkatdhetarë më lajmet më të fundit që vinin nga Kosova.
Nëse e analizojmë rëndësinë e një emisioni të radios për diasporë duhet të kemi informata të asaj periudhe kohore. Shikuar sipas kësaj na del se asokohe nuk ekzistonte telefoni celular, nuk ekzistonte interneti, nuk kishte gazeta të përditshme shqiptare, nuk kishte kanale televizive siç janë sot që bashkatdhetarët tanë i përcjellin kudo që gjenden dhe në të njëjtën kohë që transmetohen. Pra ishte errësirë informative rreth situatës në Kosovë. Informata të vetme ishin telefonatat personale me të afërmit, të cilët ishin të kufizuar, sepse përgjoheshin; ishin emisionet e Radio-Tiranës që emitoheshin në orën dy të mëngjesit; por ishte edhe shtypi i Beogradit që i deformonte ngjarjet në Kosovë.
Sot ne mund ta marrim gjë normale dhe të parëndësishme hapjen e një radio në mërgim, por për ato kohë kish rëndësi të madhe kombëtare. Nuk duhet harruar se Musa nuk financohej nga askush. Vetë duhej gjetur muzikën që ia dërgonte ambasada e Tiranës nga Parisi; vetë duhej dëgjuar lajmet e orës dy të mëngjesit të Radio-Tiranës; vetë duhej lexuar shtypi i Beogradit për të nxjerrë ato pak informacione që jepeshin.
Ja si e fillonte emisionin e tij Musa Hoti, i cili vetë i lexonte lajmet dhe e udhëhiqte emisionin.

## “Ju flet Radio  Midi, emisoni “Zëri i Kosovës”!

Dëgjues të dashur, emisioni Radios “Zëri i Kosovës” emetohet çdo të marte prej orës 16h00 deri në roa 17.00, në valët 106.8Mega herz.
Nëpërmjet valëve të radios “Zëri i Kosovës” do të njiheni me lajme dhe risi nga trojet tona shekullore, me informata e aktualitete, me gjendjen aktuale sociale, historike e kulturore.
Radio “Zëri i Kosovës” ju ofron edhe muzikë popullore e folklorike nga të gjitha viset shqiptare. “
Musa Hoti kështu e fillonte çdo emision të tij dhe e përfundonte në këtë mënyrë:
“Dëgjuat “Radio Midi”, emisionin “Zëri i Kosovës”. Dëgjues të dashur! Ju mund të na shkruani në këtë adresë: Radio Midi 1 / Centre International Rogier/ kati 4 B.P. 42 Bruxelles Kurse gjatë emisionit ju mund të na telefoni në këtë numër të telefonit 219 19 06
Mirupafshim dhe mirë u dëgjofshim në emisionet e ardhshme në të njëjtën kohë dhe në të njëjtat valë.

Ja letra që Musa e mbante para tij gjatë transmetimit direkt. Transmetimet gjithnjë ishin direkt nga studio e radios.



~~DIMANCH~~ SAMEDI ~~12–14h~~ 10–12h

JU FLET RADIO ~~ZËRI I KOSOVËS~~ MIDI-1 & JU FLET RADIO ~~ZËRI I KOSOVËS~~ MIDI-1

EMISIONI „ZËRI I KOSOVËS"

DËGJUES TË DASHUR, RADIO ZËRI I KOSOVËS EMITOHET ÇDO

TË MARTË PREJ ORËS 16 DERI NË ORA 17, NË VALET FM-106,8 MEGAHERC

NËPËRMJET TË VALËVE TË RADIOS ZËRI I KOSOVËS DO TË NJOFTOHENI

ME LAJME E RISI NGA TROJET TONA SHEKULLORE, ME INFORMATA E AKTUALITETE, ME GJENDJEN AKTUALE SOCIALE, HISTORIKE e KULTURALE.

RADIO ZËRI I KOSOVËS JU OFRON EDHE MUZIKË POPULLORE E FOLKLORIKE NGA TË GJITHA VISET SHQIPTARE.

RADIO ZËRI I KOS. BOITE POSTALE 16 1120 BRUXELLES

ADRESA E RADIOS ZËRI I KOSOVËS ËSHTË:

~~RADIO ZËRI I KOSOVËS~~
~~B.P. 16~~
~~1120 BRUXELLES~~

EMISIONI PËR SHQIPTARET „ZËRI I KOSOVËS"
QENDRA INTERNACIONALE ROZHE
KATI I KATËRTË! KUTIJA POSTALE 42
1210 BRUKSEL
TELEFONI: 219-19-06

GJIRO-LLOGARIA E RADIOS ËSHTË: RADIO ZËRI I KOSOVËS NË BRUKSEL
310-0701919-16

DËGJUAT RADION ~~ZËRI I KOSOVËS~~ MIDI-1. „ZËRI I KOSOVËS"

MIRUPAFSHIM DHE MIRË U DËGJOFSHIM TË MARTËN E ARDHSHME

NË TË NJEJTËN KOHË.

Mr JEAN-DAGONIE

731-40-25

RADIO MIDI 1
CENTRE INTERNATIONAL ROGIE
4-eme ETAGE, B.P. 42
1210 BRUXELLES
TEL. 219-19-06

*Letra që Musa e mbante para tij për hapje të emisionit*

Po t'i grumbullojmë të gjitha dokumentet që Musa i përgatiste dhe i transmetonte në emisionet e tij duhet një libër i veçantë. Në këtë botim unë kam përzgjedhur vetëm ndonjë artikull e më shumë jam përqendruar në cilësinë dhe rëndësinë e organizmit dhe të transmetimit të një emisioni të tillë. Të grumbullonte dhjetëra faqe informacione e në fund t'i redaktonte me forcat e veta, për Musa Hotin dhe për këdo tjetër ishte një mundim dhe sakrificë, pa përmendur se ora e transmetimit duhej paguar çdo muaj. Musa nuk merrte nga askush ndihma për punën që bënte. Kur bashkatdhetarët, respektivisht dëgjuesit, kërkonin këngë për ta përshëndetur lindjen e fëmijës së tyre apo për raste të tjera Musa, ua plotësonte dëshirat e lexuesve falas. Më vonë u hapën radio të tjera, por kërkesat për përshëndetje etj. Bëheshin vetëm me pagesë.
Të veçojmë njërin prej emisioneve të Musa Hoti, atë të 24 nëntorit 1987.
Këtë emision, si dhe emisionet tjera, Musa e hap si zakonisht duke dhënë pasqyrën e emisionit me titujt kryesorë, që dëgjuesit mund të ndiqnin gjatë asaj ore. Ndër titujt kryesorë ishte ai për Adem Demaçin. Ky artikull ka pesë faqe të cilat do t'i botojmë komplet; ndërsa vetëm faqen e parë po e kopjojmë sa për të faktuar atë që shkruhet për veprimtarinë e Musa Hotit.
Ja përmbajtja e emisionit të 24 nëntorit 1987, përgatitur nga Musa!



RADIO ZËRI I KOSOVËS
NË BRUKSEL
DATA 24 NENTOR 1987

DËGJUES TË DASHUR TË RADIOS
ZËRI I KOSOVËS, NË EMISIONIN E
SOTSHËM DO TË DËGJONI:

1. KONFERENCA BALLKANIKE DHE PROVOKACIONET ANTISHQIPTARE TË BEOGRADIT.
2. ME RASTIN E 51 VJETORIT TË LINDJES SË SIMBOLIT TË REZISTENCËS SHQIPTARE KUNDËR PUSHTUESVE SERBOMADHENJ - ADEM DEMAQIT.
3. ME RASTIN E 75-VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARSISË, DO TA DËGJONI ARTIKULLIN:
KËTU KU VALOI FLAMURI
SHKRUAR NGA
SHEFQET TIGANI DHE
VIZITA E ISMAIL QEMALIT NË VRANISHT TË VLORËS DHE DISA MENDIME RRETH SAJ.
4. SI DHE POEZITË: GJYSHJA LIZË DHE DHOMË REFUGJATI.

*Paralajmërimi i programit të datës 24 nentor 1987*

Dëgjues të dashur të Radios “Zëri i Kosovë”s, në emisionin e sotëm do të dëgjoni, përveç tjerash edhe:
1. Konferenca Ballkanike dhe provokacionet antishqiptare të Beogradit
2. Me rastin e 51-vjetorit të lindjes së simbolit të rezistencës shqiptare kundër pushtuesve serbomëdhenj, Adem Demaçit
3. Me rastin e 75-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, do të dëgjoni artikullin: “Këtu ku valoi flamuri” , shkruar nga Shefqet Tigani dhe
4. Vizita e Ismail Qemalit në Vranisht të Vlorës dhe disa mendime rreth saj
5. Në rubrikën e kulturës do dëgjoni poezitë: “Gjyshja Lizë”dhe “Dhomë refugjati”!

## *Një jetë të tërë për popull dhe atdhe*

Kur errësirë e madhe kishte kapluar Kosovën, Lëvizja heroike kaçake kishte ulë intensitetin, pasiqë shumica e prijësve të saj ishin vrarë në betejat e përgjakshme. Populli kosovar masakrohej nga gjëndarmët dhe ushtria e kralëve serbë; çubrilloviçët përgatisnin elaborate për zhdukjen e tërësishme të popullit shqiptar nga trojet e veta, robëruar prej shovinistëve serbomëdhenj në brigjet e lumit Llab, në fshatin e quajtur Lupq, në familjen e varfër të Zeqirit dhe Nazmie Demaçit në vitin 1936 lindi një djalë, të cilin e pagëzuan Adem.
Ademi ishte fëmija i tretë i prindërve Zeqir dhe Nazmije, që e filloi jetën në skamje e mjerim, ashtu si i vëllai, Maliqi, dhe motra Ajshe. I vëllai, pa i mbushur të njëzetat, vdiq nga tuberkulozi; kurse me motrën u rrit, ashtu siç rriteshin të gjithë fëmlijët e Llapit dhe të mbarë Kosovës hallemadhe. Ishin fëmijë, kur familja e tyre u shpërngulën në Prishtinë. I ati punonte si sharrëxhi i qytetit, e ëma vektare, kurse Ademi në ato kushte të rënda u dha pas shkollimit.
Shkollën fillore e filloi gjatë okupacionit gjerman në gjuhën shqipe dhe e vazhdoi pas Luftës së Dytë Botërore. Pasi kreu shkollën fillore u regjistrua në gjimnazin e rregullt në Prishtinë. Ishte nxënës i

Zekeria Rexhës, që e ndihmonte në çdo drejtim. Ademi shquhej në mësime.
Që gjimnazit, Ademi filloi të merrej me shkrime. Tlanti i tij u duk që në shkrimet e para; njëherë filluan të dalin në shesh pikëpamjet patriotike e revolucionare.
Terrori që zbatohej për të përzënë e shpërngulur popullsinë shqiptare nga trojet e veta ndikoi shumë në vetëdijen kombëtare të Ademit. Ai shkroi tregimin "Kthimi", ku, jo vetëm nuk pranonte idenë e largimit të shqiptarëve nga vatrat stërgjyshore, por shkroi për kthimin e atyre që kishin marrë udhët e botës me mëdyshje në ndërgjegjen e tyre: të largohen apo mos të largohen nga Kosova për t'i shpëtuar terrorit serbomadh, apo të qëndrojnë, duke u përballuar me atë jetë nën pranga e tmerre të sundimtarëve serbomëdhenj?! Protagonistët e tregimit "Kthimi" marrin rrugën e mërgimit me dilema e pasiguri të mëdha. Prandaj e ndajnë mendjen të kthejnë nga rruga e nisur me mendje të plotë t'u qëndrojnë me stoicizëm ngasjeve dhe veprimeve të djallëzuara e maltretimeve të forcave të errëta të rrëgjimit pushtues.
Ky tregim, ashtu si tërë proza e tij, nuk ishte vetëm krijimtari letraro-artistike, por ishte një thirrje që i bëhej popullit shqiptar që mos të largohej e mos t'ia kthejë shpinën vendlindjes; ishte protestë ndaj atyre që e detyronin popullin e shkrimtarit të syrgjynosej.
Ademi këto ide e pikëpamje i përcillte, jo vetëm përmes shkrimeve letrare, por edhe në biseda të lira e takime masive, duke i ndërgjegjësuar bashkëkombësit të mos linin atdheun dhe t'i përballonin persekutimet.
Sot në Turqi është gjë e zakonshme të takosh kosovarë, të cilët evokojnë kujtime për Ademin dhe tregojnë se si ai u ka folur për jetën në dhera të huaja.
E dëgjon Shaban Strajen duke thënë: "Mirë më pate thënë, o Adem Demaçi: rri në Prishtinën tënde dhe vdis këtu. Ky është dheu yt, dheu i huaj s'të tretë. Në dhe të huaj mund të bëhesh i pasur, por ajo pasuri nuk të sjell lumturi. Ajo pasuri mund të të bëjë që të të urrejnë edhe fëmijët tu. Njeriu pa atdhe e ideal e bën paranë e pasurinë gjithçka, për para e pasuri e shet edhe babain e vet. Ashtu

më tha Ademi, ashtu më doli. Bëra pasuri të madhe, më shkoi mirë tregtia, por kjo pasuri nuk po më gëzon. Sot më urrejnë fëmijët e mi, e urrejnë njëri-tjetrin për shkak të kësaj pasurie. Bile një nuse e djalit më ka akuzuar se, gjoja, kam tentue me dhunue, vetëm e vetëm të më kompromitojë, sepse ajo është turke; kurse rejat tjera i kam shqiptare e po iu duket se tjerëve po due me i lanë më shumë pasuri. Thash janë shqiptare, por çfarë shqiptare? Asnjë fjalë shqip nuk e dinë mbesat dhe nipërit e mi. Më pat thënë Adem Demaçi, e ashtu më ka dalë. Ai kish pas qenë i ditur e ne nuk e kemi ditur. Ai po kalbet në burgje të serbit e ne po marrohemi në dhe të huaj. Po, po Ademi po kalbet në burgje edhe për ne që nuk e dëgjuam, edhe për ata që e dëgjuan. Shyqyr që pati më shumë që e dëgjuan, sesa nga ata që nuk e dëgjuam”. Këso rrëfimesh dëgjon kudo në Turqi.

Kur shkruante Ademi për moslargimin e shqiptarëve nga vatrat e veta, ishte shumë i ri; ishte fëmijë, si i thonë fjalës. Terrori ndaj popullit shqiptar, presioni për t’u shpërngulur filloi menjëherë pas viteve 1948-1950. Kulmin arriti më 1955-1956.

Këto vite Ademin e gjetën në vlugun e punës dhe të luftës për popull dhe atdhe. Pasi kreu gjimnazin në Prishtinë, studimet i vazhdoi në Beograd, pasiqë në atë kohë nuk kishte fakultet në Kosovë. Punonte si gazetar në “Rilindje”. Shkruante vazhdimisht e mbi të gjitha propagandonte çështjen shqiptare dhe demaskonte krimet që zbatonin kriminelët e Rankoviçit ndaj popullit shqiptar.

Gjatë atyre viteve Ademit iu botuan 13 tregime dhe romani “Gjarpijt e gjakut”. Këto shkrime u botuan në revistën letrare “Jeta e re”, duke iu falenderuar redaktorit të atëhershëm që i vlerësonte lartë këto shkrime.

Duke i parë të gjitha metodat që i zbatonin rankoviçianët ndaj popullit tonë e njëra ndër to ishte edhe nxitja e vëllavrasjeve, Ademi u ngrit me parullën: “ Jo atyre që janë trima me e ngreh gishtin e krimit, por atyre që janë trima me shtri dorën e pajtimit”. Këto vargje Ademi i vuri në ballë të romanit të tij, që u bënë moto e shqiptarëve dhe përcilleshin dhe ende përcillen nga tërë populli shqiptar, njëlloj si vargjet e Vasko Pashës: “Mos shikoni kisha xhamia, feja e shqiptarit është shqiptaria”.

Ademi shkroi dhe demaskoi veprimet e armiqve  të popullit shqiptar, por ai diti të shkruante edhe për romët, ku shihet shpirti i tij humanist. Shkruan për Pizh magjupin dhe borinë e tij, duke e përshkuar fishkëllimën e kamxhikut mbi kurrizin e Pizh magjupit dhe talentin e tij prej muzikanti, të cilit i dëshiron që ai talent të vjen në shprehje, duke i dëshiruar që të shkollohej në ndonjë shkollë të muzikës, e jo të përfundojë dasmave të të dëshpruarëve pranë gotës së rakisë.

Veprimtaria e Ademit prej shkrimtari të talentuar dhe propagandisti patriot e revolucionar, që cili depërtoi në gjirin e popullit, duke sqaruar e përkrahur qëndresën e qytetarëve të Kosovës ndaj padrejtësive e shtypjes serbomadhe, nuk kaluan pa u diktuar nga UDB-ja e Rankoviçit.

Në vitin 1958, kur Ademi ishte vetëm 22 vjeç ia vunë prangat. Por ai tashmë kishte veprën e tij patriotike-revolucionare dhe një varg shkrimesh e sidomos romanin “Gjarpijt e gjakut” që ishte romani i parë shqiptar i shkruar në Kosovë.

Burgosja e Ademit bëri bujë të madhe,  mbi të gjitha qëndrimi heroik i tij para gjyqit. Ai nga i akuzuar u shndërrua në akuzues. Me pjekuri, mençuri e guxim demaskoi krimet që rankoviçët i bënin popullit të tij. Qëndrimi i tij burrëror i dha zemër popullit që të qëndrojë përpara terrorit serbomadh. Ndërkohë Adem Demaçi  ai u shndërrua në simbol mbrojtjeje dhe ideali të atij populli.

Ademi u dënua dhe i mbajti 3 vjet burg të rëndë. Lirimi i tij në vitin 1961, kur ai ishte ngritur në një ideolog me plotëkuptimin e fjalës, e gjeti Kosovën me ndryshime të mëdha. Kosova nuk kishte bërë ndonjë ndryshim në aspektin ekonomik. Por ata që kishin vepruar, ashtu siç kishte vepruar Ademi para se të burgosej, gjithnjë shtoheshin. Ata që kishin verpuar si ai, lirimin e tij e pritën më gëzim të madh dhe u tubuan rreth tij. Nuk kaloi shumë kohë dhe lindi organizata patriotike “Lëvizja Rrevolucionare e Bashkimit të Shqiptarëve ” LRBSH”, më vonë LNKÇVSHJ. Bashkë me Ademin në ndërtimin e kësaj organizate, organizuar në niveli kombëtar me një udhëheqje qëndrore, emërtuar Komiteti Rrevolucionar, me komitete qarkore dhe vendre në pjesën dërmuese  të viseve shqiptare

në Jugosllavi. U dallua Fazli Grajqevci, poeti që u mbyt nga UDB-ja gjatë hetimeve; Hilmi Rakovica mësues dhe udhëheqës i rinisë, i cili nga torturat e rënda dhe plagët e pashërueshme, vdiq menjëherë pas lirimit burgu; poeti Rexhep Elmazi, udhëheqës i Komitetit të Gjilanit, i cili u vra nga UDB-a, pas daljes nga burgu; Kadri Kusari profesor i gjuhës shqipe, udhëheqës i komitetit të Gjakovës , që vdiq pas lirimit nga burgu nga pasojat e plagëve; Murteza Nura, poet tani në burg i dënuar për herën e dytë me 9 vjet burg të rëndë

Kjo organizatë patriotike dhe revolucionare, e udhëhequr nga Adem Demaçi, zhvilloi aktivitet të dendur, duke i demaskuar veprimet e serbomëdhenjve, duke shpërndarë materiale propagandistike, duke ngritur flamuj (që asokohe ishte i ndaluar), duke shpërndarë literaturë patriotike etj. Këto veprime ndikuan në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, në forcimin e bindjes se vetëm të bashkuar dhe të organizuar është e mundur të luftohen veprimet antishqiptare të serbomëdhenjve.

Në qershor të vitit 1964 u bënë arrestime të mëdha, u burgos Ademi me rreth 500 aktivistë, 57 prej tyre u dënuan me burgime të rënda, nga 3-deri në 15 vjet; kurse të tjerët u dënuan në gjyqin për kundërvajtje, pasiqë u maltretuan dhe u torturuan. Ademi u dënua 15vjet burg të rëndë.

Edhe pse u bënë arrestime masive duke u burgosur një numër i madh udhëheqësish të Lëvizjes së bashku me Ademin, aktivitetet vazhduan pandërprerje, sidomos në vitet 1968/69, kur ndodhën ngjarjet e mëdha që e ngritën tërë popullin në këmbë, e tronditën tërë Jugosllavinë. Kështuqë për problemet e kërkesat e popullit shqiptar mësoi tërë bota.

Vepra e Ademit u përkrah. Ai fitoi besimin e popullit, duke u shndërruar në simbol të rezistencës së popullit shqiptar në Jugosllavi.

Pas ngjarjeve të vitit 1968 u përsërit gjykimi i patriotëve revolucionarë, që ishin dënuar në vitin 1964. Të gjithë të burgosurve iu zbritën dënimet, poashtu edhe Ademit iu zbritën, nga 15 në 10 vjet burg të rëndë, të cilin e mbajti dhe u lirua më 8 qershor 1974.

Gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Nishit u mbajt greva shumëditore e urisë, të cilës iu bashkuan Ademit dhe patriotëve tjerë shumë të burgosur.
Nën ndikimin e Ademit dhe të patriotëve të tjerë u bë traditë të organizohen greva dhe protesta të ndryshme nëpër burgjet jugosllave, ku kërkohej përmirësimi i kushteve të jetesës së të burgosurve, sidomos kthimi i tyre në burgjet e Kosovës.
Si rezultat i këtyre veprimeve dhe qëndrimeve heroike të patriotëve, organet e pushtetit qenë të detyruar të marrin vendim për ndërtimin e një burgu në Gjyrakovc. Kështu në Gjurakovc të Kosovës u kthyen, jo të burgosur politikë, por të dënuarit për vepra tjera.

ME RASTIN E 54 VJETORIT TË LINDJES SË SIMBOLIT TË REZISTENCËS SHQIPTARE KUNDËR PUSHTUESVE SERBOMDHENJË - ADEM DEMAQIT

## NJË JETË TË TËRË PËR POPULL DHE ATDHE

Kur errësirë e madhe e kishte mbuluar Kosovën,Lëvizja heroike Koqake kishte ulë intenzitetin pasi që ishin vrar në betejat e përgjakshme shumica e prijsave të Sajë,populli kosovarë masakrohej nga gjandarët dhe ushtria e kralve serb,qubrilloviqët pregaditnin elaborate për zhdukjen e tërsishme të popullit shqiptar nga trojet e veta të roberuara prej shovenistëve serbomdhenjë në brigjet e lumit Llab,në fshatin e quajtur Lupq, në familjën varfnjake të Zeqir dhe Nazmije Demaqit në vitin 1936 lindi një djalë të cilin e pagzuan Adem.

Ademi ishte fëmia i tretë i prindëve Zeqir dhe Nazmije, i cili filloi rritën në skamje e mjerim, ashtu si i vëllai Maliq dhe e motra Ajshe.I vëllai,pa i mbushur të njëzetat,vdiq nga tuberkulozi,kurse me motrën u rritën ashtu si rriteshin të gjithë fëmijtë e Llabit dhe të mbarë Kosovës hallemadhe,të cilët si fëmij së bashku me prindët u shpërngulën në Prishtinë,ku vazhduan jetën;i Ati si sharragjinjë i qytetit, e ëma si vekatare,kurse Ademi në ato kushte të rënda u dha pas shkollimit. Shkollën fillore e filloi gjatë okupacionit gjerman në gjuhën shqipe dhe e vazhdoi pas luftës së Dytë Botërore.Pasi e kreu shkollën fillore u regjistrua në gjimnazin e rregulltë në Prishtinë, i cili si nxënës i Profesor Zekeria Rexhës,që e ndihmonte në çdo drejtim, tregoi sukses të madh në mësime.

Si nxënës i gjimnazit filloi të mirret me shkrime.Që në shkrimet e para u pa talenti i Tij dhe filluan të dalin në shesh pikpamjet ideologjike,patriotike-revolucionare që i shprehte nëpërmes atyre shkrimeve,por edhe humaniteti dhe shpirti i Tij internacionalist.Terrori që zbatohej ndaj popullit shqiptar për t'a përzënë nga trojet e veta dhe për t'a shpërngulur sidomos për në shkretëtirat e Anadollit,bëri që Ademi t'e shkruan tregimin e mirënjohur "Kthimi",i cili edhe në ato situata tepër të rënda,nuk deshi të shkruaj vetëm për largim,por shkruajti për kthimin e atyre që kishin marrë rrugën e largimit dhe dyluftimet në ndërgjegjën e tyre;të largohen apo mos të largohen

18-5

*Faqja e parë "Një jetë për popull dhe atdhe" që, Musa e lexoi në radio Zeri i Kosovës, më 24 nëntor 1988*

Që opinioni i sotëm dhe ai i gjeneratave të ardhshme të ketë një pasqyrë lidhur me punën rreth transmetimit të emisionit që e mbante dhe përgatiste Musa Hoti , nga tërë dokumentacioni po veçoj njërin prej punimeve të tij të shumtë. Jo se ky dallohet prej punimeve të tjera, por për shkak se është i shkruar me dorë nga Musa Hoti.

**“Radio Zëri i Kosovës në Bruksel**
**15 mars 1988**

## Lexohet shtypi për Konferencën Ballkanike në Beograd

Fill pas përfundimit të konferencës Ballkanike në Fushë Kosovë, filloi punimet i ashtuquajturi tubim i komunistëve Fushë Kosovë, në të cilin morën pjesë disa koka çetnike të udhëheqësisë së Serbisë, të KQ të LKJ të Serbisë të Kryesisë së Serbisë dhe të Kryesisë së qytetit të Beogradit.
Edhe kësaj here, para shtëpisë së kulturës, ku u mbajt tubimi, u grumbullua një numër i madh i serbo-malazezëve nga Kosova e Serbia. Por ata që nuk ishin anëtarë të LKJ nuk u lejuan të hynin në sallë.
Tubimin e hapi çetniku Martinoviq, duke rrejtë se serbët dhe malazezët po shpërnguleshin nga Fushë Kosova dhe në vendin e tyre po vinin shqiptarë nga Maqedonia e Bujanovci.
Konkluzionet e Plenumit të 9-të serb nuk po realizoheshin siç ishte vendosur në Beograd, prandaj Martinoviqi tha se ardhja e njësive speciale nga Beogradi ishte me vend.
Vendimi se brenda një kohe të shkurtër do të ndërtoheshin 2500 ndërtesa për serbo-malazezët që do të vinin në Fushë Kosovë krerëve serbomëdhenj iu duk i pamjaftueshëm, pasi shin parashikuar e marrë masat që të instaloheshin 50.mijë serbë, që do të vinin nga Nishi, Kraleva, Kragujevaci e Qaqaku. Prandaj kërkohej ndërtimi i dyfishit të banesave të parashikuara.

Sipas Martinoviqit, udhëheqësit e Prishtinës dhe të Kosovës duhet të zgjidheshin nga masat e gjëra të Fushë Kosovës, jo nga Beogradi ose nga tërë Kosova, pasi këta të fundit në udhëheqësi po sjellin irredentistë.
Në tubimet republikane e federative duhet të ketë delegatë nga Fushë Kosova dhe serbo-malazezët që jetojnë në Kosovë. Me fjalë të tjera serbët e Fushë Kosovës po kërkonin autonomi të posaçme për Fushë Kosovën.
Po ky çetnik deklaroi se: " Edhe pas ndërrimit të Kushtetutës së Serbisë në lidhje me Krahinën e Kosovës rezultatet nuk janë të kënaqshme; se e pandryshuar ka mbetur jurisprudenca, barazia e gjuhëve, flamuri shqiptar si dhe emri Kosovë që duhet të quhet Kosovë e Metohi (Kosmet), prandaj shumë punë duheshin ndryshuar". Samargjiçi në diskutimin e vet i përkrahu të vetëquajturit liderë serb nga ky lokalitet i Prishtinës.
.......................................
Bojkoviçi kërkoi ndryshimin e datave të disa, të parapara me kalendarin e Institutit të Historisë së Kosovës...
Kur Gjura e mori fjalën filloi t'i numërojë të gjithë serbo-malazezët e vrarë nga shqiptarët. I numëroi dhunimet e rrejshme dhe shkoi deri të rasti i i Gjorgje Martinoviqit dhe punës së tij me shishe, me ç'rast një i ri shqiptar paska thënë se shishet e zbrazta nuk po i hedhin në mbeturina, por po i ruajnë për Martinoviqët e Beogradit.

Milica Bojaniçi qante me lot duke thënë se në Kosovë janë 700 fshatra etnikisht serbe. Kjo shkinë e kritikoi edhe Institutin e Historisë së Kosovës.
..............................................................................
Drago Samargjiçi tha: Kosova është djep i Serbisë e këtë djep nuk do ta braktisim pa marrë parasysh se a mbesim 7% apo 1% e popullsisë.

**Lubjanë**
Gazeta e rinisë sllovene "Mladina" që nga viti 1980 e këtej në çdo numër të saj boton artikuj në të cilët në mënyrë të drejtë e të sinqertë

kritikohen të gjitha dukurit negative në shoqërinë jugosllave, sidomos megalomaninë serbomadhe për shndërrimin e tërë Jugosllavisë në një Serbi të madhe të dirigjuar nga e ashtuquajtura armatë popullore jugosllave.

Rinia sllovene kërkoi barazinë e gjuhëve në armatë, përndryshe, citon gazeta “Mladina” : Sekretari Federativ i Mbrojtjes lë të shkojë në shtëpi që ta ruajë bagëtinë, ngase është armatë pa kontroll të organizuar shoqëror; është armatë konservatore, e cila dirigjohet vetëm nga elementët minues serbë e malazezë; është produkt unitarist; është shtet paralel që e dirigjon jetën shoqërore jugosllave, siç bëri në Kosovë në vitin 1981, kur krerët e Beogradit dërguan në Kosovë ¼ e forcave të armatosura për ta shndërruar Kosovën në atë që e shndërruan; se armata e vetëquajtur popullore me armë mbështet dhe siguron kriminelët që t’i ruajnë pozitat e tyre në kreun e degjeneruar serb e jugosllav.

Kazermat ushtarake në Jugosllavi janë e shërbejnë vetëm për kontroll të rinisë, ku pa mëshirë burgosin ushtarë, gjykojnë pa pikë faji, torturojnë ushtarë dhe nesër po këta gjeneralë të APJ-së do të pushkatojnë e do të varin ushtarë, si vepruan me Aziz Kelmendin e me shumë Haziza tjerë nga Kosova dhe viset shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi. “

Sikur këto realitete t’i shkruante “Rilindja” ose “Bota e re “ e Kosovës, jemi të bindur se në veprim do të hynin tanket e avionët luftarakë kundër vendit tonë – Kosovës; sikur këto fjali të dilnin nga goja e rinisë kosovare..?! Çdo të bëhej me ta?!

Gazetës “Mladina” me shkrime të njëjta po i bashkangjiten edhe të tjera gazeta, si “Katedra”, “Tribuna” “Teleksi” , Nova revija”.

Për problemet e armatës, për çështjet e shqiptarëve në Jugosllavi, për Konferencën Ballkanike dhe për shumë çështje tjera që në Jugosllavi quhen tema të nxehta, sot fillojnë bisedimet jugosllavo-sovjetike në Beograd, mes kryetarit të kryesisë jugosllave Mojsov dhe Gorbaçovit.


10

KAZERMAT USHTARAKE NË JUGOSLLAVI JANË
E SHËRBEJNË VETËM PËR KONTROLL TË RINISË,
KU PA MËSHIRË BURGOSIN USHTAR, GJYKOJNË PA
PIKË FAJI, TORTUROJNË USHTAR DHE NESËR POKËTA
GJENERAL TË APJ DO TË PUSHKATOJNË E DO
TË VARIN USHTAR, SIKUR QË VEPRUAN ME
AZIZ KELMENDIN E ME SHUMË AZIZA TJERË
NGA KOSOVA DHE NGA VISET SHQIPTARE NË
MAQEDONI E MAL TË ZI.

PO SIKUR KËTO REALITETE T'I SHKRUANT
RILINDJA OSE BOTA E RE E KOSOVËS, JEMI TË
BINDUR SE NË VEPRIM DO TË HYNIN TANKSAT E
AVIONËT LUFTARAK KUNDËR VENDIT TONË - KOSOVËS.

PO SIKUR KËTO FJALI T'I FLASIN
RINIA E KOSOVËS, A THUA - ÇDO TË BËHEJ ME TA?
GAZETËS MLLADINA ME SHKRIME TË NJËJTA PO I
BASHKANGJITET EDHE GAZETA KATEDRA, TRIBUNA,
TELEKSI, NOVA REVIJA ETJERË.

PËR PROBLEMET E ARMATËS, PËR
QËSHTJET E SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI, PËR
KONFERENCËN BALLKANIKE DHE PËR SHUMË
QËSHTJE TJERA QË NË JUGOSLLAVI QUHEN
TEMA TË NXEHTA, SOT FILLOJNË BISEDIMET
JUGOSLLAVO- SOVJETIKE NË BEOGRAD, MES
KRYETARIT TË KRYESISË JUGOSLLAVE MOJSOV
DHE GORBAQOVIT.

***Kopje nga origjinali i punimit të Musa Hotit, që përgatiste emisionet e radios.***

Në arkivin tim personal dhe në atë të familjes së Musa Hotit ruhet një grumbull i madh dokumentesh me vlerë për aktivitetet e asaj kohe.
Për punën e Musës në emisionin në gjuhën shqipe nuk do të zgjerohem pavarësisht se ato janë punime autoriale të Musës, pasi nuk dua të lodh lexuesin me shkrime të stërzgjatura ngase nuk është në natyrën time të kaloj në monotoni.
Nga thashethemet e shumta kundër emisionit të tij, Musa Hoti demoralizohej dhe një ditë do ta përfundonte së emituar emisionin e tij.
Pavarësisht intrigave që thureshin për këtë emision, unë disa herë kam shkuar si mysafir edhe t'i ndihmoja, të lexoja materiale të ndryshme që Musa kishte përgatitur për lajme. Disa nga ato emisione ende i ruaj në arkivin tim ku dëgjohet zëri i Misa Hotit.
Kam mendimin se Musa Hoti është rast unik në diasporën shqiptare. Punonte e nuk mburrej. E shanin e nuk shante. E xhelozonin e nuk xhelozonte. E përseri nuk ndalej, nuk demoralizohej. Ai ndoshta ishte i demrolizuar, por këtë nuk e shprehte në shoqëri.
Më duket se është i vetmi që kurrë nuk vraponte të bënte fotografi me personalitete që vinin nga Kosova apo me liderët e Lëvizjes me të cilët kishte kontakte. Musa kurrë nuk ekspozohej, ndaj tani kur po shkruaj për aktivitetet e tij nuk kemi fotografi as me Sabri Novosellen dhe me askë tjetër. Të tjerët vraponin të merrnin poza me Ibrahim Rugovën e, madje, grindeshin mes tyre se cili i pari do merrte një foto. Sot, të tillët mund të dokumentojnë se u takuan me Rugovën, Qosjën, Demaçin e të tjerë. Ata mund të mburrën me fotografi të tyre, por kur të shikohen thirrjet, dokumentet se kush i kishte ftuar liderët të vinin në Bruksel, ata mbesin me foto në dorë. E dokumentet ekzistojnë. Shikuar më realisht të gjithë neve, që kemi qenë të organizuar në Lëvizje (kush më shumë e kush më pak), na ka mbetur shprehi qe mos të kërkojmë të dalim me dikë në fotografi. Ne mendonim se nëse dikush fotografohet me ne, kur të shkonte në Kosovë do të kishte probleme me policinë. Kjo ishte arsyeja dhe kjo na mbeti ende edhe sot.

Nga zhgënjimi dhe nga shtrëngimi financiar, Musa detyrohet të mbyllë emisionin e tij.
Je leximi i tij i fundit për këtë emision:

**KUMTESË**

Dëgjues të dashur të Radio Zëri i Kosovës!
Me keqardhje të madhe, ju lajmërojmë se emisioni i Radios “Zëri i Kosovës” tani për tani ndërpritet për një kohë të pacaktuar.
Ju, dëgjues të dashur, duhet të informoheni të parët për këtë vendim arbitrar të qarqeve armike, se këtë radio nuk po e mbyllin miqtë, por armiqtë tanë nga Beogradi e nga Belgjika.
Serbomëdhenjtë nuk lanë gurë pa rrotulluar, nuk lanë vrimë pa i futur hundët, nuk lanë konferencë, plenum e kongres të niveleve më të larta shtetërore Jugosllave pa e parashtruar temën e nxehtë e aktuale që të ndalohet zëri i shqiptarëve patriotë kudo, që të mos thuhet realiteti ynë i hidhur në një komunitet me më se 20 mijë shqiptarë, siç është Brukseli; por me çdo kusht të dominojë propaganda armike e Beogradit; të dominojnë: gënjeshtra, shpifjet dhe trillimet e gatuara në kuzhinat helmuese të Beogradit.
Serbomëdhenjtë e kreut çetnik të LKj-së e të Serbisë, duke parë vendosmërinë e patriotëve shqiptarë për aktivitete pacifiste kluturore , në mënyra direket e indirekte ndikuan në shumë drejtime kompetente e jo kompetente, që sa më parë të mbyllej kjo radio dhe ky emision revolucionar, e që në vend të tij, të vendoset një emision jugosllav i dirigjuar nga UDB-ja dhe nga ambasada e Jugosllave në Bruksel, si dhe të shumohen emisionet reaksionare të llumit të emigracionit politik...
Këta hapa do të realizohen plotësisht, nëse ne heshtim, nëse ne akoma bëjmë gjumë dimëror; por, nëse u kundërvihemi qëllimeve të errëta të Beogradit dhe, pa një pa dy, hapim një radio tjetër, atëherë do të shihet se planet e zeza të Beogradit do të dështojnë me turp.
Prandaj, dëgjues e bashkatdhetarë patriotë, vëllezër revolucionarë, ju bëjmë thirrje që ju me rrethe tuaja të organizuara, të ndërmerrni

hapa të pavarur dhe të hapni një radio sa më parë, që edhe komuniteti ynë shqiptar në Bruksel të ketë radion dhe emisionet e veta revolucionare në gjuhën tonë shqipe!
Aty ku mungon aktiviteti ynë, aty shtohet aktiviteti i UDB-së. Dhe kjo, nëse dikujt i konvenon , Kosovës dhe bijve të saj nuk i konvenon as për së afërmi.
Sabotimet që po na bëhen ne në Bruksel, po na bëhen në mënyrë të organizuar e të rafinuar udbeske.... që të ndërpritet çdo aktivitet paqësor i revolucionarëve kosovarë, i forcave progresive, kryesisht nga Kosova martire dhe të mbytet çdo ndjenjë patriotike drejt konstituimit të Kosovës Republikë.
Me këtë rast i përshëndes të gjithë ata që u bënë iniciatorë dhe ata që e përkrahen iniciativën e radios sonë në Bruksel, me bindje të patundur se Brukseli nuk do të mbetët jetim, se shqiptarët në Bruksel nuk do të mbetën pa një radio revolucionare në favor të Kosovës Republikë.
Emisoni "Zëri i Kosovës" do të dëgjohet përsëri, bile edhe më i ashpër se i pari. Për këtë ndoshta lypet një kohë prej dymuajsh e ndoshta edhe më tepër, kurse për startimin e radios do të njoftoheni me lajmërim të përgjithshëm.

***Kjo ishte një kumtesë e redaksisë së Radios "Zëri i Kosovës" në Bruksel.***
***Data 21 qershor 1998***

Fandit

KUMTESË

DËGJUES TË DASHUR TË RADIOS ZËRI I KOS.

ME KEQARDHJE TË MADHE, JU LAJMËROJMË, SE: EMISIONI I RADIOS Z.K. TANI PËR TANI NDËRPREHET PËR KOHË TË PACAKTUAR.

JU, DËGJUES TË DASHUR, DUHET TË INFORMOHENI TË PARËT ME KËTË VENDIM ARBITRAR TË QARQEVE ARMIKE, SE KËTË RADIO NUK PO E MBYLLIN MIQTË, POR ARMIQTË TANË NGA BEOGRADI – E NGA BELGJIKA.

SERBOMDHEJT NUK LANË GUR PA RROTULLUAR, NUK LANË VRIMË PA I FUTUR HUNDËT, NUK LANË KONFERENCË, PLENUM E KONGRES TË NIVELIT MË TË LARTË SHTETËROR JUGOSLLAV PA E PARASHTRUAR TEMËN E NXEHTË E AKTUALE, QË TË NDALOHET ZËRI I SHQIPTARËVE PATRIOT, KUDO QË TË MOS THUHET REALITETI YNË I HIDHUR NË NJË KOMUNITET ME MË SE 20.000 SHQIPTARË – SIQ ËSHTË BRUKSELI I BELGJIKËS, POR ME ÇDO KUSHT TË DOMINOJ PROPAGANDA ARMIKE E BEOGRADIT, TË DOMINOJ GËNJESHTRA, ÇPIFJET DHE TRILLIMET E ZIERA NË KUZHINAT HELMUESE TË BEOGRADIT.

SERBOMDHEJT E KREUT ÇETNIK TË LKJ-SË E TË SËRBISË, DUKE E PARË VENDOSMËRINË E PATRIOTVE SHQIPTARË PËR AKTIVITETE PACIFISTE KULTURALE, NË MËNYRA DIREKTE E INDIREKTE NDIKUAN NË SHUMË DREJTIME →

60 – 3



2

KOMPETENTE E JO-KOMPETENTE, QË SA MË PARË TË MBYLLET KJO RADIO DHE KY EMISION REVOLUCIONAR, E QË NË VEND TË TIJ, TË VENDOSET NJË EMISION PROJUGOSLLAVË I DIRIGJUAR NGA UDB-ja DHE NGA AMBASADA JUGOSLLAVE E BRUKSELIT, SI DHE TË SHUMOHEN EMISIONET REAKSIONARE TË LLYMIT TË EMIGRACIONIT POLITIK NGA SHQIPËRIA, PRA PËR TA LUFTUAR SHQIPËRINË SOCIALISTE DHE PARTINË E PUNËS SË SAJ.

KËTA HAPA TË SERBOMDHEJVE DO ~~DO~~ TË REALIZOHEN PLOTËSISHT, NËSE NE HESHTIM, NËSE NE AKOMA BËJMË GJUM DIMËROR, POR, NËSE NE IU KUNDËRVIHEMI QËLLIMEVE TË ERRËTA TË BEOGRADIT DHE PA NJË – PA DY E HAPIM NJË RADIO TJETËR, ATËHERË DO TË SHIHET SE TË GJITHA PLANET E ZEZA TË BEOGRADIT DO TË DËSHTOJNË ME TURP.

PRANDAJ, DËGJUES E BASHKATDHETARË PATRIOT, VËLLEZËR REVOLUCIONARË, JU BËJMË THIRRJE, QË JU, ME RRETHET TUAJA TË ORGANIZUARA, TË NDËRMERRNI HAPA TË PAVARUR DHE TË HAPNI NJË RADIO SA MË PARË, QË EDHE KOMUNITETI YNË SHQIPTARË NË BRUKSEL TË KET RADION DHE EMISIONET E VETA ~~NË~~ REVOLUCIONARE NË GJUHËN TONË SHQIPE!

ATY KU MUNGON AKTIVITETI REVOLUCIONARË, ATY SHTOHET AKTIVITETI I UDB-ës DHE AI REAKSIONAR!

→

***Teksti që Musa Hoti e lexoi për herë të fundit në radion që mbante f 1,2***



3

E KJO, NËSE DIKUJT I KONVENON, KOSOVËS DHE NE
BIJVE TË SAJ NUK NA KONVENON AS PËR SË AFËRMI.
SABOTIMET QË PO NA BËHEN NE NË BRUKSEL,
PO NA BËHEN NË MËNYRË TË ORGANIZUAR, TË
PLANIFIKUAR E TË RRAFINUAR, ME QËLLIM
TË RINGJALLJES SË RRJETIT UDBESK DHE ATIJ
RREAKSIONARË, QË BRUKSELI TË BËHET EDHE
NJË HERË QENDËR E REAKSIONIT POR
MË SHUMË E UDB-es, E NJËHERIT TË
NDËRPRITET ÇDO AKTIVITET PAQËSOR I
REVOLUCIONARËVE KOSOVARË, I FORCAVE
PROGRESIVE KRYESISHT NGA KOSOVA MARTIRE,
DHE TË MBYTET ÇDO NDJENJË PATRIOTIKE
DREJTË REALIZIMIT TË KONSTITUIMIT TË
KOSOVËS REPUBLIKË.
ME KËTË RAST, I PËRSHËNDESIM TË
GJITHË ATA QË U BËNË INICIATOR DHE
ATA QË E PËRKRAHËN INICIATIVËN E MBYLLJES SË
RADIOS TONË NË BRUKSEL, ME BINDJE
TË PATUNDUR SE BRUKSELI NUK DO TË
MBETET JETIM, SE SHQIPTARËT NË BRUKSEL
NUK DO TË MBETEN PA NJË RADIO
REVOLUCIONARE NË FAVOR TË KOSOVËS DHE
TË KOSOVËS REPUBLIKË, POR EMISIONI
„ZËRI I KOSOVËS" DO TË DËGJOHET PËRSËRI,
BILE EDHE MË I ASHPËR SE I PARI,
E PËR KËTË NDOSHTA LYPSET NJË KOHË
PREJ DY MUAJSH E NDOSHTA EDHE MË
TEPËR, KURSE PËR STARTIMIN E RADIOS DO
TË NJOFTOHENI ME LAJMËRIM GJENERAL.
KJO ISHTE NJË KUMTESË E REDAKSISË SË RADIOS
ZËRI I KOSOVËS NË BRUKSEL. DATA 21-QERSHOR 1988.

***Faqja 3 dhe e fundit që Musa Hoti e lexoi në radio që mbante në Bruksel 1988***

Musa e dha lajmin e fundit për ndërprerjeje të emisionit të tij, më i zhgënjyer se kurrë më parë. Po e mbyste frytin që vetë e kishte lindur dhe e kishte rritur e tani erdhi momenti që duhej mbytur. Musa e donte dhe me kënaqësi shkonte të hapte radion, e tash duhej ta mbyllte përgjithmonë. Tash duhej ta vriste atë që vetë e kishte rritur. Ishte sikur të vrisje një pjesë nga trupi dhe shpirti i tij. Askush nuk ishte në gjendje ta kuptonte demoralizimin e tij, për ndërprerje të emisionit. E si mund ta kuptonim ne , kur ne dëshironim të ndërpritej, jo për shkak të Musës, por thjeshtë të mos përsëritej ngjarja me rastin e ekipit futbollistik e vitit 1968 dhe 1984.

## *LRSSH-ja dhe shkrirja e saj*

Dalja në liri e Musa Hotit dhe, gati në të njëjtën kohë, shpërngulja e Sabri Novosellës në Europë, ngjallte shpresa te Musa se tani e tutje Lëvizje do bëhet një forcë gjithëpopullore.

Instalimi i Sabriut dhe dalja e Musës nga burgu, patjetër do t'i shqetësonte kundërshtarët e tyre politikë. Në vend që të uleshin tensionet, ato ngriheshin gjithnjë e më shumë. Por tani nga një kundërshtar i kryesisë së Lëvizjes u bënë dy. Dy kundërshtarë, që secili kishte sejmenët e vet, që nuk dinin të arsyetonin, pasi "liderët" kishin krijuar dhe kultivuar ngritjen e figurës së tyre kudo që kishin shkuar.

Ngritjet e figurave, siç do ta shohim edhe në pjesë të tjera të këtij libri, bëhej duke u pëshpëritur në vesh familjarëve të tyre, që i kishin kudo në diasporë dhe ndonjë miopi pa dy ditë shkollë, se këta dirigjoheshin nga Tirana. Po të përhapshin fjalët se dikush kishte përkrahje nga Tirana zyrtare e asaj kohe, ai ngritje në qiell në masat popullore. Por, po të përhapeshin fjalët se Tirana është kundër tyre, autoriteti dhe kredibiliteti i tyre binte për toke. Raste të tilla kishte në dy palët. Syzana Gërvalla u fliste kundër Ibrahim Kelmendit të gjithë atyre që shkonin të vizitonin Shqipërinë. Kur ata ktheheshin në diasporë i transmetonin fjalët e saj, por gjithnjë duke shtuar se, po të mos kishte asgjë të vertetë, Sigurimi i Shqipërisë nuk do ta lejonte Suzanën të përhapte akuza direkt kundër Ibrahim Kelmendit.

Fjalët e saj për masën ishin fjalë të Enver Hoxhës. Kështu Ibrahimit i ra kredibiliteti dhe iu bashkangjit Xhafer Shatrit.
Në palën tjetër të Sabri Novoselles flitej kundër Musa Hotit, që nuk iu hap zyra në ambasadën e Shqipërisë në Paris, si dhe kundër Milaim Zekës të cilëve poashtu po u binte kredibilitetit dhe të cilët iu bashkangjitën Sabriut.
Pra, në vend që Musa t'i gëzohej lirisë, ai po përjetonte dhe përballej me të njëjtat probleme që ishte ballafaquar sa qe në burg.
Krahu i dytë i Lëvizjes me në krye me Sabriun dhe Musën, nxirrte organin dhe punën kryesore rreth organit e bënte Musa Hoti. Në fakt Musa Hoti botonte artikuj edhe në "Zëri i Kosovës", kur ishin të bashkuar. Sabri Novosella e përpilonte platformën dhe programin; ndërsa redaktimin e platformës dhe organit e bënte Musa Hoti.

PROJEKTPROGRAM ~~PROGRAMI~~ POLITIK I LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI

LRSSHJ është organizatë masash që lindi si formë e rezistencës së organizuar, e popullit shqiptarë në Jugosllavi, para së gjithash kundër shovinistëve serbomëdhenj, të cilët kanë armiqët kryesorë. Lëvizja u themelua pas bisedimeve të organizatave ~~patriotiko-revolucionare~~ në mes përfaqësuesve të LNCKVSHJ e PKMLSHJ të cilat përfunduan më 17 shkurt 1982 me ç'rast Lëvizja mori emrin e vet "Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi", u vendos që organ i saj qendror të jetë "Zëri i Kosovës" dhe u përpilua Komunikata. Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqesues të ish-OMLK, me të cilin bisedimet u mbyllën më 15 maj 1982, me ç'rast u aprovuan të gjitha vendimet e 17 shkurtit.

LRSSHJ është sinteze e një vazhdimësie dhe përvoje të ~~grupeve~~ organizatave të ndryshme revolucionare që vepruan në Kosovë për një kohë të gjatë, që pjekurinë e saj të plotë e arriti pas mëse 20 demonstratave spontane në Kosovë dhe vëllë 15 të tjerave të organizuara në mërgim. Kjo pjekuri u arritë duke bërë reflektime të thella lidhur me faktet dhe rrethanat qe u krijuan dhe që dolën në sipërfaqe pas demonstratave të pranverës 81 në Kosovë, në Jugosllavi dhe në botë, i studimit të mundesive reale, në përputhje me interesat e popullit shqiptarë dhe atyre popujve që jetojnë në Jugosllavi. Nga eksperienca e ngjarjeve të dendura, forcat e organizuara kërkesat e tyre i bënën një me ato të popullit, dhe me të gjithë potencialin e tyre u orientuan për kërkesën "Kosova Republikë", kërkesë e cila para organizatave dhe gjithë popullit qiti ~~metoda~~ forma të reja të luftes, që kërkuan zotërimin edhe më të shkathët të teknikës së konspiracionit, duke kërkuar edhe forcimin e të gjitha pozicioneve legale.

37-10

2.-

Lidhur me diskutimet rreth emërtimit të organizimit të ri,nga orientimi i të gjitha forcave për kërkesen Kosova Republikë,ne mes pikëpamjes për organizim në një parti apo në një lëvizje masash,fitoi pikëpamja qe të organizohemi në një Lëvizje masash,në flamurin e të cilës do të shkruajmë:"Presion,presion i vazhdueshëm për udhëheqjen federative deri në atë moment kur ajo do të t'ia njoh "Kosovës dhe viseve shqiptare në Jugosllavi të drejtën për formimin e një republike të atille sic jane gjashtë të tjerat në RSFJ."

Lëvizja lufton për krijimin e një republike,të cilën me cdo rast e kemi thekësuar se e nënkuptojmë vetëm në atë formë sic janë gjashtë të tjerat në Jugosllavi,kjo dmth,se ne kërkojmë ndryshime në përmbajtje dhe jo në formë,ndryshimé sasiore në radhë te pare dhe jo cilësore.Në praktikë kjo dmth le te jetë pushtet LKJ,në të gjitha Republikat duke perfshire edhe atë shqiptare,as punën e ceshtjes se sistemit ~~[illegible]~~ nuk ~~[illegible]~~ e vemë ne diskutim,edhe superstruktura në formë do te jetë si eshte ne republikat tjera,por kërkojmë qe në atë KQ të LKJ të kete shqiptare në përputhje me ~~numrin e popullsisë~~,Republika shqiptare të ketë numrin adekuat ,në proporcion me ~~numrin e popullsise~~ në të gjitha organet dhe mekanizmat udhëheqes në federatë,~~që ata miliona mineral plimbi e zn~~ t'i shfrytëzoj Kosova ashtu sic e shfrytëzon Serbia ~~kompleksin e minierave në Bor dhe Majdanpek,si e shfrytëzon Mali i Zi fabrikën e Aluminit,apo Maqedonia hekuranën e Shkupit~~.

Lëvizja si një forcë e organizuar ~~në njërën anë~~,dhe i gjithë populli ~~në anën tjetër po~~ e potenco~~në~~ se e njohin LKJ,~~por nuk duan ta njohen LK të KSA të Kosovës.Ata~~ do ta njohin ~~vetem~~ LK të RSSH në Jugosllavi.Nga kjo rezulton ~~edhe një herë~~ se Lëvizja nuk është

***Projekt Programi i Lëvizjes i korrigjuar nga Musa Hoti***

Ky projekt-program ka 10 faqe që Musa nuk e korrigjonte vetëm gjuhësisht por edhe ideologjikisht e politikisht. Dora e fundit e komunikatave dhe shkrimeve të ndryshme duhej të kalonte nga Musa Hoti. Sabri Novosella ishte ai që e bënte propozimin dhe përpilonte bazën e çdo materiali për botim, por gjërat tjera ia besonte Musës.
Ky program, që tani po botojmë, është publikuar në “Zëri i Kosovës”, në formën e përmirësuar, ashtu siç Sabriu e kishte porositur Musa Hotin. Porosia e Sabriut mund të lexohet në faqen e parë ku me dorë Sabriu e porosit Musën: “ Vëlla i nderuar, e shtyp këtë projekt program më kujdesin më të madh, duke bërë përmirësimet gjuhësore e gramatikore sa më mirë. Në një fletë të veçantë shprehi vërejtjet tua dhe ua dërgon shokëve në 8580 sa më parë”. Kurse në dy faqe është dorëshkrimi i Musës në këtë program.
Ky program dhe në disa dokumente tjerë zyrtare të Lëvizjes nuk gjejmë datë, as kur është shkruar, as kur është publikuar.
Lëvizja e krahut të shkëputur nga baza amë, me publikimin e “Zëri i Kosovës” me programe e organizime të manifestimeve të shumta, kishte filluar t’ia merrte famën Lëvizjes në Zvicër. Numër i madh themeluesish ishin instaluar në Suedi, por asnjëri prej tyre ende nuk kishte fituar të drejtën e përhershme të qëndrimit në këtë shtet.
Që këta të trajtoheshin si njerëz të rangut të lartë nga organët suedeze dhe t’u njihej sa më shpejt statusi i refugjatëve poltikë, Musa Hoti në emër të Lëvizjës u drejtohet autoriteteve suedeze me një letër të gjatë. Kjo letër ka 12 faqe. Musa Hoti fillimisht sqaron se një numër i madh shqiptarësh në Suedi kërkon strehim politik, pastaj përshkruan situatën e tendosur në Kosovë, kërkesën e Republikës në kuadër të Federatës dhe se Kosova ka të drejtë të jetë e barabartë me republikat tjera, si dhe për programin e Lëvizjes . Në përmbyllje të letrës i lutet qeverisë suedeze që anëtarëve të KQ të Lëvizjes, të cilët kanë kërkuar strehim politik në Suedi, t’u jepet kjo e drejtë sa më parë, pasi që janë persona të rëndësishëm.
Nga ky dokument po shkëpusim vetëm faqen 4, ku në vazhdim shkruan:

f – 4 –

Nr i regj.388/ I-KR-85
Përveç personit, që është i rrezikuar të arrestohet në Jugosllavi, i cili sjell këtë dokument, në Suedi, kanë kërkuar strehim politik edhe këta persona, që kanë qenë të rrezikuar të arrestohen e të torturohen deri në çmendi dhe pastaj të hidhen në qelitë mesjetare të burgjeve më famëkeq të Jugosllavisë:

1. Sabri Novosella, i lindur më 03/05/ 1943 në Vuçitërnë, me banim të përhershëm në Prishtinë
2. Xhafer Durmishi, i lindur më 14/05/1958 në Stanovë komuna e Vuçitërnës
3. Milaim Zeka, i lindur më 25/10/1962, në Obri, komuna e Sërbicës.
4. Hasan Rrahmani , i lindur më 10/03/1952 në Dumnica e Epërme, komuna e Podujevës.
5. Ymer Baça, i lindur më 28/11/1958 në Drenocë, komuna e Deçanit.
6. Naim Haradinaj nga komuna e Deçanit
7. Ibrahim Krasniqi, i lindur më 03/08/1935 në Prishtinë
8. Fazli Memaj, i lindur më 13/08/ 1960, në Lutogllavë, komuna e Prizrenit
9. Xhafer Zogaj, i lindur më 10/03/1958, Kaliqan komuna e Istogut
10. Avdi Zogaj, i lindur më 01/03/ 1960, Kaliqan komuna e Istogut
11. Ramadan Rexhepi, i lindur më 23/01/1957 Dobolldë komuna e Vitisë

Për persona të tjerë që kanë kërkuar strehim politik në Suedi, ne nuk mund të themi asgjë, pasi që ata nuk i kanë takuar LRSSHJ-së dhe ne nuk dimë për aktivitetet e tyre.
Duke patur parasysh që shteti suedez pati mirësinë dhe nuk na pengon daljen e organit të shtypit të LRSSHJ-së, për ç'gjë i jemi dhe

do t'i jemi përherë mirënjohës, besojmë se sugjerimet tona do t'i marrë parasysh.
Ju përshëndet me respekt,

Komiteti Qendror i LRSSHJ



1.Sabri NOVOSELLA, i lindur më 03.05.1943 në Vuçitërnë, me banim të përhershëm në Prishtinë;

2.Xhafer DURMISHI, i lindur më 14.05.1958 në Stanovc, komuna e Vuçitërnës;

3.Milaim ZEKA, i lindur më 25.10.1962 në Obri, komuna e Sërbicës;

4.Hasan RRAHMANI, i lindur më 19.03.1952 në Dumnicë të Epërme, komuna e Podujevës;

5.Ymer BAÇA, i lindur më 28.11.1958 në Drenoc, komuna e Deçanit;

6.Naim HARADINAJ, nga komuna e Deçanit;

7.Ibrahim KRASNIQI, i lindur më 03.08.1935 në Prishtinë;

8.Fazli MEMAJ, i lindur më 13.08.1960 në Lutogllavë, komuna e Prishtinës;

9.Xhafer ZOGAJ, i lindur më 10.03.1958 në Kaliqan, komuna e Istogut;

10.Avdi ZOGAJ, i lindur më 01.03.1960 në Kaliqan, komuna e Istogut;

11.Ramadan REXHEPI, i lindur më 23.01.1957 në Debolldë, komuna e Vitisë.

Për personat tjerë që kanë kërkuar strehim politik në Suedi, ne nuk mund të themi asgjë, pasi që nuk i kanë takuar LRSSHJ dhe nuk dimë për aktivitetet e tyre.

Duke patur parasyshë që shteti suedez pati mirësinë dhe nuk po e pengon daljen e Organit të LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI, për çka i jemi dhe do t'i jemi përjetë mirënjohës, besojmë se do t'i merrni parasyshë këto sygjerime tonat.

KOMITETI QENROR
I
LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE
SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI

Kosovë-Jugosllavi

***Kopje e letrës së 12 .05.1985, f 4***

*I pasur arkivi vetjak i Musa Hotit*

Kjo letër të shkruar nga Musa në emër të KQ të Lëvizjes është i vetmi dokument zyrtar ku padashje zbulohet anëtari i Komitetit Qëndror të Lëvizjes. Po të shtrohet pyetja se pse Musa zbulohet përmes kësaj letre, përgjigja do të jetë e shkurtër. Zbulohet, pasi që shumica e shefave të tjerë, ishin pa letra për të udhëtuar, dhe një letër anonime asnjë shtet perëndimor nuk e merrte seriozisht.
Kjo letër ka anën pozitive, sepse për herë të parë ne sot mund të themi se Musa ishte anëtar i Komitetit Qendror të Lëvizjes. Po të mos ishte kjo letër, ne vetëm do supozonim dhe pak gjë do të dinim. Aktivitetet e organizatave ilegale e kanë këtë anë negative, përndryshe të tjerat i kanë shumë mirë.
Gjatë leximeve të dokumentacionit të Musës, secili studiues i ardhshëm që do merret me punë shkencore ( gjë që një ditë e një kohë më të mirë se sot do të bëhet), jam i bindur që do ta ketë të vështirë të zbulojë apo të identifikojë se cilët shkrime ( të botuara e pabotuara), janë shkrime autoriale të Musa Hotit. Ai autor që në të ardhmen do të merret me botimin e një libri me shkrime origjinale publicistike të Musa Hotit do të gjendet para një problemi të madh. Ka shkrime në dorëshkrim dhe shkrime me makinë, por ka shkrime të njëjta edhe me dorë edhe me makinë ose vetëm me dorë apo vetëm me makinë. Ai që do të marrë përsipër të shkruajë një libër të tillë me shkrime të Musa Hotit, do ta ketë tepër të vështirë edhe pse një pjesë të vogël të punës ia lehtësoj unë përmes kësaj vepre. Mirëpo as unë nuk e kisha të lehtë t'i kujtoja nofkat e filanit e fistekut, sepse janë shlyer nga memoria, pasi bëhen tridhjetë vjet larg atyre emrave dhe ngjarjeve.
Në vazhdim do e publikoj një letër që Musa ia dërgon akademikut Rexhep Qosja lidhur me situatën në Kosovë. Letrën e dërgon përmes Këshillit KMLDNJ-së. Letra në dorëshkrim nuk ka as datë e as vit. Më pastaj po e botoj një lajmërim që është thirrje për demonstratë në Bruksel, por fatkeqësisht ka orën dhe adresën e jo ditën kur ajo mbahet. Duke shfletuar dhe lexuar materiale të ndryshme mezi e gjej datën, edhe pse përafërsisht e dija nga se

lidhur me këtë manifestim kam kujtimet e mia që do t'i lexoni në vijim.

***Letër, drejtuar akademikut Qosja***

**Akademikut Rexhep Qosja**
**Aktashi 58**
**Prishtinë**

Ne, punëtorët kosovarë me punë të përkohshme në Belgjikë, jemi të indinjuar thellë në shpirt e në zemër, me masakrat që po i përjeton populli ynë. Gjakderdhjen e madhe po e përjetojmë si një humnerë të cilën na e hapi armiku shekullor, e në të cilën do të rrokulliset ai vet.
Jemi solidarë me rininë e popullin tonë trim dhe liridashës, jemi krenarë më këto shqiponja që vdekjen për lirinë e mëmëdheut e shohin si lindje të dytë, se me një rini, me një popull si ky i yni, patjetër do të realizohen aspiratat gjithëpopullore për vetëvendosje drejt një demokracie të pashmangshme.
Ne, rreth 25.000 shqiptarë të komunitetit të Belgjikës, jemi me ju në dasma e gëzime, por sa herë ta lyp nevoja e atdheut, as vdekjes nuk e kemi zakon t'i frikësohemi. Edhe aty jemi me ju dhe gjithë Kosovën.
Ne, si komb i vjetër, luftën nuk e dëshirojmë, se shumë herë veç zi na solli, mirëpo kur atë na e shpall armiku, edhe ne patjetër duhet të mbrohemi.
Pra, ju priftë e mbara juve sot, e nesër neve.
Punëtorët me punë të Përkohshme në Belgjikë.



KOMITETI PËR MBROJTJEN E TË DREJTË NJE.
AKADEMIK REXHEP QOSJA
AKTASHI - [redacted] 58 PRISHTINË

NE - PUNËTORËT KOSOVARË - ME PUNË TË PËRKOHËSHME NË BELGJIKË, JEMI TË INDINJUAR THELLË NË SHPIRT E NË ZEMËR, ME MASAKRAT QË PO I PËRJETON AKTUALISHT POPULLI YNË. GJAKDERDHJEN E MADHE PO E PËRJETOJMË SI NJË HUMNERË TË CILËN NA E HAPI ARMIKU SHEKUL[illegible], E NË TË CILËN NESËR DO TË RROKULLISET AI VET.

JEMI SOLIDAR ME RININË DHE ME POPULLIN TONË TRIM E LIRIDASHËS, JEMI KRENARË ME KËTO SHQIPONJA QË VDEKJEN PËR LIRINË E MËMËDHEUT E SHOHIN SI LINDJE TË DYTË, SE ME NJË RINI, ME NJË POPULL SI KY I YNI, PATJETËR DO TË REALIZOHEN ASPIRATAT GJITHËPOPULLORE PËR VETËVENDOSJE DREJT NJË DEMOKRACIE TË PASHMANGËSHME.

NE, RRETH 25.000 SHQIPTAR TË KOMUNITETIT TË BELGJIKËS, JEMI ME JU NË DASMA E NË GËZIME, POR SA HERË TA LYPË NEVOJA E ATDHEUT, AS VDEKJES NUK E KEMI ZAKON T'I FRIKËSOHEMI, SE EDHE ATY JEMI ME JU E ME GJITHË KOSOVËN.

NE, SI KOMB I VJETËR, LUFTËN NUK E DOMË, SE SHUMË HERË VEQ ZI NA SOLLI, MIRPO KUR ATË NA E SHPALLË ARMIKU, EDHE NE PATJETËR DUHET TË MBROHEMI. E PRA JU PRIFTË E MBARA JUVE SOT E NESËR NEVE.

PUNËTORËT ME PUNË
TË PËRKOHËSHME NË BELGJIKË

***Letër, dërguar Rexhep Qosjës, dorëshkrimi i Musa Hotit***

Në vijim po publikoj thirrjen që mërgimtarëve të Belgjikës për një manifestim para ambasadës jugosllave në Bruksel:

**LAJMËRIM**

Të dashur shokë punëtorë,
Të dashur vëllezër e motra,
Për situatën që mbretëron në Kosovën tonë, me siguri jeni të informuar të gjithë. Atje, siç e dimë, disa mijëra minatorë po e vazhdojnë grevën tash 8 ditë, në një thellësi prej 1000 metrash nën tokën e begatshme të Kosovës Nënë. Qindra të tjerë janë shtruar në spitale. Protestës së minatorëve të Trepçës, qysh në fillim iu bashkangjitën më se 7000 studentë të Universitetit të Prishtinës, numër i cili po rritet vazhdimisht. Ata në shenjë solidariteti po e vazhdojnë grevën e urisë në sallën e sporteve "25 Maj" në Prishtinë. Minatorëve të Trepçës iu bashkangjitën të gjitha shtresat e popullit të Kosovës në përgjithësi, e klasa punëtore e saj në veçanti.
Kërkesat e klasës punëtore sa humane, janë edhe njerëzore. Punëtorët kërkuan dhe po kërkojnë dorëheqjen e Rrahman Morinës, të Ali Shukriut, të Ysemedin Azemit dhe Sllobodan Milloshevicit.
Gjendja politike në Kosovë u keqësua edhe më tepër, sidomos pas vizitës së Shuvarit dhe Milloshevicit në Kosovë. Kreu i Federatës dhe Serbisë hasi në kundërthënie, kur ky i fundit pa fije turpi deklaroi: " Dorëheqja e Morinës nuk vjen në konsiderim, për arsye se këtë e kërkojnë disa xehetarë të Trepçës në Star Tërg", deklaratë të cilën e hodhi poshtë e gjithë klasa punëtore e Kosovës heroike, që po e tmerron RSFJ-në.
Klasa punëtore e Kosovës, studentët e Universitetit të Kosovës, nxënësit e shkollave fillore e të mesme, masat e gjëra popullore, në shenjë solidariteti me kërkesat e minatorëve, e ndërprenë punën në të gjitha organizatat punuese, në të gjitha shkollat e fakultetet e Kosovës, dhe kjo grevë po vazhdon ende. Greva e urisë dhe qëndrimi solidar ka përfshirë të gjitha shtresat e popullsisë shqiptare në Kosovë.

Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës po organizon çdo ditë tubime protestuese në shenjë solidariteti me minatorët e Trepçës.
Telegrame solidarizuese me klasën punëtore të Kosovës arrijnë çdo ditë nga të gjitha viset e Jugosllavisë.
Kryetari i Lidhjes Socialiste të Sllovenisë, Jozhe Smole u dërgoi apel protestues, Dizdareviçit, Stipe Shuvarit, Slobodan Milloshevicit dhe udhëheqësisë së Kosovës, që të gjejnë zgjidhje humaniste ndaj problemit tejet delikat të çështjes së Kosovës, e njëherit të evitohet më e keqja. Smolle deklaroi: " Komitetit Republikan të Sllovenisë i arrijnë pandërprerë telegram nga individë e organizata punuese, që sa më parë të ndërmerren masa demokratike për fatin e minatorëve dhe të zgjidhet problemi kosovar në baza reale. Duhet të bëjmë çmos për t'i ikur të keqes".

2. Lidhja e Shkrimtarëve të Sllovenisë u bëri apel forcave përparimtare në vend dhe opinionit të jashtëm, që të mbrohet populli shqiptar në Kosovë nga gjenocidi që po ia servir udhëheqësia republikane e Serbsisë, kurse Federatën e akuzojnë për kompromis me politikën antishqiptare të Serbisë.
3. Shkrimtarët sllovenë reaguan kundër masave regresive që po përgatitën për Kosovën e njëherit e kundërshton vlerësimin e tubimeve të punëtorëve si kundërrevolucion që ua bëri kreu serb e federativ. Ata solidarizohën me mbrojtën e Kushtetutës së vitit 1974.

Sindikata e Kroacisë në tubimet e jashtëzakonshme më 25 shkurt e ngriti zërin në emër të mbrojtjes së jetës njerëzore. Ata, në emër të krenarisë së klasës punëtore, në emër të barazisë nacionale e sindikale, apelojnë: " Asnjë forum partiak e shtetëror, asnjë funksion i kujdoqoftë nuk mund të zëvendsohet me jetën njerëzore të klasës punëtore, prandaj është obligim njerëzor të merren masa në favor të së drejtës së klasës punëtore në Kosovë. Pra, çdo gjë do të bëhet në emër të barazisë së të gjitha kombeve e njëherit të ruajtjës së Jugosllavisë unike".
Punëtorët me punë të përkohshme në Norvegji, Suedi, Danimarkë, Zvicër e Gjermani po vazhdojnë tubimet solidarizuese përpara ambasadave dhe konsullatave jugosllave, ku shprehet solidariteti i

plotë me të gjitha kërkesat e klasës punëtore kosovare e njëherit po bëjnë greva urie në shenjë solidariteti me grevistët e Trepçës zëmadhe.
Sllovenët, që përkohësisht jetojnë e punojnë në Belgjikë, në shenjë solidariteti me klasën punëtore të Kosovës kanë ndërmarrë fushata për formimin e një fondi humanitar për ndihma familjeve të grevistëve e paralel me këtë aksion, po mbledhin nënshkrime për një peticion solidarizues që do t'u dërgohet organeve më të larta partiake e shtetërore në Jugosllavi.
Edhe ne punëtorët shqiptarë me punë të përkohshme në Belgjikë, duke u treguar solidarë me të gjitha kërkesat e klasës punëtore në Kosovë, e shohim të arsyeshëm të organizojmë një tubim solidarizues përpara lokaleve të Ambasadës Jugosllave në Bruksel.
Tubimi solidarizues mbahet të shtunën në ora 9.30
Në rrugën Avenue E. Delmot 11
Bruxelles 1060

**Punëtorët me punë të përkohshme në Belgjikë**

# L A J M Ë R I M

TË DASHUR SHOKË PUNËTORË
TË DASHUR VËLLEZËR E MOTRA

Për situatën që mbretëron në Kosovën tonë, me siguri jeni të informuar të gjithë. Atje siç e dijmë, disa mijëra minatorë po e vazhdojmë grevën e urisë tash 8 ditë, më një thellësi prej 1000 metrash nën tokën e begatëshme të Kosovës Nënë. Qindra të tjerë janë shtruar në spitale.

Protestës së minatorëve të Trepçës, qysh në fillim, iu bashkangjitën më se 7000 student të univerzitetit të Kosovës, numër i cili po rritet vazhdimisht. Ata në shenjë solidariteti po e vazhdojnë grevën e urisë në hallen e sporteve "25 Maji" në Prishtinë. Minatorëve të Trepçës iu bashkangjitën të gjitha shtresat popullore të Kosovës në përgjithësi, e klasa punëtore e saj në veçanti.

Kërkesat e klasës punëtore të Kosovës, sa janë njerëzore aq edhe humane. Ata kërkuan e po kërkojmë me këmbëngulje dorëheqjen e Rrahman Morinës, Ali Shukriut, Hysamedin Azemit dhe Sllobodan Milloshevigit.

Gjendja politike në Kosovë u keqësua edhe më tepër, sidomos pas vizitës së Shuvarit e Milloshevigit në Kosovë. Kreu i federatës dhe Sërbisë hasën në kundërthënje, kur ky i fundit, pa fije turpi deklaroi: "Dorëheqja e Morinës nuk vjen në kosiderim, për arsye se këtë e kërkojnë vetëm ca xehetarë të Trepçës në Stari Tërg" , deklaratë, të cilën e hodhi poshtë e gjithë klasa punëtore e Kosovës heroike e cila po e tmerron RSFJ-në.

Klasa Punëtore e Kosovës, Studentët e Univerzitetit të Kosovës, nxënësit e shkollave fillore e të mesme, masat e gjëra popullore, në shenjë solidariteti me kërkesat e minatorëve, e ndërprenë punën në të gjitha organizatat punuese, në të gjitha shkollat e fakultetet e Kosovës dhe kjo grevë gjenerale po vazhdon tash 10 ditë. Grevat e urisë dhe qëndrimi solidarë i ka përfshirë të gjitha shtresat e popullsisë shqiptare në Kosovë.

Lidhja e Shkrimëtarëve të Kosovës, për çdo ditë po organizon tubime protestuese në shenjë solidariteti me minatorët e Trepçës.

Telegrame solidarizuese me klasën punëtore të Kosovës arrijnë për çdo ditë nga të gjitha viset e Jugosllavisë.

Kryetari i Lidhjes Socialiste të Sllovenisë, Jozhe Smolle u dërgoi apel protestues Raif Dizdareviqit, Stipe Shuvarit, Sllobodan Milloshevigit dhe udhëheqësisë së Kosovës, që të gjejnë zgjidhje humaniste ndaj problemit tejet delikat të qështjes së Kosovës, e njëherit të evitohet më e keqja. Smolle deklaroi:"Komitetit Republikan të Sllovenis ë i arrijnë pandërprerë telegrame nga individ e organizata punuese, që sa

më parë të ndërmirren masa demokratike për fatin e minatorëve dhe të zgjidhet problemi kosovarë në baza reale. Duhet të bëjmë çmos për t'i ikur të keqes".

Lidhja e Shkrimëtarëve të Sllovenisë bëri apel forcave përparimtare në vend dhe opinionit të jashtëm, që të mbrohet populli shqipëtar në Kosovë, të mbrohet populli shqiptarë nga gjenocidi të cilin po ia servon udhëheqësia republikane e Serbisë, kurse federatën e akuzojnë për kompromis me politikën antishqipëtare të Sërbisë.

Shkrimtarët slloven apeluan kundër masave regresive që po përgatiten për Kosovën e njëherit e kundërshton vlerësimin e tubimeve të punëtorëve si kundërrevolucion që ua bëri kreu serb e federativ. Ata solidarizohen me mbrojtjen e kushtetutës së vitit 1974.

Sindikatet e Kroacisë, në tubimet e jashtëzakonshme më 25 shkurt, e ngritën zërin në emër të mbrojtjes së jetës njerëzore. Ata, në emër të krenarisë së klasës punëtore, në emër të barazis ë nacionale e sindikale, apelojnë:" Asnjë forum partiak e shtetëror, asnjë funksion i kujtëdoqoftë nuk mund të zëvendësohet me jetën njerëzore të klasës punëtore, prandaj është obligim njerëzor të meren masa në favor të së drejtës së klasës punetore në Kosovë. Pra çdo gjë të bëhet në emër të barazisë së të gjitha kombeve e njëherit edhe në emër të ruajtjes së Jugosllavisë unike".

Punëtorët me punë të përkohshme në Norvegji, Suedi, Danimarkë, Zvicër e Gjermani po i vazhdojnë tubimet solidarizuese përpara ambasadave dhe konzulatave jugosllave, ku shprehet solidariteti i plotë me të gjitha kërkesat e klasës punëtore kosovare e njëherit po bëjnë greva urie në shenjë solidariteti me grevistët e Trepçës zëmadhe.

Sllovenët që përkohësisht punojnë e jetojnë në Belgjikë, në shenjë solidariteti me klasën punëtore të Kosovës, kanë ndërmarrë fushata për formimin e një fondi humanitarë për ndihma familjeve të grevistëve e paralel me këtë aksion, po mbledhin mënshkrime për një peticion solidarizues i cili do t'iu dërgohet organeve më të larta partiake e shtetërore në Jugosllavi.

Edhe ne punëtorët shqipëtar me punë të përkohshme në Belgjikë, duke u treguar solidar me të gjitha kërkesat e klasës punëtore në Kosovë, e shohim të arsyeshme të organizojmë një tubim solidarizues përpara lokaleve të ambasadës jugosllave në Bruksel.

Tubimi solidarizues do të mbahet të SHTUNËN NË ORA 9.30

Në rrugën: AVENUE E.DEMOT. 11- 1060 BRUXELLES

PUNËTORËT ME PUNË TË PËRKOHËSHME
NË BELGJIKË

4 mars 1989

***Komunikata për demonstratë solidarizuese me minatorët e Trepçës f.1,2***

## *Problemet e këtij manifestimi*

Siç u tha edhe më herët, Lëvizja e krahut të Suedisë u aktivizua aq sa Lëvizjen e Zvicrës e la të zbehtë. Grupi i Suedisë ( kryesia) ishte më kompakt sesa ai më qendër në Zvicër. Pas ndarjes pushuan grindjet e liderëve dhe secili krah mundohej t'ia kalonte tjetrit me aktivitete, pavarësisht që përmes dy organeve fjaloseshin për një kohë jo shumë të gjatë.
Grupi i Sabriut dhe i Musës kishin respekt për njëri-tjetrin, sepse mes tyre ndonjëri kishte edhe lidhje familjare. Grupi tjetër i zvogluan aktivitetet, sepse kishte hyrë sherri mes dy liderëve: Xhaferit dhe Ibrahimit. Dikur Xhaferi ishte në krahun e Sabriut dhe Musës e tani e kishte futur nën sqetulla e tij Ibrahimin. Ibrahimi nuk ishte personalitet që dikush mund ta mbante nën sqetulla, sepse kishte themeluar vite të tëra grupet e veta. Madje, si mund të mbahej nën sqetull njeriu që kishte publikuar "Bashkimin ", që kishte vepruar me Jusuf Gërvallën . Dalja në skenë e Hysen Gërvallës dhe dy komunikatat e tij "Thirrje masave", do të bënte edhe ndryshime. Hysenit do t'i bashkohej Musa Hoti me shumë të tjerë të KQ të tyre, por Sabri Novosella do qëndronte anash.
Aktivizimin e tyre tani do ta quanin Lëvizje, por, punëtorët me punë të përkohshme jashtë atdheut. Shef i këtij organizimi të ri ishte Hysen Gërvalla. Musa Hoti i ishte bashkuar.
Krahu i Hysenit forcohej. Ai kishte mundësi organizative të mbante demonstrata në Bruksel siç ishte ajo e 4 marsit 1989. Krahu i Zvicrës kishte mbetur me po atë emër, por pa ndonjë aktivitet të bujshëm si dikur.
Në manifestimin që e organizoi Musa Hoti në emër të punëtorve, pjesëmarrja nuk ishte aq e madhe, rreth 120 veta. Pavarësisht numrit të vogël, demonstrata pati jehonë në shtypin belg. Krahu i Lëvizjes së Zvicrës në Belgjikë nuk mori pjesë, poashtu në demonstratë e tyre nuk do merrnin pjesë punëtorët.
Komiteti ynë me në krye Enver Hadrin mori pjesë i gjithë. Kur them të gjithë, mos të krijohet iluzioni se ne ishim shumë. Jo, ne ishim:

Enveri, Beharja Ganiu dhe unë. Ne interesoheshim dhe mbanin lidhje me institucione të huaja Europiane, sidomos me Parlamentin Europian.
Katër ditë më parë ne kishim organizuar një konferencë për mediet ndërkombëtare që pati jehonë në tërë Europën.
Ne arritëm te vendi i demonstratës me veturën e Enver Hadrit, ndërsa një femër tjetër belge  me të cilën merrej Enveri erdhi pas nesh, me kerrin dhe me qenin e saj të zi.
Musa Hoti na uroj mirëseardhjen, por shpejt u largua prej nesh, duke shkuar të Avdyl Gërvalla që pothuaj erdhi në të njëjtën kohë me ne.
Organizatorët tjerë sapo na panë ne, sidomos Enver Hadrin, filluan të flisnin vesh më vesh. Pas pak kamerat televizive vendore filluan të filmonin fillimin e fjalimeve.
Enveri luante me qenin e tij që e thërriste  "Bella". Grupit tonë iu bashkua Jean Doganier, një belg, dhe e mbante të hapur një lokal në Rue de Monté Negro. Belgu njihej si përfaqësues i RPS të Shqipërisë në Belgjikë. Në lokalin e tij kishte mallra nga Shqipëria dhe literaturë të ndryshme propagandistike.
Gjatë kohës që lexoheshin fjalimet, gazetari i televizionit të   RTL, erdh te grupi ynë, që ishim në fund të demonstruesve dhe  intervistoi Enver Hadrin. Ne, edhe po të donim të hynim brenda në turmë, nuk na lejonin kujdestarët e tyre, kështuqë rrinim pranë tyre, por në fund të gjithë tjerëve.
Pas përfundimit të demonstratës grupi ynë dhe Jean Doganieri erdhi në shtëpinë time. Beharja, që ishte e lodhur nga qëndrimi disaorësh në këmbë në manifestim, në vend te kafeve shërbeu pije alkoolike. Ishte ora pak pas dymbëdhjetës. Në orën trembëdhjetë prisnim lajmet në RTL.  Ja shkurtimisht se s'bisedonim në sallonin tim në pritje të lajmeve.
**UNË**: Shpëtove ti pa u rrahë e gazetari i RTL pa ia thye kamerën nga klasa punëtore!
**GANIU**: Ani, ata qysh janë klasë punëtore as në burg nuk i shtinë.
**ENVERI**: Kësaj here ia keni marrë demonstratën! Ata le të bërtasin "Poshtë Jugosllavia" e "Rrofshin punëtorët", kur t'i shohin lajmet, populli do të mendojë se demonstratën na e kemi organizua.

Koha e lajmeve kryesore të ditës u afrua. Rrezet e diellit që depërtonin nga dritaret e gjëra e të mëdha të sallonit tim, pengonin që të dukeshin lajmet. Unë u ngrita dhe i mbylla me perde të trasha dhe tek shikonim televizionin pinim nga pak wiski. Storja e demonstratave u dha, por intervista e Enver Hadrit nuk ishte. Menduam se do jepej në lajmet qendrore të mbrëmjes në orën 19.30. Ne u shpërndamë secili në shtëpitë e tyre, duke pritur lajmet e mbrëmjes.
Kur shkruaj episode të tilla, duhet kuptuar se ne nuk ishim njerëz prej gurit që nuk qeshnim e nuk qanim kurrë. Kur organizonim një aktivitet ne kishim dëshirë që për të shkruhej në shtyp dhe të flitej në televizione të huaja. Ne rrinim në ankth deri sa të nesërmen që të lexonim shtypin e përditshëm. Kemi pasur raste kur prisnim deri në orën tre-katër të mëngjesit në një kafe afër redaksisë "La derniere Heures" dhe merrnim gazetën e parë, ende pa u dërguar në shitore dhe e shfletonim se a ka shkue për aktivitetin tonë. Dhe vetëm, kur e shihnim artikullin që fliste për konferencën tonë, ne gëzoheshim si fëmijët. A e dini ju se në ato gazeta kurrë nuk është përmendur emri im, i Behares, i Ganiut? Ne nuk na përmendej emri, por ne gëzoheshim për artikullin që ishte fryt i përbashkët yni. Ne gëzoheshim se në atë artikull demaskohej propaganda serbe.
Një ditë pas demonstratës e thirra Musa Hotin për një kafe me Enverin dhe mua. Musa na tregoi se një grup i këshillit organizativ menjëherë pas demonstratës kishte shkuar në redaksi të RTL dhe kishte kërkuar prej tyre që të hiqej Enveri. Redaktorit përgjegjës i kishin thënë se nëse Enveri është, mos e jepni aspak lajmin për demonstratën.
Ne nuk mbajtëm mëri me vendimin e tyre, sepse më në fund ishte e drejtë e tyre të afirmoheshin. Sikur të lejohej deklarata e Enverit tërë diaspora shqiptare e Europës do e merrte se ishte demonstratë e jona dhe jo e Punëtorëve.

## *VITI 1990 dhe veprimtaria kombëtare e pandërprerë e Musa Hotit*

Musa nuk kënaqej duke qëndruar në sallon për të shikuar televizion ose të luante me fëmijët e tij. Jo. Musa kur nuk kishte aktivitete politike ndjehej i demoralizuar. Musa nuk mund të qëndronte në kafene duke luajtur letra, shah e me biseda të kota me të dehurit që më shumë e jetën e kalonin kafeneve sesa më fëmjët e tyre. Jo, Musa kërkonte aktivitet, kërkonte angazhim për çështjen kombëtare. Po ku mund të angazhohej për të dhënë kontributin e tij?

Viti 1990 ishte viti i ndryshimeve të mëdha politike për shqiptarët kudo që jetonin. Në skenën politike hyri LDK-ja, që bëri të dobësohej çdo organizatë, Lëvizje e parti politike që vepronin në favor të Kosovës. Lëvizja e Sabri Novosellës ishte shuar qysh më parë; Punëtorët e Hysen Gërvallës iu bashkangjitën LDK-së, por pa i përfshirë edhe degët e tyre ne vende të tjera; Lëvizja e Ibrahim Kelmedit nxirrte kokën për të treguar se “ende jam gjallë”, por Xhaferi kishte përgatitur terrenin me grupin e tij “SOS Kosovë” dhe bëhej gati t’u fuste nën sqetulla të LDK-së, mirëpo kjo kërkonte kushte.

Në Bruksel në shkurt të 1990-s u vra Enver Hadri. Kjo vrasje u bë nga tre komandat serbe me urdhër direkt të Sllobodan Millosheviçit (siç u pa në procesin e tij të Hagës gjatë dëshmisë së dëshmitarit C48). Pas vrasjës së Enver Hadrit, Komiteti ynë për disa ditë përjetoi kriza të thella, sepse dolën edhe shumë të tjerë që deklaronin se kishin punuar sekret në Komitetin tonë. Dhe ata nuk kërkonin të bëheshin anëtarë, por shefa të Komitetit. Përveçse nuk pranonin të vinin si anëtarë, ata ngulnin këmbë që unë dhe Beharja ishim grindur me Enverin dhe duhej të përjashtoheshim. Ganiu mund të rrinte në Komitet, në një post: të merrej me shqiptarët e Belgjikës.

Unë nuk dija se ç’bëhej prapa perdeve. Nuk e dija nga dolën tërë ata shokë e bashkëpunëtorë të Enverit pas vdekjes, kur gjatë aktiviteteve tona pikërisht pengoheshim prej tyre. Në përkrahje ata

kishin edhe një femër belge me origjinë gjermane e me qen të zi “Bella “, me të cilën unë isha fjalosur qysh në vitin 1982. Ne ishim fjalosur, por qe nga 1982-1990, ne bashkëpunonim, mirëpo pas vrasjes së Enverit, po ato ditë unë do të fjalosem me këtë femër, sepse ajo nuk dëshironte që në konferencën për shtyp ta akuzonim Serbinë e veçmas Milloseviçin, gjë që unë e kundërshtova. Dhe u bë konferenca e shtypit duke e akuzuar direkt Milloseviqin, Ambasadën e Serbisë në Bruksel dhe sherbimin sekret të Serbisë se ata e kishin vrarë Enver Hadrin. Nga kjo konferencë femra me qen të zi më mori mëri dhe me çdo kusht unë duhej të largohesha. Dhe u largova. Unë dhe Beharja e krijuam Byronë Informative të Republikës së Kosovës, Ganiu hyri në LDK. Byroja, kryetare ishte Beharja, gjatë dhjetëvjetëshit, deri më 1999, veproi dhe bëri emër në institucionet nderkombëtare, duke funksionuar si urë lidhësen mes të gjitha personaliteteve nga Kosova, duke filluar nga Ibrahim Rugova e deri të Thaçi. Komiteti, që kishim themeluar me Enver Hadrin, u zhduk, sepse pas vrasjes së Enverit, ai nuk u krijua për të vepruar, por për të sabotuar.

Ku mbeti Musa Hoti? Ku të angazhohej Musa Hoti? Në LDK ishin zënë vendet. Musa mund të merrte pjesë vetëm po t’i jepej përgjegjësi. Për këtë nuk bëhej fjalë. Konsiderohej si terrorist dhe mbetej terrorist. Prandaj angazhimi i tij në struktura të ngushta, sipas disave, do të dëmtonte Lëvizjen, pasi Jugosllavia do të na akuzonte dhe “ne nuk jemi me e prishë Jugosllavinë. Lëvizja e tij ishte shkrirë në LDK.

Xhafer Shatrin LDK-ja nuk e pranonte t’u shkonte si parashutë, por ky tregoi mençuri dhe përdori relacionet e tij të vjetra dhe u imponohej: ose ta merrnin, ose do t’i sabotonte. Pa pasur njohur për qëllimet e Xhafer Shatrit, mora pjesë në një mbledhje që kishte ftuar Byronë Informative në Gjenevë. Byronë e përfaqësonim: Beharja , unë, Ekrem Krasniqi, Xhavit Dujaka, dhe Gilbert Ponchot, belgu që na ndihmonte për komunikatat dhe materialet tjera në gjuhën frëngjishte, flamane dhe anglishte. Pasiqë Byroja gëzonte kredibilitet në Parlamentin Europian dhe në qarqe tjera diplomatike; pasi që “SOS Kosovë’’, poashtu gëzonte kredibilitet në OKB në

Gjenevë, në takimin tonë u vendos t'i kundërvihemi politikës paqësore në të gjitha institucionet ndërkombëtare.
Pak ditë pas kthimit tonë nga Gjeneva, Xhafer Shatri u bë pjesë e qeverisë dhe mori postin e Ministrit të Informatave. Xhaferi më harroi sikur kurrë të mos kisha ekzistuar. Harroi se gjatë aktivteteve të mia në Lëvizjen e tij vinte në shtëpinë time për të biseduar; harroi se sa ishte gjallë Enver Hadri ne bashkëpunuam ngushtë me Xhaferin; i harroi të gjitha Xhaferi. Ai në Bruksel u jepte krahë dhe autorizime njerëzve të tij, të lidhjeve familjare. Pavarësisht nga injorimi i tij, ai kurrë nuk ka pasur mundësi të më zbehë aktivitetin tim, respektivisht të Byrosë Informative. Kurrë! Aktiviteti i Byrosë Informative e detyronte Xhafer Shatrin, Bujar Bukoshin e të gjithë me radhë të vinin në Parlamentin Europian përmes ftesave të Behares. Kështu edhe Xhafer Shatri do të më drejtohej mua që ta ftoja e t'i bëja kontakte Xhaferit dhe Iliaz Ramailit. Dhe ua bëra, jo njëherë, por disa herë.
Musa Hoti nuk kishte ku të shkonte dhe me kë të bashkohej për të kontribuar për dramën kosovare. Të bashkohej me mua në Byronë Informative, ishte e pamundur sepse unë dhe Beharja ishim të anatemuar nga LDK-ja, të cilën e krijova unë. Në fakt LDK –ja, dega e Belgjikës, u krijua nga Naim Maloku. Kontaktin e parë për të themeluar degën Naim Maloku e kishte me mua dhe Sokol Tërlakun, që e kishte tezak. Naimit i organizova një konferencë për mediat ndërkombëtare që të nesermen pati jehonë në shtypin belg. Pastaj Naimit i propozuam njerëzit me të cilët mund të bashkëpunonte për të themeluar degën në Belgjikë. Dhe një javë më vonë u themelua dega e tyre, por u morëm vesh që Byroja Informative e Kosovës, që e udhëhiqte Beharja, të vepronte e pavarur. Musa Hoti ishte në të gjitha bisedimet, por nuk duhej të hynte në kryesi, sepse frika ishte nga akuzat eventuale që mund t'i bëhen LDK- së, nëse Musa "terroristi" futej aty.




***Musa Hoti me familje, Bruksel***

Gjatë vizitës së tij, Naimi takoi shumë shqiptarë, në mesin e tyre ishte edhe Musa Hoti, por fatkeqësisht Musa kurrë nuk fotografohej. Shqiptarë vinin të takoheshin me Naimin, si dhe me shumë personalitete që kanë ardhur më vonë, por fotografi të Musa Hotit janë të rralla. Në barin e Qendrës për media ishte edhe Musa Hoti, por nuk mundëm ta dokumentojmë me fotografi pjesëmarrjen e tij.
Sa më shumë që koha kalonte, në mërgatë bëheshin ndryshime të shumta. Dikush bëhej kryetar i demokratëve, tjetri hynte dhe kështu krijohej hapësira për secilin nga pak, por kurrë nuk u krijua për Musa Hotin, ndonëse gjithnjë ishte i pranishëm.
Me vizitën e Ibrahim Rugovës, që Beharja e kishte rregulluar në Parlamentin Europian, Musa Hoti do na shoqëronte në ndeja të ndryshme, por jo të kyçej në struktura partiake.

Pas vrasjes së Enver Hadrit, unë bashkëpunoja me Qendrën e Sherbimeve Sociale që më herët kishte bashkëpunuar Enver Hadri. Qndra merrej çështje juridike të problemeve të shqiptarëve. Aty kisha zyrën, faksin dhe telefonin dhe çdo gjë për të komunikuar falas. Unë punoja vullnetarisht, pa pagesë. Pas një kohe kërkova nga drejtori që quhej Zbolge (me origjinë polake), që të angazhonim një shqiptar, pasi unë isha tepër i ngarkuar në Parlamentin Europian. Drejtori u pajtua të paguante një nëpunës shqiptar, që do merrej vetëm me shqiptarët. Pas një konsultimi, Musa pranoi dhe u gëzua që, më në fund, do të ndihmonte shqiptarët që silleshin rrugëve pa asnjë ndihmë sociale.

SAF Service d'accueil et de formation - SSE asbl

Rue de la Croix, 22
1050 Bruxelles
Tél. : 02/649.99.58
Fax. : 02/646.43.24

Réf.

Bruxelles, le 20 septembre 1992

## AVIS

Le Service Social des Etrangers asbl et la Communauté Albanaise de Belgique ont le plaisir de vous annoncer qu'une permanence sociale est ouverte au siège du SSE, rue de la Croix, 22 à 1050 Ixelles.

Les assistantes sociales & une personne de la communauté seront à votre disposition le mercredi & le vendredi de 14 à 17 heures.

## LAJMERIM

Lajmërojmë bashkatdhetarët shqiptarë të cilët aktualisht jetojnë e veprojnë në Belgjikë, se Shërbimi Social për të Huaj, me seli në 1050 Bruxelles (Ixelles), rue de la Croix, 22, ka vënë në dispozicionin Tuaj një shërbim të veçantë socialo–juridik për Komunitetin Shqiptarë në nivel të Belgjikës.

Bashkatdhetarët që jetojnë jasht Brukselitetë cilëve iu paraqitet nevoja për ndonjë shërbim administrativo–juridik, shërbimit në fjalë mund t'i paraqiten edhe me shkrim, në gjuhën amëtare, me një shënim plotësues : "Pour les Services en langue albanais".

Me bashkatdhetarë punojmë çdo të mërkurë e të premte nga ora 14 deri në ora 17.

Service Social des Etrangers asbl - C.G.E.R : 004-2505191-82 - C.C.P. : 000-0979256-41

L A J M E R I M

Bashkatdhetarë të nderuar në Belgjikë

JU drejtohemi të gjithë juve që patët fatin e keq,të degëdiseni në dhena të huaja,në rrugët e pafund të mërgimit në përgjithësi, e juve këtu në Belgjikë në veçanti,dhe t'ju themi se nuk keni bërë mirë që për çdo ditë po e zbrazni truallin tonë,po e dobësoni padashje gjakun e ri në damarët e KOSOVES NENE,dhe nuk ju çortojmë në asnjë mënyrë,përkundrazi vetëm kishim me ju këshilluar që të mos bini nga gabimi në gabim,por t'i qëndroni besnik Kosovës martire, mos ta braktisni përgjithmon,dhe në qastet dhe situatat më të mira, qoft ajo pak para çlirimit definitiv nga prangat e zeza të çetnikëve,qoft edhe pas lirimit definitiv,se KOSOVA pa ju nuk mund të mbetet Kosovë,as ju pa Kosovën të mbeteni këta që jeni tani. Ne e kuptojmë situatën që na e solli armiku shekullor,e kuptojmë fare mirë situatën politike dhe ate ekonomike në Kosovë dhe viset e saj në ish-Jugoskllavërinë,që në një mënyrë apo në një tjetër ju detyruan ta braktisni Kosovën përkohësisht,por vetëm përkohësisht dhe kurrë përjetësisht!

Sipas Konventës për refugjatët politik,ju nuk jeni aspak të detyruar të kërkoni strehim politik apo Anex 26,nga se vini nga një vend ku zhvillohet luftë (luftë e nxehtë ose luftë e ftoftë!),që juve në Belgjikë ua mundëson qëndrimin edhe pa kërkuar strehim politik:Me ligjin më të ri në fuqi;të gjithë qytetarët e ardhur nga Bosna e Hercegovina si dhe nga Kosova dhe viset e saj (nga Republika e Kosovës),gëzojnë të drejtën e qëndrimit në Belgjikë me të gjitha benificionet që i gëzon refugjati politik,derisa të rregullohet çështja politike dhe ekonomike në Kosovë dhe Bosnë,e ato janë: e drejta NE PUNESIM,NE NDIHMA TE RREGULLTA MATERIALE,NE SHKOLLIM,NE SHENDETESI (pa pagesë) DHE NE SHTESA TE FEMIJEVE. Këto të drejta i shfrytëzoni edhe pa kërkuar strehim politik,por vetëm duke e kërkuar formularin ANEX 3. në zyrën e policisë së huaj,në Square de la Meeuse,8 në 1040 Bruxelles.

77- 1

*Lajmërimi ku Musa Hoti njoftonte bashkatdhetarët për hapjen e zyrës sociale*

Ja si u drejtohej Musa Hoti bashkatdhetarëve tanë përmes këtij lajmërimi, të cilin e kishte shpërndarë ndër shqiptarë dhe klubet ekzistuese të asaj kohe:

Bruksel, më 20 shtator 1992

**LAJMËRIM**

Lajmërojmë bashkatdhetarët tanë shqiptarë, të cilët aktualisht jetojnë dhe veprojnë në Belgjikë, se Shërbimi Social për të huaj me seli në 1050 Bruksel (Ixelles), rruga Rue de la Croix 22, ka vënë në dispozicionin tuaj një shërbim të veçantë socio-juridik për komunitetin shqiptar në nivelin e Belgjikës.
Bashkatdhetarët që jetojnë jashtë Brukselit, të cilëve iu paraqitet nevoja për ndonjë shërbim administrative juridik, shërbimit në fjalë mund t'i paraqiteni edhe me shkrim, në gjuhën amtare, me një shënim plotësues: "Pour les Service en langue albanais" (për shermbim në gjuhën shqipe – perkthimi im),
Me bashkatdhetarë punojmë çdo të mërkure e të premte nga ora 14.00 deri në ora 17.00 "

Lajmërimi i dytë shkruar nga Musa Hoti, ja se si u drejtohet mërgimtarëve tanë:

**Lajmërim**

**Bashkatdhetarë të nderuar në Belgjikë**

Ju drejtohemi të gjithëve ju, që patët fatin e keq, të degdiseni në dhe të huaj, në rrugët e pafund të mërgimit, e juve këtu në Belgjikë në veçanti, dhe të ju themi se nuk keni bërë mirë që për çdo ditë po e zbrazni truallin tonë, po e dobësoni padashje gjakun e ri në damarët e KOSOVËS NËNË. Ne nuk ju qortojmë në asnjë mënyrë, përkundrazi vetëm kishim me ju këshilluar që të mos bini nga

gabimi në gabim, por t’i qëndroni besnik Kosovës martire, mos ta braktisni përgjithmonë dhe në çastet dhe situatat më të mira, qoftë ajo pak para çlirimit definitiv, se Kosova pa ju nuk mund të mbetet Kosovë, as ju pa Kosovën të mbeteni këta që jeni.
Ne e kuptojmë situatën që na solli armiku shekullor, e kuptojmë fare mirë situatën politike dhe atë ekonomike në Kosovë dhe në viset e saj në ish-Jugosllavinë, që, në një mënyrë apo tjetër, ju u detyruat ta braktisnit Kosovën përkohësisht, por vetëm përkohësisht dhe kurrë përjetësisht.
Sipas konventës për refugjatë politikë, ju nuk jeni aspak të detyruar të kërkoni azil politik apo Anex 26, ngase vini nga një vend ku zhvillohet luftë (luftë qoftë e nxehtë ose luftë e ftohët), që ju Belgjika ua mundëson qëndrimin edhe pa kërkuar strehim politik. Më ligjin më të ri në fuqi thuhet: të gjithë qytetarët e ardhur nga Bosnja - Hercegovina si dhe nga Kosova dhe viset e saj ( nga Republika e Kosovës), gëzojnë të drejtën e qëndrimit në Belgjikë me të gjitha beneficionet që i gëzon refugjati politik, derisa të rregullohet çështja politike dhe ekonomike në Bosnje dhe Kosovë, e ato janë: e drejta në PUNESIM, NË NDIHMA TË RREGULLTA MATERIALE, NË SHKOLLIM, NË SHËNDETËSI (pa pagesë) DHE NË SHTESA TË FËMIJËVE. Këto të drejta t’i shfrytëzoni edhe pa kërkuar strehim politik, por vetëm duke e kërkuar formularin Anex 3 në zyrën e Policisë së huaj, në Squarre de Meeuse nr 8, 1040 Bruxelles”.

***Komentimi i lajmërimit***

Këtë analizë po e bëj vetëm nga këndvështrimi im personal. Vetëm nga kureshtja e disave që kurrë nuk u ngopën duke folur dhe duke u marrë me thashetheme për Musa Hotin. Vetëm për ata që ushqehen nga burimet informative të shtypit të Beogradit dhe shërbimet e tyre sekrete. Vetëm për ata që edhe pas vdekjes nuk e lejojnë që shpirti i tij të pushojë i qetë dhe nga bota e përtejme “të përjetojë kënaqësinë” e pavarësisë së Kosovës. Po e shkruaj këtë libër vetëm për kohën që kam kaluar dekada të tëra duke qarë e qeshur bashkë

me Musën. Po shkruaj që ato kujtime të mira apo edhe të hidhura t'i përjetojmë bashkarisht me ju, lexues të nderuar. Po shkruaj që kujtimet e mia të mos shuhen me vdekjen time, siç iu shuan Musa Hotit kujtimet, për mua me vrasjen engimtaike të tij. Po shkruaj, jo për të ngritur apo zbritur dikë. Po shkruaj jo për ta ngritur figurën e Musa Hotit, por të zbardhi publikisht veprimtarinë e tij të shumëfishtë për çështjen kombëtare e veçmas çlirimin e Kosovës. Unë nuk mund ta çoj lart figurën e Musa Hotit, sepse ajo flet vetë. Për figurën e tij flet Musa Hoti vetë përmes dokumenteve të shumta të kohës të shkruara me dorën e tij.

Lexojeni lajmërimin e tij më lart dhe do të bindeni se si Musa Hotit i pikon zemra lot kur zbrazet Kosova. Musa Hotit i pikon shpirti lotë hidhërimi kur mërgimtarët tanë sorollaten rrugëve pa ditur t'i rregullojnë dokumentet e nevojshme për të marrë ndihma dhe strehim të përkohshëm. Musa qanë për bijtë e Kosovës, të cilëve ua shtrinë dorën e ndihmës dhe të fuqisë se tij. Musa Hoti nuk dëshiron që ata të marrin azil politik, sepse do të ngulën dhe kurrë më nuk do kthehen për të jetuar në Kosovë. Duke e shkruar këtë lajmërim duket se Musa Hoti po e sheh fundin e sundimit shekullor të Kosovës dhe u lutet kosovarëve në mërgim që, pas çlirimit, kthehuni në Kosovë! E ndonjëri ende mund të vazhdojë të merret me thashetheme dhe gazeta të Beogradit. Ende ndonjëri mund të vazhdojë të merret se kush ishte dhe çka ishte thuajse të gjitha punët tjera i kanë kryer dhe tani nuk u mbetet gjë tjetër vetëm t'i njollosin figurat më të ndritura. Merren me të kaluarën tonë edhe sot në Kosovën e çliruar e para hundëve të tyre i kanë kriminelët e Beogradit! Merren me të kaluarën tonë e sot vetë merren me biznese të pista në bashkëpunim ma ata që na vranë, që na dogjën dhe na masakruan! Vetëm merruni me ne, se historia një ditë do t'i dënojë rëndë. E dënimi i historisë është më i tmerrshmi, më i rrezikshmi, sepse është PERJETËSIA.

Musa u ndihmonte falas të gjithë atyre që e kërkonin ndihmën e tij. Kur rregullonte ndonjë familje, Musa gëzohej, po aq sa familja që ishte sjellur kot muaj të tërë pa bërë gjë.

Kur u drejtohej familjeve për sqarime rreth procedurës se rregullimit të dokumentacionit, ja siç u shkruan Musa Hoti.

**Brxelles 30 janar 1995**
**Zonjë e nderuar,**

Pas intervenimit që bëri bashkëshorti juaj në Shërbimin tonë Socialo-juridik, Salih Gjonbalaj, ne morëm kontakte më sherbimin adekuat lidhur më kërkesën tuaj për nënshtetësinë belge dhe pas disa bisedave telefonike, sot ua dërguam edhe një letër të dytë, të cilën po ua dërgojmë një fotokopje.
Besoj së shpejti shërbimi në fjalë do të ju shkruajë letër juve dhe kopjen e saj e dërgojnë edhe në Shërbimin tonë. Kështu që për çdo eventualitet dhe risi në dosjen tuaj, ne do të ju lajmërojmë më shkrim.
Në fund pranoni përshëndetjet tona të sinqerta ju dhe bashkëshorti juaj, me shpresë se problemi juaj do të rregullohet shumë shpejt.

As.soc. dhe Juridik
Musa Hoti

**S S E** *Service Social des Etrangers* a.s.b.l.

*Rue de la Croix, 22*
*1050 Bruxelles*
*Tél. : 02/649.99.58*
*Fax : 02/646.43.24*

Madame: COROLI EMINE
Rue Emile Verse, 10
1070 BRUXELLES

*Réf.*

*Bruxelles, le* 30 janar 1995

Zonjë e nderuar,

Pas interrvenimit që e bëri bashkëshorti i juaj në Shërbimin tonë Socialo-Juridik, Salih GJONBALAJ, ne morëm kontakte me Shërbimin adekuat lidhur me kërkesën tuaj për nënshtetësi belge dhe pas disa bisedave telefonike, sot ua dërguam edhe një letër të dytë, të cilën po ua dërgojmë në fotokopje.

Besoj se së shpejti shërbimi në fjalë do të ju shkruaj letër juve dhe kopjen e saj e dërgojnë edhe në shërbimin tonë,kështu që për çdo eventualitet dhe risi në dosjen tuaj, ne do të ju lajmërojmë me shkrim.

Në fund, pranoni përshëndetjet tona të sinqerta ju dhe bashkëshorti i juaj, me shpresë se problemi i juaj do të rregullohet shumë shpejtë.

As.Soc.dhe Juridik,
Musa HOTI

Service Social des Etrangers asbl –C.G.E.R. : 004–2505191–82 C.C.P. : 000–0979256–41

16.2

***Letër drejtuar një familjeje shqiptare me 30 janar 1995***

Musa Hoti me përkushtim e devotshmëri i kryente punët rreth familjeve shqiptare me probleme të ndryshme, por kjo i dukej pak.
Pak ishte për kapacitetin dhe mundësinë që t'i jepte kontributin më të madh çështjes kombëtare. "Pak është", thoshte Musa. Shpirtin dhe mendje e kishte në ngjarjet që ndodhnin në Kosovë.
Zemrën e kishte të simboli i rezistencës kombëtare që posa doli nga burgu iu kishte bashkangjitur grevës. E Musa nuk i pushonte shpirti, së paku, pa ia shkruar një letër përkrahëse Adem Demaçit që ishte futur në grevë.

**Bruksel , më 29 maj 1993**
**Simbolit të rezistencës kombëtare**
**dhe martirit ADEM DEMAÇI**
**Pallati i shtypit "Rilindja "**
**Prishtinë / Kosovë**

**Ju kishim në shpirt e në zemër edhe atëherë kur dirgjeshit në kazamatët e ish-Jugosllavisë, mirëpo mbetët në zemrat tona edhe sot, kur jeni të rrethuar më shkrimtarë, poetë, gazetarë e intelektualë të tjerë nga Kosova dhe viset e saj në grevën e urisë dhe në grevën gjenerale kundër shkallëzimit të armiqësisë famëkeqe çetnike të Beogradit që po ushtron dhunë mbi popullatën e pafajshme dhe liridashës.**
**Ishim dje, jemi sot, por do të jemi edhe nesër me Ju, të gatshëm deri në sakrificë e vetëmohim për të mirën e popullit nga i cili u lindëm dhe më të cilin jemi krenarë.**
**Shërbimi Socialo-Juridik në kuadër**
**të Ministrisë Frankofone në Belgjikë**
**Musa Hoti**

**SAF** *Service d'accueil et de formation - SSE asbl*

*Rue de la Croix, 22*
*1050 Bruxelles*
*Tél. : 02/649.99.58*
*Fax. : 02/646.43.24*

Réf. 909/93 Bruxelles, le 29 maj 1993

SIMBOLIT TE RREZISTENCES KOMBETARE
DHE MARTIRIT ADEM DEMAÇI

Pallati i Shtypit
"RILINDJA"
Prishtinë - KOSOVE

Ju kishim në shpirt e në zem¨er edhe at¨eherë kur dirgjeshit në kazamatet ish-jugosllave,mirpo mbetët në zemrat tona edhe sot kur jeni të rrethuar me shkrimtarë, poet, gazetarë e intelektual të tjerë nga Kosova dhe viset e saj në grevën e urisë dhe në grebën gjenerale kundër shkallëzimit të armiqësisë famëkeqe çetnike të Beogradit që po e ushton mbi popullatën tonë të pafajshme e liridashëse.

Ishim dje, jemi sot por do të jemi edhe nesër me Ju, të gatshëm deri në sakrificë e vetëmohim për të mirën e popullit nga i cili u lindëm dhe me të cilin jemi krenarë.

SHERBIMET SOCIALO-JURIDIKE NE KUADER
TE MINISTRISE FRANKOFONE NE BELGJIKE

*Service Social des Etrangers asbl - C.G.E.R : 004-2505191-82 - C.C.P. : 000-0979256-41*

89-1

*Letra përkrahëse dërguar Adem Demaçit nga Musa Hoti*
*Më 29 maj 1993 –Bruksel*

Çka mund të bënte më shumë Musa Hoti që të kontribuonte për Kosovën? Të digjej flakë si Jan Pallahu në Pragë?! Musa digjej thellë në brendësin e  shpirtit të tij, por kundërshtarët politikë nuk ia shihnin flakën. Nuk ia shihnin Musës vuajtjet e tij shpirtërore që vuajtjet e morave dhe vëllezërve në Kosovë që përjetonin nga çetnikët serbë, Musa i përjetonte si vuajtje personale të tij.




**Në foto: Musa Hoti & Reshat Sahitaj 1993 Bruksel**

Kush mund të dinte se Musa vuante kur ai vishej gjithnjë me kostum e me kravatë e gjithmonë ishte i qeshur.

Musa Hoti tërë mllefin e tij e zbrazte në punë duke u përpjekur që emri dhe kredibiliteti i tij t’i ndihmonte se pakut diku çështjes kombëtare

## *Angazhimi i Musa Hotit në LASH*

Vetëm me ardhjen e Meriman Brahës dhe Rexhep Osmanit, të cilët i dhanë përkrahje, Musa do angazhohej në LASH, dega në Belgjikë. Ardhja e Rexhep Osmanit u bë poashtu me ftesën e Behares kur ia organizuam kontakte të shumta në Parlamentin Europian (kësaj here në Strasburb, sepse atje mbahej sesioni) dhe një konferencë për mediat ndërkombëtare.

Musa Hoti do angazhohej më tërë qenien në riorganizimin e shkollës shqipe në Belgjikë.

Shkolla shqipe "Idriz Seferi" të cilën e kisha hapur më 1982 në bashkëpunim me Hazir , Hazirin, Musa Hotin e disa të tjerë dhe që më vonë u transferua në lokale tjera e më kryesi tjetër ku unë isha i padëshirueshëm për ata të që friksoheshin ta hapnin shkollën, filloi të zbehej.

LASH-i me në krye Osman Rexhepin kishte filluar të riangazhonte struktura të shkollave shqipe në diasporë. Aty ku kishte aktivitet Osmani i përkrahte dhe aty nuk ishte zbehur aktiviteti. Osmani krijonte struktura të reja siç ishte rasti në Bruksel. Shkolla shqipe "Bajram Curri" në Bruksel ishte nën përkujdesin e klubit "Idriz Seferi " e në mënyrë indirekte nga Ibrahim Kelmendi. Në këtë shkollë, që e drejtonte Riza Kondri, ndihmonte Sadik Tolaj dhe gruaja e tij Afërdita, tani e kishte humbur famën e viteve '80. Ky krah politik nuk ishte më LDK-n andaj edhe numri i nxënëseve ishte shumë më i vogël.

Në vitin 1993 Musa Hoti, me shokët e tij morën iniciativën të aktivizojnë LASh-in, pasi në përkrahje kishin Rexhep Osmanin që njëherit asokohe konsiderohej Ministër i Arsimit të Kosovës edhe pse nuk ishte i emëruar si ministër.

Këshilli iniciator për themelimin e LASH-it ishin Sami Rexhepi, Kujtim Hajdaj dhe Musa Hoti.

Dega e LASH-it për Belgjikë u emërua "Naim Frashëri".

E

**S T A T U T S**

M. Sami REXHEPI - Rue Le Lorrain 10 - 1210 Bruxelles - de nationalité Ex-Yougosllave - né le 01.06.1949. profession : enseignant - Carte d'identité numéro : F.O.059.21.
M. Kujtim HAJDAJ - Av. Louis Bertrand 105 - 1030 Bruxelles - de nationalité Ex-Yougosllave- né le 20.06.1962. profession enseignant - Carte d'identité numéro : F.P.4.026.397.
M. Musa HOTI - Bezemstraat 85-71 - 1600 Sint-Pieters-Leuw réfugié de l'O.N.U. - né le 11.07. 1946 - profession employé.

En application de l'article 6 de la constitution de la République du Kosova et de l'article 13 de la Constitution de l'Albanie, les enseignants en Belgique sont convenus de créer, conformément à la loi du 27 juin 1921 une associations sans but lucratif dénommée LASH "NAIM FRASHERI" section en Belgique en français "Ligue des Enseignants albanais" avec le siège mère se trouvant à Prishtina - Kosovë.

**Titre I : Dénomination et siège social.**

**Article I :**
L'association est dénommé LASH "NAIM FRASHERI" (La ligue des enseignants albanais) "NAIM FRASHERI".

**Article II :**
Son siège social est établi à Bruxelles à l'adresse suivante : Rue le Lorain 10 - 1210 Bruxelles.
Cette adresse peut être déplacée en tout autre endroit désingé par le conseil d'administration.

**Article III :**
L'association est une section dont le siège mère se trouve à Prishtina qui limite le caractère autonome et indépendant.

**TITRE II : Objet.**

**Article IV :**
L'association a pour objet en dehors de tout esprit de lucre :
1) de réaliser un enseignement complémentaire de langue albanaise et les activités en découlant (culturelles et autres) destiné à la population albanaise vivant en Belgique.
2) Collaborer avec d'autres organismes, clubs, associations ou écoles pour l'organisation d' activités communes.
3) L'association éditera une revue culturelle et pédagogique en regroupant des articles de langue albanaise réflétant la vie et les pensées de notre communauté.

**TITRE III : Associés.**

**Article V :**
L'association est composée des membres effectifs et sympatisants les compsants aux présents satatuts sont membres effectifs.

**Article VI :**
Les admissions de nouveaux membres tant effectifs que sympatisants sont désignés souverainement par le Conseil d'administration.

MONITEUR BELGE
DIRECTION
-2.-8-1993
BELGISCH STAATSBLAD
BESTUUR



-4-

Article XVII :

Les adminstrateurs se contactent, en raison de leur fonction, aucune obligation personnelle et ne sont responsables que de l'exécution de leur mandat. Celui-ci est amené à titre bénévole.

Article XVIII :

Le conseil d'administration se compose de :

Président : M. Sami REXHEPI

Vice-Président : M. Kujtim HAJDAJ

Vice-Président : Mme Rukije RAMA

Secrétaire administratif : M. Musa HOTI

Trésorier : Mme Brumilda 9elmeta

Membres du conseil :
- Imer Gjonbalaj
- Shani Bujupi
- Jusuf Zenunaj
- Aziz Zekoilli.

MONITEUR BELGE
DIRECTION
-2.-8-1993
BELGISCH STAATSBLAD
BESTUUR

***Kopje nga origjinali i statutit të LASH-it , me 02/08/1993***

LASH ishte i përbërë nga kryesia ku bënin pjesë Sami Rexhepi, Kujtim Hadaj, Rukije Rama dhe Musa Hoti. Anëtarë të tjerë të kryesisë ishin Imer Gjonbalaj, Shani Bujupi, Jusuf Zenunaj dhe Aziz Zekolli.
Kryesia e degës së LASH-it "Naim Frashëri" në Bruksel ishte e tëra me intelektualë dhe me njerëz të shkolluar që kishte dallim me kryesit tjera të deritashme.
Me angazhimin e Musës dhe të kryesisë së re mësimi plotësues në gjuhën shqipe filloi të merrte përmasa në të tërë territorin e Belgjikës. Në çdo qytet të madh në Belgjikë u organizuan shkollat shqipe të degës "Naim Frashëri" vetëm në qytetin Anver vazhdonin mësimin shqip 35 nxënës që, në shkollën e Brukselit të sistemit të

vjetër nuk kishte as sa gjysma e një qyteti më të vogël të Belgjikës. Çuditërisht sa herë që festohet themelimi i shkollës shqipe në Belgjikë, gjithnjë ia fillojnë nga zero, që do të thotë e injorojnë vitin 1982 sikur asgjë të mos kishte ndodhur, por të vetëdijshëm se emri i shkollës së parë “Bajram Curri” ishte bërë nga unë.
Në secilin përvjetor çdo gjë e fillojnë nga ata që e organizojnë dhe ashtu siç atyre u konvenon. Askund nuk e përmendin Musa Hotin, emrin e të cilit do ta gjejnë në dokumentet e tyre që i kanë pranë. Jo, nuk përmendemi ne sepse ne dëshirojmë që çdo gjë të fillojë nga ne dhe historia të shkruan për ne.
Dega e LASH-it “Naim Frashëri” në Bruksel mbante mbledhje zgjedhore çdo vit dhe aty zgjidhej kryesia e re me emër të ri që donin të kontribuonin në mësimin e gjuhës shqipe nxënësve shqiptar nga të gjitha trojet tona etnike. Aty me devotshmëri punonte Rukije Rama, Zejnepe Rexhepi, Myrvete Hoti e shumë femra e meshkuj që në Kosovë kishin përfunduar fakultete.

L A J M E R I M

Lajmërojmë punëtorët e arsimit të të gjitha profileve,intelektualët e fushëve-primeve të ndryshme,punëtorët kulturorë e shkencorë,anëtarët e Shoqatave,klubeve, bashkësive fetare dhe të partive politike,prindërit si dhe të gjithë dashamirët e arsimit dhe të kulturës shqiptare se më 28 maj 1994 do të mbahet mbledhja e KUVENDIT ZGJEDHOR të LIDHJES SE ARSIMTAREVE SHQIPTARE "NAIM FRASHERI"-dega në Belgjikë.

Mbledhja është e hapur për të gjithë dhe organizohet në sallën "LA PAIX" në adresën:PLACE DE LA PAIX,2 në 1140 EVERE (pas Tavernës me të njejtin emër dhe shkohet me tramvajin numër:55),duke filluar në ora 18,oo.

Qëllimi i mbajtjes së kësaj mbledhjeje përkon me orvatjet e shtuara të Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë "NAIM FRASHERI"-dega në Belgjikë për të zhvillu-ar në nivel të kohës përmbajtjet dhe metodat e reja të punës në arsimin e mësimit plotësues në gjuhën shqipe në hapësirat ku jetojmë dhe veprojmë. Për këtë mbledhje parashihet të trajtohet ky

R e n d d i t e:

1.Zgjedhja e anëtarëve të Kuvendit zgjedhor;
2.Zgjedhja e KRYESISE së LIDHJES SE ARSIMTAREVE SHQIPTARE "NAIM FRASHERI" - dega në Belgjikë;
3.Eventuale.

Të dhënat e fundit të marra nga Enti Pedagogjik i REPUBLIKES SE KOSOVES janë mjaft alarmuese.Në dy vitet e fundit vetëm nga KOSOVA janë shpërngulur afro 40.000 filloristë, 7.000 nxënës të shkollave të mesme dhe 1.800 mësimdhënës.Në këto shifra nuk janë përfshirë të dhënat statistikore,nga se na mungojnë,për shpërnguljet nga shteti amë,Maqedonia,Mali i Zi,Presheva,Bujanovci e Medvegja.Kjo flet se fëmijëve tanë në diasporë u kanoset rreziku serioz nga rrymat e fuqishme asimiluese.

Për të evituar këtë të keqe të madhe,që u shkon për shtati vetëm vandalëve sllavë,Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë e sheh të udhës që të riorganizohet mbi bazat e shëndosha të preferuara nga shkencat bashkëkohëse didaktiko-pedagogjike,duke u përtrirë në këtë drejtim si në pikëpamje kadrovike ashtu edhe në anën organizative.

Supozojmë se vetëm në këtë mënyrë do të mund t'i ndalet hovi politikës ditore e imponuar nga njerëzit të pakompetencë,grupet joprofesionale,bisedave të rrugëve dhe të kafeneve,zëdhëndësit dhe gjurmuesit e njollave të zeza si dhe të atyre që janë të prirur të sabotojnë çështjet me peshë të rëndësishme kombëtare.

Pjesëmarrja juaj shpresojmë se kësaj mbledhjeje do t'i jap seriozitetin e nevojshëm dhe impulse të mirëfillëta pune.

Më 14 maj 1994

DEGA E LIDHJES SE
ARSIMTAREVE SHQIPTARE
NE BELGJIKE

***Një lajmërim lëshuar nga LASH, dega Naim Frashëri", Bruksel 14 maj 1994***

Musa Hoti, pasi që punonte në qendrën socialo-juridike, kishte mundësi më të mëdha për t'u angazhuar edhe në planin juridik të shkollës shqipe. Musa u shkruante letra ministrisë dhe

personaliteteve me influencë politike që shkollat e qyteteve të ndryshme t'i hapnin lokalet të shtunave për nxënësit shqiptarë.

*Vice-Premier Ministre*
*et Ministre des*
*Affaires Etrangères*

1000 BRUXELLES.
Rue des Quatre Bras 2 - Tél. 02/516.82.11

LE MINISTRE
PGeo.02-91.10-00132

Madame Anne-Marie LIZIN
Député-Bourgmestre
Chaussée d'Andenne 6
4500 HUY

**COPIE POUR INFORMATION**

Madame le Député,
Chère Anne-Marie,

Ta lettre du 1er avril 1993 concernant la situation au Kosovo a retenu toute mon attention.

Je partage entièrement tes préoccupations concernant les problèmes au Kosovo, qui constituent un élément clé de la situation dans l'ex-Yougoslavie.

La Belgique s'est efforcée de participer à chaque initiative déployée par les organisations internationales en vue de réduire les tensions dans cette province. Nous soutenons en particulier les initiatives prises dans le cadre de la Conférence de Genève et dans celui de la Conférence pour la Sécurité et la Coopération en Europe tels que le Groupe de Travail spécial sur le Kosovo et la mission de longue durée de la CSCE dans cette région. De plus, nous avons, à maintes reprises, condamné les violations des droits de l'homme et les accords qui y sont relatifs.

La Belgique s'est toujours exprimée en faveur d'une restauration de l'autonomie du Kosovo au sein de la Serbie-Monténégro, dans le strict respect des droits de l'homme de chaque minorité. Aussi, elle s'est opposée à toute ingérence des pays tiers, et à tout changement des frontières par la force.

La Belgique est prête à soutenir toute autre action préventive pour prévenir une explosion de violence au Kosovo.

Je te remercie vivement pour les noms des représentants de la Communauté albanaise. Ils ont déjà eu des contacts à plusieurs reprises avec les responsables de mon Département, et en particulier avec Mr. R. DEVRIESE qui sera chargé des aspects multilatéraux du conflit yougoslave pendant la présidence belge.

Je te prie de croire, Madame le Député, chère Anne-Marie, à l'expression de mes sentiments les meilleurs.

p.o.

L. WILLEMS
Chef de Cabinet

Willy CLAES

**SHENIM:**

Z. **MERIMAN BRAHA** ,pas bisedimeve që i bëmë me Bashën,Zekollin dhe unë, Zonja Anne-Marie **LIZIN** (parlameztare Evropiane në komisionin për ish-Jugosllavinë), i ishte drejtuar me një shkresë të veçantë Ministrit te Punëve të Jashtëme të Belgjikës lidhur me problemet aktuale në Kosovë dhe kjo është përgjigjja e Ministrit të P;të Jashtëme Willy CLAES që i drejtohet zonjës deputete në Bashkësinë Evropiane.
Pasi e formuam LASH-in dega në Belgjikë,për çka me siguri jeni në dijeni, presim autorizime me shkrim që të marrim kontakte me ministritë e arsimit frankofon dhe atij flaman, me kërkesat e njohura më parë si dhe parapregaditjen e ardhjes së Minist)risë së Arsimit të Republikës së Kosovës në Belgjikë. Autorizimet mund t'i drejtoni edhe me fax këtu në punën time, meq puna në Qendër të Kulturës është pezulluar derisa të gjindet vetëm një zyre (pa karrika e pa tavolina për pije!): 322-646-43-24 drejuar ose Q.K.SH. ose në emërin tim;M.H.

P¨ersh¨endetje dhe respekt,

M.H.

***Letër nga kryeministri i Belgjikës dërguar deputetes Anne Marie Lizin për shqiptarët***

Që shkollat shqipe në Belgjikë të njiheshin zyrtarisht nga shteti belg, Musa Hoti e kishte kontaktuar zonjën Anne Marie Lizin, e cila ishte përkrahëse e madhe e çeshtjes sonë kombëtare. Zonja Lizin, pas kontaktit me grupin e shqiptarëve të drejtuar nga Musa Hoti, i drejtohet me shkrim kryeministrit që të intervenonte për problemin e parashtruar nga grupi të cilët i kishte pranuar në audiencë.
Në këtë kopje të letrës, që janë dy faqe, kryeministri i Belgjikës i përgjigjët zonjës Lizin se ai është i preokupuar me problemin e shqiptarëve dhe se Belgjika në çdo takim të rëndësishëm ndërkombëtar merr iniciativë që të dobësohet presioni që u bëhet shqiptarëve.
Musa Hoti posa mori përgjigjën e kryeministrit, drejtuar zonjës Lizin, kopjen ia dërgoi Meriman Brahës, që ishte njëherit me Rexhep Osmanin në vizitë pune në Belgjikë.
Ja se ç'shkruan Musa Hoti në letrën, drejtuar Meriman Brahës:

## *MERIMAN BRAHËS*

"Meriman Braha, pas bisedimeve që bëmë, unë, zonja Lizin (parlamentare Europiane në komisionin për ish-Jugosllavinë) i ishte drejtuar me një shkresë të veçantë Ministrit të Punëve të Jashtme të Belgjikës, lidhur me problemet aktuale në Kosovë dhe kjo është përgjigjja e Ministrit të Punëve të jashtme Willy Claes që i drejtohet zonjës deputete në Bashkësinë Europiane.
Pasi e formuam LASH-in, dega në Belgjikë, për çka me siguri jeni në dijeni, presim autorizim më shkrim që të marrim kontakte me ministritë e arsimit frankofone dhe atyre flamane, me kërkesat e njohura më parë si dhe përgatitjen e ardhjes së Ministrit të Arsimit të Republikës së Kosovës në Belgjikë. Autorizimet mund t'i drejtoni edhe me fax këtu në punën time, më që puna në Qendër të Kulturës është pezulluar derisa të gjendet një zyrë ( pa karrige e pa tavolina për pije! ) : 0032 646 43 24, drejtuar ose QKSH ose në emër tim M.H.

**Përshendetje dhe respekt**
**M.H.**

Bazuar në këtë letër në Belgjikë ishte krijuar edhe Qendra Kulturore Shqiptare. Musa Hoti ishte poashtu i angazhuar në këtë qendër, por nuk kishte ndonjë aktivitet që vlen të përmendet ngase edhe vetë Musa e pranon. Në letrën e tij, drejtuar Meriman Brahës shkruan se qendra është pezulluar dhe po kërkohet një lokal pa karrika dhe pa pije. Fjalët e Musës “Pa karrika”, unë do t’i zbërtheja pa poste, sepse aty ku ka poste ka xhelozi dhe intriga. “Pa karrika “ ishte se vetë Meriman Braha kishte vërejtur se në Bruksel disa kishin pretendime të merrnin poste kuçe në Kosovë, e Merimani i kishte kritikuar pikërisht të tillët. Kurse fjalët “Pa pije” do t’i interpretoja se Musa nuk kishte dëshirë të shkonte në takime pune e aty të pihej aq sa harronin për çka ishin mbledhur.
Përveç Qendrës Kulturore Shqiptare, ku Musa bënte pjesë, paralel kësaj u krijuan Bashkësia Shqiptare në Belgjikë si dhe shumë “këshilla”, “komitete” e organizma, që shërbenin vetëm sa për të pasur arsye të dilnin lirshëm prej grave të tyre e të deheshin me raki rrushi. Ishte edhe një arsye tjetër se, sa herë ne organizonim ndonjë manifestim, duhej patjetër të fusnim në këshillin organizues edhe të tillët që thirreshin në emër të gjithë shqiptarëve. Duhej vetëm e vetëm të dilte një njeri më shumë në demonstrata kundër represionit që Serbia bënte mbi popullsinë tonë të pafajshme.
Po të lexohen programet e tyre disafaqëshe, njeriu i sotëm do trullosej nga habia se sa punë qenka kryer. E nëse kërkohej se cila ishte ajo punë kombëtare e kryer ? S’ka përgjigje.
Bashkësitë e tilla shqiptare edhe pa shqiptarë donin të na mbanin nën kontroll aktivitetet e ndryshme kombëtare që, më pastaj, të mburreshin se ishin aktivë. E kush mund ta mbante nën kontroll Byronë Informative të Kosovës që çdo ditë ishte në kontakte me personalitetet më të shquara të Europës. Askush! Andaj në këtë libër nuk dua t’i lodh lexuesit me emra pompoze të organizatave që nuk ishin aktive. Nga kjo nuk duhet nënkuptuar se ata nuk bënë

asgjë. Jo, ata punuan dhe vetëm ata mund të shkruajnë për veprimtarinë e tyre.! Çdo gjë që unë shkruaj për ta nuk ia vlen, sepse nuk isha i kyçur aty.

## *Musa Hoti dhe trepërqindëshi !*

Me tensionimin  e situatës në Kosovë, sidomos me shpërthimin e luftës së hapur, edhe më indiferentët tani po zgjoheshin nga kllapia dhe iluzionet së Jugosllavinë nuk kishte fuqi që ta shkatërrojë. Pasi u ndanë Sllovenia e të gjitha tjerat, radhën  e kishte Kosova të shkëputej nga sundimi i huaj.
Lëvizja e Sabri Novoselles dhe e Musës, Punëtorët e Hysen Gërvallës dhe të Musës u shuan për t'u shkrirë aty ku ishte vendi i shumicës.
Lëvizja e Ibrahim Kelmendit, që nga viti 1990 ishte dobësuar. Por më vonë me plasjen e luftës në Kosovë, që pikërisht ishte kontribut i Lëvizjes së Ibrahimit, Emrush Xhemailit, Bardhyl Mahmutit e shumë të tjerëve u forcua, aqsa i doli përballë LDK-s, forcës më të madhe në vend dhe diasporë. Në Bruksel të gjitha aktivitetet e organizatave shkriheshin njëra pas tjetjrës ose në LDK ose në LPK. E vetmja ishte Byroja Informative e Republikës së  Kosovës, që e udhëheqtë Beharja, që qëndronte. Secila pej këtyre dy forcave të mëdha e ndjenin nevojën e Beharës dhe timen për t'u organizuar takime të niveleve të larta Europiane. U bënim kontakte personaliteteve si Rugova , Bukoshi e tjerë të këtij krahu,por kur ky krah nuk e përkrahte luftën e UÇK-s, ne i bënim kontakte edhe Fazli Veliut të krahut të Ibrahimit të LPK-së e Bardhyl Mahmutit e Thaçit. Për ne nuk ishte e rëndësishme të grindeshim mes veti, por që çeshjta e Kosovës të shkonte përpara.
Musa Hoti në këtë kohë ndarjesh u gjend në krahun e LDK-së, por jo në funksione të rëndësishme. Musës iu besua sektori i mbledhjes së ndihmave të 3% -isht.

GRUPI I EMERGJENCES NE BELGJIKE

( shenime nga procesverbali nr.2,te dt.3o maj'98 )

---

Ne mbledhjen e Grupit te Emergjences ne Belgjike (mbajtur me 30 maj 1998,ne lokalet e LDK-se per Beneluks ),veç tjerash,riorganizoi,perkatesisht themeloi <u>Komisionin per ndihma humanitare</u>,ne kete perberje:

1. Esat Gashi (Anvers),.........tel.o3/648.50.21,
2. Shaip Gashi(Provinca e Limburgut).....tel.o12.74.54.97.([illegible])
3. Hajdin Bela(Vavre)................tel.oll.24.47.54.
4. Musa Hoti (BXL)...................tel.
5. Ramiz Beqa (Namur).........me kerkesen e tij eshte lirua
6. NUhi Zeqiri (Tielt).........tel.
7. Kujtim Lushaj (BXL)........tel. 0477/256783

---

Bruksel,

18 qershor 1998

Per Grupin e Emergjences

Musa Alaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

QEVERIA E REPUBLIKËS

**FONDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BELGJIKË**

**GRUPI I EMERGJENCËS PËR BELGJIKË**

Chaussée de Gand, 391B - 1080 Bruxelles

TEL. : 02/410.78.59 FAX : 02/410.87.46

**AUTORIZIM**

Autorizohet zonja, zotëriu **Musa Hoti**

nga **B-1070 Bruxelles**, Adresa : **Rue Joseph Pavez, 19**

,si anëtar i Komisionit për ndihma financiare që në kuadër të aksionit **"Ndihmë për Kosovën"**, të grumbullojë mjete financiare nga bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në territorin e Belgjikës.

Bruksel,

03.06.1998

Kryetari i Fondit për Belgjikë

Arif Sadikaj

REPUBLIKA E KOSOVËS
FONDI PËR FINANCIMIN E QEVERISË
BELGJIKË - LUKSEMBURG
391B CHAUSSÉE DE GAND
B-1080 BRUXELLES

***Lista e anëtarëve të grupit të emergjencës për ndihma Kosovës, 18 qershor 1998***

Në një anë ishte fondi “Vendlindja thërret”, në tjetrën anë qeveria kishte organizuar të gjitha strukturat që sa më shumë të mblidhte para. Fondi i qeverisë mundohej të përfitonte autoritetin e secilit personalitet në mënyrë që secili të ndikonte në rrethin e tij të ngushtë familjar e shoqëror. Fondi i qeverisë po dobësohej, sepse ishte tjetri, “Vendlindja thërret” që bashkatdhetarët jepnin ndihma për Kosovën. Një grup i quante tradhtarë ata që i jepnin ndihmat e tyre qeverisë, sepse thuhej se me pacifizëm nuk çlirohet kurrë Kosova,e në anën tjetër të qeverisë thonin se ata ishin dorë e zgjatur e Serbisë. Mërgimtarët tanë jepnin pak në fondin e “Vendlindja thërret” e pak në atë qeverisë. Kur i pyesje, ata përgjigjeshin varësisht se kush i pyeste: të ishe i LDK- së i tregonin faturën se kanë kontribuar; të ishte i krahut të Lëvizjes ua tregonin faturën tjetër te “Vendlindja thërret”.
Drejtor i Fondit të 3%- ishte Sadik Arifaj, ndërsa kryetar i Grupit të Emergjencës Musa Alaj; ndërsa si kryesi e këtij grupi ishin Esat Gashi, Shaip Gashi, Hajdin Bela, Musa Hoti, Ramiz Beqi, Nuhi Zeqiri dhe Kujtim Lushaj.
Struktura e grupit për grumbullimin e ndihmave ishte në përbërje edhe të emigrantëve nga Shqipëria, siç është Ramiz Basha. Tani për ta dobësuar fondin “Vendlindja thërret”, njerëzit nuk i quanin zogista apo ballista, por vetëm grumbullo të holla dhe rri aty ku je. Po ta bënim seleksionimin e individëve në baza ideologjike parat e mërgatës fluturonin drejt fondit tjetër.
Kurse krahu tjetër kishte seleksionim, madje këta as nuk pranonin para prej atyre që kishin formuar bindje të këqija për dikë. Kryesia e fondit “Vendlindja thërret” nuk pranonte para të atyre që “i kanë duart e përlyera më gjak”! Nuk pranonin para të atyre që ishin bashkëpunëtorë të Serbisë. Kishin të drejtë, por tani në Kosovën e çliruar, gjërat nuk janë ashtu si dikur flitej.

## *Musa Hoti dhe shtypi shqiptar*

Atentati i Musa Hotit në Bruksel më 4 gusht 1981 bëri jehonë në shtypin jugosllav. Përmes shtypit jugosllav, sidomos përmes agjencisë së lajmeve “Tanjug , shqiptarët në viset e ndryshme njoftoheshin për aktin e Musa Hotit. Pavarësisht se ç’shkruante shtypi i Beogradit, për shqiptarët ishte më rëndësi që ata dëgjonin se një shqiptar paska vrarë serbë. Një shqiptar që jetonte Belgjikë e paska vrarë trupin diplomatike të Jugosllavisë, që tjerët vetëm kur dëgjonin frikësoheshin t’ia përmendin emrin. Mësonin se Musa Hoti i kishte vra në qendër të kryeqytetit Europian e krejt i qetë kishte dalë nga lokali, duke i lënë të shtrirë tre serbët e ambasadës së Beogradit në Bruksel. Shqiptarëve nuk i interesonin artikujt e serbëve që shkruanin se Musa Hoti kishte shtirë me revole pas shpinës së serbëve, ata, nga fjalët që përcilleshin gojë më gojë e mësonin realitetin se Musa e kishte vra ballë për ballë dhe plumbin ia kishte dhënë drejt e në kokë. Ishte vrasje pikërisht sipas traditës dhe zakoneve të kanunit të Lekë Dukagjinit. Musa zbrazi vetëm dy plumba dhe la tri viktima serbe.

Shtypi në Kosovë nuk kishte guxim të shkruante artikuj autorialë, sepse rrezikonin vetën dhe familjet e tyre. Prishtina shkruante vetëm ashtu siç shkruante “Tanjugu”.



# TERRORISTI MUSA HOTI NË AZIL PËR TË SËMURIT MENTALË

## Ai më 1981 vrau në Bruksel Stojan Gjeriqin, nëpunës i ambasadës sonë

Bruksel, 24 mars (TANJUG)

Terroristi antijugosllav, Musa Hoti është vendosur në azilin psikiatrik. Kështu konfirmoi sot gjyqi belg i apelacionit, duke ven dosur për ankesën e Hotit, i cili kërkoi të gjykohet ose të lirohet.

Sikurse dihet, Musa Hoti natën midis 3 e 4 gushtit të vitit 1981 vrau në kafenenë e Brukselit „Vajt Hors" nëpunësin e ambasadës jugosllave, Stojan Gjeriqin dhe njëkohësisht plagosi Rexho Zukën, gjithashtu me punë në përfaqësinë tonë zyrtare. Terroristi menjëherë iku nga vendi i krimit, por pas disa ditë fshehjeje në Bruksel iu dorëzua policisë.

Prokuroria e Brukselit pas hetimeve të gjata vendosi që Musa Hotin të mos e nxjerrë para gjyqit, duke vlerësuar se në momentin e krimit ishte i sëmurë mentalisht. Mirëpo, meqë njëkohësisht u konkludua se ai ende është i rrezikshëm për rrethin, prokuroria mori vendim që Musa Hoti të vendoset në ndonjë azil të këtushëm për të sëmurit mentalë. Ndërkaq, ai iu ankua së pari gjyqit të shka llës së parë e pastaj edhe gjyqit më të lartë, gjyqit të apelacionit, por që të dy instancat gjyqësore vërtetuan vendimin e prokurorisë.

Pa dyshim, për Musa Hotin kjo zgjidhje ka karakter të përkohshëm, me vazhdim të paqartë, për ç'arsye edhe përpiqej të nulonte vendimin e prokurorisë. Kërkesën e vet, e argumentoi edhe me mendimin e një eksperti, i cili dallonte nga konstatimet e ko legëve zyrtarë të tij. Këtu përkujtohet se Musa Hoti para se të bënte krimin punonte në një uzinë për larjen e automobilave.

***"RILINDJA" për Musa Hotin***

Dihej se në ato kohë ka qenë vështirë të jesh redaktor i lajmeve dhe të mos u hyje në qejf sistemit, por kishte edhe redaktorë të tjerë, të cilët kanë preferuar të punojnë për të jetuar e jo për të bërë karrierë Asokohe Musa Hoti ka pasur anëtarët e familjes së tij në televizonin e Prishtinës si Bejto Jusufin, icili për bashkëshorte ka Melihatën

motrën e Musës. Bejto Jusufit i kujtohet ende kur në televizion vjen lajmi se Musa Hoti e kishte vra trupën diplomatike jugosllave në Bruksel. Ja se si i kujton Bejto Jusufi ato çaste të vështira dhe tejet të ndjeshme si për familjen e Musës, ashtu edhe për të tjerët:
Ne atë kohë, perpos meje ne TVP ishte i punësuar daja i Musa i Hotit, Xajë Jashari nga Strofci, tani dëshmor i kombit. Xaja punonte ne Pres Qender, aty ku mbërrinin lajmet e para dhe atij i bie ne dorë në formë të shkruar lajmi për veprën e Musa Hotit. Ai mënjëherë më kontakton mua për t'u marrë vesh si të veprohet. Kontaktuam redaktorin e programit informativo-poloitik për t'a njoftuar se e njohim personin dhe familjen e tij. Kërkuam që lajmi të mos jepej si lajm i parë, por diku në mes.  Redaktori në fjalë na u përgjigj: “Ky person është terrorist dhe armiku numër një i Jugosllavisë. Prandaj me këtë njoftim do të hap rubrikën e lajmeve të ditës. Disa redaktorë të programit informativo-politik u vunë në garë se cili do ta bënte komentin më të fuqishëm për t'i hyrë në hatër UDB-s”.
Shikuar nga prizmi objektiv, gazetarët dhe redaktorët tanë në Kosovë, në vete të tyre me sigurinë më të madhe kanë ndjerë simpati dhe gëzim kur Musa kreu vrasjen, por pse të rrezikonin tërë familjen për një artikull, që edhe ashtu populli informohej. Mendoj se shtypi i asaj kohe në Kosovë ka vepruar konformë rregullave të imponuara nga Beogradi; në të kundërtën do bënin që t’i mbyllnin gazetat shqipe dhe televizionin, siç vepruan zyrtarët e Beogradit dhjetë vjet më vonë.
Me këtë rast akuza më e madhe i bie Tiranës zyrtare, e cila nuk dha asnjë kronikë në radio, në emisionin e saj në të gjitha gjuhët më të rëndësishme të botës; nuk u shkrua asnjë fjalë në gazetat e tyre, madje, as në qarqet e ngushta intelektuale nuk guxohej të përmendej Musa Hoti. Ndërsa në qarqet intelektuale të Prishtinës emri i Musës përmendej me simpati.

*Haqif Mulliqi zëdhënës i figurave emblematike*

Me kalimin e kohës, me  tensionimin e situatës në Kosovë, ngjarja e Musa Hotit po shkonte drejt harresës. Gjeneratat e reja, që po vinin, as që kishin dëgjuar se dikush dikur kishte vra në qendër të Brukselit një pjesëtar të trupit diplomatik të Serbisë. Në mesin e kësaj gjenerate të re po rriteshin e  shkolloheshin shumë të rinj, që traditë e kishin patriotizmin. Këta studentë të ri, duke u interesuar për të kaluarën e lavdishme të historisë kombëtare dhe për figurat e saj, me dashje a pa dashje ndesheshin në emrin e Musa Hotit. Në mesin e këtyre entuziastëve me ide kombëtare ishte edhe i riu Haqif Mulliqi, më të cilin ende i ri isha takuar më të. Takimi me Haqifin u bë në rrethana specifike. Në takimin tonë ishte edhe Enver Hadri, që pas ndarjes e vlerësoi si djalë me të ardhme në çështjen kombëtare. Lidhur më këtë rast kam shkruar në librin "Idealistët 1".
Më vonë Haqif Mulliqi do të bëhej zëdhënës i të gjithë atyre shqiptarëve që vepruan dhe sakrifikuan në diasporë dhe brenda në Kosovë. I vetmi ishte Haqif Mulliqi që pati guxim asokohe të botonte shkrime autroiale për Vehbi Ibrahimin,  Enver Hadrin, Musa Hotin, Rexhë Karaliun e Hysen Karaliun, Hysen Xhelilin, Xhafer Shatrin e për  shumë të tjerë.
Tani disa kopjues dhe deformues të artikujve të Haqif Mulliqit dhe nga artikujt e mi, dëshirojnë ta rishkruajnë historinë e ngjarjeve të kalaura. Haqif Mulliqi bëri shkrime sa ishte Musa Hoti gjallë, duke e intervistuar zërin e Musës që rrëfente për jetën dhe aktin e tij.
Haqif Mulliqi sa ishin gjallë Hysen Xhelili e Xhelë Kalishta shkoi në Bruksel dhe i regjistroi rrëfimet e tyre të ngjarjeve që ata kishin kaluar gjatë Luftës së Dytë. Tani të tjerët që dëshirojnë të përfitojnë materialisht dhe "famë" mund të shkruajnë, por nuk mund të thonë asgjë më shumë se çfarë ka shkruar Haqifi.
Nuk ka asnjë dyshim se Haqifi me guximin e tij intelektual ishte zëdhënësi më i fuqishëm i figurave emblematike të shqiptarëve që vepronin për çështjen kombëtare. Nuk ishte e lehtë të rrije me Musa Hotin e të ktheheshe në Kosovë për të shkruar për vrasjen që ai e

kishte kryer në Bruksel. Nuk ishte e lehtë të takohej me mua e të shkruante për veprimtarinë time dhe të Enver Hadrit e të jetoje çdo ditë më frikë se kur policët serbë do të arrestonin. Haqif Mulliqi ishte ai që i pari mori guximin të shkruante për aktivitetin e Enver Hadrit. Duke i lexuar shkrimet e Haqifit figura e Enver Hadrit forcohej gjithnjë e më tepër ndër shqiptarët. Kurrë më parë opinioni ynë nuk ishte i njohur objektivisht për veprimtarinë tonë kombëtare. Ishte penda e e guximshme e Haqifit që e njoftonte opinionin tonë në mënyrën më të afërt për ato që zhvilloheshin në diasporë.

# RRËFIM

Musa HOTI, një prej emigrantëve politikë shqiptarë më të njohur në Europën Perëndimore

*“As sot e kësaj dite nuk e kam të qartë se si ia dola që me dy plumba ta vras një dhe t’i plagos tre serbët që më sulmuan”*

***Nga Haqif MULLIQI***

Ishte fundi i viteve të shtatëdhjetë. Tendosjet politike në Kosovë ishin shtuar vrullshëm, ashtu siç ishin shumëzuar edhe organizimet ilegale politike këtu. Kushtetuta e vitit 1974, edhe pse e kishte lehtësuar barrën e robërisë së shqiptarëve të Kosovës, në asnjë mënyrë nuk e kishte plotësuar as së afërmi aspiratën e tyre për t’u vetëqeverisur në truallin e tyre amnor. Fundja, po aq sa ishte “liberalizuar” jeta në Kosovën e autonomizuar, po aq, do të thosha, karshi organizatave ilegale që ishin konsoliduar dukshëm, këtu ishin shumëzuar edhe elementet e UDB-s, edhe ndër shqiptarët, të cilët me “syçeltësinë” e tyre mundoheshin ta fokusonin e më pas ta paralizonin çdo shqiptar i cili pandehej se mund të dilte nga klishetë i realitetit të instaluar kosovar nën kornizat politiko-policore.
Kështu, mu në të sosur të asaj dekade, në Mitrovicë edhe arsimtari Musa Hoti, i cili, disa herash në ambiente me më shumë njerëz, kishte shfaqur pikëpamjet e tij politike. Prandaj e hetonte UDB–ja dhe bashkëpunëtorët e saj kishin filluar ta thurin rrjetin e merimangës rreth tij, për çfarë, ky, një natë, gati beftë për të gjithë, vendos që të marrë botën në sy dhe ta mësyjë Brukselin, vendin ku atëbotë kishte më së shumti emigrantë politikë shqiptarë dhe ku Musai, vetëm pak vjet më vonë, do të përjetojë një ndodhi e cila e bëri të njohur, të thuash në gjithë botën shqiptare, nga një kënd në këndin tjetër të rruzullit. Se cila është kjo ngjarje, besoj se më së miri do ta mësojmë në këtë rrëfim ekskluziv të zotit Hoti, të cilin e shënuam këtyre ditëve në Prishtinë.

***Shtresat e emigracionit politik në Belgjikë***
***që prej Pasluftës së Dytë Botërore dhe në vijimësi...***

"Kam qenë punëtor i arsimit dymbëdhjetë vjet radhazi", nis rrëfimin e tij zoti Hoti. "Prej tyre gjashtë vjet kam punuar në shkollat tetëvjeçare, ndërsa gjashtë të fundit në shkollën e mesme në Mitrovicë. Pas disa hetimeve që mora vesh kishte filluar t'i zhvillojë UDB-ja lidhur me disa aktivitete dhe paraqitje të mijat politike, e pashë të arsyeshme të largohem nga Mitrovica, që të mos i përjetoja torturat që i kishin përjetuar shumë dashamirës si dhe im atë, për tre herë radhazi pas Luftës së Dytë Botërore.
Kështu, vendosa të dilja në Perëndim. U vendosa në Belgjikë ku, nga kohët, në cilësinë e të strehuarit politik, po jetonte dhe vepronte im vëlla, Isai. Kështu që pandehja se do të ishte shumë më e lehtë për mua që të vendosem atje nëpërmes vëllait dhe shokëve të tij të atëhershëm. Ishte ky viti 1979.
Mirëpo, edhe pse larg Kosovës, megjithatë, gjithçka që ndodhte këtu asaj kohe me një shpejtësi marramendëse, do të thosha, përçohej edhe në diasporë, veçanërisht në diasporën e Belgjikës ku ishte i grumbulluar një numër i madh i shqiptarëve të përndjekur politikisht dhe ku ishte qendra e aktiviteteve lidhur me ngjarjet në Kosovë. Asokohe nuk po përmendej fare as aktiviteti politik i shqiptarëve në Zvicër, as në Gjermani e as gjetkë nëpër Europën Perëndimore e as në Shtetet e Bashkuara. Kyç i gjithë aktivitetit tonë atje ishte ai i mërgatës politike në Belgjikë", thotë zoti Hoti më tej në rrëfimin e tij.
"Ishte kështu ngase dihet se në Belgjikë, që pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, ishte strehuar edhe një pjesë e konsiderueshme e emigracionit të vjetër politik, kryesisht nga Shqipëria, por edhe nga Kosova, ku kishte edhe zogistë, edhe ballistë etj.
Një ndër shtresimet e para në Belgjikë ishte padyshim, pra, ai i emigracionit të vjetër nga Shqipëria. Shtresimi i dytë ishte i përbërë nga të përndjekurit politikë nga Kosova. Ndërsa shtresimi i tretë i këtij emigracioni krijohet viteve të nëntëdhjeta, me refugjatë nga Kosova dhe nga Shqipëria, kryesisht me refugjatë ekonomikë, do të thosha.

Siç e thashë më lart, asokohe, ngjarjet që po ndodhnin në Kosovë, sidomos ato që lidheshin me Pranverën e Madhe të vitit 1981, reflektoheshin furishëm edhe në diasporën shqiptare të Belgjikës, ku kishin njerëz të formatit të vërtetë që dinin shumë mirë ta udhëhiqnin një aktivitet të mirëfilltë politikë që ndërlidhej me ngjarjet që zhvilloheshin në Kosovë si dhe me solidarizimin me popullin dhe ngjarjet atje. Fytyra më kyçe në kohën për të cilën po flas në Belgjikë ishte Enver Hadri, pastaj edhe Vehbi Ibrahimi, i cili u vra nëntë vjet para Hadrit nga ana e UDB-s jugosllave në Bruksel. Enveri një kohë të gjatë ishte kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë, ndërsa Vehbiu ishte përgjegjës i Partisë Naciona-Demokratike për Beneluks, një partie të djathtë ideologjikisht. Për dallim nga ne, shqiptarët e tjerë, shumica, asokohe aderonim nëpër partitë e vijës së majtë ideologjike që kishin lidhje të nduarduarta me Shqipërinë e atëhershme.
Enveri dhe Vehbiu kanë pasur aktivitete indiferente ndërmjet veti, për shkak se Enveri nuk kishte mundësi të vepronte me bashkatdhetarët. Ai kryesisht i ka krijuar dhe zhvilluar kontaktet me diplomatët perëndimorë, të cilët kishin angazhime në institucionet Europiane, siç është Parlamenti Europian, Unioni Europian apo edhe Komisioni Europian, me ç'rast me një mençuri të pashoqe ia dilte që ta afirmojë çështjen shqiptare në Europë. Fundja, kjo kishte rëndësi të veçantë edhe nga fakti se Belgjika ishte dhe mbetet një prej qendrave politike, ekonomike dhe ushtarake më të rëndësishme në botë. Ndërsa Vehbi asokohe është marrë me aktivitete tjera, shumë praktike, për çfarë edhe u bë pengesë për UDB-në. Për këtë arsye njerëzit e saj, në bashkëpunim me servilët e saj, e vranë në shtëpinë e tij në Bruksel, sikundër nëntë vjet më pas edhe Enverin në udhëkryqin e rrugëve Sen Ahil dhe Sen Bernard të kryeqytetit të Europës, pra Brukselit", rrëfen Musa Hoti, ish-emigranti më i njohur politik shqiptar.

*Asgjë nuk ndodh rastësisht*

“Fill pas ngjarjeve të Pranverës së Kosovës të vitit 1981, jo vetëm unë, por edhe një numër i madh i bashkatdhetarëve tanë u angazhuam që ta ringjallim emigracionin shqiptar në Belgjikë, veçanërisht atë emigracion që kishte prejardhje nga Kosova. Me këtë dëshironim që të bëjmë një organizim të mirë politik me shpresë se mund t’i jepnim një shtytje dhe një ndihmesë, jo vetëm kërkesave të njohura të studentëve në Prishtinë, por edhe ta afishojmë në opinionin perëndimor pozitën tejet drastike të shqiptarëve. “ Sezoni i gjuetisë’ mbi të cilët tashmë ishte shndërruar në platformë politike të UDB-s dhe poltronëve të Serbisë në Kosovë”, vazhdon tutje Musa Hoti.
"Ne aso kohe ishim aktivistë, por, fatkeqësisht, nuk kemi ditur që të kërkonim gjëra siç dalin sot në shesh, por, ja se, atëbotë e kërkonim një republikë shqiptare në kuadër të ish-Jugosllavisë. Ky është një realitet mjaft i hidhur për ne, ngase ne me vonesë i kuptuam gabimet dhe dobësitë tona", thotë zoti Hoti, i cili tashmë gradualisht nis të futet në storen e tij që ta shpalosë para lexuesve të “KOMBI”-t.
“Ndërsa”, shton ai, “sa i përket rastit tim, unë mendoj se asgjë nuk ndodh rastësisht, ngase jam i bindur që rasti im ishte rast i elaboruar në projektet e sigurimit serb dhe atij jugosllav ku kishin arritur tek përfundimi se do të ishte mirë që pikërisht në Bruksel UDB-ja ta likuidonte ndonjërin prej aktivistëve shqiptarë, jo për ta dobësuar aq shumë lëvizjen, por për t’i frikësuar të tjerët që po vepronin si dhe ata që kishin dilema t’i bashkangjiteshin aktivitetit politik atje apo jo. Kështu, ndodhi që pikërisht unë të jem njëri prej regjistrit të UDB-s, njeriu, vrasja e të cilit besonin ata se do t’i disiplinonte shqiptarët tjerë atje.
Kjo s’është dhe s’mund të ishte e rastit. E them këtë edhe nga shkaku se unë kam provuar t’i evitoj sulmet e shërbimit sekret jugosllav, por kam reaguar vetëm atëherë kur, siç i thonë fjalës, s’kisha më nga t’ia mbaj, por isha mbështetur për muri”, rrëfen zoti Hoti.

## *Edhe njëherë për ngjarjen në restorantin "White Horse"...*

“”Rasti ndodhi asaj nate, kur një bashkatdhetar yni nga Peja, që kishte ardhur atyre ditëve në Bruksel dhe e kishte të shoqen shtatzënë, më thirri pas punës. Unë pranova të shkoja dhe ta ndihmoja për t'u vendosur në apartamentin që e kishte siguruar atyre ditëve. Mirëpo, derisa po shkoja tek miku im, përnjëherë jam shtangur kur e kam vënë re se shtatë persona, të gjithë korpulentë, më ishin vënë pas. Ata, sapo m'u afruan, nisën të më kërcënojnë në gjuhën serbe. Thënë të drejtën unë në fillim nuk e kuptova qëllimin e tyre definitiv, ngase, sikur ta dija se çfarë po mëtonin ata asaj nate dhe se ishin me të vërtetë njerëz të UDB-s, padyshim do të veproja që në llafet e para. Mirëpo mendova se mund të më kishte identifikuar ndonjëri prej atyre se isha shqiptar dhe tashti, ashtu, kot, po më provokonin, ngase ishin aq të numër dhe kishin marrë zemër, ashtu siç e kanë adet të gjithë serbët...
Duke qenë i prirur nga thënia e moçme se dy qenë të këqinj e hanë edhe një ujk, unë vendosa që të mos konfrontohesha me serbët, edhe pse, siç mund të nënkuptohet, isha i armatosur. Madje, nuk e fsheh se bukur shumë u gëzova kur e vura re se në restorantin "White horse" ishin duke pirë edhe biseduar pesë bashkatdhetarë tanët, të cilët i njihja dhe që i njoh edhe sot, por të cilëve nuk do t'ua përmend emrat as kësaj radhe.
Pra, unë u futa në restorantin, i cili prej asaj nate do të bëhet shumë i njohur për gjithë shqiptarët e Belgjikës e në veçanti për serbët e atjeshëm si dhe ata të Beogradit. Pasi hyra në restorant, u ula pranë shqiptarëve që i gjeta aty. Dhe kur ata u futën në atë restorant pas meje vazhduan të më fyenin vetëm mua direkt, pavarësisht nga fakti se ishin edhe pesë bashkatdhetarë tanët aty me mua, e që do të thotë se ata kishin një paramendim krejtësisht transparent dhe qëllim ekzakt – të më likuidonin asaj nate.
Mirëpo, edhe pse edhe ata, pesë bashkatdhetarët, e kuptuan se çështja ishte tepër serioze dhe se serbët kishin për qëllim të më vrisnin, që të

pestit, në varg, u ngritën një nga një dhe dolën nga restoranti duke më lënë të vetmuar. Dikush u ngrit ‘për të blerë duhan’, dikush ‘për të shkuar në WC’ dhe kështu me radhë. Kështu mbeta i vetmuar në tavolinë. Dhe pas kësaj ngjau ajo që ngjau”, rrëfen zoti Hoti.

“Kur e panë udbashët se mbeta i vetmuar, nisën t’i nxjerrin armët që të më vrisnin. Ata ishin katër rreth tavolinës, ndërsa tre kishin ngelur jashtë. Unë isha i ulur fare pranë dritares kështu që plumbat mund të më godisnin nga dy drejtime – nga jashtë dhe nga brenda në të njëjtën kohë”, rrëfen Musa Hoti, i cili në saje të fatit dhe guximit të madh që kishte asaj nate ia doli që ta përballojë një situatë të papërballueshme.

“Ata i futën duart të parët që t’i nxjerrin armët dhe të më vrasin. Mirëpo unë, nuk e di as vetë se me ç‘shtytje, ia dola që me një shpejtësi të rrufeshme ta nxjerr revolen time dhe shtiva i pari në atë çast të mbrojtjes legjitime. Njëri prej sulmuesve u vra në vend, ndërsa tre të tjerët i plagosa”, rrëfen zoti Hoti, i cili, siç do të dalë më pas edhe në ekspertizën që do ta kryejë policia kriminale belge mbi serbët që po bëheshin gati ta vrisnin këtë veprimtar politik shqiptar, shtiu vetëm me dy plumba dhe siç e tha, një, më kryesorin e tyre, e vret ndërsa tre të tjerët i plagos.

“Thënë të drejtën, as sot e kësaj dite nuk e kam gjithaq të qartë se si ia dola që në mënyre ekzakte me dy plumba ta vras një dhe t’i plagos tre persona të tjerë – testuesvrasësit e mi”, thotë zoti Hoti, i cili tregon se tre serbët tjerë që gjendeshin jashtë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të vetmin, ngase e tëra në restorantin “White horse” kishte ndodhur me një shpejtësi të pashpjegueshme “dhe kur kam dalur nga restoranti”, rrëfen zoti Hoti, “nuk kam dalur vetëm unë, por me mua kanë dalur edhe një numër i madh i mysafirëve të restorantit që ishin gjetur rastësisht aty asaj nate dhe në atë çast. Siç u konstatua më pas, në atë lokal kishin qenë 22 veta. Mirëpo, nuk dua ta fsheh se kur dola unë nga restoranti kisha dalur me një qëllim – që të mbaroja punë edhe me ata tre të tjerët që po prisnin jashtë, mirëpo kur dola ata nuk i pashë. Pastaj u ktheva edhe njëherë brenda që të shoh se mos kishte mbetur gjallë ndonjëri prej serbëve të plagosur, mirëpo atëherë u takova me dy a tre prej atyre bashkatdhetarëve që kishin shkuar në ‘WC’ apo ‘për të blerë duhan’ dhe ata më bindën se që të katërtit

kishin mbetur të vrarë kështu që do të bëja mirë sikur të largohesha nga vendi i ngjarjes.
Nuk e di pse u besova, por atëherë mora udhë dhe nga ai vend u largova me hapa të ngadalshëm dhe të qetë, ndërsa, më pas, në një rrugicë tjetër u ula në taxi dhe u largova nga vendi i ngjarjes", thotë zoti Hoti, i cili po ashtu tregon se fillimisht as që i kishte shkuar mendja të dorëzohet, ngase, siç thotë, nuk e kishte parë të arsyeshme që "për një shka të keq të shkoj në burg dhe të përgjigjem para organeve të drejtësisë, për aq më shumë kur dihej mirëfilli se ata më kishin sulmuar mua dhe kishin planin të më vrisnin mua asaj nate...

## *Shpresa e bjerr...*

Thënë të drejtën unë atëbotë shpresoja se qeveria e atëhershme e Tiranës mund të më pranonte për strehim atje në Shqipëri, kuptohet në ilegalitet dhe konspiracion të thellë. Kështu, fill pas rastit, e kam dërguar një shok në Ambasadën e Shqipërisë në Paris që të kërkonte një ndihmesë për mua nga ata dhe të më siguronte një lloj strehimi të përkohshëm atje.
Tashti çështja ndërlidhet edhe me emrin e dëshmorit Vehbi Ibrahimi. Ngjarja në fjalë ka ndodhur më 4 gusht të vitit 1981. Dhe përgjigjen nga Ambasada e Shqipërisë në Paris e kam pritur deri më 12 gusht të po atij viti. Gjatë kësaj kohe isha i strehuar nëpër vende të ndryshme, ndër njerëz të besueshëm, emrat e të cilëve as atëherë e as sot nuk ia kam treguar policisë belge. Do të thotë, në ditën e nëntë, kur me pabesinë që më bëri një bashkatdhetar yni nga shteti amë, do të thotë nga Shqipëria, bie në duart e policisë së Belgjikës, po asaj nate tek Vehbi Ibrahimi kishte mbërritur pëlqimi nga Ambasada e Shqipërisë se unë mund të pranohesha në Shqipëri, me ç'rast ajo ambasadë do të ma përgatiste një pasaportë me të cilin do të arrija deri në jug të Francës, do të thotë në Marsejë, prej nga me ndonjë nga anijet shqiptare do të kaloja në Durrës, në Shqipëri. Fatkeqësisht, unë u preva në besë nga ai shqiptari i Shqipërisë, kështu që Vehbiut nuk iu dha rasti që të ma dorëzonte atë letër, e cila, kur vritet Vehbiu nga

UDB-ja, fatkeqësisht bije në duart e policisë belge", rrëfen tutje zoti Musa Hoti, i cili tregon se hetimet lidhur me rastin kanë vazhduar afërsisht tetëmbëdhjetë muaj sa ka qëndruar ky në burg dhe më pas policia belge ndaj tij aplikon një lloj izolimi në bregdetin e atij vendi, do të thotë një lloj izolimi të pagjyq si masë të cilën e "vuajti" zoti Hoti katër muaj pas paraburgimit.
"Ata arsyetoheshin me këtë veprim se mund të më vriste UDB-ja jugosllave. Kështu që kjo masë u quajt si masë për sigurimin e jetës sime dhe të familjes sime", thotë zotriu, rasti i të cilit me shpejtësi të erës u bë një fabul e njohur për këngët e rapsodëve shqiptarë në Kosovë dhe më gjerë, ngase trimëria dhe shkathtësia e tij mori dhënë.

## *Tentativat dhe aksionet për likuidimin e Musa Hotit*

Pasi Musa u kthye nga "izolimi", UDB-ja jugosllave bëri edhe disa tentativa për ta likuiduar zotin Hoti, madje, duke mos ia kursyer as familjen me këtë rast. "Ata kanë ndërmarrë tre aksione konkrete që të më likuidonin, por falë syçeltësisë sime dhe të rrethit tim të ngushtë, falë edhe disa bashkatdhetarie që më ishin pranë, por edhe falë fatit të madh, megjithatë UDB-ja nuk ia doli që t'i kurorëzojë rastet.
Rasti i parë ishte kur po zbrisja me familje me ashensor nga kati i katërt i apartamentit ku po jetoja. Meqë u vonuam pak derisa erdhi ashensori dhe derisa u nisëm me të poshtë, e dëgjuam një eksplodim të madh për të cilin fillimisht nuk po e dinim se për çfarë ishte fjala. Mirëpo, kur kemi dalur në parkingun e makinave, pas disa minutash e kam kuptuar edhe unë edhe familja ime se fjala ishte se ishte hedhur në ajër makina jonë, në të cilën, sigurisht pas një apo dy minutash do të gjendeshim të ulur unë, zonja ime dhe dy vajzat tona të vogla. Makina jonë ishte shpërndarë diku në 60 metra për rreth.
Herat tjera ndodhën në kohën kur kam jetuar nëpër disa fshatra në rrethin e Brukselit, për shkak se sipas insistimit të policisë belge, në çdo gjashtë muaj isha i detyruar ta ndërroja vendbanimin dhe adresën që të mos bëhesha pre e hakmarrjes së pamëshirshme të UDB-së që ishte tejet e interesuar të më vriste.

Kështu, herën e dytë serbët kanë provuar të më vrisnin në fshatin Sent Piters Lër, i cili gjendet në periferi të Brukselit. Edhe kjo herë ishte e ngjashme me të parën dhe të tretën, pra që të hidhesha në ajër me gjithë makinë, por fati e deshi që të mos ndodhte ashtu...
Me kohë edhe unë u detyrova që të ndërmerrja disa masa preventive që të mos bija pre e sigurimit serb. Kështu, një prej masave që kisha ndërmarrë ishte që, për gjithë atë kohë, unë asnjëherë nuk kisha dalur nëpër kafenetë belge, po ashtu, asnjëherë nuk kisha shkuar as nëpër klubet e atëhershme shqiptare, asnjëherë nuk më ka zënë nata në qytet, dhe asnjëherë nuk kam dalur nëpër takime të ndryshme me bashkatdhetarët tanë derisa nuk i kemi njohur mirë dhe nuk e kemi kuptuar qëllimin e takimit, por gjithnjë duke pasur parasysh edhe faktin se edhe në ato mjedise ne e bënim një lloj sigurimi të veçantë", thotë zoti Hoti.

## *Storia e dytë me Ambasadën Shqiptare në Paris*

"Pas lirimit kam telefonuar disa herë dhe kam insistuar të takohesha me ndonjërin prej përgjegjësve të atëhershëm të Ambasadës Shqiptare në Paris. Kështu, kur këtë kërkesë ma përfillën një ditë, unë, që të nesërmen, sipas marrëveshjes, me një mik timin kam marrë udhë nga Brukseli për në kryeqytetin e Francës. Kur kam mbërritur në Paris unë e kam bërë edhe një telefonatë me ç'rast në atë bisedë me njerëzit e ambasadës, sërish, është akceptuar takimi me mua. Mirëpo, diku nga ora dhjetë, kur kemi mbërritur para derës së ambasadës, kemi trokitur në derë, ndërsa nëpunësi që na e hapi derën, kur e dëgjoi emrin tim tha shkurt e qartë: 'Ju lutemi largohuni më shpejt që këtej se mund t'u vrasë UDB-ja nga dritaret e ndërtesës përballë dhe kështu edhe qeveria jonë do të implikohet në këto vrasjet tuaja!' Mesazhi ishte tepër i qartë. Ata me fjalë të tjera nuk ma 'hapën' derën, dhe, nuk dua ta fsheh, se unë me këtë rast ngela edhe i shtanguar e edhe i befasuar ngase, drejt, nuk po e prisja një veprim të këtillë të njerëzve nga Ambasada e Shqipërisë në Paris", kujton zoti Musa Hoti.

## *Përsëri UDB-ja dështon...*

Ndërsa ai tutje rrëfen se atakimi i fundit (serioz) i UDB-s për ta likuiduar kishte ndodhur në vitin 1987 kur ish-policia federative e Jugosllavisë së zhbërë kishte bërë një kërkesë nga INTERPOL-i që të bastiseshin një numër familjesh shqiptare me pretekst se kinse ishte fjala për terroristë të pandehur që po përgatisnin veprime kundër Jugosllavisë dhe përfaqësive të saja turistike dhe ekonomike nëpër Europë. Ishte kjo dita e 27 nëntorit të vitit 1987 kur në orën 16 policët e ndryshëm të shteteve të ndryshme Europiane i kontrolluan 44 familje shqiptare nëpër shtete të ndryshme Europiane. Ishin këto familje që kishin shfaqur bindje të caktuara politike dhe ishin shquar me veprimtari politike dhe atdhetare. Ndër këto familje ishte edhe ajo e zotit Musa Hoti.

“Në Belgjikë bastisjen e shtëpisë sime”, thotë zoti Hoti, “e justifikuan me atë se, siç thanë, ata kishin marrë teleks nga INTERPOLI jugosllav se kryefamiljarët e këtyre familjeve po përgatiteshin për sulme mbi qendrat dhe objektet diplomatike jugosllave nëpër tërë Europën... Në mesin e tyre, me aq sa jam unë i informuar, ishin edhe z.Xhafer Shatri në Gjenevë, Sabri Novosella në Malme të Suedisë, Reshat Sahitaj në Bruksel etj.

Mirëpo, tek asnjëri nga të kontrolluarit, kudo nëpër Europë, policët nuk gjetën asnjë armë e aq më pak eksploziv, siç kishin pandehur se mund ta gjenin...”

## *Kthimi në Kosovë*

“Në qershor të vitit të kaluar kam ardhur për herë të parë në Kosovë pas njëzet vjetësh e tre muajve. Kjo për mua ishte një rilindje e dytë, ngase isha shpresëthyer se mund ta shihja Kosovën e lirë dhe në te prindërit e mi, shokët, miqtë e dashamirët... Ky ishte një përjetim që s’do ta harroj kurrë në jetën time, gjë që u sendërtua me një trimëri dhe heroizëm të paparë të djemve dhe vashave më të mira të Kosovës,

atyre që u lidhën bashkë rreth idesë UÇK dhe të cilët mbi të gjitha e deshën Kosovën dhe Lirinë e saj. Pra, ata që e derdhën gjakun e djersën për ne dhe për ata që do të vijnë pas nesh, në luftën çlirimtare të Kosovë, duke na e mundësuar kështu edhe neve, mërgimtarëve të vjetër që të kthehemi në Kosovë".

## *Themelimi dhe organizimi i UÇK-së*

"Krijimin e UÇK-së e kam përjetuar si një rilindje të popullit tonë, i cili edhe kësaj here e dëshmoi se është një feniks i vërtetë, i cili di të krijohet edhe nga hiri i vetë, do të thotë edhe atëherë kur të tjerët sa nuk besojnë se po zhbëhet i tëri.
Personalisht isha përkrahës i flaktë i idesë dhe luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ngase e dija se vetëm ata njerëz dhe vetëm ajo luftë, mbase, mund ta krijojë mundësinë dhe të na hapte shteg që të ktheheshin një ditë në këtë tokë dhe këtë vend të shenjtë dhe të shtrenjtë për shqiptarët. Por, meqë e kisha një hipotekë nga sigurimi shtetëror i Belgjikës si dhe, s'do mend, nga ai i ish-Jugosllavisë, më është dashur që të gjitha proceset rreth zhvillimeve të UÇK-së t'i vështroja nga një distancë e konsiderueshme që të mos vinte deri tek ato evenimente që dikush, ta shfrytëzojë episodin tim të mëhershëm dhe të sprovojë të 'komprometojë' idenë dhe luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Mirëpo, falë luftës së UÇK-së dhe djemve e vajzave që e shtynë historinë e Kosovës përpara në një rrugëtim të vështirë, por të shndritshëm, tash e një vjet nuk mendoj se gjendem mërgim, ngase, tashmë janë krijuar kushtet që të vijmë në Kosovë dhe që ne, të gjithë mërgimtarët që mbase dikur kishim arsye të largoheshim nga vendi ynë, të kthehemi këtu njëherë e përgjithmonë. Tash më nuk kemi ndonjë arsye të qëndrojmë jashtë, veçanërisht një numër bukur i madh i bashkatdhetarëve tanë. Të këtillë ka mjaft në diasporë, kudo, që nga Australia deri në SHBA. (**Ky artikull u botua në gazetën "Kombi", Prishtinë ).**

shprehet për një intervistë tjetër që po e zhvillonte Haqif Mulliqi për gazetën “ Epoka e re “ : Krijimin e UÇK-së e kam përjetuar si një rilindje të popullit tonë, i cili edhe kësaj here dëshmoi së është feniks i vërtetë, i cili do të ngrihet edhe nga hiri i vet; do më thënë edhe atëherë kur tjerët sa nuk kanë besuar se po zhbëhet i tëri.
Personalisht isha përkrahës i flaktë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ngase e dija se vetëm ata njerëz dhe vetëm ajo luftë mund ta krijonin mundësinë dhe të na e hapnin shtegun që të ktheheshim një ditë në këtë tokë dhe këtë vend të shenjtë dhe të shtrenjtë për shqiptarët. Por, më që e kisha një hipotekë nga Sigurimi shtetëror i Belgjikës, s’do mend, nga ai ish Jugosllavisë, më është dashur që të gjitha proceset rreth zhvillimeve të UÇK-së, t’i vështroja nga një distancë e konsiderueshme, në mënyrë që të mos vinte deri tek ato evenimente që dikush ta shfrytëzojë episodin tim të mëhershëm edhe të provojë “ta komprometojë” idenë dhe luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Mirëpo falë luftës së UÇK-së dhe djemve e vajzave që shtynë historinë e Kosovës përpara, në një rrugëtim të vështirë por të lavdishëm, tash e një vjet nuk mendoj se gjendem në mërgim. Tashmë nuk kemi ndonjë arsye të qëndrojmë jashtë, veçanërisht një numër i madh i bashkatdhetarëve tanë. Të këtillë ka mjaft në diasporë, kudo, qe nga Australia deri në ShBA.

*( Gazeta “Epoka e re”, më 29 janar 2004, f 6,*
*e intervistoi Haqif Mulliqi*)

## Komentim

Kjo intervistë u zhvillua më herët, por u botua me rastin e vrasjes së Musa Hotit.
Musa Hoti nuk mund të qëndronte në Bruksel, kur tërë jetën e kishte sakrifikuar për çlirimin e Kosovës. Të shpërngulej për gjithnjë kishte probleme të vogla rreth dokumentacionit që duhej të zhvendosej nga Belgjika në Kosovë. Në nëntorin vitit 2003, Musa kishte rregulluar gati çdo gjë dhe kishte marrë vendim të prerë, të jetonte në Kosovë.

Në tetorin e vitit 2003 Musa Hotin e takova më të mërzitur se kurrë më parë. E ftova të bisedonim në "Grand". Kohë e nxehtë nëntori. Musa filloi të ankohej se askund nuk mund të gjente një vend pune. Kudo e refuzonin më të njëjtat fjalë se nuk guxonin nga UNMIK-u se frikësoheshin se do të akuzoheshin që e kanë punësuar terroristin. Ky etiketim po e përcillte që nga momenti që e kishte kryer aktin në Bruksel më 1981. Ky etiketim do e përcillte deri në ditën e vrasjes. Ishte i zhgënjyer por i vendosur të kthehej në Kosovë. Mllefin dhe zhgënjimin e tij nuk mund t'ia zbulonte familjes, andaj dëshironte që kohën ta kalonte me mua. Në fakt edhe mua më pëlqente biseda më të ku i kujtonim aktivitetet tona në Belgjikë, andaj i propozova Musës të rrinte në banesën time. Më shumë se një jave u çmallëm duke biseduar në banesën time në Taslixhe, ku banoja atë vit. Ishte 28 nëntori dhe ne vendosëm që atë mbrëmje ta kalonim me shoqërinë tonë të dikurshëm e që asokohe në Prishtinë ishte edhe Hazir Haziri-Dëralla. I vetmi është Hazir Haziri që Musa kurrë nuk e ka ndërruar një fjalë të keqe. Haziri është aktivist i ditëve të para në diasporën e Belgjikës. Haziri asnjëherë nuk flet dhe nuk mburret për aktivitetet e tij. Haziri kishte mbushur plot 36 vjetë pa shkuar në Kosovë. Me 28 nëntor zbulohet përmendorja e Vehbi Ibrahimit, andaj edhe një arsye për të qëndruar bashkë. Në fakt ato ditë ishin ditët më të lumtura për ne tre shokë të vjetër. Musës sikur i kaloi ai zhgënjim dhe po ringjallej gjatë bisedave tona. Sa qëndroi më mua i shkroi mbi 25 faqe për jetën e tij të cilat i botova pak para vdekjes se tij në "Epoka e re ".

Në mëngjesin 28 nëntorit e parkuam veturën e Musës para Teatrit Kombëtar dhe me vetura të TMK-së u nisem për në Gjilan, ku pastaj do shkonim për në fshatin Uglar. Në Gjilan pasi pimë pije freskuese në Hotel "Kristal", u nisëm për Uglar. Në fshatin Uglar, masa ishte mbledhur.

Familja dhe këshilli organizativ më thanë mua që ta bëja zbulimin e përmendores së Vehbi Ibrahimit. Unë pasi kisha fjalën time për figurën e Vehbiut, propozova që zbulimin ta bënte Musa Hoti. Pas fjalës sime e morën fjalën edhe Ahmet Isufi, Hydajet Hyseni e të tjerë. Zbulimin e përmendores e bëri Musa Hoti.

Pas mbarimit të ceremonisë u kthyem në Prishtinë para Teatrit Kombëtar. Vetura e Musa Hotit ishte thyer e tëra. Ne kur e parkuam askush nuk na tha se aty do ketë manifestim. Gjatë ditës ishte zhvilluar manifestimi për ditën e shpalljes së pavarësisë ku dhjetëramijëra e kishin mbuluar sheshin.
Për habi Musa Hoti nuk u mërzit për thyerjen veturës. Unë i thash se ti tërë jetën duke sakrifikuar ja tash edhe në liri. Musa qeshi dhe shkuam për ta festuar 28 nëntorin në një lokal ku na priste Hazir Haziri me komandanta të TMK-së.
Në dhjetor të po atij viti, Musa duhej të kthehej në Bruksel, për të rregulluar dokumentin e tij të fundit të shpërnguljes për Kosovë. Musa po nisej me zemër të thyer se e dinte që duhej të kthehej sa më parë në Kosovë, kur pritej vdekja e vëllait të tij, Idrizit. Vëllai i Musës ishte në fazën e fundit të zhvillimit të kancerit.  Me kerrin tim  e përcolla Musa Hotin deri në aeroport. U ndamë duke u përqafuar si asnjëherë më parë. Ne fakt asnjëherë nuk përqafoheshim aq tepër siç bëjnë disa të tjerë që një ditë mos me u pa përqafohen thuajse nuk janë parë dy vjet.
E premte 17 janar 2004. Unë isha në shoqëri më Bislim Muçaj, Veton Osmanin e disa të tjerë në Hotel “Victoria”, duke luajtur një rol në filmin episodik “Zemër e vetmuar” në regji të Jeton Ahmetaj. Pak para se të fillonim xhirimin, më cingëroi telefoni nga një shok që jetonte në Bruksel. Më tha se Musa Hoti është vra. Telefonin e mbaja te hapur e nuk e fola asnjë fjalë. Mbeta i shtangur. Lotët më rridhnin si riga shiu. Bislim Muçaj ishte i vetmi që e hetoi se diçka kishte ndodhur. Unë isha kthyer nga dritarja që askush të mos m’i shihte lotët. Bislimi u afrua pranë meje dhe më shtrëngoi.

## *Si u vra Musa Hoti?*

Pasi kishte rregulluar një dokument në administratën vendore, ishe ndalur të pinte një gotë në një klub të shqiptarëve. Kohëve të fundit Musa Hoti kishte filluar të pinte e madje jashtë masës. Pinte thuase donte që zhgënjimin e tij të brendshëm ta harronte për pak çaste aq sa zgjaste e dehura.

Pasi kishte pirë shumë, një shok i tij e lutet që ta çonte me veturë dhe kërkon nga ai të mos pinte më. Sabit Abazi duke mos dëshiruar që Musa të ecë këmbë, merr veturën tij që ta dërgojë deri në shtëpi. Musa kur afrohet te metro kërkon të ndalojë veturën e të nisej me metro në shtëpi. Në mëngjesin e asaj mbrëmje të 17 janarit trupi i Musa Hotit gjendet i vdekur në parkingun e metrosë “Art Lois”.
Bulevardi Art Lois është ndër bulevardet më të frekuentuara të Brukselit; është rrugëkryqi i Parlamentit Europian; është kontrolli më i rreptë policor sepse aty është edhe Ambasada Amerikane. Ky bulevard është i pajisur me kamera ditë e natë , poashtu edhe metroja. Musa Hoti atë natë u vra vetëm nga një plumb pas koke. Mjekët ligjorë të Belgjikës ne raportin e tyre thonë se trupi i vrarë i Musës u zhvendos nga vendi ku ishte vra dhe dërgohet në një parking nëndhese. Vrasja e Musa Hotit u krye në mënyrë profesionale. Askund asnjë gjurmë e vetme. Madje as kamerat e metrosë nuk posedojnë xhirime të kalimtarëve. Vrasësit e Musës me siguri që këtë e kanë përgatitur me kohë dhe para objektivit të kamerave të metrosë, kanë vu diçka që asgjë të mos dukej.

NJË MUAJ PA ATDHETARIN MUSA HOTI

# EDHE NJË VRASJE PAS SHPINE NË KRYEQYTETIN E BE-së

***Dhashtë Zoti që Musa Hoti të mos jetë vrarë nga ndonjë "shqiptar", që nuk do të më çuditë aspak në këto kohë të pakohë, ngase qendra e krimit është forcuar në atë masë, saqë ndodh, fatkeqësisht, që edhe ta përgatitë vrasjen, por edhe ta bëjë varrimin "madhështor". Kjo është zeja më e tmerrshme ndërshqiptare që doli me të madhe në dritë pas vitit 1997 në Shqipëri, zeje më e zezë se ajo e katit të dymbëdhjetë të Purgatorit të Dante Alighierit, zeje për të cilën është specializuar edhe qendra e krimit që i ka ngulur rrënjët thellë në Kosovë, por që një ditë do të dalë në shesh, medoemos, dhe vetëm atëherë do të shihet se nuk është dashur të vritet shumëkush.***

*Shkruan:* **Avdyl GËRVALLA**

Sot, më 16 shkurt, bëhet një muaj nga vrasja e trimit Musa Hoti, për të cilin kemi dëgjuar më shumë që nga prilli i vitit 1981.

Atdhetari Musa Hoti u varros në Kosovën e tij të dashur, në vendin e të parëve, për të cilin kishte derdhur aq shumë mund dhe djersë. Ai u përcoll i shoqëruar nga njerëz të ndryshëm deri te varri, me nderime dhe në heshtje, sepse sa ishte Musa i gjallë, emri dhe mbiemri i tij lakoheshin me frikë, sikur me të të lidhej një ogur i zi, një mëkat i përmasave përrallore.

Faktet flasin se akti i tij i paharrueshëm ka mobilizuar për herë të parë tërësinë e mërgatës shqiptare me telegrame përkrahjeje dhe ndihma materiale, të shumta, për ta nxjerrë nga burgu trimin Musa Hoti, për ç'gjë Musa ka shprehur gjithnjë mirënjohjen e vet.

Musën e kanë nderuar njerëzit e ndershëm, të cilët ai kurrë nuk i zhgënjeu, madje as ditën kur i mbylli sytë. Musën e kanë dashur haptazi, por edhe në heshtje, dhe kjo e ka mbajtur gjallë. Patriotin Musa Hoti e kishte shpërblyer Zoti edhe me tiparet e tjera dalluese: të mirënjohjes, njerëzisë, atdhetarizmit, diturisë dhe, mbi të gjitha, dashurisë për njerëzit e vet. Mendja dhe shpirti, së bashku me Orën e Musa Hotit qëndronin të zgjuara, atje lart, në atë shkallën e ngritur, ku ka vend vetëm për njerëzit e dalluar, falë virtyteve të lartpërmendura, ku ka vetëm mirëkuptim, sinqeritet, dashuri e punë. Mbi të gjitha, patrioti Musa Hoti e deshi Shqipërinë, e deshi Kosovën së bashku me të gjitha pjesët e shqyera të Atdheut dhe nuk hezitonte ta mbronte edhe në çastet më të vështira, edhe atëherë kur të tjerët e mallkonin dhe e shanin fatin njerkë të Historisë sonë. Sikur t'i mbylleshin mendja dhe veshët Musës, atëherë kur ndodhte ndonjë shpirtvogëlsi ose ngatërresë, dhe nuk hezitonte të ndërhynte me qëllim të shërimit të raporteve mes shokëve, me fjalë të zgjedhura, të ëmbla dhe të pakundërshtueshme. Atdhetari Musa



*Atdhetari Musa Hoti*

atentatesh, djegie të veturës. Dhe për të gjitha ato të zeza që ishin bërë kundër Musa Hotit, organizatat majtiste shqiptare si me pahir u zunë në valët e njëjta me shkije, dhe kulmi i poshtërsive ndodhi kur Musës i drejtoheshin nëpër gazeta ato forca "përparimtare" të Lëvizjes Popullore të Kosovës: „Terroristi Musa Hoti!" Por, këtë përmendore të gjallë s'kishte bir nëne që ta ngatërronte dhe t'ia humbte mendjen, fjalori i tij nuk njihte sharje dhe nuk përdorte as mallkime, ai me keqardhje lutej për ta me këto fjalë: - Dhashtë Zoti dhe të mbushen mend!.

Veprimtaria patriotike e komunitetit shqiptar në tërësi në Belgjikë është e mishëruar dhe lidhet ngushtë me atdhetarin Musa Hoti, i cili madje është edhe njëra nga figurat qendrore të atij komuniteti, këtë e dëshmon prania e tij në organet drejtuese të asaj veprimtarie. Djathtisti Musa Hoti nuk ka dashur kurrë të imponohet. Ai nuk ka dashur as të përzihet në asnjë punë, dhe po qe se të tjerët e kanë konsideruar të tepërt praninë e tij, ai ka ditur të largohet pa prekje dhe në mënyrë të mençur.

Atdhetari Musa Hoti ka bërë edhe shkrime të shumta, të cilat shpresoj se do ta shohin një ditë botimin, shkrime-

gon sot shumë shqiptarëve. Ai nuk përtonte të ndalej me këdo, t'i ndërronte nga dy-tri fjalë dhe ishte i gatshëm në çdo moment ta shtrijë dorën e ndihmës dhe të solidaritetit.

Dhashtë Zoti që Musa Hoti të mos jetë vrarë nga ndonjë "shqiptar", që nuk do të më çuditë aspak në këto kohë të pakohë, ngase qendra e krimit është forcuar në atë masë, saqë ndodh, fatkeqësisht, që edhe ta përgatitë vrasjen, por edhe ta bëjë varrimin "madhështor". Kjo është zeja më e tmerrshme ndërshqiptare që doli me të madhe në dritë pas vitit 1997 në Shqipëri, zeje më e zezë se ajo e katit të dymbëdhjetë të Purgatorit të Dante Alighierit, zeje për të cilën është specializuar edhe qendra e krimit që i ka ngulur rrënjët thellë në Kosovë, por që një ditë do të dalë në shesh, medoemos, dhe vetëm atëherë do të shihet se nuk është dashur të vritet shumëkush.

*P. S.*

*Në vjeshtën e vitit 1985 u takova për herë të parë me Musa Hotin, në rrethana disi të çuditshme, në banesën e përkohshme në kryeqytetin belg - Bruksel, të të ndjerit dr. Prof. Sefedin Fetiut, nga Gjakova, ish i burgosur politik, bashkëpunëtor i patriotit Kadri Kusarit dhe i figurave të tjera më eminente të patriotizmës shqiptare, të atyre që punuan aq shumë për Atdhe, por për të cilët sot e asaj dite bëhet fare pak, edhe pse janë pjesa më e lavdishme e së kaluarës sonë më të afërt. Profesori ishte patriot i shkëlqyeshëm dhe i dalluar, krijues i palodhshëm, enciklopedi e gjallë, uragan që ka ndihmuar aq shumë për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Jam i bindur se mërgata shqiptare nuk do t'i mbetet borxh Profesorit, atij njeriut të madh, personalitetit të rrallë që hapi shtigjet e mendimit të Ri, me gjithë rreziqet e panumërta që ia përgatitnin sigurimet e shteteve të ndryshme të Ballkanit të egër. Profesorin dhe Musa Hotin, së bashku me shumë bashkëmendimtarë të tyre, i lidhte një ideal i fortë: lufta e përbashkët dhe e pahile për Lirinë e*

EPOKA E RE e hënë, 19 janar 2004

Në Bruksel

# Vritet Musa Hoti

EPOKA E RE RESHAT SAHITAJ



Në mëngjesin e të premtes së kaluar, në një parking të nëntokës së kryeqytetit evropian në Bruksel u gjend i vrarë Musa Hoti, veprimtari i ditëve të para dhe njëri ndër bashkëpunëtorët e Enver Hadrit dhe Vehbi Ibrahimit.

Musa Hoti, i brumosur me frymën patriotike nga prindërit e tij dhe më vonë profesorët e shkollës se mesme të Mitrovicës, do të angozhohet në aktivitetin ilegal kundër sistemit okupues serb bashkë me Zeqir Gërvallën dhe Avdyl Lahun. Në vitin 1968, Musa Hoti gjindet në organizimin e këtyre protestave bashkë me Haxhi Gashin, Enver Haki Berishën, Musli Elshanin dhe Hilmi Rakovicën. Me udhëzimët e Hilmi Rakovicës, Musa Hoti do të organizojë protesta për tri javë rresht prej Gostivarit deri në Manastir. I përndjekur nga sistemi jugosllav, Musa detyrohet që më 1979 të kërkojë strehim politik në Belgjikë, ku menjëherë do të bashkëpunojë me Vehbi Ibrahimin dhe Enver Hadrin.

**(Këshilli Organizativ i Varrimit, Reshat Sahitaj - tel: 044 111 430)**

Në Bruksel, Musa Hoti do të merret me organizimin e demonstratave të 13 prillit 1981, bashkë me Enverin, Vehbiun, Jusuf Selenicën dhe tjerë. Një muaj më vonë, Jusuf Gërvalla në Bruksel do dërgojë Kadri Zekën dhe Bardhosh Gërvallën, të cilëve Musa Hoti dhe Enver Hadri do iu ndihmojnë në organizimin e një demonstrate para ambasadës jugosllave në Bruksel.

Po atë vit Beogradi kishte dërguar një delegacion me intelektual kosovarë të kryesuar nga djali i Gjuro Pucarit që të propagandonte se në Kosovë nuk kishte demonstrata dhe presione.

Musa Hoti, Jakup Syla dhe Bardh Mavraj do të pengonin këtë delegacion që të fliste kundër rinisë kosovare.

Në verën e vitit 1981, kur Tahir Meha rezistonte si luan në Prekaz, Musa Hoti i revoltuar nga makineria propagandistike e armikut i frymëzuar me ndjenjën patriotike do të shtie me armë zjarri mbi trupin diplomatik të Ambasadës së Beogradit në qendër të Brukselit.

Vrasja e diplomatit jugosllav do të bëjë jehonë jo vetëm në shtypin ndërkombëtar, por edhe në Kosovë.

Pas lirimit të burgut, shërbimi sekret jugosllav disa herë do të tentojë të hakmerret kundër Musa Hotit, të cilit vetëm dy vite më vonë do ia hedhin në ajër veturën, pikërisht disa sekonda pasi e mbyllë derën.

Musa i shpëtoi tentim-atentave të Shërbimit sekret serb edhe në disa raste tjera. Njëzet e dy vite më vonë Serbia me shërbimin sekret të sofistikuar do të arrijë të shuaj jetën e Musa Hotit.

Dëshira dhe amaneti i fundit i Musa Hotit ishte që të varrosët në vendlindjen e tij në Mitrovicë, që do bëhet nga mesi i javës.

KOHA DITORE e diel • 18 janar 2004

Sipas njoftimeve të familjes Hoti të Mitrovicës

# Në Bruksel, në rrethana të pasqaruara, është vrarë atdhetari Musa Hoti

MITROVICË, 17 JANAR - Musa Hoti, i përndjekur politik nga vitet e 80'ta, është vrarë të enjten në mbrëmje në Bruksel, në rrethana tani për tani të pasqaruara. Këtë lajm e ka konfirmuar, të shtunën policia dhe familja e të ndjerit.

Hetimet për këtë vrasje është duke i zhvilluar policia belge.

Musa Hoti për shkak të veprimtarisë së tij atdhetare ishte i përndjekur nga UDBA-ja. Në vitin 1978 u largua nga Kosova dhe veprimtarinë e tij patriotike e vazhdoi në Evropën Perëndimore.

Burime nga Brukseli njoftojnë se familja e të ndjerit e ka identifikuar Musën dhe ai, sipas gjasave, ka vdekur nga një plagë në kokë, e marrë nga armë zjarri.

Ishte bashkëpuntor dhe bashkëveprimtar i Jusuf e Bardhosh Gërvallës, Kadri Zekës, Enver Hadrit, e veprimtarëve të tjerë që kanë vepruar në Perëndim për çështje kombëtare, dy dekada më parë.

Sipas të dhënave të familjes së tij, ai është gjetur i vrarë një rrugë afër taksistëve në Bruksel, ku Musa jetonte bashkë me familjen e tij, gruan, 3 vajza dhe 1 djalë.

Musa Hoti e ka vrarë në vetëmbrojtje një zyrtar të lartë të Ambasasadës së ish-Jugosllavisë dhe një tjetër e ka plagosur në



**Fotografi e të ndjerit Musa Hoti, nga periudha e rinisë e ofruar nga familja**

vitin 1981 në Bruksel dhe një kohë të shkurtër ka qëndruar në burg.

Ndaj Musa Hotit, sipas familjarëve të tij, edhe me parë ka pasur tentim atentati.

Në qytetin e Mitrovicës është pritur me indinjatë e shqetësim vrasja e këtij atdhetari, ndërsa varrimi i tij pritet të bëhet në javën e ardhshme në vendlindjen e tij në Mitrovicë.

*I. Krasniqi*

*“Bota sot” “ Epoka e re”, “Koha ditore”,17 shkurt 2004*

Për vrasjen e Musa Hotit shkruante shtypi belg, por edhe shtypi në Kosovë i dha jehonë kësaj ngjarjeje të rëndë për Kosovën.

## TË JESH GRUA E NJË ATDHETARI DUHET TË JESH ATDHETARE

Çuditërisht deri në këtë faqe të librit nuk e kam cekur asnjëherë emrin e bashkëshortes së Musa Hotit, thuajse ajo nuk ekzistonte, thuase ajo nuk kishte asnjë rol në jetën e Musa Hotit. Në fakt, një pjesë e madhe e shqiptarëve rolin e gruas në aktivitetet e burrit nuk e marrin parasysh. Nuk është e rastit kur ne sot nuk jemi të informuar psh. se më kë ishte i martuar Isa Boletini, kënd kishte për grua Bajram Curri, apo Luigj Gurakuqi?!



Musa Hoti me bashkëshorten, Mevlyde

Ne ende as në ditët e sotme nuk kemi njohuri si quhej bashkëshortja e Ibrahim Rugovës ose edhe më afër si quhet gruaja e Hashim Thaçit. Gratë e veprimtarëve tanë ne nuk i përfillim, thuase ato ishin vetëm objekte të burrit. Ne shkruajmë me mburrje për dëshmorët duke e harruar rolin e gruas se tyre dhe pastaj i permendim emrat e bijve të tyre.

Musa Hoti ishte i martuar me Mevlyde Sllamnikun, e cila ne çdo moment ishte përkrahëse e aktiviteteve të bashkëshortit të saj.

Mevlydja ishte vajza e Ismajl Sllamnikut, një vperimtar i shquar i çështjes kombëtare. Mevlydja që në fëmijëri ishte brumosur me ide patriotike, andaj problemeve të shumta që iu paraqitën gjatë jetës si : bastisjet e ndryshme të policisë serbe në Kosovë, e pastaj problemet e shumta në Bruksel, pas aktit që kishte bërë Musa, Mevdlydja iu përballoi me një stoicizëm të rrallë. Babai Smajli ia kishte lë amanet bijës së tij Mevlydës që për lirinë e atdheut të mos kursente asgjë. E Mevlydje Hoti- Sllamniku, me dinjitet e vazhdoi rrugën dhe amanetin e prindërve të saj. Mevlydja kudo deri në qershorin e vitit 1999, ishte gjithnjë në ballë të demonstratave që organizoheshin në Perëndim. Mevlydja bënte pjesë në mesin e dy apo tri grave të mërgatës në Belgjikë që deri në çlirimin e Kosovës nuk kishte guxuar të vizitonte familjen e saj në Kosovë. Kishte qëndruar me mallin për dasma, linjde e vdekje, pa guxuar të shkonte në Kosovë për të ndarë dhembjet dhe dashurinë më të afërmit e saj.

Të jesh bashkëshorte e një aktivisti të devotshëm të çështjes kombëtare është më se e domosdoshme që edhe vetë gruaja të ketë ide dhe iniciativa për aktivitete kombëtare, në të kundërtën aktiviteti i burrit është i destinuar të dështojë.

Mevlyde Hoti (bashkëshortja e Musës), në fillim të ardhjes në Belgjikë, përballej me problemet e shumta të vendbanimit dhe të ndryshimit rrënjësisht të kushteve të jetës dhe ambientit. Posa familja e Musës u stabilizua, Musa e bëri aktin që menjëherë e destabilizoi jetën familjare. Mevlydja u gjend me fëmijë të vegjël, pa asnjë mbështetje, pa asnjë përkrahje, përballë bastisjeve sistematike të policisë belge të cilët kërkonin dhe rrotullonin çdo

orendi në banesë duke kërkuar edhe më të voglin fakt se Musa vrasjen e kishte bërë me paramendim.
Nga ky rast çdo gjë do të ndryshonte në jetën e saj, sepse ajo tani ishte në përcjellje sekrete të policisë belge, të cilët dëshironin të dinin se ku fshihej Musa Hoti. Mevlydja që aso kohe nuk e dinte gjuhen e as nuk dinte të orientohej në Brukselin shumëmilionësh, e kishte të vështirë të takohej edhe me njerëzit që i njifte, sepse policia belge do të interesohej detalisht për ato familje që kjo do merrte kontakte. Më rastin e dorëzimit të Musës në polici, bashkëshortes se tij do t'i dilnin tjera probleme që çdo ditë shkonin duke u shtuar njëra pas tjetrës. Duhej të përgatiste fëmijët për në shkollë, duhej të shkonte për ta vizituar burrin në burg, ku aty duhej pritur orë të tëra radhën, e pastaj duhej të përcillte mesazhet e Musës shokëve të tij jashtë burgut.
Sa më shumë që shkonte gjendja materiale e familjës dobësohej, e aq më shumë Mevlydja duhej të qëndronte stoike sepse tani ishte jo vetëm grua por edhe burrë. Të jetosh në një vend të huaj, pa e patur nënën e babain e burrit, pa njohur asnjë nga fqinjët është jetë e rëndë për një femër ku çdo gjë bie mbi kurrizin e saj. E Mevlydja duhej të gjente forcë që t'u përballonte të gjitha problemeve vetë.
Gjatë qëndrimit të Musës në burg, Mevlydja i përballoi të gjitha problemet duke i rritur dhe edukuar fëmijët e saj dhe duke e mbajtur moralin dhe dinjitetin gjë që është e rrallë në raste të tilla. Më lirimin e Musës nga burgu, Mevlydës sikur iu lehtësua barra sepse tani burri ishte shtylla kryesore e familjës, mirëpo dalja nga burgu nuk ndikoi aspak në lehtësimin e problemeve të bashkëshortes së tij. Musës i vinin shokë nga të gjitha anët e kur nuk kishte shokë që i vinin shkonte Musa në udhëtime të ndryshme për aktivitete kombëtare.
Bashkëshortja e Musës, nuk ishte grua si një pjesë e grave të tjera që ngjarjet e Kosovës t'i merrte indiferente. Jo. Mevlydja ndjente dhembje për situatën në Kosovë njëlloj si burri saj dhe merrte pjesë në manifestime kudo që ato organizoheshin. Një pjesë e grave të dëshmorëve të cilët i kisha shokë, jo vetëm që nuk e përkrahnin burrin , por i nxinin jetën duke sharë e bërtitur me fjalët: “ Qyqan,

po mendon se Kosova është vetëm e jotja!”.  Pikërisht gratë e tilla tani mburrën për aktivitetin e burrit të tyre dhe injorojnë shokët me të cilët burri kishte vepruar deri në vdekje. Mevlyde Hoti, ishte pjesëmarrëse në aktivitete patriotike krah për krah me burrin e saj dhe kjo padyshim e ka një meritë të madhe jo vetëm karshi burrit por edhe për çështjen kombëtare.
M vrasjen enigmatike të Musa Hotit, bashkëshortës së tij përsëri iu shtua barra e problemeve, thuase Mevlydja kishte lindur për të vuajtur. Në kohën kur mendonte ta kalonte një jetë të qetë të pleqërisë dhe t’i gëzonin frytet e aktiviteteve të tyre patriotike, Musa u vra në mënyrën më misterioze e Mevlydja mbet të jetoj vetëm më kujtime të së kaluarës.
Musa e kishte lënë amanet të varrosej në Kosovë. Dheu i huaj nuk më mban, thoshte kur ishte gjallë.



***Trupi i Musa Hotit në Sallën e Kuqe, Prishtinë. Ushtarët e TMK-së bënin roje nderi 22  janar 2011 Prishtinë***

Varrimi u bë nën përkujdesni e Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente
19.01.2004
Këshilli për varrim përbëhej nga:

1. ZANA KRYEZIU, kryetare
2. MERIMAN BRAHA
3. HASAN ZEKA
4. ISMET HAJRULLAHU
5. AVNI DEHARI
6. RESHAT SAHITAJ
7. DAUT DEMAKU
8. SELATIN NOVOSELLA
9. HALIL BERAMI
10. MUHARREM SLLAMNIKU
11. SHEMSI SYLA
12. NEXHMEDIN SPAHIU

UNMIK

**MINISTRIA E KULTURËS, RINISË, SPORTIT DHE ÇËSHTJEVE JOREZIDENTE**
**MINISTARSTVO ZA KULTURU,OMLADINU, SPORT I NEREZIDENTNA PITANJ**
**MINISTRY OF CULTURE,YOUTH, SPORTS AND NON-RESIDENT AFFAIRS**

19.01.2004

Këshilli për varrimin e z. Musa Hoti

1. Zana Kryeziu, kryetare
2. Meriman Braha
3. Hasan Zeka
4. Ismet Hajrullahu
5. Avni Dehari
6. Reshat Sahitaj
7. Daut Demaku
8. Selatin Novosella
9. Halil Berani
10. Muharrem Sllamniku
11. Shemsi Syla
12. Nexhmedin Spahiu

Vendi i varrimit: Prishtinë

**21.01.04, e mërkurë**

15.30………………Pritja e arkivolit në aeroportin e Prishtinës dhe çuarja në Mitrovicë
Familja, Këshilli, TMK (GARDA) – vetura për arkivol

**22.01.2004, e enjte – dita e varrimit**

9.00…………………Nisja e arkivolit prej Mitrovicës
11.00 – 12.00…… .Vendosja e arkivolit për homazhe para sallës së kuqe,
Banda muzikore (TMK)

12.00 -12.30 ……...Akademia komemorative: Prishtinë, salla e kuqe
- Hapja dhe një minute heshtje………….Ismet Hajrullahu
- Fjala e rastit…………………………....Reshat Sahitaj
- Fjala e rastit …………………………...Meriman Braha

***Këshilli organizativ i krijuar nga Ministria e Kulturës***

Ceremonia mortore  u bë në Sallën e kuqe. Kryeministri i Kosovës kishte dërguar këshilltarin e tij Ibrahim Shalën, Kryetari i Kosovës kishte angazhuar të merrte pjesë  këshilltari i tij. Secila parti politike dhe institucion kishte të dërguarin e tij special për të bërë nderimet e fundit Musa Hotit ndërsa Kryetari i Prishtinës Ismet Beqiri ishte prezent personalisht gjatë tërë kohës.
Ismet Hajrullahu në cilësinë e Ministrisë së Kulturës, ishte moderatori i këtij ceremoniali mortor.

## Fjala zyrtare në ceremoninë mortore  për atdhetarin Musa Hoti



Z. Meriman Braha gjatë mbajtjës së fjalës në ceremoninë morotre

Meriman Braha
22.01.2004

E nderuar familje Hoti,
Të nderuar të pranishëm në këtë ceremoni mortore kushtuar atdhetarit Musa Hoti,

Sot, kur Kosova merr frymë ndryshe dhe sot kur perspektiva e saj duket më e qartë dhe më ndritshme, po ndahemi me dhembje prej mikut, shokut dhe atdhetarit të nderuar Musa Hoti.
Po ndahemi me dhembje dhe me një krenari njëkohësisht, me dhembje se s'do të jetë më në mesin tonë një mik, një atdhetar, një njeri i vërtetë, e me krenari se e patëm një bashkëluftëtar të paepur.

Në historinë tonë të re Janarët shpeshherë dhembshëm u përgjakën. Në janar ranë Jusufi, Bardhoshi dhe Kadriu, Rexhepi dhe Nuhiu. Dhe ja janari përsëri u përgjak. Në ditën e fillimit të përkujtimeve për një plejadë atdhetarësh që ranë, Flakës së Janarit iu shtua edhe një flakadan. Flakës së Janarit iu shtua flakadani i Musa Hotit.
Ky fakt është shumë domethënës.

Aktivitetin e tij patriotik të nisur në Kosovë e vazhdoi me ngulm edhe për 25 vjet në Belgjikë dhe vende tjera të Europës perëndimore. Ai ishte i detyruar që fizikisht të ishte larg atdheut, por shpirtërisht ishte me të, andaj nuk pushoi për asnjë çast së vepruari për lirinë dhe çlirimin e tij nga okupatori serb e jugosllav. Natyrisht se ai e bënte punën e atdhetarit pa ngurrim dhe me trimëri, por edhe organet serbe e bënin punën e tyre duke e ndjekur hap pas hapi dhe duke e rrezikuar disa here seriozisht jetën e tij.

Bashkëpunimi i tij i ngushtë me figurat e njohura të Lëvizjes sonë kombëtare të asaj kohe, si Jusuf e Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka, Enver Hadri, Vehbi Ibrahimi dhe shumë të tjerë, si dhe mbajtja e kontakteve me atdhetarët në Kosovë, tregon më së miri se sa i

përkushtuar ka qenë Musa Hoti për çështjen mbi të gjitha çështjet – çlirimin e atdheut.

Bashkë me Enver Hadrin dhe veprimtarët tjerë ai kontribuoi shumë për hapjen e dyerve të Parlamentit Europian dhe institucioneve tjera ndërkombëtare në Bruksel për të ngritur aty çështjen e Kosovës dhe të shqiptarëve, që ishte një kualitet i ri dhe shumë i rëndësishëm i veprimtarisë së mërgatës sonë.
Musa Hoti sot po i kthehet atdheut dhe po ju bashkohet shokëve të vjetër tashmë të kthyer në atdhe dhe shpresojmë se së shpejti këtu do të prehen të qetë edhe Enver Hadri e Halil Alidemaj dhe të gjithë ata që duke kontribuar për atdhe ranë dhe u varrosën jashtë.

Faleminderit, Musa, për kontributin tënd të madh për lirinë dhe çlirimin e Kosovës!

Familja Hoti,
Qofsh gjithmonë e nderuar që linde një atdhetar e trim si Musa.

**Lavdi e përjetshme !**

Kufoma e Musa Hotit nga aeroporti i Prishtinës u përcoll nga eskorta e TMK-së.
deri në Mitrovicë në vendlindjen e Musa Hotit.
Këshilli i varrimit kishte vendosur që Musa Hoti të varrosej të varrezat e dëshmorëve në Prishtinë, ku edhe sot pushon.



**Nën përkujdesjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, trupi i Musa Hotit përcillej për në varrezat e dëshmorëve në Prishtinë**

Varrimi do bëhej të mërkurën me 21 janar 2004. Trupi i Musa Hotit atë ditë për disa orë qëndroi në lokalin afër Sallës së Kuqe në Prishitnë gjithnjë duke bërë roje nderi ushtarët e TMK-së.

**Në përcjelljen e fundit të trupit të Musa Hotit ishin prezent zyrtarët e lartë të të gjitha ngjyrimeve politike.**



**Z. Ismet Hajrullahu përfaqësues nga Ministria e Kulturës gjatë fjalës së tij në ceremoninë mortore**



**Z. Isemt Beqiri Kryetar I Komunës së Prishtinës, gjatë mbajtjes së fjalës në ceremominë mortore**



Z.Ibrahim Shala përfaqësues nga zyra e kryeministrit të Kosovës, gjatë mbajtjes se fjalës në ceremoninë mortore



***Ismet Hajrullahu përfaqësues nga Ministria e Kulturës, gjatë fjalës së rastit 22 janar 2004***

***Ismet Beqiri Kryetari i komunës së Prishtinës bënë nderimin e fundit Musa Hotit***

Atë të enjte bënte acar me një borë të egër që shponte. Kortezhi i mijëra qytetarëve të Kosovës, marshonte i qetë e më zemër të thyer sepse sot po varrosnin birin e Kosovës. Sot po i jepnin lamtumirën e fundit atij që dikur i doli zot këtij vendi, këtij populli e këtyre që sot po e bartnin mbi supet e tyre. Kortezhi marshonte drejt varreve të dëshmorëve, aty ku Musën po e prisnin edhe trimat më të zgjedhur të Kosovës për të cilët vdekja për Kosovën ishte lindje.
Atë ditë bënte ftohtë e kortezhi marshonte qetë, krejt qetë. Çuditërisht posa arritëm të varret pushoi bora e egër e rrezet e diellit sikur dëshironin ta zbusnin tokën e ngrirë për ta pranuar birin dhe trimin e Kosovës që kurrë syri nuk iu tremb prej armiqve që kishte Kosova.
E bartnin mbi supe dhe ecnin qetë krejt qetë.
Erdhën për t'ia dhënë lamtumirën e fundit birit dhe trimit të Kosovës.

## *Telegrame ngushëllimi*



TRUPAT E MBROJTJES SË KOSOVËS
SHTABI I PERGJITHSHËM

**Prishtinë, më 22 janar 2004**

**E nderuara familje Hoti,**
**Të nderuar shokë dhe bashkëveprimtarë të tij,**

Duke bashkëndjerë më Ju dhembjen e madhe për vdekjen tragjike të birit Tuaj dhe veprimtarit të madh të çështjes sonë kombëtare, Musa Hotit, Ju shpreh ngushëllimet më të thella në emrin tim personal dhe në emër të të gjithë oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të Kosovës, të cilët do të përkulen gjithmonë me respekt para emrit dhe veprës së tij të pavdekshme.

Musa Hoti me shembullin e tij prej luftëtari dhe veprimtari të devotshem në shërbim të lirisë së Kosovës ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë tone të re, në të cilën do të zë një vend të nderuar.

Me gjithë dhembjen e madhe për Musën, vrasja e të cilit tregon edhe një here se Kosova ende ka shumë armiq qe nuk ia duan të mirën, një fakt duhet të ngushëllojë të gjithëve ai e mbërriti lirinë e Kosovës për të cilën bëri dhe dha aq shumë.

Musa po i kthehet sot dheut të tokës se vet dhe po varroset në varrezat e dëshmorëve pranë shokëve të jetës dhe idealit për të qenë bashkë më ta edhe në përjetësi.

Lavdi jetës dhe veprës së Musa Hotit,
Lavdi dëshmorëve të kombit,

**Me respekt ,**
**Komandanti i TMK-së**
**Gjenerallejtnant Agim Çeku**

*Telegram ngushëllues nga TMK-ja / Gjeneral Agim Çeku*

**Në adresë të Ministrisë së Kulturës, këshillit organizativ i erdhën një mori telegramesh me rastin e humbjes së patriotit dhe veprimtarit të çështjes kombëtare. Në këtë përmbledhje nuk do përfshihen të gjitha telegram, por vetëm disa prej tyre:**

**TRUPAT E MBROJTJES SË KOSOVËS**
**SHTABI I PËRGJITHSHËM**

**Prishtinë, më 22 janar 2004**

**E nderuara familje Hoti,**
**Të nderuar shokë e bashkëveprimtarë të tij,**

Duke e bashkëndjerë me ju dhembjen e madhe për vdekjen tragjike të birit Tuaj dhe veprimtarit të madh të çështjes kombëtare, Musa Hotit, Ju shprehi ngushëllimet më të thella në emrin tim personal dhe në emër të të gjithë oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të Kosovës, të cilët do të përkulen gjithmonë me respekt para emrit dhe veprës së tij të pavdekshme.

Musa Hoti me shembullin e tij prej luftëtari dhe veprimtari të devotshëm në shërbim të lirisë së Kosovës ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë tone të re, në të cilën do të zë një vend të nderuar.

Më gjithë dhembjen e madhe për Musën, vrasja e të cilit tregon edhe një herë se Kosova ende ka shumë armiq që nuk ia duan të mirën, një fakt duhet të ngushëllojë të gjithë, ai e mbërriti lirinë e Kosovës për të cilën bëri dhe dha aq shumë.

Musa po kthehet sot dheut të tokës së vet, dhe po varroset në varrezat e dëshmorëve pranë shokëve të jetës dhe idealit për të qenë bashkë më ta edhe në përjetësi.

Lavdi jetës dhe veprës së Musa Hotit,
Lavdi dëshmorëve të kombit,

**Me respekt ,**
**Komandanti i TMK-së**
**Gjenerallejtnant Agim Çeku**

SHOQATA E VETERANËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE KOMBËTARE

## TELEGRAM PËRSHËNDETËS

E nderuara familje e Musa Hotit,
Të nderuar bashkëveprimtarë të Musa Hotit,
Të nderuar të pranishëm të Akademisë Përkujtimore,

Në pamundësi që të marrim pjesë në Akademinë Përkujtimore, të organizuar në shenjë kujtimi për atdhetarin e devotshëm, Musa Hoti, ju përshëndesim të gjithëve në emër të Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni.

Krismat e revolverit të Musa Hotit në Bruksel, më 4 gusht 1981, paralajmëronin se përpjekjet e shqiptarëve për çlirim dhe ribashkim kombëtar, kishin hyrë në një fazë të re. Këto krisma që do të pasohen edhe nga ato të flakadanëve të janarit, Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, në janarin e vitit 1984, për tu shumëzuar, pandërprerë, deri te krismat ngadhnjimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilat do ta çlirojnë Kosovën nga pushtuesit serb, në vitin 1999, së bashku me forcat e NATO-s të udhëhequra na Shtetet Bashkuara të Amerikës.

Qofshin faqebardhë ata që organizuan këtë Akademi Përkujtimore.

I përjetshëm qoftë kujtimi për atdhetarin Musa Hoti.

Kryetari,
Fazli Veliu

...qata e Veteranëve të
...trisë Çlirimtare Kombëtare
në Maqedoni

***Telegram nga Shoqata e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare nga Tetova***

**SHOQATA E VETERANËVE**
**TË USHTRISË ÇLIRIMTARE KOMBËTARE**

## TELEGERAM

E nderuara familje e Musa Hotit ,
Të nderuar bashkëveprimtarë të Musa Hotit,
Të nderuar të pranishëm të Akademisë Përkujtimore,

Në pamundësi që të marrim pjesë në Akademinë Përkujtimore, të organizuar në shenjë kujtimi për atdhetarin e devotshëm, Musa Hoti, ju përshëndesim të gjithëve në emër të Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni.

Krismat e revolverit të Musa Hotit në Bruksel, më 4 gusht 1981, paralajmëronin se përpjekjet e shqiptarëve për çlirim dhe ribashkim kombëtar, kishin hyrë në një fazë të re. Këto krisma që do të pasohen edhe nga ato të flakadanëve të janarit, Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, në janarin e 1984, për shumëzuar, pandërprerë, deri te krismat ngadhënjimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilat do ta çlirojnë Kosovën nga pushtuesi serb, në vitin 1999, së bashku me forcat e NATO-s të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
Qofshin faqebardhë ata që organizuan këtë Akademi Përkujtimore.
I përjetshëm qoftë kujtimi për atdhetarin Musa Hoti.

Tetovë **Fazli Veliu**

**Telegram drejtuar:**

**Familjes së veprimtarit Musa Hoti**

**E nderuara familje e Musës,**

Me pikëllim të thellë morëm lajmin e hidhur të vrasjes në Bruksel të veprimtarit të çështjes kombëtare Musa Hotit.

Në emër të Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe në emrin tim personal familjes Hoti i shprehi ngushëllimet më të thella.

Me pikëllim,

**Kryetar i Lëvizjes Popullore të Kosovës**

**Emrush Xhemajli**

Prishtinë, më 19 janar 2004

251

***Telegram ngushëllues nga LPK, Emrush Xhemajli***

**Telegram LPK**
**Familjes së veprimtarit Musa Hoti**

E nderuara familje e Musës,

Me pikëllim të thellë morëm lajmin e hidhur të vrasjes në Bruksel të veprimtarit të çështjes kombëtare Musa Hotit.
Në emër të Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe në emrin tim personal, familjes Hoti i shprehi ngushëllimet më të thella.

**Kryetari i Lëvizjes Popullore**
**Emrush Xhemajli**
**Prishtinë, më 19 janar 2004**



TELEGRAM NGUSHLLIMI FAMILJES HOTI

Vëllezërit Dr.Ramadan dhe Xhimë Xhema dhe miku Mehdi Hajdari me familje nga Amerika, i shprehin ngushllimet me të sinqerta familjës se atëdhetarit të devotshëm MUSA HOTIT, i vrarë në Bruksel nga një dorë tinzare.
Shpresojmë se autori i kësaj vrasje makabre së shpejti do të gjindët para drejtësisë dhe do ta marë denimin e merituar.

Zoti e bekoftë familjën Hoti!

Amerikë, 21. 01. 2004.

*Telegram ngushëllimi nga vëllezërit Xhema & Mejdi Hajdari, SH.B.A*

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI FAMILJES SË MUSA HOTIT**
**Vëllezërit Dr. Ramadan dhe Xhimë Xhema, dhe MEJDI HAJDARI**
**ShBA**

Ju shprehim ngushëllimet më të sinqerta familje së atdhetarit të devotshëm Musa Hotit, i vrarë në Bruksel nga një dorë tinëzare.
Shpresojmë se autori i kësaj vrasje makabre së shpejti do të gjendet para drejtësisë dhe do ta marrë dënimin e meritruar
Zoti e bekoftë familjen Hoti

## Amerikë 21.01.2004

Telegrame ngushëllimi familjes së Musa Hotit i arritën nga shumë personalitete vendore si dhe nga bashkatdhetarët tanë nga diaspora. Disa prej tyre botohen në këtë vëllim ndërsa tjerët në vëllime të ardhshme që padyshim do dalin edhe tre vëllime të tjera nga

dokumentacioni që e ka sistemuar Musa Hoti dhe e ka ruajtur familja e tij.
Më sa vijon do i lexoni disa mendime që janë të shkurtuara, por në vëllimin tjetër do të botohen të plota.

## Ymer Duboci

Gjatë viteve që isha drejtor (1960-1971) pranuam një numër të të përndjekurve politikë. Këta të rinj nuk i pranonte asnjë shkollë tjetër në Kosovë! Kjo shkollë me emrin "Rilindja", rilindi patriotë të ri dhe armatosi rininë me dituri si askund tjetër. Nga kjo plejadë patriotësh dolën kuadro të afta, të reja, të cilat dashurinë ndaj diturisë, atdheut e mbollën thellë në zemrat e nxënësve të tyre. I përkujtoj me dashuri dhe respekt të përjetshëm: 1. Fazli Grajqevci, 2. Musa Hoti, 3. Rrustem Morina, 4. Avdyl Lahu, 5. Zeqir Gërvalla, 6. Emine Rakovica, 7. Ragip Veseli, 8. Lah Musliu, 9. Ilaz Meta, 10. Idriz Rreci, 11. Sokol Meha, 12. Rizah Meha e të tjerë. Kujtimi i Dëshmorëve të lirisë dhe të atyre që dhanë sadopak për lirin e popullit tonë nuk do të harrohen kurrë!

**Lavdi për jetë Dëshmorit Musa Hoti dhe të gjithë Dëshmorëve të rënë për liri!**


I paharruar qoftë kujtimi i dëshmorit Musa (Daut) Hoti.
Lavdi për jetë shqiptarkave e shqiptarëve të vërtetë.

Faleminderit.
Prishtinë:15 janar 2005

Prof. Hazir R. Shala, kryetar i
Lëvizjes Kombëtare Shqiptare

**Nga fjala e Prof. Hazir Shalës**

## Prof. HAZIR SHALA

Lajmi mortor i dhembshëm pikëlloi të gjithë shqiptarët e vërtet. Dhembja e madhe ishte për familjen e tij: bashkëshorten Mevlyde, vajzat, Mimoza, Manushaqe, Melisa dhe djalit Martiri.
Me Musain mburrën të gjithë ata që e njohën , ata që e vlerësojnë sakrificën, pavdekësinë e tij për të gjithë shqiptarët.
Akti i tij ishte i guximshëm, ishte njëkohësisht kundër fashistëve, militaristëve pansllavë, si dhe kundër fodullëkut fiktiv, injorancës, inferioritetit kalkulant karierist...

**Profesor Hazir Shala, kryetar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare**


Në emër të shoqërisë në Bruksel,Degës së PDK-së,Degës së AAK-sëdhe në emërin tim personal ju përshëndes të gjithëve dhe e ndajmë dhimbjen me ju.

Lavdi jetës dhe veprës së Dëshmorit Musa Hoti!

Lavdi të gjithë Dëshmorëve të Kombit!

Në Bruksel,më 15 janar 2005

I juaji Qamil Zekolli,Bllacë ,Therandë

**Qamil Zekolli**
**Therandë – Bllacë**

Krismat që dolën nga arma e Musa Hotit,në qendër të Brukselit, jehuan njëlloj si “Dy krisma
në Paris” të të madhit Avni Rrusetemi.
Të nderuar familje e Musa Hotit,
Të nderuar pjesëmarrës,
Të nderuar organizatorë, Krismat e prindit, vëllait dhe shokut tuaj dhe tonë të idealit, tash dëshmor i kombit Musa Hotit, me jehonën e tyre zgjuan gjithë diasporën nga amullia dhe gjumi i rëndë, që si një

ankth e kishte kapluar dhe ende hamendej në përkrahje a jo të kërkesave për Republikën e Kosovës.
Qe nga vera e vitit 1981, u ndritën zemrat e të gjithë mërgimtarëve qe nga Australia e largët e deri në SH.B.A.. Gjatë kohës kur Musai ishte në burg , ne kemi pritur me qindra e mijëra vizita nga bashkatdhetarët tanë, që vinin nga të gjitha shtetet e Europës , nga SH.B.A. edhe nga Australia. Këto vizita ishin një përkrahje e madhe morale për familjen dhe për Musain, por njëkohësisht ishte edhe një ndërgjegjësim i diasporës shqiptare.

**Sabri Novosella**

Çështja shqiptare arrihet vetëm duke i përkrahur e mbështetur pasardhësit e atyre patriotëve e atdhetarëve të vërtetë, që asnjë moment nuk kanë rënë nën ndikimin e propagandës së fuqishme të regjimeve komuniste, por gjithherë janë vë në ballë të luftës për çështjen kombëtare.
Musa Hoti i takon asaj plejade të bijve dhe bijave më të guximshëm që dha kombi shqiptar me shekuj në luftëra të shumta e me armiqtë të ndryshëm që e sunduan këtë tokë, këtë dhe , të cilët u munduan ta zhduknin çdo gjë që frymonte shqip.
Vetëm me mençuri e guxim siç kishte Musa Hoti, çeshtja kombëtare mundët lirshëm të ecë përpare, sepse amanetin e dëshmorëve ende nuk e kemi krye, ne ende kemi për të punuar.
Lavdi dëshmorëve që dhanë edhe pikën e fundit të gjakut për liri të atdheut

**Sabri (Maxhuni) Novosella**

## NË EMËR TË FAMILJES HOTI
## MANUSHAQE HOTI – ( vajza e Musës)

Të nderuar personalitete të kulturës dhe politikës,
Të nderuar bashkëveprimtarë të babait tim,
Të nderuar pjesëmarrës,

Jam plotësisht e bindur se populli shqiptar i ka kuptuar planet makiavelike të shërbimit sekret serb, andaj, sot është koha që populli shqiptar të jetë më i bashkuar se kurrë.
Më vrasje të tilla, armiku nuk mundet të na frikësojë.
Me vrasje të tilla, armiku nuk mundet të përçajë popullin tonë, por e forcon edhe më shumë vetëdijen e ngritjes kombëtare.
Me vrasje të tilla, armiku kurrë nuk do të arrijë planet e tyre djallëzore e antishqiptare.
Kosova tanimë ka hyrë në një epokë të re dhe rruga e saj drejt realizimit të pavarësisë është e paevitueshme.

Lavdi të gjithë atyre që e dhanë jetën për liri të Kosovës!

**Manushaqe Hoti**
**Prishtinë 22 janar 2004**

*** * ***

***A ka përfunduar libri për Musa Hotin... ?***

Libri për jetën dhe veprimtarinë e Musa Hotit është i pashtershëm. Studiuesit e mëvonshëm kanë materiale të lënë nga kujdesi personal i Musës dhe familjes dokumente, që më gjerësisht mundet të shkruhet për luftën dhe kontributin e diasporës dhënë çështjes kombëtare.

Në këtë vëllim është paraqitur figura e Musa Hotit në të gjitha dimensionet duke i ofruar lexuesve dhe studiuesve edhe hafijeve e të painformuarve, biografinë e Musës sa më komplet.
Për fund të këtij vëllimi, kam shkëput disa pjesë nga një letër e poetit tonë të mirënjohur Agim Saphiu, më të cilin Musa Hoti këmbente letra si dhe një shkrim nga Berham Hoti aktivist i dalluar i çështjes kombëtare.
Shprehjet e Agim Spahiut nuk më kanë lënë indiferent, sepse këtë letër, ai më tërë sinqeritetin e tij dhe me shpirt artisti e shpreh brendësinë shpirtërore të ndjenjave të veta që ka për Musa Hotin.
Me pak fjalë të Agim Spahiut, lexuesit do të mësojnë për personalitetin dhe butësinë
shpirtërore të Musa Hotit, më shumë se nga tërë vëllimi i këtij libri që posa e keni përfunduar së lexuari. Kurse me pak rreshta të Berham Hotit lexuesit do të informohen edhe shumë më afër për aktivitetet e Musës në Kosovë.



Kukës, 30.09.'90

Fort i dashur dhe i shtrenjtë
im vëlla Musa!

Sot mbasdreke mora letrën Tuaj
të mrekullueshme dhe në familjen tonë
pati festë: ju kujtuam me mall gjer tash,
në orën 24.00 E tamam në minutat e parë
të 1 tetorit kam nisë t'ju shkruaj e të bi-
sedoj me ju shpirtërisht, me ju që më
nderuat e më kujtuat, me ju që më falët
një ditë të mahnitshme (7 korrikun) dhe
emocione të forta sot e përjetë. Të falen-
derohem fort për gëzimin dhe kujtesën
që më bëtë. Edhe një herë e përherë ju
falënderoj për rezonimin shpirtëror dhe
dashurinë e korrektesën!

Letra juaj më ishte nisë nga
Belgjika me 12.09.90. Pikërisht në këtë ditë
ju kam nisë nga Kukësi disa libra
në adresën e Damilit. Me Damilin, që

***Kopje nga origjinali i letrës së poetit Agim Spahiu 1990***

Kukës, 30.09.'90

**Fort i dashur dhe i shtrenjtë**
***im vëlla Musa !***

***Sot mbasdreke mora letrën Tuaj të mrekullueshme dhe në familjen tonë pati festë:***
***Ju kujtuam me mall gjer tash, në orën 24.00. E tamam në minuat e parë të 1 tetorit kam nisë t'ju shkruaj e të bisedoj me ju***

***shpirtërisht, në ju që më nderuat e më kujtuat, në ju që më falët një ditë të mahnitshme ( 7 korrikun) dhe emocione të forta sot e përjetë. Të falënderohem fort për gjerësinë dhe kujtesën që më bëtë. Edhe një herë e përherë ju falënderoj për rezonim shpirtëror dhe dashurinë dhe korrektesën.***

..................................................

***Thellësisht në ndërgjegjen time e kam ndjerë domosdoshmërinë e komunikimit me ju, por gjithnjë kam menduar se jeni tepër i zënë më punë dhe, ndoshta, ju çova veç të fala me Qamilin e shtrenjtë.***
***Por krejt papritur, si një pëllumb të bardhë dashurie dhe malli marrë një letër tepër emocionuese prej jush. Dhe vetëm këtë çast e kuptoj se midis punëve të rëndësishme ju gjeni kohë të më shkruani e të bisedoni shpirtërisht më mua.***
***Të faleminderit vëlla Musa!***
***Musa i shtrenjtë, ne ndejtëm fort pak bashkë: krejt, krejt një orë e diç më tepër; por unë gjithmonë i kam besuar syrit dhe vështrimit prej shpirtit se sa proverbit arab. Dhe ne të dy u njohëm edhe me një valë syri e shpirti , miku im , edhe me një vështrim, se hallet e mëdha kombëtare na i bashkojnë lotin e helmin....***
***Kam përpara letrën tënde , që ma mbushi shpirtin e shtëpinë, më lartësoi bjeshkët e besimin ma shumëfishoi dashurinë.***
***Eh Musa Hoti, Musa Hoti! Sa fort e paskam dashtë letrën tënde e shpirtin tënd e fjalët tua të mençura këtë natë të gjatë!***

**Krismë e armës së lirisë**

**Nga Behram HOTI**

Epokat e lavdishme të historisë kombëtare shqiptare janë jo të pakta në shekuj të etnoqëndresës së kombit shqiptar. Këto epoka kanë nxjerrë në sipërfaqe të historisë sonë atdhetarë, luftëtarë, urtakë, mendjendritur, vizionarë, flijimtarë...Por nëpër këto epoka

nuk janë të rrallë edhe atdhetarët e njohur-atentatorë kundër organeve, spiunëve, pushtetarëve të okupatorëve që tentuan ta gllabëronin dhe ta nëpërkëmbnin identitetin, atdhedashurinë e shtresave të kombit shqiptar. Historia kombëtare shqiptare njeh patriotë të cilët flijuan vetveten, jetën e tyre për të mirën e popullit, për dritën dhe lirinë e atdheut që mjegullohej herë pas herë nga shkelësit serbo-ruso -sllavë, grekofilë e bashkëpunëtorë me përmasa të hidhura kundër ardhmërisë së Shqipërisë.

Këta atdhetarë flijuan vetveten, jetët e familjeve të tyre, për të mbetur lapidar të historisë kombëtare shqiptare. Një bimë, një diell i pashuar në qiellin e lirisë së kombit tonë është komandanti legjendar i lirisë dhe i ardhmërisë të ndritur Adem Jashari...Në këtë udhë të atdheut, në këtë horizont të qiellit të tokës shqiptare, në këtë vargmal të lisave dhe të trojeve tona është padyshim edhe dora, zemra dhe gishti i një atdhetari të pavdekshëm Musë Daut HOTIT.

## *Musa Hoti rrënjë Drenice*

Musë Hoti, qe nga fëmijëria dallohej për ndjenjën e thellë të dashurisë, ndaj gjakut të tij, ndaj kushërinjve, bashkëqytetarëve, por në veçanti kjo ndjenjë përflakej më respekt të thellë ndaj veprimtarëve kombëtarë të Drenicës dhe trevën e Mitrovicës. Musa i ynë qe në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare iu kundërvu okupatorit, çetnikëve dhe kolonëve që jetonin në Mitrovicë. Kështu disa herë e gjurmuan policia dhe e bastisën familjen e tij, por vëllezërit dhe motrat e tij qendruan stoikisht duke mos treguar se ku gjendet Musa, me kënd po shoqërohej...

Çetnikët dhe udbashët e kishin në shenjestër familjen e Daut dhe Murat Hotit në Mitrovicë. Ata i përgjonin edhe familjet tjera atdhetare të Drenicës e të Shalës së Bajgorës. Ndërsa Musa strehohej në familjët e shokëve të tij në Mitrovicë.

Por, Musa Hoti, strehim dhe frymëzim të përhershëm kishte kusheririnin e tij(autorin e këtyre evokimeve)...qe në vitet 1962-1964 ishte nxënës i zellshëm në shkollën normale të Prishtinës.

## *Lëvizjet e Musa Hotit në Prishtinë*

Pasiqë Musa i Drenicës,siç e quanin bashkëveprimtarët e tij, në moshën e re djaloshare në Mitrovicë u kishte ra në sy milicëve serbë dhe serbofilëve, udbashëve serbë dhe udbashofilvëve, ai kaloi në Prishtinë, pikërisht, nën përkujdesjen dhe veprimtarinë e nxënësve të Drenicës, në shkollën normale në Prishtinë, që u paraprinte Ukshin Hoti, Behram Hasan Jashari-Hoti, nga Likoci, Adem Rukiqi nga Verbovci, Adem Shaban Mula, nga Tërsteniku, Hamdi Fallani, Islam Krasniqi, Bardhec Kelmendi nga Balinca, Habib Delijaj nga Abria, Daut Demaku nga Abria, Avdi Shala nga Nekoci, etj. të cilët krijuan bërthamën e parë të Drencës në vitet 1962-1964 në Prishtinë. Musa ishte një djalosh i shkathët dhe kishin filluar hetimet në Gjykatën e Mitrovicës,kundër veprimtarisë së tij. Familja e tij në Mitrovicë ishte shndërruar në një qendër strehimi të nxënësve të shkollave të mesme të Drenicës, që i vazhdonin mësimet në Mitrovicë. Babai dhe nëna e Musait, vëllezërit e tij nuk i linin pa bukë kurrë shokët e shkollës së Musait. Në Prishtinë, pasi që ma besoi në katër sy se ishte ngritur akuzë gjyqësore nga një gjykatës i quajtur Radmanoviq, si dhe nën presionin e milicisë gjurmohej Musai, unë i thash "që për këtë "njollë" të mos e informojë askë, sepse në mesin tonë kishte nxënës të moshave të reja dhe ata nuk duhet të bijën pre e hetuesve"... Musa, i njohur si trim për sakrificë kurdo që dikton momenti dhe kushtrimi që të ballafaqohet fizikisht me milicinë serbosllave, e mirëpriti këshillën e grupit tonë të Drenicës. Nga dy herë në javë lëvizte prej Mitrovice, hynte në fshatrat e thella të Drenicës dhe kalonte në Prishtinë. Ne i ramë në gjurmë aktakuzës. Hetuam se një daktilografe e gjykatësit

Radmanoviq, e lindur dhe e rritur në Prishtinë ishte shoqe e një nxënëseje të Shkollës Normale në Prishtinë. I kishin shtëpitë ballëpërballë pranë xhamisë së madhe të Sulltan Muratit në Prishtinë, në rrugën e Gërmisë. (Gërmia ishte Shkolla Normale e Prishtinës). Kjo nxënëse besnike (më vonë do të bëhet e dashura dhe bashkëshortja e Behram Hotit), që mësoi prej daktilografes së gjyqtarit Radmomnoviqi i cili e kishte lëndën e hapur të akuzës me të cilën akuzohej Musa Hoti, nga Mitrovica, si veprimtar i dyshimtë për prishjen e rendit dhe qetësisë së shtetit. Akuza ishte ngritur në gjyqin komunal dhe ishte bartur në Gjyqin krahinor për kundërvajtje në Prishtinë. Gjyqtari Radmanoviq në bisedë e sipër me daktilografen e tij, Hysnije Karabegu, shprehet: "me këtë akuzë Musa Hoti nga Mitrovica, deri në dy vite, por nëse ankohet prokurori mund ti dyfishohet dënimi deri në katër vite, sepse lënda është e prekshme politikisht mu pse babai i Musës, në lëndë - akuzë konfirmohet si një bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës.

Pas hetimit të kësaj lënde të rrezikshme për Musain dhe familjen e tij, rruga e lëvizjeve të Musait Mitrovicë-Prishtinë ishte rënduar edhe më shumë, por veprimtaria e jonë me syçeltësi kaloi në konspiracion të thellë. Në normalen e Prishtinës erdhi edhe Ukshin Hoti, nga Normalja e Prizrenit, së bashku më Islam Krasniqin e Negrocit dhe Bardhec Kelmendin e Balicës.

Veprimtaria jonë atdhetare është ngritur edhe më lart. Kështu që në vitin 1964 dy muaj para se të burgoset mësuesi,atdhetari dhe sinonimi i flamurit kombëtar Fazli Greiçevci, grupi i Drenicës në bashkëveprim me grupin e Llapit të shkolllës Normale në Prishtinë, organizojnë një demonstratë në oborrin e Shkolllës Normale me moton Përmbysja e bustit të Milladin Popoviqit, që ishte në oborrin e kësaj shkolle. Kjo ndodhi në një ditë para agimit të hershëm të nëntorit ku busti i Milladin Popoviqit u përlye me ngjyrë të zezë. Ndërsa pas kësaj pasojnë represaliet , ndërsa Behram Hoti (atëherë Behram Jashari) dhe Zeqir Gërvalla, që të dy nxënës të shkollës së normales, largohen nga shkolla si të padëshiruar dhe vazhdojnë mësimet e viteve të katërt në Shkollën Normale të Mitrovicës. Në Mitrovicë familja e Daut Hotit, njëherit ishte familja më e ngrohët

për këta dy nxënës kryengritës të larguar nga Normalja e Prishtinës. Musa Hoti dhe i vëllai i tij Avdullahu u bënë veprimtarë më besnikë të lëvizjes kombëtare shqiptare për vetësi, shkëputje të Kosovës nga Jugosllavia. Në Mitrovicë u fuqizua grupi i Drenicës më fizionominë e grupit të Shalës së Bajgores. Këtu po i përmendim disa nga veprimtarët e çështjes kombëtare ish nxënës të shkolllës normale në Mitrvicë: Fazli Greiçevci (për një kohë ishte mësues në Dubrashec të Drencës), Jakup Ceraja, Zeqir Gërvalla, Mehmet Kajtazi, Muhamet Kajtazi, Qerkin Peci, Esat Murtezaj, Halit Berani,Fazli Hajrizi, Nuradin Gubetini, Isa Gubetini, prof. Ahmet Maloku, prof. Latif Berisha, Hanumshahe Bimbashi, Nurije Misiri, Melihate Hoti,Nebil Duraku,shkrimtar dhe publicist i Drenicës dhe Behram Hoti.

Për një vit shkollor sa qëndruam në Mitrovicë, Musa Hoti, kishte dy thirrje nga milicia për Gjykatë të Qarkut në Prishtinë. Në Kuvendin e mbajtur në shtëpinë e Jakup Gllavnikut në rrugën "Millladin Popoviq" nja dyqind metra larg shkollës teknike të Prishtinës, morëm vendim që Musa Hoti të largohet nga Mitrovica dhe Prishtina dhe të emigrojë në Belgjikë. Aktakuza kundër Musa Hotit mbeti në sirtarët e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Familja e tij disa herë bastiset nga milicia, por përgjigja e prindërve të Musës ishte "kemi informata se djali ka shkuar të punojë në Maqedoni". Pastaj pasuan kohë dhe katrahura të rënda për Kosovë. Musa Hoti ndodhej në Bruksel të Belgjikës, ndërsa i vetmi kontakt më të ishte telefoni,që kontaktonim nga posta qendrore e Prishtinës. Përgjigja e tij ishte, ju punoni atje, pra në Kosovë, unë po punoj në Belgjikë dhe një ditë ndodhi: shkrepi arma e lirisë nga dora e tij e djathtë atdhetare...Lajmi i “Tanjugut” përshkoi territorin jugosllav, ballkanik dhe Europian: "sot u bë atentat në ambasadorin e Jugosllavisë Gjeriq, në Bruksel të Belgjikës...atentatori është Musa Hoti".

## *Edhe patriotët “pushojnë” …*

Kohë e egër dimërore atë janar 2004. Musa iu ishte kthyer tokës ku ishte betuar se do e jepte edhe pikën e fundit të gjakut për Kosovë. E mbi supet tanë po e bartnim trupin e tij që po e priste toka nënë. Arriti Musa Hoti në Kosovë duke e pritur Fazli Greiçevci me flamur. Musai e puthi flamurin në gjoksin e Fazliut. Fazliu i puthi dorën dhe gishtin e armës së lirisë...Fazli Greiçevci prehet në qetësi në varret e Nekocit të Drenicës...

Musa Hoti kuvendon më varret e dëshmorëve në Prishtinë... Kuvendin e përcjellin dhe e lartësojnë pëllumbat e pëllumbeshat e lirisë...Jusuf Gërvalla me Bardhoshin e Kadri Zekën thërrasin: “Ja ku jemi o Azem Galica...!”

**R E C E N S E**

# KUJTESË E VYER PËR BREZAT E SOTËM DHE TE ARDHSHËM

Reshat Sahitaj, njëri prej emigrantëve politikë kosovarë, veprimtar aktiv në diasporën shqiptare të Belgjikës për çlirimin e Kosovës nga zgjedha serbe dhe i kauzës kombëtare në tërësi, vjen me librin e ri titulluar Musa Hoti.

Djaloshi, burri trim, luftëtari i pa epur me fjalen e mësuesit dhe me penën e publicistit për lirinë e Kosovës dhe të çështjes kombëtare është i mirënjohur për gjeneratën e tij në Kosovë dhe në diasporë. Por Reshat Sahitaj, shok, mik e bashkëveprimtar atdhetar i tij, e sheh të udhës që figurën dhe personalitetin e dëshmorit Musa Huti t'ua bëjë të njohur brezave të sotëm dhe t'u lërë trashëgimi edhe brezave të ardhshëm të Kosovës dhe të mbarë kombit shqiptar. Për përmbushjen e këtij misioni, autori i këtij libri, veç kujtimeve vetiake dhe të bashkëkohëse, ka të ruajtur në arkivin e tij një varg dokumentesh.

Libri është konceptuar si një monografi ose më saktë një tërësi shënimesh, kujtimesh, përjetimesh e dokumentesh si bazë për një monografi shkencore. Kjo vërehet edhe në strukturën e thjeshtë narrative të librit me lajtmotiv thëniet e Musa Hotit: "Kosova është gjaku im qe nuk falet" dhe "Një ndër kushtet qenësore të kosovarëve është e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje, duke përfshirë dhe viset tjera shqiptare ne Maqedoni e Malin e Zi".

Në funksion të këtyre ideve e synimeve për një monografi të plotë, Reshat Sahitaj paraqet e sistemon një lëndë të pasur të përbërë nga kujtime, përjetime, letërkëmbime, artikuj të gazetave të kohës dhe dokumentesh, ndërthur me komente , analiza, gjykime dhe vlerësime vetiake.

Lënda e pasqyruar është organizuar thjeshtë në copëza të shkurtra e sythe me nëntituj që mbartin dhe përçojnë te lexuesit ide, të dhëna e fakte, që lidhen me heroin e veprës, me jetën e tij, por edhe me zhvillimet politike, shoqërore e historike në rrjedhën e kohës.

Pasi jep të dhëna e dituri se "Kush ishte Musa Hoti", nisur nga formimi atdhetar, nga fjalët këshillat dhe tregimet e babait, që kishte vuajtur shumë vjet në burgjet e Serbisë dhe vrarë prej tyre; nga jeta si nxënës aktiv atdhetar në bankat e gjimnazit dhe në auditorët e universitetit; nga puna si mësues; nga keqtrajtimet në zyrat e hetuesisë, që paralajmëronin arrestimin e tij; Reshat Sahitaj tregon se si u arratis dhe si u prit në Belgjikë.

Në Bruksel gjëndja nuk ishte ashtu si e idealizonte dhe e dëshironte Musa. Ishin krijuar parti, organizata dhe grupe politike më shumë se në çdo vend tjetër. Secila parti, organizatë a grup ishte kundër partisë, organizatës a grupit tjetër. Relacionet konfliktuale nxisnin dhe ushqenin shërbimet sekrete, UDB-ja dhe ambasada e Jugosllavisë në Belgjikë, kryesisht duke shfrytëzuar elementin e lëkundur, servile ose në shërbim të tyre për interesa të caktuara. Shërbimi Sekret përhapte gënjeshtra, intriga e thashetheme për t'i futur shqiptarët në grindje me njëri tjetrin; ndërkohë zbatonin stisjen e tyre për diferencimin politik. Në këto rrethana e mjedise vepronin atdhetarët midis tyre edhe Musa Hoti.

Në libër pasqyrohen aksionet dhe aktet politike të diasporës shqiptare në Bruksel në koordinim edhe me bashkatdhetarët që jetonin dhe vepronin në shtete të ndryshme të Europës dhe përtej oqeanit.

Grupi i shqiptarëve të Brukselit merrte pjesë në demonstrata e organizuara në Hagë, në Zyrih, në Gjenevë, në Frankfurt etj. Në Bruksel krahas shkollës plotësuese për fëmijët shqiptarë në gjuhën shqipe, organizuar "nën kujdesin" e Amasadës Jugosllave, u hap edhe shkolla shqiptare "Bajram Curri" në shtëpinë e atdhetarit Isa Hoti. Veprimtarë të shquar me krijimin Komitetit për Mbrojtje të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Byronë Informative të Republikës së Kosovës, e njohur dhe e mirëpritur edhe nga institucionet ndërkombëtare ndikuan shumë në dëgjimin e zërit të protestës së shqiptarëve për represionin e terrorin serbomadh në Kosovë. Kjo Byro arriti të sigurojë pjesëmarrjen e disa prej personaliteteve eminente kosovare në séance të Parlamentit Europian.

Këto e mjaft zhvillime atdhetare sidomos pas demonstrative të Prishtinës në pranverën e vitit 1981 ndikuan në ngritjen e vetëdijes

kombëtare në diasporën shqiptare, jehuan në Kosovë dhe tranden Beogradin. Një ndër aktet e qëndresës shqiptare ndaj terrorizmit serb ishte krisma e pushkës së Musa Hotit në restorantin “Wite Horse” më 4 gusht 1981, që në situate vetëmbrojtjeje qëlloi dhe vetëm me dy të shtëna vrau diplomatin Stojan Gjeriq e plagosi dy punonjës të tjerë të Ambasadës Jugosllave. Në shënimet e arsyetimet për shkaqet e rrethanat e këtij akti të Musa Hotit dhe në vijim përshkruhet “Odisea” dhe veprimtaria e pandërprerë e këtij trimi deri kur Shërbimi Sekret serb ia mori jetën.

Në libër pasqyrohen karaktere, tipa shoqërorë dhe personalitete të njohura dhe të shquara të Lëvizjes në diasporën shqiptare në Europë dhe më tej si Sabri Novosella, Hysen Gërvalla etj., të rënët si Vehbi Ibrahimi, Jusuf Gervalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, Enver Hadri.

Lexuesi njihet edhe me tipa shoqërorë që, për çështjen e atdheut janë gati të bëjnë akte si ai i aviatorit Faik Kosova. Ky ish-pilot në ushtrinë turke, për t’i dalë zot Kosovës, rrëmbeu aeroplanin ushtarak për një sulm kundër ushtrisë zaptuese, por u detyrua të kërkojë strehim politik në Bruksel; me tipa si Luljeta Kurtesi aktiviste e shquar në diasporën shqiptare; një galeri e tërë veprimtarësh, liderësh politikë dhe njerëzish të thjeshtë “pa emër dhe të lënë në harresë”, siç thuhet në libër.

Krahas tipave pozitivë nxirren në pah edhe ata negative, si serbja me emrin Zorica, agjente terroriste serbe, përgatitur dhe ushtruar në bodrumet e Ambasadës Jugosllave, që u lidh me atdhetarin Rasim Zeneli dhe, kur nuk arriti të realizojë misionin e spiunes, u urdhërua dhe gjeti rastin më 14 maj 1981 të zbrazë 8 plumba nga revolveri i saj në trupin e “të dashurit”, duke e lënë të gjymtuar për jetë.

Me vërtetësi autori i këtij libri ka skicuar e shënuar ngjarje dhe episode si akti i Musa Hotit ndaj grupit të provokatorëve serbë të Ambasadës Jugosllave; si vrasja e Vehbi Ibrahimi nga “dora e zezë” e

Shërbimit Sekret serb më 10tetor 1981 dhe ceremonia mortore madhështore në varrezat e Skarbergut në Bruksel; por edhe episodin e

burracakërisë së gazetarit beogradas Rajko Gjurgjeviç, i revistës "Duga", që, i shoqëruar nga spiunë të UDB-ës, shkoi në shtëpinë e Musa Hotit, kur ai ishte në burg, etj.

Libri duket, është shkruar me çiltërsi, ku autori paraqitet edhe si dëshmitar, jo vetëm i veprimtarisë së Musa Hotit, por, përgjithësisht, i diasporës shqiptare të Belgjikës ku ka bërë jetë aktive për lirinë e Kosovës dhe çështjen kombëtare për rreth një çerekshekulli si emigrant politik. Autori, nisur nga fakte dhe dukuri të realiteteve bashkëkohëse, synon t'u japë përgjigje atyre që "tash pas luftës po dalin trima" duke rrahur gjoksin se paskan bashkëpunuar me x apo y dëshmorë, edhe pse mire dihen se asokohe qëndronin strukur duke soditur ngjarjet kombëtare. "Ne ishim ata që ishim"- shkruan Reshat Sahitaj dhe vijonim punën tonë. Edhe kur dikush thoshte se me aktivitete kulturore nuk çlirohej Kosova, ata përsëri vijonin të organizonin veprimtari kulturore; të botonin në Bruksel edhe revistën letrare "Iliria", të publikonin kronika, lajme dhe artikuj në mediat prestigjioze të Belgjikës, si "Le soir" dhe "La derniere heurs" etj. Ai kritikon shkrimet fiktive, që e shtrembërojnë të vërteten historike, duke i cilësuar ata si "pjellë e imagjinatës" dhe ngulmon në mendimin se "Historia nuk shkruhet sipas dëshirave dhe trilleve të kujtdoqoftë, por mbi bazen e fakteve, të dokumenteve".

Kësisoj botim i ri i Reshat Sahitaj pasuron literaturën historike për lëvizjen heroike të çlirimit të Kosovës dhe të kauzës sonë kombëtare; është një kujtesë e vyer për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

*Hamit Boriçi*

Biografia e autorit



Reshat Sahitaj, i lindur me 1952, në fshatin Sopijë, komuna e Suharekës.
I martuar tre fëmijë.
Ka punuar në teatrin e qytetit në Prizren me regjisorin Sefo Beta Krasniqi
ku luan në dramën “Sfinga e gjallë”.
Në Bruksel diplomon në Ecole Supérieur de l’Etat – gjuhën frënge.
Në Radio Prishtinë luan në radiodramën “Vdekja e Gjergjezit”
Në Televizionin e Prishtinës (RTP), luan në filmin televiziv “Rropullari”
Vite me radhë ka përfaqësuar Kosovën në gara të recitueseve
Për shkaqe politike qe i detyruar të largohet nga Kosova për në Belgjikë.
Në Bruksel angazhohet për çështjen kombëtare qe nga ditët e para të instalimit të tij .
Në Bruksel qe nga viti 1981 e deri ne vitet e pas luftës ishte organizator i shumë demonstratave te cilat mbaheshin kohë pas kohe
.

Në vitin 1982, në Bruksel hap shkollën e parë shqipe te pavarur nga shkolla shqipe e ambasadës serbe.
Në vitin 1982, boton librin “Rojtari i Shqipërisë së harruar”
Në vitin 1982, realizon pjesën teatrale “Kosovë zog i diellit” sipas tekstit të Din Mehmetit
Pas vrasjes së Jusuf Gërvallës, me të cilin Reshati mbante kontakte dhe takime, realizon dramën “Procesi” që ishte dorëshkrim i vetëm.
Është autor i romanit “Rruga pa kthim”- 1984
Në vitin 1984 realizon filmin televiziv “Kosovë shqiponjë e robëruar”
Në vitin 1985, luan në filmin franko-amerikan “Prilli i thyer”, regjia Lirie Begeja, sipas romanit të Ismail Kadares
Prej vitit 1988-1999, është anëtar i Komisionit të Festivalit të filmit Mesdhetar në Belgjikë, seksionit Kosovë.
Në vitin 1993, realizon filmin dokumentar “Atdheu mbi të gjitha”(mbi vrasjen e Vehbi Ibrahimit)
Në vitin 1994, skenarist i filmit “Kosova është gjaku ynë që nuk falët” (film dokumentar mbi vrasjen e Enver Hadrit).
Në vitin 1997, luan në filmin “ A D” , në Regji të Isa Qosjes.
Në vitin 1983, emërohet sekretar për marrëdhënie me jashtë në Komitetin për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut, kryetar i të cilit ishte Enver Hadri.
Pas vrasjes së Enver Hadrit , bashkë me Behare Rexhepin krijon Byronë Informative e Republikës së Kosovës , ku e vazhdon aktivitetin patriotik pa ndërpre gjerë në përfundimin e luftës në Kosovë.
Në Parlamentin Europian veç aranzhimeve te takimeve zyrtare të personaliteteve kosovare, Reshati kontribuoi edhe në aprovimin e të gjitha rezolutave nga Parlamentin Europian, për situatën dramatike në Kosovë qe nga viti 1990 e deri më 1999.
Reshat Sahitaj ishte ndërmjetësues i kontaktëve të para diplomatike në mes të të gjithë personaliteteve kosovare në Parlamentin Europian, Senatin Belg, dhe NATO.

Ne verën e 1998, në lokalet e OKB-së në Gjenevë, Reshat Sahitaj në bashkëpunim me senatoren Anne Marie –Lizin, organizoi konferencën e parë për shtyp të UÇK-së, ku mori pjesë edhe Bardhyl Mahmuti e Agush Buja.
Pas çlirimit emërohet Drejtor për Marrëdhënie me Jashtë Në ministrinë e Kulturës në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës deri me 31.01.2000
Në vitin 2001 boton librin “Emri, varri im” (mbi Enver Hadrin)
Ka përkthyer librin”Manuali i luftëtarit të dritës” (nga Paulo Koelho, Prishtinë, 2001)

**Interpretimet në teatër dhe film:**
“Sfinga e gjallë”, në Regji të Sefo Beta Krasniqit, 1977
“Vdekja e Gjergjezit”, radiodramë për RTP, 1978.
“Rropullari”, film televiziv i RTP, 1978.
“Prilli i thyer”, film Frëngo-amerikan, Francë 1985.
“AD”, film në regji të Isa Qosjës, luajnë:Ilir Shaqiri, Reshat Arbana… 1997.
“Zemër e vetmuar”, serial televiziv TV21, 2004. etj.
Autor i emisionit letrar “Labirintet e fjalës” në RTK- 2006

**Libra të botuara:**
“Rojtari i Shqipërisë së harruar”- tregime-1982.
“Rruga pa kthim” – roman- 1983
“Mali i ndaluar”- roman- 2003
“Ëndrra e nuses”- tregime – 2004
“Jeta e dyfishtë”- roman - 2005
“ 7 minutat e fundit “ – roman - 2007
“Diku e diku “ – roman - 2008
“Idealistet “ pjesa e parë –monografi 2010
Qe nga qershori i vitit 1999, jeton në Prishtinë.
Merret me shkrime publicistike, analiza, film, teatër; në gazetat: “Kosova sot”, “Koha ditore”, “Epoka e re”, “Lajmi”, Bota sot”, Zëri ditor” etj.

Qe nga viti 2009, është kryetar i “Unionit të Shkrimtarëve dhe Kritikëve Shqiptarë”.
Në nëntor të vitit 2010, në mbledhjen e Parisit, emërohet nënkryetar i rrjetit botëror të Shkrimtarëve dhe Kritikëve në seksionin frankofon, ku njëherit është anëtar i kësaj kryesie.

**Reshat Sahitaj**
**MUSA (Daut) HOTI**
***- Shënime, kujtime, përjetime, dokumente -***

UNIONI I SHKRIMTARËVE DHE KRITIKËVE SHQIPTARË –PRISHTINË
L'UNION DES ECRIVAINS ET DES CRITIQUES ALBANAIS
E-mail: **unioni_shkrimtareve@hotmail.fr**

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

94(=18:496.51)(092)
929(496.51)Hoti, Musa

Sahitaj, Reshat
Musa (Daut) Hoti : shënime, kujtime, përjetime, dokumente / Reshat Sahitaj. - Prishtinë : Abdullah Hoti, 2011. - 400 f. : ilustr. ; 24 cm.

Në vend të parathënies : f. 4-7. - Biografia e autorit : f. 397-400

**ISBN 978-9951-8595-9-2**